



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR

**PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN**  
**2023 – 2025**

**Dhjetor 2022**

# PASQYRA E LËNDËS

<b>PJESA I: HYRJE</b> .....	<b>8</b>
1.1 ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN .....	8
1.2 MENAXHIMI I PROCESIT TË NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT .....	9
1.3 PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2023 – 2025 .....	11
<b>GRUPIMI I: THEMELORËT</b> .....	<b>14</b>
KRITERI POLITIK.....	14
<i>Demokracia dhe shteti i së drejtës</i> .....	14
Kuvendi.....	15
Zgjedhjet.....	22
Qeverisja.....	24
Reforma në Administratën Publike .....	32
Sistemi gjyqësor dhe reforma në sistemin e drejtësisë.....	52
Anti-korrupsioni.....	52
<i>Të drejtat e njeriut</i> .....	52
<i>Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare</i> .....	52
Bashkëpunimi rajonal .....	53
Marrëdhëniet Bashkimi Evropian – Shqipëri .....	58
KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT E NJERIUT .....	60
23.1 Përmbajtja e kapitullit.....	60
23.2 Struktura e kapitullit .....	61
23.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	61
23.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	62
23.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	106
23.6 Mangësitë e identifikuar dhe Prioritetet.....	107
KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA .....	130
24.1 Përmbajtja e kapitullit.....	130
24.2 Struktura e kapitullit .....	131
24.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	131
24.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore.....	132
24.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	150
24.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet.....	151
KRITERI EKONOMIK.....	156
<i>Funksionimi i ekonomisë së tregut</i> .....	156
<i>Kapacitetet për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian</i> .....	185
KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK .....	191
5.1 Përmbajtja e kapitullit.....	191
5.2 Struktura e kapitullit .....	192
5.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis-së së Bashkimit Evropian .....	192
5.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore.....	192
5.5 Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse .....	195
5.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	196
KAPITULLI 18: STATISTIKAT .....	197
18.1 Përmbajtja e kapitullit .....	197
18.2 Struktura e kapitullit .....	198
18.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian.....	198

18.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	199
18.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	214
18.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	215
<b>KAPITULLI 32: KONTROLI FINANCIAR .....</b>	<b>216</b>
32.1 Përmbajtja e kapitullit .....	216
32.2 Struktura e kapitullit .....	216
32.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	217
32.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	217
32.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	226
32.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	227
<b>GRUPIMI II: TREGU I BRENDSHËM .....</b>	<b>232</b>
<b>KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE .....</b>	<b>232</b>
1.1 Përmbajtja e kapitullit .....	232
1.2 Struktura e kapitullit .....	232
1.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	233
1.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	235
1.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	250
1.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	250
<b>KAPITULLI 2: LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE .....</b>	<b>254</b>
2.1 Përmbajtja e kapitullit .....	254
2.2 Struktura e kapitullit .....	254
2.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	254
2.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	255
2.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	260
2.6 Mangësitë e Identifikuar dhe prioritet .....	260
<b>KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE .....</b>	<b>261</b>
3.1 Përmbajtja e kapitullit .....	261
3.2 Struktura e kapitullit .....	262
3.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	262
3.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	265
3.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	272
3.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	273
<b>KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT .....</b>	<b>275</b>
4.1 Përmbajtja e kapitullit .....	275
4.2 Struktura e kapitullit .....	277
4.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	277
4.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	277
4.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	282
4.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	282
<b>KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE .....</b>	<b>283</b>
6.1 Përmbajtja e kapitullit .....	283
6.2 Struktura e kapitullit .....	283
6.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	283
6.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	285
6.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	295
6.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	295
<b>KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE .....</b>	<b>297</b>
7.1 Përmbajtja e kapitullit .....	297

7.2	Struktura e kapitullit .....	297
7.3	Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	297
7.4	Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	298
7.5	Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	307
7.6	Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	307
KAPITULLI 8: POLITIKA E KONKURRENCËS .....		310
8.1	Përmbajtja e kapitullit .....	310
8.2	Struktura e kapitullit .....	311
8.3	Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	311
8.4	Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	312
8.5	Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	316
8.6	Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	317
KAPITULLI 9: SHËRBIMET FINANCIARE .....		318
9.1	Përmbajtja e kapitullit .....	318
9.2	Struktura e kapitullit .....	319
9.3	Kërkesat e MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	319
9.4	Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	319
9.5	Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	328
9.6	Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	328
KAPITULLI 28: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETIT .....		329
28.1	Përmbajtja e kapitullit .....	329
28.2	Struktura e kapitullit .....	330
28.3	Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	330
28.4	Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	331
28.5	Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	346
28.6	Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	347
<b>GRUPIMI III: KONKURRUESHMËRIA DHE RRIJTJA GJITHËPËRFSHIRËSE .....</b>		<b>349</b>
KAPITULLI 10: SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA .....		349
10.1	Përmbajtja e kapitullit .....	349
10.2	Struktura e kapitullit .....	350
10.3	Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	350
10.4	Situata aktuale në Shqipëri .....	351
10.5	Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse .....	357
10.6	Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	357
KAPITULLI 16: TATIMET .....		358
16.1	Përmbajtja e kapitullit .....	358
16.2	Struktura e kapitullit .....	358
16.3	Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	358
16.4	Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	360
16.5	Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	364
16.6	Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	364
KAPITULLI 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE .....		366
17.1	Përmbajtja e kapitullit .....	366
17.2	Struktura e kapitullit .....	366
17.3	Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	366
17.4	Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	367
17.5	Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	373
17.6	Mangësitë e identifikuar dhe Prioritetet .....	373

KAPITULLI 19: POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI .....	375
19.1 Përmbajtja e kapitullit .....	375
19.2 Struktura e kapitullit .....	375
19.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	375
19.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	376
19.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	399
19.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	400
KAPITULLI 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE .....	404
20.1 Përmbajtja e kapitullit .....	404
20.2 Struktura e kapitullit .....	405
20.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	405
20.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	406
20.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	417
20.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	417
KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR .....	418
25.1 Përmbajtja e kapitullit .....	418
25.2 Struktura e kapitullit .....	418
25.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	418
25.4 Situata aktuale dhe arritjet kryesore .....	419
25.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	423
25.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	423
KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA .....	424
26.1 Përmbajtja e kapitullit .....	424
26.2 Struktura e kapitullit .....	425
26.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe Acquis së Bashkimit Evropian .....	425
26.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	425
26.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	436
26.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	437
KAPITULLI 29: BASHKIMI DOGANOR.....	438
29.1 Përmbajtja e kapitullit .....	438
29.2 Struktura e kapitullit .....	438
29.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	438
29.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	439
29.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	446
29.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	447
<b>GRUPIMI IV: AGJENDA E GJELBËR DHE KONEKTIVITETI I QËNDRUESHËM .....</b>	<b>449</b>
KAPITULLI 14: POLITIKA E TRANSPORTIT .....	449
14.1 Përmbajtja e kapitullit .....	449
14.2 Struktura e kapitullit .....	449
14.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	449
14.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	451
14.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	455
14.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	455
KAPITULLI 15: ENERGJIA.....	457
15.1 Përmbajtja e kapitullit .....	457
15.2 Struktura e kapitullit .....	457
15.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	457
15.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	458

15.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	465
15.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	465
KAPITULLI 21: RRJETET TRANS-EVROPIANE .....	467
21.1 Përmbajtja e kapitullit .....	467
21.2 Struktura e kapitullit .....	467
21.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	468
21.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet .....	469
21.5 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse .....	476
21.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	477
KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE .....	478
27.1 Përmbajtja e kapitullit .....	478
27.2 Struktura e kapitullit .....	478
27.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	479
27.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	479
27.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	498
27.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	499
<b>GRUPIMI V: BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI .....</b>	<b>504</b>
KAPITULLI 11: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL .....	504
11.1 Përmbajtja e kapitullit .....	504
11.2 Struktura e kapitullit .....	505
11.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	505
11.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	506
11.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	511
11.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	511
KAPITULLI 12: POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE .....	515
12.1 Përmbajtja e kapitullit .....	515
12.2 Struktura e kapitullit .....	515
12.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian .....	515
12.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	518
12.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	527
12.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritet .....	527
KAPITULLI 13: PESHKIMI .....	530
13.1 Përmbajtja e kapitullit .....	530
13.2 Struktura e kapitullit .....	530
13.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	530
13.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	532
13.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	534
13.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet .....	534
KAPITULLI 22: POLITIKAT RAJONALE DHE BASHKËKOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTUROR .....	535
22.1 Përmbajtja e kapitullit .....	535
22.2 Struktura e kapitullit .....	536
22.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian .....	536
22.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore .....	537
22.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse .....	550
22.6 Mangësitë dhe prioritetet e identifikuar .....	551
KAPITULLI 33: DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE .....	553
33.1 Përmbajtja e kapitullit .....	553
33.2 Struktura e kapitullit .....	553

33.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian.....	553
33.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore.....	554
33.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse.....	555
33.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet.....	556
<b>GRUPIMI VI: MARRËDHËNIET ME JASHTË.....</b>	<b>558</b>
KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË.....	558
30.1 Përmbajtja e kapitullit.....	558
30.2 Struktura e kapitullit.....	558
30.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian.....	558
30.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore.....	559
30.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse.....	567
30.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet.....	567
KAPITULLI 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES.....	570
31.1 Përmbajtja e kapitullit.....	570
31.2 Struktura e kapitullit.....	570
31.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian.....	571
31.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore.....	571
31.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse.....	588
31.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet.....	588

## PJESA I: HYRJE

### 1.1 Anëtarësimi në Bashkimin Evropian

Me 19 korrik 2022, u mbajt Konferenca e parë Ndërqeveritare BE-Shqipëri, si dhe një konferencë politike ndërqeveritare BE-MV, në përputhje me një qasje të dakordësuar dyhapëshe, sipas së cilës, Konferenca ndërqeveritare për nisjen e negociatave zyrtarisht me Maqedoninë e Veriut do të jetë pasi kjo të ketë kryer ndryshimet e nevojshme kushtetuese, sipas kompromisit dypalësh me Bullgarinë.

Delegacioni i Shqipërisë në Konferencën e parë Ndërqeveritare u kryesua nga Kryeministri z. Edi Rama dhe në përbërjen e tij kishte Ministren për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj. Olta Xhaçka dhe Kryenegociatorin e Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, Z. Zef Mazi, si dhe grupin negociator të Shqipërisë. Delegacioni i BE-së në Konferencën e parë Ndërqeveritare u kryesua nga Z. Jan Lipavský, Ministër i Punëve të Jashtme të Republikës Çeke, ndërsa Komisioni Evropian u përfaqësua nga Olivér Várhelyi, Komisioner për Fqinjësinë dhe Zgjerimin dhe EEAS, nga Zëvendëspresident i Komisionit dhe Përfaqësuesi i Lartë, Z. Josep Borrell.<sup>1</sup>

Hapja zyrtare e negociatave të anëtarësimit me BE-në e kthen Shqipërinë zyrtarisht në një vend negociues, një hap më pranë anëtarësimit dhe një hap cilësor në bashkëpunimin me BE-në.

Hapja e negociatave është një objektiv i përmbushur i programit të qeverisë shqiptare. Me mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare, Bashkimi Evropian konfirmoi edhe punën dhe arritjet e qeverisë shqiptare në fushën e kriterëve politike, si reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe vlerat evropiane ose duke e drejtuar politikën e jashtme bazuar në ato parime.

Ecuria e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE do të varet nga plotësimi nga Shqipëria të kriterëve të Kopenhagenit dhe nga aftësia e BE që në të ardhmen të pranojë anëtarë të rinj. Në bazë të metodologjisë së re të negociatave, që u miratua nga Këshilli në mars 2020, Shqipërisë do t'i jepet mundësia të negociojë të gjashtë grupimet e kapitujve (clusters), duke nisur nga grupimi “Thelbësorët”. Përtej detyrimeve për t'u përmbushur, në aspektin e brendshëm, kjo do të sjellë një rritje cilësore të standardeve dhe kapaciteteve brenda vendit.

Statusi i vendit negociues do krijojë mundësi për përfshirje më të madhe në programet, strukturat apo politikat e BE-së që përpara anëtarësimit, duke siguruar integrimin gradual të Shqipërisë dhe njëkohësisht duke ndikuar edhe në rritjen e kapacitetit të përthithjes së anëtarëve të rinj nga BE.

Gjatë Konferencës së parë Ndërqeveritare BE-Shqipëri për nisjen e negociatave të anëtarësimit, Këshilli ftoi Komisionin që të vazhdojë të vlerësojë gjendjen e gatishmërisë së Shqipërisë për

---

<sup>1</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/first-intergovernmental-conferences-albania-and-north-macedonia-kick-start-accession-negotiation-2022-07-19\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/first-intergovernmental-conferences-albania-and-north-macedonia-kick-start-accession-negotiation-2022-07-19_en)



hapjen e negociatave në fusha specifike dhe të identifikojë çështjet që do të dalin me shumë gjasa në negociata, duke filluar nga grupimi “Themelorët”, i cili në përputhje me kornizën negociuese, do të hapet pasi Shqipëria të ketë përmbushur kriteret përkatëse të dakorduara nga Këshilli.

Në të njëjtën ditë, më datë 19 korrik 2022, pas mbajtjes së Konferencës së parë Ndërqeveritare, u zhvillua një takim formal me të cilin Komisioni, bazuar në mandatin e Këshillit të marsit 2020, nisi formalisht procesin e shqyrtimit analitik të *acquis* (*screening*).

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022, u zhvilluan takimit shpjeguese për të gjithë kapitujt e grupimit “Themelorët” dhe “Tregu i brendshëm”. Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan edhe takimet bilaterale të grupimit “Themelorët”. Ndërkohë takimet bilaterale për grupimin “Tregu i brendshëm” do të zhvillohen gjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2023 pritet që të përfundojë procesi *screening* për të gjithë grupimet e kapitujve negociues.

## 1.2 Menaxhimi i procesit të negociatave të anëtarësimit

Roli i Kuvendit të Shqipërisë, në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian rregullohet me Ligjin nr. 15/2015, datë 5.03.2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Në përputhje me këtë Ligj, është ngritur dhe funksionon Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integritimin evropian. Këshilli Kombëtar i Integritit Evropian nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritit.

Në zbatim të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave paraqet çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisionin e Integritit Evropian një raport të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të detyrimeve në kuadër të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian, procesin e negociatave të anëtarësimit dhe menaxhimin e asistencës së Bashkimit Evropian. Këshilli i Ministrave paraqet edhe një raport të veçantë mbi Raportin vjetor të Komisionit për Shqipërinë.

Për sa i përket koordinimit ndërinstitucional, Qeveria shqiptare realizoi rikonceptualizimin e plotë të strukturave përgjegjëse për integritimin evropian. Ky proces u krye duke pasur parasysh se negociatat e anëtarësimit janë një proces tepër teknik dhe kompleks, të cilat kërkojnë një koordinim sa më të mirë dhe për një përdorim sa më eficient të kapaciteteve institucionale të administratës publike shqiptare.

Ky proces u iniciua me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Për zbatimin e këtij Vendimi u miratuan aktet e mëposhtme:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 422, datë 6.05.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, i ndryshuar<sup>2</sup>;
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 93, datë 20.05.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës”;
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”;
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin evropian”.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, në maj 2020 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 422, datë 6.05.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Ky Vendim (i ndryshuar) emëroi Kryenegociatorin për aderimin e Shqipërisë në BE dhe Grupin Negociator të përbërë nga 23 negociatorë. Vendimi përcakton përgjegjësitë e tyre në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, përfshirë në hartimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 517, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit dhe kryenegociator”, u vendos që Kryenegociatori të jetë edhe ministër shteti në Këshillin e Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton se misioni i ministrit të shtetit dhe kryenegociator është “drejtimi teknik i negociatave dhe bashkërendimi i brendshëm i procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet zhvillimit të procesit teknik të negocimit, bashkërendimit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian, bashkërendimit të prioritetëve, hartimit dhe propozimit të politikave, bashkërendimit të kuadrit strategjik të lidhur me anëtarësimin, zhvillimit të kapaciteteve, rritjes së performancës për arritjen e rezultateve, si dhe informimit të publikut për këto procese”.

---

<sup>2</sup> Ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 994, datë 9.12.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit, për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 746, datë 9.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit, për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018 përcakton se Grupi Negociator “monitoron dhe bashkërendon zbatimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të dokumenteve strategjike për procesin e Integritimit Evropian” dhe “drejton procesin e përditësimit të planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”.

Për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ministri përgjegjës për integrimin evropian përditëson çdo vit Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, si instrumenti planifikues për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 u miratua nga Këshilli i Ministrave me Vendimin e tij Nr. 91, datë 9.02.2022, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024”.

Nga monitorimi i realizimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024, vërehet se, për vitin 2022, u miratuan 59 akte ligjore me përafrim të pjesshëm dhe/ose të plotë.

### 1.3 Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafruar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Njëkohësisht, përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Procesi i negociatave të anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian ka për qëllim të koordinojë këtë proces përafrimi duke synuar njëkohësisht plotësimin e detyrimeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe detyrimet që lindin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hartimi në kohë dhe me cilësi i Planit dhe monitorimi i tij janë parakusht për përshpejtimin e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Cikli i hartimi dhe monitorimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian përbëhet nga këto procese:

1. Puna përgatitore;
2. Analiza e mangësive;
3. Planifikimi;
4. Hartimi dhe kontrolli i cilësisë;
5. Konsultimi dhe miratimi;
6. Monitorimi, raportimi, dhe vlerësimi.

**Figura: Lidhja mes proceseve të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian**



Veçanërisht të rëndësishme në këtë cikël planifikimi dhe monitorimi janë fazat e analizës së mangësive dhe planifikimit. Rezultati i këtyre proceseve mishërohet në dokumentin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, i cili tregon prioritetet e përafrimit të legjislacionit, ministrinë përgjegjëse për hartimin e projektakteve, shkallën e përafrimit, si dhe datën e pritshme (paraprake) të miratimit.

Identifikimi i masave ligjore që do të përfshiheshin në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025 që në fillim të muajit shtator 2022. Në këtë fazë, të gjitha ministrinë dhe institucionet koordinuese u udhëzuan që të fillojnë analizën e mangësive dhe identifikimin e prioritetëve duke marrë në konsideratë përgjegjësitë në kuadër të strategjive ekzistuese ndërsektoriale/ sektoriale dhe hapësirën fiskale, sikurse përcaktuar gjatë fazës së parë të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025.

Njëkohësisht filloi edhe përditësimi i metodologjisë së hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, bazuar në eksperiencën e hartimit të Planeve të mëparshme. Metodologjia e hartimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2023 – 2025 u miratua nga Grupi Negociator në tetor 2022.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2023 – 2025 përfshin masa ligjore dhe zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme që shtrihen deri në vitin 2025, duke synuar përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian nëpërmjet masave me karakter ligjor dhe masave me karakter strategjik.

PKIE-ja është e strukturuar në këto pjesë kryesore:

- Hyrja, në të cilën jepet një përshkrim i shkurtër i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, strukturat e koordinimit në këtë proces dhe një përshkrim i vetë PKIE;
- Pjesa narrative e cila është e strukturuar sipas grupimeve negociuese në përputhje me metodologjinë e re të procesit të negociatave dhe më pas në kapituj negociues;
- Pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve negociues.

Plani nuk përfshin Kapitullin 34: Institucionet dhe Kapitullin 35: Çështje të tjera. Kapitulli 34 rregullon pjesëmarrjen e shtetit anëtar në institucionet e Bashkimit Evropian, ndërsa, Kapitulli 35 (aktet ligjore të BE-së që bëjnë pjesë në këtë kapitull) përvijon fazat e fundit të negociatave për anëtarësim.

## GRUPIMI I: THEMELORËT

### KRITERI POLITIK

Interesi kryesor kombëtar dhe qëllimi strategjik i Qeverisë të Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në BE. Kriteret e anëtarësimit përcaktojnë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si edhe ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, si shtyllat kryesore të politikës kombëtare dhe politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë konsideron se përmbushja e Kriterit Politik mbart rëndësi thelbësore në procesin e anëtarësimit të BE-së. Gjithashtu, Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme në jetësimin e prioritetëve kyçe që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administratën publike.

#### Demokracia dhe shteti i së drejtës

Qeveria e Shqipërisë është plotësisht e angazhuar për të ndërmarrë dhe zbatuar të gjitha reformat e nevojshme për të forcuar procesin legjislativ, sistemin zgjedhor, qeverisjen qendrore dhe lokale, administratën publike, si dhe sistemin e drejtësisë. Fokusi i punës së Qeverisë Shqiptare do të jetë zbatimi i reformave të nevojshme për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) BE-Shqipëri dhe në veçanti, për të adresuar rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian 2022 për Shqipërinë.

Përsa i takon administratës publike, Qeveria Shqiptare është e angazhuar për zbatimin e një reforme të mirëfilltë, për trajtimin dhe vlerësimin e bazuar në merita dhe angazhimin e punonjësve duke krijuar një rrjet institucional efektiv dhe efikas që ofron shërbime më të mira për qytetarët. Gjithashtu, Qeveria shqiptare ka si objektiv përfundimtar krijimin e një administrate publike efikase, të aftë për të zbatuar plotësisht angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Çdo veprim i ndërmarrë nga Qeveria në kuadër të reformës së sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit ka për qëllim përfundimtar krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe llogaridhënës në Shqipëri, i cili është në gjendje të ofrojë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe për të zbatuar legjislacionin e përafuar me *acquis*-në e BE-së.

Lufta kundër korrupsionit është një prioritet kyç i Qeverisë Shqiptare. Drejtimet kryesore të politikës antikorupsion përfshijnë një sërë masash për parandalimin e korrupsionit, forcimin e institucioneve, monitorimin e përgjithshëm nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe ndëshkimin përmes masave të natyrës administrative dhe/ose penale të zyrtarëve të korruptuar. Zbatimi i

Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023 ka synuar të kontribuojë në reduktimin e qëndrueshëm të korrupsionit si dhe marrjen e masave efektive për parandalimin e korrupsionit në të gjitha nivelet.

Gjithashtu, Qeveria Shqiptare angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti për zbatimin e mëtejshëm të politikave kundër diskriminimit, për të përmirësuar situatën në lidhje me të drejtat sociale me fokus të veçantë në grupet vulnerabël dhe të miturit. Reformat përfshijnë fushën e të drejtave të pronësisë ashtu edhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të GjEDNj-së për kthimin dhe kompensimin e pronës.

### *Kuvendi*

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë luan një rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vendit. Kuvendi përfaqëson vullnetin e popullit dhe është mbrojtësi i vlerave të demokracisë. Si organi i zgjedhur që përfaqëson popullin shqiptar, Kuvendi është organi ligjvënës, i cili shqyrton dhe miraton ligje në dobi të interesave të shoqërisë dhe të zhvillimit të vendit. Kuvendi ushtron funksionin e kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit dhe monitoron institucionet e pavarura. Gjithashtu, Kuvendi luan një rol thelbësor në procesin e integritetit evropian të vendit, duke garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor dhe politik të procesit.

Gjatë periudhës janar – tetor 2022 Kuvendi ka bërë progres të rëndësishëm në plotësimin e rekomandimeve të Raportit 2021 të Komisionit Evropian për Shqipërinë të cilat lidhen me funksionimin e Kuvendit. Kuvendi hartoi dhe miratoi Planin e tij të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili përmban 3 objektiva kryesore të punës së Kuvendit për periudhën tetor 2021 – tetor 2022 si dhe masa konkrete (26 masa) për realizimin e këtyre objektivave. Zbatimi i masave të Planit të Veprimit është monitoruar në vazhdimësi përmes raportimeve periodike që Shërbimet e Kuvendit i kanë dërguar Konferencës së Kryetarëve dhe Ministrisë së Drejtësisë. Deri në përfundimin e afatit për zbatimin e Planit të Veprimit (6 Tetor 2021), nga 26 masat e parashikuara, 23 masa (ose 88%) u realizuan plotësisht, 2 masa (ose 8%) u realizuan pjesërisht dhe 1 masë<sup>3</sup> (ose 4%) nuk është realizuar.

Roli legjislativ i Kuvendit është rritur ndjeshëm gjatë periudhës janar – tetor 2022, nëpërmjet shtimit të nismave ligjore të propozuara nga vetë deputetët (26 nisma ligjore) si dhe amendamenteve të propozuara drejtpërdrejt nga deputetët për projektligjet e shqyrtuara nga Kuvendi (231 amendamente). Nga 211 projektligjet e depozituara në Kuvend për shqyrtim dhe miratim 26 nisma ligjore (ose 12%) janë propozuar nga deputetët.

---

<sup>3</sup> Reflektimi i Opinioneve të Komisionit të Venecias CDL-REF(2020)007-e në ligjin e medias dhe miratimi i ndryshimeve ligjore në Kuvend pasi me Vendimin Nr. 22, datë 15.11.2022 të Konferencës së Kryetarëve është miratuar me konsensus heqja nga kalendari i Dekretit të presidentit të Republikës Nr. 11413, datë 11.01.2020, “Për kthimin e ligjit Nr. 91/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 97/2013 Për mediat “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Gjatë periudhës janar – tetor 2022, Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi 183 akte parlamentare nga të cilat 72 ligje, 80 vendime dhe 29 rezoluta<sup>4</sup>. Nga 72 ligjet e miratuara gjatë kësaj periudhe, 1 ligj është miratuar me shumicë të cilësuar prej 2/3, 35 ligje janë miratuar me shumicë absolute dhe 36 ligje janë miratuar me shumicë të thjeshtë. Komisionet e përhershme të Kuvendit kanë shqyrtuar dhe miratuar 72 projektligje, 80 projektvendime dhe 29 projektrezoluta. Komisionet kanë zhvilluar 290 mbledhje. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komisione, deputetët kanë propozuar 231 amendamente, të cilat janë miratuar edhe në seancë plenare. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komisione përfaqësuesit e qeverisë iu përgjigjën 2349 pyetjeve të deputetëve mbi projektligjet.

Gjithashtu, Komisionet i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë dëgjësive me grupet e interesit (79 përfaqësues të grupeve të interesit) si dhe marrjes së mendimit dhe sugjerimeve të tyre për projektligjet e propozuara Kuvendit. Gjatë periudhës raportuese rezulton se nga 231 amendamentet e propozuara në Komisionet parlamentare, 31 (ose 13.4%) janë amendamente të cilat bazohen në vërejtjet e paraqitura nga grupet e interesit për projektligjet përkatëse.

Transparenca në procesin ligjvënës të Kuvendit është forcuar më tej, përmes ngritjes së platformës online për konsultimin e projektligjeve si dhe transmetimit të mbledhjeve të komisioneve parlamentare drejtpërdrejt në kanalën televiziv të dedikuar Kuvendit dhe në mediat sociale.

Kuvendi ka forcuar kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara me *acquis* të BE-së, duke garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafuar. Gjatë periudhës janar – tetor 2022, Kuvendi dhe KIE kanë miratuar 7 ligje që synonin përafrim të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së. Komisioni për Integrimin Europian (KIE) ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces. Gjatë shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve që synonin përafrimin me *acquis* të BE-së (7 projektligje gjatë periudhës janar – tetor 2022), KIE ka propozuar 57 amendamente, me qëllim për të siguruar një përafrim më të saktë të projektligjeve me *acquis* të BE-së, të cilat janë miratuar edhe në seancën plenare.

Roli kontrollues i Kuvendit u forcua më tej gjatë periudhës janar – tetor 2022, përmes përdorimit më intensiv dhe cilësor të instrumenteve të mbikëqyrjes parlamentare të parashikuara në Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit dhe Ligjin Nr. 15/2015 (23 interpelanca me anëtarë të Këshillit të Ministrave; 13 seanca dëgjimore në Komisione me ministrat, zëvendësministrat dhe drejtues të institucioneve të tjera qendrore; 181 kërkesa për informacion me shkrim nga deputetët; Ministrat, Zëvendësministrat dhe drejtues të institucioneve të tjera qendrore u paraqitën në 13 seanca dëgjimore para komisioneve të përhershme parlamentare dhe iu përgjigjën 166 pyetjeve të deputetëve.

Gjatë periudhës janar – tetor 2022, Kuvendi ka miratuar ngritjen e 3 komisioneve të posaçme parlamentare. Kuvendi me Vendimin Nr. 12/2022, datë 10.02.2022 dhe Nr. 48/2022 datë 9.06.2022 vendosi ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar “Për realizimin e reformës

---

<sup>4</sup> Të dhënat e Kuvendit janë për periudhën 1 janar – 31 tetor 2022.



zgjedhore”. Komisioni përbëhet nga 18 anëtarë me përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare. Objekti i punës së komisionit është hartimi i ndryshimeve legislative për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe për zgjedhjet e mëparshme të patrajuara, rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe organizatave jofitimprurëse.

Gjatë kësaj periudhe Komisioni zhvilloi 4 mbledhje. Kuvendi miratoi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit deri në mars 2023. Komisioni ka caktuar ekspertë për përgatitjen e draftpropozimeve për ndryshime ligjore që do të shqyrtohen prej tij.

Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin Nr. 13/2022, datë 10.2.2022 vendosi ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar “Për Reformën Administrativo - Territoriale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me vendimin Nr. 49/2022, datë 09.06.2022. Komisioni ka objekt veprimtarie, përcaktimin e kritereve për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë, hartimin dhe përcaktimin e kalendarit të zbatimit të reformës administrative-territoriale dhe përgatitjen e projektit për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë, me përfaqësim të barabartë mbi bazën e barazisë pozitive-opozitive.

Komisioni i Posaçëm “Për Reformën administrativo - territoriale” gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar 19 mbledhje, ndër të cilat 13 seanca dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, ekspertë, përfaqësues të botës akademike, përfaqësues të institucioneve publike dhe private, 2 mbledhje për prezantimin e raporteve paraprake të ekspertëve të mazhorancës dhe opozitës. Në përfundim të punimeve Komisioni doli me dy raporte (i shumicës parlamentare dhe i opozitës parlamentare). Të dy raportet i janë dërguar seancës plenare dhe iu nënshtruan debatit parlamentar.

Me Vendimin e Kuvendit Nr. 66, datë 8.09.2022 është ngritur dhe funksionon, Komisioni i Posaçëm Parlamentar "Për hartimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin Nr. 15, datë 5.03.2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e Integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Ky komision përbëhet nga 8 anëtarë (4 nga pozita dhe 4 nga opozita dhe ka dy bashkë-kryetarë. Afati i punës së këtij Komisioni është deri në datën 8 Shkurt 2023. Deri më sot ky Komision ka zhvilluar 5 takime.

Roli kontrollues i Kuvendit në çështjet e integritimit evropian është forcuar më tej gjatë periudhës janar – tetor 2022. Komisioni për Integritimin Evropian (KIE) dhe Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE) kanë luajtur një rol kyç për monitorimin e reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritimit evropian të Shqipërisë.

Në datën 1.11.2022 KIE ka zhvilluar një seancë dëgjimore me Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator në lidhje me gjetjet e Raportit të Komisionit Evropian 2022 dhe Grupimin 1 “Çështjet Themelore”.

KKIE ka vijuar të organizojë takimet periodike dhe ato ndërgjegjësuere mbi zbatimin e detyrimeve në kuadër të procesit të integrimit me Bashkimin Evropian. Gjatë periudhës janar – tetor 2022 janë zhvilluar në total 9 takime si më poshtë:

- Në datën 8.02.2022 u mbajt mbledhja e radhës e KKIE ku u diskutuan temat: i) Ecuria e procesit të integrimit evropian, përfshirë një raport për zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe asistencës financiare të BE-së për vitin 2021, ku raportoi Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme; ii) Përgatitja për mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare me BE-në, duke përfshirë informacionin për përgatitjen e administratës publike për procesin e negociatave, numrin e tryezave të diskutimit dhe konsultimit për kapitujt dhe numrin e takimeve të këtyre tryezave ku raportoi Kryenegociatori i Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Në këtë mbledhje u prezantua, diskutua dhe miratua Raporti Vjetor i KKIE për vitin 2021.
- Në datën 28.03.2022, u zhvillua tryeza e rrumbullakët me temë: “Sfidat e Shqipërisë gjatë negociatave me Bashkimin Evropian”. Në takim morën pjesë Ambasadori i Delegacionit të BE, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe Kryenegociatori i Shqipërisë me Bashkimin Evropian, të cilët u ndalën në hapat që ka hedhur deri më tani Shqipëria në procesin e integrimit evropian. Në këtë takim, përveç anëtarëve dhe të ftuarve të përhershëm të KKIE-së morën pjesë ambasadorë dhe përfaqësues të ambasadave të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.
- Më 11.05.2022, KKIE organizoi takimin me temë “Ecuria në luftën kundër krimit të organizuar dhe zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raportin e vitit 2021 për Shqipërinë si dhe Nënkomitetin BE - Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2021”. Të ftuar në takim për të raportuar ishin Ministri i Brendshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të parave.
- Në datën 18.05.2022, KKIE organizoi takimin me temë “Ecuria në luftën kundër krimit të organizuar dhe zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raportin e vitit 2021 për Shqipërinë si dhe Nënkomitetin BE - Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2021”. Të ftuar në takim për të raportuar ishin, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian në datën 24.05.2022 zhvilloi takimin me temë “Përgjigje mbi pyetjet e ngritura nga anëtarët e KKIE gjatë takimit të datës 18 maj 2022 mbi ecurinë në luftën kundër korrupsionit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raportin e vitit 2021 për Shqipërinë si dhe të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2021”.
- Në datën 15.06.2022 u vijua me takimin me temë “Ecuria në reformën e administratës publike dhe zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raportin e vitit 2021 për Shqipërinë, Nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2021 si dhe takimit të fundit të Grupit të Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE – Shqipëri”. I ftuar në takim për të raportuar ishte Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.
- KKIE dhe Lëvizja Evropiane në Shqipëri (EMA), në bashkëpunim me “Slovak Foreign Policy Association” më datë 17 qershor 2022, organizuan Sesionin 1 të Grupit të Punës V “Tregtia dhe Çështjet Ekonomike) “Mjedisi i biznesit në Shqipëri – përditësimi i

legjislacionit shqiptar dhe harmonizimi me *acquis* e BE (Kapitulli 20)”, në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian 2021 – 2023.

- Në datën 6 tetor 2022 u organizua tavolina e rrumbullakët me temë “Hapat që duhet të ndërmerren pas zhvillimit të Konferencës së Parë Ndërqeveritare”. Në këtë event morën pjesë Raportuesi i CDU-së për Ballkanin Perëndimor dhe të gjithë drejtuesit e organeve të pavarura të drejtësisë si, Drejtues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të cilët ndanë mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi temën.
- Në datën 17.10.2022 u organizua një takim i përbashkët i KKIE dhe Komisionit të posaçëm parlamentar të ngritur për hartimin e disa ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integrimit”. Në këtë takim fillimisht ambasadorja e Delegacionit të Bashkimit Evropian prezantoi Raportin vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022. Më pas, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe Ministria e Shtetit dhe Kryenegociatorja me BE së bashku me anëtarët e KKIE diskutuan mbi hapat që duhet të ndërmerren për ndjekjen e rekomandimeve të lëna në raport si dhe rreth iniciativës së Kuvendit për të amenduar Ligjin Nr. 15, datë 5.03.2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e Integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.
- Nga data 24 – 28 tetor 2022 u organizua edicioni i 7-të i Shkollës së Integrimit Evropian. Ky aktivitet u organizua në partneritet me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), Fondacionin Friedrich Ebert. Shkolla e Integrimit Evropian 2022 ofroi një kuadër të plotë teorik dhe praktik mbi zhvillimet më të fundit në BE, skenarët e mundshëm për të ardhmen e tij dhe veçanërisht të ardhmen e procesit të zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor. Lektorë nga Komisioni Evropian konkretisht nga Drejtoria e Zgjerimit, si dhe lektorë nga Universiteti i Oksfordit dhe ai i Selanikut së bashku me ekspertë ndërkombëtarë në çështjet e negociatave nga vende që e kanë kaluar atë fazë siç është Kroacia, ose që po e kalojnë aktualisht këtë fazë si Serbia dhe Mali i Zi pasqyruar eksperiencën e tyre dhe mësimet e marra. Programi përmbante tema të rëndësishme rreth procesit të integrimit evropian si: Sfidat dhe strategjitë e negociatave të anëtarësimit; Negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, hapat e negociatave, kapitulli 23 dhe kriteri politik; Roli i institucioneve të drejtësisë në procesin e negociatave; Roli i mediave në procesin e integrimit evropian; Roli i pushtetit vendor në procesin e integrimit evropian; Financimet e BE-së gjatë fazës së negociatave të Shqipërisë etj. Nga 163 aplikantë, bazuar në një përzgjedhje transparente e cila merr në konsideratë përfaqësimin e të gjithë grupeve të interesit dhe aktorëve të procesit të integrimit u përzgjedhën 38 pjesëmarrës nga organizatat e shoqërisë civile, sektori privat, institucionet e arsimit të lartë, institucionet qendrore, institucionet e varësisë dhe të ato të pavarura, media, bashkitë, partitë politike dhe nga sindikatat.

Kuvendi ka ushtruar kontrollin parlamentar mbi organet kushtetuese apo ato të krijuara me ligj për verifikimin e zbatimit të kuadrit ligjor të miratuar. Gjatë vitit periudhës janar – tetor 2022, 29 institucione të pavarura kanë raportuar në komisionet parlamentare për veprimtarinë e tyre për vitin 2021, nga të cilat 25 institucione të pavarura kanë raportuar edhe në seancë plenare. Kuvendi

ka miratuar në seancë plenare 25 Rezoluta, përmes të cilave ka vlerësuar veprimtarinë vjetore të 25 institucione të pavarura për vitin 2021, si dhe u ka caktuar atyre detyra konkrete për vitin 2022.

Mekanizmi ndërinstitucional “Qeveri-Kuvend-Institucione të Pavarura”, i miratuar me vendimin e Kuvendit Nr. 49/2017 “Për ndjekjen dhe monitorimin sistematik të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj”, sipas Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit është në proces rishikimi. Platforma ndërinstitucionale përditësohet vazhdimisht nga ana e Kuvendit dhe institucioneve të pavarura. Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve ka përpunuar periodikisht çdo 4 muaj të dhënat mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura adresuar ekzekutivit dhe agjencive të varësisë.

Kuvendi në ushtrim të funksionit zgjedhës, gjatë periudhës janar – tetor 2022, miratoi 25 vendime për zgjedhjen ose emërimin e titullarëve dhe/ose anëtarëve të 9 institucioneve të pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj, konkretisht: 3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nga të cilët edhe Guvernatorin, 1 anëtar në Bordin e Entit Rregullator të Energjisë, 2 anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, 2 anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, 1 anëtar në Këshillin Drejtues të Radio-Televizionit Publik Shqiptar, 2 anëtarë të Komisionit të Konkurrencës, 5 anëtarë të Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, 2 Komisionerë të Avokatit të Popullit, 6 anëtarë të Autoritetit të Mediave Audiovizive).

Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.01.2022 ka shpallur vendin vakant, për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi me mbarimin e afatit të aplikimit i ka dërguar KED emrat e kandidatëve së bashku me dokumentacion e depozituar nga kandidatët.

KED në përfundim të verifikimit të kriterëve kushtetuese dhe ligjore dhe të pikëzimit e renditjes së kandidatëve ka përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë emrat e 4 kandidatëve.

Kuvendi në zbatim të dispozitave të nenit 125 të Kushtetutës, nenit 7/c të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese si dhe Rregullores të Kuvendit, ka filluar procedurën e shqyrtimit për vlerësimin e kandidaturave të përcjella nga KED për vendin vakant. Në seancën plenare të datës 22 dhjetor 2022, Znj. Mariana Semini u zgjodh gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

Instituti parlamentar (IP), si strukturë e re në Kuvend që ka në përbërje Shërbimin e Kërkimit dhe Analizës, Shërbimin e Edukimit Qytetar si dhe Shërbimin e Botimeve dhe Bibliotekës Parlamentare, nëpërmjet produkteve kërkimore (me kërkesë dhe proaktive) i mundëson deputetëve analiza kërkimore objektive, të paanshme dhe në kohë për t’i mundësuar vendimmarrje të bazuar në evidenca dhe përmirësuar debatin parlamentar. Për tema më rëndësi të veçantë IP organizon edhe veprimtari me deputetë, ekspertë, shoqërinë civile dhe qytetarë për të ndarë publikisht analizat dhe gjetjet e për të mundësuar një debat publik gjithëpërfshirës dhe të bazuar në evidenca.

Instituti Parlamentar nëpërmjet Shërbimit të Edukimit Qytetar (ShEQ) zbaton programe të edukimit qytetar për grupmosha të ndryshme, kryesisht rinore, për t’i afruar me Kuvendin si dhe për ti dhënë njohuri mbi procesin legjislativ, funksionimin e Kuvendit, demokracinë parlamentare

dhe instrumentet në dispozicion të të rinjve për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse. Disa nga programet edukuese për të cilat ShEQ është përgjegjës dhe ndikojnë, ndër të tjera, në rritjen e transparencës së Kuvendit janë si vijon:

- Programi “Këndvështrimi im” është një lojë simulimi që vendos të rinjtë gjimnazistë përballë sfidës për gjetjen e një zgjidhje ligjërish të aplikueshme për një problem politik, përmes imitimit të proceseve legislative. Qëllimi i këtij programi është rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve për çështjet politike, edukimi i tyre mbi mekanizmat parlamentarë, zhvillimi i mendimit analitik, nxitja e gjykimit kritik dhe aftësimi në të folurën publike;
- Programi “Punishtja e Demokracisë”, është një program edukativ për fëmijët e grupmoshës 8-14 vjeç që promovon vlerat dhe parimet e qeverisjes demokratike përmes ofrimit të informacionit, të përshtatshëm për moshën, mbi çështje politike. Ky program i ndihmon fëmijët të kuptojnë proceset e vendimmarrjes demokratike, i prezanton ata hap pas hapi me procedurat legislative, u mëson parimet bazë të qytetarisë së angazhuar, i aftëson ata si të shprehin opinionin e tyre në mënyrë të pavarur, etj.;
- Programi “Modeli i Parlamentit Shqiptar” drejtohet nën moton “*deputetë fiktivë - ligjbërje e vërtetë*” dhe ka për qëllim organizimin e takimeve periodike me studentë të institucioneve të arsimit të lartë publike dhe jo publike, profili Drejtësi, për simulimin e procesit ligjbërës. Ky program periodik ka karakter edukativ dhe synon njohjen e të rinjve të grup moshës studentore me kulturën e debatit parlamentar konstruktiv;
- Turi Parlamentar u mundëson grupmoshave të ndryshme, duke filluar nga mosha 4-6 vjeç e më të rritur, të vizitojnë sallën e seancave plenare dhe Kryesinë e Kuvendit, të shoqëruar nga personel i kualifikuar, i cili ofron guidë në gjuhën shqipe dhe/ose gjuhën angleze. Gjatë turit vizitorët njihen me historikun e Kuvendit, veprimtarinë e komisioneve, funksionet e Kuvendit si dhe familjarizohen me sallën e seancave plenare, vendet ku ulet qeveria dhe deputetët, ambientet ku zhvillojnë veprimtarinë e tyre Komisionet Parlamentare, Sallën e Grupit Parlamentar, Sallën e Byrosë së Kuvendit, etj.;
- “Dyer të Hapura”, përbëjnë një seri aktivitete të cilat ndodhin paralelisht në ditë të caktuara të vitit, të përzgjedhura mes ditëve të Festave Kombëtare si dhe në ditë të shënuara ndërkombëtare. Gjatë ditëve të hapura, zakonisht, Salla e Seancave Plenare qëndron e hapur për vizitorët, sipas një orari të përcaktuar. Shërbimet e Kuvendit shoqërojnë dhe informojnë qytetarët mbi funksionet e Kuvendit, historikun e parlamentarizmit, përbërjen e legjislaturës aktuale, hapat e procesit ligjbërës, etj. Gjithashtu vizitorëve u ofrohen materiale informuese rreth veprimtarisë e Institutit Parlamentar, programet e edukimit qytetar të ofruara nga Instituti, mënyrat e angazhimit dhe pjesëmarrjes në programet e edukimit qytetar, etj.

#### **Prioritetet e Kuvendit për vitin 2023 janë:**

- Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare (*përfaqësimi, ligjbërja, kontrolli parlamentar*);
- Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integritetit evropian;
- Rritja e transparencës në veprimtarinë e Kuvendit;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit.

**Këto prioritete të Kuvendit do të ndiqen përmes realizimit të objektivave dhe masave të mëposhtme:**

- Forcimi i rolit ligjberës të Kuvendit, nëpërmjet: organizimit të workshop-eve dhe sesioneve të informimit me deputetët për procesin legjislativ në komisione dhe seancë plenare; monitorimit efektiv të përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara Kuvendit me *acquis* të BE-së për të garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafuar.
- Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit, nëpërmjet: organizimit të workshop-eve dhe sesioneve të informimit për orientimin e deputetëve në përdorimin efektiv dhe eficient të instrumenteve të kontrollit parlamentar (seancat dëgjimore, vizitat monitoruese në terren, interpelancat dhe pyetjet, mocionet me debat, kërkesat për informacion); përdorimit më të shpeshtë dhe cilësor të instrumenteve të kontrollit parlamentar për monitorimin e reformave dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritimit evropian; rishikimit të Ligjit Nr. 15/2015 për të parashikuar një mekanizëm efektiv të mbikëqyrjes së veprimtarisë së qeverisë (konkretisht rishikimin e pozicionit negociues) gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit, bazuar në praktikën më të mirë në këtë fushë.
- Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Kuvendin në Raportin 2022 të KE-së për Shqipërinë si dhe monitorimi i zbatimit të tij.
- Forcimi i transparencës në veprimtarinë e Kuvendit nëpërmjet: zhvillimit të sesioneve të trajnimit me grupet e interesit dhe me OSHC-të që bashkëpunojnë me Kuvendin për procesin ligjberës, procesin e konsultimit dhe dëgjesat publike; organizimit të takimeve periodike të deputetëve me qytetarët për të prezantuar veprimtarinë e Kuvendit; zhvillimit të seancave dëgjimore publike nga komisionet e përhershme të Kuvendit për marrjen e mendimeve edhe nga aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, gjatë procesit vendimmarrës të Kuvendit; rritja e aksesit të informacionit për qytetarët; publikimit të raportit të Kuvendit mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2022; forcimit të bashkëpunimit të Kuvendit me shoqërinë civile, si një partner shumë i rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integritimit; publikimit periodik online të Newsletter-it të Kuvendit lidhur me veprimtarinë e Kuvendit në procesin e integritimit evropian.
- Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me procesin e integritimit evropian.

*Zgjedhjet*

Roli i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri. Ky organ drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore, dhe mediat në raport me zgjedhjet. Ligji nr. 101/2020, krijoi një

arkitekturë të re të administrimit zgjedhor me formimin e tre organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë:

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- Komisioni Rregullator;
- Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës Nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, u caktua data 6 Mars 2022, për realizimin e zgjedhjeve në bashkitë, Durrës, Lushnjë, Vorë, Rrogozhinë, Shkodër dhe Dibër.

- Në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, u regjistruan 11 subjekte zgjedhore dhe një koalicion zgjedhor.
- U regjistruan 19 kandidatë përkatësisht: bashkia Durrës 3 kandidatë, bashkia Lushnjë 3 kandidatë.
- bashkia Dibër 4 kandidatë, bashkia Vorë 3 kandidatë, bashkia Rrogozhinë 3 kandidatë, bashkia Shkodër 3 kandidatë.
- Për një kandidat për kryetar bashkie, në bashkinë Durrës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi mosregjistrimin e kandidat për shkak të mungesa e depozitimit të dokumentacionit të kërkuar nga subjekti zgjedhor.
- Në zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022:
  - u regjistruan 19 kandidatë për kryetar bashkie nga të cilët 16 ishin burra dhe 3 ishin gra;
  - numri total i zgjedhësve është 654 585 nga të cilët 324 065 janë gra dhe 330 520 janë burra.
- U realizua identifikimi dhe votimi elektronik në një bashki, përkatësisht në bashkinë Vorë, i cili u realizua me sukses.
- U krye trajnimi i administratës zgjedhore, monitoruesve, dhe audituesve për verifikimin e raporteve financiare të partive politike dhe kandidatëve.
- U krye procesi i këqyrjes passzgjedhore, në përfundim të të cilit u konstatua përmbushja e saktësisht e detyrave nga administrata zgjedhore.

Presidenti i Republikës, dekretoi datën 14 Maj 2023, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore nëpërmjet dekretit Nr. 13864, datë 24.10.2022.

Prioritetet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 janë:

- Implementimi i votimit dhe numërimit elektronik në më shumë se një bashki;
- Garantimi i të drejtës themelore për zgjedhje të lira e te fshehta, ruajtjen e parimit të barazisë, heqjen e kufizimeve për shkak të aftësive të kufizuara, lehtësimin e informimit të pakicave kombëtare;
- Zhvillimi i programeve të edukimit zgjedhor, informimi në kohë për votuesit, me prioritet përfshirjen e votuesve për herë të parë, personave me aftësi të kufizuara dhe programe të dedikuara për nxitjen e rolit të grave në procesin zgjedhor;
- Hetimi administrativ për rastet e keqpërdorimit të burimeve shtetërore;

- Lehtësimi i komunikimit ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më bashkitë për detyrat që Kodi Zgjedhor i ngarkon bashkive, nëpërmjet krijimit të një rrjeti personash përgjegjës në çdo bashki;
- Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit për të gjithë kandidatët me qëllim garantimin e integritet të personave që zgjidhen;
- Verifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në zgjedhje, me qëllim transparencën e fondeve të përfituara dhe shpenzuara;
- Respektimi i detyrimeve ligjore për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në media;
- Nxitja dhe inkurajimi i mospërdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese;
- Nxitja/promovimi për sigurinë e të dhënave personale dhe sigurinë juridike;
- Trajnimi i administratës zgjedhore, monitoruesve, audituesve të raporteve financiare të partive politike dhe kandidatëve dhe trajnimi i kandidatëve për mënyrën e plotësimit të detyrimeve ligjore për transparencën e të ardhurave dhe shpenzimeve për fushatë;
- Digjitalizimi i proceseve të punës që kanë të bëjnë kryesisht me regjistrimin e subjekteve politike, dorëzimi i raporteve financiare, monitorimi i fushatës zgjedhore e auditimi i fondeve, rekrutimi i stafit, komisionet zgjedhore.

#### *Qeverisja*

Qeveria qendrore përcakton vizionin dhe politikat kyçe dhe propozon legjislacionin për forcimin e demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Qeverisë/Këshillit të Ministrave (i përbërë nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe Ministrat e Kabinetit) parashikohet në dispozitat themelore kushtetuese dhe në Ligjin Nr. 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Përsheptimi i reformave dhe përgatitja e vendit për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian mbetet një prioritet kyç i Qeverisë Shqiptare.

#### ***Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim***

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030 (SKZHIE 2022 – 2030) është dokumenti kryesor strategjik për vendin, që paraqet drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, në rrugën e integritit të tij në Bashkimin Evropian, përfshirë dhe ndërlihdjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, në funksion të arritjes së synimeve të Agjendës 2030.

SKZHIE 2022 – 2030 shtrihet në harkun kohor dhjetëvjeçar 2022 – 2030 dhe synon të pasqyrojë prioritetet e zhvillimit në një periudhë relativisht të gjatë kohore, duke marrë parasysh:

- Harmonizimi i zbatimit të SKZHIE 2022 – 2030 me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG/ OZHQ), pjesë e Agjendës 2030, për të cilën Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në 2030;
- Zhvillimi dhe zbatimi i një vizioni afatgjatë për zhvillimin e vendit;
- Shtyrja deri në vitin 2030 e disa prej strategjive të rëndësishme sektoriale të miratuara ose



në proces përgatitjeje;

- Përfitimi i krijimit të një kuadri strategjik afatgjatë që ndihmon procesin e integritit të Shqipërisë në BE brenda një kuadri strategjik të qartë dhe të qëndrueshëm;
- Mbështetja e procesit të buxhetimit afatmesëm duke ndërtuar projeksione afatgjata të shpenzimeve buxhetore për arritjen e qëllimeve strategjike dhe objektivave të politikave për zhvillimin e vendit.

SKZHIE 2022 – 2030 përbën shtyllën kryesore të Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe orienton në nivel afatmesëm dhe afatgjatë politikat prioritare të zhvillimit të vendit. SKZHIE është dokumenti ombrellë, që siguron prioritizimin e politikave në nivel afatmesëm dhe afatgjatë dhe shërben si dokument kuadër për të gjitha politikat dhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale.

SKZHIE III pararend miratimin e fondeve vjetore të buxhetit të shtetit, duke përcaktuar objektivat e politikave, që përfshihen në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha institucionet shtetërore. SKZHIE-III është gjithashtu një dokument i rëndësishëm referimi për partnerët e zhvillimit, për harmonizimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit e proceseve të integritit të vendit në BE, me mbështetjen që partnerët ndërkombëtarë i japin Shqipërisë.

SKZHIE 2022 – 2030 ofron kuadrin kryesor për të gjithë programimin e fondeve të donatorëve të ndryshëm, duke përfshirë fondet IPA të BE-së ose agjenda të tjera zhvillimi me donatorë dypalësh (SIDA, SDC, Gjermani, Itali etj.) dhe shumëpalësh (BB, OKB, BERZH, etj.). Për të siguruar koherencë me periudhat e planifikimit të BE-së, SKZHIE shpërndahet në një periudhë dhjetëvjeçare, nga të cilët cikli i jashtëm buxhetor i BE-së është për shtatë vite dhe viti 2030 shënon vitin e fundit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe treguesit dhe objektivat përkatës.

Në kuadër të prioritizimit të politikave afatmesme, si fazë përgatitore për SKZHIE 2022 – 2030, është hartuar dhe diskutuar Dokumenti i Politikave Prioritare 2023 – 2025, i cili siguron buxhetimin e prioriteteve dhe përcaktimin e tavaneve të PBA-së afatmesme.

Nga viti 2022, Dokumenti i Politikave Prioritare 2023 – 2025 përgatitet nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në varësi të Kryeministrisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim rregullimin e procesit të shpërndarjes së burimeve ndërmjet sektorëve.

Dokumentet e Politikave Prioritare 2023 – 2025 është diskutuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe përbën një fazë të ndërmjetme përpara përcaktimit të tavaneve buxhetore për planifikimin buxhetor afatmesëm, si dhe për përgatitjen e draft Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030. Procesi për përgatitjen e SKZHIE 2022 – 2030 është bazuar në parimin e funksionimit të plotë të të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale që lidhen me Sistemin e Planifikimit të Integruar.

Procesi i hartimit të SKZHIE 2022 – 2030 është realizuar përmes angazhimit të një numri të konsiderueshëm institucioneve shtetërore ku përfshihen të gjitha ministrinë, institucionet e

pavarura, agjenci të rëndësishme zbatuese të politikave sektoriale, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë. Puna për përgatitjen e SKZHIE 2022 – 2030 është koordinuar nga Agjencia e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), si struktura përgjegjëse që siguron hartimin, zbatimin dhe harmonizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, strategjive sektoriale, bashkërendimin e ndihmës së huaj, bashkërendimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar.

I gjithë procesi i hartimit të SKZHIE 2022 – 2030 është shoqëruar me konsultime me palët e interesit, shoqërinë civile, përfaqësuesit e biznesit, akademinë etj.

Në tetor të vitit 2022 u publikua në faqen zyrtare të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike draft SKZHI 2022 – 2030, me qëllim mbledhjen e sugjerimeve, komenteve nga qytetarët, shoqëria civile, partnerët socialë dhe të zhvillimit, dhe pasurimin e këtij dokumenti themelor me mendimet dhe opinionet publike mbi reformat dhe përparësitë strategjike të vendit. Aktualisht ka përfunduar procesi i konsultimit publik dhe janë pasqyruar të gjitha komentet e adresuara përgjatë këtij harku kohor. Gjithashtu, me qëllim përmbushjen e hapave ligjorë që i paraprijnë miratimit në Këshill të Ministrave, është hartuar dhe përcjellë pranë strukturave përgjegjëse të Kryeministrit, drafti final i SKZHIE III së bashku me relacionin shpjegues.

### ***Roli i Ministrisë të Shtetit dhe Kryenegociatorit***

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori i ri i Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian u emërua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar.

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator vijoi të drejtojë në tërësi strukturën negociatore, lidhur me koordinimin e procesit të stabilizim-asociimit, të zhvillimit të takimeve shpjeguese dhe bilaterale për procesin *screening* dhe të përgatitjeve për negociatat e anëtarësimit.

Në kuadër të takimeve *screening*, gjatë periudhës tetor – dhjetor 2022, ministri i Shtetit dhe Kryenegociator zhvilloi takime të dedikuara me negociatorët dhe delegacionet shqiptare përpara çdo takimi në Bruksel.

Në të gjitha këto takime u dhanë orientime për delegacionet për:

- organizimin e takimit dhe përgatitjen e pyetjeve paraprake nga delegacionet në takimet shpjeguese, bazuar në agjendat e dërguara paraprakisht nga shërbimet e Komisionit Evropian;
- qëndrimet zyrtare mbi çështje specifike/rekomandime të Komisionit për çdo kapitull/kriter negociues;
- planet e ardhshme të Shqipërisë për përafrimin me *acquis* e Bashkimit Evropian;

- integrimin e përshpejtuar;
- masat antikorupsion për çdo kapitull; etj.

Gjatë vitit 2022 u zhvilluan takimet shpjeguese për Grupimin “Themelorët”, Grupimin e dytë “Tregu i brendshëm” dhe Grupimi i tretë “Konkurrueshmëia dhe rritja gjithëpërfshirëse”.

Gjatë vitit 2022 u zhvilluan takimet dypalëshe (bilaterale), si më poshtë vijon:

- Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria;
- Kapitulli 18: Statistikat;
- Kapitulli 5: Prokurimi publik;
- Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore;
- Kapitulli 32: Kontrolli financiar;
- Kriteri ekonomik;
- Reforma në administratën publike.

Në periudhën janar – dhjetor 2022, Zyra e Kryenegociatorit ka paraqitur rregullisht raporte javore ku janë pasqyruar zhvillimet mbi ecurinë e përafrimit të legjislacionit dhe zbatimin e angazhimeve të PKIE 2022 – 2024.

Zyra e Kryenegociatorit ka ndjekur dhe monitoruar rregullisht takimet javore të Drejtorive Juridike, mbi statusin e përmbushjes së masave ligjore PKIE 2022 – 2024, për të adresuar çdo problematikë.

Në periudhën janar – dhjetor 2022, Kryenegociatori, në koordinim me MEPJ dhe negociatorët ka monitoruar mbledhjen e informacioneve periodike dhe mbarëvajtjen e takimeve vjetore të Nënkomiteteve të Stabilizimit-Asociimit BE-Shqipëri duke përfshirë dhe Komitetin e Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri, ku ka marrë pjesë edhe Kryenegociatori. Informacionet shitesë dhe raportet përfundimtare të këtyre Nënkomiteteve i janë dërguar strukturave të Komisionit Evropian (KE) me cilësi dhe brenda afatit.

Anëtarët e Grupit Negociator në bashkërendim me Kryenegociatorin, kanë identifikuar prioritetet relevante me qëllim garantimin e mbështetjes për kapitujt specifikë gjatë hartimit të programimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian sipas kapitujve përkatës.

Në periudhën janar – dhjetor 2022, Kryenegociatori ka ndjekur dhe monitoruar procesin e ngritjes dhe funksionimit të Platformave të Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), punimet mbi mbledhjet teknike të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për kapitujt respektivë të *acquis*.

Gjatë vitit 2022, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian, ka organizuar në total 12 takime, 6 periodike dhe 6 ndërgjegjësuese. Kryenegociatori dhe më pas Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator kanë marrë pjesë në takimet e mëposhtme:

- Më datë 2 shkurt 2022, në takimin periodik të KKIE me temë “Ecuria e procesit të integritimit evropian duke përfshirë edhe një raportim mbi zbatimin e PKIE dhe të asistencës financiare të BE për vitin 2021. Përgatitja mbi zhvillimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare me BE duke përfshirë informacion mbi përgatitjen e administratës publike për procesin e negociatave, numrin e ngritjes së tryezave të diskutimit dhe këshillimit për kapituj si dhe numrin e takimeve të këtyre tryezave”;
- Më datë 28 mars 2022, në takimin ndërgjegjëses me temë “Sfidat e Shqipërisë gjatë negociatave me Bashkimin Evropian”;
- Më datë 17 tetor 2022, në takimin periodik të KKIE me temë “Prezantimi i raportit vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022); Hapat për ndjekjen e rekomandimeve të raportit vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022); Diskutim me pjesëmarrësit për hartimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15, datë 5.03.2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e Integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ka monitoruar veprimtarinë e disa projekteve të asistencës teknike të kapitujve të *acquis* me qëllim që t’i kushtohet vëmendje e veçantë kapitujve të grupimit themelor. Në këtë kuadër, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ka marrë pjesë në takime me ministritë e linjës dhe organizatat e asistencës së huaj në Shqipëri.

Në kuadër të procesit të anëtarësimit, Kryenegociatori dhe Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator kanë zhvilluar një seri takimesh me përfaqësues të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, Kryenegociatori ka ndjekur dhe komunikuar me Komisionin Evropian qëndrimet dhe shqetësimet e palës shqiptare mbi tekstet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, memorandume, rekomandime/konkluzione, kryesisht në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kryenegociatori ka realizuar takime të rregullta të dedikuara me shumicën e ambasadorëve të vendeve të BE-së të akredituar në Tiranë, si dhe ka kryer vizita në disa kryeqytete të vendeve të BE-së, pas të cilave është raportuar rregullisht tek Kryeministri për rezultatet kyçe të vizitave.

Kryenegociatori ka zhvilluar gjithashtu takime të vazhdueshme pune, lidhur me shkëmbimin e përvojave dhe transferimin e njohurive mes Kryenegociatorëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

### ***Reforma Administrative Territoriale***

Përgjatë vitit 2022, një nga fokuset prioritare të Qeverisë Shqiptare ka qenë konsolidimi i reformës territoriale dhe procesit të decentralizimit. Për këtë qëllim, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë rritur cilësisht ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe operatorëve të biznesit si dhe kanë ushtruar kompetencat dhe funksionet e tyre sipas kërkesave dhe nevojave në territor. Gjatë këtij vitit vihet re një fuqizim i financave vendore dhe ka pasur përpjekje për thellimin e procesit të autonomisë financiare.

Reforma Administrative – Territoriale ndikoi direkt në performancën financiare të bashkive duke rritur me rreth 2.3 herë të ardhurat nga taksat vendore në vitin 2022 krahasuar me vitin 2015.

Ndërkohë, shpenzimet vendore në vitin 2022 janë rritur me 60% krahasuar me vitin 2015. Progresi për konsolidimin e kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësisve të vetëqeverisjes vendore vlerësohet në masën 75%, ku avancim të shpejtë ka pasur konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative (100% realizueshmëri), aplikimi i shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë e informacionit për 61 bashki dhe njësitë e tyre administrative (50%) dhe forcimi i dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme (75%).

Duke qenë se bashkitë kategorizohen si njësi me numrin më të lartë të shërbimeve që ofrohen në territor, qeverisja qendrore për t'ju përgjigjur nevojave dhe zhvillimeve teknologjike të kohës, nëpërmjet bashkërendimit të masave dhe procedurave me AKSHI-n, gjatë muajit gusht është ngritur grupi i punës për digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve të punës dhe shërbimeve online për qeverisjen vendore.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2022 ka nisur puna për hartimin e strategjisë së re ndërsektoriale të decentralizimit dhe qeverisjes vendore 2023-2030. Nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit Nr. 76, datë 22.4.2022 janë krijuar grupet ndërinstitucionale të punës duke përfshirë ministrinë e linjës dhe institucionet përgjegjëse. Në vijim janë zhvilluar takime me OECD/SIGMA për të përcaktuar metodologjinë e hartimit të strategjisë dhe partnerët e zhvillimit të fokusuar në çështjet vendore. Procesi i është nënshtruar një konsultimi të gjerë me bashkitë, këshillat e qarqeve, donatorët dhe shoqërinë civile. Në të njëjtën kohë, donatorët kanë vënë në shërbim të grupeve të punës, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë sipas fushave të përgjegjësisve për lehtësimin e procesit të hartimit të strategjisë. Aktualisht drafti i strategjisë është hedhur në konsultim me ministrinë e linjës, duke parashikuar miratimin në fund të muajit janar 2023.

Prioritetet në zbatimin e strategjisë së re udhëhiqen nga forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor. Synohet krijimi i një mjedisi të favorshëm biznesi duke përdorur maksimalisht potencialet në nivel vendor me qëllim krijimin e një mjedisi socio-ekonomik të qëndrueshëm vendor. Shtylla e dytë e strategjisë ka si qëllim që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të ofrojnë shërbime efçente për qytetarët duke konsoliduar rolin e tyre të pa zëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve të veta bazuar në standarde të mirëpërcaktuara dhe duke rritur ndjeshëm performancën e tyre. Prioriteti i tretë do të jetë digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre, i lidhur me qëllimin e grupit të punës për digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve të punës dhe shërbimeve online për qeverisjen vendore. Strategjia e re parashikon konsolidimin e sistemit financiar të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe rritjen e autonomisë fiskale nëpërmjet rritjes së të ardhurave vendore duke synuar kështu bashki të shëndetshme financiarisht. Prioritet strategjik parashikohet forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet mirëfunksionimit të këshillave bashkiak dhe avancimi i agjendës evropiane në nivel vendor.

### ***Shoqëria civile***

Udhërrëfyesi për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 25.7.2019, përmban tri drejtime strategjike dhe nëntë prioritete si më poshtë vijon:

- **Drejtimi Strategjik 1:** Bashkëpunim i institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian;
- **Drejtimi Strategjik 2:** Mundësimi i mjedisit ligjor dhe qeverisjes së të dhënave;
- **Drejtimi strategjik 3:** Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm.

Në qershor 2022 në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile është prezantuar raporti i monitorimit të Udhërrëfyesit “Për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 – 2023” për periudhën 2019 – 2021 ku rezulton se nga masat e parashikuara janë realizuar deri më tani plotësisht masat si më poshtë vijnë:

- Planifikimi dhe zbatimi i duhur i Udhërrëfyesit sipas planeve të tyre tremujore dhe vjetore;
- Garantimi i angazhimit të vazhdueshëm për zbatim të grupit ndërministror të punës, përfshirë të gjitha ministritë e linjës;
- Hartimi nga AMShC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe organizimi i zgjedhjeve;
- Përfshirja e KKShC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile;
- Përditësimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planeve vjetore të punës së Agjencisë për periudhën 2015 – 2021 për arritjen e objektivave kryesore, përfshirë përmbushjen e rolit të saj si sekretariat i KKShC-së;
- Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMShC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje për informim dhe mbështetje nga OShC-të lokale;
- Vazhdimi i asistencës teknike për AMShC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit të rishikuar strategjik të organizatës;
- Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecurisë së Udhërrëfyesit;
- Caktimi i personave të kontaktit për OShC-të në ministritë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin me OShC-të;
- Garantimi i zbatimit efikas të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin përmes ndërgjegjësimit në nivel lokal dhe kombëtar dhe përfshirjes sistematike të OShC-ve;
- Përshtatja e regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike për të përfshirë OShC-të si një kategori më vete kontribuuesish;
- Zhvillimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe për bërjen e transparencës së vendimmarrjes;
- Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi;
- Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike;

- Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian;
- Përfshirja e OShC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian;
- Rritja e pjesëmarrjes së OShC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit;
- Koordinimi i financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile;
- Mundësimi i përfshirjes efikase të OShC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian;
- Skema të financimit nga shteti për promovimin e punës vullnetare;
- Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OShC-ve për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në efçente për OShC-të dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të OShC-ve;
- Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OShC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore të qeverisë bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime;
- Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social;
- Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OShC-ve në aspektin e TVSh-së.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në rolin e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar, me qëllim funksionimin e Këshillit realizon procesin e zgjedhjeve në vijim të vakancave të krijuara nga shoqëritë civile në Këshill, në përputhje me ligjin “Për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile”. Aktualisht janë krijuar 8 vakanca, dhe gjatë periudhës 16 nëntor – 16 dhjetor 2022, është bërë shpallja e njoftimit në faqen e uebit të AMSHC ([www.amshc.gov.al](http://www.amshc.gov.al)), si dhe ka nisur procesi i konsultimit publik dhe informimit pranë OShC-ve në lidhje me procedurat dhe kriteret e nevojshme për të konkurruar.

AMSHC shpërndan çdo vit fonde dedikuar mbështetjes së Shoqërisë Civile. AMSHC shpall thirrje për projekt – propozime. Me qëllim përcaktimin e fushave prioritare për thirrjet për projekt-propozimet, Agjencia përpara çdo thirrje organizon takime konsultative me shoqërinë civile, si dhe shpërndan online në uebsite e Agjencisë, paraprakisht një pyetësor tek të gjitha organizatat e shoqërisë civile të cilat janë të regjistruara në bazën e të dhënave të saj. Në vijim të takimeve konsultative dhe të pyetësorëve të plotësuar identifikohen edhe fushat prioritare për thirrjet për projekt-propozime. Në përfundim të të gjithë këtij procesi, Bordi i AMSHC-së përcakton fushat dhe bën shpalljen për thirrjen për projekt propozime. Fushat prioritare për thirrjen nr. 15 që i përket periudhës 31 maj – 1 korrik 2022 ishin shëndetësia dhe shërbimet sociale; lufta kundër korrupsionit dhe edukimi ligjor i publikut dhe SKZHI; mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm; arsimit dhe integrimi evropian si dhe edukimi mediatik online.

## **Kuadri strategjik për reformën në administratën publike**

Reforma në Administratën Publike është një proces tejet i rëndësishëm për vendin, i lidhur ngushtë me integrimin drejt Bashkimit Evropian. Një administratë publike moderne, profesionale dhe me integritet është një parakusht i domosdoshëm për përmbushjen e vizionit të qeverisë drejt reformimit të administratës publike.

Përgjatë viteve, RAP ka qenë gjithmonë në vëmendjen e qeverisë, pjesë e portofolit të Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrit si dhe duke filluar nga qershori 2022, Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve iu ngarkua përgjegjësia për përmbushjen e parimeve të mirëqeverisjes.

Qeveria Shqiptare është angazhuar të ndërmarrë vendimet e duhura strategjike dhe për këtë arsye janë ngritur strukturat që harmonizojnë proceset administrative dhe shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet nivelit politik dhe teknik.

Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), si niveli më i lartë i vendimmarrjes i drejtuar nga Kryeministri, që mbështetet në nivel teknik nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) ka funksionuar rregullisht. Në mbledhjet e KPS-së janë diskutuar tema të rëndësishme në lidhje me: (i) përcaktimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal të qeverisë; (ii) përcaktimin e prioritetëve të qeverisë; (iii) përcaktimin e prioritetëve të politikave dhe investimeve publike; (iv) tavanet e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm; dhe (v) investimet me rëndësi të veçantë për Shqipërinë.

Gjatë vitit 2022, KPS ka miratuar vizionin, objektivat, afatet, kalendarin e përgatitjeve për 9 strategjitë ndërsektoriale dhe sektoriale, ndër të cilat 6 strategji janë miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe 3 janë në proces miratimi.

Tashmë është i konsoliduar kuadri strategjik i RAP dhe janë të mirëpërcaktuara fushat prioritare, në linjë me standardet evropiane dhe që mundësojnë një mirëfunksionim të administratës publike.

Prej vitesh, Shqipëria ka një kuadër strategjik të mirëpërcaktuar të Reformës në Administratën Publike e cila përfshin 5 strategji: (i) Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike; (ii) Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore; (iii) Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike; (iv) Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe (v) Strategjinë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë”.

Për më tepër kuadri strategjik i RAP bazohet në dokumentin bazë strategjik - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), në të cilën përcaktohen vizioni, prioritetet dhe objektivat strategjike sektoriale për një periudhë 5-vjeçare.



Ministri i Shtetit për Shërbimet dhe Standardet, si anëtar i përhershëm i KPS-së, drejton Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe RAP, gjatë së cilit sigurohet koordinimi për Agjendën e RAP.

GMIP për Mirëqeverisjen dhe RAP përfshin disa Grupe Tematike, që mbulojnë disa komponentë kryesorë të RAP si: (i) Politikëbërja; (ii) Reforma në shërbimin civil dhe SNRAP; (iii) Shërbimet Publike; (iv) Qeverisja Elektronike dhe Digjitalizimi; (v) Statistikat; (vi) Anti-Korrupsioni; (vii) Decentralizimi dhe Zhvillimi Rajonal; si dhe (viii) Menaxhimi i Financave Publike.

Gjatë vitit 2022 është hartuar Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE III) përmes koordinimit nga SASPAC dhe angazhimit të një numri të konsiderueshëm të institucioneve shtetërore, ministrive të linjës, institucioneve të pavarura, agjencive zbatuese të politikave sektoriale, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.

SKZHIE 2022 – 2030 është dokumenti kryesor strategjik që përcakton vizionin për zhvillimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit në rrugën e integritit në Bashkimin Evropian, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në funksion të arritjes së synimeve të Agjendës 2030.

Draft-dokumenti strategjik SKZHIE III është publikuar në datë 31 tetor 2022 në faqen zyrtare të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) me qëllim mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve nga palët e interesuara mbi adresimin e sfidave të progresit dhe integritit evropian, orientimin e reformave të vendit në nivel afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe pasurimin e këtij dokumenti themelor me opinionet publike mbi reformat dhe përparësitë strategjike të vendit.

**Sa i përket zbatimit të kuadrit strategjik nën RAP dhe monitorimit të tij**, Departamenti i Administratës Publike, si institucioni përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015 - 2022 (SNRAP) dhe Planit të Veprimit 2018 - 2022, ka përgatitur dhe publikuar raportin e monitorimit të SNRAP për vitin 2021, në linjë me standardet ISPIS.<sup>5</sup>

Në korrik të vitit 2022, DAP ka iniciuar procesin e monitorimit të SNRAP për periudhën janar – qershor 2022. Raporti i SNRAP janar – qershor 2022, si dokumenti gjashtëmuor i fundit i SNRAP, ka shërbyer si një dokument vetëvlerësimi për të: (i) evidentuar aktivitetet e përfunduara plotësisht, (ii) vlerësuar performancën e institucioneve dhe (iii) identifikuar problemet e hasura dhe masat që do të vazhdojnë të mbeten relevante për periudhën e ardhshme.

Për më tepër, gjatë vitit 2022, Departamenti i Administratës Publike ka nisur procesin e hartimit të strategjisë së re për Reformën në Administratën Publike 2023 – në vijim. Aktualisht, DAP është

---

<sup>5</sup> <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/204-raportet-e-monitorimit-te-strategjise>

në fazën e hartimit të çështjeve thelbësore potenciale të identifikuar gjatë zbatimit të SNRAP gjatë 2015 – 2022, që duhet të adresohen në strategjinë e re.

Në vijim të këtij procesi, krahas klasifikimit të çështjeve, do të identifikohen edhe shkaqet kryesore të sfidave të strategjisë së RAP. Gjithashtu, ky proces do të mundësojë hartimin e rekomandimeve kryesore gjatë shkrimit të strategjisë së re të RAP për vitin 2023 – në vijim.

Gjatë kësaj periudhe ka nisur dhe procesi i përgatitjeve për shkrimin e strategjive të reja nën RAP dhe konsultimin e tyre, konkretisht për:

- Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike;
- Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

### **Prioritetet kryesore për periudhën në vijim:**

Miratimi i strategjive të reja nën RAP gjatë vitit 2023, si:

- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike;
- Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike;
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

### **Zhvillimi dhe koordinimi i politikave**

Në kuadër të përmirësimit të sistemit të politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit puna ka vijuar drejt konsolidimit të politikave.

Me anë të VKM-së nr. 517, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit” është përcaktuar përgjegjësia e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit për koordinimin e prioriteteve për politikën dhe politikëbërjen e qeverisë. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori bashkëpunojnë ngushtësisht me Departamentin e Politikave dhe Mirëqeverisjes, pjesë e Kryeministrisë, që ka një njësi të dedikuar për politikën.

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që lidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është edhe **procesi i konsultimit publik**.

Në vijim të riorganizimit institucional të Kryeministrisë dhe të rolit të Qendrës së Qeverisjes, Konsultimi publik është nën përgjegjësinë e Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë nga muaji qershor 2022, duke u integruar me proceset e tjera të rëndësishme të politikëbërjes si Vlerësimi i Ndikimit Rregullator dhe Programimi Vjetor i Projekt-akteve.

Me qëllim bërjen efektiv të procesit të konsultimit publik për legjislacionin me interes të lartë kombëtar, u iniciua procesi i hartëzimit të aktorëve të interesit sipas fushave të përgjegjësisë për 11 ministritë e linjës. Kështu, mbi 800 aktorë interesi nga shoqëria civile, shoqata biznesi, organe

këshillimore, institute kërkimore, ekspertë, akademi, dhe partnerë për zhvillim janë regjistruar në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJK).

Gjithashtu, janë marrë masa dhe për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe politikëbërje nëpërmjet procesit të konsultimit publik duke përmirësuar me funksionalitete të reja dhe sipas standardeve të BE-së Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, si faqja zyrtare e publikimeve për konsultim publik nga organet publike.

Falë masave të marra, indeksi i konsultimit publik është regjistruar në nivelin 83,83%, (më i larti i shënuar ndonjëherë), ndërsa indeksi për cilësinë është 5,55 nga 7. Gjatë kësaj periudhe, janë organizuar aktivitete konsultative me përfshirjen e rreth 2000 grupeve të interesit, pjesëmarrës në takime konsultative, nga të cilët 326 kanë kontribuar me komente.

Sa i përket kontributit të publikut në regjistrin elektronik, **janë dërguar 146 komente për 51 akte** dhe totali i shikimeve për 457 aktet e publikuara rezulton të jetë 554,570 me një mesatare prej 1213 shikimesh për publikim.

Lidhur me shtrirjen e Konsultimit Publik në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), janë marrë masa për krijimin e infrastrukturës në RENJK për publikimet për konsultim publik edhe nga bashkitë për dokumente me interes të lartë vendor. AMVV ka caktuar një koordinator zyrtar që do të koordinojë teknikisht procesin me 61 bashkitë.

Përsa i takon procesit të **Vlerësimit të Ndikimit Rregullator** (RIA), proces i cili po zbatohet prej vitit 2018, tashmë aktet ligjore përpara miratimit të tyre shoqërohen me raportin RIA përkatës. Falë masave të marra mund të evidentohet rritje në cilësinë e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimit të zbatimit për aktet ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara gjatë periudhës 2019 – 2022, dhe sipas një vlerësimi të kryer pikët mesatare të raporteve RIA të konfirmuara janë 80 nga 100<sup>6</sup>.

Duhet theksuar se zbatimi i procesit të vlerësimit të ndikimit (RIA), ka ndikuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetin e hartimit të politikave/legjislacionit duke bërë të mundur që ndërhyrja e qeverisë të jetë e drejtuar aty ku është e nevojshme, si dhe duke dhënë rezultate më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore e administrative, nëpërmjet analizave *ex-ante* kryesisht të vlerësimit të projektligjeve, para miratimit të tyre.

Njëkohësisht, procesi RIA ka shërbyer si një mekanizëm vlerësimi i ndikimeve të transpozimit të *acquis* së Bashkimit Evropian, duke mundësuar kryerjen e një përafrimi sa më të saktë, të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat rregullatore, ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendit.

---

<sup>6</sup> Të cilat janë pikët mesatare për cilësinë e raporteve të vlerësimit të ndikimit për projektligjet që janë përcjellë për miratim në KM gjatë periudhës janar – dhjetor 2021.

Prej fillimit të zbatimit të procesit, Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe Vlerësimit të Ndikimit (RIA) ka shqyrtuar në total 220 raporte vlerësimi ndikimi, nga ku janë konfirmuar 122 prej tyre.

Për të përmirësuar akoma më tej këtë proces, vëmendje i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të stafeve për të kryer procesin sipas standardeve dhe gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar: 25 sesione trajnimi për rrjetin RIA, 10 sesione trajnimi për Njësinë RIA, si dhe janë trajnuar më shumë se 100 nëpunës civilë.

### **Prioritetet kryesore për periudhën në vijim:**

**Në lidhje me përmirësimin e cilësisë së raporteve të RIA-s** si dhe vazhdimin e trajnimeve të anëtarëve aktualë dhe të ardhshëm të rrjetit RIA mbetet prioritet:

- zhvillimi i një agjende trajnimi (brenda janarit 2023) për anëtarët e rrjetit RIA për vitin e ardhshëm;
- trajnimet e rregullta për RIA të jenë pjesë e kurrikulës standarde të trajnimit për nëpunësit civilë.

Sa i përket masave për rritjen e cilësisë së procesit të **Konsultimit Publik (KP)**, prioritare mbetet:

- respektimi i periudhës minimale të afatit të konsultimit;
- prodhimi dhe publikimi i raporteve individuale në KP përpara miratimit të aktit;
- rritja e përdorimit të platformës elektronike të konsultimit publik;
- përforcimi i rolit të koordinatorit;
- bërja e procesit të Konsultimit Publik pjesë e planifikimit të hershëm.

### **Shërbimi civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore**

Administrata publike përbën themelet mbi të cilat zbatohet çdo nismë, çdo reformë dhe çdo iniciativë në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Cilësia, profesionalizmi, paanësia dhe integriteti i administratës publike janë parimet e domosdoshme të një administrate të suksesshme, e cila është në shërbim të plotë të qytetarit në mënyrë transparente, duke reflektuar kështu dhe vlerat më të mira të Shqipërisë.

Në këtë fushë Shqipëria bazuar në Raportin e Monitorimit të SIGMA (2021) është vlerësuar me pikët më të larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor<sup>7</sup> përsa i takon **stabilitetit dhe forcimit të sistemit të shërbimit civil, zbatimit të legjislacionit në përputhje me parimet e rekrutimit të bazuar në meritë, ngritjes së kapaciteteve si dhe rritjes profesionale të nëpunësve publikë** në përballimin me sukses të sfidave të integritetit drejt Bashkimit Evropian.

---

<sup>7</sup> <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf> (faqe 68).

Sot Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë, të qartë e të konsoliduar në fushën e shërbimit civil si dhe është përmirësuar ndjeshëm menaxhimi i burimeve njerëzore me fokus përmirësimin e procesit të rekrutimit.

Kështu është shënuar progres sa i përket automatizimit dhe digjitalizimit të proceseve të rekrutimit duke nisur që me: (i) shpalljen e vendeve vakante; (ii) vlerësimin e dosjes së aplikantëve; (iii) gjenerimin automatik të tezave të testimit nga banka e pyetjeve të përditësuara; (iv) kontrollin e automatizuar të testeve, si dhe (v) shpalljen e rezultateve.

Gjithashtu, për të garantuar meritokracinë në shërbimin civil, legjislacioni në fuqi ka parashikuar një prag pikësh për të klasifikuar kandidatit si fitues, ku kandidatët duhet të grumbullojnë mbi 70% të totalit të pikëve të vlerësimit.

Rregullim i hollësishëm është parashikuar në legjislacionin e shërbimit civil si për institutin e promovimit ashtu edhe për lirin nga shërbimi civil.

Legjislacioni i shërbimit civil zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore (aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit), institucion të pavarur (administrata e Kuvendit, e Presidentit, e pushtetit vendor, e Gjykatës Kushtetuese, e Gjykatës së Lartë, e Prokurorisë dhe çdo institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë apo i krijuar me ligj dhe që i raporton Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale) apo njësi të qeverisjes vendore.

Ndërkohë, marrëdhënia e punësimit në administratën publike në sektorë të veçantë rregullohet nga një kuadër ligjor i posaçëm, ku përfshihen forcat e armatosura, sektori shëndetësor, arsimor dhe të tjerë, ku gjejnë rregullim të detajuar procesi i rekrutimit, promovimit ose lirim të nëpunësve.


Në këtë drejtim është synuar përmirësimi i procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore duke u fokusuar gjithnjë e më tepër në rekrutimin e më të mirëve në administratën shtetërore dhe targetuar *soft skills* të kandidatëve.

Falë masave të marra është arritur të shënohet nga viti në vit rritje e numrit mesatar të aplikantëve të cilët kërkojnë të bëhen pjesë e shërbimit civil<sup>8</sup> duke treguar kështu rritje të besimit të aplikantëve për pjesëmarrje në procedurat e konkurrimit të drejta dhe të bazuara në meritë.

---

<sup>8</sup> 11 aplikantë në 2015, 13 në 2016, 18 në 2017, 22 në 2018, 12 në 2019, 24 në 2020 dhe 15 në 2021 (burimi: Raportet vjetore të DAP ndër vite: <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>).

### Numri mesatar i aplikantëve për periudhën 2001 - 2021



Ky perceptim është provuar gjithashtu dhe nga vlerësimet e partnerëve ndërkombëtarë të cilët kanë vlerësuar me pikë maksimale (5 nga 5) praktikat e rekrutimit në Shqipëri për zbatimin e parimit të meritokracisë dhe efektivitetit të procedurave të rekrutimit<sup>9</sup>.

Gjithashtu është ulur numri i ankesave të pranuar nga gjykata që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit. Numri i ulët (pothuajse 0) i ankesave të pranuar nga Gjykata Administrative e Apelit tregon për një zbatim rigoroz të legjislacionit përkatës për rekrutimin e nëpunësve civilë duke përfshirë këtu Ligjin nr. 152 “Për Nëpunësin Civil” dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, për organizimin e procedurave transparente në mënyrë profesionale dhe bazuar në meritë.

Platforma “**administrata.al**” ka përmirësuar ndjeshëm komunikimin dhe raportimin e informacionit në kohë reale si dhe ka lehtësuar punën e nëpunësve civilë të cilët mund të përdorin modulet dhe praktikat administrative (mbi 300 modele/template) të zhvilluara për procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si: rekrutim, lirim, pezullim, dekriminalizim, Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ristrukturim, ekzekutim i vendimeve gjyqësore, masa disiplinore, çështje ligjore dhe template për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues.

Gjithashtu, për të koordinuar dhe mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, platforma i ka mundësuar DAP dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ushtrim më të mirë të kompetencave në kohë reale ku më shumë se 200 institucione të nivelit lokal dhe qendror raportojnë në mënyrë periodike duke përdorur setin e indikatorëve.

Për të mundësuar një unifikim të praktikave që sigurojnë zbatimin e parimeve në shërbimin civil janë finalizuar **një sërë manualesh dhe udhëzuesish si:** (i) udhëzuesi mbi kryerjen e intervistave të bazuara në kompetenca duke vlerësuar *soft skills* të kandidatëve, (ii) manuali i **përshkrimeve të punës** për ministrinë e linjës, i cili është në funksion të nëpunësve civilë me synim unifikimin e përshkrimeve të punës; mbi **1328 përshkrime pune të rishikuara** dhe të miratuara; (iii) manuali për zbatimin e **Legjislacionit të Shërbimit Civil dhe Kodin e Procedurave Administrative**; (iv) manuali për **vlerësimin e rezultateve në punë**; (v) manuali për **vlerësimin e pozicioneve të punës**

<sup>9</sup> <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf> (faqe 77).

**dhe përshkrimet e përgjithshme të pozicioneve** të punës të përshtatura edhe për Njësitë e Qeverisjes Vendore; (vi) udhëzuesi mbi **organizimin e brendshëm dhe strukturën në institucionet** e pushtetit vendor; dhe mbi **standardizimin e procedurave të rekrutimit** dhe administrimin e burimeve njerëzore në institucionet e pushtetit vendor.

Të gjitha praktikat e reja u janë prezantuar nëpunësve civilë në nivel qendror, lokal dhe atyre të institucioneve të pavarura gjatë vitit 2021, në sesione të dedikuara trajnimi duke rritur kështu ndjeshëm kapacitetet e tyre në mirëpërdorimin dhe mirëzbatimin e këtyre praktikave<sup>10</sup>.

**Në drejtim të rritjes së eficensës dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë** pritet të gjejë zbatim programi “Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të administratës publike, përfshirë trajnimet/praktikat në administratat e vendeve anëtare të BE-së dhe skemën e bursave (“qelizat e reja”)<sup>11</sup>. Qëllimi i kësaj skeme është të zgjedhë një organizatë që do të mbështesë Departamentin e Administratës Publike për reformën e shërbimit civil përmes zhvillimit dhe zbatimit të programit të trajnimit dhe *internship*-it dedikuar nëpunësve civilë të rinj. Kjo skemë do të kontribuojë në zhvillimin e një administrate publike efçente, efektive dhe transparente në Shqipëri.

Në skemë mund të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë të rinj të kategorisë III dhe IV, të administratës shtetërore, institucioneve të pavarura dhe njësitë të qeverisjes vendore të cilët kanë 3-8 vjet eksperiencë në shërbimin civil.

**Në lidhje me iniciativat për reformën e skemës së pagave**, në vitin 2021, u përgatit dhe u finalizua dokumenti për politikën e pagave, në kuadër të Projektit IPA “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”.

Në vijim, në Dhjetor 2021 kanë nisur konsultimet me partnerët SIGMA/OECD dhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore për të vlerësuar nëse kjo skemë e pagave mund të zbatohet siç parashikohet në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe nëse skema është e përshtatshme për Shqipërinë, si dhe përvoja të tjera që mund të merren parasysh për të arritur një reformë në këtë drejtim.

Procesi i konsultimit ka përfshirë tetë takime (22 dhjetor 2021 – deri në fillim të korrikut 2022), të cilat theksuan rëndësinë që do të ketë reforma e pagave në administratën publike, si dhe u propozuan rekomandime dhe skenarë të mundshëm që mund të ndiqen për zbatimin e kësaj reforme.

Në takimet e fundit, të mbajtura më 7 dhe 8 korrik 2022, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë drejtues (Sekretarë të Përgjithshëm dhe Drejtorë të Përgjithshëm të ministrive kryesore të

---

<sup>10</sup> <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/204-raportet-e-monitorimit-te-strategjise>, raporti i monitorimit të SNRAP 2021(faqe 36-39).

<sup>11</sup> “Capacity building for civil servants of the public administration, including trainings/internships in eu members state administrations and scholarship scheme ("young cells")”.

linjës), u diskutuan kriteret mbi të cilat do të bazohet rritja e pagave, mekanizmat dhe ndikimi financiar i kësaj reforme.

Synimi i këtyre takimeve ishte që të diskutohej sesi Shqipëria mund të ecë përpara duke shfrytëzuar sa më mirë fondet e alokuara nga qeveria dhe si këto fonde mund të integrohen më së miri në skemën e pagave.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, në bazë të VKM-së nr. 158/2022<sup>12</sup>, paga minimale në shkallë vendi pësoi një rritje mesatare në muajin Mars prej 6.67%, konkretisht nga 30.000 lekë në muaj, në 32.000 lekë në muaj.

Në vijim, në muajin Shtator në bazë të VKM-së nr. 604/2022<sup>13</sup>, paga minimale pësoi përsëri një rritje mesatare prej 6.25%, nga 32.000 lekë në muaj, në 34.000 lekë në muaj.

Ndër politikat e qeverisë shqiptare për vitin 2022, një reformë e rëndësishme ka qenë dhe rritja e pagave për: i) punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar; ii) oficerët dhe nënoficerët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; si edhe iii) punonjësit e sistemit të shërbimit shëndetësor.

Për më tepër, **sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është rishikuar** dhe qasja e re ndaj vlerësimit të administratës do të zbatohet në praktikë pas miratimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore për përmirësimin e procesit. Moduli elektronik i vlerësimit të administratës është pjesë e platformës së integruar **administrata.al** dhe mbi përdorimin e tij janë organizuar trajnime të dedikuara për zhvillimin e procesit të vlerësimit të administratës për nëpunësit civilë.

Gjithashtu, DAP ka vijuar monitorimin e modulit online të inkorporuar në platformën **administrata.al** në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në institucionet e administratës shtetërore. Gjatë periudhës janar – 19 dhjetor 2022 janë ekzekutuar 19 vendime gjyqësore të formës së prerë.

Në drejtim të **avancimit në shtrirjen dhe përdorimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ)**, miratimi i VKM nr. 833 në tetor 2020<sup>14</sup>, i cili përcakton detyrimin e institucioneve, përfshirë institucionet në nivel vendor, për të hedhur dhe përditësuar të dhënat në regjistrin qendror të personelit, **i hapi rrugën automatizimit të pagave përmes sistemit SIMBNJ**. Përfundimi i testeve dhe ndërlidhja e sistemeve që mundësojnë automatizim të listës së pagave është evidentuar gjithashtu si një arritje në raportin e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2021<sup>15</sup>.

---

<sup>12</sup> VKM nr. 158/2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

<sup>13</sup> VKM nr. 604/2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

<sup>14</sup> VKM nr. 833/2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit”.

<sup>15</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda\\_21\\_5276](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_21_5276)



Në vijim të masave të marra në maj 2021, DAP dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë nënshkruan udhëzimin e përbashkët për formën, elementët dhe plotësimin e listëpagesës mujore<sup>16</sup>, hap ky i rëndësishëm që do të kërkojë ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve për të shtuar kështu në vitet e ardhshme numrin e institucioneve të cilët e përdorin SIMBNJ për të gjeneruar listëpagesat.

Ndër të tjera, një kontribut në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore ka dhënë dhe zbatimi i **programit “Administrata që Duam”**, një iniciativë ambicioze e nisur nga qeveria shqiptare në vitin 2018. Programi përbëhet nga katër komponentë kryesorë si: (i) orientimi i administratës; (ii) aftësimi i administratës; (iii) motivimi i administratës; dhe (iv) ndërveprimi i administratës. Programi ka mundësuar rritjen e ndërveprimit përmes nxitjes dhe ndarjes së mendimeve të nëpunësve të organizuar sipas rrjeteve profesionale të ngritura, të cilat janë në funksion të plotë.

Në lidhje me unifikimin e proceseve të administrimit të shërbimit civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), në bazë të vendimit nr. 1, datë 5.01.2022, ka nisur një proces të gjerë unifikues, që lidhet me strukturimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, në strukturën organizative të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, që përfshin 61 bashki të vendit.

Ky proces, synon unifikimin e strukturave të administratës vendore, duke pasur parasysh dy komponentë kryesorë: (i) standardet numerike të ndërtimit të njësive organizative; dhe (ii) saktësimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nëpërmjet hartimit të përshkrimeve të punës në përputhje me aktivitetin e çdo pozicioni dhe do të shtrihet deri në vitin 2025.

Aktualisht, Komisioneri është në proces për shtimin edhe të dy pozicioneve të tjera, të nivelit inspektor, të cilët do të jenë pjesë e drejtorisë së re të krijuar. Fondet në buxhetin e institucionit në lidhje me këtë proces janë miratuar dhe procedura po vazhdon për miratimin e strukturës në Kuvendin e Shqipërisë.

**Në lidhje me trajnimet e ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike**, gjatë periudhës janar – tetor 2022 janë zhvilluar webinare, trajnime në klasë, kurse online me certifikim, trajnime për trajnerë, si dhe trajnime në bashkëpunim me partnerë, ku janë trajnuar afërsisht 4987 individë, ose 20244 pjesëmarrës.

Rëndësi gjatë kësaj periudhe i është dhënë **ofrimit të trajnimeve për Bashkimin Evropian** (2,103 të trajnuar) duke qenë se roli i administratës publike është kyç në përgatitjen drejt rrugëtimit të Shqipërisë në BE, si dhe ofrimit të **trajnimeve në fushën antikorrupsion** (2372 të trajnuar).

---

<sup>16</sup> Nr. 1, datë 21.05.2021 “Për formën, elementët dhe plotësimin e listëpagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Në vijim të vlerësimit të nevojave për trajnim me target grup “Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” (GNPIE), është implementuar programi i detajuar për trajnimin e anëtarëve të GNPIE.

Gjithashtu, në kuadër të rritjes së kapaciteteve trajnuese dhe prezantimit të metodave hibride të trajnimit, puna ka vijuar në drejtim të zhvillimit të platformave online të trajnimeve *Learning Management System (LMS)*. Në muajin Tetor 2022, ASPA filloi trajnimet online në platformën **LMS** duke zhvilluar sesione interaktive dhe punë në grup.

### **Prioritet kryesorë për periudhën në vijim:**

- Prezantimi i promovimit (lëvizjes horizontale) në nivelet e pagave, ku ndryshimet ligjore në legjislacionin e shërbimit civil priten të miratohen në vitin 2023, dhe zbatimi i ndryshimeve duke filluar nga – 2024;
- Standardizimi i procedurave të rekrutimit për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND) – 2023;
- Zbatimi i metodologjisë së re të vlerësimit të vendeve të punës – 2023;
- Thjeshtimi dhe përmirësimi i metodologjisë së vlerësimit të nevojave për trajnim dhe vlerësimit të cilësisë së procesit të trajnimit – 2023;
- Përfundimi i programit të trajnimit të thelluar për TND – 2023;
- Zgjerimi i mëtejshëm i SIMBNJ.

### **Llogaridhënia**

Në kuadër të zbatimit të reformës funksionale strukturore të institucioneve të varësisë dhe në bazë të urdhrin nr. 59/2018 të Kryeministrit, “Për ngritjen e strukturave për reformën strukturore në qeveri”, u krijuan struktura përkatëse përgjegjëse, ku organ përgjegjës u caktua Komiteti Drejtues i Reformës Strukturore të Qeverisë, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri.

Ky proces ka përfunduar për 4 sisteme ministrore (shëndetësi, arsim, turizëm dhe bujqësi), për të cilat u morën në analizë funksionet e institucioneve të varësisë dhe u riorganizuan institucionet sipas tipologjisë së miratuar nga Komiteti Drejtues (autoritet, agjenci të menaxhimit të cilësisë dhe operatorë të ofrimit të shërbimeve).

Në drejtim të reformimit të institucioneve të varësisë, DAP-i është mbështetur nga projekti i asistencës teknike të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, “Mbështetje për reformën e institucioneve të varësisë dhe agjencive në Shqipëri”, i cili prek tipologjinë e institucioneve dhe linjën e tyre të raportimit.

Gjithashtu, DAP-i është mbështetur nga projekti IPA “Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike”, për hartimin e proceseve horizontale dhe vertikale të punës në ministrinë e linjës.

Në përputhje me programin e qeverisë 2021 – 2025 dhe në kuadër të nismës së ndërmarrë për mbylljen e të gjitha zyrave dhe ofrimin e shërbimeve tërësisht online, ka vijuar procesi i ristrukturimit të institucioneve në varësi dhe ministrive të linjës. Në periudhën janar – 19 dhjetor 2022 për shkak të ndryshimit të disa vendimeve të Këshillit të Ministrave për fushën e përgjegjësisë për ministrinë e linjës, si dhe në miratimin e vendimeve për ngritjen e institucioneve të reja, u krye ristrukturimi i 43 ministrive të linjës /institucioneve të varësisë dhe u ngritën 4 institucione të reja.

Ligji Nr. 90/2012 parashikon tipologjinë e institucioneve, ku përveç administratës së prefektit, përfshihen: 1) institucionet e varësisë; 2) agjencitë autonome; 3) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve. Këto institucione sigurojnë zbatimin e politikave, nëpërmjet funksioneve rregullatore dhe të ofrimit të shërbimeve.

Kuadri rregullator e centralizon funksionin e përgatitjes së strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore në një institucion të vetëm, duke ia dhënë këtë kompetencë DAP-it dhe atë të miratimit Kryeministrit. Nga ana tjetër, konsultimi dhe marrja e mendimit nga ministria përgjegjëse për financat në lidhje me strukturat dhe organikat e institucioneve, është e detyrueshme. Edhe në rastet kur mbështetet në një ligj të veçantë, struktura organizative nuk miratohet nga Kryeministri, merret në mënyrë të detyrueshme mendimi i DAP-it dhe ministrisë përgjegjëse për financat.

Ky mekanizëm synon: (i) të unifikojë mënyrën e organizimit të institucioneve të administratës shtetërore; (ii) të garantojë respektimin e rregullave të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore; dhe (iii) të shmangë mbivendosjen e funksioneve.

Njësitë organizative në përbërje të institucioneve krijohen në bazë: (i) të identifikimit të kompetencave kryesore dhe grupimit të tyre; (ii) rregullave për krijimin e njërive strukturore të niveleve të ndryshme, si dhe; (iii) rregullave për alokimin e burimeve njerëzore në dispozicion midis njërive që realizojnë funksionet për të cilat ekziston institucioni dhe njërive të shërbimeve mbështetëse.

Gjithashtu, në legjislacion parashikohen shprehimisht rastet kur mund të ndryshohen strukturat organizative të institucioneve të administratës shtetërore.

Format e **bashkëpunimit** janë të mirëpërcaktuara në legjislacion ku përcaktohet se: (i) institucionet i sigurojnë njëri-tjetrit të dhëna, informacione dhe ndihmën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre; (ii) krijojnë grupe të përbashkëta pune për hartimin e strategjive, politikave, studimeve ose projekt-akteve të veçanta; dhe (iii) krijojnë njësi të përbashkëta për të kryer detyra administrative të cilat për nga natyra e tyre kërkojnë pjesëmarrjen e disa institucioneve. Në funksion të mekanizmave të bashkëpunimit janë të përcaktuara në legjislacion edhe procedurat e bashkëpunimit.

Për sa i përket **linjave të llogaridhënies** ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe atyre të varësisë, situata paraqitet si më poshtë:

- Planet vjetore, buxhetet dhe raportet vjetore të institucioneve të varësisë i dorëzohen ministrisë nga varen, për miratim;
- Drejtoritë e përgjithshme të ministrive mbikëqyrin në praktikë implementimin e planeve vjetore të institucioneve të varësisë;
- Planet vjetore dhe raportet vjetore të institucioneve të varësisë konsistojnë në objektiva të përgjithshëm dhe lista të detajuara të aktiviteteve që planifikohen të kryhen ose janë kryer.

**Në lidhje me monitorimin e proceseve të politikëbërjes nga Kuvendi**, është në funksion kuadri rregullator që mundëson shqyrtimin dhe mbikëqyrjen parlamentare të politikave të qeverisë, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar dhe në Rregulloren e Kuvendit, të ndryshuar.

Në takimet e Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit, diskutohen dhe merren vendime mbi programin e punës, kalendarin e procedurave të Kuvendit dhe komisioneve të tij, pasi një nga anëtarët e Kuvendit është Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Rregullorja e Kuvendit parashikon që projektligjet e paraqitura nga Qeveria të shoqërohen me raport shpjegues, i cili përmban gjithashtu raporte të RIA dhe tabela të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së kur një projekt-ligj është në përaftrim me *acquis*.

Ministrat dhe zëvendësministrat i prezantojnë projektligjet në komisionet parlamentare. Për periudhën janar – tetor 2022, numri i projektligjeve është 159, numri i pyetjeve të deputetëve për projektligjet është 1655, numri i ndryshimeve të miratuara në mbledhjet e komisionit është 281 dhe numri i ndryshimeve të miratuara nga grupet e interesit është 31.

Për periudhën janar – tetor 2022 janë miratuar 72 ligje, 29 rezoluta, 80 vendime dhe 2 ligje me procedurë të përshpejtuar.

Ligji nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit gjatë procesit të integritit të Republikës së Shqipërisë në BE” dhe Rregullorja e Kuvendit përcaktojnë dispozitat për monitorimin e punës së qeverisë në fushën e integritit në BE.

Për periudhën janar – shtator 2022 janë përafuar 16 ligje dhe 57 amendamente/ndryshime në Komisionin për Integrimin Evropian.

Gjithashtu, Kuvendi ushtron funksionin kontrollues për zbatimin e legjislacionit, politikave ose çështjeve të tjera në komisionet e përhershme parlamentare dhe në seancë plenare.

Për vitin 2022 rezulton se nga janari deri në tetor 2022 numri i seancave plenare me ministrat dhe zëvendësministrat është 13 dhe numri i pyetjeve nga deputetët në këto seanca është 166.

Numri i kërkesave për seanca plenare është 23 dhe i kërkesave për informacion është 181.

Referuar numrit të projektligjeve të dorëzuara nga deputetët dhe të dhënave për numrin e ligjeve të miratuara në seanca plenare gjatë periudhës janar-tetor 2022, rezulton se 26 projektligje janë propozuar nga deputetët dhe 5 ligje të propozuara nga deputetët janë miratuar në seanca plenare.

Bazuar në raportin e monitorimit të SIGMA-s për vitin 2021 për Shqipërinë, rezulton se vlera për treguesin ‘Shqyrtimi parlamentar i politikëbërjes së qeverisë’ është 4 nga 5 në total dhe se nuk ka pasur ndryshime të mëdha të evidentuara në legjislacionin apo praktikën e mbikëqyrjes parlamentare të Qeverisë.

Në vijim të rekomandimit të Komisionit Evropian, Parlamenti krijoi një mekanizëm të përbashkët ndërinstitucional për të përmirësuar rolin e tij mbikëqyrës. Një nga funksionet kryesore të këtij mekanizmi është të sigurojë që Parlamenti të ndjekë rekomandimet e organeve ekzekutive. Pjesë e mekanizmit është Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin<sup>17</sup>, roli i të cilit është të koordinojë me ministrinë e linjës për zbatimin e rekomandimeve nga institucionet e pavarura.

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka ngritur një rrjet koordinorësh në ministrinë e linjës për të mbështetur procesin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Rrjeti i koordinorëve është përgjegjës për monitorimin e progresit dhe raportimin dy herë në vit.

Ky rrjet mbledhet dhe trajnohet nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Në prill 2022 u mbajt takimi i parë i këtij viti, ku u caktuan detyra konkrete për vazhdimin e procesit të raportimit dhe përmirësimin e tij në cilësinë dhe përmbajtjen e raportit.

Me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit është ngritur një grup pune për rishikimin e vendimit nr. 49/2017 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e një mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese”. Ky grup pune përbëhet nga anëtarë të Drejtorisë së Shërbimit të Monitorimit në Kuvend, përfaqësues nga Institucionet e Pavarura dhe përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Aktualisht, grupi i punës po punon mbi rishikimin e vendimit dhe pritet që procesi të përfundojë në vitin 2022.

Qëllimi i rishikimit të vendimit nr. 49/2017, është që të forcohet roli i Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin në monitorimin e ministrive të linjës në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe përdorimin e Platformës Ndërinstitucionale Online.

---

<sup>17</sup> VKM nr. 11/2019, “Për përcaktimin e përgjegjësisë së Ministrisë së Shtetit dhe marrëdhëniet me Parlamentin”- Ministri, koordinon punën dhe trajton çështjet e institucioneve të pavarura apo institucioneve të tjera në lidhje me marrëdhëniet institucionale që kanë me Këshillin e Ministrave, ministrinë apo autoritete shtetërore të ndryshme; harton projekte që adresojnë organizimin dhe funksionimin e tyre; interesa të tjera që kanë për projekte të ndryshme apo për procesin legjislativ.

Kjo platformë është pjesë e mekanizmit të përbashkët monitorues ndërinstitucional dhe përbëhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (6 nga 21 institucione të pavarura).

### **Në lidhje me ndryshimet e Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.**

Garantimi i të drejtës për informimin e qytetarëve është përmirësuar dukshëm, duke ndikuar në rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Për të adresuar problematikat e ndryshme të hasura gjatë zbatimit të ligjit nr. 119/2014, por edhe sugjerimet/propozimet e vazhdueshme të grupeve të interesit, doli si domosdoshmëri nevoja e përmirësimit të rregullave në këtë fushë.

Për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit hartoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara përmirësojnë dhe forcojnë rregullat dhe procedurat e legjisllacionit aktual dhe konsistojnë në mënyrë të përmbledhur në:

- parashikimin e kompetencave të Komisionerit për fushën e të drejtës për informim në ligjin që rregullon këtë veprimtari (përfshirë hetimin administrativ);
- rishikimin e kufijve minimalë të gjobës vendosur koordinatorit apo personit përgjegjës në raport proporcional me pagën e tij, duke ulur kufijtë minimalë të gjobës;
- bashkëpunimin e autoriteteve publike me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin për përmbushjen e detyrave të tij, duke i ngarkuar ato me detyrimin për të raportuar çdo fillimviti kalendarik pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të ligjit;
- përfundimin e procedurës administrative nga autoriteti publik pa një vendim përfundimtar duke pasur detyrimin për të vërtetuar barrën e provës të natyrës abuzive të kërkesës në rastet e kërkesave abuzive ose të përsëritura. Kundër vendimit të autoritetit publik për përfundimin e procedurës pa një vendim përfundimtar, mund të paraqitet ankim tek Komisioneri;
- mundësinë e sanksionimit të personit përgjegjës për refuzimin e dhënies së informacionit, përveç rasteve kur përgjegjës është koordinatori për të drejtën e informimit si dhe rastet për të cilat mban përgjegjësi titullari i autoritetit publik.

Projektligji është publikuar në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik në datën 19.10.2022 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe ka qenë në proces konsultimi deri në datën 15.11.2022. Pritet që ndryshimet në projektligjin nr. 119/2014 të miratohen brenda fundit të vitit 2022.

Pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar 873 ankesa me objekt “Refuzim dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare” ndaj autoriteteve publike dhe janë kryer 43 hetime

administrative me autoritetet publike, si dhe i janë dhënë 28 rekomandime autoriteteve publike për rishikimin/përditësimin e programit të transparencës.

Sa i përket vënies në funksion të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve deri në muajin shtator 2022, 195 autoritete publike kanë të instaluar REKPDI.

### **Prioritetet kryesore për periudhën në vijim:**

- Pas 10 vitesh zbatimi të ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, analizat dhe rekomandimet e bëra nga SIGMA/OECD, si dhe nga projekti “Mbështetje për reformën e institucioneve të varësisë dhe agjencive në Shqipëri”, një nga çështjet të cilat janë evidentuar për ndërhyrje të mëtejshme është çështja që lidhet me **tipologjinë e institucioneve të administratës shtetërore**.

Duhet theksuar se dallimi midis dy llojeve të institucioneve - institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome - është i paqartë dhe nuk bazohet në kritere të qarta, duke ofruar diskrecion të gjerë dhe pak udhëzime për zgjedhjen e formës organizative për funksione specifike. Ligji nuk përcakton një tipologji dhe kritere të qarta për krijimin e organeve të varësisë.

Gjithashtu, SIGMA ka lënë rekomandime në raportin e fundit të monitorimit për Shqipërinë (nëntor 2021) në lidhje me linjën e llogaridhënies duke theksuar që është i nevojshëm një përcaktim më i mirë i linjave të llogaridhënies administrative, veçanërisht në qartësimin e funksioneve mbikëqyrëse ndërmjet ministrive të linjës dhe agjencive në varësi.

Për këtë qëllim, **ligji 90/2012 do t'i nënshtrohet një procesi ndryshimesh** për përcaktimin më të mirë të organizimit, funksioneve, tipologjive të institucioneve dhe linjës së llogaridhënies duke përfshirë mbikëqyrjen e institucioneve të varësisë.

Një draft i parë është në përgatitje e sipër, bazuar në rekomandimet e projekteve të sipërcituara dhe synohet që këto ndryshime të miratohen në Parlament gjatë vitit 2023.

### **Në lidhje me të drejtën e informimit synohet:**

- përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- komunikimi proaktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike;
- bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësimit me qëllim zbatimin efektiv të tij;
- zhvillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda komunitetit global rregullator të të drejtës për informim.

### **Shërbimet publike**

Revolucioni digjital i shërbimeve publike në Shqipëri ka ndryshuar prej kohësh perceptimin e qytetarëve në lidhje me komunikimin elektronik me institucionet shtetërore, duke bërë që sot të ofrohen **1,225 shërbime online** ose rreth **95%** të të gjitha shërbimeve publike.

Qeveria shqiptare, si promovuese e shndërrimit të shërbimeve offline në shërbime online, e shndërroi platformën e-Albania e cila në 2013 kishte vetëm 14 shërbime elektronike, në një histori suksesi dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të rivendoste besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Aktualisht në portal ofrohen 55 dokumente me vulë elektronike, duke eliminuar tërësisht printimin e tyre në letër në sportelet fizike të institucioneve. Në 5 vite (shtator 2017 – dhjetor 2022) janë gjeneruar 23 milionë dokumente me vulë elektronike.

Një qytetar sot përmes e-Albania merr çdo dokument shtetëror, nga certifikata personale tek certifikatat e pronave, paguan faturat mujore, shërbimet e shëndetit, merr vërtetime gjyqësore, vërtetime për sigurimet, e çdo shërbim tjetër utilitar dhe nuk e ka më të nevojshme të shkojë fizikisht në zyrat e shtetit. Në total portali e-Albania u ka kursyer qytetarëve dhe bizneseve 990 vite pritje nëpër radhë për marrjen e dokumenteve shtetërore me vulë elektronike dhe rreth 9 milionë euro në xhepat e tyre, nga heqja e tarifave të këtyre dokumenteve që ofrohen tashmë pa pagesë në platformë në versionin e tyre elektronik.

Raportet e organizatave nga OKB, OECD, Departamenti Amerikan i Shtetit dhe BE, e vlerësojnë Shqipërinë me notën maksimale në qeverisjen digjitale. Shqipëria vlerësohet me çmim për qeverisjen digjitale nga ReSPA (iniciativë e BE-së) dhe OECD/SIGMA për zbatimin e praktikave, iniciativave, shërbimeve online dhe masave efikase për përballimin e krizës së koronavirusit.

Deri në fillim të vitit 2022, vetëm 1/3 e shërbimeve elektronike siguronin dokumentin përfundimtar (certifikatë, vërtetim) në mënyrë elektronike me vlerë ligjore (e nënshkruar ose e-vulosur). Gjatë vitit 2022, u vendosën zhvillime teknike për të digjitalizuar përgjigjen ndaj 828 llojeve të aplikimeve të qytetarëve, të cilët jepnin dokumentin përfundimtar në letër, kryesisht në recepsionet e institucioneve ose me postë.

**Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje** është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të afateve brenda Sistemit të Qarkullimit Elektronik të Dokumentacionit dhe përdorimin e sistemit në rastet kur duhet të bëhet shkëmbim i dokumentacionit shoqërues ndërmjet institucioneve deri kur shërbimi dhe dokumenti përfundimtar me një vulë elektronike ose nënshkrim elektronik u dorëzohet qytetarëve dhe bizneseve, sipas afateve ligjore.

Në bazë të ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen” parashikohet se ofrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet ofruese të shërbimeve, aplikimet e të cilave dorëzohen nëpërmjet platformës e-Albania, do të bëhet vetëm në mënyrë elektronike duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vlerë ligjore (vulë elektronike ose nënshkrim elektronik).



Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, puna e administratës për kthimin e përgjigjeve po monitorohet plotësisht në kuadër të **Sistemit të Qarkullimit Elektronik të Dokumenteve (SQED)**, duke i bërë shërbimet publike të jenë më efikase dhe transparente.

Monitorimi në kohë reale ndihmon në identifikimin e dobësive dhe drejtuesit e institucioneve marrin informacion në kohë reale me qëllim që të ndërhyjnë në zgjidhjen e problemeve dhe të shmangin vonesat.

Për periudhën 1 maj – tetor 2022, janë dorëzuar 223,728 aplikime të monitoruara përmes SQED.

### **Prioritetet kryesore për periudhën në vijim:**

- Rritja e numrit të dokumenteve të vulosura elektronikisht, të cilat ofrohen në kohë reale në platformën e-Albania, nëpërmjet digjitalizimit të arkivave fizike ose vendosjes së sistemeve të reja elektronike;
- Ri-inxhinierimi dhe personalizimi i mëtejshëm i shërbimeve publike, si masë e nevojshme për thjeshtimin e procedurave administrative dhe reduktimin e kohës së marrjes së shërbimit;
- Përfshirja e institucioneve të mbetura në SQED, për çdo aplikim, përgjigjet në kohë reale sigurohen nga sistemi – fundi i vitit 2022;
- Faza fillestare e inspektimeve bazuar në rezultatet e monitorimit të SQED dhe ankesave përkatëse të qytetarëve përmes platformës së bashkëqeverisjes - fundi i vitit 2022/inspektim mujor gjatë vitit 2023;
- Masat disiplinore dhe sanksionet e duhura që lidhen me aplikimet që vonohen ose dorëzohen me gabime. Identifikimi i pengesave në sistem dhe sugjerimet për përmirësim - gjatë vitit 2023.

### **Menaxhimi i financave publike**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vijuar me zbatimin e reformave të ndërmarra në fushën e menaxhimit të financave publike, të cilat materializohen në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019 – 2022, e cila u miratua në 18 dhjetor 2019. Kjo strategji përbëhet nga shtatë objektiva specifike (OS), si:

- OS1: Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm;
- OS2: Planifikim i mirëintegruar dhe efikas;
- OS3: Mbledhja e të ardhurave;
- OS4: Zbatim efikas i buxhetit;
- OS5: Transparenca e financave publike;
- OS6: Kontroll i brendshëm efektiv;
- OS7: Mbikëqyrje efektive e financave publike.

Raporti i Monitorimit për vitin 2021 për Strategjinë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2019 – 2022, u diskutua në Komitetin Teknik të mbajtur në datë 9.06.2022 dhe u miratua në Komitetin Drejtues në datën 19.07.2022.<sup>18</sup>

Disa nga arritjet kryesore për vitin 2022 paraqiten si vijon:

- Për përgatitjen e Programit Buxhetor afatmesëm (PBA) 2023 – 2025 janë trajnuar 210 nëpunës civilë të të gjitha Ministrive të Linjës dhe Institucioneve Qendrore;
- Komiteti i Planifikimit Strategjik diskutoi në muajin korrik 2022 “Dokumentin e Politikave Prioritare 2023 – 2025”;
- SASPAC në bashkëpunim me MFE, kanë iniciuar procesin e rishikimit të VKM-së nr. 185, datë 29.03.2018 “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”, i cili do të përfshijë dhe procedurat për vlerësimin dhe miratimin e Listës Unike të Projekteve Kombëtare. Ky proces është në fazën finale të reflektimit të komenteve dhe sugjerimeve nga institucionet e përfshira dhe pritet të hyjë në fuqi në vitin 2023;
- MFE ka arritur të monitorojë rreth 83.9% të të gjitha kontratave për Partneritetin Publik Privat dhe Koncesionet (193 nga 230 kontrata në total);
- Procesi i Programit Buxhetor afatmesëm (PBA) 2023 – 2025 në nivel vendor është përmirësuar duke u fokusuar në planifikimin në nivel produkti si dhe është prezantuar Instrumenti i Planifikimit Financiar 2023 – 2025 me formatet e reja për buxhetimin në nivel produkti. Aplikimi i metodologjisë së re të buxhetimit është kryer në 3 bashki pilot. Gjithashtu është miratuar dhe publikuar Udhëzimi i rishikuar i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023 – 2025, shoqëruar me anekset dhe relacionin që duhet përgatitur nga njësitë e qeverisjes vendore;
- Raporti “Për statusin e gjendjes financiare të njësisve të vetëqeverisjes vendore, për vitin 2021” është hartuar dhe paraqet statusin e gjendjes financiare për të 61 bashkitë;
- Gjithashtu është hartuar raporti i fizibilitetit për shtrirjen e AFMIS-it në nivel vendor;
- Për sa i përket Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), ekzistojnë procedura të automatizuara të bazuara në risk dhe stoku i rimbursimeve të TVSH-së u zerua në vitin 2022. Platforma e rimbursimit të TVSH-së filloi të funksionojë në vitin 2022;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ofron aktualisht nëpërmjet portalit e-Albania 31 shërbime, duke krijuar mundësinë që tatimpaguesit dhe individët të marrin shërbimin e kërkuar duke kursyer kohë, burime njerëzore dhe kosto administrative;
- Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit gjatë vitit 2022 bëri të mundur që 272 institucione të reja buxhetore të përdorin WebPortal-i për arkivin elektronik (aktualisht e përdorin 417 institucione nga 1100 në total);
- Integrimi i Sistemit Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me Sistemin Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) për automatizimin e pagave të punonjësve ka përfunduar (aktualisht 122 institucione buxhetore janë pjesë e këtij integrimi);
- Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit përmirësoi parashikimin dhe monitorimin e likuiditetit që është përgatitur dhe përditësuar në baza ditore dhe mujore;

---

<sup>18</sup> <https://financa.gov.al/raportet-e-monitorimit-2/>

- Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2022 – 2026 u miratua në korrik 2022 përmes VKM-së Nr. 534 datë 29.07.2022;
- Nëpunësit e Komisionit të Prokurimit Publik për periudhën janar – tetor 2022 kanë ndjekur trajnime të ndryshme individuale (21 trajnime në total);
- Për periudhën janar – shtator 2022, përqindja e ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Prokurimit Publik pas kalimit të afatit, ka rënë në 10.2%, nga 10.8% që ishte në vitin 2021;
- Gjatë kësaj periudhe është hartuar dhe publikuar Buxheti për Qytetarët 2023, ku është përfshirë për herë të parë një aneks për buxhetimin gjinor;
- Fundi i vitit 2022 shënon finalizimin e hartimit të anekseve të reja dhe rishikimin e Udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, që do të përmbajnë informacion mbi treguesit kyç të performancës në nivel qëllimi dhe objektivi, të gjeneruara automatikisht nga moduli i Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve (BPPM) i sistemit AFMIS;
- Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të MFE janë zhvilluar trajnime si dhe ka përfunduar pilotimi i trajnimit për herë të parë i kontabilistëve dhe financierëve të sektorit publik (100 kontabilistë të trajnuar);
- Zbatimi i Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) 2021 – 2022 në Shqipëri;
- Në lidhje me rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike që merren me zbatimin e procesit të menaxhimit të riskut janë zhvilluar 10 seanca trajnime me 520 pjesëmarrës;
- Në lidhje me misionet e auditimit për vitin 2022, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), për periudhën janar – shtator 2022 ka kryer dhe evaduar 121 misione auditimi në të gjitha nivelet e qeverisjes;
- Në datën 25 nëntor 2022, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë buxheti i qeverisë për vitin 2023.

Prioritetet për periudhën në vijim:

Në fushën e financave publike:

- Reduktimi i borxhit publik;
- Shlyerja dhe parandalimi i detyrimeve të prapambetura;
- Mobilizimi i vazhdueshëm për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore;
- Përmirësimi i menaxhimit të projekteve të investimeve publike duke përfshirë Partneritetin Publik Privat dhe dhënien me koncesion;
- Sigurimi i një lidhjeje më të mirë të planeve strategjike me Programin Buxhetor Afatmesëm;
- Më shumë angazhim në fushën e transparencës së financave publike duke nxitur buxhetimin me pjesëmarrje në këtë proces të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Rritja e përpjekjeve për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe gjetjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

- Implementimi i mëtejshëm i kuadrit rregullator të kontabilitetit të sektorit publik të hartuar bazuar në IPSAS;
- Ngritja e kapaciteteve në fushën e kontabilitetit të sektorit publik bazuar në IPSAS;
- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së re të Menaxhimit të Financave Publike;
- Në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, pritet të miratohet rishikimi i Ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” si dhe i akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në një mënyrë më të përmbledhur janë evidentuar prioritetet dhe afatet kohore për arritjen e tyre gjatë vitit 2023.

- Konsolidimi i Kadastrës Fiskale, ligji i ri për taksën e pasurisë dhe përgatitja për zhvillimin e modulit për proceset e vlerësimit. Miratimi i ligjit të ri për taksën e pasurisë dhe avancimi i proceseve të lidhura me popullimin e Kadastrës Fiskale dhe puna për zhvillimin e modulit për proceset e vlerësimit.
- Procesi i konsultimit dhe miratimi i Ligjit të ri për taksën e pasurisë së paluajtshme: 31.12.2023:
  - draftimi i akteve nënligjore shoqëruese: 31.12.2023;
  - vazhdimi i proceseve me bashkitë pilot dhe shtrirja edhe në bashki të tjera për popullimin me të dhëna të Kadastrës Fiskale: 31.12.2023;
  - zhvillimi i modulit për regjistrimin e transaksioneve të shitjes (Regjistri i Çmimit të Shitjeve) dhe fillimi i punës për procesin e vlerësimit duke u përqendruar në hapat primarë të kategorizimit të transaksioneve dhe regjistrimit të tyre në Regjistrin e Çmimit të Shitjeve; 30.06.2023.

*Sistemi gjyqësor dhe reforma në sistemin e drejtësisë*

*Për më shumë informacion referohuni tek Kapitulli 23 “ Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.*

*Anti-korrupsioni*

*Lutemi referohuni tek Kapitulli 23 “ Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.*

*Të drejtat e njeriut*

*Lutemi referohuni tek Kapitulli 23 “ Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.*

*Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare*

## *Bashkëpunimi rajonal*

Prioriteti kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në rajon është promovimi i fqinjësisë së mirë dhe kontributi në stabilitetin politik, paqen, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik nëpërmjet bashkëpunimit si në nivel dypalësh, ashtu edhe në atë shumëpalësh. Një rajon i sigurt dhe politikisht i qëndrueshëm që zhvillon lidhjet e duhura ekonomike brenda tij dhe me pjesën tjetër të botës, i shërben interesave kombëtare të Shqipërisë, por është edhe në interes të të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe të fqinjëve.

Shqipëria vazhdon të kontribuojë në mënyrë aktive në të gjitha nismat rajonale, ku ajo është pjesëmarrëse. Shqipëria kryesoi presidencën e NAJ-EUSAIR për periudhën qershor 2021 – maj 2022. Në kuadër të kësaj presidence u organizuan me sukses aktivitete në fusha të ndryshme si: turizmi, kultura, çështjet rinore, ekonomia, infrastruktura, digjitalizimi, integrimi në BE i Ballkanit Perëndimor, etj. Në 16 – 17 maj 2022 u mbajt Forumi i Ministrave të Jashtëm të NAJ-EUSAIR. Presidenca shqiptare realizoi me sukses të gjitha objektivat e saj, duke dorëzuar Presidencën Bosnjë-Hercegovinës dhe vazhduar të jetë pjesë e Trio-s së NAJ-EUSAIR.

Shqipëria mbetet një pjesëmarrëse dhe përfituese aktive e Procesit të Berlinit, që ka qenë vendimtar në krijimin e një epoke të re të vullnetit të mirë dhe bashkëpunimit në rajonin tonë. Shqipëria vlerëson shumë atë që është arritur në kuadër të Procesit të Berlinit: më shumë bashkëpunim dhe projekte në fushën e transportit dhe infrastrukturës, bashkëpunimin ekonomik, bashkëpunimin rinor, bashkëpunimin e biznesit dhe shoqërinë civile në Ballkanin Perëndimor. Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), krijimi i korridoreve të gjelbra dhe Forumi i Investimeve i Dhomave të Ballkanit Perëndimor (WBCIF) janë arritje të padiskutueshme të Procesit të Berlinit.

Shqipëria vlerëson marrëveshjet e arritura në Samitin e Berlinit të PB më 3 nëntor, për lëvizjen e lirë dhe njohjen e letërnjoftimeve për të gjithë qytetarët e rajonit, si dhe për njohjen reciproke të diplomave universitare dhe kualifikimeve profesionale brenda rajonit, si etapa të rëndësishme në përmbushjen e angazhimeve për të krijuar një Treg të Përbashkët Rajonal.

Në fushën e lidhjes digjitale, Shqipëria vlerëson zbatimin e plotë të Marrëveshjes Rajonale për Roaming dhe fillimin e regjimit të roamingut falas në Ballkanin Perëndimor që nga 1 korriku 2021. Mbështetur në zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje, vlerësohet deklarata e përbashkët e operatorëve të telekomunikacionit të BE-së dhe BP-së, arritur në Samitin e Tiranës BE-BP, 6 dhjetor, që do të bëjë të mundur uljen e parë të kostove të roaming-ut midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në vitin 2023, me synimin për t'i hequr ato plotësisht më pas. Ulja e tarifave të roaming-ut ndërmjet BE-së dhe BP është në përputhje me Masat në mbështetje të një Agjende Digjitale për Ballkanin Perëndimor dhe agjendën e Tregut të Përbashkët Rajonal 2021 – 2024.

Nisma e “Ballkanit të Hapur” është një pjesë integrale dhe logjike e procesit të Berlinit. Aktualisht një bashkëpunim mes tre vendeve të rajonit, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, i hapur për të gjitha vendet e rajonit, Ballkani i Hapur synon avancimin e zbatimit të katër lirive të BE-së (njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit) në Ballkanin Perëndimor dhe përshpejtimin e

procesit të integritit. Kjo nismë inovative dhe në pronësi rajonale synon të krijojë një rajon të integruar ekonomikisht. Ajo synon forcimin e bashkëpunimit rajonal, gjenerimin e rritjes ekonomike, uljen e papunësisë (veçanërisht në mesin e të rinjve) dhe përmirësimin e mirëqenies sociale të qytetarëve tanë, rritjen e tregtisë dhe investimeve, por njëkohësisht edhe bashkëpunimin për të luftuar migrimin e paligjshëm dhe krimin e organizuar.

Kjo nismë është komplementare me punën në vijim për Tregun e Përbashkët Rajonal, Agjendën e Gjellbër, transformimin digjital, agjendën e lidhjes dhe është një vlerë e shtuar për procesin e integritit në BE të vendeve të rajonit.

## **Republika e Kosovës**

- Republika e Shqipërisë ka marrëdhënie të shkëlqyera me Republikën e Kosovës, bazuar në Deklaratën e Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik. Nuk ka çështje të pazgjidhura midis dy vendeve. Punohet intensivisht për thellimin e marrëdhënieve ekonomike dhe për të rritur vëllimin e tregtisë;
- Bashkëpunimi midis dy vendeve konsiderohet strategjik, stabilizues për rajonin dhe orientues për perspektivën Euro-Atlantike;
- Partneriteti Strategjik me Kosovën zbatohet përmes marrëveshjeve dhe protokolleve të nënshkruara gjatë tetë takimeve ndërqeveritare (G2G) (G2G VIII (Prishtinë, 20 qershor 2022) që kanë ndodhur deri më tani. Ato kanë mundësuar një paketë për të zhvilluar marrëveshje bilaterale që mbulojnë të gjitha fushat e bashkëpunimit, përfshirë zhvillimin e tregtisë, bashkëpunimin midis autoriteteve doganore, infrastrukturën e transportit, bashkëpunimin energjetik, bujqësinë, turizmin, arsimin, bashkëpunimin kulturor, por edhe bashkëpunimin e sigurisë, lehtësimin e procedurave të kontrollit kufitar, luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar, zbatimin e politikës së jashtme, dhe më shumë;
- Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht dialogun e drejtuar nga BE midis Kosovës dhe Serbisë, rezultati përfundimtar i të cilit duhet të jetë një Marrëveshje e detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjellë mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të pakicave kombëtare, konform Kushtetutës së Kosovës;
- Vlerësohet bashkëpunimi ekonomik aktual me Kosovën, si dhe gatishmëria e të dyja vendeve për të forcuar më tej këtë bashkëpunim.

## **Bosnjë dhe Hercegovina**

- Marrëdhëniet me Bosnjë dhe Hercegovinën (BiH) janë të mira me gatishmëri për të intensifikuar dialogun politik;
- Shqipëria po punon për përfundimin e procesit të hapjes së ambasadave respektive të të dyja vendeve, në Tiranë (e hapur tashmë) dhe Sarajevë;
- Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht sovranitetin, integritetin territorial, kohezionin shoqëror të Bosnjë dhe Hercegovinës, si dhe përparimin e saj në rrugëtimin Euro-Atlantik;
- Në këtë kuadër, Shqipëria mbështet pa mëdyshje marrjen e statusit të vendit kandidat për anëtarësimin në BE të Bosnje dhe Hercegovinës;

- Shqipëria është e vendosur kundër çdo përpjekjeje destabilizuese dhe retorikës “separatiste” që vjen nga brenda dhe jashtë BiH;
- Shqipëria ndjek me shumë shqetësim rritjen e tensioneve më të fundit etnike në vend, përpjekjet e liderëve serbë të BiH për t’u tërhequr nga institucionet e përbashkëta shtetërore, veçanërisht nga forcat e armatosura të përbashkëta të BiH;
- Shqipëria pret nga Bosnje dhe Hercegovina më shumë angazhim në bashkëpunimin rajonal, përfshirë përfshirjen e të gjashtë vendeve të BP në nismat rajonale, si dhe një qëndrim më të hapur ndaj përfshirjes së Republikës së Kosovës në mekanizmat e bashkëpunimit rajonal;
- Shqipëria beson se ka ardhur koha për të miratuar një pozicion të ri ndaj Kosovës dhe BiH duhet të rishikojë njohjen e dokumenteve të Republikës së Kosovës dhe lehtësimin e qarkullimit -pa viza- për qytetarët e Kosovës;
- Shqipëria beson se marrëveshja e arritur në Samitin e Berlinit (më 3 nëntor) për lëvizjen e lirë dhe njohjen e letërnjoftimeve për të gjithë qytetarët e rajonit, është një arritje e rëndësishme në këtë drejtim;
- Vëllimi i tregtisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinës mbetet modest. Ndërsa një regjim pa viza ka qenë në fuqi që nga viti 2010, në vitin 2018 u mundësua udhëtimi i qytetarëve nga të dy vendet vetëm me letërnjoftim.

## **Serbia**

- Qeveria Shqiptare i nënkupton marrëdhëniet dypalëshe me Serbinë në dritën e implikimeve dhe ndikime të shumëfishta në nivel rajonal, përfshirë Kosovën dhe shqiptarët që jetojnë në rajon;
- Prej janarit 2021 mes dy vendeve është bërë efektive marrëveshja për lëvizjen e lirë të qytetarëve me letërnjoftime;
- Shqipëria ruan një vëmendje të veçantë për shqiptarët që jetojnë në jug të Serbisë dhe kërkon për ta, më shumë respekt dhe përfshirje në jetën socio-ekonomike të vendit të tyre, në përputhje me normat ndërkombëtare dhe të drejtën evropiane;
- Një çështje e rëndësishme për Shqipërinë është çregjistrimi i adresave të shqiptarëve, më së shumti në Medvegje. Adresat e fshira në komunën e Medvegjës nuk janë një rast i izoluar, por një politikë e vazhdueshme që i privon ata nga të drejtat themelore;
- Shqetësim mbetet edhe përdorimi i vazhdueshëm i gjuhës dhe termave diskriminuese ndaj popullit shqiptar dhe pakicës shqiptare nga autoritetet e larta në Republikën e Serbisë;
- Shqipëria mbështet fuqimisht dialogun Kosovë-Serbi të udhëhequr nga BE, rezultati përfundimtar i të cilit duhet të jetë një Marrëveshje e detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjellët mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të pakicave kombëtare, konform Kushtetutës së Kosovës;
- Shqipëria pret që pala serbe të jetë e drejtpërdrejtë dhe e sinqertë në dialogun me Kosovën;
- Ekziston një ofensivë diplomatike e vazhdueshme nga Serbia kundër shteteve të ndryshme në mënyrë që të tërhiqet njohja e Republikës së Kosovës dhe të pengohet anëtarësimi i Kosovës në nismat rajonale dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare. Kjo ofensivë është kundër frymës së bashkëpunimit rajonal, Procesit të Berlinit dhe Dialogut të lehtësuar nga

BE. Serbia duhet të ndalojë këtë ofensivë, që është në kundërshtim me Ligjin Ndërkombëtar dhe minon stabilitetin rajonal.

## **Mali i Zi**

- Marrëdhëniet me Malin e Zi janë shumë të mira, miqësore dhe vijojnë të intensifikohen më tej. Një marrëdhënie dinamike dhe produktive ka prodhuar një bashkëpunim dypalësh në rritje. Shqipëria mirëpret përparimin e bërë nga Mali i Zi në procesin e negociatave të pranimit në BE;
- Me Malin e Zi zhvillohet një bashkëpunim politik dhe në fusha të tjera, aktiv, përfshirë edhe mekanizimin e takimeve ndërqeveritare G2G;
- Ka pasur një shkëmbim intensiv gjithashtu në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, në kuadrin e pranimit në BE, NATO, Procesi i Berlinit dhe Iniciativa Trepalëshe Shqipëri - Mali i Zi – Kroaci;
- Të dy qeveritë janë të përkushtuara për të punuar në rritjen e thellimin e bashkëpunimit ekonomik, përfshirë rritjen e vëllimit të tregtisë, që aktualisht mbetet modest;
- Shqipëria shpreson që të tejkalohet situata e paqëndrueshmërisë politike në vend, që forcat politike do të gjejnë rrugën e bashkëpunimit për të siguruar një qeverisje të qëndrueshme në të ardhmen e afërt, duke besuar fuqishëm se kjo do të ndihmojë stabilitetin dhe zhvillimin e vendit dhe do të lehtësojë procesin e negociatave me BE-në;
- Shqipëria vlerëson rolin balancues dhe përcaktues të faktorit shqiptar në ruajtjen e trajektore së orientimit euroatlantik të Malit të Zi. Shqipëria ka kërkuar gjithmonë respektimin e të drejtave të komunitetit shqiptar në Mal të Zi brenda kornizës kushtetuese të Malit të Zi.

## **Maqedonia e Veriut**

- Marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut janë intensifikuar dhe vazhdojnë të jenë veçanërisht të mira dhe miqësore. Dialogu ndërshtetëror midis qeverive është i qëndrueshëm, i fortë dhe i integruar përmes bashkëpunimit të gjerë dypalësh në shumë sektorë dhe fusha;
- Shqipëria ka pasur një dialog politik intensiv, përfshirë mbajtjen e takimit të dytë G2GII në nëntor 2022 dhe nënshkrimin e 21 marrëveshjeve, protokolleve dhe memorandumeve të bashkëpunimit dypalësh;
- Shqipëria mirëpret përpjekjet dhe arritjet e qeverisë së Maqedonisë së Veriut për të ndërtuar një shoqëri funksionale multi-etnike bazuar në zbatimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe Ligjit për Gjuhët dhe shpreson që autoritetet në Shkup të bëjnë përpjekje të mëtejshme për këtë çështje;
- Shqipëria vlerëson angazhimin e qeverisë së RMV-së, e cila krahas reformave mori një qasje të re ndaj fqinjëve për ta çuar vendin drejt anëtarësimit të plotë në BE;
- Shqipëria është e kënaqur të shohë rolin aktiv dhe konstruktiv të aktorëve politikë shqiptarë në këtë proces, si dhe besnikërinë e popullatës shqiptare në interes të vendit dhe orientimeve euroatlantike;



- Vlerësohet mbajtja e konferencës së parë ndërqeveritare BE-Shqipëri dhe BE-RMV, si mesazhe pozitive për perspektivën evropiane të rajonit, për përpjekjet e dy vendeve për reforma dhe për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të procesit të integritimit;
- Të dy vendet po punojnë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe në të gjitha fushat me interes të ndërsjellët, përfshirë avancimin e korridoreve të infrastrukturës, energjisë dhe lëvizshmërisë, me fokus të veçantë në projektet madhore të infrastrukturës dhe lidhjes së energjisë: si Korridori VIII, Segmenti Durrës – Elbasan – Shkup; rruga e Arbrit dhe shtrirja në segmentin Bllata – Shkup; përfundimi i interkonektorit 400 KV; ndërtimi i hekurudhës Kërçovë – Ohër me shtrirje deri në Lin, pika e përbashkët doganore dhe e kalimit kufitar në Qafë – Thanë.

## **Greqia**

- Marrëdhëniet me Greqinë mbeten të mira. Greqia është një fqinj i çmuar, partnere e Shqipërisë në NATO, si dhe në rrugën e saj drejt demokracisë, progresit dhe integritimit evropian;
- Për vite Greqia ka qenë në krye të listës së partnerëve në tregti dhe investime të huaja direkte. Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Shqipërisë është orientuar drejt Greqisë, duke i bërë ekonomitë e të dy vendeve të ndërlidhura ngushtë ndërmjet tyre. Të dyja vendet kanë dëshirë të thellojnë akoma më shumë bashkëpunimin ekonomik dhe rritjen e prezencës së investimeve greke në fushën e energjisë, turizmit, transportit, infrastrukturës, bujqësisë, etj. Forumi i biznesit i mbajtur në Athinë më 18 nëntor 2022, i shërben këtij qëllimi;
- Arritjet në bashkëpunimin dypalësh përfshijnë fillimin e bisedimeve për marrëveshjen në fushën e sigurimeve shoqërore (takimi i parë në nivel teknik në shtator 2022); vazhdimin e zbatimit të marrëveshjes për kërkimin, zhvarrosjen, identifikimin dhe varrosjen e ushtarëve grekë të rënë në territorin shqiptar gjatë luftës greko-italiane të 1940 – 1941; intensifikimin e punës për dakordimin e dy marrëveshjeve kufitare (për mirëmbajtjen e piramidave dhe për incidentet kufitare);
- Ka vijuar intensifikimi i dialogut politik ndërmjet dy vendeve me shkëmbime të vizitave të nivelit të lartë: vizita e MPJ grek Dendias në Tiranë në maj 2022, vizita e MEPJ Xhaçka në Athinë, dhjetor 2022, vizita e KM grek Mitsotakis në Tiranë, dhjetor 2022. Ka pasur intensifikim të kontakteve ndërparlamentare, si dhe një sërë vizitash në nivel ministrash, në Tiranë dhe Athinë;
- Pakica kombëtare greke në Shqipëri dhe komuniteti shqiptar në Greqi janë ura të forta lidhëse që forcojnë marrëdhëniet mes vendeve tona.

## **Italia**

- Marrëdhëniet me Italinë janë jashtëzakonisht të mira. Italia mbetet një nga partnerët kryesorë strategjikë të Shqipërisë;

- Bashkëpunimi bazohet në marrëdhënie të jashtëzakonshme historike, kulturore dhe ekonomike. Dialogu ndërshtetëror midis qeverive është i qëndrueshëm, i fortë dhe i integruar përmes bashkëpunimit të thellë dypalësh në shumë sektorë dhe fusha;
- Ka një intensifikim të dialogut politik me shkëmbimet e vizitave në nivele të larta: vizita zyrtare e Presidentit Sergio Mattarella, në shtator 2022, në Tiranë; takimi dypalësh i KM Rama me KM Meloni, në 6 dhjetor 2022; takimi i MEPJ Xhaçka me Zv/KM dhe MPJ italian Tajani, në nëntor 2022 dhe më parë, me ish MPJ Di Maio, në maj 2022;
- Bashkëpunimi në fushat e mbrojtjes, drejtësisë dhe punët e brendshme u forcua më tej, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore, migracionit të paligjshëm dhe azilit. Shqipëria po bashkëpunon ngushtë me Italinë për migracionin e parregullt;
- Italia mbetet partneri i parë tregtar i Shqipërisë dhe një nga donatorët kryesorë të Shqipërisë.

## **Turqia**

- Shqipëria vlerëson partneritetin strategjik dhe marrëdhëniet tradicionale shumë të mira dhe miqësore me Turqinë;
- Lidhjet tona strategjike, si dhe partneriteti i ngushtë i shërbejnë fqinjësisë së mirë, stabilitetit, paqes dhe përparimit në rajon dhe më gjerë;
- Shqipëria dhe Turqia janë partner të besueshëm në NATO;
- Intensifikimi i dialogut politik dhe bashkëpunimi i gjithanshëm dypalësh reflektohet në shkëmbimin e vizitave të nivelit të lartë si vizita e Presidentit Erdogan në Shqipëri, në janar 2022, vizitat e KM Rama në Turqi në gusht 2022 dhe në tetor 2022, vizita e MEPJ Xhaçka në Turqi, nëntor 2022, konsultimet diplomatike në nivel zëvendësministri në dhjetor 2022, shkëmbime vizitash në nivel parlamentar dhe në nivel ministrash, si dhe nënshkrimi i një sërë marrëveshjesh të bashkëpunimit dypalësh;
- Ka një prani në rritje të investimeve turke, veçanërisht në fushat e energjisë, sistemit bankar, turizmit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës. Turqia është partneri i 4 më i madh tregtar i Shqipërisë. Investimet turke kapin shifrën e 3.5 miliard dollarëve, ndërkohë që 15 mijë shtetas shqiptarë punojnë në kompanitë turke;
- Ka pasur një shkëmbim intensiv në nivel rajonal, në kuadër të nismave rajonale dhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare.

### *Marrëdhëniet Bashkimi Evropian – Shqipëri*

Marrëdhënia e Shqipërisë me Bashkimin Evropian karakterizohet nga një angazhim gjithëpërfshirës politik dhe institucional i vendit tonë në kuadër të përbushjes së reformave të nevojshme për anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian.

Procesi i anëtarësimit në BE përfaqëson një mbështetje për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 424, datë 22.6.2022 u miratua Deklarata Hapëse e Republikës së Shqipërisë, Pozicioni i Përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Më 19 korrik 2022 u zhvillua Konferenca e parë Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, ku Shqipërisë iu dha formalisht korniza e përgjithshme dhe kuadri negociues për anëtarësimin.

Në bazë të metodologjisë së re të negociatave, që u miratua nga Këshilli në mars 2020 dhe iu dha formalisht Shqipërisë me kornizën e përgjithshme negociuese të BE-së për Shqipërinë, gjatë Konferencës së parë Ndërqeveritare, Shqipërisë i është dhënë mundësia të negociojë të gjashtë grupimet e kapitujve (clusters), duke nisur nga grupimi “Themelorët”.

Gjatë Konferencës së parë Ndërqeveritare BE-Shqipëri për nisjen e negociatave të anëtarësimit, Këshilli ftoi Komisionin që të vazhdojë të vlerësojë gjendjen e gatishmërisë së Shqipërisë për hapjen e negociatave në fusha specifike dhe të identifikojë çështjet që do të dalin me shumë gjasa në negociata, duke filluar nga grupi i themeloreve, i cili në përputhje me kornizën negociuese, do të hapet fillimisht pasi Shqipëria të ketë përmbushur kriteret përkatëse të dakorduara nga Këshilli.

Me 19 korrik 2022, pas mbajtjes së K1NQ, u zhvillua një takim formal me të cilin Komisioni, bazuar në mandatin e Këshillit të marsit 2020, nisi formalisht procesin e shqyrtimit analitik të *acquis* (*screening*). Ky takim formal i nisjes së procesit *screening* u pasua nga një kalendar takimesh mes administratës tonë të përfshirë në negociatat e anëtarësimit dhe Komisionit Evropian dhe përcakton kryerjen e fazave të procesit:

- Takimet shpjeguese (vazhdimin, për *acquis* të re të miratuar në BE, nga momenti që Shqipëria e përfundoi paraprakisht këtë proces në dhjetor 2019 e deri tani);
- Takimet dypalëshe (bilaterale) për të gjitha grupkapitujt, proces në të cilin Shqipëria raporton tek Komisioni për nivelin e përafrimit me *acquis* të BE, analizën e boshllëqeve ligjore/administrative/institucionale dhe financiare dhe planifikimin për arritjen e përputhshmërisë së plotë gjatë negociatave dhe përpara anëtarësimit.

Gjatë vitit 2022, Shqipëria vijoi të tregojë progres të qenësishëm dhe të qëndrueshëm, të bazuar në meritë.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), dialogu politik Shqipëri-BE lidhur me çështje të integritimit evropian zhvillohet në formatin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit (KSA), Komitetit të Stabilizim-Asociimit dhe nëpërmjet Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit.

Këshilli i Stabilizim Asociimit nuk është mbledhur për periudhën raportuese.

Komiteti i Stabilizim Asociimit zhvilloi takimin e 12-të më datë 15 shkurt 2022. Komiteti i Stabilizim-Asociimit vlerësoi përparimin e arritur nga Shqipëria gjatë vitit 2021. Komiteti vlerësoi se Shqipëria kishte vazhduar që të përmbushte të gjitha kushtet para takimit të parë të Konferencës Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit. Komiteti inkurajoi Shqipërinë që të ruajë ritmin e reformave.

Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit zhvilloi dy takime gjatë vitit 2022, respektivisht në datat 23 – 24 shkurt 2022 në Tiranë dhe në Bruksel, në datat 1 – 2 dhjetor 2022.

## KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT E NJERIUT

### 23.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 23 është një kapitull thelbësor në procesin e stabilizim asociimit dhe mbart një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme, sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore.

Më konkretisht, Politikat e BE-së në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej Bashkimin Evropian si një fushë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Vendosja e themeleve për një gjyqësor të pavarur dhe efikas mbart rëndësi të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe standardi i lartë i gjykimit nga ana e gjykatave janë thelbësore për respektimin e sundimit të ligjit. Me qëllim realizimin e këtij objekti, kërkohet angazhim i fortë për shmangien e çdo ndikimi të jashtëm, si dhe për t'i përkushtuar burime të mjaftueshme financiare dhe rritje kapacitetesh. Me rëndësi të veçantë janë dhe krijimi i garancive ligjore për procedurat e një gjykimi të drejtë. Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive, pasi kjo paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Një kuadër i fortë ligjor dhe institucione të besueshme janë të nevojshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin e korrupsionit. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë respektin për të drejtat themelore dhe të drejtat e qytetarëve të BE-së, siç garantohet nga *acquis* dhe nga Karta e të Drejtave Themelore.<sup>19</sup>

Këto parime janë përkthyer në një kuadër ligjor të Bashkimit Evropian që përcakton të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare dhe gjithashtu të vendeve kandidatë që synojnë të jenë shtete anëtare të BE-së. Prandaj, është e domosdoshme për secilin vend kandidat që synon të bëhet shtet anëtar i BE-së për të njohur dhe përafuar *acquis* e BE-së që mbulon Kapitullin 23.

Përveç kësaj, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive pasi paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe për sundimin e ligjit. Neni 83 (1) i TFBE përcakton kompetencën e BE-së për të hartuar rregulla minimale në lidhje me përcaktimin e

<sup>19</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en)

veprave penale dhe sanksioneve në fushën e korrupsionit. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave themelore është i domosdoshëm. Sipas nenit 6 të TBE-së dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), BE respekton të drejtat themelore, të garantuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian siç rezulton nga traditat kushtetuese të përbashkëta për Shtetet Anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës së BE-së. Kështu, ato janë të detyrueshme për institucionet e Bashkimit në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe për Shtetet Anëtare kur zbatojnë të drejtën e BE-së (neni 51 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian).

### 23.2 Struktura e kapitullit

Tre shtyllat kryesore për reformat në këtë kapitull të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të ndërsjellë me njëra tjetrën janë:

1. Sistemi gjyqësor;
2. Lufta kundër korrupsionit;
3. Përmirësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore.

### 23.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Përafrimi i parimeve dhe *acquis* së BE-së për kapitullin 23 përbëjnë një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri. Në veçanti, nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së janë të një rëndësie thelbësore për këtë kapitull. Sipas nenit 78 të MSA-së, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet forcimit të sundimit të ligjit dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si dhe të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë. Përveç kësaj, neni 78 i MSA-së përcakton se bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efektivitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të organeve të policisë dhe të zbatimit të ligjit duke siguruar trajnime të përshtatshme si dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Gjithashtu, përafrimi me *acquis* dhe standardet e BE-së për kapitullin 23 është një nga kërkesat që vendi kandidat në BE duhet të zbatojë gjatë procesit të negociatave për aderim në BE.

Lidhur me përafrimin e legjislacionit të BE në legjislacionin e brendshëm, duhet theksuar se *acquis* i transpozueshëm ndahet në “*hard acquis*” (*acquis* që buron nga aktet me efekt detyrues siç janë traktatet, direktivat, rregulloret etj. të BE-së) dhe “*soft acquis*” (*acquis* që buron nga standardet, parimet dhe rekomandimet e institucioneve të BE-së apo organizatave të tjera ndërkombëtare relevante).

#### 23.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe Arritjet kryesore

Sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2022, Shqipëria ka një nivel të caktuar përgatitjeje/ka përgatitje mesatare për zbatimin e *acquis* së BE-së dhe standardeve evropiane në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore. Progres i mirë është shënuar përmes zbatimit dhe konsolidimit të vazhdueshëm të reformës në drejtësi. Në Gjykatën Kushtetuese ka pasur dy emërimet të reja, gjë që përmirëson më tej aftësinë e gjykatës për të përmbushur mandatin e saj. Gjykata e Lartë ka rritur efikasitetin e saj me emërimin e gjashtë gjyqtarëve të rinj dhe ka filluar të reduktojë numrin e çështjeve të prapambetura dhe të unifikojë praktikën gjyqësore. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka vazhduar të përparojë në mënyrë të qëndrueshme. Përpjekjet operationale për të luftuar korrupsionin po sjellin disa rezultate, përfshirë procedimet penale dhe hetimet financiare në disa çështje të nivelit të lartë, të cilat përfunduan me disa dënime të formës së prerë. Këto përpjekje duhet të vazhdojnë më tej. Në lidhje me të drejtat themelore, ka pasur njëfarë progresi në një sërë fushash, por përpjekjet për zbatimin e politikave duhet të vazhdojnë. Në lidhje me të drejtat e pronës, duhet të bëhet progres më i shpejtë me regjistrimin e parë të pronave dhe të proceseve të tjera tranzitore. Duhet të miratohet pjesa e mbetur e legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit kuadër të 2017 për mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare, veçanërisht për të siguruar vetidentifikimin. Për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, Shqipëria duhet të marrë masa për të parandaluar shkeljet masive të të dhënave personale dhe për të përshpejtuar përpjekjet për të përafuar legjislacionin e saj me *acquis-në* e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### **Reforma në Drejtësi**

Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2022, Shqipëria ka përgatitje mesatare për funksionimin e gjyqësorit. Progres i mirë është shënuar me zbatimin e vazhduar të reformës në drejtësi. Është miratuar zgjatja kushtetuese me afat të kufizuar e mandatit të organeve të procesit të rivlerësimit kalimtar. Deri më sot, 64 % e dosjeve të trajtuara në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar kanë rezultuar në shkarkime nga detyra, dorëheqje ose ndërprerje të mandatit të magistratëve që i janë nënshtruar këtij procesi. Në vijim të emërimeve të reja të gjyqtarëve, Gjykata e Lartë për herë të parë në gjashtë vjet ka reduktuar ngarkesën e çështjeve të prapambetura, dhe ka arritur kuorumin për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka dhënë disa vendime të rëndësishme për zyrtarë të lartë, përfshirë këtu një ish-ministër të brendshëm dhe një ish-prokuror të përgjithshëm. Progres i kufizuar është shënuar në zbatimin e rekomandimit për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe sistemit të trajnimit ligjor për gjyqtarët dhe prokurorët . Efiçenca e sistemit gjyqësor vazhdon të ndikohet negativisht nga kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, përqindja e ulët e zgjidhjes së çështjeve dhe numri i lartë i çështjeve të prapambetura.

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve ka vazhduar të përparojë në mënyrë të qëndrueshme dhe ka dhënë rezultate të prekshme. Me synimin për të përfunduar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mandati i organeve të rivlerësimit

është zgjatur deri më 31 dhjetor 2024. Në seancën plenare të datës 10 shkurt 2022, Kuvendi miratoi ndryshimet në Kushtetutën e Shqipërisë për zgjatjen e mandatit të organeve të rivlerësimit.

*Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK)* për periudhën 1 janar – 30 nëntor 2022 ka dhënë gjithsej 101 vendime, nga të cilat 44 vendime konfirmimi në detyrë, 34 vendime për shkarkim nga detyra, 13 vendime për ndërprerje procesi, 7 vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar dhe 3 vendime për pezullim nga detyra për një vit dhe detyrimin për ndjekjen e trajnimit për një periudhë një vjeçare pranë Shkollës së Magjistraturës.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit deri më 30 nëntor 2022 ka rivlerësuar gjithsej 587 subjekte të procesit të rivlerësimit dhe janë në proces rivlerësimi 218 subjekte.

*Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA)*, vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik, ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në total, që nga fillimi i procesit deri më 30 nëntor 2022, KPA ka dhënë 171 vendime të juridiksionit të rivlerësimit, nga 300 çështje të regjistruara gjithsej. Për periudhën 1 janar – 30 nëntor 2022 KPA ka dhënë gjithsej 45 vendime të juridiksionit të rivlerësimit, në të cilat ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në 31 vendime;
- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në 7 vendime;
- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit në 5 vendime;
- Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke urdhëruar KPK të vazhdojë kryerjen e procesit të rivlerësimit në 1 vendim; prishjen e vendimit të KPK dhe pushimin e gjyqimit të çështjes në 1 vendim.

*Institucioni i Komisionerëve Publikë*, gjatë periudhës 1 janar – 30 nëntor 2022, është njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për 96 vendime. Ndërkohë, në fund të dhjetorit 2021, është njoftuar për 8 vendime të tjera, të cilat janë shqyrtuar në muajin janar 2022.

*Institucioni i Komisionerëve Publikë*, gjatë periudhës 1 janar – 30 nëntor 2022, ka shqyrtuar gjithsej 98 vendime dhe 6 prej tyre janë në proces shqyrtimi sipas afateve ligjore. Për 98 vendimet e shqyrtuara, Komisionerët Publikë kanë vendosur të ankimojnë 10 vendime në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe për 88 vendime të KPK-së kanë vendosur të mos ushtrojnë ankim.

*Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit*, gjatë periudhës 1 janar – 30 nëntor 2022, u ka paraqitur Komisionerëve Publikë 2 rekomandime me shkrim, për të ushtruar ankim.

Në regjistrin e denoncimeve të publikut, për periudhën 1 janar – 30 nëntor 2022, janë regjistruar 120 denoncime.

***Emërimet e reja në KLGJ dhe KLP***

Në dhjetor të vitit 2021, 5 anëtarëve të KLGJ-së (3 prej radhëve të gjyqësorit dhe 2 anëtarëve jo gjyqtarë) u mbaroi mandati. Për pasojë, Këshilli në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë inicioi hapjen e procedurës për aplikime të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në përfundim të procedurës së votimit, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, zgjodhi tre anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësues nga të tre shkallët e gjyqësorit. Ndërkohë që dy anëtarët e tjerë jo-gjyqtarë, u zgjodhën nga Kuvendi gjatë muajit shkurt me vendim Nr. 22/2022 të Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, me mandat 5 vjeçar duke filluar nga data 2.03.2022.

Në lidhje me konfigurimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe zgjedhjes së anëtarëve të rinj, gjatë vitit 2021, Kuvendi i Shqipërisë shpalli vakancat për dy anëtarë joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Gjatë vitit 2022 është deklaruar me vendim të Këshillit mbarimi i mandatit për 3 anëtarë të KLP, 2 anëtarë joprokurorë, vakancat e të cilëve u shpallën në fund të vitit 2021 nga Kuvendi, dhe 1 anëtarë prokurorë, për shkak të shkarkimit nga detyra.

Një nga 3 anëtarët për të cilët është deklaruar mbarimi i mandatit ushtronte njëkohësisht edhe funksionet e Kryetarit të Këshillit. Gjatë muajit mars 2022 Këshilli i Lartë i Prokurorisë zgjodhi Kryetarin e ri Z. Alfred Balla.

Në lidhje me shpalljen e vakancave nga Kuvendi për anëtarët joprokurorë, Kuvendi i Shqipërisë gjatë vitit 2022 me vendimin Nr. 23/2022, dhe vendimin Nr. 78/2022 zgjodhi 2 anëtarët e rinj të KLP-së nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës.

Për sa i përket vakancës së krijuar për shkak të shkarkimit nga detyra të një prokurori, Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve më datë 25.10.2022 zgjodhi anëtarin e re të KLP nga radhët e prokurorëve të apelit.

### ***Kuadri strategjik***

*Dokumente strategjikë:* Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021 – 2025 dhe Plani i saj i Veprimit, është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë 2021 – 2025 dhe të Planit të saj të Veprimit”.

Vizioni i strategjisë është “*një sistem drejtësie i pavarur, i përgjegjshëm, i aksesueshëm, transparent dhe efikas që mbron të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë në përputhje me standardet evropiane*”.



Ky dokument strategjik ndahet në disa qëllime ku secili prej tyre kërkon të arrihen objektiva strategjike të posaçëm, veprime për t'u ndërmarrë dhe një seri treguesish performance për të matur ecurinë drejt përmbushjes së qëllimeve politike.

Konkretisht, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021 – 2025 dhe Plani i saj i Veprimit përbëhet nga: 4 Qëllime Politike, 17 Objektiva Specifikë dhe 186 masa.

Më konkretisht, 4 qëllimet politike janë:

- *Qëllimi Politik 1:* Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.”
- *Qëllimi Politik 2:* Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane.
- *Qëllimi Politik 3:* Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.
- *Qëllimi Politik 4:* Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit.

Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për koordinimin, përgatitjen dhe monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Në janar 2022, Ministria e Drejtësisë, si ministria përgjegjëse për përgatitjen dhe monitorimin e këtij dokumenti strategjik, filloi procesin e hartimit të raportit të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën janar – dhjetor 2021 i cili u miratua në mbledhjen e Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi më 31 mars 2022.

Ndërsa në muajin korrik 2022, Ministria e Drejtësisë, filloi procesin e hartimit të raportit paraprak të monitorimit në bazë të kontributeve të dërguara nga institucionet përgjegjëse për periudhën kohore 1 janar – 30 qershor 2022. Raporti u miratua në mbledhjen e Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi më datë 19 dhjetor 2022.

Në hartimin e draft raportit, struktura përgjegjëse për hartimin e raportit të monitorimit në Ministri, ka pasur mbështetjen e asistencës teknike të Projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Justal”.

Gjithashtu edhe institucionet e drejtësisë kanë hartuar, miratuar dhe zbatojnë dokumente strategjike institucional dhe planet e tyre të veprimit.

KLJGJ, nëpërmjet vendimit Nr. 184, datë 11.05.2022, ka miratuar planin e ri strategjik për sistemin gjyqësor, për periudhën 2022 – 2024, plan i cili do të formësojë të ardhmen e gjyqësorit në funksion të një reforme gjithëpërfshirëse.

Gjykata Kushtetuese ka hartuar dhe zbaton “Strategjia e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Planin e saj të Veprimit 2021 – 2023”. Përmes kësaj Strategjie Gjykata Kushtetuese synon të sigurojë një funksionim të pavarur dhe të paanshëm, transparent dhe llogaridhënës, efikas dhe efektiv.

Shkolla e Magjistraturës ka hartuar dhe zbaton “Strategjinë e Shkollës së Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë, 2019 – 2023”, dokument i cili synon që nëpërmjet objektivave dhe masave të parashikuara në të, të bëjë të mundur që Shkolla e Magjistraturës të kontribuoj në rritjen e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë në funksion të nevojave që rrjedhin nga reformat e vazhdueshme të drejtësisë; të kontribuoj në përmirësimin e kulturës ligjore në sektor e në vend, si dhe në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu Shkolla e Magjistraturës ka nisur procesin për hartimin e Strategjisë së re 2024 – 2028 bazuar në monitorimin e vazhdueshëm që i është bërë ecurisë së Strategjisë në fuqi.

Në lidhje me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ky institucion ka miratuar dhe zbaton Planin Strategjik 2020 – 2022 bashkë me planin e veprimit i cili ka për mision/qëllim vendosjen e standardeve mbi mënyrën e verifikimit të ankesave, trajtimit të tyre në një kohë sa më të shpejtë me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve në ushtrimin e detyrës nga njëra anë dhe motivimin e rritjen e besimit të qytetarëve dhe organeve që ligji u njeh të drejtën e paraqitjes së ankesave, ndaj sistemit gjyqësor, nga ana tjetër. Aktualisht, ILD është në fazën e konsultimit të draft strategjisë 2023 – 2025 dhe planit të veprimit.

Për sa i përket KLP, ky institucion ka miratuar dhe zbaton Planin Strategjik 2021 – 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili përmban vizionin, misionin dhe vlerat thelbësore që do të drejtojnë punën e këtij këshilli për arritjen e një qëllimi të përgjithshëm që është kontributi për forcimin e shtetit ligjor dhe krijimi i një sistemi të pavarur dhe eficient të prokurorisë, për të kontribuar në mënyrë efektive në luftën kundër krimit, duke garantuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe rritjen e besimit të publikut.

## ***Profesionalizmi dhe Kompetenca***

### *Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë*

Aktualisht **Gjykata Kushtetuese** përbëhet nga 9 gjyqtarë nga 9 që duhet të ketë, duke u bërë plotësisht funksionale e duke formuar të plotë trupën e kësaj gjykate.

Në përmbushje të detyrave të tij funksionale kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) ka vijuar procedurat e verifikimit të kushteve ligjore të kandidatëve që kanë kandiduar për vendet vakante për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Lidhur me vakancat e shpallura nga Gjykata e Lartë, KED përfundoi procesin e vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve për dy vende vakante, dhe i përcolli materialin Gjykatës së Lartë, si rezultat i të cilit u mundësua zgjedhja e dy anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese nga Mbledhja

e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në muajin mars 2022 dhe shtator 2022, Z. Sandër Beci dhe Z. Ilir Toska. Për sa i përket vakancës së tretë, vakancës së krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të gjyqtarës Vitore Tusha, KED pezulloi procedurën e verifikimit të kandidaturave, për shkak se numri i kandidaturave ishte nën dy kandidatura, dhe njoftoi Gjykatën e Lartë si subjekti që e ka vënë në lëvizje këtë procedurë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave të tjera.

Në lidhje me vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në janar 2022, KED përfundoi procesin e verifikimit të kushteve ligjore dhe pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve dhe i përcolli materialin institucionit të Presidentit të Republikës. Presidenti i Republikës më datë 7 dhjetor 2022 dekretoi Z. Gent Ibrahimimi gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Sa i përket vakancës së shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në janar 2022, KED përfundoi procesin e verifikimit të kushteve ligjore dhe pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve dhe i përcolli materialin Kuvendit të Shqipërisë. Në seancën plenare të datës 22 dhjetor 2022, Znj. Mariana Semini u zgjodh gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese.

**Funksionimi i plotë i Gjykatës së Lartë** mbetet prioritet për të garantuar funksionimin e sistemit gjyqësor. Numri aktual i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë është 15 nga 19 që është organika e kësaj gjykate. Ndërkohë, procesi po vijon aktualisht për plotësimin e 3 vendeve vakante të shpallura më datë 17.11.2021, sipas procedurës së ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve. Gjithashtu më datë 11.05.2022 është shpallur procedura e ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale për shkak të përfundimit të mandatit të një prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, krahas plotësimit të trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ka marrë masa për rritjen e efikasitetit të gjykatës si strukturë organizative, duke mundësuar plotësimin e organigramës së kësaj gjykate dhe konkretisht të Njesisë së Shërbimit Ligjor. Kjo e fundit ka një peshë të konsiderueshme dhe një mision të rëndësishëm në Gjykatën e Lartë, sepse ushtron funksione këshillimore dhe ndihmëse në procesin e vendimmarrjes, duke ndikuar ndjeshëm në numrin e çështjeve gjyqësore të trajtuara. Aktualisht, KLGJ ka miratuar vendimin për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë për 13 këshilltarë ligjorë (1 këshilltar ligjor është pranuar në shërbim civil gjyqësor në vitin 2020, 7 këshilltarë ligjorë janë pranuar në vitin 2021 dhe 5 këshilltarë ligjorë janë pranuar deri më 5 dhjetor 2022). Sipas strukturës organizative, kjo njësi përbëhet nga 34 pozicione Këshilltar Ligjor dhe aktualisht, ushtrojnë funksionin 24 këshilltarë ligjorë, nga të cilët 5 pozicione me status ndihmës magjistrati dhe 19 pozicione me status këshilltari ligjor. Procesin po vijon për plotësimin e pozicioneve të tjera vakante.

### ***Funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar***

Pas krijimit të Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (me vendim të KLGJ Nr. 288, datë 18.12.2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka punuar intensivisht për plotësimin

e vendeve vakante në këto gjykata. Aktualisht Gjykata e Posaçme e Apelit ka në detyrë 10 gjyqtarë nga 11 që parashikon ligji, ndërsa Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka në detyrë 9 gjyqtarë, 3 prej të cilëve janë caktuar nga skema e delegimit, nga 16 të tillë të parashikuar.

### ***Gjendja aktuale e vakancave në sistemin e prokurorisë dhe gjyqësor dhe emërimi i magistratëve të rinj***

Organika e sistemit gjyqësor përbëhet nga 408 gjyqtarë. Në sistemin gjyqësor aktualisht janë në detyrë 322 gjyqtarë, ndër të cilët 230 gjyqtarë ushtrojnë efektivisht detyrën e gjyqtarit dhe për 92 gjyqtarë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin e tyre nga detyra por vendimi i shkarkimit nuk ka marrë ende formë të prerë. Në sistemin gjyqësor rezultojnë 86 vakanca të përhershme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë përpjekje për plotësimin e vendeve vakante prioritare të gjyqtarëve dhe vazhdimin e progresit në rekrutimin e magistratëve të rinj. Gjatë vitit 2022 janë emëruar në funksione gjyqësore një numër total prej 24 magistratësh (nga të cilët 23 magistratë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021 – 2022 dhe 1 magistrat nga radhët e juristëve të spikatur i emëruar në Gjykatën e Lartë). Një nga kandidatët për magistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës nuk është emëruar nga KLGJ për shkak të procedurës disiplinore në të cilën ndodhej kandidati në atë moment, procedurë e cila kishte filluar nga Prokurori për Disiplinën pranë Shkollës së Magjistraturës. Pas përfundimit të çështjes disiplinore, në muajin shtator 2022 KLGJ ka vijuar procedurën për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit për magistratë.

Organika e sistemit të prokurorisë përbëhet nga 341 prokurorë. Në sistemin e prokurorisë, aktualisht janë në detyrë 215 prokurorë, ndër të cilët 20 prokurorë janë të komanduar në organet e sistemit të drejtësisë, 53 prokurorë janë të pezulluar dhe për 1 prokuror është miratuar leja e papaguar nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Sistemi i prokurorisë ka 52 vakanca të përhershme.

Sa i përket emërimit të magistratëve të rinj, për vitin 2022, nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pas verifikimit të pasurisë dhe figurës, janë emëruar 22 prokurorë të rinj, të cilët janë caktuar në prokurori të ndryshme.

Në lidhje me rekrutimin e kandidatëve të rinj magistratë, KLGJ dhe KLP, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, kanë rritur gradualisht numrin e kandidatëve të pranuar në trajnimin fillestar. Në kuadër të procesit të rekrutimit të magistratëve të rinj, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi në datat 22.04.2022 dhe 25.04.2022 provimin për kandidatët magistratë dhe këshilltar/ndihmës ligjorë. Në bazë të rezultateve, u shpallën fitues 74 kandidatë për magistratë, prej të cilëve 45 në profilin “Gjyqtarë” (nga 45 kuota të shpallura nga KLGJ) dhe 29 në profilin “Prokurorë” (nga 35 kuota të shpallura nga KLP). Gjithashtu u shpallën fitues edhe 3 kandidatë në profilin “Ndihmës ligjor” (nga 10 kuota të shpallura nga KLGJ).

Numri i kandidatëve për magistratë që kanë nisur Shkollën e Magistraturës për vitin akademik 2022-2024 është më i lartë se në vitet e mëparshme. Në vitin 2022, Shkolla diplomoi 46 kandidatë për magistratë (24 kandidatë për magistratë profili gjyqtarë dhe 22 kandidatë për magistratë profili prokurorë), pas përfundimit me sukses të tre viteve të Programit të Formimit Fillestar.

### ***Ngritja në detyrë***

Në kuadër të ngritjes në detyrë të magistratëve gjatë vitit 2022, ka përfunduar procedura për ngritje në detyrë për 5 magistratë në Gjykatën e Lartë dhe për 12 magistratë në gjykatat e juridiksionit të apelit, nga të cilat 3 magistratë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, 1 magistrat në Gjykatën Administrative të Apelit dhe 8 magistratë në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm. Ndërkohë, me datë 21.11.2022 është shpallur procedura për ngritje në detyrë nga radhët e gjyqtarëve për 3 pozicione, në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, më konkretisht në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës dhe Korçë. Gjithashtu, më datë 21.11.2022 është rishpallur procedura e ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve për 3 pozicione në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në kuadër të ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, përgjatë vitit 2022 ka përfunduar procedura për ngritje në detyrë për 1 prokurori. Ndërkohë janë shpallur vakancat për ngritje në detyrë në pozicion drejtuesi në 9 prokurori të tjera.<sup>20</sup> Kjo procedurë nuk ka përfunduar ende dhe pritet të përmbyllet së shpejti. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, është shpallur 1 procedurë për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, për 1 pozicion. Kjo procedurë nuk ka përfunduar ende dhe pritet të përmbyllet së shpejti.

### ***Rritja e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve***

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha shkallëve. Prioriteti i punës së ILD është shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha pretendimeve të paraqitura si nga qytetarët, ashtu edhe nga institucionet lidhur me veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magistratëve brenda apo jashtë funksioneve të tyre. Në lidhje me trajtimin e ankesave të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në periudhën janar-nëntor 2022 janë depozituar 719 ankesa, numër që u shtohet 2104 ankesave (*backlog*) të ardhura në vitet paraardhëse dhe atyre të përcjella nga institucionet ekzistuese para hyrjes në fuqi të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ankesave të ardhura drejtpërdrejtë në ILD. Për periudhën janar-nëntor 2022 ILD ka shqyrtuar 1444 ankesa me 1085 vendime, nga të cilat 770 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar dhe 315 vendime arkivimi pas verifikimit. Nga 1444 ankesa të trajtuara, 445 ankesa i përkasin fondit *backlog*. Nga momenti i funksionimit të ILD deri më 31 nëntor 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka në proces shqyrtimi 1667 ankesa, nga të cilat 1161 janë ankesa që i përkasin fondit *backlog* (të mbartura). Sa i përket vendimeve për fillim hetimi disiplinor dhe

<sup>20</sup> Në vakancat e sipërcituara, nuk është përfshirë procedura e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila është shpjeguar në titullin “Funksionimi i SPAK”.

kërkesave për procedim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë periudhës janar – nëntor 2022 ka miratuar 28 vendime për fillim/vazhdim hetimi disiplinor për 41 magjistratë dhe ka paraqitur 5 kërkesa për procedim disiplinor, 3 kërkesa për procedim disiplinor pranë KLGJ (1 pranuar pjesërisht, 1 e pezulluar dhe 1 në proces) dhe 2 kërkesa për procedim disiplinor pranë KLP (1 e pezulluar dhe 1 në proces).

Pjesë e procedimeve disiplinore janë edhe kandidatët për magjistratë, por ligji parashikon që procedura hetimore disiplinore në këto raste bëhet nga organet përgjegjëse në Shkollën e Magjistraturës (Prokurori për Disiplinën dhe Komisioni Disiplinor). Gjatë vitit 2022, Shkolla është investuar në verifikimin dhe hetimin disiplinor për dy raste të kandidatëve për magjistratë. Për njërin rast është marrë masa disiplinore “Vërejtje”, ndërsa për rastin tjetër është vendosur mbyllje e hetimit të filluar<sup>21</sup>.

Në bazë të ligjit nr. 115/2016, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kryen edhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të KLGJ, KLP, Ministrit të Drejtësisë apo Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga funksionimi i tij e deri tani ka ndërmarrë 3 inspektime tematike sipas këtyre akteve:

1. Vendim Nr. 1 datë 11.02.2020, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt “Lirimin me Kusht”.
2. Vendim Nr. 37, datë 01.06.2021 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””, i ndryshuar. Ka përfunduar inspektimi tematik.
3. Vendim Nr. 47, datë 15.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal” për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”. Ka përfunduar inspektimi tematik.

Masat e marra nga ILD kundër keqpërdorimit të institucionit ligjor të “lirimit me kusht”, kanë sjellë rezultate të matshme ndaluar keqpërdorimin e këtij instituti nga magjistratët në detyrë. Pas rekomandimeve të lëna nga ILD për institucionet përgjegjëse, pritet një ndikim i dukshëm në sistem edhe pas inspektimeve me objekt: “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e

---

<sup>21</sup> Vendim Nr. 533/7 Prot, datë 21.07.2022 “Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinor”; Vendim Nr. 422/2 Prot, datë 17.05.2022 “Për mbylljen e hetimit të filluar ndaj kandidatit për magjistratë”

masave të sigurimit personal” për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”.

Gjatë vitit 2022, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka zhvilluar vizita pune dhe trajnime në vendet homologe me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe marrjen e praktikave më të mira.

Më 24 dhe 25 qershor 2022 nga ILD u mbajt një konferencë me Drejtues dhe përfaqësues të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë nga vendet e Bashkimit Evropian, ku u diskutua mbi temën “Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve”.

### ***Vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarëve***

Gjatë vitit 2022, KLGJ ka plotësuar paketën e akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve. Për të gjithë gjyqtarët për të cilët vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar ka marrë formë të prerë dhe janë përcjellë dosjet përkatëse pranë Këshillit, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional. Nga fillimi i procesit deri në 2021, rezultojnë të jenë kryer 72 projektraporte të vlerësimit etik dhe profesional për 36 gjyqtarë, të ndara përkatësisht 36 projektraporte vlerësimi për periudhën e vlerësimit për “vitin 2013-2016” dhe 36 projektraporte vlerësimi për periudhën e vlerësimit “viti 2019”. Ndërsa për vitin 2022 janë kryer në total 25 projektraporte vlerësimi për 17 gjyqtarë.

Vlen të theksohet se në këtë proces i është dhënë përparësi gradimit dhe vlerësimit të përshpejtuar të detyruar të kandidatëve aplikantë për ngritje në detyrë në Gjykatë të Lartë, në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Në lidhje me procesin e vlerësimit të prokurorëve, gjatë vitit 2022 është hartuar dhe miratuar:

- Rregullorja për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve;
- Programi që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2022;
- Plani tre-mujor i vlerësimit etik dhe profesional i prokurorëve për vitin 2022.

Gjithashtu janë caktuar me short relatorët dhe këshilltarët ligjorë përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve.

Në funksion të fillimit të procesit të vlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar edhe disa anekse, që kanë të bëjnë me metodologjinë e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit; tabela vlerësimi, sipas tipologjisë së çështjeve/punës së kryer nga prokurori; formular i integruar i vlerësimit të prokurorit; formati i procesverbalit për pasqyrimin e veprimeve që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit; formati i raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit; si dhe formati i projekt raportit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e Rregullave dhe Kodit të Etikës dhe për monitorimin e tyre, që në vitin 2021 ka miratuar Kodin e Etikës Gjyqësore, si dhe ka caktuar një gjyqtar si Këshilltar për Etikën.

Kodi i Etikës Gjyqësore synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe ligjin.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në muajin shkurt të vitit 2022 miratoi “Raportin mbi veprimtarinë e Këshilltarit të Etikës për vitin 2021”.

Një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën ka edhe bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë që asistojnë gjyqësorin në Shqipëri. Ky bashkëpunim konsistoi kryesisht në përpjekjet për shtimin e aktiviteteve të lidhura me etikën gjyqësore në programin e trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Aktualisht Shkolla e Magjistraturës ka të përfshirë në programin e trajnimit fillestar lëndën e “Etikës profesionale”. Aktualisht është në proces hartimi manuali informues me pyetje dhe përgjigje mbi dilemat etike, bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe vendimet relevante të Këshillit.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi përgjegjës për miratimin e Rregullave dhe Kodit të Etikës dhe për monitorimin e tyre, gjatë muajit shkurt të vitit 2022 miratoi “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit”.

Këto standarde dhe rregulla të sjelljes synojnë të vendosin, ruajnë dhe forcojnë integritetin profesional dhe personal të prokurorëve, si dhe të rrisin efektivitetin, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre, në emër dhe në interes të shoqërisë, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Këto rregulla përkrahin zbatimin e standardeve më të larta të sjelljes etike dhe profesionale, ruajtjen e imazhit të profesionistit, si dhe sjelljen e përshtatshme në zyrë, në prokurori, në gjykatë apo jashtë këtyre ambienteve, për shkak të funksionit si prokuror. Ato plotësojnë kuadrin e akteve normative në fuqi të nxjerra për prokurorët.

Gjatë muajit mars 2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë rihapi procedurën e plotësimit të pozicionit të Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit dhe në muajin prill komandoi zotin Hysen Keta, prokuror pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionin e Këshilltarit për Etikën, me një afat komandimi prej 5 vjetësh.

Shkolla e Magjistraturës, në muajin mars të vitit 2022 miratoi Kodin e Etikës për kandidatët për magjistratë, i cili është konceptuar si një mjet për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të qëndrimeve dhe sjelljeve drejt standardeve më të larta të drejtimit dhe ridimensionimit e moralitetit të zakonshëm në sferën e edukimit fillestar dhe vazhdues të magjistratëve. Ky akt do të përbëjë kuadrin e veprimtarisë së përditshme të subjekteve që u drejtohet për sa ata kryejnë



veprimtari brenda e jashtë auditorëve të Shkollës së Magjistraturës, duke orientuar qëndrimin e tyre përreth interesit publik në tërësi dhe institucionit në veçanti.

### *Cilësia e drejtësisë dhe efica*

Shkolla e Magjistraturës është përgjegjëse për garantimin e cilësisë së formimit fillestar të kandidatëve për magistratë dhe atij vazhdues për magistratët në detyrë. Aktualisht, Programi i Formimit Fillestar po realizohet me kurrikula të përmirësuara, të cilat kanë një qasje më praktike dhe synojnë që kandidati për magistrat të përfitojë kompetenca dhe aftësi që lidhen me profesionin që ai pritet të ushtrojë dhe veçanërisht me njohuri të qëndrueshme dhe të thelluara për të drejtën, zbatimin e saj nga pikëpamja praktike, aftësim për përgatitjen e seancës gjyqësore dhe zhvillimin e debatit gjyqësor, mes të tjerash. Me të njëjtën metodologji, Shkolla e Magjistraturës ka realizuar edhe rishikimin e planit mësimor dhe kurrikulave të vitit të dytë akademik, i cili, parashikohet si një vit program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve në profilin që kanë zgjedhur, si gjyqtarë dhe/ose prokurorë, nën kujdesin e Shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë. Pjesë e kurrikulës së Shkollës së Magjistraturës është edhe trajnimi i kandidatëve për çështje të integritetit dhe pavarësisë së gjyqtarit, etikës që ai duhet të tregojë dhe drejtësisë së vendimmarrjes.

Lidhur me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Shkolla ka analizuar Metodologjinë për Vlerësimin e Aktiviteteve trajnuese duke bërë pjesë të saj shumë elemente cilësore matëse të ekspertizës dhe efektivitetit të trajnimeve. Trajnimet vazhduese bazohen tërësisht në kërkesat e vetë magistratëve, dhe zhvillohen sipas një metodologjie që ka në bazë interaktivitetin dhe synojnë të specializojnë gjyqtarët dhe prokurorët sipas fushave të interesit dhe aktivitetit të tyre të përditshëm. Gjatë vitit akademik 2021 – 2022, Shkolla ka trajnuar rreth 164 gjyqtarë dhe 146 prokurorë.

Mundësitë që Shkolla ofron për gjyqtarët dhe prokurorët në sistem, duke i bërë ata pjesë të ekspertizës apo mësimdhënies në Shkollë, trajnimet e trajnerëve, ndërmjetësimi për t'i bërë pjesë të aktiviteteve ndërkombëtare e rajonale, synojnë rritjen e cilësisë së drejtësisë. Në drejtim të efica së sistemit gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë masa administrative, ligjore dhe strategjike të cilat synojnë të minimizojnë efektin e procesit të rivlerësimit kalimtar në sistemin gjyqësor, krahas mbështetjes me prioritet të reformës në drejtësi.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, ka miratuar Udhëzimin Nr. 1 datë 26.5.2022 për heqjen dorë nga një kategori e caktuar çështjesh civile dhe administrative në Gjykatën e Lartë, që janë depozituar deri në datën e hyrjes në fuqi të udhëzimit. Me miratimin e këtij udhëzimi, stoku në Gjykatën e Lartë lehtësohet nga rreth 3800 dosje që janë në pritje të gjykimit, dhe nga një mijë dosje të tjera që janë ende në proces. Qëllimi i këtij udhëzimi është të lehtësojë barrën e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar shumë çështje që janë ende në pritje. Udhëzimi i drejtohet jo vetëm administratës shtetërore, por edhe shoqërive tregtare me mbi 50% kapital shtetëror, aksionet apo kuotat e të cilave zotërohen nga institucionet e administratës shtetërore në përgjegjësi të Këshillit të Ministrave.

Gjykata e Lartë në vitin 2022 ka filluar publikimin e Buletinit Informativ Elektronik i cili do të vijojë të shpërndahet periodikisht dhe do të përmbajë zhvillimet kryesore në jurisprudencë dhe informacione të tjera që lidhen me veprimtarinë vendimmarrëse të Gjykatës së Lartë.

Në Gjykatën Kushtetuese përgjatë vitit 2022 janë paraqitur dhe regjistruar 267 kërkesa të reja. Gjatë 2022 Gjykata Kushtetuese ka 38 vendime përfundimtare dhe 177 vendime moskalimi. Aktualisht në Gjykatën Kushtetuese janë në shqyrtim 89 kërkesa.

### ***Harta e re Gjyqësore***

Harta e re gjyqësore u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, me anë të të cilit u vendos riorganizimi në 13 (trembëdhjetë) gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, 2 (dy) gjykata administrative të shkallës së parë dhe 1 (një) gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, duke përcaktuar dhe kompetencat tokësore përkatëse të tyre.

Në vijim, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për ndjekjen dhe zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave. Aktualisht, në përbërje të GNP janë përfshirë 3 (tre) anëtarë të Këshilli të Lartë Gjyqësor, 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, 2 (dy) përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, 2 (dy) magjistratë dhe 1 (një) kancelar si përfaqësues të gjykatave të shkallës së parë dhe në nivel apeli, si dhe 3 (tre) përfaqësues të nivelit të lartë të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilët asistohen në kryerjen e detyrave të tyre nga ekspertë të Këshilli i Evropës dhe të East-West Management Institute (Projekti Mbështetës Teknik i Hartës) si dhe për çështje të caktuara, asistencë sigurohet edhe nga gjyqtarë, administrata gjyqësore dhe administrata e KLGJ.

Shtyllat kryesore të punës të grupit të punës përfshijnë riorganizimin e burimeve njerëzore, infrastrukturës dhe godinave, teknologjisë së informacionit, administrimit gjyqësor dhe informimit të publikut.

### ***Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve***

Ngritja e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve synon rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së gjykatave si dhe rezultateve të të dhënave të prodhuara. Gjithashtu sistemi do të synojë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes së përdoruesve të gjykatës.

Me vendimin e fundit të Bordit të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit janë miratuar kërkesat teknike për krijimin e infrastrukturës mbështetëse për hostrimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve (ICMIS). Aktualisht sipas grafikut të ekzekutimit të kontratës, pajisjet do të instalohen dhe konfigurohen brenda vitit 2022. Me vendimin Nr. 10, datë 19.09.2022, Bordi drejtues i QTI ka miratuar ToRs e dokumentit teknik për standardet e dizenjimit dhe standardet për specifikimet teknike të Sistemit të Ri Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS i ri). Në vijim

të punës, Bordi Drejtues i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë (QTI), ka miratuar vendimin Nr. 12 datë 31.10.2022 për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, për hartimin e standardeve për sistemet e teknologjisë së informacionit në institucionet e sistemit të drejtësisë. Sipas këtij vendimi grupi i punës do të përgatisë standardet për sistemet e teknologjisë së informacionit brenda datës 31 janar 2023.

Sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve gjyqësore do të jetë një sistem i menaxhimit të të dhënave dhe dokumenteve i bazuar në ueb për të gjitha gjykatat në Shqipëri. Një instalim i vetëm i centralizuar do të lejojë të thjeshtojë vendosjen e versioneve të reja të softuerit, si dhe të gjitha aktivitetet e mirëmbajtjes dhe rezervimit. Centralizimi i bazës së të dhënave do të ndihmojë në shmangien e përpjekjeve aktuale për të siguruar konsistencën midis të dhënave të shpërndara dhe do të bëjë të mundur aksesin sinkron dhe transferimin e të dhënave.

### ***Nëpunësit civilë gjyqësorë***

Rritja e burimeve njerëzore është konsideruar si një mekanizëm për të minimizuar, për sa është e mundur, ndikimin e procesit të vetingut në mungesën e burimeve njerëzore. Në kuadër të kësaj reforme, me vendimin Nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njësisë të shërbimit ligjor në gjykatat e apelit“, u ngritën njësitë e shërbimit ligjor si një mekanizëm për përsheptimin e zgjidhjes së çështjeve gjyqësore.

Në juridiksion apeli për harkun kohor 2020 – 2021 janë emëruar gjithsej 21 ndihmës ligjorë duke e çuar numrin total aktual të ndihmësve ligjorë në 29 nga 51 të parashikuar në organikë (pra aktualisht rezultojnë 22 vakanca).

Gjithashtu, në sistem janë rekrutuar në total edhe 102 nëpunës civilë gjyqësorë, për periudhën janar 2022 – 11 nëntor 2022.

Gjithashtu, masat *ad hoc* që Këshilli ka marrë në funksion të garantimit të funksionalitetit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor lidhen me përballimin e vakumit të krijuar nga procesi i vetingut, duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të gjyqtarëve të shkarkuar nga detyra. Kështu, gjatë vitit 2022, Këshilli ka trajtuar 499 kërkesa për caktim gjyqtari gjithsej, në përgjigje të të cilave janë caktuar 654 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Shkolla e Magjistraturës ka përgatitur kurrikulën për formimin fillestar të kancelarëve të gjykatave dhe prokurorive dhe duke trajnuar rreth 32 kancelarë në detyrë për tema që lidhen me performancën e gjykatës përballë publikut, për çështje të menaxhimit të prokurorisë, etj.

### **Lufta kundër korrupsionit**

Sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2022, Shqipëria ka një nivel të caktuar përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Pavarësisht këtij progresi, shtimit të përpjekjeve dhe angazhimit

politik në luftën kundër korrupsionit, kjo e fundit mbetet një fushë që përbën shqetësim serioz. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) zhvilloi procese gjyqësore dhe hetime financiare në disa çështje të nivelit të lartë. Janë shpallur disa dënime të formës së prerë për zyrtarë të lartë. Vlerësimi kalimtar i anëtarëve të gjyqësorit vazhdon të sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit brenda gjyqësorit. Në Ministrinë e Drejtësisë u krijua një Drejtori e re e Përgjithshme e Antikorrupsionit për të përmirësuar koordinimin në nivel qendror; efikasiteti i saj mbetet ende për t'u parë. Rritja e numrit të dënimeve të formës së prerë për zyrtarë të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm për të trajtuar më tej kulturën e pandëshkueshmërisë. Sektorët më të cenueshëm ndaj korrupsionit kanë nevojë për vlerësime të synuara të riskut dhe veprime të dedikuara.

### ***Funksionimi i SPAK***

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin Nr. 6, datë 28.01.2021, miratoi numrin e përgjithshëm (20) të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Aktualisht, Prokuroria e Posaçme ka në përbërje të saj 17 prokurorë të emëruar në mënyrë përfundimtare.

Më datë 19.09.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpalli thirrjen për fillimin e procedurave për plotësimin e pozicionit vakant për Drejtues të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Thirrja për shprehjen e interesit iu drejtua të gjithë prokurorëve që janë të emëruar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Më datë 16 dhjetor 2022 Këshilli i Lartë i Prokurorisë zgjodhi Drejtuesin e ri të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në lidhje me funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, aktualisht të 60 hetuesit ushtrojnë detyrën pranë kësaj strukture.

Në fillim të gushtit 2021 filloi punën grupi i parë i hetuesve dhe në fund të qershorit 2022, grupi i dytë i hetuesve filloi punën në Byronë Kombëtare të Hetimit. Hetuesit janë të ndarë në dy sektorë, Sektori Kundër Korrupsionit dhe Sektori i Krimit të Organizuar, dhe po punojnë me prokurorët specialë për të hetuar rastet.

Ngritja e institucioneve të posaçme për luftën kundër korrupsionit ka filluar të japë edhe rezultatet e para, ku SPAK ka regjistruar disa raste të hetimit dhe gjykimit të zyrtarëve të lartë. Për vitin 2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka hetuar dhe regjistruar gjithsej 16 procedime penale me 18 persona nën hetim, për ish-zyrtarët e nivelit të lartë nga të cilët:

- Janë dërguar në gjykatë me Kërkesë për Gjykim 7 procedime penale me 7 persona të pandehur, akuzuar për veprat penale që lidhen me korrupsionin.
- Nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2022, janë dhënë dy vendime dënimi me 2 të dënuar për veprat penale që lidhen me korrupsionin, për ish-zyrtarët e nivelit të lartë.

Për periudhën 1 janar 2022 – 30 nëntor 2022, janë hetuar (mbartur dhe regjistruar) gjithsej 439 procedime penale me 275 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me korrupsionin. Për periudhën 1 janar 2022 – 30 nëntor 2022 janë regjistruar gjithsej 131 procedime penale me 76 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me korrupsionin. Për të njëjtën periudhë janë dërguar në gjykatë me Kërkesë për Gjykim 36 procedime penale me 158 persona të pandehur, për veprat penale që lidhen me korrupsionin, si dhe janë dërguar me Kërkesë për Pushim 25 procedime penale me 15 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me korrupsionin.

### ***Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit***

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, në fushën e politikave antikorrupsion, monitoron periodikisht zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 – 2023 dhe Planit të saj të Veprimit 2020 – 2023, të miratuar me VKM Nr. 516, datë 1.07.2020, nëpërmjet një strukture monitorimi, planifikimi dhe koordinimi. Gjatë vitit 2022, janë hartuar 4 raporte monitorimi, raporti i monitorimit janar – dhjetor 2021, janar – mars 2022, janar – qershor 2022 dhe korrik – shtator 2022.

Në vitin 2022, ka filluar puna për hartimin e Strategjisë së re Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2023-2030, vizioni i të cilit është *“Institucione publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike, dhe ofrojnë shërbime efikente ndaj qytetarëve”*. Strategjia e re antikorrupsion, do të ofrojë një ndërthurje të qasjes horizontale antikorrupsion me sektorë specifikë, që kanë rezultuar problematike dhe me perceptimin më të lartë të korrupsionit, siç janë: arsimi, shëndetësia, pronat, taksat e tatimet. Risi të strategjisë së re janë prioritizimi i elementëve të integritetit, forcimi institucional i burimeve njerëzore e profesionale antikorrupsion, mekanizimi i lobimit si instrument antikorrupsion, përfshirja e kapaciteteve të biznesit në mekanizmat antikorrupsion si dhe orientimi i qasjes gjinore kundër korrupsionit.

Me qëllim zhvillimin e instrumenteve të integritetit institucional, në vitin 2022, Ministria e Drejtësisë ka koordinuar dhe asistuar ministrinë e linjës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe miratimin e planeve të integritetit. Të gjitha ministrinë kanë tashmë plane integriteti të miratuara me urdhër të ministrave të linjës, dhe të publikuara në faqet e tyre zyrtare. Ky proces është lehtësuar nga projekti i Asistencës Teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit Miratimi i Planeve të Integritetit ka vijuar më pas me emërimin e koordinatorëve të integritetit në ministrinë e linjës. Ministria e Drejtësisë ka hartuar të parin raport monitorimi për Planin e Integritetit, si dhe ka shpërndarë këtë praktikë edhe në institucionet e tjera publike qendrore në vend, ku dhe këto institucione do të hartojnë raporte monitorimi për planin e integritetit të miratuar prej tyre.

Ministria e Drejtësisë ka vijuar rregullisht komunikimin dhe vizibilitetin publik për fushën antikorrupsion, nëpërmjet publikimit dhe shpërndarjes së një buletini mujor elektronik me një përmbledhje aktivitetesh, e aksesueshme në faqen e Ministrisë së Drejtësisë dhe të shpërndarë me grupet e ndryshme të interesit. Është rishikuar Plani Vjetor i Vizibilitetit dhe Komunikimit 2022

në fushën e antikorrupsionit, i cili përmban 12 aktivitete dhe evente publike me efekte ndërgjegjësimi antikorrupsion, të planifikuara për zbatim përgjatë vitit. Janë ndërmarrë aktivitete, takime, forume, konferenca me grupe interesi në fusha të ndryshme si akademi, sport, biznes, shoqëri civile, etj. Ka pasur gjithashtu, bashkëpunim dhe konsultim të shtuar të akteve dhe dokumenteve të politikave dhe të monitorimit në fushën antikorrupsion.

Qeveria Shqiptare ka hartuar të parin Raport Kombëtar për Antikorrupsionin gjatë vitit 2022, i cili evidenton në formë të dukshme dhe të mbështetur në fakte konkrete të dhëna për luftën kundër korrupsionit në fushën e parandalimit dhe ndëshkimit të korrupsionit. Raporti evidenton risitë, evidencat, statistikën dhe arritjet e procesit të digjitalizimit në vend, të ndara sipas fushave ku ofrohen shërbime publike. Raporti u lançua në një konferencë 3-ditore kombëtare antikorrupsion. Raporti kombëtar vjetor antikorrupsion është botuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe gjendet i publikuar në faqen e Ministrisë së Drejtësisë, në link: [https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/08/Raport-Vjetor-Komb%C3%ABtar-p%C3%ABr-Antikorrupsionin - 2021-1-1.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/08/Raport-Vjetor-Komb%C3%ABtar-p%C3%ABr-Antikorrupsionin-2021-1-1.pdf).

Gjatë vitit 2022, Ministria e Drejtësisë ka përmbyllur me sukses bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ambasadën e Italisë në Shqipëri për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, për promovimin e përbashkët të një projekti pilot didaktik-edukativ (moduli antikorrupsion) për nxënësit e arsimit të mesëm e të lartë, një projekt i cili pritet të ketë vijueshmëri zbatimi edhe në tre vitet e ardhshme 2023 – 2025.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Drejtësisë ka koordinuar punën për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare të Rikuperimit të Aseteve. Grupi i punës, ngritur për këtë qëllim, ka kryer analizën e kuadrit ligjor aktual, vlerësimin e nevojave për ndryshime të mundshme ligjore, si edhe vlerësimin e çështjeve teknike lidhur me krijimin, organizimin, strukturën, varësinë financiare dhe fushën e kompetencës. Janë analizuar dhe vlerësuar disa modele evropiane të organizimit dhe funksionimit të institucioneve të rikuperimit të asetëve, rekomandimet e studimit të Këshillit të Evropës, si edhe propozimet konkrete të të ftuarve në grupin e punës. Propozimet për ndryshime ligjore për ngritjen e Zyrës për Rekuperimin e Aseteve do të hartohen përgjatë vitit 2023.

Në kuadër të verifikimeve administrative të denoncimeve dhe ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion vijon punën për të ndërtuar një historik solid në luftën kundër korrupsionit. Konkretisht, nga hetimet administrative të kryera nga kjo strukturë për periudhën janar-nëntor 2022 janë hartuar në total 48 raporte përfundimtare dhe janë propozuar 273 masa disiplinore e 94 rekomandime për institucionet publike. Janë depozituar 28 kallëzime penale + 4 shtesa kallëzimi penal, nga ku janë kallëzuar gjithsej 86 punonjës/nëpunës të institucioneve.

***Veprimtaria e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)***

Gjatë periudhës vijuese janar – nëntor 2022, ILDKPKI ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të projekteve asistuese në drejtim të ngritjes së Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë.

Në kuadër të masave të marra, pilotimi i sistemit në disa institucione publike ishte një fazë shumë e rëndësishme, e realizuar gjatë vitit 2021, dhe që i parapriu fillimit të funksionimit të sistemit.

Në zbatim të dispozitave ligjore, të parashikuara në ligjin Nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, Inspektorati i Lartë hartoi dhe miratoi aktet e nevojshme nënligjore dhe formularët e deklarimit për sistemin elektronik.

Inspektori i Përgjithshëm, miratoi<sup>22</sup> përkatësisht formularët e deklarimit të interesave privatë në sistemin elektronik EACIDS, si dhe u hartua dhe u miratua udhëzimi i Inspektorit<sup>23</sup> të Përgjithshëm për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë në formë elektronike në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave, në të cilin janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e aktorëve të përfshirë në procesin e deklarimit elektronik.

Duke filluar nga data 1 janar 2022, të gjitha subjektet deklaruuese deklaruan përmes sistemit elektronik EACIDS. Udhëzimet dhe manualët për plotësimin e këtyre formateve janë publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI, në sesionin e dedikuar për sistemin e deklarimit elektronik EACIDS. ILDKPKI ka trajtuar të gjitha kërkesat e individëve apo mediave lidhur me publikimin e deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, brenda afatit 10 ditor, pavarësisht fluksit të kërkesave dhe procesit manual të përpunimit për redaktimin e të dhënave personale, duke rritur kështu transparencën institucionale. Në këtë kuadër, për t’u theksuar mbetet fakti se nuk janë paraqitur kontestime apo ankesa nga palët e interesuara.

Volumi gjithmonë e më shumë në rritje tregohet në mënyrë të qartë edhe nga të dhënat e publikimit të deklaratave të interesave privatë, ku gjatë periudhës 2014 – 2021 ILDKPKI ka publikuar rreth 61,933 deklarata me kërkesë, ndër të cilat vetëm për vitin 2021 janë publikuar rreth 3,553 deklarata me kërkesë, ndërsa për periudhën janar – nëntor 2022 janë publikuar rreth 3,749 deklarata.

*Zbatimi i ligjit Nr. 60, datë 2.6.2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.*

ILDKPKI ka vijuar zbatimin e kompetencave të dhëna nga ligjit Nr. 60, datë 2.6.2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

---

<sup>22</sup> Inspektori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 925 dhe Urdhrin nr. 926, datë 29.10.2021 miratoi formularët e deklarimit të interesave privatë në sistemin elektronik EACIDS.

<sup>23</sup> Udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 927, datë 1.11.2021 “Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë në formë elektronike në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave”,

ILDKPKI, gjatë periudhës 2017 – 2021, në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, ka regjistruar dhe trajtuar në total 58 raste sinjalizimi dhe 7 raste kërkesash për mbrojtje nga hakmarrja. Për vitin 2021, ILDKPKI, ka regjistruar dhe trajtuar në total 11 raste sinjalizimi dhe 1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, ndërsa për periudhën janar – nëntor 2022 ka regjistruar 7 raste sinjalizimi të jashtëm dhe 1 kërkesë për mbrojtje.

### ***Agjencia e Mbikëqyrjes Policore***

Në bazë të nevojës për një reformim rrënjësor të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në përputhje me standardet e organizatës së Partnerëve Evropian Kundër Korrupsionit (EPAC) dhe objektivave afatgjatë të Ministrisë së Brendshme dhe Qeverisë Shqiptare, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi ligji Nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”. Vijimi i konsolidimit organizativ dhe funksional të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore nëpërmjet hartimit dhe miratimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, riorganizimi strukturor dhe funksional, rritja dhe fuqizimi i mekanizmave parandalues, kontrollues dhe mbikëqyrës ndaj strukturave janë objekt i veprimtarisë së Agjencisë. Deri më tani janë miratuar një sërë aktesh<sup>24</sup> të cilat kanë të bëjnë me strukturën dhe organikën e agjencisë, pagat e punonjësve, rregulloren për organizimin dhe funksionimin e agjencisë, për procesin e hetimit disiplinor, për organizimin dhe funksionimin e komisionit disiplinor në agjenci.

Që prej muajit tetor 2022, Komisioni Disiplinor i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, ka marrë në shqyrtim 14 raste për 23 punonjës policie dhe të gardës së republikës për shkelje të rënda, të iniciuara mbi bazën e hetimit administrative të ankesave dhe inspektimeve dhe hetimit procedural penal.

Për periudhën janar-tetor 2022 për sa i përket hetimit administrativ të ankesave & inspektimeve dhe hetimit procedural penal, treguesit statistikorë janë si vijon:

- Hetimi administrative i ankesave & inspektimeve:
  - Marrë dhe trajtuar 1339 ankesa të publikut;
  - Marrë dhe shqyrtuar 3810 telefonata nga Linja e Gjelbër 0800 90 90;
  - Kryer 101 Inspektime në 95 struktura.

---

<sup>24</sup> Urdhri nr. 117, datë 28.07.2022 i Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Përbërjes Organike të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Vendimi nr. 487, datë 21.07.2022 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Vendimi nr. 532, datë 29.07.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë nr. 335, datë 23.09.2022 “Për implementimin e procesit të hetimit disiplinor ndaj subjekteve të Agjenci-së”;

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë nr. 334, datë 23.09.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor në Agjenci”;

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë nr. 333, datë 23.09.2022 “Për miratimin e Procedurës Standarde “Hetimi disiplinor i Subjekteve të Agjenci-së”.



Në përfundim të hetimit administrativ të ankesave dhe inspektimeve:

- Për 13 punonjës të strukturave janë referuar materialet për fillimin e procedimit penal në prokuroritë e rretheve Gjyqësore përkatëse;
  - Për 92 punonjës të strukturave është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore, si personat përgjegjës për shkeljet e evidentuara.
- Hetimi procedural penal

Veprimtaria hetimore e strukturave të AMP-së, e pasqyruar në numrin e referimeve të veprës penale pranë organit të Prokurorisë, konstaton në 208 referime penale për

- 316 punonjës të strukturave, ku
  - 308 punonjës policie;
  - 7 punonjës të Gardës së Republikës;
  - 1 punonjës i MNZSH dhe;
  - 30 shtetas;
- 130 punonjës të strukturave me masa sigurie arrestuar/ndaluar/masa të tjera dhe
- 23 shtetas me masa sigurie arrestuar/ndaluar/masa të tjera

### ***Rikonceptimi i procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë.***

Në seancën plenare të datës 17.11.2022 Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 78/2022, datë 17.11.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 12/2018 "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", i ndryshuar, i cili synon:

- reduktimin dhe kufizimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin 12/2018 dhe kryerjen e procesit të vlerësimit nëpërmjet një strukture permanente vlerësimi për zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s;
- përcaktimin e një afati ligjor për kryerjen e procesit të vlerësimit;
- përfshirjen e institucione të tjera ndihmëse në proces si ILDKPKI;
- plotësimin e vakumeve ligjore;
- standardizimin dhe detajimin e procedurave të vlerësimit për të tre komponentët: pasuri, figurë dhe profesionalizëm;
- parashikimin e sanksioneve ligjore për t'i dhënë fuqi detyruese zbatimit të vendimit të trupave të vlerësimit nga institucionet përkatëse;
- parashikimin e procedurave të dorëzimit dhe arkivimit të dosjeve të shorteve të papërfunduara nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit

### ***Raportimet ndërkombëtare***

Në fokus të punës së Ministrisë së Drejtësisë për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ka qenë edhe adresimi i rekomandimeve të mekanizmave monitorues të Këshillit të Evropës GRECO, UNCAC si dhe rekomandimeve të FATF.

Më 3 dhjetor 2020, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) publikoi Raportin e Vlerësimit për Raundin e Pestë të Vlerësimit, “Për Parandalimin e Korrupsionit dhe Promovimin e Integritetit të Zyrtarëve të Lartë dhe Agjencive Ligjzbatuese”. Në këtë raport, GRECO vlerësoi reformat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare dhe theksoi rëndësinë e implementimit të këtyre reformave për përmirësimin e rezultateve në luftën kundër korrupsionit. Në përputhje me gjetjet e raportit, për Shqipërinë u lanë për zbatim 24 rekomandime me afat zbatimi 18 muaj. Në vijim të këtij procesi, Ministria e Drejtësisë hartoi planin e veprimit për adresimin e këtyre rekomandimeve si dhe ka monitoruar rregullisht punën e institucioneve publike për zbatimin konkret të çdo detyre të lënë nga ky raport. Raporti i Vetëvlerësimit i Qeverisë Shqiptare, është dorëzuar zyrtarisht pranë sekretariatit teknik të GRECO, në datë 30 prill 2022. Në seancën plenare të datës 29 nëntor 2022 u diskutua dhe miratua Raporti i Vlerësimit të GRECO-s për Shqipërinë.

Sipas raportit, Shqipëria ka zbatuar me sukses të plotë 5 rekomandime prej 24 rekomandimeve, 13 prej tyre janë zbatuar në mënyrë të pjesshme dhe 6 rekomandime nuk janë zbatuar sipas kërkesave dhe pritshmërive të GRECO-s.

Sa i takon rekomandimeve të adresuara Shqipëria ka rritur transparencën për të dhënat e funksionarëve politikë pranë kabineteve ministrore, ka filluar deklarimi online i pasurive të subjekteve që e kanë këtë detyrim, janë rritur kapacitetet njerëzore, profesionale dhe burimet financiare të ILDKPKI, janë rritur kapacitetet burimore dhe profesionale të SPAK si dhe është zbatuar plani i parë i integritetit të Policisë së Shtetit.

Rekomandimet pjesërisht të zbatuara i referohen kryesisht çështjeve të lidhura me zbatimin e plotë të planeve të integritetit në institucionet qendrore, konsolidimit e zbatimit të rregullave të integritetit për funksionarët e lartë, të zbatimit të rregullave dhe parashikimeve të Kodit Etik Ministror, ndërngjegjësimin e shtuar dhe frekuent të funksionarëve të lartë politikë dhe këshilltarëve të tyre, shtimin e formave plotësuese të konsultimit publik të akteve, rregullimin e lobimit të funksionarëve të lartë, rastet e evidentuara të abstenimit nga vendimmarrja e Këshillit të Ministrave të anëtarëve të qeverisë, analizën e dedikuar për dhuratat dhe donacionet dhënë policisë së shtetit, forcimin e kapaciteteve dhe trajnimin e strukturave të policisë për çështje të integritetit dhe këshillimit konfidencial, mbi vijueshmërinë e procesit të vettingut në polici, mbi zbatimin e rregullave për pranimin dhe deklarimin e dhuratave në polici, mbi procedurat ligjore të ndjekura nga Ilyrian Guard dhe për rritjen e kapaciteteve të stafeve të policisë për zbatimin e ligjit të sinjalizuesve.

6 rekomandimet e vlerësuara të pazbatuara i referohen kryesisht atyre që lidhen me zbatimin e rregullave kufizuese të pas-punësimit për anëtarët e Qeverisë dhe të këshilltarëve politikë, mbi zbatimin e politikave dhe rregullave për ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit, hartimin dhe zbatimin e një manuali praktik udhëzues të parimeve etike dhe rregullave, rritjen e qëndrueshmërisë së drejtuesve të lartë të Policisë në detyrë, emërimin e drejtuesve të policisë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit si dhe vendosjen e rregullave kufizuese të pas-punësimit për punonjësit e policisë.

Qeveria e Shqipërisë do të dorëzojë informacione shtesë për adresimin e plotë [ të rekomandimeve ne 30 qershor 2024.

Shqipëria ndjek gjithashtu me vëmendje dhe është e përfshirë në ciklin e dytë të vlerësimit të kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional në përputhje me dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsion (UNCAC). Shqipëria për këtë cikël do të vlerësohet nga Azerbajxhani dhe Liberia. Grupi i ekspertëve vlerësues pritet të vij në Tiranë në muajin prill 2023.

Prej muajit shkurt 2020, Shqipëria ka ndërmarrë një angazhim të nivelit të lartë politik për zbatimin e Planit të Veprimit të dakordësuar me ICRG/FATF. Në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të ICRG/FATF, nga institucionet pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës gjatë vitit 2022 janë realizuar objektivat si më poshtë:

- Kanë përfunduar pjesa më e madhe e masave të parashikuara në planin e unifikuar nga institucionet ligjzbatuese që lidhet me vlerësimin kombëtar të riskut.
- Është arritur vënia në funksion të plotë të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve për prioritizimin sistematik të letër-porositve.
- Janë miratuar ndryshimet në ligjin “Për Noterinë”, ligji Nr. 8/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, ndryshime që i mundësojnë Ministrisë së Drejtësisë të kontrollojë gjendjen penale të noterëve dhe të personave të lidhur me ta.
- Është miratuar ligji Nr. 9/2022, datë 27.1.2022 “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, sipas parashikimeve të të cilit Ministria e Drejtësisë kryen kontrollet për të parandaluar personat me precedentë penal dhe bashkëpunëtorët e tyre që zotërojnë ose kontrollojnë agjentët e pasurive të paluajtshme.
- Për subjektet që nuk respektojnë detyrimet e tyre të raportimit të pronarit përfitues u aplikuan gjobat përkatëse në bazë të ligjit. Aplikimi i gjobave pati edhe efekt korrigjues në kuptimin që subjektet e gjobitura deklaruan më vonë në regjistër pronarin përfitues. Deri më 1 tetor 2022 regjistri i pronarëve përfitues është i populluar në masën 97.4% për subjektet tregtare dhe 98.19% për OJF.
- Janë përditësuar të dhënat në lidhje me zbatimin e ndryshimeve në ligjin 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, (për sa i përket informacionit bazë) ashtu edhe me ndryshimet në ligjin 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar (në lidhje me informacionin e pronarëve përfitues) të zbatuar pas hyrjes së tyre në fuqi në fillim të 2022 dhe korrik 2022, respektivisht. Gjithashtu vijon të zbatohet kuadri i ri i sanksioneve në lidhje me OJF-të, i cili ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm veprimesh korrigjuese.
- Janë vendosur mekanizmat ligjore që sigurojnë që të dhënat e regjistruara në përputhje me detyrimet e transparencës ligjore janë të përditësuara dhe të verifikohen në mënyrën e duhur nga QKB dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Tashmë janë vendosur dhe shfaqen **red flags**-një shënim alertues (shoqëruar me një ikonë të vogël flamuri të kuq) për shembull në rastet kur subjekti nuk ka depozituar pasqyrat financiare vjetore raportuese, mbajtja e të cilave është e detyrueshme, në rastet kur të dhënat janë të papërditësuara ose të pasakta.

- Me ritme të shpejta ka vijuar trajnimi në të gjitha zyrat e prokurorive në rrethe që nuk kanë pasur ende rastin të përdorin sistemin PRESTO i cili që prej qershorit 2022 po monitoron rastet e pastrimit të parave me bazë kombëtare me qëllim për të maksimizuar gjithë përfshirjen e rasteve të pastrimit të parave në sistem.
- Institucionet ligj zbatuese dhe prokuroritë kanë rritur numrin e hetimeve për veprën penale të pastrimit të parave (“çështjet e regjistruara”), referimet e policisë për pastrim parash, hetimet pasurore (financiare) dhe dënimet për pastrim parash. Rastet e veprave penale mëmë të kryera në juridiksion të huaj tashmë përbëjnë një numër më të madh se rastet e veprave penale mëmë të kryera në juridiksionin vendas, duke konfirmuar një fokus më të madh në këtë aspekt të pikës së planit të veprimit.
- Është përmirësuar performanca e përgjithshme e sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve, duke përfshirë kryerjen e rregullt të hetimeve financiare dhe identifikimin e pronave për sekuestrim, përfshirë në rastet komplekse dhe që synojnë pastrimin e parave nga palët e treta, subjektet raportuese dhe profesionistët.
- Nga 19 pikat e planit të Veprimit të ICRG, vetëm një pikë mbetet “pjesërisht e adresuar”, ndërsa pikat e tjera janë të adresuara.

## **Të drejtat e njeriut**

Në bazë të Raportit të Komisionit Evropian për 2022, në përgjithësi, Shqipëria respekton instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore. Njëfarë progresi është shënuar, lidhur me miratimin e një plani kombëtar veprimi të ri dhe me buxhet të mirë për personat LGBTIQ, të një strategjie kombëtare për barazinë gjinore dhe të një plani kombëtar veprimi për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Përdorimi i alternativave të burgimit dhe në veçanti, i shërbimit të provës ka shënuar njëfarë progresi. Duhet të intensifikohen përpjekjet, duke përfshirë ato lidhur me plotësimin e kuadrit ligjor dhe duke shënuar progres të mëtejshëm në proceset e para të regjistrimit dhe kompensimit.

Në lidhje me të drejtat e pakicave kombëtare, u miratuan akte nënligjore shtesë por pjesa tjetër e akteve nënligjore priten ende të miratohen. Për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, Shqipëria ende duhet të marrë masa për të parandaluar ripërsëritjen e shkeljes në masë të të dhënave personale dhe duhet të përshpejtojë përpjekjet për të harmonizuar legjislacionin e saj me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave.

## ***Të drejtat e pronës***

Të drejtat e pronës përfaqësojnë një nga elementet e rëndësishme të kornizës së të drejtave themelore. Prioriteti kryesor i Shqipërisë në aspektin e të drejtës së pronës është reformimi i shërbimeve publike në lidhje me të drejtat e pronësisë, me qëllim krijimin e një sistemi modern, efektiv dhe transparent, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme, pjesë e Reformës së Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Tokës, është miratimi nga Kuvendi i ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, deri në nëntor 2022, nga 17 akte nënligjore, janë miratuar 14 VKM, ndërsa në zbatim të ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, deri në nëntor 2022, nga 19 akte nënligjore, janë miratuar 13 VKM.

Procesi i përfundimit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme është duke vijuar. Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme deri në nëntor 2022 është kryer në 2 786 zona kadastrale nga 3 058 zona kadastrale që janë gjithsej. Nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar në 272 zona kadastrale, me rreth 300 mijë pasuri të paluajtshme. Numri i pasurive të regjistruara është afërsisht 3 563 323 prona nga 4 milionë që është përlogaritja e numrit total të pasurive të paluajtshme në territorin e vendit. Gjatë vitit 2022 ka përfunduar regjistrimi fillestar në 5 zona kadastrale, me rreth 7 423 mijë regjistrime shtesë të pasurive të paluajtshme.

Në lidhje me procesin e legalizimit, gjatë periudhës 2006 – 2013 janë legalizuar 21 750 ndërtime informale, kurse për periudhën 2014 – 2021 janë legalizuar 240 529 ndërtime informale. Gjatë periudhës janar – tetor 2022 janë legalizuar 15 758 ndërtime informale.

Në dhjetor 2021 Qeveria e Shqipërisë miratoi financimin e projektit për digjitalizimin e arkivit të kadastrës. Me miratimin e strukturës së re të Kadastrës, u parashikua edhe ngritja e Qendrës së Kadastrës Digjitale. Qendra e Kadastrës Digjitale u krijua në janar të vitit 2022. Projekti përfshin skanimin për rreth 56 milion dokumente dhe digjitalizimin për rreth 3.3 milion Kartela Pasurie.

### *Kompensimi i pronave*

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka punuar për realizimin e objektivave të përcaktuar në ligjin 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe kompletimin e procesit të kompensimit të pronës”. Objektivat e ATP-së në zbatim të ligjit janë si vijon:

- Vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare për vitet 1993 – 2013 që kanë njohur të drejtën për kompensim me qëllim nxjerrjen e një fature financiare përfundimtare, si dhe ndjekjen e procedurave për ekzekutimin e tyre. Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri më datë 31 tetor 2022, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vlerësuar gjithsej 26.092 vendime përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013. Gjatë periudhës janar - tetor 2022 ATP ka vijuar punën mbështetur në regjistrat e përditësuara të vendimeve përfundimtare për kompensim. Janë përditësuar 15 vendime që kanë njohur të drejtën e kompensimit. Përditësimet janë bërë publike në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare Nr. 3, datë 24.01.2022.
- Kompensimi financiar dhe fizik i vendimeve përfundimtare. Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, ATP ka ekzekutuar 794 vendime, me një vlerë prej 7,842,824,598.92 lekë (vlera e kompensimit financiar plus vlera e llogaritur për kompensim financiar të kërkesave të veçanta) dhe 72 vendime për mbyllje procedimi. Janë shpërndarë 713.22 ha tokë si fond

fizik dhe është realizuar trajtimi i kërkesave për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI). Gjithashtu, janë ekzekutuar gjithsej 7 626 kërkesa që nga viti 2016 dhe është shpërndarë vlera financiare prej 9,290,080,287 lekë;

- Nga muaji shkurt e deri më tani, ATP ka pezulluar procesin e ekzekutimit të kërkesave për kompensim për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 4, datë 15.02.2021 i cili vendosi shfuqizimin e disa pikave të ligjit 133/2015. Në vijim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të vendimit të GJEDNJ në çështjen Beshiri kundër Shqipërisë, u hartua projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.
- Më datë 17 nëntor 2022 u miratua Ligji Nr. 77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”;
- Gjatë vitit 2022 ATP ka vijuar me përditësimin e vendimeve përfundimtare për kompensim. Bazuar edhe në vendimin e GJEDNJ në çështjen Beshiri kundër Shqipërisë ka përlllogaritur vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit, bazuar në vlerësimin financiar me 10% të zërit kadastral aktual, të cilat do të publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare pas miratimit të ndryshimeve ligjore në ligjin 133/20215. Sipas përlllogaritjeve rezulton se preken 4672 vendime. Vlera e faturës për 4672 vendime të cilat mund të preken nga ndryshimet ligjore arrin në 18,503,141,414.38 lekë.
- Ndryshimet ligjore parashikojnë dhe shtyrjen e afateve të procesit të shqyrtimit të kërkesave për njohjen e të drejtës së pronësisë si dhe kryerjen e vlerësimit financiar të atyre vendimeve që nuk është arritur të vlerësoheshin para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.
- Shqyrtimi i kërkesave për njohje pronësie dhe vlerësimi financiar i vendimeve, bazuar në ligjin 133/2015, i ndryshuar do të përfundoj deri në datë 31.12.2024.
- Në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të vlerësuara për komunitetet fetare nga ATP, ky proces është në varësi të kërkesave të administruara pranë agjencisë nga vetë subjektet. Gjatë periudhës janar – tetor 2022 janë regjistruar 13 aplikime nga këto subjekte.
- Gjatë periudhës janar-tetor 2022, në lidhje me kompensimin financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI) janë evidentuar 880 kërkesa nga qytetarët, janë ekzekutuar 244 kërkesa, dhe është shpërndarë vlera financiare prej 553,856,429 lekë.
- Përparimi i nevojshëm në digjitalizimin dhe hartëzimin e pronave. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka bërë përparim në procesin e digjitalizimit dhe hartëzimit të pronave me krijimin e sistemit elektronik të digjitalizuar Web – Gis. Krijimi i një “harte” unike “vendimesh” në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave mundësoi inventarizimin dhe skanimin e situatës së krijuar ndër vite për të gjitha dosjet që janë trajtuar me vendime nga ish-KKKP-ja, ZRKKP-ja apo AKKP-ja, si dhe mundëson transparencë të institucionit ndaj subjekteve të ligjit dhe përmirësim të efikasitetit të punës në ATP.

Rishtë e Ligjit Nr. 77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”:

- Vendosja e pragut minimal 10% të vlerës së pronës kur zëri kadastral i pronës së njohur për kompensim;

- Rregullat dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të kompensimit dhe rendi prioritar i formave të kompensimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Garanci e shtuar në lidhje me fondin fizik për kompensimin e pronave;
- Rivendosja e juridiksionit administrativ për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie, kthimin dhe/ose kompensimin e saj;
- Rivendosja e juridiksionit administrativ për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare për njohjen e të drejtës së kompensimit të pronës;
- Indeksimi i shumës deri në ekzekutimin e vendimit të kompensimit.

### *Sistemi i burgjeve*

Në zbatim të misionit të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i ka kushtuar një vëmendje të veçantë krijimit të kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues duke u siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të garantojnë trajtimin njerëzor të personave me liri të kufizuar.

Në këtë kuadër, fokus i rëndësishëm ka qenë adresimi i rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë si Komisioni Evropian dhe Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor e Degradues ose Ndëshkues (CPT), si dhe institucioneve kombëtare monitoruese të sistemit të burgjeve si Avokati i Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës. Tashmë rekomandimet e CPT dhe Avokatit të Popullit janë bërë pjesë e Planeve të Posaçme Veprimi për adresimin, trajtimin dhe zbatimin e tyre në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.

Me mbështetjen e ekspertëve të Këshillit të Evropës, janë rishikuar të gjitha modulet dhe më specifikisht moduli i "Mekanizmit për Parandalimin e Torturës dhe Keqtrajtimit". Mbi këtë tematikë janë zhvilluar trajnime për trajnerë, si dhe trajnime të stafit të vijës së parë dhe të nivelit të mesëm lidhur me parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit. Gjithashtu, një zhvillim pozitiv në drejtim të vlerësimit të performancës është hartimi i një liste kontrolli lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në burg, si dhe është publikuar Manuali i të Drejtave të të Burgosurve dhe janë shpërndarë postera informues mbi të drejtat e të dënuarve.

Numri total i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit gjatë periudhës janar – nëntor 2022 është 196, prej të cilave 79 janë realizuar, 82 janë në proces, 25 janë realizuar pjesërisht dhe 10 rekomandime nuk janë realizuar.

Mbështetur në rekomandimet e vazhdueshme të CPT dhe Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2022 është bërë e mundur mbyllja e burgjeve të Krujës, Vaqarrit, Tropojës dhe Sarandës, për shkak të kushteve infrastrukturore të papërshtatshme për mbajtjen dhe trajtimin e të burgosurve.

Lidhur me situatën e popullimit në burgje, sipas të dhënave më të fundit, sistemi i burgjeve vazhdon të jetë në nivel nënpopullimi -10 %.

Në kuadër të programit “Mbështetje Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, 2019 – 2022” – HF38, financuar nga BE dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës, sistemi shqiptar i burgjeve është mbështetur përmes dy projekteve të rëndësishme që kanë në fokus forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut<sup>25</sup> dhe luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje<sup>26</sup>. Në këtë kuadër janë hartuar dhe pilotuar metodologji bashkëkohore për forcimin e punës rehabilituese me të burgosurit, duke përfshirë edhe të burgosurit e dënuar për radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm; përmirësimin e shërbimit shëndetësor në burgje, përfshirë edhe shëndetin mendor; forcimin e kapaciteteve të qendrës së trajnimit etj.

Në aspekt të forcimit të mekanizmave për riintegrim të të burgosurve të dënuar për radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm, Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social (IANS) po zbaton në sistemin e burgjeve projektin “Komunitete të sigurta- burgje të sigurta”, të financuar nga Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Holandës. Qëllimi i projektit është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve institucional në adresimin e çështjeve të shkëputjes, rehabilitimit dhe riintegritimit në shoqëri të të dënuar për radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.

26 punonjës të disiplinave të ndryshme të sistemit të burgjeve kanë përfituar nga mbështetja e Ambasadës Amerikane në Tiranë, nëpërmjet projekteve INL, përmes pjesëmarrjes në 2 trajnime dy javore të zhvilluara gjatë vitit 2022 në ICMTC në Kolorado, SHBA.

Në qershor 2022 ka përfunduar projekti i përbashkët shqiptaro-suedez “Rritja e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese dhe gjykatave shqiptare për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit – një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë”, 2017 – 2022. Përgjatë këtij projekti Institucioni për të Miturit në Kavajë u asistua në hartimin dhe zbatimin e një metodologjie të re për trajtimin rehabilitues të të miturve në konflikt me ligjin. Me iniciativën e DPB, tashmë kjo metodologji zbatohet edhe për të rinjtë e grup-moshës 18-21 vjeçare në sistemin e burgjeve.

Në kuadër të krijimit të një klime të sigurtë ndërveprimi social ndërmjet të miturve në IM Kavajë, Komiteti Holandez i Helsinkit ka mbështetur stafin e këtij institucioni për zbatimin e metodologjisë TOPs!, e cila synon rehabilitimin e deficiteve të aftësive kognitive dhe aftësive sociale, të vetëkontrollit dhe mungesës së arsytimit moral te grup-mosha e të miturve në konflikt me ligjin.

Në bazë të Ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, pacientët me masë mjekësore “mjekim i detyrueshëm” duhet të trajtohen në aspektin mjekësor në institucionet e kujdesit shëndetësor që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Duke marrë në konsideratë urgjencën e nevojës së adresimit të masave për këtë kategori, referuar edhe rekomandimeve të vazhdueshme të CPT dhe Avokatit të Popullit, si dhe vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për rastin “Strazimiri kundër Shqipërisë”, pas transferimit të pacientëve në ambientet e përshtatura posaçërisht për këtë

<sup>25</sup> Projekti “Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve në Shqipëri”, 2019 – 2022

<sup>26</sup> Projekti rajonal, “Rritja e kapaciteteve penitenciare në adresimin e radikalizimit në burgje në Ballkanin Perëndimor”, 2019 – 2022.



kategori në IEVP Lezhë në muajin nëntor 2021, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë shtuar përpjekjet për adresimin e masave sa i përket përmirësimit të trajtimit terapeutik dhe kujdesit shëndetësor të pacientëve në IEVP Lezhë. Në tetor 2022 është bërë i mundur fuqizimi i strukturës së stafit që trajton pacientët në IEVP Lezhë përmes shtimit në organikën ekzistuese<sup>27</sup> edhe të 2 mjekëve psikiatër, 4 psikologëve, 3 punonjësve socialë, 1 mjeku laborant, një infermieri laborant, 5 kujdestarë dhe 5 sanitarëve.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale për rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri të të burgosurve është miratuar VKM “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” Nr. 602/2021 duke hapur rrugë zbatimit të programeve të punësimit për të burgosurit.

Zhvillime të tjera rëndësishme, gjithashtu kanë qenë investimet në godinën e Pojskës në Pogradec, si institucion për të dënuarit e moshuar; rritja e pagave të stafit psiko-social në burgje, përmes ndryshimit të klasifikimit të nivelit të pagave; fuqizimi i flotës së sistemit të burgjeve me autoburgjet dhe autoambulanca të reja etj.

#### *Trajtimi financiar i punonjësve të sistemit të burgjeve*

Në VKM Nr. 920, datë 25.11.2020 “Për trajtimin me pagë e shtesa mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të policisë së burgjeve” janë të përcaktuara strukturat, niveli i pagave për gradë, shtesat mbi pagë për natyrë të veçantë punë etj. Ky akt nënligjorë me efekt të konsiderueshme financiarë e ka shtrirë zbatimin e tij në 3 vite e konkretisht:

- Nga data 7 gusht 2020 lidhur me pagat bazë mujore për gradë për punonjësit e policisë;
- Nga data 1 Janar 2021 lidhur me shtesën për vjetërsi shërbimi, për çdo vit të qëndrimit në gradë;
- Nga data 1 Janar 2022 lidhur me zbatimin e shtesave për natyrë të veçantë pune.

Ky akt rezulton se është zbatuar e vijon të zbatohet i plotë që nga 1 janar 2022, ku punonjësit e policisë marrin të gjithë trajtimin financiar në përputhje me këtë VKM.

Sa lidhet me trajtimin financiar të punonjësve civil dhe atyre mbështetës, përmes VKM Nr. 443, datë 29.06.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 187, datë 08.03.2017” u arrit rritja e kategorisë së pagave për disa nga strukturat civile në sistemin e burgjeve, ku ky ndryshim në nivelin e pagave do të ndikojë në rritjen e cilësisë së punës dhe nga ana tjetër do rritet niveli i kërkesave për punësim në këtë sektor të profesionistëve.

---

<sup>27</sup> Organika ekzistuese ka patur në përbërje 2 mjekë psikiatër, 1 mjek të përgjithshëm, 1 mjek shërbimi, 1 psikolog, 3 punonjës social, 1 mjek kardiolog, 1 stomatolog, 1 farmacist, 1 kryeinfermier, 10 infermierë, 5 kujdestarë, 5 sanitarë.

Për sa i përket trajtimit financiar të personelit mjekësor, përmes VKM Nr. 466, datë 06.07.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 555, datë 11.08.2011”, strukturat e shërbimit mjekësor në IEVP përfitojnë rritje në aspektin financiar e konkretisht shtesë për pozicion pune.

Gjatë vitit 2022 janë miratuar dy akte nënligjore të rëndësishme për sa i përket pajisjeve me uniforma të punonjësve të policisë së burgjeve e konkretisht:

- VKM Nr. 549, datë 29.07.2022 për një ndryshim në VKM Nr. 260, datë 5.05.2021 “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të policisë së burgjeve” u miratua paraqitja e gradave forma dhe ndërtimi i tyre pjesë kryesore e uniformes së policisë së burgjeve.
- Përmes VKM Nr. 550, datë 29.07.2022 për disa ndryshime në VKM Nr. 296, datë 19.05.2021, u miratua përcaktimi i Flamurit, stemës, uniformes, dhe ngjyrës së shenjave në mjetet e policisë së burgjeve.

### ***Mbrojtja e të Dhënave Personale***

Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale përbëhet nga ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, i përafuar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46/EC të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të procesit të përafritimit të këtij ligji me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680, si një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare, Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me ekspertët e projektit të binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafritimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* e Bashkimit Evropian”, përgatiti draftin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të përafuar me GDPR dhe Direktivën e Policisë dhe 13 akte nënligjore për zbatimin e tij. Pas vlerësimit paraprak dhe disa ndryshimeve të kryera nga Ministria e Drejtësisë, në qershor të vitit 2022, projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i është dërguar për mendim të gjitha ministrive të linjës, institucioneve të pavarura, IAL, është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, si dhe janë mbajtur dy tryeza konsultimi (njëra me institucionet e pavarura dhe tjetra me grupet e interesit). Pas marrjes së komenteve dhe mendimeve të aktorëve të mësipërm, projektligji kaloi në një fazë rishikimi tërësor nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me qëllim reflektimin e komenteve të përcjella, si dhe përputhshmërinë me rregullat e teknikës legjislative në mënyrë që dispozitat e tij të jenë sa më të qarta dhe të kuptueshme. Pas përmbylljes së këtij procesi, si dhe vlerësimit të kujdesshëm të komenteve, gjatë muajit tetor 2022, projektligji i është dërguar për bashkërendim ministrive dhe institucioneve të pavarura të cilat përcollën komentet e tyre. Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, është dërguar edhe pranë shërbimeve të Komisionit Evropian më datë 31.10.2022 nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, dhe ndërkohë vijon puna për vlerësimin e komenteve të përcjella gjatë fazës së bashkërendimit.

Gjatë vitit 2022, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe ratifikuar Protokollin ndryshues të Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”

(Konventa 108+), nëpërmjet miratimit të ligjit Nr. 49, datë 12.05.2022 “Për ratifikimin e Protokollit Ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale””. Miratimi i Konventës 108+ do të sigurojë standardet më të larta globale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale për qytetarët shqiptarë.

Gjatë vitit 2022, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar aktivitete me karakter trajnues e ndërgjegjësues në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me fokus nxitjen e integritetit dhe përgjegjshmërisë për garantimin e të drejtave të qytetarëve, konkretisht aktivitet mbi prezantimin e Strategjisë Institucionale 2022 – 2025, trajnime në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në Ministrinë e Financave, takim për prezantimin e rezultateve të pyetësorit për vlerësimin e njohurive të autoriteteve publike në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe realizimi i workshop në bashkëpunim me Shoqatën Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), për sa i përket të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në fushën e biznesit”, si dhe aktivitet ndërgjegjësues me fokus rolin dhe detyrat e Personit të Kontaktit/Nëpunësi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale, me përfaqësues nga kontrollues publik dhe privat, në sektorë të ndryshëm si telekomunikacion, sektori bankar-financiar, shëndetësi, arsim etj.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB).

### ***Liria e shprehjes***

Veprimtaria e mediave audio/audiovizive rregullohet prej ligjit Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj synon që të garantojë të drejtën e informacionit, lirinë e shprehjes, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtat themelore të njeriut, respektimin dhe garantimin e jetës private, moslejimin e transmetimeve që nxisin intolerancën, gjuhën e urrejtjes dhe dhunën në shoqëri.

Në fushën e medias, Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është i përafuar plotësisht me Direktivën e Shërbimeve Mediatike Audiovizive 2010/13/BE. Direktiva 2010/13/BE është ndryshuar me Direktivën 2018/1808/BE me qëllim mbrojtjen më të mirë të minorenëve, prezantimin e rregullave për platformat e video sharing etj.

Gjatë vitit 2022 u punua për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” me qëllim transpozimi të Direktivës 2018/1808/BE. Projektligji u dërgua për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ofruesve të Shërbimeve të Mediave Audiovizive (OSHMA), si dhe është publikuar në Regjistrin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Projektligji u dërgua gjithashtu për mendim pranë Komisionit Evropian. Me përfaqësues të DG NEAR dhe DG CNECT, Observatorit Evropian të Medias si dhe AMA, MIE, u organizua një takim teknik në muajin nëntor 2022. Gjatë takimit nga ekspertet e Komisionit Evropian u dhanë sugjerime për

përfshirjen në projektligj të parashikimeve të Direktivës 2018/1808, lidhur me Video Sharing Platform (VSP) si një kërkesë që Shqipëria të përfitojë nga programi “Europe Creative Programme”. Projektligji i rishikuar është përcjellë sërish për mendim në javën e parë të muajit dhjetor 2022 Komisionit Evropian. Projektligji pritet të miratohet në fillim të vitit 2023.

Kodi i Transmetimit, miratuar fillimisht në vitin 2014 dhe rishikuar në dhjetor 2017, përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikat e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë, me qëllim garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, dhe me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të fëmijëve, për t’u shprehur dhe për t’u informuar, etj. Aktualisht, AMA, ka iniciuar procesin e rishikimit dhe përmirësimit të këtij akti rregullator, bazuar në praktikat e deritanishme, problemet e evidentuara dhe në përputhje me zhvillimet shoqërore dhe teknologjike. Procesi i rishikimit të Kodit të Transmetimit është në përputhje me objektivat e planifikuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit (2021 – 2023). Aktualisht është iniciuar një fushatë e konsultimit publik (12 tryeza të rrumbullakëta në 10 rrethe të vendit) me fokus Draftin e Ri të Kodit të Transmetimit e cila pritet të përfundojë në vitin 2023. Drafti i ri i Kodit të Transmetimit i dedikon një seksion të veçantë: parandalimit dhe luftimit të gjuhës së urrejtjes në transmetimet audiovizive; promovimit të barazisë gjinore dhe luftimit të diskriminimit gjinor në mediat audiovizive; përmirësimit të mbrojtjes së të dhënave personale; mbrojtjes së të miturve dhe komunikimeve tregtare.

Në kuadër të projekteve që mbështet AMA për përmirësimin e raportimit në median audiovizive, në vitin 2022 janë iniciuar një sërë projektsh, konkretisht mbi rolin e medias audiovizive në formimin e personalitetit tek fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç. Projekti ka disa objektiva konkretë, që lidhen me identifikimin dhe dokumentimin e hapësirës dedikuar kësaj grupmoshe; monitorimin e programacioneve në dy TV kombëtare dhe dy TV lokale/rajonale; analizimi i informacionit të mbledhur; organizimi i katër tryezave të rrumbullakëta me grupet e interesit të përfshira në proces.

Kurse në mbështetje të komunitetit të gazetarëve, për përmirësimin e marrëdhënieve kontraktuale të punës mes tyre dhe punëdhënësve, po zbatohet një projekt tjetër i financuar nga AMA, mbi marrëdhëniet e punës së gazetarëve audiovizivë dhe prezantim i modeleve bashkëkohore. Qëllimi është vlerësimi i situatës aktuale mbi mënyrën e aplikimit të kontratave të punës, pagesat, por dhe të jepen propozime për nxitjen e procesit vetërregullues në ndërtimin e marrëdhënieve të standardizuara kontraktuale punëdhënës – punëmarrës.

Në vitin 2022 Shqipëria i është bashkuar Deklaratës për të Ardhmen e Internetit. Promovimi i demokracisë, paqes, sundimit të ligjit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe ruajtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të komunikuar, lidhur, angazhuar, punuar duke përdorur teknologjinë digjitale, në një internet të sigurt, të besueshëm, global, të hapur dhe falas do të vazhdojë të rritet.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është institucioni përgjegjës për sigurim e zbatimit të legjislacionit të punës i cili ka si mision të tij kontrollin, konstatimin, këshillimin, njoftimin, formimin, zbutjen e konflikteve, parandalimin dhe sanksionimin e subjekteve

ekonomike që kryejnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë, pjesë e së cilës janë edhe subjektet mediatike.

Për vitin 2022 ISHPSHSH ka inspektuar 7 subjekte në sektorin e mediave në të cilat janë konstatuar shkelje të legjislacionit të punës të cilat konsistojnë në:

- mungesë të përpilimit të dokumentit të vlerësimit të riskut;
- mungesa e informimit të punëmarrësve;
- mungesa e regjistrimit që mban punëdhënësi për punëmarrësit e tij;
- mungesa e regjistrimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- punë në ditët e festave zyrtare dhe moskompensimi i saj;
- mosrespektimi i procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës;
- dhënia e pagës rregullisht dhe brenda afatit;
- pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- dhënie e pushimeve vjetore;
- mbulimi i punëmarrësve me shërbim mjekësor.

Për një subjekt është vendosur sanksion me gjobë dhe për subjektet e tjera është urdhëruar të korrigjohen shkeljet brenda afateve të përcaktuara në aktin e inspektimit.

### ***Të drejtat e fëmijëve***

Shqipëria ka miratuar një kornizë solide normative lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” është i përafër me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe mund të krahasohet me standardet më të përparuara evropiane në këtë fushë.

Me qëllim rritjen e mirëqenies së fëmijëve, në Paketën e Rezistencës Sociale janë marrë masa që ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve. Gjatë vitit 2022 është dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike për familjet me tre ose më shumë fëmijë ( rreth 15000 familje), është dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike për gratë kryefamiljare me deri dy fëmijë (5700 gra) dhe janë trefishuar pagesat për jetimët.

“Bonusi i Bebes” rezultoi një politikë sociale me impakt në lindshmëri si dhe politikë universale për të gjithë familjet nga përfitojnë jo vetëm familjet në nevojë, por dhe çdo fëmijë shqiptar i lindur, brenda dhe jashtë vendit. Për periudhën janar 2022 – shtator 2022 kanë përfituar bonusin 32,088 të sapolindur.

Reforma e deinstitutionalizimit po shoqërohet me transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime të kujdesit alternative komunitar, ku prioritet kanë programet e fuqizimit ekonomik dhe social të familjes së fëmijëve në institucione. Janë pilotuar në dy bashki (Korçë dhe Vlorë) dy shërbime të reja komunitare “Fuqizimi fëmijës & familjes dhe 3 modele të reja, që do të

mundësojnë deinstitutionalizimin dhe realizimin e të drejtës së fëmijës për të jetuar në mjedis familjar.

Këto modele janë

- a) Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen;
- b) Kujdestari alternative profesionale dhe;
- c) Procedura të Ribashkimit të Fëmijës me Familjen biologjike.

Gjatë viteve 2020 – 2022, në kuadër të Fondit Social, me fokus fëmijët, është financuar zbatimi i projekteve për ngritjen e shërbimeve të reja për fëmijët më aftësi të kufizuara, në komunitet, si shërbim i specializuar në banesë apo shërbim emergjence për fëmijë në situatë risku. Këto shërbime janë ngritur në bashkitë Kavajë, Rrogozhinë, Maliq, Librazhd, Lezhë, Lushnje, Durrës, Korçë, Vlorë, Elbasan.

Deri më sot vetëm nga Fondi Social kanë përfituar 26 bashki, për 27 shërbime të reja të ngritura, nga të cilat 14 shërbime janë për fëmijët. Gjithashtu në kuadër të Fondit Social janë financuar dhe 13 shërbime të specializuara në nivel qarku, nga të cilat 8 shërbime të dedikuara për fëmijë: një linjë kombëtare këshillimi për fëmijët, dy shërbime për fëmijët autik, tre shërbime për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshëm të trafikimit, një shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.

Ngritja e dy qendrave (Fier, Shkodër) me një ndalesë të reagimit emergjent për fëmijët viktimat/të mbijetuar nga abuzimi seksual dhe forma të tjera të rënda të dhunës, (përveç qendrës Liliun) mundëson ofrimin e shërbimeve të duhura ndaj tyre.

Në zbatim të ligjit 18/2017, në datat 25 janar dhe 21 nëntor 2022 u mbledh Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në të cilin u diskutua në lidhje me situatën aktuale të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe monitorimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020.

#### *Kuadri strategjik për drejtësinë penale për të mitur*

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër prioritetet kyçe të Ministrisë së Drejtësisë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor: *“Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale”*.

Qeveria Shqiptare për herë të parë me vendimin nr. 541, datë 19.9.2018, miratoi “Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur”, si dokument politik i shoqëruar me planin e veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021. Pavarësisht angazhimit dhe vullnetit maksimal nga të gjithë aktorët e përfshirë në implementimin e masave të kësaj strategjie, u vlerësua e nevojshme dhe e domosdoshme vijueshmëria e procesit të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të një sërë masave

ende të pajetësuar në praktikë dhe në rezultate, nëpërmjet Strategjisë së re të Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026, ka si vizion të saj “*Garantimi i një drejtësie më miqësore për fëmijët që mbrojnë interesat e tyre më të larta*”, dhe mbështetet mbi katër qëllime politike, të cilat janë:

1. Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve;
2. Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë;
3. Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë;
4. Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026 u miratua në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datë 27 dhjetor 2022.

Që prej vitit 2021 është ngritur dhe funksionon Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve e cila në bazë të tre shtyllave kryesore në të cilat bazohet veprimtaria e saj si parandalimi, rehabilitimi dhe riintegrimi gjatë vitit 2022 ka zhvilluar këto aktivitete:

- Ka nënshkruar 6 marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, Nismën për Ndryshim Shoqëror Arsis, Shoqatën e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë, Qendrën për Formim dhe Zhvillim (CFD), Organizatën “Caritasi Shqiptarë” dhe me “International Police Organization”;
- Ka marrë pjesë në trajnime të certifikuara nga organizata të ndryshme si International Police Organization, Projekti Suedez, Komiteti Holandez i Helsinkit dhe Caritas Albania të cilat kanë pasur në fokus të tyre parandalimin e recidivizmit përmes një procesi të suksesshëm rehabilitimi dhe riintegrimi, trajtimin dhe vlerësimin individual të rasteve konkrete si dhe “Metodologjinë Coposo”.

Në bashkëpunim edhe me institucione të tjera ka zhvilluar disa aktivitete si:

- Në Ditën Ndërkombëtare të Diskriminimit Zero, Ministria e Drejtësisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve organizuan një tryezë të rrumbullakët për të promovuar diversitetin dhe të drejtat e gjithë secilit për të jetuar një jetë të denjë dhe të barabartë;
- Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Leximit dhe Institutin e të Miturve në Kavajë, realizuan një takim me të miturit që po vuajnë dënimin në këtë institucion rreth diskutimeve që lidhen me librin, dëshirat edhe ëndrrat e këtyre të miturve. Qendra Kombëtare e Leximit dhuroi për të miturit një sasi të konsiderueshme librash, të cilët do të jenë pasuri si për institucionin, bibliotekën, ashtu edhe për të miturit që kanë nevojë të mos humbasin lidhjet me botën e jashtme;

- Në kuadër të “Ditës së Drejtësisë” u lançua nisma “Ministër për një ditë”, nismë e cila ka për qëllim mbledhjen e ideve dhe propozimeve konkrete nga gjimnazistët për politikën për parandalimin e krimit;
- Në ditën ndërkombëtare të fëmijëve, u prezantua botimi i parë i revistës “REFLEKTIME”, një revistë me intervista të të miturve të dënuar, por edhe të profesionistëve të drejtësisë penale për të mitur. Ky botim synon të afrojë të gjithë lexuesit me situatën aktuale të të miturve në konflikt me ligjin dhe të promovojë modelet e suksesshme të rehabilitimit të tyre.

Në kuadër të fushatës sensibilizuese “edukimin ligjor nëpër shkollë” nga muaj shtator 2022 deri më tani, janë zhvilluar 7 fushata sensibilizuese, përkatësisht në qytetet Tiranë, Durrës, Cërrik, Gramsh, Kukës, Kavajë dhe Durrës. Qëllimi i kësaj fushate, është informimi i të miturve, për të bërë të mundur njohjen e tyre me parimet e drejtësisë penale për të mitur, si dhe programet parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese që Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me QPKMR harton. Gjithashtu ka realizuar edhe 2 spote promovuese me qëllim sensibilizimit të publikut mbi rolin e programeve riintegruese dhe informimin e të rinjve mbi kuadrin rregullator që vepron në fushën e drejtësisë penale për të mitur dhe njëkohësisht ndërgjegjësimin për pasojat e veprave penale.

Gjatë vitit 2022 QPKMR ka trajtuar **20 raste** të miturve të liruar nga IM Kavaja, nga të cilët:

- 3 të mitur po ndiqen me kurse profesionale;
- 3 të mitur janë punësuar;
- 7 të mitur janë rikthyer në shkollë;
- 4 të mitur me masë sigurie “arrest shtëpie”;
- 2 të mitur recidivist

Sa i përket Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për administrimin e të dhënave të sistemit. Ministria ka një rol administrues, raportues, auditues dhe zhvillues. Roli dhe funksioni i QPKMR është përdorues (hedh të dhënat në sistem) dhe raportues për Ministrinë e Drejtësisë për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit

Në vijim të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë është ngritur Grupi i Punës për hartimin e Rregullore të funksionimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur e cila pritet të miratohet së shpejti nga Ministri i Drejtësisë. Në draft rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mirëfunksionimin e sistemit, rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion, të cilët kanë të drejtë të hedhin të dhënat në sistem, duke ju referuar edhe akteve ligjore në fuqi.

Në bashkëpunim me UNICEF-in është hartuar një raport për sistemin e integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur, mbi funksionimin e sistemit, i cili përshkruan në mënyrë të detajuar hapat që janë ndjekur për zhvillimin e sistemit, situatën aktuale të përdoruesve të tij, statistikat bazuar mbi të dhënat e reflektuara në sistem gjatë periudhës 2021 – shtator 2022, si dhe



rekomandime për hapat e mëtejshëm drejt konsolidimit të tij. Ekspertët e UNICEF gjatë periudhës korrik 2021 – qershor 2022 kanë zhvilluar sesione trajnimi dhe mentorimi në mënyrë të vazhdueshme sipas kërkesave të vazhdueshme nga përdoruesit fundor dhe mbikëqyrës të sistemit nga institucionet si: Prokuroria, Policia, Burgjet, Shërbimi i Provës.

Në muajin qershor 2022, QPKMR ka përgatitur studimin mbi Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe broshura ilustruese informuese për këtë sistem. Gjithashtu UNICEF ka krijuar një video ilustruese për funksionimin e Sistemit të Integruar.

### ***Barazia gjinore***

Shqipëria ka miratuar një kornizë solide normative që promovon, zbaton dhe monitoron barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin në bazë të seksit, krahas legjislacionit dhe politikave të miratuara me fokus të veçantë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe parimet për fuqizimin ekonomik të gruas dhe mbrojtjen e saj nga çdo formë dhune përkthehen më tej në ligje, politika dhe strategji, ku mund të përmendim Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 miratuar gjatë vitit 2021.

Në vijim të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021 – 2030 ka pasur arritje të rëndësishme në përparimin drejt barazisë gjinore si dhe në përpjekjet për adresimin në mënyrën e duhur të dhunës në familje e dhunës ndaj grave e vajzave në tërësi.

Zbatimi i legjislacionit për barazinë gjinore dhe kuotave ka rezultuar në një numër të lartë të përfaqësimit të grave e vajzave në politikë e vendimmarrje. 50 gra deputete nga 140 gjithsej ose 37.5%, shënuan në këtë legjislaturë një rritje me 3,2 % krahasuar me 2017 – 2021.

Kryetarja e Kuvendit dhe një nga dy nënkryetarë janë gra, ndërsa 50% e komisioneve të përhershme parlamentare drejtohen nga deputete gra.

Në përbërjen e Qeverisë posti i zëvendëskryeministrit dhe 12 nga 16 ministrinë drejtohen nga gra.

Pushteti vendor: 8 nga 61 bashki drejtohen nga kryetare bashkie femra, duke shënuar një rritje prej 13% nga zgjedhjet e fundit vendore. Në Këshillat Bashkiak gratë përbëjnë rreth 44%.

U ndërmorën një sërë masash e veprimesh si një paketë e plotë me fokus rimëkëmbjen pas situatës së Covid-19, ku gratë dhe vajzat ishin në qendër të vëmendjes. Dyfishimi e më pas trefishimi i mbështetjes ekonomike për rastet e dhunës në familje me urdhër mbrojtje, vendosjes në prioritet të grave kryefamiljare, u kombinuan me funksionimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtje nga dhuna në familje e dhuna me bazë gjinore, ku vetëm për vitin 2021 u financuan nga Fondi Social mbi 10 shërbime të reja në të gjithë vendin. Aktualisht 34 shërbime operojnë si shërbime mbështetëse të specializuara për personat që përjetojnë situata vulnerabiliteti të dhunës me bazë gjinore ose të dhunës në familje, të organizuara në strehëza të përkohshme (16 qendra në nivel qarku dhe bashkie) dhe shërbime rezidenciale në nivel kombëtar (2 qendra kombëtare). Në

këto shërbime ofrohet: strehim, shërbim shëndetësor, ligjor, psiko-social, mbrojtje, ofrim sigurie dhe shërbime anti-trafikimit, edukim, kujdes për fëmijët.

Operojnë gjithashtu 3 linja këshillimi, përveç Qendrës Liliun, gjatë vitit 2022 operojnë dhe dy qendra të reja për trajtimin e dhunës seksuale dhe formave më të rënda të dhunës ndaj fëmijëve përkatësisht në Fier dhe Shkodër.

Që nga janari 2022 në mbështetje të familjeve, grave e vajzave dhe kategorive në nevojë janë ndërmarrë një sërë masash:

- Është rritur Ndihma Ekonomike 20% për të gjitha familjet në nevojë, ku gratë janë përfituese të kësaj ndihme;
- Dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike për 15,000 familje me 3 e më shumë fëmijë;
- Dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike për 5700 familje me kryefamiljare gra të cilat kanë mbi 2 fëmijë;
- Dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike për 5200 anëtarë familje mbi 65 vjeç dhe pa pensione sociale;
- Trefishuar pagesa e ndihmës ekonomike për 771 jetimë, viktime të dhunës në familje dhe viktime të trafikimit viktime të abuzimit seksual

Përdorimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si praktikë përshpejtuese për tejkalimin e pabarazisë, diskriminimit, disavantazhimit e dhunës po synohet të shtrihet edhe në nivel vendor. Në PBA 2022 – 2024, pabarazitë gjinore në shëndetësi, arsim, bujqësi, shërbime sociale etj., trajtohen përmes 45 programeve buxhetore në 14 ministri, nga 75 programe gjithsej, e cila përbën rreth 9% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve buxhetore.

Ndërmarrja e masave për vaksiminin falas të vajzave ndaj virusit të Papiplomës Humane është një politikë e re e ndërmarrë me qëllim mbrojtjen e shëndetit të vajzave dhe fuqizimin e tyre. Garantimi i paketave për trajtimin për kancerin e gjirit (të gjitha diagnozat) të ofruara në spitalet publike dhe vazhdimi i fushata vjetore ndërjegjësuere për kancerin e gjirit.

Në shkurt të vitit 2022 Shqipëria iu bashkua vendësve që kanë ratifikuar Konventën C190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 2019 (Nr. 190). Kjo konventë pranon të drejtën e gjithsecilit për një botë pune pa dhunë dhe ngacmim, duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin me baza gjinore. Me ratifikimin e kësaj Konvente me qëllim parandalimin dhe eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, çdo anëtar respekton, promovon dhe realizon parimet dhe të drejtat themelore në punë, lirinë e shoqërimit dhe njohjen efektive të së drejtës së negociatave kolektive, eliminimin e të gjitha formave të punës me forcë apo të detyruar, eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin si dhe promovimin e punës së denjë.

***Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara***

Politikat dhe strategjitë e Qeverisë së Shqipërisë për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara janë në përputhje me objektivat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjinë Evropiane për Aftësinë e Kufizuar 2021 – 2030. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale monitoron dhe zbaton në bashkëpunim me të gjithë aktorët përgjegjës Planin Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2021 – 2025, i cili është miratuar nga Qeveria me VKM Nr. 276, datë 12.05.2021.

Në harkun kohor 2021 – 2025 të Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar, ka një angazhim ndërinstitucional për masat për aksesueshmërinë në ndërtim, infrastrukturë, transport, komunikim dhe aksesueshmërinë e informacionit në të gjitha sferat, arsim, punësim, shërbime, turizëm. Ende nuk ka një alokim fondesh të targetuar për masat mbi aksesueshmërinë, veçanërisht aksesin në informacion.

Aksesi i përmirësuar në shërbimet publike që mbështesin përfshirjen dhe mirëqenien është parakusht për integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara. Masat e aksesueshmërisë në infrastrukturë konsistojnë në përmirësimin e infrastrukturës në nivel qendror dhe vendor. Gjatë këtij viti MSHMS është duke përmirësuar 25 qendra shëndetësore, poliklinika dhe spitale. Gjithashtu, në shkollat e prekura nga tërmeti ka pasur përmirësime të infrastrukturës dhe aksesueshmërinë për PAK. Për personat që nuk dëgjojnë është plotësuar baza ligjore për interpretin e gjuhës së shenjave dhe është përmirësuar niveli në arsimin e mesëm profesional.

Në zbatim të Ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” është miratuar VKM nr. 436, datë 22.6.2022, i cili përcakton rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara dhe VKM nr. 470 datë 6.07.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuar”.

Aksesi në ndihmën juridike falas ofrohet bazuar në përcaktimet e Ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike” ku personat me aftësi të kufizuar janë një ndër kategoritë përfituese të kësaj ndihme. Ligji për përkthyesit zyrtarë, përfshin edhe shërbimin e interpretit të gjuhës së shenjave në shërbimet e përkthimeve zyrtare.

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga fushat e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Është rritur numri i mësuesve ndihmës dhe janë prioritet qendrat burimore në arsimin special. Profili i mësuesve ndihmës është tashmë një profesion i licencuar dhe i rregulluar dhe gjatë vitit 2022 janë shtuar 250 mësues ndihmës. Raporti nxënës mësues ndihmës është 3/1. Gjatë vitit 2022, 150 klasa zhvillimore në institucionet arsimore, u shërbejnë 1 100 nxënësve përfitues fëmijë me aftësi të kufizuara.

Legjislacioni për punësimin përmban krijimin e një Fondi Social të Punësimit, i cili do të përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitimin në punë dhe shërbimet mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara dhe po ndërmerren hapa për të mundësuar këtë

fond. E drejta e kompensimit të aftësisë së kufizuar dhe e drejta për punësim nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën duke nxitur punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Planet Sociale ofrojnë një mundësi që aktorët vendorë të bashkëpunojnë për shërbime të qëndrueshme me shoqërinë civile dhe vetë kategoritë përfituese. Njëkohësisht janë financuar shërbime nga fondi Social si qendra të reja funksionale të shërbimeve komunitare për personat me aftësi të kufizuara. Fondi Social ka krijuar shërbime inovative si shërbimi i asistencës shtëpiake krahas shërbimeve sociale të integruara që operojnë sipas standardeve të miratuara. 5 shërbime të specializuara të lëvizshme funksionojnë në 5 bashki me më shumë se 600 përfitues dhe familjet e tyre. Modele të shërbimit të jetesës së pavarur promovohen dhe ofrohen nëpërmjet Fondit Social.

Shërbimet sociale të integruara për PAK ofrohen në nivel kombëtar në 35 institucione rezidenciale (7 shërbime publike dhe 28 jopublike dhe 28 shërbime komunitare të kujdesit ditor (11 shërbime publike dhe 17 jopublike) funksionojnë në territor nga të cilat përfitojnë 16 105 fëmijë me aftësi të kufizuara .

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar synon të përmirësojë cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara duke integruar përfitimet në para me shërbime, shërbime të kujdesit social, shëndetësisë, arsimit, punësimin dhe formimin profesional, në bashkëpunim me të gjithë aktorët dhe strukturat në qendrën, rajonin dhe nivel lokal.

Qeveria ka ndërmarrë reformën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar që është në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, standardet ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksioneve (ICF).

Skema e vlerësimit bio-psiko-social po shtrihet në mënyrë progresive në të gjithë vendin dhe deri tani po zbatohet në 9 nga 12 qarqet e vendit.

Qeveria Shqiptare ka marrë masa për të zbutur efektet e krizave që kanë impakt në të gjitha kategoritë e PAK. Është miratuar në mars të këtij viti, Paketa e parë e Rezistencës Sociale nga e cila personat me aftësi të kufizuar përfituan mbështetje financiare në vlerën 9000 lekë për tre muaj. Nga kjo masë përfituan 70 mijë persona me aftësi të kufizuara.

Me Paketën e Dytë të Rezistencës Sociale të miratuar, pagesat e aftësisë së kufizuar u rritën me 7.5%. Gjithashtu u rrit me 1000 lekë masa e kompensimit të energjisë elektrike për kategorinë e paraplegjikëve, tetraplegjikëve dhe të verbërve. Me VKM nr. 616/2022, këto pagesa janë rritur në vlerën 3000 lekë në muaj për kategoritë që përfitojnë asistent personal dhe 2400 lekë në muaj për kategoritë e tjera.

### ***Romët dhe egjiptianët***

Lidhur me të drejtat e Romëve dhe Egjiptianëve, MSHMS po zbaton dhe monitoron Planin Kombëtar të Veprimtimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021 –

2025". Prioritetet janë hartuar në përputhje me Kornizën strategjike të BE-së 2020 – 2030 për Romët, për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje si dhe në Deklaratën e Partnerëve të Rajonit në Poznan. Plani bazohet në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave.

Shqipëria organizoi Seminarin e Pestë të Dialogut Politik Shqipëri-BE në prill 2022, me qëllim promovimin e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve. Rekomandimet e përbashkëta të seminarit të Dialogut të Përbashkët Shqipëri - BE të miratuara dhe zbatimi i tyre janë një prioritet. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale koordinon zbatimin e Rekomandimeve të përbashkëta në bashkëpunim me të gjithë aktorët përgjegjës dhe shoqërinë civile si partnerë.

Pabarazitë adresohen në politika të synuara për mos-diskriminimin, për promovimin e barazisë, gjithëpërfshirjes, në çdo sektor të Planit. Plani Kombëtar përmban një qëllim mbi antixhopsizmin, luftën kundër diskriminimit dhe qëndrimeve diskriminuese duke njohur dhe trajtuar antixhopsizmin në politikat publike.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bashkëpunon me gjithë njësitë vendore. Qeverisja vendore zbaton plane lokale për R/E, me mbështetjen e Këshillit të Evropës – Projekti Romacted.

Komuniteti rom dhe egjiptian kanë përfituar nga lehtësimi i procedurave në zbatimin e skemës së ndihmës ekonomike si dhe nga dyfishimi i pagesave të ndihmës ekonomike gjatë pandemisë. Nga skema e ndihmës ekonomike përfituan rreth 2 700 familje rome dhe egjiptiane në gjysmën e parë të vitit 2022.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Fondit Social ka dhënë mbështetje financiare për bashkitë, qendrat emergjente dhe qendrat multifunksionale komunitare, nga të cilat vlerësohet se 40 shërbime sociale ofrohen në nivel kombëtar, me përfitues midis të tjerëve dhe romë dhe egjiptianë.

Një prioritet tjetër është kujdesi shëndetësor për romët dhe egjiptianët. Standardet e integruara social-shëndetësore janë miratuar në nivel lokal për të gjitha grupet në nevojë me fokus ndërmjetësuesit shëndetësorë për të lehtësuar aksesin në shërbimet shëndetësore dhe rrjedhimisht rritjen e mirëqenies fizike por jo vetëm të komunitetit rom dhe egjiptian. Rritja e aksesit në shërbime shëndetësore cilësore për të gjithë fëmijët dhe prindërit e grupeve vulnerabël dhe të margjinalizuara, dhe veçanërisht për gratë shtatzëna, nënat dhe foshnjat është prioritet. Komunitetet rome dhe egjiptiane janë informuar për përkujdesin shëndetësor duke përfshirë çështjet e shëndetit fizik, mendor dhe riprodhues, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, imuniteti i fëmijëve 0-14 vjeç, përdorimi i drogës, etj. si dhe kanë përfituar shërbime nga ekipet mjekësore të lëvizshme. Fëmijët e moshës 0-18 vjeç përfitojnë të gjitha shërbimet parandaluese ose të kujdesit shëndetësor sipas Paketës Bazë të Kujdesit Parësor Shëndetësor, pavarësisht nga vendbanimi ose statusi i tyre social dhe ekonomik, përfshirë vaksinimin.

Në arsimin gjithëpërfshirës, ndër masat e marra gjatë vitit 2022 është mbështetja me bursa/mbështetje financiare për disa kategori sociale si nxënës, fëmijë të familjeve në nevojë, të cilët janë të regjistruar në arsimin bazë midis të cilëve dhe nxënësit e pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane që të ndjekin rregullisht arsimin.

Grupet vulnerabël të nxënësve do të përfitojnë, mbështetje nga punonjës të caktuar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në rolin e mediatorit për këto grupe, për mbështetjen e aksesit në arsimin gjithëpërfshirës. Mediatorët të cilët janë të parashikuar në një Vendim të veçantë për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet grupeve vulnerabël dhe institucioneve të arsimit parauniversitar, me qëllim rritjen e frekuentimit të procesit mësimor. Gjithashtu, tekstet shkollore shpërndahen falas, një nismë që do të vazhdojë çdo vit shkollor.

### ***Mbrojtja e pakicave kombëtare***

Diversiteti dhe bashkëjetesa me pakicat kombëtare janë pjesë përbërëse dhe një pasuri e madhe e shoqërisë shqiptare. Në Shqipëri, mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare nuk është vetëm tolerancë, por vlerësim për shoqërinë e larmishme kulturore në të cilën jetojmë. Të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e pakicave, mund të sigurohen vetëm në një shoqëri ku dialogu, mirëkuptimi dhe diversiteti kulturor shihen si burime pasurimi.

Promovimi dhe mbrojtja e barazisë së plotë dhe efektive për personat që u përkasin pakicave kombëtare në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, si dhe kushtet e nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën, identitetin, fenë, gjuhën, traditat e tyre dhe trashëgiminë kulturore nuk është vetëm një detyrim, por një sfidë në rrugën tonë drejt integrimit në BE.

Detyrimet për zbatimin e ligjit 96/2017 “Për pakicat kombëtare” dhe nxjerrjen e akteve nënligjore vijnë në vazhden e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 849, datë 3.06.1999. Për sa i përket miratimit të legjislacionit zbatues në lidhje me ligjin kuadër të vitit 2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare, në 15 dhjetor 2021 u miratua një akt nënligjor shtesë i cili e çoi numrin e akteve nënligjore të miratuara në nëntë, nga 12 të tilla të parashikuara.

Më 15 dhjetor 2021, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin Nr. 769 “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e “Fondit për pakicat kombëtare”.

Aktualisht kanë mbetur 3 akte nënligjore të pamiratuara të cilat janë konkretisht:

- Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr. 96/2017)”.

- Projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”.
- Projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Komiteti për Pakicat Kombëtare, një institucion qendror në varësi të Kryeministrit i cili funksionon në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, ligjit Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë; ka në përbërje 9 anëtarë nga 9 pakicat kombëtare.

Në muajin prill të vitit 2022 është miratuar me urdhër të Kryeministrit struktura e re e Komitetit, duke bërë pjesë të saj dhe një strukturë të re si Drejtoria e Analizave dhe Projekteve e cila është përgjegjëse për administrimin e fondit të pakicave kombëtare.

Buxheti i shtetit i miratuar për Komitetin e Pakicave Kombëtare për vitin 2022 është 32 786 000 lekë. Fondi i buxhetit të shtetit për financimin e projekteve të pakicave kombëtare bazuar në VKM Nr. 769, datë 15 dhjetor 2021 për “Fondin për pakicat kombëtare” ishte 4 000 000 lekë për vitin 2022.

Vlerat e gjeneruara nga pakicat kombëtare dhe gjuhësore në Shqipëri konsiderohen si pjesë e trashëgimisë kulturore jomateriale. Në ditën botërore të diversitetit kulturor më 21 maj, organizohen çdo vit aktivitete sensibilizuese dhe promovuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare. Në kuadër të bashkëpunimit me UNESCO-n për regjistrimin dhe inventarizimin e trashëgimisë kulturore jomateriale në Shqipëri, Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, po zbatojnë për herë të parë Projektin “ Inventarizimi i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Shqipëri me bazë komunitare, në rrethet Shkodër, Gjirokastrë, Korçë ”, 2020 – 2022, financuar nga UNESCO. Që nga viti 2002, Ministria e Kulturës mbështet financiarisht Festivalin Folklorik Ndërkombëtar “Qyteti Multikulturor i Përmetit – Minoritetet dhe Përkatësia Etnike”.

Për sa i përket edukimit, pakicat kombëtare kanë mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve arsimore për mbështetjen e arsimit të fëmijëve të pakicave kombëtare në gjuhët e pakicave, si dhe kanë institucione të veçanta arsimore në sistemin arsimor parauniversitar për nxënësit e pakicës kombëtare greke dhe maqedonase. 39 tekste shkollorë të arsimit fillor janë të botuara në gjuhën amtare të pakicës maqedonase, dhe 53 tekste të arsimit fillor janë të botuara në gjuhën amtare të pakicës kombëtare grek. 456 nxënës që i përkasin pakicës kombëtare greke dhe 89 nxënës që i përkasin pakicës kombëtare maqedonase kanë frekuentuar arsimin fillor gjatë vitit shkollor 2021 – 2022.

***Të drejtat e personave LGBTI+***

Shqipëria ka bërë progres drejt përmirësimit të kuadrit ligjor kombëtar për të drejtat e njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin, si dhe harmonizimin e këtij kuadri me atë ndërkombëtar, përfshirë të drejtat LGBTI+.

Plani Kombëtar i Veprimit LGBTI+ 2021-2027, trajton çështjet e të drejtave, mbrojtjes dhe trajtimit të personave LGBTI+. Nëpërmjet bashkëpunimit me OJF-të-të e fushës ka vazhduar ndërgjegjësimi i profesionistëve dhe publikut sidomos për ndalimin e gjuhës së urrejtjes, e cila kulmon me fushatën IDAHOT në maj të çdo viti. Mbrojtja dhe mbështetja e personave që pësojnë situatë vulnerabiliteti si ato të dhunës ofrohet nëpërmjet shërbimeve si Qendra Streha, e mbështetur nga Fondi Social. Kjo Strehëz siguron strehim të sigurt, mbështetje psiko-sociale, ligjore, referim në shërbime të tjera të specializuara etj. Në dy vitet e fundit rreth 173 përfitues që i përkasin të rinjve LGBTI kanë marrë shërbime në këtë qendër.

Policia e Shtetit, ka marrë masa për të garantuar liritë dhe të drejtat themelore të personave të ndaluar, arrestuar në ambientet e Drejtorive Vendore të Policisë, Komisariateve të Policisë, Personave, që u përkasin komuniteteve të cënueshme si Rom, Egjiptian, LGBTI, etj duke iu garantuar dhe respektuar të drejtat ligjore në mënyrë të barabartë, të njëjtë dhe pa diskriminim.

Policia e Shtetit ka përmirësuar sistemin kompjuterik të përpunimit të të dhënave statistikore, ku për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal, gjenerohen të dhëna të ndara edhe për veprat penale me motiv për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë, ka rishikuar modulet e trajnimit për oficerët e policisë mbi rastet e komunitetit LGBTI+ bazuar në Manualin e Këshillit të Evropës “Hetimi i krimeve të urrejtjes që përfshijnë personat LGBTI”. Mbi 500 studentë në Akademinë e Sigurisë u trajnuan për përdorimin e këtij manuali.

### ***Mosdiskriminimi***

Me ndryshimet e bëra në vitin 2020 në Ligjin Nr. 10221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është përmirësuar kuadri ligjor kundër diskriminimit. Këto ndryshime ndër të tjera sollën legjislacionin kombëtar kundër gjuhës së urrejtjes në përputhje me standardet ndërkombëtare. Numri i konsiderueshëm dhe i qëndrueshëm i çështjeve të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) tregon rritjen e ndërgjegjësisimit dhe besimit të publikut ndaj këtij institucioni.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka miratuar Planin Strategjik 2022 – 2026. Ky Plan Strategjik mbështetet në 5 qëllimet e mëposhtme strategjike:

1. Rritja e informimit dhe ndërgjegjësisimit të shoqërisë dhe institucioneve publike në Shqipëri, lidhur me promovimin e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.
2. Rritja e ndikimit të vendimeve të marra në kuadër të çështjeve të trajtuara nga KMD, në funksion të mbrojtjes ligjore kundër diskriminimit.



3. Përmirësimi i politikëbërjes, mbështetur në prova, duke studiuar dhe monitoruar situatën për zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit.
4. Forcimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit me organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe mediat.
5. Rritja e efektivitetit dhe efijencës së brendshme të institucionit.

Gjatë muajit nëntor 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi realizoi 8 sesione trajnime për rritjen e njohurive për Kartën Sociale Evropiane dhe përdorimin e saj në nivel qendror dhe vendor. Këto trajnime u realizuan në 8 bashki, Korçë, Pogradec, Shkodër, Lezhë, Vlorë, Fier, Elbasan dhe Durrës. Gjatë këtyre trajnimeve u trajnuan rreth 160 persona, përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoritë Arsimore, Shkollat, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Zyrat e Punës, Inspektorati i Punës, Policia, Sigurimet Shoqërore, Ndhma Juridike Falas, Klinikat e Ligjit, dhe OJF.

Trajnimet u realizuar në kuadër të projektit me temë “ *Mbështetja e Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut dhe organeve Kombëtare të Barazisë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat sociale dhe ekonomike të përcaktuara në Kartën Sociale Evropiane*”, të financuar nga Këshilli i Evropës dhe zbatuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### ***Të drejtat procedurale***

Ndhma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë efijente dhe efektive.

Aktualisht qytetarët përfitojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në 14 qytete. Gjatë vitit 2022 janë hapur qendrat e reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Berat, Elbasan, Kukës dhe Korçë. Gjatë vitit 2022 u lidh marrëveshja e bashkëpunimit me klinikën e Ligjit pranë Universitetit Epoka si dhe janë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë 3 organizata<sup>28</sup> për ofrimin e ndihmës juridike.

Numri i rasteve të trajtuara për ndihmën juridike parësore për periudhën janar – tetor 2022 është 6 229. Për sa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike parësore, në total evidentohet se 66% e tyre pretendojnë pamundësi financiare, si mungesë të ardhurash dhe pasurie. Ndërsa në pjesën prej 34% përfshihen kategoritë e veçanta ligjore si personat viktime të dhunës, përfitues të skemave sociale, e të tjerë<sup>29</sup>.

Për vitin 2022 kanë nënshkruar kontratë me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike dytësore 157 avokatë, kurse për vitin 2021 kanë rezultuar 124 avokatë si pjesë të listës së ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. Në lidhje me të dhënat statistikore për ndihmën juridike dytësore, numri total i vendimeve gjyqësore të administruara deri në periudhën

---

<sup>28</sup> 3 organizatat janë të specializuara në fushën e viktimeve të dhunës në familje, të miturve dhe të drejtave të refugjatëve.

<sup>29</sup> Nuk janë përfshirë të dhënat e platformës juristonline dhe numrit të gjelbër nisur fakti se natyra e ofrimit të këtij shërbimi nuk kërkon domosdoshmërisht kategorizimin e qytetarëve dhe ndarjen e natyrës së çështjes.

tetor 2022 është 937 vendime. Përsa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se 68% e tyre pretendojnë pamundësi financiare, si mungesë të ardhurash dhe pasurie. Ndërsa në pjesën prej 32% përfshihen kategoritë e veçanta ligjore si personat viktimë të dhunës, përfitues të skemave sociale, e të tjerë.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar gjithashtu edhe forcimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, duke ofruar trajnime të detyrueshme për punonjësit e qendrave që ofrojnë këto shërbime. Ka vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare si UNDP/ADA (mbështetje për qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore), OSFA/CLE (mbështetja për angazhimin e paraligjorëve për zhvillimin e fushatave informuese në terren), dhe Caritas Shqiptar (mbështetja për zhvillimin e trajnimit të punonjësve të Qendrave).

Me qëllim forcimin e aksesit në drejtësi dhe edukimit ligjor të qytetarëve, një rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit ndërinstitucional dhe promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Konkretisht, është bërë i mundur nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror, vendor, institucionet e pavarura dhe gjykatat në kuadër të referimit të rasteve dhe ndërgjegjësimit<sup>30</sup>. Gjithashtu janë zhvilluar takime/aktivitete të përbashkëta ndërmjet ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/ përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura me fokus promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Janë zhvilluar 168 takime/aktivitete ndërgjegjësuese të përbashkëta, si dhe janë zhvilluar 5 intervista televizive në televizionet lokale nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

### 23.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

1. Kuvendi;
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
3. Ministria e Brendshme;
4. Ministria e Kulturës;
5. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
6. Ministria e Mbrojtjes;
7. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
9. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
10. Gjykata e Lartë;
11. Gjykata Kushtetuese;
12. Kontrolli i Lartë i Shtetit;
13. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

---

<sup>30</sup> Janë lidhur 14 marrëveshje bashkëpunimi me KMD, Bashkinë Berat, Gjirokastrë, Kukës, Korçë, Caritasin Shqiptar, Universitetin Epoka, Këshillin e Qarkut Fier, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Durrës, Shkodër, Drejtorinë e Kujdesit Social Bashkia Lezhë, Organizatën Vatra si dhe ISSH Gjirokastrë

14. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
15. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
16. Kolegji i Posaçëm i Apelit;
17. Institucioni i Komisionerëve Publikë;
18. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
19. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
20. Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
21. Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
22. SPAK;
23. Shkolla e Magjistraturës;
24. Prokuroria e Përgjithshme;
25. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
26. Departamenti i Administratës Publike;
27. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA);
28. Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
29. Agjencia e Trajtimit të Pronave;
30. Avokati i Popullit;
31. Avokatura e Shtetit;
32. Instituti i Statistikave;
33. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
34. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
35. Autoriteti i Mediave Audiovizive;
36. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit;
37. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës;
38. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
39. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
40. Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
41. Komiteti i Pakicave Kombëtare;
42. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.
43. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;
44. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje

### 23.6 Mangësitë e identifikuar dhe Prioritetet

#### **Gjyqësori**

Objektivi i harmonizimit në fushën e drejtësisë është vendosur në bazë të standardeve të parashikuara në *acquis* e BE në formën e Rekomandimeve/Udhëzimeve dhe Opinioneve që kanë të bëjnë me Pavarësinë dhe Paanshmërinë, Llogaridhënien, Profesionalizmin dhe Kompetencën, si dhe Cilësinë e Drejtësisë dhe Efiçencën. Sipas analizës ligjore të kryer deri më tani, kuadri ligjor kombëtar është përgjithësisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së për Nënkapitullin e Gjyqësorit.

Brenda objektivave të përcaktuara nga kuadri i politikave kombëtare për këtë fushë, kuadri strategjik i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 ka si vizion një sistem të drejtësisë të pavarur, llogaridhënës, të aksesueshëm, transparent dhe eficient që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane. Ky vizion synohet të jetësohet përmes katër Qëllimeve të Politikës të cilat janë:

- funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientë dhe llogaridhënie;
- fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane;
- një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;
- koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

Në lidhje me zbatimin e kornizës së politikave kombëtare në këtë fushë, është thelbësor vijimi i konsolidimit të kapacitetit të sistemit gjyqësor dhe institucioneve të qeverisjes, duke përfshirë fuqizimin e mëtejshëm të sistemit për edukimin ligjor dhe zbatimin e hartës së re gjyqësore.

#### **Në nivel normativ:**

- Duhet të konsolidohen përpjekjet për të forcuar efikasitetin dhe transparencën e të gjitha gjykatave dhe prokurorive, përfshi edhe nëpërmjet hartimit të një plani efikas për zbatimin e hartës së re gjyqësore;

Sikurse është sqaruar në seksionin për eficientë në sistemin e drejtësisë, Harta e re gjyqësore u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rrethve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, me anë të të cilit u vendos riorganizimi në 13 (trembëdhjetë) gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, 2 (dy) gjykata administrative të shkallës së parë dhe 1 (një) gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, duke përcaktuar dhe kompetencat tokësore përkatëse të tyre. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për ndjekjen dhe zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

#### **Në nivel zbatimi:**

- Duhet të konsolidohen përpjekjet për të forcuar efikasitetin dhe transparencën e të gjitha gjykatave dhe prokurorive, përfshirë edhe nëpërmjet veprimeve të shpejta dhe vendimtare për ngritjen e një Sistemi modern për Menaxhimin e Integruar të Çështjeve

Sikurse është sqaruar në seksionin për eficientë në sistemin e drejtësisë, ngritja e një sistemi të ri do të synojë rritjen e eficientë dhe cilësisë së punës së gjykatave si dhe rezultateve të të dhënave

të prodhuara. Gjithashtu sistemi do të synojë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes së përdoruesve të gjykatës

### **Në nivelin institucional dhe administrativ:**

- Nevojitet konsolidimi i kapacitetit të sistemit gjyqësor dhe institucioneve të qeverisjes së drejtësisë, duke përmirësuar njëkohësisht cilësinë dhe efikasitetin në Shkollën e Magjistraturës;
- Cilësia e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm në Shkollën e Magjistraturës (SHM) kërkon përmirësim dhe nevojitet një rritje e mëtejshme e numrit të kandidatëve;
- Shkolla e Magjistraturës duhet të intensifikojë përpjekjet e saj për të forcuar stafin e saj akademik dhe për të siguruar procedura konkurruese dhe transparente të rekrutimit;
- Plotësimi i vakancave në Gjykatën e Lartë.
- Rekrutimi i ekspertëve të rinj administrativë dhe ligjorë, përmirësimi i metodave të punës dhe rritja e komunikimit dhe transparencës mbeten detyra kryesore;
- Rekrutimi i inspektorëve shtesë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përmirësimi i kapaciteteve mbeten ende të nevojshme;

Sipas strukturës së miratuar me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka një numër prej 26 inspektorësh, me ndarje të barabartë pozicionesh për magjistratë dhe jomagjistratë. Aktualisht ushtrojnë detyrën 4 inspektorë magjistratë të komanduar nga Këshillat dhe 7 inspektorë jomagjistratë të emëruar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

### **Prioritetet**

- Përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve brenda afatit të parashikuar në Kushtetutë 31.12.2024;
- Hartimi dhe miratimi nga KLP i disa akteve nënligjore<sup>31</sup>;
- Intensifikimin e bashkëpunimit institucional me Shkollën e Magjistraturës për sa i përket programit vjetor të trajnimit vazhdueshëm të prokurorëve, si dhe në lidhje me përzgjedhjen e tematikave në përputhje me propozimin dhe interesin e vetë prokurorëve;
- Rritja e numrit të kandidatëve për prokurorë, duke ruajtur standardet dhe cilësinë e prurjeve në Shkollën e Magjistraturës, me qëllim plotësimin e këtyre vakancave dhe funksionimin e duhur të sistemit prokurorial në tërësi;

---

<sup>31</sup> Rregullorja “Për komandimin e magjistratit në një institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë”; Rregullorja “Për mënyrën e caktimit të kompensimit financiar që përfitojnë prokurorët në skemën e delegimit, që delegohen, transferohen përkohësisht ose caktohen përkohësisht”; Për disa ndryshime në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”; Për disa ndryshime në Rregulloren “Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Median”; Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”; Rregullorja “Për statusin e nëpunësve civil të sistemit të prokurorisë”; Hartimi i Anekeve “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve pranë Prokurorisë të Apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, të Rregullores Nr.95, datë 09.05.2022”; “Për hartimin e planit të integritetit”; Rregullorja e përbashkët KLP dhe KLGJ “Për bashkimin dhe zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve”; Rregullorja “Për komandimin e magjistratëve prokuror”; Rregullorja “Për përfitimin e pensionit të parakohshëm të magjistratëve prokuror”; Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”; Rregullorja “Për vlerësimin etik dhe profesional të drejtuesit të prokurorisë”;

- Vijimi i procesit të vlerësimit periodik të prokurorëve sipas programit dhe listës së përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Vijimi i procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për të bërë të mundur sa më shpejt plotësimin e vendeve të lira në këtë institucion në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 6, datë 28.1.2021;
- Nisja e procedurës së ngritjes në detyrë të prokurorëve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm;
- Vënia në funksion e një Sistemi të ri të Integruar të Manaxhimit të Çështjeve.
- Përfundimi i procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë për të gjitha pozicionet e lira dhe identifikimin dhe zbatimin e mekanizmave për reduktimin e *backlog*-ut të çështjeve të prapambetura;
- Zbatimi i Hartës së re Gjyqësore;
- Përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Vazhdimi i zbatimit dhe përfundimi i procesit të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve sipas Programit të Vlerësimit, në përputhje me skemën e re të vlerësimit të gjyqtarëve;
- Verifikimi dhe konfirmimi në detyrë i kancelarëve, në përputhje me Rregulloren mbi “Procedurën e verifikimit të plotësimin të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit”, të miratuar në vitin 2020;
- Rritja e burimeve njerëzore për Shkollën e Magjistraturës;
- Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore të Shkollës së Magjistraturës.
- Rritja e burimeve njerëzore në gjykata për administratën gjyqësore në shkallë vendi.
- Trajtimin me prioritet të ankesave *backlog* dhe shmangien e krijimit të stokut për ankesat e depozituara në ILD;
- Plotësimin e vendeve vakante në ILD (me fokus të veçantë njësinë e inspektorëve);
- Ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale, përmes bashkëpunimeve ndërkombëtare me inspektoratet homologe;
- Zhvillimin e institutit të inspektimeve tematike në funksion të përmirësimit të sistemit dhe rritja e bashkëpunimit për inspektimet me homologët evropianë;
- Zhvillimin e projekteve teknologjike në funksion të lehtësimit të proceseve të punës;
- Krijimi i një sistemi llogaridhënës funksional mbështetur në standardet e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së magjistratëve;
- Matja e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë;
- Krijimin e historikut për të dhënat statistikore të institucionit ndër vite (Krijimi i një drejtorie të posaçme Drejtoria e Metodikës dhe Standardeve e cila do të ketë në përbërjen e saj Sektorin e Statistikave).

## **Lufta kundër korrupsionit**

Objektivi i harmonizimit në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është vendosur aktualisht në bazë të Rekomandimeve të mekanizmave monitorues të Konventave të Këshillit të Evropës, rekomandimeve të GRECO, Moneyval, si dhe rekomandimeve të FATF.

Sipas analizës ligjore të kryer deri më tani, kuadri ligjor kombëtar është pjesërisht i përputhur me *acquis*-në e BE, për Nënkapitullin e Politikave Kundër Korrupsionit .

Brenda objektivave të përcaktuara nga kuadri i politikave kombëtare për këtë fushë, kuadri strategjik i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit synon të ketë institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm.

Në lidhje me zbatimin e kornizës së politikave kombëtare në këtë fushë, është thelbësore të demonstron progres i mëtejshëm drejt krijimit të një historiku solid të hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit, si dhe sekuestrimit dhe konfiskimit/rikthimit të aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin.

#### **Në nivel normativ:**

- Ngritja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve;
- Miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023 – 2030;
- Parlamenti shqiptar duhet ende të miratojë një ligj të unifikuar për financimin e partive politike dhe fushatave, si dhe të adresojë rekomandimet e mbetura të OSBE/ODIHR.

#### **Në nivel zbatimi:**

- Shqipëria duhet të garantojë që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), të adresojë me efikasitet korrupsionin në nivelet e larta, të rrisë stafin dhe burimet e saj, si dhe bashkëpunimin me organe të tjera ligjzbatuese, të prokurorisë dhe të gjyqësorit të ngarkuara për parandalimin e korrupsionit;
- Shqipëria duhet të bëjë më shumë progres në krijimin e një historiku hetimesh, ndjekjes penale dhe gjykimi të çështjeve të korrupsionit, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale që vijnë nga veprat e lidhura me korrupsionin;
- Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si dhe Rrjetit të Koordinatorëve në institucionet pjesë e rrjetit Kundër Korrupsionit, do të vazhdojë të jetë në fokus. Garantimi i historikut solid të rasteve të korrupsionit dhe propozimi dhe marrja e masave konkrete, përfshirë këtu dhe kallëzimet penale në prokurori janë në qendër të punës së këtyre strukturave. Ndërkohë, duhet të vijohet me vlerësimet e rrezikut brenda administratës qendrore, në kuadër të hartimit të planeve të integritetit, si mekanizëm parandalues;
- Institucionet publike të cilat kanë miratuar planet e tyre të integritetit, do të vijojnë me procesin e zbatimit të tyre, duke hartuar raportet e monitorimit mbi baza 6 mujore. Ky

proces synon të krijojë një pasqyrë më të qartë të përpjekjeve institucionale në fushën antikorrupsion.

#### **Në nivel institucional dhe administrativ:**

- Duhet të sigurohet një koordinim efektiv ndërinstytucional ndërmjet strukturave të reja qeveritare të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Mbetet për t'u vlerësuar efienca e Drejtorisë së re të Përgjithshme kundër Korrupsionit.
- Plotësimi dhe fillimi nga funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit në institucionet pjesë e Rrjetit (plotësimi i vakancave në strukturën e miratuar);
- Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale hetimore, përmes trajnimeve për praktikatat dhe taktikat e hetimit administrativ të rasteve të dyshuara të korrupsionit;
- Vënia në funksion e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Denoncimeve të Rasteve Korruptive (SEMDR) pranë Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim gjurmimin e rasteve dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së denoncimeve nga qytetarët dhe bizneset.

#### **Prioritetet**

- Vijimi i procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme, për të përmbushur numrin prej 20 prokurorësh të miratuar me vendim të Kuvendit;
- Zbatimi i Rekomandimeve të Raundit të Pestë të Vlerësimit të GRECO-s;
- Rritja e zbatueshmërisë së objektivave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si dhe adresimi i problematikave të evidentuara nga raportet e fundit;
- Hartimi i kuadrit ligjor për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve;
- Plotësimi dhe fillimi nga funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit në institucionet pjesë e Rrjetit (plotësimi i vakancave në strukturën e miratuar);
- Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale hetimore, përmes trajnimeve për praktikatat dhe taktikat e hetimit administrativ të rasteve të dyshuara të korrupsionit;
- Zbatimi i planeve të integritetit në të gjitha ministritë e linjës si mekanizma parandalues të bazuar mbi riskun e integritetit në këto institucione;
- Miratimi i kuadrit të ri strategjik antikorrupsion 2023 – 2030 dhe fillimi i zbatimit të tij;
- Vijimi i konsolidimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të reja;
- Digjitalizimi dhe informatizimi, vazhdimi i projekteve të nisura në këtë drejtim;
- Ushtimi i kompetencave të reja, kryesisht hetimit disiplinor për shkelje të rënda të subjekteve mbikëqyrëse, si Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe PMNZSH;
- Vettingu në radhët e strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe AMP-së, sipas ndryshimeve të ligjit Nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.



## **Të drejtat e njeriut**

Objektivi i harmonizimit në fushën e të drejtave të njeriut bazohet në akte të *acquis* së BE të këtij kapitulli. Sipas analizës ligjore të kryer deri më tani, kuadri ligjor kombëtar është pjesërisht i përafëruar me *acquis*-në e BE-së për Nënkapitullin e të Drejtave të Njeriut.

### **Në nivel normativ:**

- Përafrimi i legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE-së 679/2016 dhe Direktivën 680/2016;
- Miratimi i akteve nënligjore të mbetura për të drejtat e pakicave kombëtare;
- Ratifikimi i protokollit opsional të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

### **Në nivel zbatimi:**

- Nevojiten përpjekje për të siguruar përfshirjen e aspektit gjinor të të gjitha strategjitë kombëtare në nivel qendror dhe vendor dhe përdorimin e buxhetimit të përgjithshëm gjinor.
- Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të finalizuar proceset kalimtare të pronësisë dhe regjistrimit të akteve të pronësisë, dhe kthimin e kompensimit të pronave të shpronësuara padrejtësisht gjatë regjimit komunist.
- Të forcohet zbatimi i kuadrit ligjor dhe politikave në lidhje me mosdiskriminimin duke ofruar trajnime të specializuara për gjyqtarët dhe prokurorët.
- Duhet të garantohet zbatimi i Kodit të Punës dhe të fuqizohet mbrojtja e punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë.
- Kuadri ligjor që rregullon të drejtat e fëmijës është në fuqi dhe është shënuar pak progres në ngritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin efikas të tij.
- Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një reagim të përshtatshëm dhe sistematik ndaj të gjitha llojeve të dhunës ndaj fëmijëve.
- Është thelbësore që plani kombëtar i veprimtimit për personat LGBTI+ 2021 – 2027 të financohet mjaftueshëm dhe që të tregohet vullnet politik për zbatimin e tij.

### **Në nivel institucional dhe administrativ:**

- Forcimi i ndërgjegjësimit në institucionet publike për sa i përket detyrimeve të përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Duhet të alokohen burime njerëzore dhe financiare shtesë për Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim kryerjen efektive të detyrave të tij dhe ushtrimin e kompetencave të tij, për të përmbushur rolin e vet.

- Rritja e kapaciteteve të stafit inspektues të Zyrës së Komisionerit për t'i pajisur me njohuri dhe kompetenca të nevojshme për të adresuar nevojat inspektuese si në aspektin sasior, ashtu edhe cilësor.
- Duhet të forcohet kapaciteti institucional i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila është institucioni përgjegjës për koordinimin e politikave në lidhje me Romët.
- Rekomandohen përmirësime të mëtejshme të kushteve infrastrukturore të institucioneve penitenciare, të ofrimit të kujdesit shëndetësor të të burgosurve veçanërisht të kujdesit për shëndetin mendor, regjimit të aktiviteteve rehabilituese për të burgosurit dhe mekanizmit për riintegrim të të dënuarve pas lirimit të tyre, me fokus të veçantë të dënuarit për ekstremizëm të dhunshëm.

## Prioritetet

- Miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafuar me *acquis* të BE në këtë fushë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të harmonizimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave me *acquis* të BE-së;
- Rritja e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmirësimeve ligjore, me fokus të veçantë sistemet e sigurisë së menaxhimit të informacionit (SMSI);
- Promovimi i qasjes së re të kontrolluesve dhe përpunuesve në procesin e përpunimit të të dhënave personale me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit;
- Krijimi i Rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin publik dhe privat dhe promovimi i dialogut me ta;
- Shtimi i strukturës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe hapja e 6 Qendrave të reja të ndihmës juridike parësore, me mbështetjen e buxhetit të shtetit, në qytetet të cilat preken nga implementimi i hartës së re gjyqësore;
- Nënshkrimi i marrëveshjes së re me UNDP/ADA për mbështetjen e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore për periudhën 2023-2024;
- Përfundimi me sukses i procedurës së financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë;
- Lidhja e kontratave me avokatët ofrues të ndihmës juridike dytësore për vitin 2023;
- Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave nga të gjitha grupet, nëpërmjet mbështetjes për krijimin e kushteve të favorshme për pjesëmarrjen e tyre në tregjet ekzistuese; ngritja e kapaciteteve për t'u dhënë atyre akses më të mirë në punësim; pjesëmarrje në vendimmarrjen ekonomike; mbështetje për gratë dhe vajzat sipërmarrëse që zbatojnë ide inovative me fokus në digjitalizimin dhe ekonominë mjedisore;
- Mbështetje nga sigurimet shoqërore për nënat e papuna me 3 e më shumë fëmijë, deri në janar 2023;
- Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave, të rinjve dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre në vendimmarrjen politike dhe publike në nivel vendor, duke respektuar kuotat për barazinë gjinore dhe promovimin e modeleve pozitive;

- Mbrojtje më e mirë e grave, burrave, grave të reja, të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmi, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, nëpërmjet: Krijimit i programeve të dedikuara për rehabilitimin e shkelësve, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit, përvojat ndërkombëtare dhe praktikatat e mira ekzistuese në vend; ngritja dhe përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat/të mbijetuarit e Dhunës me Bazë Gjinore të përshtatura sipas nevojave të tyre;
- Shërbime të specializuara mbështetëse të aksesueshme dhe të disponueshme për personat LGBTI+ në të gjithë vendin;
- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve: kujdesi shëndetësor dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit social profesionistë, të vetëdijshëm dhe të gatshëm për të ofruar shërbime miqësore dhe sipas standardeve për personat LGBTI+;
- Zhvillimi i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit të publikut IDAHOT në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, përmes partneritetit me institucionet në nivel qendror dhe vendor, OJF dhe partnerë ndërkombëtarë;
- Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë, përfshirjes dhe mosdiskriminimit ndaj personave LGBTI+;
- Forcimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTI+ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës, nëpërmjet rishikimit dhe harmonizimit të legjislacionit kombëtar me standardet evropiane/ndërkombëtare;
- Përgatitja e raportit të dytë për Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara deri në vitin 2023, sipas nenit 35 të Konventës së të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Rritja e mëtejshme e kapaciteteve të Komitetit Shtetëror të Pakicave Kombëtare dhe kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjëse për koordinimin e politikave të lidhura me romët.
- Përmirësimi i kornizës së mbledhjes së të dhënave për pakicat kombëtare me fokus në Planin Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen, Barazinë dhe Pjesëmarrjen deri në vitin 2025.
- Përpjekje të mëtejshme për të garantuar dhe përmirësuar standardet socio-ekonomike të pakicave rome dhe egjiptiane, në përputhje me Deklaratën e Poznanit dhe kuadrin e Investimeve të Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2024.
- Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në përdorimin e e-albania;
- Përmirësimi i sigurisë në internet për politikën e fëmijëve, duke u fokusuar në përdorimin inteligjent të pajisjeve digjitale dhe sigurinë në internet deri në vitin 2024;
- Mbështetje për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë deri në janar 2023;
- Përmirësimi i mekanizmave të zbatimit të legjislacionit të punës dhe ngritja e kapaciteteve të kontrollit;
- Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale të sistemit penitenciar;
- Përmirësimi i proceseve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e burgjeve;
- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore të institucioneve penitenciare, nëpërmjet investimeve dhe pajisjeve logjistike;

- Forcimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor të burgosurve, duke përfshirë edhe kujdesin për shëndetin mendor;
- Procese të fuqizuara të rehabilitimit dhe riintegritimit të të burgosurve;
- Forcimi i sistemit të parandalimit dhe menaxhimit të ekstremizmit të dhunshëm në sistemin e burgjeve;
- Përmirësimi i shërbimit penitenciar profesional përmes trajnimeve të fokusuara dhe të vazhdueshme;
- Forcimi i mekanizmit të kontrollit të brendshëm përmes ofrimit të një mandati më të gjerë dhe kapaciteteve të përmirësuara operationale;
- Master - Plan i Burgjeve (2023 – 2028), i cili do të konsistojë në rikonfigurimin e sistemit, bazuar në hartën e re gjyqësore;
- Implementimi dhe vënia në efikasitet të plotë e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Vizitave në tërë sistemin;
- Klasifikimi progresiv i të dënuarve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, bazuar në nivelin respektiv të riskut, duke filluar nga 2023;
- Fuqizimi i strukturës së Qendrës së Trajnimit me instrumente programatikë, duke filluar nga 2023, me ekspertizën e Këshillit të Evropës;
- Ndërhyrje e optimizuar në kuadër të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit duke filluar nga 2023, me ekspertizën e Këshillit të Evropës;
- Fuqizimi i rrjetit ndër – institucional sa lidhet me asistencën post – penale, duke filluar nga 2023, me ekspertizën e Këshillit të Evropës;
- Ndërtimi i një qasjeje strategjike për komponentin e mirëqenies së stafit, duke filluar nga 2023, me ekspertizën e Këshillit të Evropës;
- Ndërhyrje e optimizuar në termat e rehabilitimit të të burgosurve, duke filluar nga 2023, me ekspertizën e Këshillit të Evropës;
- Qasja e angazhimit komunitar për integrimin e të dënuarave, projekt pilot, duke filluar nga 2024, me ekspertizën e Këshillit të Evropës.
- Vijimi i ekzekutimit të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit;
- Ekzekutimi i vendimeve të vlerësuara për komunitetet fetare nga ATP-ja;
- Trajtimi dhe shpërndarja e fondit për kompensim financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI);
- Vijimi i procesit të digjitalizimit të vendimeve, hartave dhe dosjeve të ATP-së;
- Identifikimi, verifikimi dhe pasurimi i fondit të tokës në favor të ATP-së për kompensimin e pronarëve;
- Finalizimi i proceseve në bashkëpunim me AKSHI-n të aplikimit online për të gjitha shërbimet që ofrohen në ATP;
- Informimi i qytetarëve për çështjet e kompensimit të pronave; Përditësimin e rregullt të informacionit të ATP-së, duke përfshirë informacione për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore;
- Vijimi i procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme;
- Përfundimi i Digjitalizimit të të Dhënave Ligjore (Kartela) brenda 2024;
- Zhvillimi dhe zbatimi i Planit Antikorrupsion, në kuadër të Strategjisë së re Ndërsektoriale për Luftën Kundër Korrupsionit (2023 – 2030) duke përfshirë me përfaqësues nga Ministria e

Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme, ekspertë të fushës së sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve kriminale, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile:

- 100% shërbime digjitale të ofruara përmes aplikimeve online deri në vitin 2024.
- Vlerësimi i nivelit bazë të kënaqësisë së klientit ndaj shërbimeve të ofruara nga ASHK, duke përfshirë nivelin e korrupsionit dhe transaksionet informale të pronës.

## **Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së për Kapitullin 23 të *acquis*-së “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”**

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis*-në e Bashkimit Evropian është një detyrim i cili buron prej Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Në këtë kuadër, Shqipëria vazhdon përpjekjet për të përafuar në mënyrë graduale legjislacionin e brendshëm me atë të BE, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe shtrimin e rrugës drejt BE. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Institucionit Lider për Kapitullin 23, ka parashikuar si prioritete për t’u përafuar me legjislacionin e BE-së masat ligjore të analizuara si më poshtë vijon:

Përafrimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27.04.2016 "Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave" që shfuqizon Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.

Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale përbëhet nga ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, përafuar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46/KE të Bashkimit Evropian.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) në maj të vitit 2018, lindi nevoja e përafrimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me këtë akt dhe me Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27.04.2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” që shfuqizon vendimin kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.

Edhe pse GDPR është Rregullore, kompleksiteti i saj kërkon që të ndërmerren hapat e nevojshëm për ndryshimet legjislative në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e saj me kuadrin ligjor në fuqi. Qëllimi i GDPR-së është që të mbrojtë privatësinë dhe shkeljet e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në një kohë kur përpunimi i të dhënave në kuadër të zhvillimeve teknologjike është shumëfishuar nga koha në të cilën është themeluar Direktiva e vitit 1995. Megjithatë parimet

kryesore të mbrojtjes së të dhënave janë akoma në përputhje me direktivat e mëparshme, shumë ndryshime janë propozuar për politikën rregullatore. Disa nga risitë që sjell kjo Rregullore mbi mbrojtjen e të dhënave personale janë:

- *Zgjerimi i shtrirjes territoriale të efekteve të saj ligjore:*

Ndoshta ndryshimi më i madh në peizazhin rregullator të mbrojtjes së të dhënave vjen me juridiksionin e zgjeruar të efekteve të GDPR. Më parë, aplikimi territorial i direktivës ishte i paqartë. GDPR e bën zbatueshmërinë e saj shumë të qartë. GDPR do të jetë e zbatueshme për përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit që ndodhen në vendet e BE-së, pavarësisht nëse përpunimi kryhet apo jo në këto vende.

- *Forcimi i kriterëve për dhënien e pëlqimit:*

Ka një qasje të re lidhur me konceptin e “pëlqimit” sipas GDPR-së. Në rregulloren e re trajtohen konkretisht aspektet praktike të pëlqimit dhe aspekte të tjera që lidhen me pëlqimin e të miturve ose pëlqimin me mjete elektronike.

- *Të drejtat e reja - E drejta për t’u harruar/“Right to be forgotten”:*

Kjo do të thotë që subjekti i të dhënave ka të drejtën t’i kërkojë kontrolluesit të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, pa vonesë, dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, bazuar në shkaqet e parashikuara në Rregulloren e BE-së.

- *E drejta e transferueshmërisë së të dhënave - Data Portability:*

Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë të dhëna personale që ai ose ajo i ka dhënë kontrolluesit, në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm automatikisht dhe ti transferojë ato të dhëna te një kontrollues tjetër pa pengesë.

- *Forcimi i llogaridhënies:*

GDPR sjell një forcim të llogaridhënies në raport me përpunuesit e të dhënave. Kontrolluesit janë të detyruar të tregojnë më shumë vëmendje në respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtave në çdo fazë të përpunimit të të dhënave, duke krijuar një kulturë të monitorimit, rishikimit dhe vlerësimit të procedurave të përpunimit të të dhënave apo dhe përmes rritjes së sanksioneve ndaj moszbatuesve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

- *Rritja e transparencës:*

Parimi i transparencës kërkon që çdo informacion që i drejtohet publikut ose subjektit të të dhënave të jetë konciz, i aksesueshëm lehtësisht dhe i lehtë për t’u kuptuar, dhe të përdoret gjuhë e lehtë dhe e qartë, e përveç kësaj, sipas rastit, edhe vizualizim.

- *Mbrojtja e të dhënave të fëmijëve:*

Fëmijët meritojnë mbrojtje specifike në lidhje me të dhënat e tyre personale, pasi ata mund të jenë më pak të ndërgjegjshëm për rreziqet, pasojat dhe garancitë përkatëse dhe të drejtat e tyre në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

- *Forcimi i pavarësisë së Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:*

GDPR garanton pavarësinë e plotë të Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke sugjeruar rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare.

- *Krijimi i rrjetit të Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave (DPO):*

GDPR sjell si risi detyrimin për caktimin e Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave, të cilët duhet të caktohen me qëllimin për të vlerësuar nëse një organizatë kryen një përpunim të gjerë të të dhënave personale.

- *Certifikimi i kontrolluesve – përpunuesve të mbrojtjes së të dhënave:*

Në zbatim të nenit 43 të Rregullores 2016/679, kërkohet certifikimi i kontrolluesve të mbrojtjes së të dhënave sipas kërkesës së tyre. Në këtë kuptim, autoriteti mbikëqyrës duhet të ketë krijuar kushtet e nevojshme ligjore për:

- Hartimin dhe miratimin e aktit ligjor ose nënligjor “Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”;
- Akreditimin e organit certifikues;
- Certifikimin e kontrolluesve.

Sa më sipër, qëllimi i parashikimit të këtij akti në PKIE është harmonizimi i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për mbrojtjen e të dhënave personale me praktikën më të mira të BE-së, në mënyrë që të garantohen standarde evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Sikurse vërehet, risitë që sjell rregullorja e GDPR janë të shumta. Edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e BE, si një vend që aspiron integrimin, duhet të ndjekë trendin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*.

Gjithashtu, përfrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27.04.2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” që shfuqizon vendimin kuadër të Këshillit 2008/977/JHA është aktualisht një nga prioritetet e Qeverisë

Shqiptare si një nga detyrimet e parashikuara edhe në Raportin e Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022.

Në sajë të përafrimit të legjislacionit dhe adoptimit të standardeve të reja në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” vërehet një përmirësim i konsiderueshëm qoftë i dispozitave aktualisht në fuqi dhe prezantimi i dispozitave që përbëjnë risi në legjislacionin kombëtar. Duke u ndalur te risitë që sjell ky projektligj, theksojmë:

- shtimin e kategorive të të dhënave personale sensitive ku do të përfshihen të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat për orientimin seksual, si dhe rishikimi i përkufizimeve të termave që tashmë përpunohen me ato të rregullores së BE-së;
- përfshirjen për herë të parë të rregullave mbi përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për sigurinë publike ose kombëtare dhe për parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale në kuadër të transpozimit të Direktivës së BE 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 prillit 2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”;
- zgjerimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe përmirësimi i të drejtave që ata gëzojnë aktualisht për të garantuar një kontroll më të lartë mbi të dhënat e tyre personale;
- përfshirja e detyrimeve të reja për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave për të garantuar në mënyrë më efektive sigurinë e informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale;
- përkrahimin më të hollësishëm të parimeve dhe kritereve për përpunimin e të dhënave personale që do t’i shërbejnë qartësisë dhe zbatueshmërisë së dispozitave;
- zgjerimin dhe qartësimin e kompetencave të Komisionerit;
- rishikimin e sanksioneve administrative me qëllim përpunueshmërinë me rregulloren.

Objektivat madhor të këtij projektligji janë:

- Harmonizimi me *acquis* dhe zbatimin e standardeve të BE në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke u përshtatur me sfidat e kohës dhe konceptet e reja në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- Garantimi i një niveli më të lartë kontrolli nga ana e qytetarëve mbi të dhënat e tyre personale;
- Garantimi i mbrojtjes së të dhënave personale në mënyrë sa më efektive nëpërmjet rritjes së “përgjegjshmërisë” së kontrolluesve dhe përpunuesve në procesin dinamik të përpunimit të të dhënave personale;
- Sigurimi i mbikëqyrjes efektive të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet forcimit të rolit të Zyrës së Komisionerit në cilësinë e autoritetit përgjegjës për garantimin e kësaj të drejte;
- Garantimi i një trajtimi më të mirë të mbrojtjes së të dhënave në lidhje me sfidat e reja të privatësisë që rezultojnë nga përdorimi në rritje i mjeteve teknologjike, si dhe qarkullimit gjithnjë e më të madh të të dhënave personale në botën digjitale;



- Krijimi i një kuadri ligjor gjithpërfshirës, duke garantuar edhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me përpunimin e të dhënave nga autoritetet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla;
- Heqja e pengesave ekzistuese për përfshirjen e kontrolluesve që operojnë në Shqipëri, në tregun digjital evropian dhe nxitja e rritjes ekonomike, inovacionit dhe krijimit të vendeve të punës;
- Përfshirja e Shqipërisë në listën e shteteve për të cilat Komisioni Evropian përcakton se ofron sistem të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave personale me qëllim që importimi i të dhënave personale nga BE të kryhet lehtësisht.

**Përafrimi i ligjit “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” me Direktivën 2019/1937 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 tetor 2019 për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit.**

Ligji Nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” i cili është miratua në 2 qershor 2016, ka për qëllim parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat, nxitjen e sinjalizimit të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit, si dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë këto praktika, nëpërmjet përcaktimit të rregullave të qarta që lidhen me sinjalizimin e veprimeve ose praktikave të dyshuara nga korrupsioni në sektorin publik e privat, mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e autoriteteve publike e të subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Referuar zhvillimeve të kornizës ligjore evropiane mbi mbrojtjen e sinjalizuesve, Direktiva 2019/1937 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi mbrojtjen e sinjalizuesve e cila ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2019, synon të sigurojë standarde të përbashkëta minimale të mbrojtjes në të gjithë Bashkimin Evropian për sinjalizuesit që parashtrajnë shkelje të ligjit të BE-së. Në kushtet kur ligji i brendshëm për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit është miratuar përpara Direktivës 2019/1937, lind nevoja e rishikimit të tij me qëllim garantimin e harmonizimit me standardet dhe garancitë minimale që ofron direktiva, si dhe të forcimit të mbrojtjes ekzistuese që legjislacioni ynë garanton, përmes transpozimit të saj.

Nevoja për rishikimin e këtij ligji vjen edhe në kuadër të angazhimeve dhe përpjekjeve ligjore të vazhdueshme të ndërmarra nga qeveria shqiptare për uljen në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të korrupsionit, duke rritur integritetin e institucioneve dhe duke nxitur mirëqeverisjen dhe transparencën.

**Përafrimi i legjislacionit penal me direktivat e BE-së, si pjesë e Kapitullit 23 dhe Kapitujve të tjerë të *acquis*-së**

Legjislacioni penal është një ndër fushat më të rëndësishme në kuadër të garantimit të shtetit të së drejtës. Që prej miratimit të Kodit Penal në vitin 1995 nga zbatimi praktik është vlerësuar e nevojshme përfshirja në këtë akt të një sërë elementësh të tjerë me qëllim garantimin e standardeve

ndërkombëtare dhe ofrimin e mbulimit ligjor mbi veprimtaritë e reja kriminale të cilat diktohen nga zhvillimet teknologjike, ekonomike, demografike etj.

Për plotësimin e legjislacionit të brendshëm duke e përmirësuar atë, por edhe në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër për integrimin e saj në Bashkimin Evropian është vlerësuar se në disa fusha kyçe duhet të ndërmerren masa ligjore për përafrimin me standardet ndërkombëtare dhe *acquis* e Bashkimit Evropian.

Aktualisht në fokus të së drejtës penale, për shkak edhe të zhvillimeve globale, janë lufta kundër pastrimit të parave, lufta kundër terrorizmit, mbrojtja e interesave financiare, lufta kundër terrorizmit, ndalimi i trafikimit të narkotikëve dhe qenieve njerëzore, lufta kundër racizmit dhe ksenofobisë, veprave penale që kryhen nëpërmjet sistemeve kompjuterike, si dhe lufta kundër mashtrimit nëpërmjet instrumenteve të pagesave. Në këtë kuadër, aktet e Bashkimit Evropian që lidhen me këto fusha, do të jenë prioritet për t'u parashikuar në Kodin Penal me qëllim përafrimin e tyre, në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Me anë të këtij Plani Kombëtar të Integritimit Evropian, synohet përafrimi i Kodit Penal dhe ligjit Nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, të ndryshuar, me Direktivat e BE-së, të cilat janë pjesë e Kapitujve 23, 24, 19 dhe 17 të *acquis*, si më poshtë:

- Direktiva 2017/1371<sup>32</sup> “Mbi luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit Evropian”;
- Direktiva 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi luftën kundër terrorizmit”;<sup>33</sup>
- Direktiva 2015/849, ndryshuar nga Direktiva 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare me qëllim pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit”;<sup>34</sup>
- Direktiva 89/654 e Këshillit të BE-së “Mbi vendosjen e masave minimum të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”;<sup>35</sup>
- Direktiva 89/391 e Këshillit të BE-së “Mbi nxitjen e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në ambientet e punës”;<sup>36</sup>
- Direktiva 2011/93/BE “Mbi luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve”;<sup>37</sup>
- Direktiva 2014/62/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian “Për mbrojtjen nga ligji penal të Euros dhe monedhave të tjera kundër falsifikimit”;<sup>38</sup>
- Direktiva 2014/42/BE “Mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve/të ardhurave të krimeve të kryera në Bashkimin Evropian”;<sup>39</sup>

---

<sup>32</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 23.

<sup>33</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

<sup>34</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 23.

<sup>35</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 19.

<sup>36</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 19.

<sup>37</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

<sup>38</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

<sup>39</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 23.

- Direktiva 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”;<sup>40</sup>
- Direktiva “Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA<sup>41</sup> i 25 Tetorit 2004 që përcakton dispozitat minimale mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe ndëshkimeve në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës”;
- Direktiva 2019/713/BE<sup>42</sup> e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi luftën kundër mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesave jo në të holla, e cila zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/413;
- Direktiva 2013/40/BE<sup>43</sup> e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi sulmet kundër sistemeve informatike, e cila zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2005/222;
- Vendimi Kuadër 2008/913<sup>44</sup> mbi luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë nëpërmjet mjeteve kriminale.

Lidhur me përafrimin e **Direktivës 2017/1371** mbi luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit Evropian”, është e nevojshme që Kodi Penal të inkriminojë cenimin e interesave financiarë të Bashkimit Evropian nëpërmjet mashtrimit. Gjithashtu përafrimi duhet të bëhet edhe në drejtim të përcaktimit të dënimeve shtesë për personat juridike përgjegjës për veprat penale që lidhen me mashtrimin ndaj interesave financiare të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, në legjislacionin penal duhet të garantohen standardet e vendosura nga BE nëpërmjet **Direktivës 2017/541** të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi luftën kundër terrorizmit, duke njehsuar terminologjinë e përdorur, si dhe duke zgjeruar anën objektive të veprave penale terroriste edhe për sa u përket:

- i. sulmeve ndaj integritetit fizik të personit;
- ii. shkatërrimit të një platforme fikse të vendosur në shelfin kontinental, një vendi publik ose privat që mund të rrezikojë jetën e njeriut ose të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike;
- iii. ndërhyrjes së paligjshme në sistemet apo të dhënat,
- iv. vjedhjes së rëndë me qëllim kryerjen e veprave penale terroriste;
- v. zhvatjes me qëllim kryerjen e veprave penale terroriste;
- vi. hartimit ose përdorimit të dokumenteve të rreme administrative me qëllim kryerjen e veprave penale terroriste.

Po ashtu, nevojitet shtimi i veprave penale të udhëtimit me qëllime terroriste dhe lehtësimi apo organizimi i udhëtimit me qëllim kryerjen e veprave terroriste.

Përafrimi i Kodit Penal duhet të bëhet edhe me **Direktivën 2015/849**, ndryshuar nga Direktiva 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare me qëllim pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, duke i dhënë një përkufizim

<sup>40</sup> Direktive e përfshirë në Kapitullin 24.

<sup>41</sup> Direktive e përfshirë në Kapitullin 24.

<sup>42</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

<sup>43</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

<sup>44</sup> Direktivë e përfshirë në Kapitullin 23.

të unifikuar veprimtarisë së “*pastrimit të parave*” për të qenë në përputhje me parashikimin e Direktivës dhe standardeve evropiane

Në legjislacionin e brendshëm ka lindur nevoja për ofrimin e një mbrojtjeje më të gjerë edhe lidhur me mbrojtjen e subjekteve në vendin e tyre të punës. Rrjedhimisht, **Direktiva 89/654** të Këshillit të BE-së “Mbi vendosjen e masave minimum të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, si dhe **Direktiva 89/391** të Këshillit të BE-së “Mbi nxitjen e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në ambientet e punës” konsiderohet si akte me rëndësi në kuadër të përmirësimit të legjislacionit me qëllim mbrojtjen e shëndetit në ambientin e punës dhe parandalimin e rasteve të cilat mund të cenojnë sigurinë, shëndetin dhe jetën gjatë kryerjes së punës.

Në Kodin Penal është diktuar një përafrim i plotë me **Direktivën 2011/93/EU** mbi luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, për shkak të problematikave lidhur me veprave penale kundër integritetit seksual. Direktiva ofron një kornizë ligjore më të detajuar lidhur me ndëshkimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve duke parashikuar nevojën për kriminalizimin e figurës së tërheqjes dhe angazhimit dhe ekspozimit të fëmijëve ndaj akteve seksuale pa pasur nevojën e asistimit në veprimtarinë seksuale, përfshirjen në veprimtari seksuale etj. Masat e dënimit në Kodin Penal duhet gjithashtu të rishikohen në përputhje dhe në frymën e Direktivës. Direktiva parashikon edhe inkriminimin lidhur me shtrëngimin, detyrimin ose kërcënimin e një fëmije në aktivitete seksuale me një palë të tretë, si dhe blerjes së materialeve pornografike të fëmijëve, elementë këta të cilët mungojnë në legjislacionin penal të brendshëm.

Duke i paraprirë integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka lindur nevoja për të parashikuar në legjislacionin e brendshëm penal norma juridike mbi mbrojtjen e monedhës Euro dhe monedhave të tjera, sipas parashikimeve apo standardeve të vendosura nga **Direktiva 2014/62/EU** e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mbrojtjen nga ligji penal të Euros dhe monedhave të tjera kundër falsifikimit. Direktiva kërkon që shtetet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që sjelljet në vijim të dënohen si vepër penale, kur kryhen me dashje:

- i. importimi, eksportimi, transportimi, mbajtja e monedhës së falsifikuar kur subjekti ka dijeni se është e falsifikuar;
- ii. instrumente, artikuj, programe kompjuterike dhe të dhëna, dhe çdo mjet tjetër i përshtatur posaçërisht për falsifikimin ose ndryshimin e monedhës;
- iii. karakteristikat e sigurisë, të tilla si hologramet ose përbërës të tjerë të monedhës që shërbejnë për të mbrojtur nga falsifikimi, etj.

Në kuadër të luftës së krimit të organizuar dhe veprave penale të tjera të rënda, të cilat prodhojnë të ardhura, është vlerësuar me rëndësi përafrimi i **Direktivës 2014/42/EU** mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve/të ardhurave të krimeve të kryera në Bashkimin Evropian, me qëllim krijimin e një kuadri të plotë ligjor i cili gjen aplikim në rastet e kryerjes së veprave penale në BE të cilat gjenerojnë të ardhura. Në përafrimin e kësaj Direktive në legjislacionin penal duhet mbajtur në vëmendje terminologjia e parashikuar në Direktivë, e cila diferencon nga terminologjia e

përdorur në legjislacionin e brendshëm, me qëllim konsolidimin e instituteve në mënyrë të qartë dhe të unifikuar.

Lufta ndaj trafikut të qenieve njerëzore ka qenë dhe vijon të mbetet prioritet për institucionet ligjzbatuese dhe organet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, është e domosdoshme përfshirja në ligjin e brendshëm të parashikimeve të **Direktivës 2011/36** mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre, pasi kjo direktivë vendos një standard minimal rregullash që lidhen me përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikut të qenieve njerëzore. Direktiva paraqet gjithashtu dispozita duke marrë parasysh perspektivën gjinore për të forcuar parandalimin e këtij krimi dhe mbrojtjen e viktimave të tij, si dhe përcakton rrethana rënduese mbi subjekte të caktuar.

Po ashtu, Direktiva përcakton detyrime shtesë për të ofruar ndihmë ndaj viktimave të trafikut, për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të krimit të trafikut të qenieve njerëzore dhe për kompensimin e tyre.

Gjithashtu, në kuadër të integritimit evropian të Shqipërisë, ka lindur nevoja për të parashikuar në ligjin e brendshëm penal rregulla juridike mbi dënimet ku vepra përfshin sasi të mëdha droge, si dhe rastet kur vepra përfshin droga të dëmshme për shëndetin ose ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në shëndetin e një numri personash, sipas parashikimeve apo standardeve të vendosura nga **Direktiva 2004/757/BE** për vendosjen e rregullave minimum mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikimit të drogës. Direktiva kërkon që shtetet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që dënimet e parashikuara nga shtetet anëtare duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese dhe të përfshijnë edhe dënime me privim të lirisë. Për të përcaktuar nivelin e dënimeve, duhet të merren në konsideratë elemente faktike, si p.sh. sasi të dhe llojet e drogave të trafikuar, si dhe fakti nëse vepra është kryer në kuadër të një organizate kriminale.

Në vijim të procesit për plotësimin e kuadrit ligjor lidhur me veprat penale kundër sistemeve informatike, vlerësohet me rëndësi plotësimi i elementëve shtesë të parashikuar nga **Direktiva 2013/40** e cila vendos rregulla minimum mbi veprat penale, sanksionet dhe masat për parandalimin e sulmeve kundër sistemeve informatike. Republika e Shqipërisë ka bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm Konventën kundër krimit kibernetik, mirëpo elementë të caktuar të parashikuar në Direktivë nuk gjejnë rregullim në legjislacionin penal. Ndodhur në kushtet e zhvillimeve teknologjike dhe digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve publike dhe private, mbrojtja e sistemeve informatike aktualisht përbën një prioritet qeveritar.

Zhvillimet ekonomike dhe teknologjike në ditët e sotme ecin me ritme tepër të shpejta duke sjellë instrumente dhe mjete inovative të cilat shpesh nuk gjejnë trajtim dhe mbulim nga legjislacioni penal. Në kuadër të analizës mbi rishikimin e legjislacionin penal, vlerësohet imediate nevoja për përaftrimin e Kodit Penal me **Direktivën 2019/713/BE** e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi luftën kundër mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesave jo në të holla. Direktiva jep përkufizimin dhe kuptimin e instrumenteve të pagesave në mënyrë të qartë duke shmangur keqinterpretime në praktikë lidhur me zbatueshmërinë e ligjit penal. Ndërkohë që në legjislacionin

e brendshëm mungojnë një sërë elementësh lidhur me inkriminimin e falsifikimit të instrumenteve të pagesave jo në të holla (*jo cash*) si dhe përdorimin e tyre.

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave themelore dhe integritetit personal, në legjislacionin penal është vlerësuar mangësi në raport me **Vendimin Kuadër 2008/913** mbi luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë nëpërmjet mjeteve kriminale, vendim ky i cili parashikon mënyrat e kryerjes së thirrjeve të urrejtjes dhe akteve raciste dhe ksenofobike. Si rrjedhim, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë duhen bërë amendimet përkatëse, me qëllim plotësimin e dispozitave që ndëshkojnë aktet e racizmit dhe ksenofobisë.

### **Përafrimi i legjislacionit penal me direktivat e BE-së, si pjesë e Kapitullit 23 lidhur me mbrojtjen e të drejtave procedurale dhe mbrojtjen e viktimave të krimeve të dhunshme.**

Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave themelore, të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i jepet një vëmendje e posaçme përafrimit të legjislacionit penal me aktet e Bashkimit Evropian lidhur me të drejtat procedurale të subjekteve në procesin penal, në kuadër të respektimit të parimit për një proces të rregullt.

Të drejtat procedurale përfshijnë të drejtën për t'u informuar, të drejtën për t'u ndihmuar nga një avokat, të drejtën për ndihmë juridike falas, të drejtën për t'u ndihmuar nga një përkthyes ose interpret, të drejtën për mjete juridike efektive dhe për gjykim të drejtë, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën e mbrojtjes, parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të veprave penale dhe dënimeve si dhe të drejtën për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale.

Legjislacioni shqiptar garanton edhe në Kushtetutë të njëjtat të drejta, të rregulluara kryesisht nga nenet 27 deri në 34. Gjithashtu, këto të drejta rregullohen në mënyrë të detajuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, si dhe legjislacione të tjera të fushës.

Kodi i Procedurës Penale i është nënshtruar një reforme të gjerë në vitin 2017 në kuadër të reformës në drejtësi dhe ka përmirësuar ndjeshëm pozitën juridike të personave të dyshuar apo të akuzuar lidhur me të drejtat e tyre ligjore. Megjithatë, elementë të caktuar nuk gjejnë trajtim të plotë në raport me *acquis* e Bashkimit Evropian. Një nga mangësitë kryesore është terminologjia e përdorur e cila duhet të përqaset dhe unifikohet me parashikimet e akteve të Bashkimit Evropian.

Me anë të këtij Plani Kombëtar të Integritetit Evropian, synohet përafrimi i Kodit të Procedurës Penale, ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ligjit Nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, si dhe ligjit Nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar, me Direktivat e BE-së, pjesë e Kapitullit 23 të *acquis*, si më poshtë:

- Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal;

- Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procesin penal;
- Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi të drejtën e aksesit ndaj një avokati në procesin penal dhe procedurat e urdhrimit evropian të arrestit dhe për të drejtat e një pale të tretë që ka informuar privimin e lirisë dhe komunikimin me të tretët dhe me autoritete konsullore në rastet që i është hequr liria;
- Direktiva 2016/343/BE për forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim;
- Direktiva 2016/800/BE mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar dhe të akuzuar në procesin penal;
- Direktiva 2016/1919/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 për ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurën e arrestit evropian.

**Direktiva 2010/64/BE (27/10/2013)** mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit garanton të drejtën e çdo personi të dyshuar apo të akuzuar për një vepër penale, për tu asistuar nga një interpret apo përkthyes. Direktiva përfshin procedura dhe mekanizma për të konstatuar nëse personi i dyshuar ose i akuzuar flet dhe kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedimit, asistencën e përkthyesit gjatë komunikimeve me mbrojtësin, përkthimin e dokumenteve të caktuara të cilat kanë rëndësi të posaçme për ecurinë e procesit penal, si dhe kontrollin e cilësisë së përkthimit. Jo të gjitha parashikimet e Direktivës gjejnë trajtim në legjislacionin e brendshëm penal, rrjedhimisht është vlerësuar nevoja për përafrimin e këtij akti kryesisht në Kodin e Procedurës Penale, si akti juridik kryesor që rregullon procedimin penal, si dhe në akte të tjera, siç është ligji që rregullon profesionin e përkthyesit.

Ndryshimet e bëra në vitin 2017 në Kodin e Procedurës Penale i kanë dhënë garanci shtesë personat të dyshuar, të arrestuar apo të akuzuar lidhur me të drejtën e informimit. Letra e të drejtave është një nga instrumentet thelbësor të fillimit të procedimit penal në momentin kur personi merr statusin e personit nën hetim, personit të pandehur apo në rastet e arrestit e të ndalimit. Megjithatë **Direktiva 2012/13/BE** mbi të drejtën e informimit në procesin penal nuk është plotësisht e përafuar në Kodin e Procedurës Penale. Kjo Direktivë parashikon të drejtën për tu informuar në lidhje me të drejtat themelore procedurale ku përfshihen e drejta për të pasur mbrojtës, e drejta për ndihmë juridike falas, e drejta për t'u informuar për akuzën, veprën penale konkrete dhe personat e dyshuar, e drejta për t'u asistuar nga një interpret dhe përkthyes, marrja e letrës së të drejtave, informimi mbi, si dhe e drejta për t'u njohur me materialet e çështjes. Të gjithë këto elementë gjejnë trajtim në legjislacionin e brendshëm por terminologjia e përdorur nuk ofron mbulim për secilën nga parashikimet e Direktivës. Rrjedhimisht, në kuadër të garantimit të të gjitha të drejtave që lidhen me zhvillimin e procesit të rregullt penal, është e nevojshme që Direktiva të përafrohet në mënyrë të plotë dhe të saktë në legjislacionin e brendshëm.

E drejta për të pasur një mbrojtës është një nga të drejtat themelore që ka çdo person në Republikën e Shqipërisë e cila parashikohet edhe në nenin 28 dhe 31 të Kushtetutës. Mirëpo nga vlerësimi i kryer, **Direktiva 2013/48/BE** e cila vendos rregulla të posaçme mbi të drejtën e aksesit ndaj

mbrojtësit në procesin penal, nuk është plotësisht e përafuar në legjislacionin procedural penal. Direktiva përfshin të drejtën e aksesit ndaj një avokati gjatë marrjes në pyetje, mbledhjen e provave, heqjen e lirisë, gjatë procedurave të Urdhrit Evropian të Ndalimit, të drejtën për të komunikuar me anëtarët e familjes, të afërmit dhe autoritetet konsullore për personat në paraburgim. Në Kodin e Procedurës Penale parashikohen një sërë rregullash mbi praninë e detyrueshme të mbrojtësit, në kuadër të vlefshmërisë së veprimeve procedurale dhe provave të marra por vlerësohet se përputhshmëria me Direktivën nuk është e plotë.

Një nga mangësitë kryesore aktualisht në legjislacionin penal është mungesa e rregullimi të Urdhrit Evropian të Ndalimit. Pavarësisht se shteti Shqiptar nuk është ende një vend anëtar i Bashkimit Evropian, ndërhyrja në legjislacionin penal që rregullon marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale është e nevojshme për plotësimin e kuadrit juridik.

**Direktiva 2016/343/BE** për forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim është një nga aktet me të rëndësishme e cila vendos rregullat bazë mbi zhvillimin e procesit penal. Në kuadër të procesit të rregullt penal në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar rregulla të posaçme lidhur me të drejtën për t'u konsideruar i pafajshëm deri në një vendim penal të formës së prerë, caktimin e një dënimi vetëm përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, përcaktimin e barrës së provës fajësuese dhe shfajësuese mbi organin e akuzës, të drejtën për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten, të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim si dhe të drejtën e rigjyqimit. Mosrespektimi i rregullave që lidhen me këto të drejta çon në pavlefshmëri të procesit, ndaj mbrojtja që i ofrohet personit të dyshuar apo akuzuar në këto raste është e një rëndësie themelore. Megjithatë, disa elementë nuk gjejnë në mënyrë të shprehur trajtim në Kodin e Procedurës Penale, siç është ndalimi i bërjes së referencave publike mbi fajësinë e personit pa u caktuar më parë një vendim penal i formës së prerë dhe marrja e masave për heqjen e tyre.

**Direktiva 2016/800/BE** mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar dhe të akuzuar në procesin penal parashikon të drejtën për asistencën nga një mbrojtës, për dhënien e informacionit në mënyrë të përshtatshme, kryerjen vlerësimin individual në çdo rast, të drejtën për asistencë dhe ekzaminim mjekësor, mbajtjen e regjistrimit audio-vizual gjatë procesit të marrjes në pyetje, masat në rast të privimit të lirisë, të drejtën për mbrojtjen e privatësisë si dhe kryerjen e trajnimeve të posaçme për personat që punojnë me fëmijët. Në legjislacionin e brendshëm këto rregulla gjejnë kryesisht trajtim në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, i vili është miratuar në vitin 2017 dhe përmban një sërë parashikimesh në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare lidhur me fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Por, legjislacioni penal procedural duhet të rishikohet në disa aspekte që lidhen kryesisht me terminologjinë e përdorur, kontrollin mjekësor të të miturve, qëndrimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe mjeteve për rivendosjen/riparimin e të drejtave të shkelura. Gjithashtu, një element i cili nuk gjen trajtim është mungesa e rregullimi të Urdhrit Evropian të Ndalimit. Ndërhyrja në legjislacionin penal që rregullon marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale është e nevojshme për plotësimin e kuadrit juridik.



**Direktiva 2016/1919/BE** për ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurën e arrestit evropian parashikon të drejtën për ndihmën juridike falas në procesin penal dhe në procedurat e Urdhrit Evropian të Ndalimit, vendimet në lidhje me dhënien e ndihmës juridike si dhe cilësinë e dhënies së ndihmës juridike falas dhe trajnimet për punonjësit e organeve të drejtësisë për aplikimin e kësaj të drejtë dhe personave që ofrojnë ndihmën juridike falas, në kuadër të rritjes së cilësisë së ofrimit të shërbimit. Ligji për ndihmën juridike falas është miratuar në Republikën e Shqipërisë në vitin 2018 dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, e cila administron, procesin e dhënies së ndihmës juridike, është plotësisht funksionale.

Mirëpo, referuar legjislacionit të brendshëm mbrojtja e ofruar nga shteti për personin që i atribuohet vepra penale, personin nën hetim dhe të pandehurit, garantohet vetëm në rastet kur nuk këta persona nuk kanë mjete financiare për të pasur mbrojtës të zgjedhur ose nëse mbrojtja është e detyrueshme. Në ligj nuk parashikohet e drejta për të kërkuar ndihmë juridike falas nëse një gjë e tillë është në interes të drejtësisë. Po kështu, legjislacioni i brendshëm nuk rregullon në mënyrë specifike rastet e pamundësisë së pjeshme financiare të subjektit në fjalë për përballimin e shpenzimeve të mbrojtjes.

Gjithashtu, duke qenë se Direktiva mbi Urdhrin Evropian të Ndalimit nuk është transpozuar në legjislacionin kombëtar, parashikimet që lidhen me zbatimin e këtij instrumenti nuk gjejnë zbatim edhe në këtë rast.

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimeve të dhunshme, qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë masash ligjore, administrative dhe sociale me qëllim përmirësimin e pozitës së viktimave jo vetëm gjatë procesit penal por edhe jashtë tij, në kuadër të trajtimit rehabilitues për shkak të pasojave të krijuara nga vepra penale. Viktimave të krimit duhet të t'ju krijohet akses dhe mbështetje në çdo fazë të procedimit penal si dhe pas përfundimit të procesit. Ndër aktet kryesore të Bashkimit Evropian lidhur me parashikimin e të drejtave të viktimave të krimit janë:

- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA;
- Direktiva 2004/80/KE e 29 Prill 2004 mbi kompensimin e viktimave të krimit;
- Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi Urdhrin e Mbrojtjes Evropiane.

*Acquis* në këtë fushë kryesisht përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe siguron që personat që kanë rënë viktimave të krimit të njihen dhe trajtohen me respekt. Ata gjithashtu duhet të marrin mbrojtjen, mbështetjen dhe aksesin e duhur në drejtësi.

Direktiva 2012/29 është pjesa më e rëndësishme e *acquis* të BE-së në fushën e të drejtave të viktimave të krimit, i cili është një instrument horizontal që parashikon të drejtën për informacion, mbrojtje, mbështetje dhe akses në drejtësi të gjitha viktimave dhe familjeve të për të gjitha krimet.

*Acquis* forcon në mënyrë të konsiderueshme të drejtat e viktimave dhe anëtarëve të familjeve të tyre për informacion, mbështetje dhe mbrojtje si dhe të drejtat procedurale të viktimave në procedimet penale. Gjithashtu, shteti duhet të sigurojë trajnimet e duhura për nevojat e viktimave për ata punonjës që bien në kontakt me viktimat.

Nëpërmjet Direktivës 2004/80 synohet mbështetja e viktimave të dhunshme nëpërmjet kompensimin e viktimave të krimit nëpërmjet skemave dhe fondeve të posaçme me qëllim dhënien e ndihmës për viktimën për të tejkaluar pasojat e shkaktuara nga vepra penale e kryes.

Po kështu, Direktiva 2011/99 përcakton rregullat sipas të cilave mbrojtja që rrjedh nga disa masa mbrojtëse të miratuara sipas ligjit të një Shteti Anëtar mund të shtrihet në një Shtet tjetër Anëtar në të cilin personi i mbrojtur vendos të banojë ose të qëndrojë.

Megjithatë, ka një sërë aktesh të tjera të cilat në mënyrë të tagente parashikojnë edhe masa shtesë mbi trajtimin e viktimave të krimit ku përfshihet direktiva për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, direktiva kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual etj.

Nisur nga fakti se trajtimi i viktimave të krimit është një terren i cili ndërthur së bashku të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, organet ligjzbatuese, organet përgjegjëse për trajtimin mjekësor, psikologjik dhe social, punësimin, rivendosjes së drejtave ekonomike etj, vlerësohet se rishikimi i kuadrit ligjor dhe marrja e masave përkatëse, si dhe mbikëqyrja e tyre mund të arrihet më mirë nëpërmjet një procesi ndërsektorial me miratimin e një strategjie për mbrojtjen e viktimave të krimit.

Me qëllim përafrimin e akteve të Bashkimit Evropian që përmbajnë masa apo mekanizma për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të krimit institucionet përgjegjëse shtetërore, në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse dhe shoqërinë civile duhet të ofrojnë ekspertizën e tyre për përcaktimin e objektivave dhe përmbushjen e tyre për të krijuar jo vetëm një kuadër ligjor të plotë e miqësor për viktimat e krimit por edhe një ambient të qëndrueshëm miqësor e socializues për këto viktime.

## KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA

### 24.1 Përmbajtja e kapitullit

Politikat e BE-së kanë për qëllim të zhvillojnë më tej Bashkimin Evropian si një fushë lirie, sigurie dhe drejtësie. Për çështje të tilla si: kontrolli kufitar, vizat, migrimi i jashtëm, azili, bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave financimit të terrorizmit dhe lufta kundër terrorizmit, bashkëpunimi në fushën e drogës, bashkëpunimi doganor ,bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale dhe civile, shtetet anëtare duhet të jenë të pajisura në mënyrën e duhur

për të zbatuar në mënyrë të përshtatshme kuadrin në rritje të rregullave të përbashkëta. Mbi të gjitha, kjo kërkon një kapacitet administrativ të fuqishëm dhe të integruar brenda agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera relevante, të cilat duhet të arrijnë standardet e nevojshme. Një polici profesionale e organizuar mirë, e besueshme dhe efikase është me rëndësi të madhe. Pjesa më e detajuar e politikave të BE-së për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë është *acquis* e Schengen-it. Gjithsesi për Shtetet e reja Anëtare, pjesa thelbësore e “*acquis*” së Schengenit, janë implementuar duke ndjekur një Vendim më vete të Këshillit, të marrë pas hyrjes së tij në fuqi.

## 24.2 Struktura e kapitullit

1. Lufta kundër krimit të organizuar
2. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës
3. Lufta kundër terrorizmit
4. Migracioni i rregullt dhe i parregullt
5. Azili
6. Politika e vizave
7. Kufijtë Schengen dhe Kufijtë e Jashtëm
8. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale
9. Bashkëpunimi Doganor (shih Kapitullin 29)
10. Mbrojtja e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)

## 24.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë të drejtën e saj kombëtare me *acquis* të BE-së. Bashkëpunimi në fushën e menaxhimit të kufijve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenin 80 të MSA-së. Në vazhdim, bashkëpunimi në fushën e migracionit midis Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenet 4, 80 dhe 81 të MSA, ndërsa bashkëpunimi në fushën e politikës së vizave dhe azilit parashikohet në nenin 80 të MSA.

Neni 80 përcakton që puna duhet përqendruar në zbatimin e legjislacionit të brendshëm për të përmbushur standardet e Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967, për të siguruar respektimin e parimit të moskthimit të individit në vendin që përbën një kërcënim për jetën e tij, si dhe të drejta të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Zhvillimet në fushën e bashkëpunimit policor dhe luftën kundër krimit të organizuar midis Republikës së Shqipërisë dhe BE-së janë parashikuar në nenet 4, 82, 84 dhe 85 të MSA. Nenet 4 dhe 85 të MSA-së parashikojnë bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe BE-së në luftën kundër trafikimit të paligjshëm. Më tej, nenet 4 dhe 82 të MSA-së parashikojnë bashkëpunim në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, në nenet 5, 82 dhe 84 MSA,

parashikohet bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe BE-së në luftën kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të MSA-së parashikojnë bashkëpunimin në luftën kundër drogës. Detyrimet në fushën e bashkëpunimit në çështjet penale është përcaktuar në nenin 85 të MSA-së.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë rregullohet në Titullin V të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (nenet 67-89). Për më tepër, Karta e të Drejtave Themelore është bërë e detyrueshme. Protokollin 36 i Traktateve Themelore rregullon statusin e legjislacionit përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, i cili ishte miratuar nën kuadrin e Shtyllës së Tretë së mëparshme të Bashkimit Evropian. Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë përfshin legjislacionin dytësor në fushat kryesore: Migracioni, Vizat dhe Azili; Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale; dhe Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Civile. Dy fushat e para dominohen nga direktivat dhe vendimet kornizë, ndërkohë që këto të fundit përmbajnë direktiva të zbatueshme drejtpërdrejt. Legjislacioni primar dhe sekondar plotësohet nga një vëllim i madh i jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

#### 24.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje/është mesatarisht e përgatitur për të zbatuar *acquis* të BE-së në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Ka një lloj progres në tërësi. Strukturat e Specializuara kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) po ndërtojnë një historik të dhënash/track-record fillestar të rasteve të zbatimit të ligjit dhe zbatimi i Planit të Veprimit të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) ka përparuar ndjeshëm. Track-record-i për pastrimin e parave dhe niveli i lartë i rasteve të korrupsionit mbeten të pamjaftueshme, hetimet financiare duhet të zhvillohen më tej dhe Plani i Veprimit FATF duhet të përfundojë. Shqipëria ka vazhduar angazhimin e saj pozitiv me të gjitha agjencitë e drejtësisë dhe të punëve të brendshme të BE-së. Nuk është bërë progres në referimin në procedurën e azilit dhe zbatimin e procedurave të kthimit në përputhje me kuadrin ligjor. Numri i kërkesave për azil të paraqitura nga shtetasit shqiptarë në shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e lidhura me Schengenin mbetet më i ulët se niveli para pandemisë, por është rritur që nga vera e vitit 2021, dhe për këtë arsye kërkon ende përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Shqipëria duhet të vazhdojë të trajtojë fenomenin e të miturve të pashoqëruar. Politika e vizave e Shqipërisë duhet të përafrohet me atë të BE-së. Meqenëse është bërë një përparim i pjesshëm me rekomandimet e Komisionit të vitit 2021, ato mbeten ende për tu plotësuar.

#### ***Lufta kundër krimin të organizuar***

Vendi ka një nivel përgatitjeje në zbatimin e *acquis* të BE-së në këtë fushë. Është bërë një lloj progresi në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të kaluar. Bashkëpunimi me shtetet anëtare të BE-së, Europolin dhe Eurojust-in ka vijuar të jetë i suksesshëm. Shqipëria vazhdoi të tregojë angazhim për të luftuar prodhimin dhe trafikimin e kanabisit. Është bërë përparim i mirë në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të lidhura me krimin e organizuar që duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Përpjekjet gjithashtu duhet të vazhdojnë për të siguruar rritje të ndjekjeve

penale dhe dënimeve përfundimtare, veçanërisht në nivele të larta. Lufta kundër krimit kibernetik, trafikimi i qenieve njerëzore dhe pastrimi i parave mbeten fusha në të cilat nevojiten rezultate shtesë. Të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet duhet të hetohen.

Shkëmbimi i informacionit cilësor dhe operacionet e përbashkëta policore që përfshijnë partnerë ndërkombëtarë janë intensifikuar, njësitë e përbashkëta hetimore, (JIU) dhe ditët e veprimit të përbashkët (*JIT- Joint investigation Team*) me vendet e BE-së dhe më gjerë.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të mëtijshëm për të forcuar bashkëpunimin policor ndërkombëtar. Vlen të theksohet se bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë me të gjitha shtetet, kryesisht bashkëpunimi ka konsistuar në shkëmbimin e informacioneve policore në fushat e hetimit të veprave penale për narkotikët, trafiqet e paligjshme, pastrim parash, krimin ekonomik e financiar, krimin kompjuterik dhe krimeve të rënda, veprave panele në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale dhe krimet mjedisore , ku informacioni është shkëmbyer kryesisht nëpërmjet kanaleve të Interpol, Europol (nëpërmjet kanalit komunikimit SIENA) dhe oficerëve ndërlidhës policor, Rrjetit CARIN, Zyrës së Interforcës, oficerëve të kontaktit etj. Oficeri ndërlidhës i Europol i vendosur në Tiranë që nga qershori 2019, ka ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe forcave policore të Shteteve Anëtare të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar. Shqipëria ka një oficer ndërlidhës të vendosur në selinë e Europol në Hagë, si dhe një Prokuror në Eurojust.

Bashkëpunimi me Interpolin ka vazhduar të japë rezultate pozitive. Shqipëria merr pjesë në gjashtë aktivitete prioritare të EMPACT në kuadër të ciklit të politikave të BE-së.

Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policë së Shtetit Nr. 208, datë 21.02.2022, është miratuar dokumenti “Rregullat dhe Procedurat për funksionimin e ZQK INTERPOL Tirana” si dhe Procedurat Standarde të Punës për Funksionimin e ZQK INTERPOL Tirana.

Me Ligjin Nr. 17/2022 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në plotësim të Konventës Evropiane për Ekstradimin e vitit 1957”, ka hyrë në fuqi kjo marrëveshje në Maj 2022 dhe janë ndjekur me përparësi dosjet e personave në kërkim ndërkombëtar (shtetas shqiptarë), të shpallur në kërkim nga autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Spanjës.

Ministria e Brendshme ka nënshkruar Udhëzimin e Përbashkët Nr. 209/4, datë 12.07.2022, me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, “Për Shpalljen në Kërkim Ndërkombëtar”.

Nga Policia e Shtetit janë shfrytëzuar me efikasitet shërbimet që ofron INTERPOL-i, dhe produktet analitike të projekteve të EUROPOL-it. Gjithashtu, me qëllim parandalimin dhe hetimin veprave penale, janë shkëmbyer dhe përdorur të gjitha informacionet dhe produktet e dërguara nga EUROPOL dhe INTERPOL.

Polica e Shtetit është anëtarësuar në 18 (nga 30) Projekte Analitike, të EUROPOL - një sistem i përpunimit të informacionit, që lidhet me luftën kundër krimit të organizuar, kultivimin dhe trafikimin e drogës, terrorizmin islamik, luftën kundër krimit kibernetik, abuzimin me fëmijët përmes internetit, kontrabandën e migrantëve, trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimin e parave etj.

Polica e Shtetit, si një partner i besueshëm i Europol, është pjesë e shumë operacioneve të koordinuar nga Europol dhe të organizuara në kuadrin e EMPACT si dhe pjesëmarrëse në 11 prioritetet e EMPACT (nga 16).

Është miratuar baza ligjore e nevojshme për shtesën organike për funksionin e oficerit ndërlidhës në Hagë-Holandë dhe Madrid-Spanjë. Aktualisht është në proces dërgimi i një oficeri të dytë ndërlidhës në selinë e Europol-it në Hagë dhe një oficeri ndërlidhës në Madrid-Spanjë, Gjithashtu pritet të miratohet, projektligji për ndryshimet në ligjin për Policinë e Shtetit, lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar, dhe konkretisht përdorimin e përbashkët të oficerëve ndërlidhës jashtë shtetit.

Në funksion të programeve të mbrojtjes së dëshmitarit, është forcuar bashkëpunimi ndërkombëtar me të gjitha shtetet me të cilat ka marrëveshje të nënshkruara. Aktualisht Shqipëria ka të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi me 7 vende të BE-së.

Janë nënshkruar dy marrëveshje midis Policisë së Shtetit Shqiptar, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe midis Policisë së Shtetit Shqiptar - Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, “Për Dhënien e të Drejtës së Aksesit në Sistemin Elektronik “Siena”, si dhe janë kryer lidhjet e sigurta të komunikimit me këto agjenci, të cilat aktualisht kanë përdorues aktiv të SIENA.

Ligji për armët është pjesërisht i përafuar me dispozitat e BE -së. Shqipëria ndryshoi më tej këtë ligj në dhjetor 2020, duke transferuar një pjesë të kuadrit rregullator të BE-së në legjislacionin e saj kombëtar. Ligji Nr. 152/2020, datë 17.12.2020 është përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”, me Direktivën (BE) 2017/853 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 Maj 2017 që ndryshon Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991, “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve” dhe Rregulloren nr. 258/2012 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 mars 2012, në zbatim të nenit 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara Kundër Prodhimit dhe Trafikimit të Paligjshëm të Armëve të Zjarrit, Pjesëve Përbërëse të tyre dhe Municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara të Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokolli i Armëve të Zjarrit të KB), dhe përcakton autorizimin e eksportit, dhe masat e importit dhe transitit për armët e zjarrit, pjesët përbërëse të tyre dhe municionet.

Janë miratuar 11 aktet në zbatim të ligjit për Armët si dhe është në proces miratimi Draft-Udhëzimi i Përbashkët me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës “ Për Tarifat”, si më poshtë:

1. VKM Nr. 269, datë 12.5.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 94, datë 4.2.2015, “Për procedurat për armët, në rastet e deklarimit të vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”.
2. VKM Nr. 289, datë 19.5.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 95, datë 4.2.2015, “Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme”.
3. VKM Nr. 270, datë 12.5.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 96, datë 4.2.2015, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe paaftësisë për armët e koleksionit”.
4. VKM Nr. 271, datë 12.5.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 275, datë 1.04.2015 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e sigurisë armëve”.
5. VKM Nr. 292, datë 08.04.2015 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit të armëve”.
6. VKM Nr. 272, datë 12.5.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 348, datë 29.04.2015 “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në territorin e Republikës së Shqipërisë” shqiptarë e të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në territorin e Republikës së Shqipërisë”.
7. VKM Nr. 462, datë 30.07.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”.
8. Udhëzim i Nr. 334, datë 28.10.2021, Ministrit të Brendshëm “Për procedurat për lëshimin/revokimin e dëshmisë për aftësimin teorik e praktik për armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik për veprimtaritë e lejuara me armët për programin e kursit të trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet e objektit ku zhvillohet ky program”.
9. Udhëzim Nr. 368, datë 23.11.2021, “Për procedurat, dokumentacionin dhe afatet e shqyrtimit, për pajisjen me autorizim për armë të subjekteve juridike e fizike, formatin e regjistrit për armët dhe municionet, për subjektin e licencuar për veprimtaritë me armët, për rregullat, procedurat dhe formularin që plotësohet në kohën e realizimit të qitjes eksperimentale dhe administrimin e gëzhgjës në një bankë të dhënash”
10. Urdhër i Ministrit të Brendshëm Nr. 367, datë 18.11.2021, “Për përbërjen ,detyrat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit për pajisjen e subjekteve me licencë/autorizim për veprimtaritë e lejuara me armë”.
11. VKM Nr. 348, datë 26.5.2022, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre”. e përafuar pjesërisht me Rregulloren Zbatuese e Komisionit (BE) 2018/337 e datës 5 mars 2018 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) 2015/2403 që përcakton udhëzime të përbashkëta mbi standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të siguruar që armët e zjarrit të çaktivizuar të bëhen në mënyrë të pakthyeshme të papërdorshme.

Është në proces miratimi Udhëzimi i Përbashkët Nr. 264/1, datë 29.06.2015 i Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë të Financave “Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifën financiare për veprimtarinë e lejuar me armët”.

Për zbatimin e “Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor”, në vitin 2021, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 754, datë 9.12.2021, “Për miratimin e planit të veprimit 2022 – 2024, të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024, është miratuar Plani i Veprimit të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve të tyre dhe Eksplozivëve, për vitet 2022 – 2024.

Ligji për administrimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, i miratuar në vitin 2019, parashikon krijimin e një zyre për rikuperimin e aseteve (ARO), sipas kërkesave nga *acquis* e BE-së. Në fund të vitit 2020, u miratua një strukturë e re dhe të gjitha aktet e nevojshme zbatuese për Agjencinë si dhe u krijua një sistem elektronik për asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara. Në maj 2021, u krijua një grup pune për vlerësimin dhe ngritjen e ARO, me urdhër të Kryeministrit Nr. 49, datë 28.05.2021 me ekspertë ndër-institucional nga Ministria e Brendshme, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme si dhe ekspertë të ndryshëm vendas dhe të huaj si Instituti për Demokracinë dhe Ndërmjetësim (IDM), Këshilli i Evropës etj. Ministria e Drejtësisë e cila drejton këtë proces ka përfunduar vlerësimin e përgjithshëm të kuadrit ligjor aktual dhe nevojat për ndryshime të mëtejshme ligjore, si dhe vlerësimin e çështjeve teknike për krijimin, organizimin, strukturën, vartësinë financiare, etj. Aktualisht, 3 modele janë duke u shqyrtuar nga Grupi i Punës në lidhje me institucionin ku do të vendoset një zyrë e tillë. Ky proces është gjithashtu në diskutim me partnerë ndërkombëtarë si: Këshilli i Evropës dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, si dhe me organizatat e shoqërisë civile.

U miratua dhe u vu në zbatim Ligji nr. 154/2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” dhe VKM Nr. 415, datë 08.07.2021 “Për Rregullat e aksesit të subjekteve të interesuara në bazën e të dhënave të regjistrit qendror të llogarive bankare”. U miratua Ligji Nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 531, datë 29.07.2022, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”, është miratuar numri i përgjithshëm i personelit të Policisë së Shtetit në organikë në 11.834 punonjës nga 11.802 që ishte më parë, me një rritje prej 32 punonjës.

Me urdhër të Ministrisë të Brendshme Nr. 5449/7, datë 26.10.2022, është krijuar Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor si një strukturë e re në Policinë e Shtetit.



Me VKM Nr. 1140, datë 24.12.2020 është miratuar Strategjia e re kundër Krimeve të Organizuara dhe të Rënda 2021 – 2025 dhe Plan i saj të Veprimit për 2021 – 2022. Aktualisht, nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, është në proces hartimi i Planit të veprimit 2023 – 2025.

Në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore po zbatohen Procedurat Standarde për Mbrojtjen e Viktimave të Mundshme të Trafikimit, si dhe vijon bashkëpunimi ndërinstitucional për parandalimin, mbrojtjen dhe asistencën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit.

Është miratuar Pani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021 – 2023”, me Vendimin nr. 670, datë 10.11.2021 “Për një shtesë në Vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit, 2021 – 2022”, si dhe vijon zbatimi i aktiviteteve për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese, ndjekjes penale, mbrojtjes së viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, ri-integritit të tyre, dënimit të trafikantëve, bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar. Mekanizmi kombëtar i referimit për viktimat (e mundshme) të trafikimit ka vazhduar të jetë funksional.

Në 2020, Shqipëria miratoi një strategji të re mbi sigurinë kibernetike dhe një plan veprimi për 2020 – 2025, të cilat mbulojnë përparësitë kryesore në këtë fushë. Ndërkohë, me Urdhër të Ministrit të Brendshëm Nr. 494, datë 30.12.2020, u miratua edhe “Strategjia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike dhe Plan i Veprimit për periudhën 2021 – 2025”. Po punohet për ndryshimet legjislative bazuar në strategjinë e sipërpërmendur.

Me Urdhër të Ministrit të Brendshëm Nr. 157, datë 17.02.2021 “Për disa ndryshime në strukturat organike të Policisë së Shtetit”, u krijua Drejtoria Hetimore, Njësia për hetimin e krimit ekonomik e Financiar, Njësia për hetimin e krimeve kibernetike.

Progres i dukshëm është bërë edhe në zbatimin e planit të veprimit për të adresuar rekomandimet e FATF. Qeveria ka hartuar edhe një program te posaçëm ne nivel kombëtar për zbatimin e këtyre rekomandimeve qe monitorohet nga Komiteti kombëtare Kundër Pastrimit të parave dhe një sekretariat i posaçëm teknik, tek i cili institucionet zbatuese raportojnë çdo javë progresin.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe strukturat ligjzbatuese detare, ka implementuar sistemin “Baza e të Dhënave për Trafikun Detar” falë financimit të Forcës së Kufirit të Mbretërisë së Bashkuar. Ky sistem synon kontrollin e kufijve detare, menaxhimin më të mirë të të dhënave të të gjitha mjeteve lundruese me natyrë tregtare ose jo, që gjenden apo lundrojnë në ujërat dhe portet e Shqipërisë dhe mundëson rritjen e sigurisë dhe ruajtjen e ujërave shqiptarë, përshtatjen dhe rritjen e sektorit detar shqiptar përmes përdorimit të të dhënave reale, statistikave dhe parashikimeve. Sistemi i ngritur përmbush detyrimet e Direktivës 2010/65/BE.

Instituti i Policisë Shkencore ka miratuar legjislacionin lidhur me organizimin dhe funksionimin e tij si dhe legjislacionin për sa i përket administrimit dhe marrjes së profileve të ADN-së dhe të dhënave daktiloskopike. Shqipëria ka nënshkruar edhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit Policor midis vendeve të Ballkanit Jugperëndimor, PCC SEE, “Për shkëmbimin automatik të të dhënave daktiloskopike, të profileve të ADN-së dhe të të dhënave të automjeteve”, si dhe e ka ratifikuar këtë marrëveshje në Parlament.

Në kuadër të plotësimit të standardeve ISO 17025, është miratuar projekti i ndërtesës së re të Institutit të Policisë Shkencore dhe është lëvruar fondi prej 6 milion Euro për ndërtimin e kësaj godine.

### ***Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës***

Shqipëria ka vazhduar të tregojë përkushtim në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të drogës. Drejtoria e Policisë së Shtetit ka filluar monitorimin nëpërmjet dronëve.

Është miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Plani i Veprimit Nr. 80, datë 27.01.2022, “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, për vitin 2022”.

Me qëllim mbikëqyrjen ajrore për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, për vitin 2022, është miratuar Urdhri Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 476, datë 29.04.2022, për Ndjekjen në vijimësi të Protokollit Operacional Nr. 636/6, datë 18.02.2021, ndërmjet Departamentit të Sigurisë Publike të Ministrisë së Brendshme në Itali dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Shqipëria bashkëpunon me Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA) për të rritur kapacitetin e saj raportues për çështjet e drogës dhe për ta sjellë atë në përputhje me udhëzimet/protokollet e EMCDDA. Kjo kërkon një bashkëpunim të fortë me institucione të tjera të rëndësishme, si Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, OJQ-të, etj. Zyra e Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën, në Institutin e Shëndetit Publik, është Korrespondenti Kombëtar i EMCDDA (Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Drogat). Në fushën e dograve, në “Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021 – 2030”, dhe planin e saj të veprimit, dokument ombrellë strategjik në fushën e shëndetësisë, miratuar me VKM Nr. 210, datë 6.4.2022, parashikohen ndërhyrje dhe aktivitete për sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial, nëpërmjet zhvillimit dhe forcimit të politikave dhe planeve të veprimit për parandalimin e përdorimit të alkoolit dhe drogës.

Në zbatim të këtij kuadri të ri strategjik në fushën e shëndetësisë, si dhe të kuadrit strategjik në fushën e krimit të organizuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po harton Planin e Veprimit për Parandalimin, Trajtimin dhe Reduktimin e Dëmit nga Drogat.

### ***Lufta kundër terrorizmit***

Shqipëria ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për të parandaluar dhe luftuar terrorizmit dhe ka avancuar në përafrimin me pjesën kryesore të *acquis* të BE-së. Vazhdojnë të implementohen masat e planifikuara në Planin e Veprimit (2021 – 2023) të Strategjisë Ndër-Sektoriale Kundër Terrorizmit 2021 – 2025. Është raportuar në periudha 6 mujore për hedhjen e të dhënave në sistemin IPSIS dhe ka përfunduar raporti vjetor për realizimin e masave për vitin 2021. Deri në fund të vitit 2022 pritet miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale për luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit e cila bashkon dy strategjitë ekzistuese në një dokument të vetëm strategjik. Shqipëria ka realizuar pjesën më të madhe të masave të planifikuara në Planin e Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor” dhe Plani i ri i Veprimit është nënshkruar në datë 9 dhjetor.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Drejtoria e Antiterrorit vijon bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe institucionet e tjera përgjegjëse, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe pjesëmarrjes aktive në grupet e punës për kryerjen e analizave të riskut si dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnimeve të përbashkëta për hetimin e financimit të terrorizmit. Në bazë të Marrëveshjeve dypalëshe dhe Planeve të Përbashkëta të Masave vazhdon bashkëpunimi me Shërbimin Informativ të Shtetit dhe Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për shkëmbimin e informacionit lidhur për subjekte të lidhur me terrorizmin dhe kryerjen e veprimeve operacionale të përbashkëta.

Në zbatim të Planit të Veprimit Ndërinstitucional shtesë “Për Pritjen dhe Trajtimin e Shtetasve Shqiptarë që kthehen nga Zona e Konfliktëve në Siri dhe Irak”, autoritetet riadhesuan në vitin 2022, 13 shtetas të tjerë shqiptarë nga kampet në Siri, nga të cilët 9 fëmijë dhe 4 gra, duke e çuar në total numrin e të kthyerve në 38. Kthimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i tyre është përgatitur dhe shoqëruar nga një grup pune ndërinstitucional, me role drejtuese për Qendrën Koordinuese CVE dhe Drejtorinë e Antiterrorit në Policinë e Shtetit. I gjithë informacioni përkatës është ndarë me Europol.

Me ndryshimet e fundit të kryera në Kodin e Procedurës Penale që nga marsi i vitit 2021 të gjitha veprat penale që lidhen me terrorizmin dhe financimin e tij kaluan në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin.

Ka përfunduar drafti i një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet Shërbimit të Hetimit Kriminal Detar dhe Policisë së Shtetit për bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit dhe çështje të tjera kriminale, i cili pritet të firmoset deri në fund të vitit 2022.

Shqipëria ka bashkëpunuar me Qeverinë Norvegjeze për ngritjen e kapaciteteve dhe hartimin e një “Plani Veprimi për Reagimin në rastet e sulmeve të dhunshme/terroriste”.

Janë në proces finalizimi procedurat standarde në rastet e situatave të cilat quhen emergjencë civile, incidenteve radiologjike apo ngjarjeve që përfshijnë burime radioaktive.

Policia e Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Instituti i Shëndetit Publik po bashkëpunojnë për hartimin e një Udhëzuesi mbi ngritjen e arkitekturës së dedektimit të lëndëve radiologjike jashtë entit rregullator.

Sa i takon Vendimit për Shkëmbimin e Informacionit dhe Bashkëpunimin lidhur me Veprat Terroriste (2005/671/JHA) është vendosur baza ligjore për krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore, ku përfshihen ato për luftimin e terrorizmit. Ligji Nr. 9539/2006 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8498, datë 10.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Ndihmën Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Penale dhe Protokollin Shtesë”.

Shqipëria vijon me zbatimin e aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve të shërbimeve të specializuara në luftën kundër terrorizmit nëpërmjet shtimit të numrit të burimeve njerëzore dhe logjistike si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Shqipëria është përdoruese e platformës së komunikimit, produkteve, shërbimeve dhe aftësive të Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit dhe bashkëpunon me Njësinë e Referimit të Internetit të Europol.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) , nga prilli i vitit 2022 është institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme së Republikës së Shqipërisë e angazhuar në koordinimin dhe monitorimin e punës me institucionet qendrore, vendore dhe partnerët ndërkombëtarë për proceset e parandalimit të radikalizmit, kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe pritjes dhe akomodimit të shtetasve të rikthyer nga zonat e konfliktit si dhe zbatimin të planeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit.

Me urdhër të Kryeministrit Nr. 59, datë 1.04.2022, u miratua Rregullorja e Brendshme e Institucionit të QKEDH-së “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)”.

Është miratuar VKM Nr. 449 datë 29.06.2022, “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë dhe të fondeve buxhetore në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2022”.

Ka përfunduar faza e konsultimit publik për Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2022 – 2025 dhe Planet e Veprimit në zbatim të saj të cilët janë konceptuar në dy dokumente specifike, si detyrim i vendit për përmbushjen e prioritetëve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dëlnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT).

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka zhvilluar trajnime të shumta për profesionistët dhe aktorët e vijës së parë të përfshirë në zbulimin, parandalimin dhe trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel qendror dhe lokal, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe partnerët kombëtarë/ndërkombëtarë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar informimit dhe ndërgjegjësimit për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm për të gjitha grupet shoqërore, por me fokus të veçantë punonjësit e vijës së parë. Gjithashtu, QKEDH në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit synon të ndërhyjë në kurrikulën bazë arsimore për ta pasuruar atë në kuadrin e njohurive arsimore të përgjithshme të nxënësve shqiptarë duke iu referuar konceptit bazë. Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit me Rektoratin e Tiranës për angazhimin e profesorëve për përfshirjen e njohurive EDH dhe Radikalizmit në literaturën studentore. Sa i takon angazhimin në terren, QKEDH vazhdon angazhimin maksimal për koordinimit, monitorimin e punës me ministrinë e linjës, agjencitë ligj-zbatuese, partnerët kombëtar dhe ndërkombëtarë për të lehtësuar procesin e rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit për qytetarët shqiptarë të kthyer nga kampet Al-Hol dhe Roj në Sirinë të tre riatdhesimeve përfshirë dhe ato të fundit më 27 maj 2022. Fokusi i qendrës CVE është fuqizimi ekonomik i grave të kthyer deri tani duke i përfshirë dhe në kurse mbi aftësimin profesional. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në kuadër të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe në bashkëpunim me CVE realizohen seanca informuese dhe trajnime për mësuesit drejtuesit, psikologët dhe oficerët e sigurisë.

### ***Migracioni i rregullt dhe i parregullt***

Kuadri ligjor për migracionin është përafëruar kryesisht me *acquis* të BE-së, por ka nevojë të përditësohet në përputhje me zhvillimet e fundit nga BE.

Bazuar në rekomandimet e BE-së lidhur me menaxhimin e migracionit të parregullt, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në nëntor 2021, Ligji Nr. 79/2021, datë 24.06.2021, “Për të huajt”.

Ligji për të huajt synon të lehtësojë menaxhimin e migracionit të rregullt dhe luftën kundër migrimit të parregullt, si dhe përmirësimin e fushës së të drejtave të të huajve, në drejtim të mbrojtjes së migrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, refugjatëve, azilkërkuesve, si dhe garanton akses në programe dhe shërbime integrimi për të huajt.

Me qëllim zbatimin e mirë të dispozitave të këtij ligji janë miratuar deri tani 12 akte nënligjore, si:

- Vendimi Nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”;
- Udhëzimi Nr. 174, datë 12.09.2022, të Ministrit të Brendshëm “Mbi procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”;
- Udhëzimin Nr. 186, datë 28.09.2022, i Ministrit të Brendshëm “Mbi procedurat për sigurimin e asistencës në transit, me qëllim kthimin në rrugë ajrore”;

- Udhëzimi i përbashkët Nr. 176, datë 15.9.2022, për procedurën e shpalljes së të huajit person i padëshiruar dhe miratimin e modelit të urdhrit për shpalljen e një të huaji person i padëshiruar;
- Vendimi Nr. 857, datë 29.12.2021, i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrimit Elektronik Kombëtar për të huajt në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendim Nr. 450, datë 30.6.2022, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes të lejeve të qëndrimit për të huajt”;
- Urdhri Nr. 185, datë 28.09.2022, i Ministrit të Brendshëm “Për përcaktimin e procedurave të monitorimit të lejeve të qëndrimit dhe lejeve unike”;
- Urdhër Nr. 180, datë 22.06.2022, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komisionit vlerësues për plotësimin e kushteve për një leje unike si investitor”;
- Urdhri Nr. 178, datë 22.06.2022, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komisionit vlerësues për plotësimin e kritereve të lejes unike si të vetëpunësuar”;
- Udhëzimi Nr. 18, datë 22.6.2022, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e procedurave të bashkëpunimit ndërinstitucional për përcaktimin e kuotave vjetore të punësimit”;
- Udhëzimi i përbashkët Nr. 220, datë 8.11.2022, MB-MEPJ “Për procedurën e zgjatjes, afatet e zgjatjes së qëndrimit, rastet e rëndësishme të veçantë, si dhe dokumenti me të cilin pajiset i huaji”;
- Udhëzimi i përbashkët Nr. 219, datë 8.11.2022 MB-MEPJ “Për procedurat për organizimin e operacioneve të kthimit dhe operacioneve të përbashkëta të kthimit në rrugë ajrore”.

Vijon zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019 – 2022, duke siguruar një kuadër të qartë për koordinimin ndërinstitucional dhe qeverisjen e migracionit në Shqipëri.

Janë hartuar tre raporte vjetore të monitorimit të zbatimit të këtij dokumenti.

Gjithashtu në zbatim të parashikimeve të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, me urdhër të Kryeministrit Nr. 99 datë 27.7.2020 u ngritën Komiteti Teknik i Migracionit, dhe me urdhër të Kryeministrit Nr. 35 datë 10.3.2021, Grupi Drejtues për Migracionin.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019 – 2022, aktualisht është në vitin e fundit të zbatimit të saj, për këtë qëllim një nga objektivat e ardhshëm në fushën e migracionit është hartimi dhe zbatimi i një dokumenti të ri strategjik kombëtar dhe gjithëpërfshirës.

Politika e re migratore do të synojë:

- Përmirësimin e mëtejshëm të mekanizmave të ngritur për koordinimin e qeverisjes së migracionit dhe menaxhimin e flukseve migratore që kanë prekur rajonin dhe vendin tonë dhe pritet të vijojnë edhe në periudhën e ardhshme;

- Pajtueshmërinë e objektivave të saj me dispozitat e Komunikatës së Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi Strategjinë e BE-së për kthimin dhe riintegrimin vullnetar, datë 27.04.2021 - EUR-Lex - 52021DC0120;
- Zhvillimin dhe zbatimin e një politike të qeverisjes së migracionit të harmonizuar me Paktin Global për Migracionin (GCM), nëpërmjet një qasjeje të gjithë qeverisë dhe të gjithë shoqërisë;
- Zhvillimin dhe zbatimin e një politike të qeverisjes së migracionit të harmonizuar me SKZHI 2022 – 2030.

Shqipëria ka marrëveshje dhe protokolle ripranimi me BE-në me 12 shtete anëtare.

Negociatat mbi Marrëveshjet e Ripranimit (marrëveshjet për kthimin e migrantëve të parregullt në vendin e tyre të origjinës) po vijnë kryesisht me vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore. Në kuadrin e parandalimit dhe menaxhimit të migracionit të parregullt janë draftuar dhe janë në proces negociimi Marrëveshjet e Ripranimit me Afganistanin, Irakun, Pakistanin, Indinë, Algjerinë, Marokun me Egjiptin, Bangladeshin dhe Tunizinë.

Gjithashtu, janë në proces edhe Marrëveshjet e Ripranimit me Gjeorgjinë dhe Armeninë të cilat më pas do të dërgohen pranë autoriteteve kompetente për ndjekje të procedurave të mëtejshme ligjore.

Kapaciteti i pritjes së migrantëve në vitin 2022, krahasuar me 2021, është rritur me 60 shtretër, në Stacionin e Policisë Kufitare Kapshticë (Korçë), financuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin me mbështetjen e BE-së.

Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Frontex për operacionet e kthimit është shumë i mirë.

Në kuadrin e rritjes së kapaciteteve të ripranimit, pala shqiptare është përfituese e projektit rajonal WBCAP (2021 – 2024), financuar nga Danimarka dhe menaxhuar nga Zyra Rajonale e IOM-it.

### ***Azili***

Ligji Nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” është pjesërisht i përafuar me *acquis* të BE-së dhe garanton parimin e mos-kthimit. Procedurat përshkruajnë trajtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare që mund t'u drejtohen institucioneve kompetente. Ligji i ri për azilin parashikon dhënien e të drejtave të azilit edhe kur kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare, paraqiten në zonat transit brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, duke u dhënë atyre informacion mbi mundësinë e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Nuk ka pasur raste të kthimit në kufi për shtetasit që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në zbatim të Ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” janë miratuar 15 akte nënligjore. Është përmirësuar infrastruktura për pritjen, akomodimin dhe intervistimin e migrantëve dhe azilkërkesve, në bashkëpunim me agjencitë e përfshira në këtë proces, me qëllim që të arrihen standardet e BE-së.

Regjistri elektronik për të dhënat e azilkërkuesve dhe personave që janë në mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, funksionon si një qendër integrale midis Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit dhe Qendrës Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesit, duke shkëmbyer informacionin dhe nxjerrjen e statistikave në kohë reale, duke shkurtuar procedurat në vendimmarrje, si dhe duke shërbyer si bazë unike të dhënash në këtë fushë.

### *Politika e vizave*

Kuadri ligjor për vizat në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me Ligjin Nr. 79/2021 “Për të huajt”.

Bazuar në rekomandimet e BE-së, Ligji i ri Nr. 79/2021 “Për të huajt”, synon përmirësimin e fushës së të drejtave të të huajve, të lehtësojë menaxhimin e migracionit të rregullt dhe luftën kundër migrimit të parregullt, përmirësimin në drejtim të mbrojtjes së migrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, si dhe garanton akses në programe dhe shërbime integrimi për të huajt.

Me qëllim zbatimin e dispozitave të ligjit të sipërcituar “Për të huajt”, janë në zbatim dhe aktet e mëposhtme:

- VKM Nr. 450, datë 29.06.2022, Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt”;
- VKM Nr. 243, datë 20.04.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 858/2021 “Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”;
- VKM Nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 857, datë 29.12.2021, “Për ngritjen dhe funksionimin e regjistrit elektronik kombëtar për të huajt në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 854, datë 30.12.2021, “Për aprovimin e vizës pullë dhe formatit të vizës elektronike”.

Aktualisht aktet nënligjore për trajtimin, qëndrimin dhe hyrjen e të huajve, në Republikën e Shqipërisë, janë përafëruar pjesërisht me direktivat e BE-së.

Lista negative: Shqipëria ka regjim të njëjtë për 97 shtete dhe regjim të ndryshëm me 9 shtete: Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Guajana, Kina, Kuvajti, Kazakistani, Turqia dhe Kosova.

Lista pozitive: Shqipëria ka regjim të njëjtë vizash me 57 shtete dhe me 10 shtete ka regjim të ndryshëm: Grenada, Ishujt Marshall, Mikronezia, Samoa, Saint Vincet and Grenadines, Ishujt Solomon, Timor-Leste, Tonga, Tuvalu dhe Vanuatu.



Aktualisht, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka ndërmarrë iniciativën për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe me 10 shtetet e mësipërme, për heqjen e regjimit të ndërsjellë të vizave për mbajtësit e pasaportave të zakonshme.

### ***Kufijtë Schengen dhe Kufijtë e Jashtëm***

Në zbatim të Programit Vjetor të Policisë së Shtetit, Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit për periudhën 2021 – 2027 dhe Planit të Veprimit 2021 – 2023, struktura përgjegjëse e ka përqendruar punën e saj në realizimin e prioritetit kryesor, atë të përsosjes së komponentëve të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe sistemit të sigurisë kufitare, nëpërmjet rritjes së standardeve të kontrollit kufitar, parandalimin e goditjen e krimit ndërkufitar, menaxhimin e migracionit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe aftësive tekniko-profesionale, forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar sipas standardeve të BE-së.

Ministria e Brendshme dhe Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, si pjesë përbërëse e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka pasur progres të vazhdueshëm në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, në përmirësimin e kuadrit ligjor, rritjen kapaciteteve administrative dhe profesionale të strukturave, të zbatimit të Procedurave Standarde të Punës, të zbatimit të programeve të trajnimit, të përmirësimit të infrastrukturës dhe teknologjike së informacionit, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, të forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe në drejtim të goditjes të aktiviteteve të paligjshme që zhvillohen nëpërmjet kufirit shtetëror, dhe si arritje kryesore në këtë fushë, evidentohet:

- Përafrimi i legjislacionit për sigurinë kufitare dhe për të huajt me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- Përqasja me standardet e organizimit strukturor të Policisë Kufitare dhe Migracionit sipas praktikave më të mira të vendeve të BE-së;
- Forcimi i kapaciteteve logjistike të Policisë Kufitare dhe Migracionit me mjete patrullimi dhe transporti, pajisje për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit në përputhje me standardet e parashikuara nga katalogu Schengen;
- Ngritja e strukturave të konsoliduara të analizës së riskut në nivel qendror dhe vendor, si dhe vendosja e analizës së riskut në themel të policimit kufitar. Brenda një kohë të shkurtër në bashkëpunim me FRONTEX do të aplikohet modeli CIRAM 2.0 i analizës së riskut si standardi më i avancuar i BE-së;
- Forcimi i ndjeshëm dhe i mbështetur në besimin reciprok me vendet fqinje reflektuar në numrin në rritje të marrëveshjeve dhe protokolleve në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar dhe në numrin e patrullimeve dhe operacioneve të përbashkëta të zhvilluara me autoritetet e këtyre vendeve;
- Sigurimi i mbështetjes financiare nga BE, vendet anëtare dhe institucionet e Kombeve të Bashkuara për forcimin e kapaciteteve logjistike dhe profesionale (trajnimet e përfituara);
- Forcimi i kapaciteteve profesionale të policisë kufitare dhe migracionit nëpërmjet trajnimeve bazë sipas kurrikulave të FRONTEX dhe trajnimeve të ofruara brenda dhe jashtë vendit nga partnerët ndërkombëtarë si dhe pjesëmarrjes në operacionet e ndryshme ndërkombëtare, ku rojet kufitare punojnë së bashku me rojet kufitare të vendeve të tjera;

- Standardizimi i procedurave të punës të shërbimit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, bazuar në praktikat më të mira dhe në standardet Schengen;
- Informatizimi në shkallë më të lartë i proceseve të punës, ku Policia Kufitare ka në dispozicion sisteme dhe pajisje bashkëkohore për kontrollin e kufirit, mjete komunikimi, Sisteme Tims/Interpol/Databaze të ndryshme si NCR, E-viza, E-Leje qëndrimi dhe pajisje të ndryshme kontrolli;
- Funksonimi i strukturës së Policisë Kufitare dhe Migracionit, ngritja e Analizës së Riskut dhe zbatimit të Masave Plotësuese për Kontrollin e Territorit në të gjitha Drejtoritë vendore si dhe krijimi dhe funksionimi i Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare;
- Zhvillimi i operacioneve simuluese të përbashkëta me vendet fqinje në zbatim të protokolleve të nënshkruara për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare për patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror të cilat janë mbështetur nga misioni i OSBE- së në vendin tonë;
- Zhvillimi i operacioneve të suksesshme me FRONTEX në kuadër të operacionit të përbashkët me FRONTEX “JO Albania Sea 2021” në kufirin detar, i planifikuar deri me datë 25.01.2023;
- Zhvillimi i operacioneve të suksesshme me FRONTEX në kuadër të operacionit të përbashkët me FRONTEX “JO Albania Land 2022” në kufirin tokësor me Greqinë që ka mundësuar kapjen e 88% të numri të kapjes së shtetasve të huaj imigratë të parregullt;
- Bashkëpunimi operacional me Frontex-in, për zhvillimin e operacioneve tokësore në kufirin me Greqinë, operacioneve detare, operacioneve ajrore të kthim ripranimeve të shtetasve shqiptarë dhe të trajnimeve të personelit të polici kufitare.

Me datë 14 prill 2022, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave kanë firmosur Urdhrin e përbashkët për miratimin e rregullave “Për bashkëpunimin për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të përbashkëta të autoriteteve të policisë dhe autoriteteve doganore”. Në Kapitullin 4 të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar dhe është përshkruar “E drejta e konsultimit të sistemit të menaxhimit të informacionit (TIMS) nga DPD dhe e drejta e konsultimit të bazës së të dhënave (*oracle application reports*) nga DPPSH”.

Është miratuar Ligji Nr. 22/2020, datë 5.3.2020 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, i cili përfshin krijimin dhe funksionimin e njësisë API/PNR dhe është përafëruar pjesërisht me *acquis* e BE-së.

Po ashtu, në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1009, datë 24.08.2022, është ngritur Grupi i Punës në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, për të përgatitur draftin e strukturës së Hetimit në këtë Departament, e cila do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve hetimore të Policisë së Shtetit në aspektin procedural dhe operacional.

### **Qendrat e Përbashkëta të Bashkëpunimit Policor:**

Aktualisht, janë funksionale 3 Qendra të Përbashkëta të Bashkëpunimit Policor të Republikës së Shqipërisë me shtetet fqinje dhe është në proces ngritja e QBPB me Greqinë, në PKK Kakavijë (në territorin e Greqisë):

- Qendra e Përbashkët e Bashkëpunimit Policor trepalëshe (Shqipëri – Kosovë – Mali i Zi), e vendosur në Plavë, Mali i Zi;
- Qendra e Përbashkët e Bashkëpunimit Policor me Maqedoninë e Veriut (Qafë-Thanë – Kjafasan), e vendosur në PKK Kjafasan, Maqedoni e Veriut;
- Qendra e Përbashkët e Bashkëpunimit Policor me Kosovën, e vendosur në PKK Morinë. Marrëveshja për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Përbashkët e Shkëmbimit të Informacionit me Kosovën;
- Është në proces ngritja e Qendrës së Përbashkët e Shkëmbimit të Informacionit Kakavijë, (në territorin e Greqisë) firmosur në Janar 2021, në PKK Kakavijë, nga Zëvendësministri e Brendshëm të dy vendeve, për të cilën pala shqiptare ka kryer të gjitha detyrimet dhe priten detyrimet e palës greke.

### **Bashkëpunimi me fqinjët:**

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje, janë nënshkruar dhe zbatohen një sërë marrëveshjesh siç është ajo me Republikën e Kosovës, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Janë nënshkruar Marrëveshje dhe Protokolle për patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror, mbi organizmin dhe zhvillimin e takimeve ndërmjet drejtuesve të policive kufitare, mbi shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit, për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, për krijimin dhe funksionimin e qendrave të përbashkëta të bashkëpunimit policor, për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare, për rregullimin e regjimit të trafikut lokal, etj.

### **Me Republikën e Kosovës:**

Ngritja dhe funksionimi i Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar me Republikën e Kosovës është realizuar në zbatim të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta të kontrollit kufitar”, ratifikuar me ligjin Nr. 24, datë 18.04.2019, dhe ka filluar të funksionojë në muajin Janar të vitit 2019.

Marrëveshjet/protokollet me Kosovën dhe zbatimi i tyre:

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për rregullimin e regjimit të trafikut lokal të kufirit.
  - Protokollin ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës për implementimin e kontrollit të përbashkët kufitar në Pikën e Përbashkët të Kalimit Kufitar Morinë/Kukës (Vërmicë/Prizren), nënshkruar më datë 20.06.2022, në Prishtinë, në mbledhjen e përbashkët “G2G” të dy qeverive.

- Marrëveshje ndryshuese të “Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Shishtavec (Kukës) – Dragash (Kosovë):
  - Më datë 15.04.2022, është nënshkruar Protokoli zbatues nga Ministrat e Brendshëm të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, për Pikën e Përbashkët të Kalimit Kufitar Shishtavec (Kukës) – Dragash (Kosovë)”, zbatimimi i të cilit vijon pa probleme.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 67, datë 2.02.2022.

### **Me Maqedoninë e Veriut:**

Përveç marrëveshjeve të tjera në fushën e kufirit, të cilat zbatohen rregullisht nga policitë kufitare të dy vendeve, është në proces zbatimimi “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Është nënshkruar më datë 14 nëntor 2022 Protokoli zbatues për pikën e përbashkët të kalimit kufitar Qafë Thanë/Kjafasan.

### **Me Malin e Zi:**

Protokoli “Për bashkëpunim gjatë sezonit turistik 2022”, Nr. 5330, datë 12.07.2022, mes DPPSH të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Policisë të Malit të Zi Nr. 070/22-21108, datë 11.07.2022.

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi hapjen e kalimit kufitar Bajzë (Republika e Shqipërisë) – Tuz (Mali i Zi) për transportin hekurudhor ndërkombëtar.

Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi, në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi hapjen e kalimit kufitar Bajzë (Republika e Shqipërisë) – Tuz (Mali i Zi) për transportin hekurudhor ndërkombëtar ndërmjet dy vendeve”.

Janë në funksionim të plotë tre Pika të Përbashkëta të Kalimit Kufitar, me Malin e Zi, PPKK Murriqan, PPKK Grabon, PPKK Hekurudhor Tuz dhe është në proces zbatimimi i Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë – Cklla/Skje/ Mal i Zi), për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës”.

Në kuadër të Projektit “CONNECTA”, me qëllim zhvillimin e një rrjeti transporti ndërmjet BE-së dhe 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, është përcaktuar që Pika e Kalimit Kufitar Hani i Hotit/Bozhaj, të bëhet Pikë e Përbashkët e Kalimit Kufitar (PPKK), sipas parimit “Një ndalesë - Një kontroll” (One Stop Shop).

Policitë Kufitare të dy vendeve tona janë pjesë aktive e takimeve/diskutimeve për hartimin e një Marrëveshje për ngritjen dhe funksionimin Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Hani i Hotit/Bozhaj, si dhe hartimit të Protokollit teknik në zbatim të saj.

PPKK Murriqan është pika e kalimit kufitar me fluksin më të madh të kalimit kufitar me Malin e Zi, ku gjatë sezonit aplikimi i lehtësimit të kalimit kufitar bëhet i përbashkët në të njëjtën kohë, duke lehtësuar në maksimum fluksin e udhëtarëve. Nga Policitë Kufitare të dy vendeve tona, po punohet për gjetjen e mundësive financiare mbi ristrukturimin e pikës së kalimit, me qëllim rritjen kapaciteteve përpunuese të njerëzve e të mallrave.

Me datë 16 dhjetor 2020, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave për “Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, ratifikuar me Ligjin Nr. 10474, datë 27.10.2011”.

Në kuadër të Procesit të Berlinit, do të rifillojnë takimet e Grupit të Punës “Ad Hoc” mbi “Marrëveshjen Rajonale për Lirinë e Lëvizjes me Kartat e Identitetit në Ballkanin Perëndimor”, “Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes së Qytetarëve të Palës së Tretë brenda Ballkanit Perëndimor” dhe Marrëveshjen “Qytetarët e Palëve të Treta, të cilëve nuk u kërkohet të kenë vizë”, organizuar dhe drejtuar nga RCC.

Me datë 18 janar 2021 është firmosur Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë mbi ngritjen dhe funksionimin e një Qendre Bashkëpunimi Policor dhe Doganor, në Kakavijë, në ambientet e Pikës Greke të Kalimit Kufitar. Vazhdojnë procedurat për ratifikimin e saj dhe për ngritjen dhe funksionimin e qendrës.

Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. 923, datë 1.08.2022, ka filluar përdorimi i sistemit elektronik të verifikimit kufitar (e-Gate), në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas, në hyrje dhe në dalje të Republikës së Shqipërisë.

Në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, janë zbatuar me korrektësi masat parandaluese kundër korrupsionit në pikat e kalimit kufitar, përmes instalimit të kamerave, nëpërmjet ankesave dhe denoncimeve në Platformën Digjitale të Bashkëqeverisjes, si dhe në adresat publike të e-mail të Policisë së Shtetit dhe Policisë Kufitare.

***Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale***

Në bazë të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust”, që Republika e Shqipërisë nënshkroi në 5 tetor 2018, është emëruar prokurori ndërlidhës për korrespondencën me EUROJUST në janar të vitit 2021 që lehtësoi më tej zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit. Ky është një hap i rëndësishëm për të lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor në luftën kundër krimit të organizuar transnacional.

Ligji për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale me juridiksionet e huaja i cili u ndryshua me Ligjin Nr. 97 datë 7.07.2021“ Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” për të thjeshtësuar procedurat për letër-porositë, ligj i cili lejon marrëdhënie të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve gjyqësore, rregullon procedurën e videokonferencës, të masave shtrënguese dhe sekuestrimit, Urdhrit Ndërkombëtar të Arrestit, si dhe Skuadrat e Përbashkëta Hetimore duke përcaktuar afate për secilin procedurë dhe përshpejton ndihmën e ndërsjellë juridike me autoritetet e huaja gjyqësore. Në draftimin e këtyre ndryshimeve, janë marrë në konsideratë rekomandimet e MONEYVAL, boshllëqet ligjore të referuara në LGA në Kapitullin 24, etj.

Në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet civile, duhet theksuar se ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, ligjin “Për ndërmjetësimin”, ligjin “Për ndihmën juridike”, ligjin “Për falimentimin” janë miratuar dhe transpozuar në përputhje me standardet e *acquis*.

### ***Bashkëpunimi Doganor (shih Kapitullin 29)***

### ***Mbrojtja e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)***

Shqipëria në kuadër të përafrimit me *acquis* në fushën e mbrojtjes së monedhës së euros, ka miratuar Ligjin Nr. 77, datë 11.11.2019 “Për Ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Luftën Kundër falsifikimit të Monedhës” bazuar në Vendimin e Këshillit 2001/887/DÇB e 6 dhjetorit 2001 për mbrojtjen e euros nga falsifikimi, për ratifikimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1929. Me Komisionin Evropian/DGECFIN në vitin 2019 dhe me Bankën Qendrore Evropiane në vitin 2021, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së monedhës (euros) nga Banka e Shqipërisë. Banka Shqipërisë, Prokuroria Shqiptare dhe Ministria e Brendshme janë në proces hartimi të një marrëveshje bashkëpunimi për rritjen efektivitet të autoriteteve kompetente kombëtare në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së monedhave kundër falsifikimit.

### 24.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, Drejtoria për Politikën e Rendit dhe Sigurisë Publike, Drejtoria e Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Politikave për Azilin dhe Shtetësinë, Qendra e

Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara).

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Ministria e Mbrojtjes

- Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile
- Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
- Agjencia e Inteligjencës dhe sigurisë së Mbrojtjes
- Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
- Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

- Autoriteti i Aviacionit Civil

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Instituti i Shëndetit Publik
- Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministri i Shtetit për Rininë e Fëmijët

Ministria e Kulturës

Prokuroria e Përgjithshme

SPAK

Banka e Shqipërisë

Shërbimi Informativ i Shtetit

INSTAT

Dhoma e Ndërmjetësimit

Autoriteti i Mediave Audiovizive

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

#### 24.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Përafrimi me *acquis* është duke përparuar në të gjitha fushat e mbuluara nga Kapitulli 24. Si institucion lider për GNPIE 24, Ministria e Brendshme organizoi punën në katër grupe sipas nënfushave të këtij kapitulli. Aktualisht janë përfunduar të analizës ligjore të *acquis* të cilat përditësohen vazhdimisht.

***Lufta kundër krimit të organizuar***

Kuadri ligjor në lidhje me krimin e organizuar është *pjesërisht harmonizuar* me *acquis* e BE-së në këtë fushë.

Lidhur me *Krimin Kompjuterik*, Shqipëria duhet të miratojë ndryshimet legislative për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet. Pritet nënshkrimi i Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike, i cili është hapur për shtetet për nënshkrim që prej datës 12 maj 2022. Lidhur me rritjen e kapaciteteve për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale në fushën e krimit kibernetik, aktualisht me Urdhër të DPPSH Nr. 1009/1, datë 14.09.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për strukturën e Policisë së Shtetit”, po punohet për reformimin e Policisë Kriminale dhe strukturës së Policisë së Shtetit.

*Në luftën kundër trafikimit të armëve*, ligji për armët është përafuar pjesërisht me dispozitat e BE-së, por ka nevojë të harmonizohet me zhvillimet më të fundit të *acquis* në këtë fushë. Kuadri ligjor nuk është i plotë lidhur me çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe mungojnë standardet kombëtare në çaktivizimin e tyre. Duhet të adresohet mungesa e procedurave standarde dhe mekanizmave në luftën kundër tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe armëve të lehta (AVL) nga ajri. Masat e marra nga Shqipëria në lidhje me rezervat e municioneve duhet të vijnë në përputhje me direktivat e BE-së.

*Lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore*, evidentohet nevoja e ndryshimeve në Kodin Penal dhe Procedural Penal lidhur me kompensimin e viktimave të trafikimit, lidhur me përcaktimin e Vulnerabilitetit të Personave, me përfshirjen në një nen të vetëm të trafikimit të të rriturve dhe të miturve, me përcaktimin e qartë të trafikimit të brendshëm tek të miturit, me shfrytëzimin e të miturve për prostitucion në harmonizim me Konventën e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore, etj.

*Lidhur me konfiskimin*, ku kërkohet të përfundojë ngritja e një zyre për rikuperimin e pasurive (ARO), përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e pasurive kriminale, duhet të miratohen dhe zbatohen rregulla për konfiskimin e zgjeruar dhe ngrirjen paraprake të pasurive, si dhe miratimin dhe zbatimin e rregullave për të siguruar që asetet e konfiskuara do të ripërdoren në mënyrë efektive, në mënyrë që të mos humbin vlerën e tyre ekonomike.

Në kuadër të përmirësimit të legjislacionit mbi pasuritë e pajustificuara është parashikuar përafrimi i legjislacionit shqiptar me nenin 20 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Gjithashtu është parashikuar zgjerimi i fushës së veprimit të Ligjit Nr. 10192, “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuara dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, duke shtuar numrin e veprave penale si; Krimin Kibernetik, Mashtrimin Financiar, Pornografinë me Fëmijë, Falsifikimin e Monedhave etj, në përputhje me Vendimin Nr. 2003/577/JHA të legjislacionit të Bashkimit Evropian.



### *Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

Në aspektin e përafrimit me legjislacionin e BE-së dhe të harmonizimit me standardet e BE-së në nënfushën e luftës kundër krimit të organizuar, prioritetet kryesore janë:

- Krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në përputhje me *acquis* të BE-së, e cila është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e asetëve kriminale, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar;
- Nënshkrimi i Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës për bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike;
- Miratimi i akteve të reja ligjore dhe nënligjore për krimin kibernetik, bazuar në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2020 – 2025;
- Miratimi i ndryshimeve legjislative për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet.

### *Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës*

Pritet miratimi i Planit të Veprimit për Parandalimin, Trajtimin dhe Reduktimin e Dëmit nga Drogat. Gjithashtu, duhet të përditësohet lista e substancave të ndaluara psikoaktive në mënyrë që të sigurohet një kuadër ligjor për të hetuar dhe ndjekur penalisht në lidhje me substanca të tilla. Në këtë kuadër nevojiten amendime në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995, “Për barnat narkotike dhe substancat psikotrope” të ndryshuar.

### *Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Krijimi i Observatorit Kombëtar të Drogës;
- Krijimi i një Sistemi të Paralajmërimit të Hershëm për shkëmbimin e informacionit në lidhje me substancat e reja psikoaktive.

### *Lufta kundër terrorizmit*

Shqipëria ka një kuadër të konsiderueshëm ligjor në luftën kundër terrorizmit, parandalimit dhe luftimit e financimit të terrorizmit, por legjislacioni në këtë fushë konsiderohet pjesërisht i përafruar. Janë identifikuar disa mangësi ligjore, ndër të cilat mungesa e një dispozite në legjislacionin shqiptar në lidhje me asistencën dhe mbështetjen veçanërisht për viktimat e terrorizmit, e cila pritët të realizohet në kuadër të miratimit të projektligjit “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i cili duhet të përputhet me Direktivën 2017/541 me amendimet e parashikuara për tu miratuar në tre mujin e katërt të vitit 2023.

Nuk është përafruar Direktiva BE 2021/784 e Parlamentit Evropian për adresimin e shpërndarjes së përmbajtjes terroriste online.

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon ende një plan sigurie për çdo objekt, siç dhe rekomandohet në Direktivën 2008/114/KE e datës 8 dhjetor 2008 “Për identifikimin dhe përcaktimin e

infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”. Kjo Direktivë është pjesërisht e traspozuar në legjislacionin vendas.

#### *Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Do të vijojë përdorimi në mënyrë proaktive i produkteve, shërbimeve dhe kapaciteteve të platformave të komunikimit të Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit të Europolit dhe do të bashkëpunohet me Njësinë e Referimit në Internet të Europolit.
- Do të vazhdojë përdorimi sistematik i hetimeve financiare paralele lidhur me veprat penale terroriste.
- Do të vazhdojë harmonizimi me legjislacionin e BE-së për eksplozivët dhe prekursorët e tyre, dhe të përditësojë treguesit për Pikën Fokale për Armët e Zjarrit në bazë të rekomandimeve të Këshillit, të korrikut 2021.
- Do të vijojë bashkëpunimi për zbatimin e masave në Planin e Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor.

#### *Migracioni i rregullt dhe i parregullt*

Kuadri ligjor për migracionin është i përafuar më së shumti me *acquis-të* e BE-së, por duhet të përditësohet në vijim të zhvillimeve të kohëve të fundit nga ana e BE-së. Aktualisht po punohet për përditësimin me *acquis-të* e reja të BE-së.

Vijon procesi i përzgjedhjes së shtetasve të huaj imigrantë të parregullt dhe zbatimi i procedurave të kthimit sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi të përafuara në zbatim të rekomandimeve të BE-së.

Policia Kufitare dhe Migracionit ka marrë masa për kontrollin e kalimit të kufirit dhe do të vijojë forcimin e masave të kontrollit të kalimit të kufirit për të miturit dhe kontrollit në hyrje të prindërve/kujdestarëve ligjorë/individëve.

#### *Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Do vijojnë negociatat dhe me asistencën e BE-së për të siguruar zhvillime të reja lidhur me nënshkrimin e projekt marrëveshjeve të ripranimit. Në kuadrin e projektit rajonal WBCAP (rritja e kapaciteteve të ripranimit) dhe me ndërmjetësim të IOM –it, po bëhen përpjekje për të finalizuar marrëveshjet e ripranimit me disa vende të origjinës.
- Do vijojë procesi i rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në fushën e menaxhimit të migracionit.
- Do të rishikohen Procedurat Standarde të punës për tu përshtatur me ndryshimet e reja ligjore për të huajt dhe azilin.
- Do të zbatohen procedurat e kthimit në përputhje me Ligjin “Për të huajt” dhe do të sigurohet që mekanizmi i saj i kthimit për migrantët e parregullt të jetë në përputhje me *acquis* të BE -së duke përfshirë respektimin e plotë të të drejtave themelore.

#### *Azili*

Ligji aktual “Për azilin” është përafruar pjesërisht me *acquis* të BE-së.

*Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Duhet të vijojë zbatimi i ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Rritja e kapacitetit të Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, për të vlerësuar kërkesat individuale, veçanërisht informacionin mbi vendin e origjinës dhe rastet që përfshijnë njerëz vulnerabël.

***Politika e vizave***

Politika e vizave, nuk është akoma në përputhje të plotë me *acquis*, përfshirë këtu listat e vendeve të treta që udhëtojnë në BE me vizë.

*Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Duhet të sigurohet përafrim i plotë i legjislacionit me politikën e vizave të BE-së.

***Kufijtë Schengen dhe Kufijtë e Jashtëm***

Ligji Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore zbatuese janë në përputhje me *acquis* e BE-së. Sidoqoftë, kuadri më i gjerë legjislativ për menaxhimin e kufijve të jashtëm të Shqipërisë nuk është akoma në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufijve 2014 – 2020 përputhet pjesërisht me standardet evropiane.

Do të riorganizohet struktura hetimore në policinë kufitare duke rimarrë kompetenca hetimore me qëllim zbulimin e rasteve të kontrabandimit të njerëzve dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

*Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Kontrollin Kufitar dhe miratimi i Ligjit API/PNR.
- Do të sigurohet zbatimi detyrimeve që policia kufitare ka për mbrojtjen e të dhënave personale ne kuadër të sistemit PISCES për identifikimin e personave dhe përdorimi i tij në përputhje me *acquis*-të e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale.

***Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale***

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* dhe standardet evropiane është arritur kryesisht, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor.

Ligji për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale është ndryshuar me Ligjin Nr. 97/2021, datë 7.7.2021, sikurse parashikohet në disa direktiva të rëndësishme në lidhje

me njësitë e përbashkëta hetimore, si Vendimi i Këshillit 2002/465/JHA i 13 qershorit 2002 mbi ekipet e përbashkëta hetimore si dhe Rezoluta e Këshillit e 26 shkurtit 2010 mbi një marrëveshje model për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor.

*Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Duhet finalizuar procedurat e brendshme për aderimin në Konventën e Hagës të vitit 2005 mbi Zgjedhjen e Marrëveshjeve të Gjykatës dhe Protokollin e vitit 2007 mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet e Mirëmbajtjes.
- Duhet të përmirësohet më tej kapaciteti institucional i strukturës së bashkëpunimit ndërgjyqësor.

### **Mbrojtja e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)**

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* dhe standardet evropiane në fushën e mbrojtjes së monedhave nga falsifikimi është realizuar me ratifikimin e Konventës së Gjenevës për Luftën Kundër falsifikimit të Monedhës të vitit 1929, nëpërmjet Ligjit Nr. 77/2019, datë 11.11.2019 “Për Ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Luftën Kundër falsifikimit të Monedhës”, si dhe me marrëveshjet e arritura në fushën e mbrojtjes së monedhës euros nga Banka e Shqipërisë, respektivisht me Komisionin Evropian/DG ECFIN në vitin 2019 dhe me Bankën Qendrore Evropiane në vitin 2021.

*Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë*

- Përmirësimi i kapaciteteve të strukturës qendrore kundër falsifikimit të monedhave në DPPSH, në përputhje nenin 12 të Konventës së Gjenevës, për koordinimin dhe hetimin rasteve të falsifikimit të monedhave.
- Miratimi i projektligjit për disa ndryshime në Kodin Penal, Nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, në Nenin 183 “Falsifikimi i monedhave” dhe Nenin 185 “Prodhimi i mjeteve për falsifikim” në kuadër të përafrimit të përkufizimit të veprës penale të falsifikimit të monedhave, sipas Direktivës 2014/62/EU për mbrojtjen e monedhës euro kundër falsifikimit.
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Fushën e Parandalimit dhe Mbrojtjes së Monedhave nga Falsifikimi mes Ministrisë Brendshme (DPPSH), Prokurorisë Përgjithshme dhe Bankës Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve dhe masave të nevojshme për mbrojtjen e monedhave kundra falsifikimit, sipas Direktivës 2014/62/BE dhe Rregulloren 1338/2001/BE.

## KRITERI EKONOMIK

Funksionimi i ekonomisë së tregut

Shqipëria ka bërë **përparim të mirë** dhe është **mesatarisht e përgatitur** për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Në sajë të një korpusi politikash kryesisht të përshtatshme, ekonomia shqiptare tregoi elasticitet dhe rimori veten më shpejt nga pritshmëritë në vitin 2021, duke fshirë shumicën e humbjeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia e COVID-19. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka goditur ekonominë shqiptare në mënyrë të tërthortë përmes çmimeve më të larta të mallrave dhe rritjes më të ulët të partnerëve të saj kryesorë tregtarë në BE, por duke mos ndikuar negativisht mbi rritjen gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2022. Megjithatë, është e qartë që risqet janë në rënie në periudhën e ardhshme. Deficiti buxhetor dhe norma e borxhit publik u rritën më pak se parashikimet gjatë vitit 2021, por hapësira fiskale mbetet e kufizuar, duke rritur cenueshmërinë e vendit nga goditjeve të jashtme. Është bërë përparim i mirë me reformat e lidhura me të ardhurat, por ka ende dobësi në kuadër të planifikimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve për investime. Përdorimi i rregullt i akteve normative për rishikimet e shpeshta të buxhetit dhe ligji për buxhetin dobësojnë besueshmërinë fiskale. Inflacioni ka pësuar rritje përtej synimit, çka e ka shtyrë bankën qendrore të rrisë normën bazë të interesit në disa raste. Mjedisi i biznesit përfitoi nga shkalla më e lartë e digjitalizimit të shërbimeve publike. Kjo, së bashku me rritjen e përfshirjes financiare dhe veprimtaritë e suksesshme për uljen e punësimit të nënraportuar, ka dhënë gjithashtu kontribut për formalizimin e ekonomisë, megjithëse një pjesë e madhe e ekonomisë mbetet informale. Konsultimi i publikut nga ana e qeverisë nuk ka pasur përmirësim domethënës.

## **Zhvillimet ekonomike**

PBB-ja reale e Shqipërisë u rikuperua fuqishëm me 8.5% në 2021 dhe 6.5% në fillim të 2022, duke u rikuperuar shumë mbi nivelet para pandemisë deri në tremujorin e tretë të 2021. Rritja ishte me bazë të gjerë, e mbështetur nga një performancë më e mirë se sa pritej e sektorit të turizmit, shpenzimet e larta të konsumatorëve dhe investimet. Rimëkëmbja u bazua në një mjedis të qëndrueshëm ekonomik dhe monetar, në bilanc të shëndoshë financiar, në përmirësim të besimit dhe në kushte financiare akomoduese. Për më tepër, ajo u shoqërua me rritje të fortë të vendeve të punës dhe pagave. Mbështetja e konsiderueshme fiskale dhe një politikë monetare ekspansioniste, së bashku me lehtësimin e synuar dhe të përkohshëm të kërkesave mbikëqyrëse, ndihmuan në frenimin e efekteve të pandemisë dhe hapën rrugën për një rimëkëmbje të fortë.

Lufta në Ukrainë e ka përkeqësuar disi tablonë makroekonomike si rezultat i ngadalësimit të ekonomisë globale, kryesisht në Evropë, dhe presioneve të forta inflacioniste. Ndikuar nga çmimet dhe kostot e larta të prodhimit si dhe nga një pasiguri e lartë, zgjerimi i PBB-së u ngadalësua në 2.2% në tremujorin e dytë të vitit 2022. Kjo ecuri reflektoi një stepje të investimeve në një realitet të ri me rritje të shpejtë të kostove dhe pasiguri të lartë, një ngadalësim të rritjes së eksportit të mallrave dhe një rritje të shpejtë të importeve. Nga ana tjetër, konsumi privat u rrit me ritme të qëndrueshme në reflektim të kursimeve të akumuluar dhe rritjes së kërkesës pas ndrydhjes së saj gjatë pandemisë Covid-19.

Deficiti i llogarisë korente shënoi 621.2 milionë euro në 9-mujorin e parë të vitit 2022, duke u ulur me 0.7% në terma vjetorë. Raporti i tij ndaj PBB-së qëndron në 4.6%, krahasuar me 5.5% në 9-mujorin e parë të 2021 dhe 7.6% për vitin në tërësi. Rënia e deficitit të llogarisë korente është

ndikuar nga rritja e suficitit në nënllogarinë e shërbimeve (me 35.1%), si rezultat i rritjes së fortë të eksportit të “shërbimeve të udhëtimit”. Nga ana tjetër, deficitit tregtar i mallrave u zgjerua me 16.3%, si pasojë e rritjes së shpejtë të importeve, e nxitur nga çmimet më të larta ndërkombëtare. Rritja e suficitit të shërbimeve ka përmirësuar deficitin e përgjithshëm tregtar i cili u rrit me 4.7% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë, deficitit i të ardhurave parësore është thelluar kryesisht si pasojë e daljeve më të larta të të ardhurave nga investimet. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave dytësore është përmirësuar për shkak të flukseve hyrëse të remitançave, të cilat u rritën në vit me 9.8%.

Daljet neto në llogarinë kapitale regjistruan vlerën 3.0 milion EUR në 9-mujorin e vitit 2022. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë kjo llogari regjistronte hyrje neto prej 245.4 milionë EUR. Detyrimet neto në llogarinë financiare u rritën me 130.5% në terma vjetorë, të ndikuara edhe nga rritja e Investimeve të Huaja Direkte. Flukset neto të Investimeve të Huaja Direkte u rritën me 22.7%, të ndikuara kryesisht nga sektorët e “Pasurive të Paluajtshme”, “Energjia”, “Industria nxjerrëse” dhe “Industria Përpunuese”. Struktura e financimit të deficitit korrent mbetet e mbështetur te flukset jo-borxh krijuese.

Borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë është reduktuar në 56.3% të PBB-së në fund të 9-mujorit 2022, nga 63.2% në fund të vitit 2021. Borxhi shënon vlerën 9,947.4 milion EUR, duke regjistruar një rritje vjetore me 10.9% kryesisht si pasojë e emetimit të Eurobondit në fund të vitit 2021. Sipas ndarjes sektoriale evidentohet një shpërndarje e borxhit si në vijim: (i) qeveria e përgjithshme zotëron rreth 48.5% të tij; (ii) korporatat depozitë-marrëse rreth 16.3%; (iii) sektorët e tjerë rreth 15.6% ; (iv) investimet e huaja direkte (IHD) rreth 17.2%; dhe (v) autoriteti monetar rreth 2.4% të borxhit.

Shpërndarja e borxhit sipas instrumenteve evidenton se “investimet e tjera” në formën e “huave” dhe “monedha dhe depozita ” përfaqësojnë instrumentin kryesor të borxhit, i cili pasohet nga IHD hua - ndër - kompani. Ndërkohë, emetimi i Eurobondit vitin e kaluar ka shkaktuar një rritje të mëtejshme të peshës së “investimeve të portofolit”, e cila mbetet edhe gjatë vitit 2022. Sipas maturitetit, borxhi afatgjatë përbën rreth 91.0% të totalit të borxhit. Ai është pakësuar në terma vjetorë me rreth 10.0%.

Në dhjetor 2022, niveli i rezervave valutore qëndron në 4,952 milionë euro, duke qëndruar pranë niveleve të një viti më parë. Raportet e mjaftueshmërisë së rezervës ndërkombëtare qëndrojnë dukshëm mbi nivelet e tyre të kriterëve të mjaftueshmërisë. Rezervat bruto në tremujorin e tretë vlerësohen të mbulojnë mbi 3 herë stokun total të borxhit të jashtëm afatshkurtër, dukshëm mbi nivelin kritik prej 100%. Për të njëjtën periudhë, stoku i rezervave ndërkombëtare vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për të mbuluar rreth 7.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh, mbi kërkesën minimale prej 4 muajsh.

Inflacioni i IÇK-së u rrit gjatë gjithë vitit 2022, duke arritur në 6.7% mesatarisht nga 1.8% mesatarisht gjatë 2017 – 2021. Inflacioni u rrit progresivisht deri në muajin tetor, kur shënoi 8.3% dhe u reduktua në muaj të vijim për të qëndruar në 7.4% në muajin dhjetor. Presionet e çmimeve

të mallrave të lidhura me luftën në Ukrainë, në veçanti çmimet e ushqimeve dhe naftës dhe në përgjithësi inflacioni i lartë global janë nxitësit kryesorë të një përsheptimi në normën e inflacionit. Së bashku me faktorët globalë, një mjedis i brendshëm i karakterizuar nga një kërkesë relativisht e qëndrueshme konsumatore, një treg pune i fortë dhe pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacion, lehtësuan përhapjen e këtyre goditjeve në vend. Për këto arsye, rritja e çmimeve ka një bazë të gjerë. Matje të ndryshme të inflacionit bazë qëndrojnë në nivele të larta historike duke u luhatur në një interval vlerash mesatare 5-6% për vitin. Krahasuar me inflacionin në vendet e rajonit dhe të BE-së, inflacioni në Shqipëri është më i ulët, duke reflektuar kryesisht një çmim të pandryshuar të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë dhe një mbiçmim të vazhdueshëm të lekut.

Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë ka nisur procesin për normalizimin e politikës monetare për të adresuar rritjen e inflacionit dhe për të kontrolluar efektet e raundit të dytë. Inflacioni total pritet të ngadalësohet gjatë vitit 2023 dhe të kthehet në objektivin e BSH-së në gjysmën e parë të vitit 2024.

Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare ka gjetur pasqyrim në tregjet financiare. Ky pasqyrim po ndodh në përputhje me veçoritë e çdo segmenti dhe në linjë me kohëvonesat e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Transmetimi ka qenë i menjëhershëm dhe i plotë në tregun ndërbankar, më i ngadaltë në segmentin e depozitave me afat, më i drejtpërdrejtë në kreditë për individë dhe ato për biznesin e vogël dhe më i ngadaltë në kreditë për biznesin e madh. Ndërkohë, yield-et e letrave me vlerë të qeverisë, pas rritjes së fortë që pësuan në periudhën korrik-nëntor të vitit 2022, kanë filluar të reduktohen, në reflektim të stabilizimit të pritjeve të tregut për ecurinë e normës bazë në të ardhmen dhe ngadalësimit të inflacionit. Në fund të vitit, yield-i 12 mujor qëndroi në nivelin 5.5%, ndërkohë normat e kredisë për individë u rritën në 8% nga niveli mesatar prej 6.1% në vitin 2021 dhe normat e interesit të kredisë për bizneset në 7% nga 5.5% në 2020 – 2021.

Edhe pse normat e interesit kanë ardhur në rritje, tregjet financiare mbeten likuide dhe me prime të përmbajtura rreziku, ndërsa kushtet e kreditimit janë ende akomoduese dhe fluksi i kredive vijon të mbetet pozitiv. Rritja e kredisë për sektorin privat pasi u përsheptua deri në 14% në muajin shtator 2022 dhe u ngadalësua në vijim, duke shënuar normën 10.6% në fund të vitit. Kjo normë rritjeje është e ngjashme me zgjerimin e kredisë një vit më parë. Rritja e kredisë ka vijuar të jetë me bazë të gjerë, por në kushtet e një mjedisi me rritje çmimesh dhe kostosh, rritja e kredisë për kapital qarkullues dhe në valutë ka dominuar kreditimin e bizneseve. Ndërkohë, kredia për individë ka vijuar të mbështetet nga zgjerimi i shpejtë i kredisë për banesa. Në terma të strukturës valutore, rritja e kredisë në lekë ka ardhur në ngadalësim, duke shënuar një normë mesatare prej 6.3% gjatë vitit 2022. Megjithatë, struktura valutore e portofolit të kredisë mbetet e balancuar me pesha të barabarta të kredisë në monedhën vendas dhe të huaj. Qëndrueshmëria financiare e sektorit bankar dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portofolit të kredisë krijojnë premisa për mbështetjen e vazhduar me fonde të ekonomisë.

*Stabiliteti makroekonomik*

Ekonomia shqiptare ka përballuar relativisht mirë goditje të shumta që nga viti 2019. Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit, deri në tërmetin e nëntorit 2019 dhe pandeminë Covid-19, ka shfaqur një tendencë pozitive zhvillimi që është reflektuar në një sërë parametresh makroekonomike në vend. Viti 2020, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, ishte një nga vitet më të vështira në tre dekadat e fundit. Sidoqoftë, me gjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë pasur për ekonominë e vendit, në sajë të përgjigjeve relativisht të mira të politikave ekonomike dhe masave të duhura rregullatore të ndërmarra, të dhënat statistikore dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë ishte konsiderueshëm më e shpejtë sesa pritshmëritë fillestare.

Edhe gjatë goditjes më të fundit të jashtme si pasojë e luftës në Ukrainë, e reflektuar në një pakësim të ofertës globale të disa mallrave bazë, të cilat kanë shkaktuar një rritje të fortë të nivelit të përgjithshëm të çmimeve (inflacionit) si dhe një shtrëngim të fortë të kushteve financiare, sërish deri më tani, fundamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj të gjitha këtyre goditjeve.

Pas recesionit të fortë në vitin 2020, në normën prej -3.5 përqind, ekonomia është rikuperuar fuqishëm në vitin 2021, në normën 8.5 përqind dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme.

Gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2022, ekonomia e vendit vijoi sërish të performojë me një rritje pozitive dhe relativisht të lartë. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) real u rrit me 6.37 përqind në terma vjetorë në tremujorin e parë të vitit 2022, duke u pasuar nga një rritje më e përmbajtur prej 2.65 përqind në tremujorin e dytë dhe vijoi trajektoren pozitive me një rritje prej 4.02 përqind në tremujorin e tretë, krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2021. Ndërsa në terma 9-mujor për vitin 2022, ekonomia ka shënuar rritje me 4.23 përqind kundrejt së njëjtës periudhë të 2021.

Sipas optikës së kërkesës agregate, sipas vlerësimeve të deritanishme, rritja përgjatë vitit 2022 duket të jetë gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme treguan një rritje të ndjeshme të shkëmbimeve gjatë vitit 2022, si në eksporte ashtu edhe në importe. Eksportet, si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve, veçanërisht turizmi, kanë pasur një ecuri mjaft të mirë. Megjithëse njëkohësisht edhe importet kanë regjistruar po ashtu një rritje të fortë (në reflektim të rritjes së kërkesës agregate), sërish kontributi neto i kërkesës së huaj ka qenë pozitiv.

Konsumi final, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, për 9-mujorin 2022 ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 6.4 përqind, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 8.3 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë, vetëm për 3-mujorin e tretë



konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan një normë rritje në respektivisht 6.7 përqind dhe 8.1 përqind.

Formimi i Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale) shënoi rritje me rreth 4.6 përqind në terma realë vjetorë përgjatë 9-mujave të vitit 2022, ndërkohë vetëm për 3-mujorin e tretë të vitit 2022 kjo normë ishte 7.1 përqind.

Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore të INSTAT, përgjatë 9-mujave të vitit 2022, eksportet e mallrave dhe shërbimeve kanë pasur një rritje të moderuar prej rreth 9.2 përqind, ndërsa rritja ka qenë e fortë në importet e mallrave dhe shërbimeve prej rreth 17.2 përqind.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, sektorët të cilët kanë shënuar rritjen më të fortë përgjatë periudhës 9-mujore të vitit 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” me rritje prej 13.28 përqind; “Tregtia me shumicë dhe pakicë” me rritje me 10.84 përqind; “Aktivitete financiare dhe të sigurimit” me rritje prej 10.77 përqind; “Ndërtimi” me rritje prej 9.31 përqind; si dhe “Informacioni dhe komunikacioni” me rritje prej 8.36 përqind, etj. Ndër sektorët që kanë pësuar rënie janë: “Administrimi publik, Arsimi dhe Shëndetësia” me rënie prej -3.03 përqind dhe “industria” me rënie prej -0.69 përqind.

*Zhvillimet në tregun e punës*, referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT, deri më tani kanë qenë relativisht pozitive, dhe në rikuperim të vijueshëm pas valës së rënies së aktivitetit ekonomik shkaktuar nga pandemia. Situata aktuale në numrin total të të punësuarve është përmirësuar duke shënuar rritje për çdo tremujor prej tremujorit të dytë 2021 e në vijim deri në tremujorin e tretë 2022 që janë dhe të dhënat e fundit të disponueshme. Për 9-mujorin 2022 rritja vjetore e numrit të të punësuarve ka qenë mesatarisht 4.7 përqind. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e 2022 ishte 11.3 përqind, duke pësuar rënie nga niveli prej 12.1 përqind i 9-mujorit të 2021. Ndërsa vetëm për 3-mujorin e tretë 2022, norma e papunësisë për grupmoshën 15-64 vjeç, ka shënuar 10.8 përqind, normën më të ulët të regjistruar në të paktën dekadën e fundit. Gjithashtu, për grupmoshën 15 vjeç e lart, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, shënoi nivelin më të ulët prej rreth 10.6 përqind.

*Pozicioni i jashtëm i ekonomisë*, një tjetër fundament tejet i rëndësishëm dhe tipikisht vulnerabël përballë goditjeve të tilla, mbeti relativisht solid, përtej pritshmërive fillestare për impaktin që mund të kishte ky fundament i ekonomisë prej goditjes së pandemisë dhe implikimeve negative zinxhir që mund të shkaktonte në fundamente të tjerë.

Në vitin 2021, bilanci i pagesave u mbyll me një rritje të mjeteve të rezervës në rreth 6.1 përqind të PBB. Ndërkohë për 9-mujorin e vitit 2022 bilanci i pagesave regjistroi një tepricë negative prej -58.1 milionë euro, kundrejt një balance pozitive prej 209.6 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Deficiti i llogarisë korrente për 9-mujorin 2022 shënon 621 milionë euro, i ngushtuar lehtësisht në terma vjetorë me rreth 4.6 milionë euro ose 0.7 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ecuria e deficitit korrent reflektoi kryesisht thellimin e deficitit tregtar në mallra dhe zgjerimin e balancës negative të të ardhurave parësore, faktorë të cilët janë

kompensuar në masë të madhe nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime, si dhe rritja e remitançave. Eksporti i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me turizmin u zgjerua në vlerën 2.2 miliardë euro për 9-mujorin 2022, ose rreth 48.8 përqind më shumë krahasuar me 1.5 miliardë euro në të njëjtën periudhë të një vitit më parë.

Nga ana tjetër, deficitit tregtar rezultoi me një zgjerim prej rreth 424 milion euro ose 16.3 përqind krahasuar me 9-mujorin e 2021. Eksporti i mallrave për 9-mujorin 2021 u rrit me 61.8 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021, por në të njëjtën kohë edhe importi i mallrave u zgjerua ndjeshëm me rreth 28.1 përqind, në reflektim të rritjes së kërkesës së brendshme stimuluar edhe nga sezoni turistik. Pësha ndjeshëm më e lartë e importeve të mallrave në raport me eksportet çoi për rrjedhojë në zgjerimin e deficitit tregtar. Remitancat për periudhën 9-mujore të vitit 2022 shënuan vlerën 592 milionë euro, me një rritje prej rreth 9.8 përqind krahasuar me 539 milionë euro në periudhën respektive të një viti më parë. Kontributi pozitiv i këtyre faktorëve ka kompensuar plotësisht thellimin e deficitit tregtar në mallra si dhe zgjerimin e bilancit negativ të të ardhurave parësore. Në 9-mujorin e parë të vitit 2022, teprica pozitive e llogarisë financiare dhe kapitale rezultoi në 582 milionë euro krahasuar me 734 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brenda kësaj llogarie, për këtë periudhë, investimet e huaja direkte hyrëse shënuan nivelin prej 984.3 milionë euro, ose një rritje prej 34.8 përqind në krahasim me nivelin prej 730 milionë euro të së njëjtës periudhë të 2021. Gjithashtu, vetëm për 3-mujorin e tretë të vitit 2022, IHD shënuan vlerë prej +344.3 milionë euro me rritje rreth +32.2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në këtë tremujor, hyrjet valutore në formën e investimeve të huaja direkte janë përqendruar kryesisht në sektorin e hidrokarbureve (në masën 25.7%), energjisë (në masën 8.7%), ndërmjetësimit financiar (në masën 12.4%) dhe pasuritë e paluajtshme (në masën 22.3%).

Stoku i rezervave valutore, në fund të dhjetorit 2022, është 4,952 milionë euro, të mjaftueshme për të mbuluar 7.1 muaj importe vjetore të mallrave dhe shërbimeve.

Këto zhvillime në pozicionin e jashtëm të ekonomisë dhe performanca relativisht e mirë e ekonomisë në tërësi janë reflektuar edhe në fondamentin tjetër mjaft të rëndësishëm të kursit të këmbimit. Duke pasur një regjim të lirë të kursit të këmbimit, monedha vendase (Leku) ka qëndruar mjaft stabil ndaj valutave kryesore (Euro, USD etj.) përgjatë viteve 2020 dhe 2021 dhe vijon të jetë mjaft i qëndrueshëm. Për vitin 2022, leku është nënçmuar ndaj dollarit amerikan me rreth 1.6% dhe është mbiçmuar ndaj euros me rreth 4.9% që nga fundi i vitit të kaluar.

Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një themel tjetër i fortë i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të vitit 2022 nivelin 5.0% nga 8% që shënonin rreth dy vite më parë. Stoku total i kredive bankare për vitin 2022 pati një rritje me 6.5%, ku stoku i kredive në lekë u rrit me 5.9%, ndërsa ai i kredive në valutë u rrit me 7.1%.

Sa i përket Depozitave, gjatë vitit 2022 ato u rritën me 5.9 përqind, ku depozitat në lek u rritën me 1.4 përqind, ndërsa depozitat në valutë u rritën me 10.1 përqind. Në fund të vitit 2022, rezultoi se

rreth 46.1 përqind e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 53.9 përqind përbëhet nga depozitat në valutë të huaj.

Rritja e inflacionit është kthyer në një nga sfidat kryesore makroekonomike për ekonominë tonë, si në shumë vende të tjera të botës. Megjithatë, në një krahasim gjeografik evidentohet se inflacioni në vendin tonë ka qenë ndjeshëm më i ulët se sa në vendet e rajonit, apo se sa mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian. Inflacioni, pasi shënoi nivelin më të lartë prej 8.3 përqind në muajin tetor, erdhi në rënie gjatë muajve nëntor e dhjetor të vitit 2022. Përgjatë vitit 2022, ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit shënoi 6.7 përqind, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte 2.0 përqind. Rënia e inflacionit për të arritur objektivin 3 përqind, do të mbështetet nga stabilizimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare, nga ecuria e mirë e kursit të këmbimit, si edhe nga efektet e kursit normalizues të politikës monetare.

Pas recesionit të fortë në vitin 2020, në normën prej -3.5 përqind, ekonomia u rimëkëmb fuqishëm në vitin 2021, në normën 8.5 përqind dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 3.7 përqind për vitin 2022 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 3.4 përqind përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2023-2025. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 2.6, 3.8 dhe 3.9 përqind respektivisht për vitet 2023, 2024 dhe 2025.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të ketë një efekt të moderuar pozitiv. Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, veçanërisht pas rikthimit në nivelet normale të inflacionit i cili pritet të ndodhë gradualisht brenda vitit 2023, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredi-marrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet edhe nga përmirësimi i pritshëm i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ që goditja e ofertës ka shkaktuar në inflacion dhe në normat e interesit.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi ashtu edhe nga investimet. Gjithashtu edhe kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të ketë efekt të moderuar pozitiv. Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Eksportet si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve (veçanërisht turizmi) pritet të kenë një ecuri të mirë, por njëkohësisht pritet që edhe importet të kenë po ashtu një rritje (në reflektim të rritjes së kërkesës agregate, veçanërisht investimeve), e për rrjedhojë kontributi neto i kërkesës së huaj në afat-mesëm pritet të jetë sërish pozitiv, por më i moderuar se ai i kërkesës së brendshme

### *Stabiliteti financiar dhe përshpejtimi i kreditimit të ekonomisë.*

Sektori bankar ka ruajtur një nivel adekuat të kapitalizimit, pozicionit të likuiditetit dhe përfitueshmërisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vazhduar të bien dhe raporti i tyre ndaj totalit të kredive arriti në 5.1% në shtator 2022 nga 6.5% një vit më parë. Gjithashtu, kredia për sektorin privat ka vijuar të rritet, duke mbështetur nevojat e familjeve dhe bizneseve për likuiditet dhe investime.

Lufta në Ukrainë nuk ka ndikuar në ecurinë e sektorit bankar deri tani, duke pasur parasysh bazat e tij të forta dhe ekspozimin e kufizuar të drejtpërdrejtë ndaj Rusisë dhe Ukrainës. Ushtrimet e rezistencës tregojnë se sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj goditjeve të mundshme për shkak të rezervave të forta të kapitalit dhe likuiditetit, dhe nivelit të lartë të provigjonimeve të kredive me probleme.

### *Pozicioni i jashtëm i ekonomisë dhe bilanci i pagesave mbetet përgjithësisht i qëndrueshëm*

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë ka ardhur në përmirësim ashtu sikurse edhe rezervat valutore dhe treguesit e aftësisë paguese të vendit. Deficiti i llogarisë korente është tkurrur në 4.6% të PBB-së në 9-mujorin 2022, nga 7.6% një vit më parë. Përmirësimi i tij është ndikuar kryesisht nga rritja e eksporteve të shërbimeve dhe e remitançave. Investimet e huaja direkte kanë ardhur në rritje gjatë kësaj periudhe dhe janë më të larta se deficiti i llogarisë korente. Ecuria e mirë e tyre ka rikthyer flukset jo-borxh krijuese në burimin kryesor të financimit. Momenti aktual pozitiv i rritjes së IHD-ve pritet të shtrihet në periudhën afatmesme. Rezervat valutore janë të larta me stokun në fund të dhjetorit 2021 në 4,952 milionë euro, të mjaftueshme për të mbuluar 7.1 muaj importe mesatare të mallrave dhe shërbimeve. Borxhi i jashtëm bruto ka rënë në 56.3% të PBB-së në fund të tremujorit të tretë 2022 nga një shifër mesatare prej 64.5% në 5 vitet e fundit. Treguesit e kapacitetit ripagues dhe të mjaftueshmërisë së likuiditetit kanë ardhur në përmirësim për shkak të rritjes së eksporteve dhe të ardhurave fiskale. Stabiliteti i pozicionit të jashtëm të ekonomisë u reflektua edhe në tregun valutor, ku kursi i këmbimit të lekut ndaj euros është mbiçmuar gjatë gjithë vitit 2022.

### **Politikat monetare dhe fiskale**

Banka e Shqipërisë ka filluar normalizimin e politikës monetare në përgjigje të rritjes së presioneve inflacioniste me burim si nga ekonomia e huaj, ashtu dhe nga ajo e brendshme. Ajo ka rritur normën bazë të interesit pesë herë gjatë vitit 2022, nga niveli më i ulët historik prej 0.50% në nivelin 2.75% në muajin dhjetor. Rritja e normës bazë është përcjellë tek tregjet financiare vendase, ku normat e depozitave dhe kredive në lekë kanë njohur rritje graduale. Pavarësisht rritjes së normës bazë, kushtet monetare mbeten mbështetëse për ekonominë dhe kredia bankare vazhdon të jetë një financuese e zgjerimit të aktivitetit ekonomik dhe e mbulimit të nevojave për likuiditet.

Inflacioni parashikohet të reduktohet gjatë vitit 2023 dhe do të kthehet në objektiv brenda gjysmës së parë të vitit 2024. Rënia e inflacionit në vend do të mbështetet nga stabilizimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare, nga ecuria e mirë e kursit të këmbimit edhe nga efektet e kursit normalizues të politikës sonë monetare. Ky normalizim, i transmetuar nëpërmjet një rritjeje graduale drejt një niveli neutral të normës bazë të interesit, do të krijojë premisa për një balancim më të mirë të kërkesës dhe ofertës në ekonomi.

Në përputhje me mandatin e stabilitetit të çmimeve dhe duke në konsideratë se rreziqet për inflacionin janë në kahun e sipërm, Banka e Shqipërisë ka pasur komunikuar se do të vijojë të rrisë normën e interesit në të ardhmen. Megjithatë, shpejtësia e normalizimit të politikës monetare do të varet nga të dhënat e reja dhe do të udhëhiqet nga përditësimi i parashikimeve për inflacionin dhe për ekonominë.

Prioritetet e politikës monetare në kontekstin e kriterit ekonomik janë:

- Vijimi i hartimit të politikës monetare në funksion të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve;
- Përmirësimi i mekanizmit të transmisionit nëpërmjet mbështetjes së iniciativave për zhvillimin e tregut të parasë;
- Modernizimi i mëtejshëm i sistemit të pagesave dhe zgjerimi i shërbimeve të pagesave;
- Harmonizimi i vazhduar i politikës monetare me atë fiskale dhe makroprudenciale.

Kombinimi aktual i politikave ekonomike është i përshtatshëm dhe i nevojshëm për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe për mbështetjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të rritjes së ekonomisë.

### *Politika fiskale*

Në vitet e fundit, deri përpara goditjes nga pandemia, financat publike kishin hyrë në një trajektore të sigurtë dhe optimale të konsolidimit fiskal, e materializuar në parametrat më kyç të qëndrueshmërisë. Së pari, kjo u materializua në uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 5% të PBB në vitin 2013 në poshtë nivelit prej 2% në vitin 2019.

Pas një stimuli të lartë, për të kryer një politikë fiskale ekspansioniste të domosdoshme dhe njëkohësisht të paevitueshme gjatë viteve 2020 dhe 2021 me qëllim amortizimin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme 2023 – 2025 do të ri-orientohet sërish drejt konsolidimit fiskal, në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të Ligjit Organik të Buxhetit.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse.

Politika fiskale për periudhën afatmesme do të targetojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore rënëse graduale por e përvitshme, ndërsa balanca primare do të rikthehet në nivel

pozitiv duke nisur nga viti 2023 dhe do të vijojë e tillë, në përputhje edhe me rregullat fiskale në LOB.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, do të synohet ruajtja e një raporti të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale ( investimet publike vetëm nga qeveria qendrore) do targetohen të jenë rreth 5 përqind e PBB në çdo vit buxhetor.

Deficiti buxhetor për vitin 2023 planifikohet të jetë në nivelin 2.6 përqind të PBB-së nga rreth 3.2 përqind i pritshëm për vitin 2022; nivelin prej 2.2 përqind të PBB-së në vitin 2024 dhe 2025. Balanca primare pritet të jetë pozitive në rreth 0.3 përqind, në një përmirësim të qenësishëm nga niveli negativ prej rreth -1.2 përqind që pritet për vitin 2022 dhe do të vazhdojë të zgjerohet më tej në nivelin 0.9 përqind në 2024 dhe 1.2 përqind në 2025. Ndërkohë që, duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim ky target do të jetë edhe ligjërisht i detyrueshëm, ku në LOB përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive).

Balanca korrente fiskale (diferenca midis investime publike dhe deficit fiskal) do të jetë pozitive në vitin 2023, në nivelin prej 3.1 përqind të PBB nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 2.4 përqind për vitin 2022, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal (“rregullin e artë” të buxhetit).

Gjithashtu edhe borxhi publik bruto do vijojë trajektoren rënëse të nisur që në vitin 2021 pas pandemisë në përputhje me rregullin respektiv fiskal. Në vitin 2022 pritet që borxhi publik të bjerë në rreth 68.8 përqind të PBB nga rreth 73.2 përqind që ishte në vitin 2021 dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth 67.5 përqind në vitin 2023. Balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv (suficit primar) që prej vitit 2023 e në vijim. Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 65.3 përqind në vitin 2025 dhe më tej në rreth 55 përqind në vitin 2031.

Shqipëria ka shënuar përparim në fushat bazë të politikave. Brenda vitit 2022 është parashikuar miratimi i Ligjit të ri të tatimit mbi të ardhurat individuale dhe të korporatës, në linjë me Direktivat e BE për tatimet direkte, dhe Rekomandimet e OECD-së. Shqipëria, me mbështetjen e Departamentit të Çështjeve Fiskale të FMN-së, ka hartuar Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, e cila përmbledh reformat kryesore në fushën e politikave tatimore dhe administrimit tatimor dhe atij doganor, me synim rritjen e të hyrave të buxhetit me 3% të GDP-së brenda një periudhe afatmesme, dhe me objektivin për tejkalimin e nivelit 30% të të ardhurave të buxhetit në raport me GDP.

Implementimi i plotë i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS), në fushën e politikave fiskale u shty në kohë për shkak të: (i) pasojave në ekonominë e vendit të tërmetit të fund vitit 2019; (ii) pasojave të Pandemisë globale të Covid 19 në ekonomi; dhe (iii) pasojave po në ekonominë e vendit të luftës Rusi-Ukraine. Megjithatë, në fushën e politikave tatimore, nga janari i vitit 2022 ka filluar implementimi i masave të parashikuara në MTRS, fillimisht në fushën e akcizave, dhe do vazhdojë në vitin 2023 në tatimet direkte mbi të ardhurat e individëve dhe korporatave. Më tej, kjo strategji do zbatohet edhe për ndryshimet e projektuara në fushën e tatimit

mbi vlerën e shtuar. Ndërkohë, në administrimin tatimor e doganor, masat e parashikuara në MTRS po zbatohen, ku më sinjifikative janë zhvillimet në fushën e fiskalizimit, implementimit të e-invoicing, reduktimit të barrierave burokratike dhe zgjerimit të ndjeshëm të shërbimeve elektronike. Rezultatet në reforma janë materializuar në rritjen e të ardhurave të buxhetit, të cilat në 2022 arrijnë në 28.2% të GDP-së, në vitin 2023 janë projektuar 29% e GDP-së, ndërkohë që në vitin 2019, si vit referues i fillimit të reformës, kanë qenë në nivelin 27.2% e GDP-së. Shqipëria po ecën me hapa të sigurtë drejt rritjes dhe përmirësimit të burimeve vetjake, të cilat do të mbështesin buxhetet respektive në vite.

## **Ndërveprimi i forcave të tregut**

Procesi i privatizimit mbetet një prioritet, veçanërisht në sektorët strategjikë, duke synuar tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendas që do të kishte një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik. Në privatizimet strategjike dhe jo strategjike nuk ka kufizime për pjesëmarrësit.

Privatizimi i paketave aksionere strategjike (shoqërive tregtare që operojnë në sektorë me rëndësi të veçantë për ekonominë) zbatohet në përputhje me Ligjin Nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

Në kuadër të realizimit të objektivave lidhur me privatizimin e pasurive shtetërore, Ministri përgjegjës për ekonominë rishikon çdo vit planin për privatizimin e pasurive shtetërore:

- Plani i veprimit për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore në sektorët strategjikë për periudhën 2015 – 2020, si Dokumenti Nr. 7476, datë 30.09.2015;
- Plani i veprimit për privatizimin e pasurive për periudhën 2016 – 2020, si Dokumenti Nr. 3459, datë 29.04.2016, ndryshuar për periudhën 2018 – 2020, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr. 88, datë 21.03.2018;
- Plani i veprimit për privatizimin/likuidimin e ndërmarrjeve shtetërore në sektorët jo strategjikë 2017 – 2020, si Dokumenti Nr. 2564, datë 29.03.2017.

Shitja e asetëve shtetërore bëhet nëpërmjet procedurës së ankandit publik ku ish-pronarët e tokës kanë të drejtën e parablerjes. Disa nga këto pasuri janë blerë nga pronarët e truallit, duke ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes.

Gjate vitit 2021 janë privatizuar dhe lidhur kontratat e shitjes për 7 asete ne total, duke realizuar 24 696 978 Lek te ardhura dhe 57 852 504 te ardhura ne Bono Privatizimi. Ne total janë realizuar 82 549 482 te ardhura.

Gjate periudhës janar – tetor 2022 është privatizuar dhe lidhur kontrata e shitjes për 1 aset ne total, duke realizuar 6 278 056 te ardhura ne Leke dhe 51 750 000 te ardhura ne Bono Privatizimi. Ne total janë realizuar 58 028 056 leke te ardhura.

*Për më shumë informacion mbi privatizimin, ju lutem referojuni Kapitullit 20: Sipërmarrja dhe Politika industriale.*

## **Hyrja dhe dalja nga tregu**

Në kuadër të përmirësimit të kuadrit rregullator, gjatë vitit 2021 për nënindikatorin dalje nga tregu mund të përmendim miratimin e VKM-së Nr. 65, date 3.02.2021 “Për miratimin e rregullores së marrëveshjeve jashtëgjyqësore të riorganizimit të përsheptuar”. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat për lidhjen e marrëveshjeve të riorganizimit të përsheptuar jashtë gjykatës ndërmjet debitorit, i cili është objekt i ligjit për falimentimin, dhe dy ose më shumë kreditorëve, nëse debitori është i paaftë.

Brenda vitit 2023 pritet të miratohet VKM për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat dhe kushtet e organizimit të provimit të licencimit të administratorëve të falimentimit”. Miratimi i këtij drafti do të ndryshojë disa kritere mbi pranimin e kërkesave për licencim si administrator falimentimi.

Deri në vitin 2007, regjistrimi i personave juridikë bëhej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që regjistrimi i personave fizikë bëhej pranë Gjykatave të Rretheve. Për këtë arsye, duke qenë se regjistrimi ishte një procedurë tërësisht gjyqësore, krijimi i një biznesi në Shqipëri haste një numër të madh barrierash gjyqësore dhe administrative, të cilat shtonin kostot dhe krijojnë vështirësi në ushtrimin e aktivitetit tregtar. Për më tepër, në atë kohë, mungonte një regjistër tregtar lirisht i aksesueshëm nga publiku dhe informacioni nuk mund të merrej në kohë reale nga personat e interesuar.

Me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe uljen e kostove, me Ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, u krijua Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), e cila ka si funksion kryesor trajtimin e procedurave të regjistrimit të biznesit, si dhe mbajtjen dhe administrimin e Regjistrimit Tregtar.

Me krijimin e QKR-së, regjistrimi i biznesit nga një proces gjyqësor u transformua në një proces administrativ me vetëdeklarim, në një qendër me një ndalesë. Falë kësaj, u mundësua që me regjistrimin e subjekteve në regjistrin tregtar të realizohej edhe regjistrimi i njëkohshëm i tyre pranë administratës tatimore qendrore dhe vendore, skemës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore, Inspektoratit të Punës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Reforma në fushën e regjistrimit u pasua me reformën në fushën e licencimit dhe lejimit të biznesit. Procesi i licencimit/lejimit deri në vitin 2009 ishte shumë i gjatë, burokratik, i kushtueshëm dhe jo transparent. Ekzistonte një numër i madh licencash/lejesh dhe institucionesh të përfshira në këtë proces. Aplikimi bëhej në formë shkresore dhe procedurat, afatet dhe formatet e aplikimit nuk ishin të standardizuara. Gjithashtu, nuk ekzistonte një regjistër kombëtar për licencat dhe lejet.



Krijimi i Qendrës Kombëtare të Licencimit, solli një përmirësim të mëtejshëm të klimës së biznesit në vend, reduktim të barrierave administrative, si dhe rritje të transparencës në procedurat e licencimit/lejimit. Një risi tjetër, ishte edhe transformimi i procesit të licencimit/lejimit nga një proces shkresor në një proces tërësisht elektronik, me anë të ngritjes dhe funksionimit të Regjistrisë Kombëtare të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Në dhjetor 2015, u miratua Ligji Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)”, i cili krijoi institucionin e ri, Qendrën Kombëtare të Biznesit ku ndër funksionet e kësaj qendre është edhe trajtimi i procedurave të regjistrimit dhe licencimit/lejimit të biznesit.

Bashkimi i QKR-së dhe QKL-së mundësoi krijimin e QKB-së, si një qendër e vetme me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit. Kjo ka sjellë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Krijimi dhe funksionimi i QKB-së u mirëprit nga subjektet, pasi tashmë procedurat dhe i gjithë informacioni i nevojshëm për të operuar në tregun shqiptar mund të gjendet lehtësisht në një qendër të vetme.

Shërbimet administrative të ofruara nga QKB ofrohen me procedura të thjeshta, në mënyrë elektronike, brenda afateve kohore të shkurtra dhe me tarifa simbolike.

Ndërkohë, nga fillimi i vitit 2020, QKB ka ofruar të gjitha shërbimet e saj vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, dhe për aplikimet online nuk zbatohet tarifa e aplikimit në QKB prej 100 ALL.

Regjistri Tregtar është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji, dhe mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas ligjit regjistrohen nga QKB-ja në format elektronik në dosjen e subjektit në regjistër. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese: a) të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, ruhen dhe arkivohen nga QKB-ja vetëm në format elektronik; b) të paraqitura në format shkresor, sipas këtij ligji, konvertohen dhe ruhen nga QKB-ja në format elektronik. QKB-ja nuk ka detyrim të mbajë e të arkivojë aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor.

Regjistri përmban gjithashtu të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.

Sipas Ligjit Nr. 9723/2007, subjektet që detyrohen të regjistrohen janë:

- subjektet tregtare;
- shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;
- personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;

- zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;
- shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;
- shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së.

Çdo person i interesuar mund të kryejë, sipas këtij ligji, pa pagesë, pranë çdo sporteli shërbimi, kërkime në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve.

Aplikimi për regjistrim bëhet elektronikisht përmes sportelit elektronik (aplikimi online) ose në sportelet e shërbimit të QKB, të ndodhura në zyrat qendrore të QKB-së, si dhe në njësitë e qeverisjes vendore ose dhomat e tregtisë, si dhe në zyrat noteriale (vetëm on-line aplikim).

Aplikimi online mund të bëhet nga çdo individ/zyrtar ose subjekt (i pajisur me NUIS/NIPT) (pa pasur nevojë që të paraqitet pranë sporteleve fizike të QKB), i cili së pari duhet të regjistrohet në portalin unik qeveritar e-Albania. Regjistrimi në këtë portal bëhet duke plotësuar të dhënat e kërkuara përkatësisht në varësi të faktit nëse aplikimi do të kryhet nga një individ ose një subjekt.

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, kapitali fillestar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar është 100 lekë, me përjashtim të shoqërive aksionare, kapitali i parë fillestar i të cilave varion nga 3 500 000 lekë te shoqëritë aksionere me ofertë private në 10 000 000 lekë te shoqëritë aksionere me ofertë publike.

Miratimi i Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të ndërmarrjeve tregtare” mundësoi bashkimin ndërkufitar midis një kompanie të huaj dhe asaj shqiptare. Për më tepër, në përputhje me parashikimet e ligjit të sipërcituar, Qendra Kombëtare e Biznesit ka zhvilluar funksione të reja në regjistrin elektronik, që mundësojnë aplikimin për bashkim ndërkufitar mes një shoqërie të huaj dhe një shoqërie shqiptare. Megjithatë, aktualisht aplikimi mund të bëhet vetëm për bashkimin ndërkufitar që rezulton në krijimin e një shoqërie të re shqiptare.

Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” është ndryshuar në shkurt 2015 me Ligjin Nr. 8/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, me qëllim përafrimin e këtij ligji me Direktivën 2009/101/KE, duke parashikuar depozitimin elektronik të pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të auditimit nga subjektet.

Njësia ekonomike regjistron dhe depoziton në regjistrin tregtar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur këto dokumente duhet të ruhen deri në 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Dorëzimi i tyre bëhet elektronikisht përmes portalit e-Albania.

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, si dhe me mbështetjen e Bankës Botërore është implementuar projekti “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar”. Me anë të këtij projekti është mundësuar:

- Përcaktimi i qartë i dokumenteve që duhet të hartohen nga subjektet, në varësi të klasifikimit të tyre, gjatë procesit të raportimit financiar;
- Rritja e mëtejshme të transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar;
- Përpunimi dhe gjenerimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare;
- Zbatimi i formatit (sistemit) të ri për dërgimin e deklaratave të shërbimit në QKB, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, duke përdorur një format të komunikimit elektronik (XML).

Në shkurt 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit nënshkroi marrëveshjen për pjesëmarrjen e regjistrin tregtar shqiptar në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtarë (BIFIDEX). Falë këtij projekti, mundësohet komunikimi në kohë reale i të dhënave të besueshme, të përditësuara për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në regjistrat tregtarë të vendeve pjesëmarrëse, si dhe baza për krijimin e shërbimeve globale për të gjitha subjektet në vendet pjesëmarrëse. Portali do të mundësojë gjithashtu ndërlidhjen e bizneseve shqiptare me ato të rajonit, duke mundësuar rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të vendeve të rajonit.

Ndërkohë, si rregull, çdo aktivitet ekonomik kryhet lirisht në Shqipëri. Sidoqoftë, disa aktivitete që mund të ndikojnë në shëndetin publik, sigurinë kombëtare, etj, kërkohet që t'i nënshtrohen procesit të licencimit.

Në aneksin e Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen fushat dhe kategoritë kryesore të licencave/ autorizimeve/lejeve të lëshuara në Shqipëri nga institucionet qendrore.

Ndërkohë, në VKM-në Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, bëhet ndarja e mëtejshme e licencave dhe lejeve të lëshuara nga institucionet qendrore, në licenca/leje të trajtuara nga ose nëpërmjet QKB-së dhe në licenca/leje të trajtuara pa përfshirjen e QKB-së.

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të regjistruar dhe të pajisur me NUIS/NIPT, mund të aplikojnë në sportelet e shërbimit të QKB-së për pajisjen me një nga licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së. Duke filluar nga viti 2020, shërbimet me licencë/leje ofrohen vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar e-albania.

Megjithatë, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, Qeveria e Shqipërisë ka krijuar një grup pune për reformën e rregullimit në fushën e licencimit, ku QKB është një institucion kontribuues. Në kuadër të kësaj reforme, grupi i punës ka propozuar eliminimin e 22 licencave dhe përmirësimin e mëtejshëm të procesit të licencimit, me anë të riklasifikimit të

licencave ose reduktimin e afatit të vendimmarrjes për 49 licencat e tjera. Aktualisht janë eliminuar 11 licenca, si më poshtë:

- Licenca “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)”, me kodin II.2.A.2;
- Licenca “Prodhim tregtim i farave dhe fidanëve”, me kodin II.4;
- Licenca “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.A;
- Licenca “Shërbime të ekspertizës dhe ose profesionale lidhur me pyje apo kullota”, me kodin III.7.A;
- Licenca “Shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A;
- Licenca “Shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me burimet hidrokarbure”, me kodin IV.4.B;
- Licenca “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi”, me kodin VII.3.B.3;
- Licenca “Agjenci që trajtojnë praktikat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4;
- Licenca “Shërbimi i Përmbartimit”, me kodin XI.2;
- Licenca “Auditues energjetik”;
- Licenca “Shërbimet energjetike”.

Në luftën kundër informalitetit, administrata tatimore vitet e fundit zbaton planet sektoriale sipas modelit më të mirë të menaxhimit të rrezikut të përputhshmërisë dhe skemës së OECD. Ndër këto plane mund të përmendim planin sektorial në sektorin e ndërtimit, turizmin, nëndeklarimin e pagave, planin e trajtimit të tatimpaguesve në kufijtë e ndryshimit për përgjegjësitë tatimore.

Kontrollet kryesisht nga viti 2022 kryhen për një periudhë 2-vjeçare dhe kjo ka sjellë një shpërndarje më të mirë të burimeve dhe një kontroll më të gjerë në treg ku ka të dhëna potenciale të rrezikut, duke përmirësuar kështu konkurrencën dhe forcimin e besimit në administratën tatimore.

Tabela: Numri i Tatimpaguesve që i nënshtrohen kontrollit ose vizitës fiskale ndër vite

2018	2019	2020	2021	2022
2,287	2,025	1,509	1,977	2,500

Administrata tatimore kryen monitorime në vend mbi bazë risku dhe në këtë mënyrë adresohen verifikimet aty ku është e nevojshme.

Për periudhën janar – tetor 2022 janë kryer 9 916 monitorime në vend dhe janë konstatuar 814 shkelje tatimore. Ky numër i lartë monitorimesh lidhet me procesin e fiskalizimit, i cili është kryesisht informativ. Gjatë periudhës janar – tetor 2022 janë kryer më shumë vizita monitoruese se vitin e kaluar, për të cilat janë kryer 5 480 monitorime, ku janë konstatuar 504 shkelje.

Bazuar në të dhënat për shkeljet tatimore, vihet re se për vitin 2022:

- është ulur numri i subjekteve të paregjistruara;
- vihet re tendencë pozitive e tatimpaguesve për deklarin real të numrit të punonjësve;
- reduktimin e rasteve të zbulimit të subjekteve që disponojnë mallra pa dokumentacion justifikues;
- ulje në rastet e moslëshimit të faturës.

#### **A. Reduktimi i punës së padeklaruar dhe të nëndeklaruar gjatë vitit 2022**

Në kuadër të rekomandimit për ekzistencën e një strategjie gjithëpërfshirëse, me urdhër të Kryeministrit u krijua një grup pune me synim reduktimin e punës së padeklaruar dhe të nëndeklaruar gjatë vitit 2022. Në zbatim të Urdhrit u koordinua puna mes disa institucioneve të rëndësishme të vendit si MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Inspektorati Shtetëror i Punës. Nga analiza e riskut u identifikuan 10 153 tatimpagues të cilëve u janë dërguar letra të personalizuar si thirrje për përmirësimin e deklarinave. Kjo shënon përpjekjet e administratës tatimore për të qenë e hapur dhe për të krijuar ura komunikimi me tatimpaguesit.

Efektet e planit të zbatuar janë si më poshtë për të gjithë popullsinë e përzgjedhur:

- 26% e numrit të vendeve të punës kanë deklaruar rritje pagash;
- 12 015 lekë është rritja mesatare e pagës për rastet me rritje page;
- 7% më shumë kontribute sociale dhe shëndetësore të deklaruara.

Me kalimin e viteve niveli i pagës minimale është rritur, rritje është vërejtur edhe në të dhënat për pagat mesatare të llogaritura me kontribute dhe numrin e punonjësve.

Situata e pandemisë Covid-19 ka ndikuar në rritjen e numrit të punonjësve të larguar nga lista e pagave gjatë muajve të parë të vitit, por në fund të vitit 2020, të dhënat u rikuperuan në nivelet e mëparshme, si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme dhe politikave të ndërmarra nga qeveria dhe administrata tatimore.

#### ***Fiskalizimi***

Fiskalizimi konsiderohet si një reformë madhore që ndikon në uljen e konkurrencës së pandershme duke eliminuar faturat fiktive të lëshuara nga librat e vjetër tatimorë (faturat në letër).

Shitjet nga tatimpaguesit pasivë nuk lejohen. Fiskalizmi ka thjeshtuar mënyrën e faturimit dhe verifikimit nga administrata tatimore në kohë reale. Kjo reformë e madhe ka çuar në rritjen e të ardhurave.

*në 000 leke*

	2018	2019	2020	2021	9 Mujor 2022

<b>Tatim mbi vlerën e shtuar (bruto)</b>	50,903,912	49,456,618	46,174,825	56,461,470	42,262,308
<b>Kontributi shoqëror dhe shëndetësor në total</b>	88,778,080	94,167,402	94,116,872	106,266,160	87,109,831

*Burimi: Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikave, DPT*

Nga tabela e mësipërme, të ardhurat nga TVSH-ja për vitin 2021 rezultojnë me një rritje prej 18% krahasuar me vitin 2020, ndërsa kontributet shoqërore dhe shëndetësore janë rritur me 13%. Për shkak të ndikimit të situatës së Covid-19 në ekonomi, viti 2020 shënon të ardhurat më të ulëta të mbledhura nga TVSH-ja dhe nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

Bazuar në një projeksion për nivelin e të ardhurave për TVSH-në për 12 muajt e vitit 2022, parashikojmë një rritje prej 3% krahasuar me vitin 2021. Ndërsa përsa i përket nivelit të të ardhurave nga kontributet shoqërore dhe shëndetësore referuar projeksionit për vitin 2022, parashikojmë një rritje prej 9% të tyre krahasuar me vitin 2021.

Të dhënat e disponueshme nga fiskalizimi deri më 31.08.2022 janë si më poshtë:

- 95 012 tatimpagues aktivë plotësisht të fiskalizuar që lëshojnë fatura të fiskalizuara. 540 milionë fatura të fiskalizuara që nga 1 janari 2021.
- 102 243 tatimpagues të pajisur me certifikatën e fiskalizimit.
- 100% e Biznesit të Madh (BM) dhe Biznesit të Vogël me TVSH (BV me TVSH) që janë aktive dhe ushtrojnë aktivitet është i fiskalizuar.
- 92% e Bizneseve të Vogla (BV) janë fiskalizuar.

Në proces verifikimi mbeten 7 089 tatimpagues. 287 tatimpagues janë penalizuar për mos instalim të sistemit të fiskalizimit, nga këto 127 BM, 50 BV me TVSH dhe 109 BV.

### ***Mbështetja e administratës tatimore për tatimpaguesit.***

Në klimën e biznesit dhe të bërit biznes, digjitalizimi dhe kalimi në të gjitha shërbimet online shmang pritjet në radhë, mundësinë e korrupsionit, si dhe krijon lehtësira për taksapaguesit për të ulur kostot e aplikimeve, etj.

Duke lëvizur drejt shërbimeve digjitale, ne ofrojmë një klimë më të favorshme për të bërë biznes dhe lehtësi në marrjen e kredencialeve dhe shërbimeve.

### ***Numri i subjekteve të reja të regjistruara për periudhën 2018 – 2022***

Për vitin 2021 vihet re një rritje e numrit të tatimpaguesve të rinj të regjistruar dhe një trend pozitiv rritjeje për periudhën janar – shtator 2022 krahasuar me vitin 2020 si vit në të cilin ndikoi situata e pandemisë Covid-19.

## ***Shërbimet online për periudhën 2018 – 2022***

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ofron nëpërmjet portalit e-Albania një sërë shërbimesh, duke krijuar mundësinë që tatimpaguesit dhe individët të marrin shërbimin e kërkuar, duke kursyer kohë, burime njerëzore dhe kosto administrative.

Gjithashtu, në këtë mënyrë synohet përmirësimi i gatishmërisë, cilësisë dhe transparencës së shërbimeve publike, si dhe reduktimi i kohës së zbatimit të procedurave dhe kostove të administratës publike. Aktualisht, Administrata Tatimore ofron 31 shërbime online nëpërmjet portalit e-Albania, nga të cilat 14 shërbime u mundësojnë tatimpaguesve të paguajnë të gjitha llojet e taksave online.

Gjatë vitit 2018, në portalin e-Albania janë ofruar 9 shërbime. Ndërkohë gjatë viteve të fundit portalit kanë nisur t'i shtohen edhe 8 shërbime të tjera.

### **Që nga maji 2022, të gjitha shërbimet e Administratës Tatimore ofrohen online.**

Numri i shërbimeve të ofruara, gjatë periudhës 2018 - 2022

Shërbimet online

<b>Viti</b>	<b>Nr.</b>
<b>2018</b>	399,871
<b>2019</b>	366,806
<b>2020</b>	640,386
<b>2021</b>	902,655
<b>Janar – Qershor 2022</b>	1,138,511
<b>Total</b>	<b>3,448,229</b>

### **Klima e biznesit dhe besimi në Administratën Tatimore si dhe krijimi i bazës për një treg konkurrues ndikohet gjithashtu nga:**

- Pastrimi i stokut të rimbursimeve të TVSH-së për pretendimet e miratuara dhe të palikuiduara;
- Automatizimi i procesit për kërkesat e rimbursimit (platforma online) ka reduktuar kohën për të marrë një rimbursim me 40%.

**Sistemi ligjor (të drejtat e pronësisë; zbatimi i ligjit dhe i kontratave; efektshmëria e gjyqësorit**

*Për më shumë informacion në lidhje me kadastrën e tokës, ju lutemi shikoni Kapitullin 23: “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, në Seksionin Gjyqësori dhe seksionin e të Drejtave të Pronës.*

## **Sektori financiar**

### Vështrim i përgjithshëm

Sektori financiar, siç tregohet nga ndryshimi i madhësisë së bilancit dhe treguesve kryesorë të përfitueshmërisë, mbeti i fuqishëm dhe fitimprurës gjatë vitit 2021 dhe 2022. Cilësia e kredisë dhe mjaftueshmëria e kapitalit të sektorit bankar mbeten të përshtatshme. Të gjithë treguesit e bankave që i nënshtrohen rregullimit sugjerojnë se ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut mbetet i kufizuar dhe nën nivelet kritike. Treguesit nominalë dhe relativë të kredive me probleme kanë vijuar rënien gjatë dy vjetëve të fundit për shkak të shlyerjeve dhe fshirjeve të kredive me probleme.

Në vlerë absolute fitimi i sektorit bankar gjatë vitit 2022, ishte i njëjtë me atë të vitit paraardhës, rreth 21.6 mld lekë. Treguesi i kthimit nga aktivet mesatare shënoi 1.2% ndërsa nga kapitali mesatar rezultoi 12.3%, së bashku lehtësisht më të ulët se nivelet e një viti më parë. Të ardhurat neto nga interesi nga operacionet e klientëve (kreditimi) dhe investimet në letra me vlerë kanë vazhduar të rriten gjatë periudhës, të mbështetur nga rritja e normave të interesit, por rezultati neto është ndikuar negativisht nga shpenzimet më të larta operacionale dhe rënia e vlerës së investimeve në instrumente financiare. Shpenzimet për provigjionet e humbjeve nga kreditë nuk kanë qenë të rëndësishme, por tregojnë një rritje të lehtë krahasuar me vitin paraardhës.

Situata financiare e korporatave jofinanciare dhe e sektorit të individëve ka mbetur e qëndrueshme, ndërsa pozicioni neto i secilit sektor, përkatësisht si huamarrës neto dhe huadhënës neto, ka vazhduar të rritet në vitet 2021 dhe 2022. Kredia për bizneset dhe depozitat e individëve kanë vazhduar të rriten me një normë vjetore prej 8-10%, por rritja është ngadalësuar disi në pjesën e fundit të vitit 2022. Të dhënat nga vrojtimet e realizuara, tregojnë që pesha e individëve me të paktën një kredi ka rënë gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, dhe aftësia paguese sipas vlerësimit të tyre mbetet nën mesataren historike. Perspektiva për rritjen e kredisë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme është pozitive për sektorin e korporatave jofinanciare dhe e përzier për sektorin e individëve. Sipas vrojtimit tremujor të kreditimit, kërkesa për kredi nga korporatat jofinanciare është forcuar në vitin 2022, por në të njëjtën kohë, bankat kanë raportuar një normë më të lartë të refuzimit të kërkesave për kredi. Kërkesa për kredi nga sektori i individëve pritet të jetë më e zbutur, mes shqetësimeve për rritjen e normave të interesit dhe çmimeve të konsumit.

Tregu i brendshëm financiar i dominuar nga transaksionet në letrat shtetërore shënoi vëllime dhe çmime më të larta tregtimi gjatë gjysmës së parë të vitit 2022 krahasuar me tremujorët e mëparshëm. Në përgjithësi, oferta e fondeve për investime në letrat shtetërore ka tejkaluar kërkesën e qeverisë për huamarrje. Monedha vendase është forcuar kundrejt euros dhe është



nënçmuar ndaj dollarit. Tregu vendas i këmbimit valutor mbetet i qëndrueshëm, pavarësisht disa luhatjeve afatshkurtra në tremujorin e parë, të menaxhuara nëpërmjet ndërhyrjeve ad hoc të Bankës së Shqipërisë. Rritja e vazhdueshme e çmimeve të pasurive të paluajtshme është mbështetur nga kërkesa dhe oferta e fortë, si dhe nga një rritje e moderuar e kostove të ndërtimit gjatë gjysmës së parë të vitit 2022. Kredia për banesa dhe kredia për sektorin e ndërtimit shënuan rritje të fortë vjetore në pjesën e parë të vitit 2022, por norma e rritjes u ngadalësua në pjesën e dytë të tij. Kredia për këta sektorë mbetet sidoqoftë ndër kontribuuesit kryesorë në rritjen e përgjithshme të kredisë.

Treguesit agregatë dhe vrojtimi i bankave sugjerojnë një rrezik më të lartë të lidhur me mjedisin e jashtëm dhe rritjen e inflacionit, ndërkohë që rreziqet që lidhen me aktivitetin e ekonomisë së brendshme, të qeverisë së përgjithshme, të sektorit të biznesit dhe të ekonomive familjare dhe të sektorit financiar nuk kanë ndryshuar ndjeshëm nga viti i mëparshëm. Stress testi i aftësisë paguese që mbulon horizontin 2022 – 2024 tregon se sektori bankar mbetet elastik ndaj goditjeve të mundshme makroekonomike, megjithëse disa banka mund të përballen me nevojën për të rritur kapitalin e tyre të paguar. Pavarësisht rënies së vazhdueshme dhe të qëndrueshme të stokut dhe të raportit të kredive me probleme, është rritur mundësia e transformimit të rrezikut të normës së interesit në rrezik kredie, për shkak të rritjes së kostove të ripagimit të kredisë për huamarrësit si rezultat i rritjes së normave të interesit dhe peshës prej rreth 70% të kredive me normë interesi të ndryshueshme në totalin e portofolit të kredisë së sektorit bankar. Në Raportin e fundit të Stabilitetit Financiar (H1-2022), Banka e Shqipërisë u kërkoi bankave të identifikojnë ekspozimet e tyre më të ndjeshme si dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të adresuar rreziqet, duke përfshirë krijimin e rezervave financiare dhe forcimin e pozicioneve të tyre kapitale.

### **Zhvillimet kryesore në sektorin financiar dhe bankar**

Në fund të shtatorit 2022, pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së ra me 8 p.p në 97.1%. Kjo ecuri reflektoi rritjen më të lartë të PBB-së krahasuar me atë të aktiveve të sistemit financiar. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të dominojë me rreth 90% të totalit të aktiveve. Sektori jobankar është i vogël, por ka vijuar të zgjerohet dhe aktualisht numëron 79 institucione,<sup>45</sup> ndërkohë që pesha e tij ndaj PBB-së mbeti e pandryshuar në 10%. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët dhe i qëndrueshëm, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj aktivitetit të sektorit bankar mbetet e lartë.

### **Aktiviteti i sistemit financiar ndaj PBB-së (%)**

Autoriteti Mbikëqyrës	Banka e Shqipërisë	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Ndërmjetësimi financiar
-----------------------	--------------------	-------------------------------------	-------------------------

<sup>45</sup> Duke përfshirë 12 shoqëri sigurimi, 11 fonde investimi, 5 fonde pensioni, 13 shoqëri kursim-krediti dhe një numër institucionesh të cilat ofrojnë shërbime të mikrokredisë, qera financiare, factoring dhe transfertat dhe pagesa elektronike.

	Sektori bankar	IFJB	SHKK-të dhe Unioni	Shoqëritë e sigurimit	Fondet e pensionit	Fondet e investimit	
<b>2011</b>	86.1	2.6	0.8	1.5	0.0		<b>91.0</b>
<b>2012</b>	89.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	<b>95.4</b>
<b>2013</b>	91.4	2.6	0.7	1.6	0.0	3.7	<b>100.2</b>
<b>2014</b>	92.7	2.8	0.8	1.8	0.0	4.6	<b>102.7</b>
<b>2015</b>	91.9	2.7	0.7	2.0	0.1	4.7	<b>102.0</b>
<b>2016</b>	95.5	2.8	0.6	2.0	0.1	4.5	<b>105.5</b>
<b>2017</b>	93.2	2.9	0.5	2.0	0.1	4.7	<b>103.4</b>
<b>2018</b>	88.8	3.2	0.6	1.9	0.1	4.2	<b>98.8</b>
<b>2019</b>	87.2	3.9	0.6	2.0	0.2	4.0	<b>97.9</b>
<b>2020</b>	97.8	4.2	0.7	2.4	0.2	4.2	<b>109.5</b>
<b>2021</b>	93.9	4.0	0.7	2.2	0.2	4.1	<b>105.1</b>
<b>2022*</b>	87.9	3.7	0.7	2.0	0.3	2.5	<b>97.1</b>

*Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare*

*\* 2022*

Pesha e aktiveve të bankave me kapital vendas (5 nga 11 banka) ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar u rrit nga 18% në 2017 në 34% në fund të vitit 2022. Bilanci i sektorit bankar u zgjerua me 5.8% gjatë vitit 2022. Në anën e aktiveve, zgjerimi u mbështet nga rritja e tepicës së kredisë , e veprimeve me letrat me vlerë dhe i ekspozimeve me thesarin dhe ndërbankare, te cilat u rritën përkatësisht me 6.5%, 6.2% dhe 5.5%. Ritmi i rritjes vjetore u ngadalësua në tremujorin e katërt të vitit, dhe reflekton edhe mbiçmimin e kursit të këmbimit të lekut ndaj euros. Struktura e letrave me vlerë dominohet nga letrat me vlerë të qeverisë shqiptare në monedhën vendase (55%) dhe në valutë (13%) dhe pjesa e mbetur iu përket letrave me vlerë në valutë të jorezidentëve. Aktivitetet në valutë dhe pretendimet ndaj jorezidentëve zënë 52.7% dhe 21.1% të totalit të aktiveve dhe u rritën në terma vjetorë përkatësisht me 0.7 pp dhe me (-0.9) pp. Detyrimet dhe aktivitetet në valutë kanë një madhësi të krahasueshme, ndërsa pretendimet ndaj jorezidentëve janë 8 herë më të mëdha se detyrimet ndaj jorezidentëve. Sektori bankar shqiptar mban një pozicion kreditor neto me jorezidentët.

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar është në formën e depozitave (80.7% e aktiveve), të cilat arritën nivelin e 1,514.24 miliardë lekëve në fund të vitit 2022 dhe regjistruan një rritje vjetore me 5.9%. Si rezultat i një mjedisi me norma të ulëta interesi, struktura e depozitave ka ndryshuar në vite duke shfaqur një zhvendosje nga depozitat me afat në ato në formën e llogarive rrjedhëse. Depozitat me afat zënë 42% të stokut të përgjithshëm të depozitave, dhe kjo peshë ka rënë ndjeshëm nga 51% në fund të vitit 2019. Në fund të vitit 2022, stoku i tepicës së kredisë rezultoi 712 miliardë lekë. Zgjerimi i tepicës së kredisë u ndikua kryesisht nga rritja e fluksit të kredive të reja të cilat u rritën me 20% në terma vjetorë. Rritja më e madhe u regjistrua në kredinë dhënë individëve, kredinë në valutë dhe në atë afatshkurtër, por ritmet e rritjes janë ngadalësuar në tremujorin e fundit të vitit. Rritja e kredisë dhënë individëve lidhet me rritjen e

kredisë konsumatore dhe asaj për blerje të pasurive të paluajtshme. Kredia për pasuri të paluajtshme zë rreth 70% të totalit të kredisë dhënë individëve. Tek bizneset, kredia për investime në pasuri të paluajtshme dhe për blerje pajisjesh, zë peshën kryesore në portofolin e kredisë për bizneset, me rreth 52%.

Cilësia e portofolit të kredisë së bankave ka vijuar të përmirësohet gjatë vitit 2022, dhe raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave (RKP) zbriti në 5.1% në fund të vitit, kundrejt nga 5.7% një vit më parë. Përmirësimi reflekton njëkohësisht rritjen e tepricës së kredisë, si dhe rënien e stokut të huave me probleme, veçanërisht për disa portofole specifike si portofoli i kredisë në valutë, kredisë afatgjatë dhe kredisë për sektorët e industrisë, ndërtimit dhe tregtisë. Rënia në stokun e huave me probleme u ndikua nga fshirja e huave të humbura si dhe shlyerja e disa kredive me probleme, kurse indeksi i lëvizjes së kredisë në klasa paraqet një përkeqësim të lehtë të portofolit të kredisë, pasi më shumë kredi kanë lëvizur nga klasat me cilësi të lartë drejt atyre me probleme sesa anasjelltas. Struktura e kredive me probleme dominohet nga kategoria e kredive të humbura (49%), ndërsa ato në kategoritë ‘të dyshimta’ dhe ‘nënstandard’ zënë respektivisht 19% dhe 32% të totalit.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar, shënoi vlerën 18.1% në fund të vitit, duke mbetur pothuaj i pandryshuar. Sidoqoftë, ecuria e tij u përcaktua nga zhvillimet në tremujorin e katërt, ku disa banka shpërndanë fitimin në formën e dividendit. Rezultati financiar i sektorit bankar në fund të vitit 2022 ishte pozitiv në nivelin 21.6 mld leke, në të njëjtën vlerë absolute si në vitin paraardhës. Megjithatë, treguesit e kthimit nga aktivet dhe nga kapitali, treguan një rënie të lehtë, duke rezultuar përkatësisht në vlerat 1.2% dhe 12.3%. Në këtë ecuri të fitimit, në kahun pozitiv ndikuan rritja e të ardhurave neto nga interesi me rreth 13.1%, ndërsa në kahun e kundërt ndikuan rënia e të ardhurave neto jo nga interesi me rreth 27%, rritja e shpenzimeve të veprimtarisë me 2.9% dhe rritja e provigjioneve për cilësinë e aktiveve me rreth 23%. Gjatë vitit 2022 të gjitha bankat raportuan raporte likuiditeti të cilat janë dukshëm më të larta së kufijtë minimale rregullatorë. Raporti i kredive ndaj depozitave në fund të vitit shënoi nivelin 47%, pothuaj i pandryshuar ndaj një viti më parë.

### Treguesit e sektorit bankar

	2017	2018	2019	2020	2021	2022*
Totali i aktiveve të sektorit bankar (milion EURO)	10,768	11,398	12,380	13,156	14,980	16,434
Pesha e kapitalit të huaj të sektorit bankar (%)	81.4	80.8	78.4	69.4	68.8	73.7
Rritja e kredisë (%.,vmv)	0.2	-3.4	-0.9	5.8	10.2	6.6
Rritja e depozitave (%.,vmv)	0.7	1.3	1.1	7.8	11.4	5.9
Diferenca e normave të interesit (%)	5.1	5.1	5.0	4.9	4.1	4.5
Kredia me normë të ndryshueshme ndaj totalit të kredisë (%)	72.6	71.6	77.4	73.8	74.7	79.4
Treguesit e shëndetit financiar (%)						

- hua me probleme ndaj totalit të huave	13.2	11.1	8.4	8.1	5.7	5.0
- kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.0	18.7	18.7	18.7	18.5	18.1
- aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	30.2	34.2	35.7	34.8	33.3	29.6
- kthimi nga kapitali (roe)	15.7	13.0	13.5	10.7	12.9	12.3
- kredi në valutë ndaj totalit të kredisë	56.4	56.1	51.2	50.3	51.1	51.4
- pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator	6.68	7.78	7.43	8.44	9.2	5.0
- pozicioni i hapur neto i normës së interesit në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator	-1.51	2.44	2.93	4.33	5.84	2.8

\* Shtator

Burimi: Banka e Shqipërisë

### *Rreziqet në sektorin bankar*

Sipas raporteve dhe analizave financiare më të fundit të kryera nga Banka e Shqipërisë, rreziqet makrofinanciare janë duke u akumuluar, por mbeten të kontrolluara, ndërkohë që perspektiva në afatin e shkurtër dhe të mesëm vlerësohet sfiduese. Harta e stabilitetit financiar për 6-mujorin e parë të vitit 2022, tregoi një rritje të rreziqeve që lidhen me zhvillimet në mjedisin e jashtëm politik dhe ekonomik, ndikuar nga lufta e Rusisë në Ukrainë. Këto rreziqe janë reflektuar kryesisht në formën e presioneve të shtuara inflacioniste me pasojë në zhvillimet e brendshme ekonomike, por ndikimet kanë qenë të përballeshme deri në fund të vitit. Ekspozimi relativisht i kufizuar ndaj vendeve të përfshira në luftë, qëndrueshmëria makroekonomike, përshtatja e politikave ekonomike dhe financiare në sektorin publik dhe privat, si edhe gjendja e mirë e bilanceve të sektorit real dhe atij financiar, kanë zbutur goditjen mbi zhvillimet ekonomike në vend; megjithatë ndikimet e plota të krizës në të ardhmen mbeten të pasigurta. Sektori bankar shqiptar ka përbaluar disa goditje duke nisur që prej fundit të vitit 2019. Aktiviteti i sektorit bankar ka mbetur i qëndrueshëm, me rritje të moderuar të kreditimit ndaj sektorit privat (mesatarisht me 10% gjatë 2022), me gjendje të mirë të likuiditetit e të kapitalizimit dhe me nivele të përshtatshme të treguesve kryesorë të stabilitetit financiar. Raporti i kredive me probleme ka ndjekur një prirje në rënie, megjithatë rreziku i kredisë në nivel sistematik është duke u akumuluar. Bankat perceptojnë rreziqe të shtuara të lidhura me nivelin e inflacionit dhe cilësisë së kredisë në afatin e mesëm. Indeksi i akumulimit të rrezikut sistematik shënoi rritje ndikuar kryesisht nga rritja e mëtejshme e çmimit të pasurive të paluajtshme si dhe zgjerimi i portofolit të kredisë me norma të ndryshueshme interesi.

Që prej tremujorit të parë të vitit 2022 Banka e Shqipërisë nisi procesin e normalizimit të politikës monetare me qëllim uljen e normës së inflacionit në periudhën afat-mesme. Gjithashtu, po ndërmerren masa të natyrës fiskale dhe administrative për sigurimin e energjisë së nevojshme për ekonominë. Çmimet rekord të larta të energjisë dhe të mallrave në tremujorin e tretë të vitit, u korrektuan ndjeshëm në tremujorin e katërt. Paralelisht, rritja e normave të interesit në tregjet financiare u ngadalësua ndjeshëm, dhe në disa raste, ato shënuan rënie. Megjithatë, pasiguria e

zhvillimeve mbetet e pranishme dhe ajo mund të ndikojë në ngadalësimin e rritjes ekonomike të vendit

Rreziku i kredisë pritet të rritet në të ardhmen afatshkurtër. Së pari, nëse ekonomia ngadalësohet, aftësia paguese e bizneseve dhe familjeve mund të bjerë dhe të përcillet në sektorin bankar nëpërmjet rënies së cilësisë së aktiveve, rënies së niveleve të fitimit të veprimtarisë apo krijimit të humbjeve financiare. Së dyti, rritja e normave të interesit ka rritur koston e shërbimit të huave për huamarrësit dhe mund të ulë aftësinë e tyre paguese, kryesisht për atë pjesë të portofolit të huave të lidhura me indekse të ndjeshme ndaj lëvizjes së normës bazë si në monedhë të huaj ashtu edhe në lekë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrolluar, por kërkon monitorim të kujdesshëm në të ardhmen e afërt. Rritja e normave të interesit, përveç ndikimit indirekt përmes rritjes së kotove të shërbimit të borxhit nga huamarrësit, ndikon drejtpërdrejt edhe në vlerën e tregut të titujve me normë interesi të pandryshuar deri në T2-2022 ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të normës së interesit, e matur nga pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, ka shënuar rënie dhe vijon të mbetet dukshëm nën kufirin e sipërm të përcaktuar nga kuadri rregullator. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit është zbutur gjatë vitit 2022 dhe mbetet ndjeshëm nën kufirin rregullator. Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit nuk ka shënuar ndryshime të dukshme, në kushtet e qëndrueshmërisë së vlerës së kredisë në valutë të pambrojtur nga kursi i këmbimit gjatë periudhës, e zbut efektin e materializimit të këtij rreziku. Rreziku i likuiditetit mbetet i kontrolluar. Treguesit e likuiditetit paraqiten me nivele të qëndrueshme dhe mjaft më të larta nga kufijtë e poshtëm rregullatorë për të gjitha bankat e sektorit. Prania e bollshme e aktiveve likuide, zbut rrezikun që vjen prej zgjerimit të hendekut negativ mes aktiveve dhe detyrimeve për shportat e ndryshme të afateve të maturimit.

Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë periodike ushtrimet e provës së rezistencës, për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar ndaj goditjeve nga ekonomia reale ose tregjet financiare në një horizont afatmesëm. Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit ose aftësinë paguese tregon shkallën e rezistencës së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë përshtatshmërinë e tij në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike, kredinë, kursin e këmbimit dhe normat e interesit. Prova e rezistencës së likuiditetit tregon aftësinë e sektorit bankar për të përballuar situatat e stresit të likuiditetit brenda një horizonti afatmesëm. Në tërësi, këto ushtrime të kryera për gjysmën e parë të vitit 2022, dhe të shtrira në periudhën 2022 – 2024, tregojnë se sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj goditjeve të supozuara makroekonomike dhe se gjendja e likuiditetit të tij është e fortë. Rezultatet gjithashtu tregojnë që banka të veçanta janë më të ndjeshme ndaj goditjeve të supozuara dhe kanë nevojë të fuqizojnë pozicionet e tyre të likuiditetit dhe të kapitalit. Pavarësisht performancës dhe pozicionit të mirë të sistemit financiar dhe sektorit bankar në vend, e ardhmja karakterizohet nga një nivel i shtuar i pasigurisë. Ndikimi në ekonomi i zhvillimeve gjeopolitike dhe të energjisë, përfaqësojnë sfida të rëndësishme për politikën ekonomike dhe mund të ndikojnë veprimtarinë e sistemit financiar dhe të sektorit bankar në mënyrë të ndryshme. Në rast se situata ekonomike përkeqësohet, bankat mund të përballen me

ulje të mëtejshme të fitimit e ndoshta edhe me humbje financiare. Për të administruar dhe zbutur rreziqet apo humbjet e mundshme, nevojitet që bankat të evidentojnë ekspozimet e tyre më të ndjeshme dhe të ndërmarrin në kohën e duhur veprimet e nevojshme për mbulimin e rreziqeve, duke përfshirë krijimin e rezervave financiare dhe fuqizimin e pozicioneve të kapitalit.

## Mbikëqyrja makroprudenciale

Në vijim të miratimit të dokumentit të Strategjisë së Politikës Makroprudenciale (2017), i cili përcakton një kuadër të përgjithshëm operacional për zbatimin e politikës makroprudenciale në Shqipëri, Banka e Shqipërisë miratoi Rregulloren “Mbi shtesat makroprudenciale të kapitalit” (2019). Kjo rregullore përcakton metodën e vendosjes së shtesës konservuese të kapitalit (KONS), shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC), shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST) dhe shtesës së kapitalit për rrezikun sistematik (STRUK) për bankat që kryejnë aktivitet në Shqipëri. Të gjitha këto shtesa duhet të plotësohen me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë (KBN1); aplikohen si shtesa ndaj kërkesave të detyrueshme për kapital që janë kërkesat për ‘Shtyllën I + Shtyllën II + MREL’<sup>46</sup> dhe shprehen si raport në përqindje ndaj ekspozimeve të peshuara me rrezik. Rregullorja parashikon një zbatim gradual të shtesave makroprudenciale të kapitalit. Sipas Rregullores vlerat maksimale të shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit do të arrihen në vitin 2024.

### Pasqyrë e hyrjes graduale në fuqi të shtesave makroprudenciale të kapitalit

Shtesat makroprudenciale të kapitalit	2020	2021	2022	2023	2024 e në vazhdim
Shtesa konservuese e kapitalit (KONS)	0.5%	1%	1.5%	2%	2.5%
SPEKUNC* {Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC: 0-2.5%)}	0.625%	1.25%	1.875%	2.5%	3%
Shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST)	0.5%	{0.5%; 1%}	{0.5%; 1%; 1.5%}	{0.5%; 1%; 1.5%; 2%}	{0.5%; 1%; 1.5%; 2%; 2.5%}
ASTRUK** {Shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik (STRUK: 1-3%)}	1%	{1%; 1.5%}	{1%; 1.5%; 2%}	{1%; 1.5%; 2%; 2.5%; 3%}	{1%; 1.5%; 2%; 2.5%; 3%}

*Shënim: \*SPEKUNC është shtesa kundërciklike e kapitalit e aplikuar për një bankë specifike*

*\*\* ASTRUK është shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik e aplikuar për një bankë specifike*

*Burimi: Banka e Shqipërisë*

<sup>46</sup> Kërkesa minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar që lidhet me zbatimin e Ligjit për “Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, nr.133/2016

Që nga viti 2020 bankat kanë filluar të përmbushin kërkesat për kapital të lidhura me shtesat KONS dhe SIST. Ndërkohë që instrumenti KUNC është aktiv dhe operacional, norma e tij është e barabartë me zero që nga shpallja për herë të parë e kësaj norme, sipas vendimit të Guvernatorit që publikohet në fund të çdo tremujori. Banka e Shqipërisë shpall listën e bankave sistemike dhe shtesat përkatëse SIST një herë në vit në fund të tremujorit të parë. Në vitin 2022 lista u shkurtua në 4 banka nga 5 të përcaktuara si banka sistemike një vit më parë. Zbatimi i shtesave KUNC dhe SIST mbështetet nga metodologjitë shoqëruese që janë publikuar në faqen e Bankës së Shqipërisë. Përmbushja nga ana e bankave e kërkesave për shtesat e kapitalit sipas Rregullores vlerësohet çdo tremujor nga Banka e Shqipërisë në bazë të një pakete të posaçme raportimi dhe raportit përkatës. Shtesa për rrezikun sistematik nuk është ende operacionale. Banka e Shqipërisë po punon për të operacionalizuar këtë instrument, me qëllim përdorimin e tij si një mjet makroprudencial për të adresuar rrezikun sistematik strukturor që rrjedh nga niveli i lartë i euroizimit në ekonominë Shqiptare. Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet nxitjes së përdorimit të monedhës vendase në ndërmjetësimin financiar dhe në të njëjtën kohë duke forcuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar përballë ekspozimeve ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. Metodologjia e kalibrimit të këtij instrumenti është në proces.

Gjatë vitit 2022 janë bërë hapa para në drejtim të masave rregullative makroprudenciale me bazë kredimarrësin. Banka e Shqipërisë ka përgatitur një projekt rregullorë e cila synon të përmirësojë procesin e mbledhjes së informacionit mbi ekspozimet e sektorit bankar në kredi dhe investime në sektorin e pronave të paluajtshme rezidenciale dhe tregtare. Rregullorja do të sigurojë që ky informacion mbështetet në përkufizime të njëtrajtësuar dhe do të mundësojë llogaritjen e treguesve bazë për standardet e kreditimit për pasuri të paluajtshme duke përfshirë treguesit e huasë ndaj vlerës (LTV), huasë ndaj të ardhurave (LTI) dhe shërbimit të huasë ndaj të ardhurave (LSTI). Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë ka marrë në konsideratë rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB/2016/14 dhe ESRB/2019/3). Gjithashtu, projekt rregullorja i njeh Bankës së Shqipërisë autoritetin që të përdorë këta tregues si instrumente makroprudenciale, duke aplikuar kufizime, në rastet kur bëhet e nevojshme për të kontrolluar huadhënien për prona të paluajtshme për sektorin e individëve dhe bizneseve. Projekt-rregullorja është publikuar në faqen e Bankës së Shqipërisë në seksionin e akteve në proces konsultimi dhe është në proces konsultimi me sektorin bankar.

## **Tregu i sigurimeve**

Tregu i sigurimeve përbëhet nga 12 shoqëri sigurimesh. Në strukturën e tregut, 8 shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës dhe 4 në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës kryen edhe aktivitet risigurimi. Bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë këtij viti vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga portofoli i MTPL së brendshme.

**Totali i primeve të shkruara bruto**, për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës në 31.12.2021 është 19.27 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 2.66 miliardë lekë ose 16.01% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto në masën 2.39 miliard lekë ose rreth 16% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës dhe rritje prej 265 milionë lekë ose rreth 23 % në tregun e sigurimeve të Jetës.

**Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit** për tregun e Jo-Jetës në 31.12.2021 është i mjaftueshëm, me 3.7 miliardë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 184%. Për tregun e Jetës treguesi është sërisht i mjaftueshëm me rreth 556 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 138%. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka pësuar rritje për të dy tregjet e sigurimeve.

**Treguesit e Rentabilitetit ROE (Kthimi nga kapitalet e veta) dhe ROI (Kthimi nga investimi)** për vitin 2021, janë përkatësisht ROE në nivelin 4.6% nga 8.73% në vitin 2020 dhe ROI 0.3% nga 2.68% në vitin 2020.

**Totali i aktivitetit të tregut** të sigurimit për periudhën 31.12.2021, sipas pasqyrave financiare, është rreth 41 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 1.7 miliard lekë krahasuar me 31.12.2020. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” në të dy sektorët, Jo-Jetës dhe Jetës.

**Rezultati financiar neto** i tregut të sigurimeve për vitin 2021 është pozitiv në vlerën 601 milion lekë.

Në janar – shtator 2022, tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 9.46%. Volumi i primeve të shkruara bruto arriti shifrën 15.51 miliardë lekë.

Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve sipas të dhënave të raportuara në 30.06.2022, është 42.72 miliardë lekë, me rritje prej rreth 5.29% krahasuar me fund vitin 2021.

### **Tregu i Fondeve të Investimeve**

Struktura e tregut të Fondeve të Investimeve deri më 31.12.2021 përbëhej nga njëmbëdhjetë fonde investimi.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve më 31.12.2021, vlera neto e aseteve të Fondeve, ishte mbi 81.9 miliardë lekë me një rritje prej 21.5% krahasuar me fundin e vitit 2020.

Numri i investitorëve që kanë investuar në këtë treg më 31.12.2021 arriti në 40 055 investitorë, duke shënuar një rritje prej 22.66% krahasuar me 31.12.2020. Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve më 30.09.2022, vlera neto e aseteve të Fondeve ishte mbi 53.76 miliardë lekë me një ulje prej 30.80% krahasuar me 31.12.2021.



## Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare përbëhet nga katër fonde pensioni, të cilat administrohen nga tre shoqëri të ndryshme administrimi.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2021 tregon një total të aktiveve neto prej 4.58 miliardë lekë me një rritje prej 27.23% krahasuar me fundin e vitit 2020.

Gjatë vitit 2021, investimet e tregut të Fondeve të Pensioneve përbëhen nga Obligacione thesari të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 5, 7,10 dhe 15 vjeçar.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.09.2022 tregon një total të aktiveve neto prej 5.45 miliardë lekë me një rritje prej afro 870.32 milionë lekë, ose 18.98% krahasuar me fundin e vitit 2021.

Kapacitetet për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

Shqipëria ka bërë **njëfarë përparimi** dhe ka **njëfarë niveli përgatitje** për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Infrastruktura e energjisë dhe transportit, digjitalizimi i ekonomisë dhe arritjet arsimore janë përmirësuar, por hendeku me nivelet rajonale dhe Evropiane mbetet i konsiderueshëm. Konkurrueshmëria e Shqipërisë është e penguar nga mungesa e dijeve në sipërmarrje dhe atyre teknologjike, nivelet e konsiderueshme të informalitetit, nevojat e papërbushura për investime në kapital njerëzor dhe fizik, dhe shpenzimet vazhdimisht të ulëta për kërkim dhe zhvillim. Përpjekjet për të përmirësuar formimin profesional dhe për të trajtuar mospërputhjen e aftësive kanë vijuar dhe përgatitja institucionale për Planin e Garancisë Rinore ka përparuar. Integrimi rajonal dhe eksportet janë përmirësuar, por janë ende nën potencial. Mungesa e produkteve dhe diversifikimit gjeografik të eksporteve shtojnë cenueshmërinë e Shqipërisë ndaj goditjeve të jashtme.

## Kapitali njerëzor dhe kapitali fizik

### *Funksionimi i tregut të punës*

Zhvillimet në tregun e punës deri më tani kanë qenë relativisht pozitive, të mbështetura nga politikat e ndërmarra nga qeveria duke sjellë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe nxitje të punësimit. Si sektori i ndërtimit, industrisë ashtu edhe ai i shërbimeve kanë përfituar nga këto zhvillime, duke ofruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin dhe duke krijuar premisa të mira për perspektivën afatmesme. Të dhënat më të fundit nga INSTAT sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës (LFS) në tremujorin e tretë të 2022, tregojnë nivel më të lartë të punësimit dhe ulje të lehtë të shkallës së papunësisë krahasuar me tremujorin paraardhës.

Shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, në tremujorin e tretë 2022, për popullsinë 15 vjeç e lart është 10.6 përqind. Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, ky tregues u ul me 0.7 pikë përqindje dhe krahasuar me një tremujor më parë të 2022, ky tregues u ul me 0.5 pikë përqindje. Ndërsa për grupmoshën e punës 15-64 vjeç, shkalla e papunësisë në tremujorin e tretë 2022 shënoi 10.8 përqind, kundrejt 11.6% që ishte për të njëjtin tremujor të një viti më parë. Numri i personave të papunë në moshë pune (15-64 vjeç) në tremujorin e dytë të vitit 2022 ishte 150,280 persona.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 65.4 përqind. Ritmi vjetor i ndryshimit të punësimit për popullsinë 15 vjeç e lartë, nga tremujori i tretë i vitit 2021 në tremujorin e tretë të vitit 2022, është +4.2 përqind. Në terma vjetorë, punësimi ulet me 0.2 përqind në sektorin e industrisë, rritet me +4.7 përqind në sektorin e shërbimeve dhe me 6.5 përqind në sektorin e bujqësisë.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç, në tremujorin e tretë 2022, ishte 73.4 përqind. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2021, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 3.3 pikë përqindje më e lartë, ndërkohë krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ky tregues është rritur me 0.6 pikë përqindjeje. Gjatë tremujorit të tretë 2022, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15 - 29 vjeç është 54.9 përqind. Për popullsinë nga 30 deri në 64 vjeç, në tremujorin e dytë 2022, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 82.2 përqind.

**Tabela e të dhënave të tregut të punës (15 vjeç e lart)**

(Në %)		Shkalla Zyrtare e Papunësisë	Shkalla e Punësimit	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore
<b>2012</b>	Q1	12.9	51.1	58.7
	Q2	13.3	50.2	57.9
	Q3	13.6	48.6	56.2
	Q4	13.6	48.7	56.4
<b>2013</b>	Q1	14.3	47.0	54.9
	Q2	16.0	44.1	52.5
	Q3	16.8	42.9	51.5
	Q4	16.8	42.4	50.9
<b>2014</b>	Q1	18.2	41.5	50.8
	Q2	17.2	44.4	53.6
	Q3	17.0	45.8	55.2
	Q4	17.6	45.6	55.3
<b>2015</b>	Q1	16.9	45.6	54.8
	Q2	17.0	45.8	55.2
	Q3	17.2	46.3	55.9
	Q4	17.3	47.0	56.8

<b>2016</b>	Q1	16.6	47.5	56.9
	Q2	15.5	48.4	57.2
	Q3	14.7	49.9	58.6
	Q4	14.2	49.1	57.2
<b>2017</b>	Q1	14.2	49.2	57.3
	Q2	13.9	50.0	58.1
	Q3	13.6	50.7	58.7
	Q4	13.4	51.2	59.1
<b>2018</b>	Q1	12.5	51.9	59.3
	Q2	12.4	52.0	59.3
	Q3	12.2	52.2	59.4
	Q4	12.3	52.3	59.6
<b>2019</b>	Q1	12.1	52.5	59.7
	Q2	11.5	53.6	60.6
	Q3	11.4	53.8	60.7
	Q4	11.2	53.8	60.6
<b>2020</b>	Q1	11.4	53.1	60.0
	Q2	11.9	51.7	58.8
	Q3	11.6	53.2	60.2
	Q4	11.8	52.0	59.0
<b>2021</b>	Q1	11.9	51.9	58.8
	Q2	11.6	52.4	59.3
	Q3	11.3	53.7	60.5
	Q4	11.4	53.5	60.4
<b>2022</b>	Q1	11.3	54.2	61.1
	Q2	11.1	55.1	62.0
	Q3	10.6	56.5	63.2

*Burimi: INSTAT*

Fondet e parashikuara për arsimin, sipas projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, ishin në 7.16% të shpenzimeve publike për vitin 2022, në 7.1% të këtyre shpenzimeve në vitin 2023, si dhe në 6.97% në vitin 2024. Fondet për arsimin janë parashikuar të arrijnë në 2.45% të PBB-së në vitin 2022, në masën 2.26% të PBB-së në vitin 2023, si dhe në nivelin 2.22% të PBB-së për vitin 2024.

Fondet për “Sektorin e Arsimit” parashikuar për periudhën afatmesme 2022 – 2024 përfshijnë: të ardhurat dytësore të IAL publike; të ardhurat e tjera për arsimin nga të tretë; fondet e parashikuara nga Ministria e Mbrojtjes “Akademia e Forcave të Armatosura”; fondet e parashikuara nga Ministria e Drejtësisë “Shkolla e magistraturës”; fondet e parashikuara nga Ministria e Brendshme “Akademia e Sigurisë”; fondet e parashikuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë “Fonde për arsimin dhe formimin profesional”; fondet e parashikuara të njësive të vetëqeverisjes vendore “Për shërbimet dhe funksionet në arsimin parauniversitar”, si dhe fondet nga projekte të veçanta

të donatorëve (\*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private).

Në vitin 2022, fondet për arsimin arrijnë në 65.6 miliard lekë, ose 10.29% të shpenzimeve publike, ose 3.51% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

Në vitin 2023, fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 67.04 miliard lekë, ose 10.71% të shpenzimeve publike, ose 3.41% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

Në vitin 2024, fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 71.3 miliard lekë, ose 10.91% të shpenzimeve publike, ose 3.47% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

### **Struktura sektoriale dhe ajo e ndërmarrjeve**

Statistikat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, për vitin 2020, tregojnë se:

- 99.8% e ndërmarrjeve aktive janë NVM, përqindje e njëjtë me vitin 2019;
- 81.9% e numrit total të të punësuarve janë të punësuar nga NVM-të, nga 81.6% në 2019;
- 79.7% e qarkullimit është realizuar nga NVM-të krahasuar me 78.9% të realizuar në vitin 2019;
- 74.0% e totalit të investimeve janë realizuar nga NVM-të nga 68.2% e investuar në vitin 2019;
- 74.1% e vlerës së shtuar e realizuar nga NVM-të krahasuar me 72.4% që ishte në vitin 2019.

NVM-të kanë kontribuar negativisht në të gjithë treguesit kryesorë për vitin 2020, përkatësisht nga:

- -1,5 pikë përqindje në numrin e ndërmarrjeve;
- -3,9 pikë përqindje në numrin e të punësuarve;
- -3,3 pikë përqindje në qarkullim;
- -8,9 pikë përqindje në totalin e investimeve;
- -2.6 pikë përqindje në vlerën e shtuar.
- 10.1% e SME-ve janë importuese nga 10.8% që ishin në vitin 2019;
- 9.7% e xhiros u eksportua nga SME-të. Ndërmarrjet e mesme zënë përqindjen më të lartë të eksporteve me 17.6% të xhiros. Mikro-ndërmarrjet eksportojnë vlerën më të ulët ku eksportohet 3.1% e xhiros.

Mikro-ndërmarrjet kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve ushqimore me 69.7%. Ndërmarrjet e vogla kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e ndërtimit me 31.4%. Ndërmarrjet e mesme kanë shkallën më të lartë të punësimit në sektorin e industrisë përpunuese me 37.3%.

Mikrondërmarrjet kanë përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve ushqimore me 55.9%. Ndërmarrjet e vogla kanë përqindjen më të lartë në sektorin e tregtisë me 36.8%. Ndërmarrjet e mesme kanë përqindjen më të lartë të vlerës së shtuar në industrinë përpunuese 35.5%.

Për më shumë informacion mbi të dhënat dhe metodologjinë e përdorur ju lutemi referojuni linkut: <http://instat.gov.al/media/9674/results-on-sme-2020.pdf>.

## **Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri**

Raporti vjetor i monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2021 është në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore. Raporti vjetor i ndihmës shtetërore për vitin 2021 nuk përfshin të dhëna për ndihmën në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, pasi ky sektor nuk është në objektin e ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar.

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesore që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2017 – 2021. Shuma e ndihmës shtetërore të dhënë në Shqipëri gjatë viteve 2017 – 2021 vlerësohet në rreth 53,070,36 milionë lekë (388,54 milionë €), nga të cilat 4,633,30 milionë lekë (37,44 milionë €), që përfaqësojnë 0,25% të PBB-së, janë dhënë në vitin 2021. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2021, ndihma horizontale është 54,2% dhe ndihma sektoriale është 45,8% e totalit të ndihmës. Shumica e skemave të ndihmës shtetërore nuk e kalojnë pragun “de minimis” të Bashkimit Evropian.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2021 janë grantet dhe përjashtimet nga taksat.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2021 janë ulur me 26,100.74 milionë lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2020. Ky ndryshim është rezultat i:

- rritjes së ndihmës shtetërore për punësim me 43.89 milionë lekë;
- rritjes së ndihmës shtetërore për trajnime me 94.21 milionë lekë;
- rritjes së ndihmës shtetërore për mbështetjen e sportit me 63,86 milionë lekë;
- rritjes së ndihmës shtetërore për sportin me 60.59 milionë lekë;
- reduktimit të ndihmës shtetërore për kulturën me 9,95;
- uljes së ndihmës operacionale me 27,150.05 milionë lekë;
- rritjes së ndihmës shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin prej 672,02 milionë lekë;
- rritjes së ndihmës shtetërore për SME-të me 14.95 milionë lekë;
- uljes së ndihmës shtetërore për shërbimin publik (Ujësjellësit) me 340 milionë lekë;
- rritjes së ndihmës për infrastrukturën broadband me 526.56 milionë lekë; dhe
- rritjes së ndihmës shtetërore për turizmin me 526.56 milionë lekë.

## **Platforma Akses në Financë**

AIDA në kuadër të objektivit “Rritja e aksesit në financa për NMVM-të (BIDS 2021 – 2027)”, me mbështetjen e BERZH-it ka krijuar platformën “Access to Finance” për t’i shërbyer NMVM-ve kompanitë shqiptare, të cilat duan të zgjerohen dhe investojnë në aktivitet duke përfituar nga mundësitë financiare që ofron tregu, me grante, kredi apo iniciativa të tjera financimi.

Platforma u lançua në maj të vitit 2021 në faqen uebin e AIDA-s. Në këtë portal NMVM-të mund të gjejnë informacion të përditësuar mbi instrumentet financiare.

Kjo platformë online ofron një shërbim “one-stop-shop” me informacione të lidhura drejtpërdrejt me aksesin në financa për NMVM-të, nga institucione, organizata apo kompani të ndryshme private dhe publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

AIDA, si zbatuesja kryesore e kësaj nisme, ka ndjekur, asistuar dhe dhënë një kontribut të vazhdueshëm gjatë krijimit të platformës, në bashkëpunim me kompaninë e zhvillimit.

Informacioni i përditësuar për thirrjet e ndryshme për aplikime nga NMVM-të shqiptare mirëmbahet dhe menaxhohet nga AIDA [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al).

### **Financimi i granteve për MSME-të për të zbatuar digjitalizimin dhe tregtinë elektronike**

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 540, datë 29.07.2022 “Për shumën e grantit, kriteret dhe kushtet e veçanta të përfitimit të grantit për sipërmarrjet mikro, të vogla, të mesme”, AIDA do të menaxhojë fondin për NMVM-të, për zbatimin e digjitalizimit dhe e-tregti.

Skema e granteve të AIDA-s për vitin 2022 do të financojë MSME-të deri në 2,500,000 lekë për të zbatuar digjitalizimin dhe tregtinë elektronike. AIDA përmes kësaj skeme granti synon të ndihmojë MSME-të të rrisin përdorimin e teknologjive digjitale/e-commerce/aplikacione të tjera dhe do t’i mbështesë ato për të rritur nivelet e tyre të produktivitetit dhe konkurrencës për të rritur biznesin.

Ky grant do të mbështesë sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, përmes thirrjes për propozime për bashkëfinancimin e kostove të pranueshme (subvencionimit) me fokus transformimin digjital të proceseve kryesore të biznesit.

Granti do të mbështesë financiarisht NMVM-të, në varësi të projektit konkurrues të përgatitur, në masën 80 për qind të kostove të miratuara dhe deri në shumën 2 500 000 (dy milionë e pesëqind) lekë.

Në datën 31 gusht 2022, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka shpallur thirrjen për “Fondin për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme”. Ky fond ka në fokus digjitalizimin e bizneseve shqiptare, si një nga mënyrat kryesore për të ruajtur konkurrueshmërinë në treg, për të qenë sa më koherent, si dhe për të arritur sa më shumë klientë

potencialë përmes platformave digjitale. Thirrja qëndroi e hapur për aplikime deri më 21 tetor 2022.

Në kuadër të promovimit u ndërmor një fushatë e gjerë informuese, gjatë së cilës u ndoqën hapat e mëposhtëm:

- Krijimi i një fletëpalosjeje prezantimi, me informacion në lidhje me grantin;
- Organizimi i katër sesioneve informative me përfaqësues të bizneseve nga rajone të ndryshme të Shqipërisë. (Dibër, Vlorë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Kukës, Gjirokastrë, Korçë). Në këto sesione morën pjesë 125 kompani;
- U organizua një ngjarje e Ditës së Hapur për të gjithë ata që donin të bashkoheshin
- Promovim i vazhdueshëm në rrjetet sociale të AIDA-s (përgatitja e 46 postimeve të fokusuara në informim);
- Promovimi përmes medias së shkruar (Revista Monitor dhe Revista Business Magazine).

Njësia e menaxhimit të granteve në AIDA ka përfunduar shqyrtimin e aplikimeve të pranuar dhe plotësimin e kriterëve të përgjithshme. Pas verifikimit, aplikimet i janë dërguar Bordit të Vlerësimit, i cili u mbledh në nëntor 2022. Aplikimet janë në proces shqyrtimi /vlerësimi nga Bordi.

- Promovim i vazhdueshëm në rrjetet sociale të AIDA-s (përgatitja e 46 postimeve të fokusuara në informim);
- Promovimi përmes medias së shkruar (Revista Monitor dhe Revista Business Magazine).

## **Integrimi tregtar**

Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë janë të përqendruara me vendet e BE-27.

Në nëntëmujorin e parë të vitit 2022, eksportet e mallrave drejt BE-së përbënin afro 73,6% të totalit, ndërsa importet e mallrave afro 52,1%. Brenda BE-së, Italia përfaqëson partnerin kryesor në të dyja kushtet. Tregtia e mallrave dominohet kryesisht nga “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” e ndjekur nga “Materiale ndërtimi dhe metale”.

Sa i përket CEFTA-s, aksionet e tregtisë së mallrave arritën në 10.7% të totalit të tregtisë së mallrave për nëntëmujorin e parë të vitit 2022, duke u rritur me 24.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Kosova përfaqëson partnerin kryesor sa i përket eksportit të mallrave, ndërsa Serbia është partneri kryesor i importit të mallrave.

## **KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK**

### **5.1 Përmbajtja e kapitullit**

*Acquis* për prokurimin publik përfshin parimet e përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit. Për më tepër, rregulla specifike të BE-së zbatohen për koordinimin e dhënies së kontratave publike për punë, shërbime dhe mallra, për autoritetet kontraktore tradicionale dhe për sektorë të veçantë. *Acquis* gjithashtu specifikon rregullat për procedurat e rishikimit dhe disponueshmërinë e mjeteve juridike. Nevojiten organe të specializuara zbatuese.

## 5.2 Struktura e kapitullit

Ky kapitull nuk është i ndarë në nënkapituj.

## 5.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis*-së së Bashkimit Evropian

Kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përfshihen në Nenin 74 “Kontratave publike”, i cili përcakton se Shqipëria dhe BE do të konsiderojnë hapjen e dhënies së kontratave publike në bazë të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në kontekstin e OBT-së, si një objektiv të dëshirueshëm.

Neni 70 i MSA-së, në anën tjetër, përcakton detyrimin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë për të përafuar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së.

*Acquis* e prokurimit publik bazohet në parimet e përgjithshme siç janë transparenca, trajtimi i barabartë, konkurrenca e lirë dhe mosdiskriminimi që rrjedhin nga Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), Pjesa e tretë, Titulli IV dhe Titulli VII, Direktiva 2014/23/BE, Direktiva 2014/24/BE, Direktiva 2014/25/BE, Direktiva 2009/81/KE, Direktiva 89/665/KEE dhe 92/13/KEE, dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED).

## 5.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimet publike. Është bërë përparim i mirë, veçanërisht sa i takon vijimit të procesit të miratimit të legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit të ri për prokurimin publik, vënies në punë të sistemit elektronik të ankesave, zhvillimit dhe implementimit të kurseve të trajnimit me certifikim për prokurimin publik, publikimit të raportit të parë të monitorimit për strategjinë e prokurimit publik dhe vendosjen e “të dhënave të hapura”/open data në kohë reale për procedurat e prokurimit dhe përfshirjes së risqeve të korrupsionit të lidhura me prokurimin në planet e integritetit të institucioneve.

Ndërkohë, në përfundim të takimit dypalësh Shqipëri-BE, në kuadër të procesit “*screening*”, për Kapitullin 5, zhvilluar më datë 18 nëntor 2022, Komisioni u shpreh se legjislacioni shqiptar është



në masën më të madhe i përafuar me *acquis*-të e BE-së dhe u inkurajua vijimi i punës për përmirësim të mëtejshme në këtë drejtim.

## **Kuadri ligjor**

Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” është miratuar në dhjetor të vitit 2020. Ky ligj transponon gjerësisht direktivat e BE-së si më poshtë vijojnë:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, e ndryshuar.
- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE, e ndryshuar.
- Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike, e ndryshuar.
- Direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, e ndryshuar.

Kuadri ligjor në fushën e prokurimit publik plotësohet nga aktet e tjera nënligjore:

1. VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
2. VKM nr. 384, datë 30.06.2021 “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”;
3. VKM nr. 457, datë 30.07.2021 “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit”;
4. VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”;
5. VKM nr. 393, datë 09.06.2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Prokurimet e Përqendruara dhe ngarkimin e kësaj Agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve të varësisë”;
6. VKM nr. 486, datë 21.07.2022 “Për përcaktimin e rregullave për pavlefshmërinë e kontratave të prokurimit publik”;
7. Dokumentet standarde të tenderit;
8. Udhëzime;
9. Rekomandime;
10. Manuale teknike.

Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar rregullon koncesionet dhe partneritetin publik-privat në Republikën e Shqipërisë. Ky Ligj është pjesërisht i

përafuar me Direktivën 2014/23/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 shkurt 2014 për dhënien e kontratave të koncesioneve.

Kuadri ligjor në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publik privat plotësohet nga aktet e tjera nënligjore:

1. VKM nr. 280, datë 7.4.2020 “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të komitetit të përzgjedhjes së projekteve të koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar”;
2. VKM nr. 285, datë 10.4.2020 “Për organizimin, funksionimin si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”;
3. VKM nr. 420, datë 27.05.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, të ndryshuar”.

Sa i takon prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, Ligji Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” përafuron pjesërisht Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009 për koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon Direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE.

Kuadri ligjor për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë plotësohet nga aktet e tjera nënligjore:

- VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe software-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”;
- VKM nr. 542, datë 29.09.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”;
- Dokumentet standarde të tenderit.

## **Kuadri institucional**

Në fushën e prokurimit publik (klasik dhe kontrata sektoriale), kompetencat institucionale janë si vijojnë:

- Institucion politikëbërës: Agjencia e Prokurimit Publik
- Institucion propozues për akte ligjore dhe nënligjore: Agjencia e Prokurimit Publik.
- Institucion monitorues dhe verifikues për procedurat e prokurimit: Agjencia e Prokurimit Publik

- Institucion përgjegjës për shqyrtimin e ankesave: Komisioni i Prokurimit Publik.
- Institucion zbatues: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara; Autoritetet dhe entet kontraktore sipas përcaktimeve në ligjin e prokurimit publik.

Në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, kompetencat institucionalë janë si vijojnë:

- Institucion politikëbërës dhe propozues i akteve ligjore e nënligjore: Agjencia e Trajtimin të Koncesioneve dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- Institucion përgjegjës për shqyrtimin e ankesave: Komisioni i Prokurimit Publik.
- Institucion monitorues për ligjshmërinë e procesit të prokurimit: Agjencia e Prokurimit Publik
- Institucion zbatues: Autoritetet kontraktore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve.

Në fushën e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kompetencat institucionalë janë si vijojnë:

- Institucion politikëbërës: Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme.
- Institucion përgjegjës për shqyrtimin e ankesave: Komisioni i Prokurimit Publik.
- Institucion monitorues për ligjshmërinë e procesit të prokurimit: Agjencia e Prokurimit Publik;
- Institucion monitorues në lidhje me sigurinë e informacionit: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Institucion zbatues: Autoritetet kontraktore sipas përcaktimeve të legjislacionit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

## Arritjet kryesore

Arritjet kyç të konstatuara gjatë vitit 2022 përfshijnë:

1. Përmbyllja e suksesshme e takimit dypalësh Shqipëri-BE në Bruksel, në kuadër të procesit “*screening*” për Kapitullin 5;
2. Miratimi i VKM për Agjencinë Shtetërore për Prokurimet e Përqendruara dhe i VKM për përcaktimin e pavlefshmërisë së kontratave;
3. Miratimi i VKM për përcaktimin e rregullave për pavlefshmërinë e kontratave të prokurimit publik.

### 5.5 Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse

- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATRAKO);
- Ministria e Mbrojtjes;

- Ministria e Brendshme;
- Agjencia e Blerjeve të Përqendruara;
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Instituti i Statistikave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

## 5.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Sa i takon fushës së prokurimit publik, me anë të miratimit të Ligjit të ri për prokurimin publik në vitin 2020, të rregullave për prokurimin publik në maj të 2021, DST-ve, udhëzimeve, VKM për format e komunikimit, VKM për kodet CPV është arritur një përafrim i konsiderueshëm i Direktivës 2014/24/BE dhe Direktivës 2014/25/BE. Megjithatë, nevojitet përafrim i mëtejshëm i direktivave, veçanërisht sa i takon kufijve monetarë.

Sa i takon shqyrtimit të ankesave, me anë të miratimit të Ligjit të ri për prokurimin publik në vitin 2020 dhe të rregullave për prokurimin publik në maj të 2021, është arritur një përafrim shumë i konsiderueshëm i Direktivave 89/665/KEE dhe 92/13/KEE.

Sa i takon koncesioneve dhe PPP-ve, shkalla e përafrimit me Direktivën 2014/23/BE është vlerësuar si e pjesshme. Në bazë të analizës së boshllëkut ligjor të realizuar nga ekspertët e SIGMA, është konstatuar që ligji aktual është bazuar në direktivën e mëparshme të koncesioneve dhe nevojitet një ligj i ri cili të reflektojë dispozitat e Direktivës 2014/23.

Sa i takon prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me anë të miratimit të Ligjit Nr. 36/2020 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të rregullave për prokurimet në këtë fushë në dhjetor të vitit 2020, si dhe të DST-ve në prill të 2021 është arritur një përafrim shumë i konsiderueshëm i Direktivës 2009/81/KE. Megjithatë, nevojitet përafrim i mëtejshëm i direktivës, veçanërisht sa i takon kufijve monetarë.

Në përgjithësi, *acquis* e BE-së për Kapitullin 5 janë përafuar në masën më të gjerë me anë të ndryshimeve të fundit ligjore, me përjashtim fusha e koncesioneve e cila do të kërkojë një përafrim të mëtejshëm.

Gjithashtu, në vijim të takimit dypalësh, është theksuar nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor në fushën e prokurimit publik si dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me qëllim që shkalla e përafrimit të jetë e plotë.

Prioritetet në fushën e prokurimit publik për periudhën 2023 – 2025 janë:

- Përafrimi i mëtejshëm i ligjit për koncesionet dhe PPP me Direktivën 2014/23/BE.
- Përafrimi mëtejshëm legjislationit në fushën e prokurimit publik me Direktivën 2014/24/BE.

Përafrimi i Direktivës 2014/23/BE do të arrihet me anë të miratimit të një ligji të ri për koncesionet dhe PPP, brenda tremujorit të katërt të 2023.

Përafrimi i Direktivës 2014/24/BE dhe 2014/25/BE do të arrihet nëpërmjet ndryshimit të ligjit aktual për prokurimin publik (Ligji Nr. 162/2020) dhe rregullave për prokurimin publik (VKM 285, datë 19.05.2021), brenda tremujorit të katërt të 2023.

## KAPITULLI 18: STATISTIKAT

### 18.1 Përmbajtja e kapitullit

*Acquis* në fushën e statistikave kërkon ekzistencën e një infrastrukture statistikore bazuar në parime të tilla si paanshmëria, besueshmëria, transparencja, konfidencialiteti i të dhënave individuale dhe shpërndarja e statistikave zyrtare.

Instituti kombëtar i statistikave vepron si pikë referimi për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. *Acquis* mbulon metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme si statistikat makro-ekonomike, statistikat demografike dhe sociale, statistikat rajonale dhe statistikat mbi biznesin, transportin, tregtinë e jashtme, bujqësinë, mjedisin, shkencën dhe teknologjinë.

Për periudhën e këtij dokumenti, pas një procesi të hollësishëm vlerësimi, INSTAT do të propozojë projektligjin “Për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore”, projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e Nomenklaturës së produkteve sipas aktiviteve CPA 2015”. Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, me autoritetin që i jep ligji për statistikat zyrtare, do të miratojë dokumentet udhëzues me qëllim përafrimin e *acquis* zbatuese të rregulloreve/direktivave të BE-së.<sup>47</sup>

Nga ana tjetër, INSTAT ka dërguar pranë Këshillit të Ministrave Planin Vjetor 2023 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026. Ky dokument përmban detyrimet e prodhuesve të statistikave zyrtare për kryerjen e aktiviteve specifike statistikore për sigurimin e statistikave zyrtare sipas parashikimeve të programit. Gjithashtu, dokumenti përcakton detyrimet e institucioneve furnizuese me të dhëna administrative, frekuencën dhe mënyrën e dërgimit të këtyre të dhënave.

---

<sup>47</sup> Sipas Ligjit Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, neni 17 pika 4, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve të parashikuara në nenin 20, shkronja “b”, të këtij ligji, vetëm për INSTAT-in. Neni 20 shkronja b Bordi Drejtues t’i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm nxjerrjen e udhëzimeve dhe vendosjen e standardeve për t’u zbatuar nga institucionet e Sistemit Kombëtar Statistikor, për të siguruar cilësinë në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, si dhe të monitorojë zbatimin e tyre.

## 18.2 Struktura e kapitullit

Struktura e kapitullit 18 “Statistikat” është si më poshtë:

- Statistikat Demografike dhe Sociale;
- Statistika Ekonomike;
- Statistikat Sektoriale;
- Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain.

## 18.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar për statistikat zyrtare me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 70 dhe 88 të MSA-së.

Neni 88 parashikon se “bashkëpunimi midis palëve do të përqendrohet kryesisht në fushat kryesore që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e statistikave”. Kjo do të synojë në veçanti zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna krahasimore, të besueshme, objektive dhe të sakta të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformat në Shqipëri. Ai gjithashtu do të mundësojë Institutit të Statistikave të Shqipërisë që të plotësojë më mirë nevojat e përdoruesve të saj kombëtarë dhe ndërkombëtarë (si administratës publike, ashtu edhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të miratuara nga Kombet e Bashkuara, Kodi i Praktikave të Statistikave Evropiane i dhe dispozitat e Ligjit Evropian Statistikor dhe të zhvillohet drejt *acquis* të Komunitetit.

*Acquis* në fushën e statistikave përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga legjislacioni i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare siç janë Rregulloret e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Vendimet dhe Rregulloret e Komisionit. Për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor parashikohen rregulla të zakonshme. *Acquis* statistikore përmban gjithashtu një gamë të gjerë të manualeve metodologjike në fusha të ndryshme statistikore si bujqësia, politikat ekonomike dhe monetare, statistikat demografike dhe sociale dhe kërkimet. Marrëveshjet ndërkombëtare ose standardet ndërkombëtare si kodi i praktikës në statistika ofrojnë një bazë tjetër për prodhimin statistikor.

Puna e Sistemit Kombëtar të Statistikave bazohet në Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2022 – 2026 të miratuar me Ligjin nr. 30/2022. Ky është dokumenti kryesor që rregullon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Statistikor Kombëtar i nevojshëm për të vëzhguar gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në Nenet 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, të cilat janë në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Programi shërben gjithashtu për të orientuar INSTAT-in dhe agjencitë e tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor të kërkuar nga standardet e *acquis*. Kuvendi i Shqipërisë miraton gjithashtu Planin Vjetor për

zbatimin e Programit, sipas draft-dokumentit të përgatitur nga INSTAT në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare.

Ligji nr. 17/2018, datë 05.04.2018 “Për statistikat zyrtare” është hartuar sipas Kodit të Praktikës dhe Rregullores Evropiane të Statistikave EC 223/2009 dhe parimeve të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane.

Baza ligjore për zhvillimin, mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave të Bankës së Shqipërisë është Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili është pjesërisht në përputhje me Rregulloren 184/2005 KE.

#### 18.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për statistikat. Është bërë përparim i kufizuar në adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar. Ka patur progres në përafrimin e mëtejshëm me standardet ESA 2010, publikime më të shpejta dhe rritje të transmetimit në EUROSTAT. Programi zyrtar i statistikave 2022 – 2026 është miratuar dhe përgatitjet për Censin e Popullsisë dhe Banesave po vijojnë. Roli i Sistemit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) është forcuar më tej dhe burimet e tij janë përmirësuar; megjithatë, metodat e mbledhjes së të dhënave duhet të modernizohen ndërsa proceset e prodhimit statistikor u përmirësuan.

Sa i përket infrastrukturës statistikore, ligji i Shqipërisë për statistikat zyrtare është në përputhje me legjislacionin evropian përkatës. Kodi i Praktikës së Statistikave dhe shumica e klasifikimeve janë në përputhje me standardet e BE-së. Programi i Statistikave Zyrtare u miratua me ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2022 – 2026”. Sistemi Kombëtar i Statistikave (INSTAT) ka nisur zbatimin e tij. INSTAT ka dërguar pranë Këshillit të Ministrave projekt-Planin Vjetor 2023 për zbatimin e Programit.

Ndërkohë që INSTAT ka bërë disa përpjekje për plotësimin e vendeve të lira, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të reduktuar lëvizjen e stafit dhe për të siguruar që të niveli i stafit të jetë i mjaftueshëm dhe i trajnuar për të siguruar nevojat e prodhimit zhvillimet statistikore.

Statistikat demografike dhe komponentët e tij si: Popullsia, Lindjet, Vdekjet, Shtesa Natyrore dhe Migracioni Neto prodhohen në përputhje me rregulloret dhe definicionet e përdorura nga EUROSTAT. INSTAT ka transmetuar këto të dhëna si dhe metadata nëpërmjet platformës elektronike Metadata Handler me frekuencë vjetore (Euro SDMX Metadata Strukturore, ESMS). INSTAT transmetoi të dhënat kryesore të popullsisë në EUROSTAT në qershor 2022 si dhe do të transmetojë të dhënat e detajuara demografike në dhjetor 2022.

INSTAT ka përpunuar analizuar dhe transmetuar për herë të parë në EUROSTAT të dhëna mbi vdekjet javore sipas karakteristikave kryesore demografike (NUTS 3, SEX dhe AGE). Këto të dhëna u transmetuan si të dhëna finale për vitin 2020. Gjithashtu, të dhënat paraprake të vdekjeve

janë transmetuar sipas javëve të 2021. INSTAT iu bashkua nismës nga EUROSTAT në mënyrë vullnetare për statistika sa më të detajuara dhe me periodicitet të lartë në kuadër të situatës të shkaktuar nga pandemia globale COVID-19.

INSTAT në përputhje me PSZ 2017 – 2021 ka mbledhur, përpunuar, analizuar dhe shpërndarë që prej 2017 të dhënat mbi të huajt me leje qëndrimi, të huajt e parregullt si dhe statistikat mbi azil kërkuesit në Shqipëri. Këto të dhëna bënë të mundur plotësimin e disa indikatorëve mbi azil kërkuesit të cilët kërkohen nga pyetësorët e EUROSTAT dhe janë transmetuar së fundmi në Shkurt të 2022. Në kuadër të përafrimit të statistikave të lejeve të qëndrimit, të huajve të parregullt si dhe statistikave mbi azil kërkuesit, INSTAT ka hartuar formate tip për mbledhjen e tyre nga burimet administrative në përputhje me rregulloret dhe definicionet e përdorura nga EUROSTAT.

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri. Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e peshave të përdorura në Indeksin e Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të NjEF si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve. Nga janari i vitit 2014, ABF është një anketë e vazhdueshme dhe me baza vjetore. Prej vitit 2019, për të gjithë kampionin informacioni në ditë mbledhet me periudhë mbledhjeje të të dhënave 1 javë. Rezultatet kryesore të ABF 2021 u publikuan në Tetor 2022. Aktualisht është duke u kryer në terren anketa e vitit 2022, kampioni i së cilës vazhdon në madhësinë e kampionit të vitit 2021 për të studiuar dhe analizuar treguesit kryesorë të konsumit për 6 bashki kryesore.

Për sa i përket Anketës së Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime”, ka përfunduar grumbullimi i të dhënave në terren për tremujorin 1 dhe 2 për vitin 2022. Aktualisht, është duke u përgatitur publikimi i rezultateve kryesore me të dhënat e vitit 2021, të cilat do të bëhen publike në Nëntor 2022. Të dhënat e vitit 2021 po përgatiten për t’u transmetuar në EUROSTAT sipas kërkesave dhe udhëzimeve përkatëse. Grumbullimi i të dhënave në terren për tremujorin e tretë të anketës për vitin 2022 është në terren, ndërkohë ka përfunduar hedhja e të dhënave për tremujorin e parë dhe të dytë.

Sa i përket Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Njësiti Ekonomike Familjare (NjEF) dhe Individë, procesi i mbledhjes së të dhënave në terren për vitin 2022 në periudhën Shtator-Tetor-Nëntor 2022 është drejt përfundimit. Të dhënat e vitit 2021 janë transmetuar në EUROSTAT sipas kërkesave dhe udhëzimeve përkatëse. Publikimi i rezultateve kryesore për të dhënat e vitit 2022 do të bëhet në Dhjetor 2022.

Gjatë vitit 2022, INSTAT realizoi anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, (SILC 2022) gjatë periudhës prill – gusht 2022 (4 muaj). Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në pastrimin e të dhënave të SILC 2021 si dhe përgatitjen e skedarëve agregat, përditësimin të programeve si dhe ndërtimit të skedarit të konsoliduar për të dhënat e SILC 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Procesin e përfundimit dhe transmetimit në EUROSTAT të të dhënave të konsoliduara të SILC 2021 do të realizohet në dhjetor 2022.



Që nga viti 2019, INSTAT është duke zhvilluar Sistemin e Integruar Evropian të Statistikave të Mbrojtjes Sociale (ESSPROS).

Në vitin 2021-2022 Shqipëria u asistua nga ekspertë teknik të mbështetur nga IPA 2019 ku u realizua moduli i Përfituesve të pensioneve për vitet 2018 – 2020 dhe u transmetuan të dhënat paraprake në EUROSTAT. Gjithashtu INSTAT ka mbledhur të dhënat cilësore dhe sasiore për sistemin bazë të cilin e ka transmetuar në EUROSTAT.

Për të përmirësuar dhe zhvilluar më tej sistemin ESSPROS në vend, Shqipëria vazhdon të asistohet nga një mbështetje teknike ad-hoc nga projekti IPA Shumëpërfitues.

Në përputhje me PSZ 2022 – 2026, INSTAT prodhon dhe publikon statistika të përditësuara mbi shkaqet e vdekjeve dhe shëndetin publik. Me fillimin e implementimit të Nomenklaturës së miratuar të Shkaqeve të Vdekjeve (ICD-10) do reflektohen ndryshimet në statistikat e shkaqeve të vdekjeve sipas rekomandimeve të EUROSTAT. Rezultatet e anketës EHIS do të plotësojnë dhe pasurojnë tërësinë e të dhënave të shëndetit publik sipas ECHI (European Core Health Indicators), si dhe do lehtësojnë krahasimin e të dhënave, të cilat do shërbejnë për të monitoruar shëndetin, kujdesin shëndetësor në nivelin e standardeve të BE-së.

Në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, INSTAT është asistuar vazhdimisht nga IPA 2014, 2015 dhe 2017. Klasifikimi ndërkombëtar i krimeve për qëllime statistikore (ICCS) është në proces finalizimi dhe diskutimi në komisionin e nomenklaturës. INSTAT ka përfunduar për të gjithë nivelet hartëzimin e klasifikimit bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, dhe njëmbëdhjetë nivelet e klasifikimit janë finalizuar dhe dakordësuar me grupin ndërinstitucional teknik të punës. Zbatimi i këtij klasifikimi, nga INSTAT dhe institucionet përgjegjëse për prodhimin e statistikave të drejtësisë penale, do siguroj krahasueshmëri të dhënash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga viti 2013, INSTAT transmeton në EUROSTAT pyetësor mbi statistikat e krimeve. Në kuadër të projektit IPA-2017 “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale”, INSTAT po zhvillon setin e zgjeruar të krimeve me interes në BE, vepra penale të cilat janë në linjë me klasifikimin ICCS.

Në përputhje me PSZ 2022 – 2026, INSTAT publikon çdo vit statistika të përditësuara gjinore në një botim të dedikuar “Gra dhe Burra në Shqipëri. Gjatë vitit 2022, INSTAT ka nisur punën përgatitore për llogaritjen e GEI 2021, nëpërmjet kombinimit të treguesve të përzgjedhur të barazisë gjinore në një masë të vetme përmbledhëse. Pas analizimit të të dhënave, llogaritjet e GEI 2021 do dërgohen për validim të EIGE dhe pritet brenda tremujorit të katërt 2022 të përfundojë llogaritja e treguesit për vitin 2021. Treguesi i barazisë gjinore është një vlerë themelore e Bashkimit Evropian dhe është thelbësor për zhvillimin e politikave gjinore të një vendi. Si i tillë matja e progresit të barazisë gjinore është një pjesë integrale dhe efektive e politikë bërësve.

Për sa i përket statistikave të arsimit, INSTAT publikon çdo vit statistika të përditësuara mbi regjistrimet dhe diplomimet sipas programeve dhe niveleve arsimore, në institucionet arsimore

publike dhe private. Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit ISCED-11 përdoret për të klasifikuar të dhënat dhe për të prodhuar statistika sipas niveleve dhe fushave të studimit. Statistikat e arsimit bazohen në burime administrative, kryesisht nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Tregues shtesë në lidhje me ndjekjen në shkollë dhe arsimin e të rriturve janë llogaritur duke përdorur Anketën për Arsimin e të Rriturve (AES) dhe të dhënat e Anketës së Forcës së Punës (LFS). Për herë të parë, anketa AES është zhvilluar në vitin 2017 dhe raundi i ardhshëm është planifikuar në 2023. Statistikat e arsimit transmetohen çdo vit në UNESCO-UIS përmes pyetësorëve shumë të detajuar. Në 2022 ka nisur transmetimi në EUROSTAT i pyetësorëve të UOE data Collection; janë transmetuar katër pyetësorë dhe janë në proces dy të tjerë nga nëntë pyetësorë gjithsej për vitin shkollor 2020 – 2021. Përmirësimet e mëtejshme në lidhje me cilësinë e të dhënave dhe transmetimi i të dhënave në EUROSTAT do të jenë objektivi kryesor lidhur me këto statistika.

Spektori i Tregut të punës kryen vlerësime për dy aktivitete statistikore me frekuencë tremujore: “Anketën Tremujore të Forcave të Punës” dhe “Prodhimin e të Dhënave Administrative të Tregut të Punës”. Për të “Dhëna Administrative mbi Pagat”, me frekuencë tremujore dhe vjetore, do të vazhdojë publikimi duke përdorur të dhënat administrative të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjatë vitit 2022, u përpunuan, publikuan dhe u transmetuan në EUROSTAT të dhënat e Anketës rreth “Strukturës së Kostos nga Puna” e planifikuar çdo katër vjet. INSTAT ka arritur të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga PSZ-së 2022 – 2026. Janë realizuar sipas moduleve objektivat si më poshtë:

- Tregues statistikorë mbi forcat e punës, punësimin dhe papunësinë sipas gjinisë, aktivitetit ekonomik, grup profesioneve, grup moshave, nivelit arsimor dhe qarqeve (Publikimi i fundit korrespondon me Tremujorin e 2-të, 2022);
- Tregues statistikorë mbi të papunët e regjistruar gjithsej dhe sipas gjinisë, grup moshave, nivelit arsimor dhe qarqeve, të papunët e regjistruar që përfitojnë pagesë papunësie, të papunët afatgjatë të regjistruar dhe shkalla e papunësisë së regjistruar;
- Përpilimi i Anketës rreth “Strukturës së të ardhurave nga puna” që do të kryhet në vitin 2023 dhe rezultatet do të publikohen në vitin 2024. Kjo anketë përmban tregues statistikorë të vitit 2022 mbi strukturën e të ardhurave nga puna për orë pune, mujore dhe vjetore sipas karakteristikave individuale të punonjësve (gjinia, mosha, profesioni, niveli më i lartë arsimor i arritur), dhe punëdhënësit (aktiviteti ekonomik, madhësia dhe pronësia e ndërmarrjes) (Publikimi i fundit korrespondon me vitin 2019);
- Tregues statistikorë mbi pagën mesatare mujore për të punësuarit me pagë në sektorin shtetëror dhe për të gjithë sektorët ekonomikë sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup profesioneve, hendekun gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup profesioneve (Publikimi i fundit korrespondon me Tremujorin e 2-të 2022).

Gjatë vitit 2022, ka vazhduar puna përgatitore për Censin e Popullsisë dhe Banesave:

- INSTAT ka rishikuar Planin e aktiviteteve të Censit, me periudhë propozimi për vitin 2023, 17 shtator – 29 tetor 2023 (6 javë në terren), me datë fillimi 17 Shtator.

- Është rishikuar buxheti i Censit duke rialokuar linjat e buxhetit të shtetit si dhe buxhetin e mbuluar nga donatorët (Komisioni Evropian; Qeveria Suedeze (Sida); Qeveria Zvicerane (SDC + FSO); UNFPA);
- Në vijim të komunikimit mbi shtyrjen e grumbullimit të të dhënave në terren të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022, si dhe në kuadër të Kontratës së Grantit “Mbështetje për zbatimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri”, INSTAT organizoi mbledhjen Ad-hoc të Komitetit të Lartë Drejtues, për të informuar donatorët si dhe për të prezantuar rishikimin e planit të aktivitetit si dhe efektet financiare të tij.
- INSTAT ka hartuar planin vjetor të INSTAT, ku është propozuar dhe data e Censit së bashku me përmbajtjen e pyetësorit të Censit. Ky projekt-plan pritet të miratohet në dhjetor 2022 në Parlament.
- Në zbatim të vendimit të KPP, INSTAT i ka dërguar shkresë zyrtare AKSHI-t, për të bërë publike standardet që INSTAT do të përdorë për tabletët. Gjithashtu, është dërguar shkresë pranë Këshillit të Ministrave, ku kërkohet autorizimi që AKSHI të mbështesë INSTAT në këtë proces shumë të rëndësishëm.
- Ka vijuar puna në kuadër të përgatitjes së fushatës konceptuale të komunikimit për censin, në bashkëpunim me kompaninë e rekrutuar për këtë qëllim dhe në përputhje me strategjinë e komunikimit. Puna është fokusuar në përgatitjen konceptuale të materialeve promovuese dhe vizuale për fushatën e komunikimit si edhe atë të rekrutimit të stafit të terrenit
- Ka vazhduar puna me përcaktimin e zonave mbikëqyrëse dhe përcaktimin e zonave GIS si dhe po bëhet vlerësimi i modifikimeve të mundshme në aplikacionet për censin

Vitet e fundit, Shqipëria ka bërë një punë intensive në fushën e statistikave të Llogarive Kombëtare për rritjen e nivelit të përputhshmërisë me ESA 2010, konkretisht në përmirësime metodologjike apo edhe në shtimin e treguesve të rinj. Projekte të ndryshme IPA shumë-përfituese, nga BE dhe jo vetëm, kanë ndihmuar në zhvillimin e Llogarive Kombëtare dhe do të vazhdojnë të japin asistencë teknike deri në implementimin e plotë të saj. Zhvillimet e fundit të Llogarive Kombëtare janë si më poshtë:

- Prodhimi dhe publikimi i “Llogarive kombëtare tremujore” sipas metodës së prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime korrente dhe ato të vitit të mëparshëm (të dhëna zinxhirore 2010=100), të përshtatura / jo të përshtatura sezonalisht. Seria kohore e publikuar T1\_2008 – T2\_2022. Formimi bruto i kapitalit fiks sipas aseteve dhe konsumi i familjeve sipas qëndrueshmërisë transmetuar në EUROSTAT me statusin “Jo për publikim”.
- INSTAT vijon punën për zgjerimin e serisë kohore të PBB-së tremujore sipas metodës së prodhimit për periudhën T1-2001 - T4-2007. Publikimi i kësaj serie kohore do të jetë pjesë e revizionimit të PBB-së në vitin 2024. Nën asistencën e IPA MBP është përmirësuar metodologjia e vlerësimit në terma tremujor të treguesit të Vlerës së shtuar bruto për aktivitetin e Bujqësisë dhe seria kohore T1 2008 – T2 2022 është transmetuar në EUROSTAT nëpërmjet platformës SDMX.
- Prodhimi dhe publikimi i “Llogarive kombëtare vjetore” me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime korrente dhe ato të vitit të mëparshëm, Seria kohore e publikuar 1996 – 2020.

- Përmirësime metodologjike në vlerësimin e komponentëve të ekonomisë së pa-vrojtuar;
- Përmirësime në përpilimin e llogarive të sektorit jo-financiar nëpërmjet aplikimit të metodës bottom – up për vlerësimin e drejtpërdrejtë për secilin sektor duke mundësuar rritjen e numrit të transaksioneve të vlerësuara si dhe balancimin e tyre. Aktualisht, INSTAT ka përpiluar dhe transmetuar në EUROSTAT sekuencën e plotë të llogarive jo-financiare për periudhën 2016 – 2019 mbi baza eksperimentale.
- Përpilimi, publikimi dhe transmetimi në EUROSTAT i “Llogarisë së Prodhimit dhe Gjenerimit të të Ardhurave”. Seria kohore e publikuar 2013 – 2019;
- Përpilimi, publikimi dhe transmetimi në EUROSTAT i “Tabelave burim përdorime dhe Input – Output”. Seritë kohore të transmetuara: me çmime korrente për 2010 - 2019 dhe me çmime të vitit të kaluar për 2015 - 2019.
- Përpilimi, publikimi dhe transmetimi i treguesve të vlerës së shtuar bruto (VSHB) dhe prodhimit të brendshëm bruto (PBB) sipas rajoneve statistikore (2/3) dhe sipas aktiviteteve ekonomike në nivel agregimi A10, me çmime korrente dhe ato të vitit të mëparshëm. Seria kohore e publikuar 2008 – 2020.

INSTAT ka bërë përmirësime në integrimin e burimeve të reja të të dhënave për vlerësimet e VSHB-së rajonale, vlerësimi eksperimental i formimit të kapitalit fiks bruto (2009 – 2018) dhe të ardhurave familjare (2013 – 2016) sipas aktiviteteve dhe sipas rajoneve statistikore; prapa-cast për seritë kohore 2000 – 2007. Këto përmirësime do të publikohen dhe transmetohen nga SDMX në EUROSTAT pas rishikimit të standardit të vitit 2024.

Në kuadër të programit shumë përfitues IPA 2019, INSTAT është në proces të përmbushjes së objektivave të Projekteve Statistikore në të cilat përfshihen Llogaritë Kombëtare, si Statistikat e Financave të Qeverisë dhe Procedura e Deficitit të Tepruar, Metodologjia e Llogarive Kombëtare, Programi i Transmetimit ESA 2010, Llogaritë sektoriale, Tabelat burim, përdorime dhe Input – output, Llogaritë Rajonale. Këto projekte statistikore do të kontribuojnë në: përpilimin e sekuencës së plotë të llogarive të sektorit jo-financiar 2019 – 2020; vlerësimin eksperimental të PBB – së, sipas metodës së të ardhurave për vitin 2020; rritjen e prodhimit të një grupi më të plotë të treguesve të llogarive kombëtare, sipas Programit të Transmisionit ESA 2010; integrimi i plotë i tabelave burim, përdorime dhe Input - Output në sistemin e llogarive kombëtare; përmirësime në metodologjinë e llogarive rajonale. Një nga objektivat kryesore të këtij projekti është revizionimi madhor i PBB-së në vitin 2024 sipas kërkesave të ESA 2010.

Në përmbushje të detyrimeve në kuadër të përafrimit të statistikave të Llogarive Kombëtare janë përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të NSTAT metadatat strukturore të Llogarive Kombëtare, të cilat janë transmetuar në EUROSTAT nëpërmjet Metadata Handler (Euro SDMX Metadata, ESMS).

INSTAT në bashkëpunim me BSH dhe MFE transmeton rregullisht (dy herë në vit) në EUROSTAT, Tabelat e njoftimit të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP). Dërgimi i fundit është kryer në Tetor 2022, duke përdorur formatin zyrtar të kërkesave të EUROSTAT. Këto tabela

vlerësohen të jenë pjesërisht të përafuara me rekomandimet e ESA 2010 dhe Manualin e Deficitit dhe Borxhit (MDGG 2014).

Për plotësimin e tabelave EDP është i nevojshëm identifikimi i tërësisë së njësive institucionale që klasifikohen nën Qeverinë e Përgjithshme, në përputhje me standardet ESA2010. Listat e njësive të sektorit publik dhe atij financiar hartohen në përputhje me ESA2010 dhe publikimi i tyre plotëson detyrimet e rrjedhura në kuadër të integritimit. Lista e dakordësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë dhe INSTAT përditësohet dhe publikohet rregullisht, çdo vit.

Politika e Revizionimit të statistikave Makroekonomike, mbështetur në Politikën e Harmonizuar të Revizionimit (HERP), e cila është e detyrueshme për të gjithë vendet anëtare të Bashkimit Evropian është publikuar në faqen zyrtare të INSTAT. Kjo politikë u hartua në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë. Metadatat Strukturore të Llogarive Kombëtare janë të publikuara gjithashtu, në faqen zyrtare të EUROSTAT dhe INSTAT.

Në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi Statistikat e Bizneseve, INSTAT është asistuar nga programet IPA Shume përfitues. Për sa i përket “Statistikave të Biznesit”, INSTAT ka vlerësuar, përditësuar dhe transmetuar në EUROSTAT të dhëna mbi treguesit ekonomik, në përputhshmëri me rregulloret evropiane. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2022 janë realizuar objektivat e vendosura në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2022 – 2026.

INSTAT mirëmban dhe është përgjegjës për përditësimin e regjistrave të biznesit. Regjistrat përditësohen dhe mirëmbahen me burimet administrative dhe statistikore. Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore dhe ndërmarrjet që kryejnë veprimtari ekonomike, duke kontribuar në prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Në qershor të vitit 2022 u publikuan të dhënat e regjistrit me vit referencë 2021. Për herë të parë në këtë publikim u shtuan të dhëna në lidhje me punësimin dhe shitjet neto. Botimi shoqërohet me raportin e cilësisë ESQRS (Struktura Standarde e Raportit të Cilësisë ESS) i cili botohet çdo vit në faqen zyrtare të INSTAT dhe transmetohet në EUROSTAT. Regjistri Statistikor i Njësive Lokale është ndërtuar në vitin 2010 dhe përditësohet çdo vit. Ky regjistër është baza kryesore për prodhimin e statistikave rajonale. Për shkak të globalizimit, krahasueshmëria ndërkombëtare e të dhënave statistikore është bërë shumë e rëndësishme. Regjistri i Grupeve të Ndërmarrjeve dhe Grupet e Ndërmarrjeve Shumëkombëshe (MNE) është ndërtuar dhe mirëmbahet prej vitit 2018.

Organizimi i një studimi të dedikuar për përmirësimin e cilësisë së regjistrave të biznesit për të kontrolluar dhe përmirësuar karakteristikat e njësive statistikore do të zhvillohet në vitin 2024 për: Ndërmarrje; Njësi lokale; Grupi i Ndërmarrjeve; KAU. Prodhimi i statistikave demografike të biznesit është gjithashtu një nga aktivitetet e planifikuara për tu realizuar.

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve ekonomike jobujqësore me vrotim vjetor. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri, pavarësisht formës së tyre ligjore. Të dhënat finale publikohen 14 muaj pas vitit të referencës në

njoftimin për shtyp “Rezultate finale të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve”, në Vjetarin Statistikor dhe faqen elektronike të INSTAT-it. Rezultatet publikohen në nivel kombëtar, sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes. Gjithashtu, INSTAT prodhon dhe Statistika Strukturore të Ndërmarrjeve sipas rajoneve, të cilat kanë si qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën e aktiviteteve ekonomike të tyre.

Gjatë vitit 2022 u realizua prodhimi i rezultateve finale të Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike 2020. Gjithashtu, u realizua përpunimi dhe prodhimi i statistikave strukturore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2020. INSTAT ka kryer vlerësimin e statistikave strukturore në nivel rajonal për treguesit kryesorë për vitin 2020. Në Qershor 2022 u transmetuan në EUROSTAT disa nga treguesit kryesorë sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes. Për të siguruar vazhdimësinë dhe përmirësimin e cilësisë të treguesve statistikorë të ndërmarrjeve, INSTAT do të shfrytëzojë edhe burimet administrative për llogaritjen dhe publikimin e të dhënave. Në vitin 2023, në kuadër të përafritimit me rregulloret, do të punohet me revizionimin e kampionit të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, duke e shtrirë mbulimin në nivel 3-4 shifror të aktiviteteve ekonomike të pambuluara në vitin 2022. Përmirësimi i afatit kohor të prodhimit të të dhënave paraprake të ASN është gjithashtu një nga aktivitetet e planifikuara për tu realizuar.

“Statistika mbi produktet industriale të ndërmarrjeve (PRODCOM)”, janë rezultat i të dhënave nga aktiviteti mbi vrojtimin vjetor që kryhet nga INSTAT për listën e produkteve industriale. Seria kohore 2019 -2021 është përgatitur në nivel 8- shifror (Lista e produkteve industriale, PRODCOM 2019) Gjatë vitit 2023 do të analizohen të dhënat dhe kjo seri do të shërbejë për një vlerësim më të plotë të treguesve sasior të produkteve industriale. Përgatitja dhe transmetimi i serive kohore të të dhënave PRODCOM sipas Rregullores së BE-së, do të realizohet.

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve ekonomike jobujqësore. Gjatë viteve të fundit të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe vrojtimit tremujor. Statistikat Afatshkurtra përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri, pavarësisht formës ligjore të tyre. Të dhënat publikohen 60 ditë pas mbylljes së tremujorit referencë për Lejet e Ndërtimit dhe 75 ditë për Statistikat Afatshkurtra. Prej vitit 2018, të dhënat transmetohen rregullisht me bazë tremujore për disa tregues kryesorë dhe raportet e cilësisë për këta tregues në përputhje me afatin e kërkuar transmetohen në EUROSTAT. Gjatë vitit 2022 në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar:

- Indeksi i Tregtisë me Pakicë tremujor, publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e dytë 2022;
- Statistikat Afatshkurtra, Të mirat dhe Shërbime, publikim tremujor i fundit korrespondon me tremujorin e dytë 2022;

Gjatë vitit 2022, gjithashtu u realizua prodhimi i statistikave mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë me frekuencë tremujore, duke shfrytëzuar të dhënat administrative. Publikimi tremujor i fundit korrespondon me tremujorin e tretë 2022.

Gjatë vitit 2023 burimet administrative do të përdoren për analizën dhe prodhimin e treguesve afatshkurtër. Në rast të mungesës së burimit administrativ do të përdoren kontakti me anketues për ndërmarrjet. Gjithashtu, do të vlerësohen të dhënat e aktiviteteve të reja të përfshira në fushën e shërbimeve për statistikën afatshkurtra, si dhe llogaritja e indekseve mujore për treguesit e shitjeve në statistikën afatshkurtra .

Përpilimi dhe transmetimi i indekseve të prodhimit në ndërtim në total (F) dhe ndarja sipas NVE Rev.2; 41, 42, 43, zbatimi i klasifikimit NPA për treguesit e lejeve të ndërtimit; përpilimi dhe transmetimi i IPI, IKN dhe IÇI në baza mujore janë disa aktivitete të tjera që do të realizohen.

Në zbatim të Ligjit Nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 17/2018, datë 05.02.2004 “Për statistikën zyrtare”, “Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017-2021”, Banka e Shqipërisë ka vijuar me prodhimin dhe publikimin e blloqeve statistikore të prezantuara nëpërmjet statistikave monetare e financiare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Banka e Shqipërisë është kujdesur që të gjithë treguesit e përgatitur prej saj të garantojnë plotësimin dhe respektimin e të gjitha parimeve të statistikave zyrtare, të tilla si integritetin, transparencën, cilësinë, koherencën, konfidencialitetin etj.

Për sa i përket aktiviteteve zbatuese për statistikën monetare janë prodhuar dhe publikuar rregullisht treguesit monetarë mujorë dhe tremujorë, të tillë si: agregatet monetarë, depozitat, kreditë, normat e interesit të depozitave dhe kredive për sasi të reja dhe sasi gjendje, bilancet sektoriale dhe paraqitjet monetare të korporatave depozituese dhe institucioneve të tjera financiare.

Lidhur me hartimin e statistikave të llogarive financiare ka vijuar puna lidhur për konsolidimin e burimeve të informacionit dhe metodikës së vlerësimit në hartimin e Llogarive Financiare, për të gjithë sektorët ekonomikë, në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore Evropiane dhe EUROSTAT-it. Banka e Shqipërisë publikon rregullisht si Llogaritë Financiare të Shqipërisë, në frekuencë vjetore së bashku me analizën e tyre.

Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për përpilimin dhe transmetimin në EUROSTAT të llogarive financiare sipas sektorëve institucionalë bazuar në metodologjinë ESA2010. BSH ka raportuar në EUROSTAT nëpërmjet platformës SDMX për publikim këto tabela për vitet 2013 – 2021:

- 0710 – Bilancet e aktiveve dhe detyrimeve financiare (aksione), të konsoliduara;
- 0720 – Bilancet e aktiveve dhe detyrimeve financiare (aksione), të pakonsoliduara.

Në EUROSTAT janë raportuar gjithashtu të dhëna pilot për vitet 2020-2021 për tabelat:

- 0610 – Llogaritë financiare sipas sektorëve (transaksione), të konsoliduara;
- 0620 – Llogaritë financiare sipas sektorëve (transaksione), të pakonsoliduara

Në kuadër të grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e cilësisë së treguesve të Procedurës së Deficitit të Tejkalar (EDP), ka vijuar puna për harmonizimin e të dhënave të llogarive financiare me statistikën e financave të qeverisë. Gjithashtu, puna vijon për implementimin e rregullores 501/2004 EC për hartimin e llogarive financiare me bazë tremujore.

Lidhur me statistikat e sektorit të jashtëm, Banka e Shqipërisë ka transmetuar rregullisht në EUROSTAT pyetësorët e mëposhtëm, me bazë tremujore dhe vjetore:

- Bilanci pagesave tremujore;
- Pozicioni i investimeve ndërkombëtare;
- Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve sipas shteteve;
- Fluksi i investimeve direkte sipas shteteve;
- Të ardhurat nga i investimeve direkte sipas shteteve;
- Fluksi dhe të ardhurat nga investimet direkte sipas shteteve dhe aktivitetit ekonomik;
- Stoku i investimeve direkte sipas shteteve;
- Stoku i investimeve direkte sipas shteteve dhe aktiviteteve;

Banka e Shqipërisë ka vijuar rregullisht publikimin e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve sipas shteteve, si një produkt i ri statistikor.

Në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022 – 2024, për përafrimin metodologjik të statistikave me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimin e tyre sipas *acquis*, gjatë vitit 2022 është punuar për përafrimin e akteve si më poshtë:

- Rregullores (BE) Nr. 1073/2013 e Bankës Qendrore Evropiane, e 18 tetor 2013 në lidhje me “Raportimin statistikor të fondeve të pensionit”;
- Rregullores (BE) Nr. 1374/2014 e Bankës Qendrore Evropiane, 28 nëntor 2014 në lidhje me “Raportimin Statistikor të shoqërive të sigurimit”;
- Rregullores (BE) Nr. 2018/231 e 26 janar 2018 në lidhje me “Raportimin statistikor të fondeve të investimit”.

Këto rregullore synojnë përshtatjen dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare të sistemit raportues të institucioneve të tjera financiare me qëllim përpilimin e statistikave monetare. Banka e Shqipërisë është institucioni i vetëm, i cili grumbullon përpilon dhe publikon të dhënat monetare. Këto të dhëna kanë një rëndësi të veçantë për përmbushjen e funksionit të saj kryesor, hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, si dhe luajnë një rol të rëndësishëm në analizat dhe vendimmarrjen në kuadër të stabilitetit financiar të vendit.

Banka e Shqipërisë gjatë periudhës maj – gusht 2022 ka hedhur në terren dy vrojtme pranë ndërmarrjeve: vrojtimi për matjen e vlerës së përpunimit të mallrave të zotëruara nga jo-rezidentët dhe vrojtimi për matjen e koeficienteve të kredisë tregtare dhe kontrabandës për tregtinë e mallrave. Ndërmarrjet u anketuan në lidhje me të dhënat e vitit 2021. Vrojtimi pranë ndërmarrjeve për përpunimin e mallrave është i dyti që Banka e Shqipërisë ndërmerr në kuadër të konsistencës në seri kohore të vlerësimit të këtij treguesi. Vrojtimi për matjen e koeficienteve të kredisë tregtare dhe kontrabandës për tregtinë e mallrave do të shërbejë për aplikimin e koeficienteve të rinj si edhe rishikimin e vitit 2021, sipas kalendarit të rishikimit. Në qershor 2022, Banka e Shqipërisë, realizoi hartimin dhe hedhjen e metadave për vitin 2021 në sistemin e EUROSTAT Metadata Handler për të gjithë treguesit të mbuluar nga *acquis* përkatëse. Këto metadata u validuan me sukses nga EUROSTAT.



INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat e Energjisë Elektrike të grumbulluara prej burimeve administrative. Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, importin dhe eksportin bruto të energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudhën tremujore të siguruara nga burimet administrative. Gjatë vitit 2022, në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar publikime tremujore mbi statistikat e energjisë elektrike, ku publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e tretë 2022.

INSTAT mbledh dhe publikon Bilancin e Përgjithshëm të Energjisë, i cili paraqet situatën aktuale në sektorin e energjisë në Republikën e Shqipërisë. Ai është një përmbledhje e gjithë bilanceve të burimeve energjetikë të disponueshëm dhe është hartuar i plotë që nga viti 1998. Bilanci paraqet origjinën dhe përdorimin specifik sipas burimeve të energjisë dhe përbëhet nga dy pjesë kryesore: furnizimi dhe përdorimi i energjisë. INSTAT transmeton çdo vit në EUROSTAT mini-pyetësorë; pyetësorët vjetorë (Energjia Elektrike dhe Ngrohja, Gazi Natyror, Nafta, Qymyri, Energjia e Rinovueshme dhe Mbetjet, Konsumi i Energjisë në Familje dhe Vlerësimi i përmbledhur i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë); pyetësorët mujorë (Nafta, Gazi dhe Energjia Elektrike) dhe çmimet e energjisë (Energjia Elektrike dhe Gazi për Familjet/Industrinë);

INSTAT prodhon dhe publikon statistikat mbi Lëvizjen e Shtetasve të cilat paraqesin të dhëna të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj: sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë), pikave kufitare, qëllimit të udhëtimit të shtetasve të huaj, hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve. Statistikat mbi Lëvizjet e Shtetasve publikohen afërsisht 25 ditë pas përfundimit të muajit referues (T+25), sipas datës së paracaktuar në Kalendarin e Publikimeve të INSTAT. Të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve janë të dhëna administrative. Gjatë vitit 2022 në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar publikime mujore mbi lëvizjen e shtetasve; i fundit korrespondon me muajin tetor 2022.

Lidhur me Statistikat e Turizmit – ana e ofertës – INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikat mbi “Strukturat Akomoduese”. Në korrik 2017, me mbështetjen e projekteve IPA MB nisi vrojtimi mujor për mbledhjen e informacionit pranë ndërmarrjeve. Në korrik 2020, u publikuan për herë të parë të dhënat e Anketës së Turizmit mbi “Strukturat Akomoduese”, për periudhën kohore 2018-2019. Publikimi për vitet 2020 dhe 2021 është kryer me frekuencë tremujore.

Gjatë viti 2022 u përmirësua metodologjia e mbledhjes së të dhënave, kalimi nga metoda PAPI në atë CAPI. Përmirësime të mëtejshme u realizuan në dizejimin e kampionit të anketës dhe prodhimin me frekuencë mujore të statistikave të strukturave akomoduese me qëllim rritjen e nivelit të përputhshmërisë me rregulloren Nr. 692/2011. Rishikimi i pyetësorit për të identifikuar numrin e strukturave akomoduese që kanë një ose më shumë dhoma gjumi të aksesueshme për personat me lëvizshmëri të reduktuar, duke përfshirë përdoruesit e karrigeve me rrota do të realizohet. Për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit dhe, për rrjedhojë, edhe validimin e të dhënave, INSTAT do të zbatojë rekomandimet e EUROSTAT dhe do të punojë për transmetimin e të

dhënave në përputhje me afatet e kërkuara. Të dhënat dhe raporti i cilësisë do të transmetohen në EUROSTAT.

Statistikat mbi Shkencën përfshijnë vrojtimet dyvjeçare në të gjithë sektorët ku ky aktivitet potencialisht zhvillohet: Sektori i biznesit, i organizatave jofitimprurëse, qeveritar, institucionet e arsimit të lartë si dhe statistikave lidhur me fondet e alokuara në buxhetin e shtetit për këtë aktivitet. Metodologjia e ndjekur bazohet në Rregulloret e KE për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave për Shkencën dhe Teknologjinë, si dhe në Manualin e Frascat-it 2015. Për statistikave të kësaj kategorie, INSTAT, gjatë vitit 2023 do të mbledhë të dhënat e vrojtimet mbi aktivitetin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit 2020 – 2022 për katër sektorë: ndërmarrje private, institucione publike, institucione të arsimit të lartë dhe organizatat jo-fitimprurëse. Me qëllim prodhimin e statistikave cilësore për sektorët e institucioneve publike dhe institucioneve të arsimit të lartë do të organizohen grupe pune ndër-institucionale ku do përcaktohen metodologjia dhe treguesit e detajuar sipas institucioneve përkatëse.

INSTAT, gjatë vitit 2023 do të mbledhë dhe përpunojë të dhëna administrative mbi fondet e alokuara në buxhetin e shtetit për aktivitetin e Kërkimit Shkencor (statistikave GBARD) me periudhë referencë 2022.

Statistikat mbi Teknologjinë përfshijnë treguesit statistikore mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga ndërmarrjet. Treguesit statistikore të përdorimit të TIK në ndërmarrje përfshijnë vrojtimin vjetor në ndërmarrje me 10 dhe me shumë të punësuar. Grumbullimi i të dhënave realizohet me metodën CAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me tabletë. Metodologjia e ndjekur dhe pyetësi i përdorur është në përputhje me Rregulloret e KE. Statistikat e përdorimit të TIK në ndërmarrje prodhohen nga viti 2015 e në vazhdim dhe prej vitit 2021, prodhohen dhe publikohen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në rregullore. INSTAT realizoi mbledhjen e të dhënave për vitin referencë 2022 dhe publikimin e këtyre treguesve duke u bazuar në Rregulloren Zbatuese vitin referencë. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, këto tregues u transmetuan në EUROSTAT. Transmetimi i të dhënave në afatin e caktuar dhe transmetimi i raportit të cilësisë janë detyra në vazhdim.

Statistikat e Inovacionit përfshijnë vrojtimin dyvjeçar në ndërmarrje ku mblidhet informacion për tre vite referencë. Metodologjia e ndjekur është në përputhje me botimin e katërt të Manualit të Oslos dhe Rregulloret e KE, për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave për Shkencën dhe Teknologjinë. INSTAT prodhon tregues për aktivitetet e Inovacionit në ndërmarrje prej periudhës referuese 2017 – 2019 duke u bazuar në pyetësin e harmonizuar të BE-së. Për të qenë në përputhje me periudhën referuese të mbledhjes së të dhënave me vendet e BE-së, vrojtimi i fundit do të kryhet nga INSTAT në dhjetor të vitit 2022 për periudhën referuese 2020 – 2022. Disa tregues kryesorë do të transmetohen në EUROSTAT.

Gjatë vitit 2022, në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar publikime mujore për statistikave të Transportit dhe sigurisë në rrugë, i fundit korrespondon me muajin tetor 2022. Për realizimin dhe publikimin e këtyre statistikave, INSTAT përpunon të dhënat administrative të

marra nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2022, u rrit numri i treguesve të prodhuar mbi transportin dhe mbi sigurinë në rrugë bazuar në rregulloret evropiane si dhe transmetimi i treguesve të prodhuar për statistikat e transportit në EUROSTAT dhe institucionet e tjera ndërkombëtare. Të dhënat sipas NST 2007 për transportin hekurudhor do të prodhohen për seritë kohore 2020 – 2023 në baza vjetore. Në fokus të punës do të jetë rritja e bashkëpunimit, koordinimit dhe krijimit të një sistemi me burimet përkatëse administrative për statistikat e transportit ajror, detar dhe rrugor.

Mbi Statistikat e Mjedisit, deri në vitin 2019 statistikat mbi “Mbetjet e Ngurta Urbane në Shqipëri” mbështeteshin në të dhëna të mbledhura në terren nëpërmjet anketës vjetore mbi mbetjet urbane pranë subjekteve që ushtronin veprimtarinë e mbledhjes dhe menaxhimit të tyre. Në vitin 2022, INSTAT për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet e ngurta urbane referuar vitit 2021, ka vazhduar me aplikimin e metodës inovative nëpërmjet pyetësorëve elektronikë “online” pranë gjithë bashkive të vendit. Kjo metodë e re mundëson prodhimin e disa indikatorëve të disagreguar në nivel qarku si dhe prodhimin e indikatorëve të rinj në nivel bashkie. Gjatë kësaj periudhe, INSTAT ka vijuar me publikimet vjetore për llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore (E – MFA) dhe taksat e mjedisit dhe do të vazhdojë t’i prodhojë ato në baza vjetore. Në kuadër të projektit IPA shumë-përfituese 2017, ka kryer punën për vlerësimin e situatës në lidhje me prodhimin e llogarive të emetimeve në ajër dhe llogarive të tjera mjedisore (EGSS, PEFA, EPEA). Gjithashtu, INSTAT ka përfunduar punën për ngritjen e sistemit për prodhimin e llogarive të emetimeve në Ajër, si dhe ka prodhuar të dhënat për vitin 2016, të cilat janë dërguar në EUROSTAT për vlerësim. Në kuadër të projektit IPA shumë-përfituese 2019, i cili është i fokusuar tërësisht mbi statistikat e Mjedisit, INSTAT ka nisur punën nëpërmjet dy projekteve statistikore. Projekti i parë është i fokusuar në prodhimin e indikatorëve lidhur me llogaritë e emetimeve në ajër, llogarite rrjedhëse fizike të energjisë, si dhe ngritjen e sistemit për llogaritë monetare mjedisore. Në përfundim të zbatimit të projektit, INSTAT parashikon të rrisë numrin e indikatorëve të prodhuar në përputhje të plotë me metodologjinë Evropiane. Nga ana tjetër, nëpërmjet projektit të dytë statistikor, po në kuadër të IPA 2019, INSTAT po punon për përafrimin e mëtejshëm të statistikave të mjedisit, duke filluar transmetimin në EUROSTAT të indikatorëve që kanë lidhje me statistikat e mbetjeve. Ky proces pritet të përfundojë pas implementimit të të gjithë aktiviteteve të parashikuara në termat e referencës së projektit.

Për prodhimin e statistikave të blegtorisë, kryhen vrojtime mujore (siç janë therja e bagëtive, të leshtave, të dhirtave dhe derrave në thertore, therja e shpendëve në thertore, grumbullimi dhe përpunimi i qumështit, prodhimi i vezëve). INSTAT, gjithashtu zhvillon edhe vërtimin vjetor mbi përpunimin e qumështit. Të dhënat mujore janë të disponueshme dhe dërgohen në EUROSTAT për vlerësim, megjithatë ato ende nuk shpërndahen në shkallë vendi pasi informacioni nuk është ende i plotë për këto statistika, pasi mungojnë të dhënat e therjeve jashtë thertoreve si dhe prodhimi i qumështit të lopës në fermë, etj. Metoda e mbledhjes së të dhënave me tablet (CAPI) është testuar gjatë gjithë vitit 2022 dhe implementimi i plotë i kësaj metode parashikohet në momentin e parë që do të sigurohen instrumentet IT të përshtatshme.

Në lidhje me Statistikat e Peshkimit, në muajin korrik 2022, INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (si burimi kryesor i informacionit statistikor), ka realizuar publikimin e këtyre statistikave. Gjithashtu janë dërguar në EUROSTAT të dhëna të hollësishme në lidhje me statistikat e Peshkimit dhe Akuakulturën si dhe ka përfunduar përgatitja dhe dërgimi në EUROSTAT i “Metadatave lidhur me Statistikat Peshkimit dhe Akuakulturës”.

Lista e fermave e Censit të Bujqësisë 2012 është përdorur si një bazë zgjedhje për Anketën Vjetore të Bujqësisë (AAS). Për shkak të mungesës së burimeve të tjera të të dhënave administrative, baza e zgjedhjes aktualisht përditësohet vetëm nga informacioni i ardhur nga vrojtimit vjetore në bujqësi. Baza e zgjedhjes përditësohet gjithashtu me listën e fermave të reja të hartuara çdo vit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

Në Shqipëri Vrojtimi Vjetor i Bujqësisë (AAS) përfshin përdorimin e tokës, sipërfaqet e mbjella dhe prodhimi i produkteve bimore, numrin e bagëtive dhe prodhimin e kafshëve, bilancet, kontributin e punës në bujqësi si dhe shpenzimet. Sa i përket të dhënave të këtij vrojtimi, në kuadër të programit IPA shumë-përfituese 2015 u realizua seria kohore 2013 – 2017 lidhur me statistikat e tokës dhe prodhimit bimor. Në vazhdimësi të punës së kryer, me mbështetjen e IPA shumë-përfituese 2017, është realizuar seria kohore 2013 – 2018, sa i përket statistikave të numrit të krerëve dhe prodhimeve blegtorale. Ndërkohë në kuadër të Projekti IPA shumë-përfitues 2017 është punuar për plotësimin e serive kohore 2018 – 2020 për statistikat e prodhimeve bimore dhe blegtorisë. INSTAT gjatë vitit 2022 ka punuar me qëllim përmirësimin e këtyre statistikave duke përditësuar serinë edhe me vitin 2021.

Në lidhje me statistikat e çmimeve të produkteve bujqësore, kryhet një vrojtim mujor mbi çmimet e prodhimit. Indekset e çmimeve të prodhimit publikohen çdo vit në nivel kombëtar. Të dhënat mbi çmimet e inputeve bujqësore mblidhen nga vrojtimit tremujore (INPUT1 dhe INPUT2). INSTAT zhvillon një anketë të dedikuar për çmimet e kafshëve për mbarështim. Të dhënat për çmimet dhe qiratë e tokës bujqësore mblidhen me anë të Vrojtimit Vjetor në Bujqësi.

Në vitin 2023 sipas rekomandimeve të EUROSTAT do të fillojë prodhimi i indeksit të çmimeve të prodhimeve bujqësore me bazë vitin 2020 (2020=100). Gjithashtu nëpërmjet asistencës teknike do të mundësohet prodhimi për herë të parë të indeksit të inputeve të prodhimeve bujqësore. Në vijim, INSTAT do të fillojë dërgimin në EUROSTAT të të dhënave mbi çmimet e prodhimeve bujqësore.

Sektori i llogarive ekonomike në bujqësi harton dhe transmeton Llogaritë Ekonomike në Bujqësi (EAA) vetëm për përdorim të brendshëm. Të dhënat e EAA janë përdorur kryesisht për përpilimin e Llogarive Kombëtare vjetore dhe tremujore, si dhe për përpilimin e llogarive rajonale për bujqësinë. Aktualisht, INSTAT nuk prodhon dhe nuk publikon të gjithë grupin e llogarive dhe treguesve të EAA për publikim. Bazuar në rezultatet e IPA shumë-përfituese 2017, Censit të ardhshëm të bujqësisë dhe misionëve ad-hoc, ngritja e sistemit të llogarive ekonomike në bujqësi planifikohet të përfundojë gjatë vitit 2025.

Në kuadër të projektit IPA me shumë përfitues 2017, INSTAT u mbështet me një mision Ad-Hoc i cili analizoi rezultatet e modulit të bujqësisë nga pilotimi i Censit të Popullsisë dhe Banesave 2021. Bazuar në gjetjet e këtyre analizave u identifikuan disa problematika që lidhen me aplikacioni për mbledhjen e të dhënave. Përmirësimet përkatëse u kryen dhe ky modul, i cili do të shërbejë për krijimin e bazës së zgjedhje për Censin e Bujqësisë.

Më datë 27 maj 2022 u zhvillua seminari me temë: “Prezantimi i draft strategjisë së Censit të Bujqësisë” organizuar nga INSTAT në bashkëpunim me FAO me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Censi i Bujqësisë ishte planifikuar të kryhej në vitin 2022, por aktualisht është vendosur që viti i Censit të shtyhet me dy vjet deri në vitin 2024 krahasuar me planin fillestar, për arsye operationale. Censi i vitit 2024 do të përcaktojë informacionin bazë statistikor për sektorin e bujqësisë për të gjithë territorin e Shqipërisë. Censi i Bujqësisë do të ndjekë rekomandimet e Programit Botëror të FAO-s për Censet e Bujqësisë 2020 (WCA 2020) dhe do të jetë gjithashtu në përputhje me Rregulloret e Bashkimit Evropian (Rregullorja (BE) 2018/1091 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 korrik 2018 mbi statistikën e integruara të fermave).

INSTAT është i përkushtuar dhe do të ndjekë në mënyrë rigoroze aktivitetet aktuale të planifikuara për kryerjen e Censit të Bujqësisë siç është planifikuar në vitin 2024. Shtyrja e procesit të mbledhjes së të dhënave e Censit të Popullsisë dhe Banesave nuk do të ndikojë në zhvillimin e tij, duke marrë gjithashtu parasysh progresin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në finalizimin e Regjistrimit Administrativ të Fermave. Regjistri i fermave i krijuar nga MBZHR do të jetë burim për bazën e zgjedhjes së Censit të Bujqësisë 2024. Censi i Bujqësisë do të kryhet pa letër. Të gjitha mjetet dhe instrumentet për mbledhjen e të dhënave, përfshirë pyetësorët dhe manualët, do të jenë në format digjital dhe të gjitha intervistat do të bëhen duke përdorur teknikën CAPI.

Arritjet kryesore gjatë vitit 2021 – 2022 janë:

- Përmirësimi metodologjik në aplikimin e vrojtimit vjetor, duke implementuar metodologjinë e mbledhjes së të dhënave online për mbetjet urbane krahas asaj tradicionale në fushën e përdorimit të ujit dhe të lëndës së drurit në industri;
- Dërgimi për herë të parë në EUROSTAT i Metadatës të Statistikave të Peshkimit;
- Seminari me temë: “Prezantimi i draft strategjisë së Censit të Bujqësisë” mes INSTAT dhe MBZHR;
- Prodhimi i indikatorëve në nivel bashkie për statistikën mbi mbetjet e ngurta urbane.

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore, shërben për përditësimin e vazhdueshëm të zonave të Censit. Gjatë vitit 2022, INSTAT ka kryer kontrollin e cilësisë dhe përditësimin e gjeo-databazës së ndërtesave dhe hyrjeve të tyre, të të dhënave të ardhura nga përditësimi në terren i informacionit gjeo-hapësinor të vitit 2019, si dhe ka përfunduar ndarjen e zonave të cens në mbështetje të Censit të Popullsisë dhe Banesave. Aktivitetet e informacionit

gjeo-hapësinor të cens në fazën e para-numërimit, gjatë dhe pas Censit në vitin 2023 do të vazhdojnë me: kontrollet e cilësisë së të dhënave në rast ndryshimesh në terren si: përditësimi e gjeo-databazës së censit, përditësimi i kufijve të Zonave të Censit, përditësimin e numrit të Zonave të Censit në rast ndryshimesh, gjeo-kodifikimin e njësive gjeografike. Gjatë vitit 2023 do të kryhet edhe përgatitja e hartave digjitale të Zonave të Censit për të gjithë zinxhirin e stafit të terrenit - anketues, kontrollorë dhe mbikëqyrës, sipas kërkesave të Njësive të Teknologjisë së Informacionit për t'u aksesuar/integruar në aplikacionin e pyetësorëve të Censit.

INSTAT ka nisur ndërtimin e Regjistrat Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (ASRBD), i cili do të shërbejë si një element kyç drejt një sistemi të rregullt dhe të integruar për statistikën e popullsisë, njësive ekonomike familjare dhe banesave, i cili kombinon të dhënat nga regjistrat digjitalë të përditësuar rregullisht, të dhënat administrative dhe anketat statistikore. Të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave do të jenë bazë për ndërtimin e këtij regjistri, të plotësuar me informacion nga sistemi i adresave të Zyrës së Gjendjes Civile. ASRBD do të mirëmbahet nga INSTAT me përditësime të shpeshta në terren nga INSTAT si dhe bazuar në të dhënat e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit e cila është institucioni përgjegjës për lejimin e ndërtesave të reja. Gjatë vitit 2023 synohet të kryhet një testim i regjistrat statistikor të ndërtesave dhe banesave (ASRBD) me të dhënat e pilot Cens 2021. Fokusi do të jetë ndërtimi i një gjeo-databaze ku, pasi të kryhet kontrolli i cilësisë së të dhënave nga sektorët përgjegjës, do të analizohen dhe integrohen në gjeo-databazë të dhënat e disponueshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (Adresari) apo autoritete të tjera publike shqiptare sipas variablave të përcaktuar në ASRBD.

#### 18.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

INSTAT është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar të Statistikave (SKS), i përbërë edhe nga dy agjenci statistikore si Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë. Institucionet e tjera publike si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, etj., dhe institucionet e tyre të varësisë, kontribuojnë në prodhimin e statistikave zyrtare si ofrues të informacionit statistikor dhe të dhënave administrative.

Banka e Shqipërisë, si agjenci statistikore është institucioni përgjegjës për prodhimin e statistikave monetare dhe financiare, dhe llogarive financiare, gjithashtu përgjegjës për prodhimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si agjenci statistikore, është përgjegjëse për prodhimin e statistikave financiare të qeverisë. Gjithashtu së bashku me Bankën e Shqipërisë, ajo mbështet dhe furnizon me të dhëna INSTAT-in për hartimin e tabelave input-output në kuadër të EDP.

## 18.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Qëllimi kryesor i INSTAT-it është të përafrojë më tej legjislacionin e tij me *acquis* të BE-së në lidhje me standardet statistikore evropiane dhe të rrisë rolin e saj si koordinator i Sistemit Kombëtar të Statistikor.

Bazuar në rekomandimet e fundit të BE-së, për vitin 2022, prioritetet e identifikuara janë si më poshtë:

- Shqipëria duhet të zbatojë Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023, të përgatisë planin dhe sigurojë burimet për Censin e fermave bujqësore në përputhje me rregulloret përkatëse të BE-së dhe standardet ndërkombëtare;
- Duhet të përmirësojë rolin e Sistemit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) si koordinator i Statistikave Kombëtare dhe zgjerimin e numrit të agjencive statistikore;
- INSTAT duhet të rrisë prodhimin dhe transmetimin e të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë në EUROSTAT.

Prioritete të tjera bazuar në programin e Statistikave Zyrtare 2022 – 2026, në Strategjinë e Zhvillimit të INSTAT, si dhe në rezolutën e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikës për vitin, janë si në vijim:

- Rishikimi i shportës së produkteve bujqësore të përfshira në llogaritë ekonomike në bujqësi dhe ri-bazimi i Indeksit të Çmimeve në Bujqësi (2020 = 100).
- Fokusimin në nevojat e të dhënave për përpilimin e moduleve të Llogarive Ekonomike në Mjedis. INSTAT do të përqendrohet në zhvillimin e mëtejshëm të moduleve: Llogaritë e emetimeve në ajër, Llogaritë e flukseve fizike të energjisë, dhe Taksat mjedisore;
- Kryerja e suksesshme e Censit të Bujqësisë;
- Mbështetje e aktiviteteve statistikore me informacion gjeo-hapësinor (cense, vrojtme, anketa, etj.).
- Implementimi i vazhdueshëm i Sistemit Evropian i Llogarive ESA 2010;
- Rritja e llojshmërisë së tabelave të transmetuara në EUROSTAT, në kuadër të Programit të Transmetimit ESA 2010;
- Transmetimi i të dhënave mbi Vdekjet Javore, kërkesë vullnetare nga Eurostat në kuadër të pandemisë globale;
- Fokusimin në nevojat e të dhënave për përpilimin e moduleve të mbetura, INSTAT do të përqendrohet në zhvillimin e mëtejshëm të moduleve: Llogaritë rrjedhëse fizike të energjisë (physical energy flow accounts), produktet dhe shërbimet në sektorin e mjedisit (environmental goods and services sector), llogaritë e shpenzimeve për mbrojtjen e mjedisit (environmental protection expenditure accounts);
- Hartimi i statistikave të bilancit të pagesave me frekuencë mujore;
- Hartimi i llogarive financiare me baza tremujore (stock dhe fluks).

Gjithashtu, INSTAT ka parashikuar përafrimin e disa akteve të BE-së në PKIE 2023 – 2025 të parashikuara nga Kapitullin 18 Statistikat, për harmonizim të mëtejshëm me standardet e BE-së. Aktet e parashikuara në zbatim dhe të rekomandimeve të EU janë si më poshtë:

- Projektligji “Për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore”;
- Projekt-Udhëzim “Në mbështetje të implementimit të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare”;
- Projekt-Udhëzim “Për Vrojtimet Statistikore të Qumështit dhe të Nën-Produkteve të tij”;
- Projekt-Udhëzim “Për zbatimin e rregullores për Vrojtimet Statistikore të Qumështit dhe të Nën-Produkteve të tij”;
- Projektvendim “Për zbatimin e Nomenklaturës së produkteve sipas aktiviteteve”;
- Projekt-Udhëzim “Për Zbatimin e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës”.

Këto akte do të kërkojnë përkthim të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, trajnime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit, organizim të trajnimeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores si dhe tavolina konsultuese me grupet e interesit.

## KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

### 32.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli ka të bëjë me miratimin e kuadrit dhe standardeve të pranuar botërisht të tilla si COSO: Internal Control Integrated Framework; INTOSAI: Udhëzues për qeverisje të mirë; Auditi i Brendshëm (International Professional Practices Framework (IPPF); dhe INTOSAI: Parimet Themeluese; Parakushtet për Funksonimin e Institucioneve Supreme të Auditimit; Parimet Themelore të Auditimit; dhe Udhëzimet e Auditimit, si dhe me përafrimin e *acquis* në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së dhe në atë të mbrojtjes së euros nga falsifikimi.

Objektivat kryesore të kapitullit janë: stabiliteti financiar i Shteteve Anëtare, parandalimi i keqpërdorimit të mjeteve financiare, kontributi në një shpenzim më eficient dhe të përgjegjshëm, i cili ofron një mekanizëm të rëndësishëm për të luftuar korrupsionin.

Objektivat kryesore të kapitullit janë zhvillimi i një sistemi efikas të KFBP (Kontrolli i Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si edhe me praktikën më të mira të BE-së, mbrojtja e interesave financiare të BE-së, si dhe parandalimi dhe lufta ndaj falsifikimit të monedhës euro.

### 32.2 Struktura e kapitullit

1. Kontrolli i brendshëm financiar publik
2. Auditimi i jashtëm
3. Mbrojtja e interesave financiare të BE-së
4. Mbrojtja e euros nga falsifikimi



### 32.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi i përafrimit të legjislacionit shqiptar në fushën e kontrollit financiar me *acquis* të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 70, 85 dhe 90 të MSA-së.

Në fushën e mbrojtjes së monedhës euro, *acquis* e BE-së ka qëllim të sigurojë koordinimin e duhur të masave të ndërmarra kundër falsifikimit nga autoritetet kombëtare dhe dënimeve adekuate të falsifikatoreve sipas ligjit penal kombëtar.

Legjislacioni i BE-së përmban dispozita themelore në lidhje me mbledhjen dhe analizën e të dhënave teknike dhe statistikore lidhur me kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara, si dhe me bashkëpunimin mes autoriteteve kombëtare në vendet anëtare të BE-së, Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane, vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare.

Përcaktimet kryesore:

- Analiza dhe identifikimi - autoritetet në vendet e BE-së, duhet të dërgojnë për identifikim dhe analizë teknike kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara në qendrat e tyre kombëtare të Analizës (rregullore 1338/2001 & 1339/2001);
- Tërheqja nga qarkullimi - bankat dhe institucionet e kreditit duhet ti tërheqin nga qarkullimi të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat metalike euro të dyshuara të falsifikuara, dhe ti dorëzojnë ato tek autoritetet kombëtare kompetente (rregullore 1338/2001 & 1339/2001);
- Kontrolli i vërtetësisë - bankat dhe institucionet e kredit duhet të kontrollojnë vërtetësinë e të gjitha kartëmonedhave dhe monedhave metalike euro që do hidhen në qarkullim (Vendim BQE/2010/14 dhe Rregullore e (KE) Nr. 1210/2010).

#### *Dënimet e Kodit Penal*

Më 22 maj 2014, ka hyrë në fuqi, Direktiva e re 2014/62 /BE. Kjo Direktivë ka për qëllim të forcojë mbrojtjen e euros nga falsifikimi me masa ligjore në kodin penal. Direktiva zëvendëson Vendimin Kuadër 2000/383/JHA si dhe plotëson e ndihmon në zbatimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1929 për ndalimin e falsifikimit. Masat e reja përfshijnë ashpërsimin e sanksioneve për shkelësit e ligjit dhe përmirësimin e mjeteve të hetimit ndërkufitar.

### 32.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e kontrollit financiar. Njëfarë përparimi është bërë gjatë periudhës raportuese, veçanërisht me zbatimin e dokumentit të politikave për forcimin e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP), udhëzimet për auditimin e detyrimeve të papambetura, miratimin e manualit të rishikuar të auditimit të performancës dhe përafrimin e mëtejshëm me *acquis* e BE-së në lidhje me mbrojtjen nga falsifikimi të kartëmonedhave dhe

monedhave metalike euro. Kontrolli i brendshëm nuk është siguruar ende në të gjitha njësitë buxhetore dhe ai duhet të forcohet përmes një angazhimi më të fortë ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kuvendit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

## **K kontrolli i brendshëm Financiar Publik**

**Kuadri strategjik** për Kontrollin e brendshëm Financiar Publik (KBFP-në) është në fuqi. Masat e KBFP-së janë të përfshira në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019 – 2022, në Strategjinë e Reformës në Administratën Publike, si dhe të detajuara më tej në Dokumentin e Politikave për Zhvillimin e Kontrollit të brendshëm Financiar Publik 2021 – 2022. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti, zbatimi i të cilit është i monitoruar nga strukturat përgjegjëse përkatëse gjatë vitit 2022.

Në lidhje me **përgjegjshmërinë menaxheriale**, raportimi fokusohet kryesisht në performancën financiare, por me një numër në rritje të institucioneve që raportojnë edhe për performancën kundrejt objektivave.

Legjislacioni për **kontrollin e brendshëm** është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe mundëson një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Rishikimi i metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm të njërive publike, si dhe rishikimi dhe përmirësimi i instrumentit të planit të veprimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, pjesë e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u miratuan në dhjetor 2021. Në vitin 2021, më shumë institucione përcaktuan deklaratat e misionit, objektivat dhe rezultatet. Njësia Qendrore e Harmonizimit ka mbështetur pesë institucione në finalizimin e manualeve të proceseve të punës, zbatimin e udhëzimeve të delegimit dhe linjave raportuese dhe krijimin e regjistrave të riskut. Funkcioni i inspektimit buxhetor, i cili është i centralizuar në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kryen aktivitete ex-post sipas kërkesës.

Legjislacioni mbi **praktikën e auditimit të brendshëm** është vlerësuar të jetë gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, megjithatë zbatimi i kërkesave të standardeve profesionale të fushës nuk ka gjetur pajtueshmëri të plotë në praktikën audituese. Në këtë kuadër, nisma për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ka si qëllim të krijojë ambient të përshtatshëm, i cili siguron një funksionim adekuat të auditimit të brendshëm. Dispozitat e Ligjit të AB kanë për qëllim të sigurojnë që auditimet të forcojnë kontrollet e brendshme, si dhe të përmirësojnë proceset e menaxhimit të riskut të qeverisjes, duke ndikuar ndjeshëm në efikasitetin e punës së subjekteve publike dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për përdoruesit, përfituesit dhe tatimpaguesit shqiptarë.

Shërbimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik është krijuar dhe funksionon duke kërkuar të kontribuojë për një efikasitet më të madh operacional, disiplinë buxhetore dhe fiskale dhe pajtueshmëri ligjore dhe rregullatore nga njësitë e sektorit publik. Përmirësimet e kuadrit ligjor

synojnë që çdo njësi e sektorit publik të jetë objekt i auditimeve të brendshme të rregullta, sistematike dhe gjithëpërfshirëse.

Zhvillimi profesional i kapaciteteve dhe aftësive të audituesve të brendshëm është institucionalizuar nëpërmjet vendosjes dhe funksionimit efektiv të Sistemit të Zhvillimit Profesional i cili përfshin Certifikimin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm si dhe Trajnimin e Vijueshëm Profesional (TVP/CPD). Programet e trajnimeve synojnë që të sigurojnë që njësitë e AB-së të kenë kapacitetet e nevojshme dhe aftësitë që u mundësojnë atyre të zbatojnë standardet e auditimit të brendshëm të Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm (IIA), me qëllimin përfundimtar për t'u siguruar përdoruesve të raporteve të AB-së siguri mbi cilësinë dhe saktësinë e punës së raportuar.

Të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë trajnohen duke ndjekur Programin Vjetor të trajnimit të vazhdueshëm (jo më pak se 80 orë trajnimi të shtrirë në dy vjet) dhe numri i audituesve të brendshëm të certifikuar rritet nga viti në vit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE ( DH AB) monitoron dhe mbikëqyr të gjithë veprimtarinë dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në organet e vetëqeverisjes vendore po ashtu dhe institucionet, agjencitë e nivelit të dytë dhe shoqëritë publike, nëpërmjet vlerësimeve të jashtme të cilësisë të kryera periodikisht në të gjitha strukturat e auditimit të brendshëm.

Vlerësimet e jashtme të cilësisë kanë si qëllim të vlerësojnë nivelin e pajtueshmërisë së punës audituese me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm si dhe praktikat profesionale të fushës. Në çdo njësi të auditimit të brendshëm janë vendosur procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit dhe niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve të auditimit është një nga treguesit kryesorë të performancës së auditimit.

**Njësia qendrore e harmonizimit (NjQH)** ofron udhëzime metodologjike dhe rritje kapacitetesh, monitoron performancën e kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik në bazë të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporteve të vetëvlerësimit të kryera nga institucionet. Numri i vlerësimeve të jashtme të cilësisë për auditimin e brendshëm është rritur me 27% në vit duke rritur dhe mundësitë që të përmbushet kërkesa e IPPF që çdo njësi audituese të vlerësohet të paktën një herë në 5 vjet. Deri në fund të vitit 2022, Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm ka nxjerrë një opinion për përputhshmërinë e aktivitetit të auditimit të brendshëm për 99 njësi të vlerësuara kundrejt 135 në total, ku vetëm 36% janë gjetur pjesërisht ose plotësisht në përputhje. Krahas auditimit të brendshëm, NjQH për Menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin filloi vlerësimet e cilësisë për sistemet e kontrollit të brendshëm në 20 njësi të sektorit publik.

Zhvillimet aktuale, përparimi dhe fokusi për të ardhmen i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik paraqiten në Raportin vjetor të KBFP-së, i cili i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe më pas diskutohet në Kuvend si pjesë e miratimit të buxhetit faktik të vitit 2022.

Arritjet kryesore paraqiten si më poshtë:

- Ligji “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” është miratuar në Këshillin e Ministrave dhe pritet të miratohet në Kuvend;
- Realizimi i aktiviteteve për ndërtimin dhe zbatimin e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kuadër të ofrimit të asistencës teknike në 5 njësi të qeverisë së përgjithshme (Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme, Agjencia e Prokurimit Publik, Bashkia Belsh dhe Bashkia Lezhë);
- Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme;
- Është bërë vlerësimi i gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2021 (Raporti Vjetor i KBFP);
- Zhvillimi i konferencës kombëtare “Sistemi i kontrollit të brendshëm si një nga shtyllat kryesore në mirëmenaxhimin e financave publike”;
- Organizimi në bashkëpunim me SIGMA i një takimi me menaxherë të nivelit të lartë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Kryeministrisë dhe ministrive të linjës mbi trajtimin e çështjeve që lidhen me konceptin dhe vizionin e përgjegjshmërisë menaxheriale, evidentimin e statusit aktual të zhvillimit si dhe opsionet e mundshme apo masa të tjera për të rritur ndërgjegjësimin mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe përgjegjshmërisë menaxheriale, duke përfshirë delegimin e autoritetit si një nga elementët kryesorë të tij;
- Janë organizuar takime ndërgjegjësuese me menaxherë të 5 njësive të përzgjedhura pilot të qeverisjes së përgjithshme, mbi zbatimin me rigorozitet të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike janë zhvilluar 10 seanca trajnimi 1-ditore (Webinar) mbi rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike lidhur me zbatimin e procesit të menaxhimit të riskut (520 pjesëmarrës)). Gjithashtu, janë realizuar 2 kurse trajnimi 5-ditore mbi procesin e menaxhimit të riskut ku janë certifikuar 38 punonjës të administratës publike;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i mbështetur nga asistenca teknike e SIGMA OECD është miratuar në Kuvendin e Shqipërisë më 02.02.2023;
- Janë përgatitur dhe pilotuar dokumente udhëzues për fusha specifike të auditimit , ku përfshihet:
  - Udhëzues për “Auditimin e Detyrimeve të Prapambetura”;
  - Udhëzues për “Vlerësimin e riskut në auditim”;
  - Këshilla praktike për krijimin dhe mbajtjen e “Programit të sigurimit të brendshëm të cilësisë së auditimi”;
  - Udhëzues praktik për “Vlerësimin e riskut të mashtrimit/shkeljeve/parregullsive në nivel institucional”.
- Përmirësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm;

- Është rritur numri i rekomandimeve të auditimit të zbatuara dhe në proces zbatimi si dhe janë dhënë opinionet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë për 99 njësi auditimi, nga 135 të krijuara;
- Të gjithë audituesit e brendshëm të punësuar në sektorin publik (433 auditues të brendshëm) ndjekin çdo vit jo më pak se 40 ore trajnimi, të cilat mbulojnë çështje të rëndësishme të qasjes audituese, përditësimet dhe thellimin e njohurive për auditimin e brendshëm po ashtu dhe përditësime mbi aspekte të ndryshme të menaxhimit të financave publike të tilla si: Risku i parregullsive/mashtimit dhe korrupsionit, Auditimi i fondeve të Programit IPA, Planifikimi mbi bazë risku i auditimit, Raportimi dhe ndjekja e rekomandimeve;
- Deri në fund të vitit 2021, rreth 80% e audituesve të brendshëm të punësuar janë të certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik (342 auditues të brendshëm të certifikuar nga 433 në total) dhe pjesa tjetër, 82 kandidatë kanë filluar procesin e certifikimit në sezonin tetor 2022 – qershor 2023 me synimin përfundimtar që të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë të jenë të certifikuar.

## Auditimi i jashtëm

Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), **kuadri kushtetues dhe ligjor** i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH). Në përputhje me planin strategjik të zhvillimit 2018 – 2022, Kontrollit të Lartë të Shtetit kryen aktivitete për përmirësimin e kapaciteteve institucionale. Programi vjetor i zhvillimit profesional për stafin e auditimit po zbatohet, duke u fokusuar, ndër të tjera, në prokurimet publike, koncesionet/PPP-të, si dhe manualin e ri të auditimit të performancës, i rishikuar në nëntor 2021 dhe miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 196, datë 26.11.2021. Objektivat e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë zhvendosur nga auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë drejt auditimeve të performancës. KLSH po ndjek një qasje të auditimit të jashtëm të bazuar në risk. KLSH jep opinion mbi raportet financiare të Qeverisë duke përfshirë të ardhurat, shpenzimet, asetet, si dhe detyrimet e të gjithë njësive qendrore të qeverisë. Auditimet kryhen duke zbatuar ISSAI't.

Në funksion të përafrimit të metodologjisë audituese me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit – ISSAI, KLSH rishikoi bazën metodologjike të auditimit dhe gjatë vitit 2022 janë hartuar, rishikuar dhe përshtatur një sërë dokumentesh që i shërbejnë bazës metodologjike, mbi të cilën mbështetet auditimi publik, konkretisht:

- U rishikuan Manuali i Auditimit Financiar dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, në çështje të caktuara, për të reflektuar në kohë ndryshimet që diktojnë ISSAI-të, si dhe sugjerimet e dala përgjatë auditimeve në terren. Këta dy manuale u miratuan me Vendimet e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022 dhe nr. 245, datë 29.12.2022.
- U përkthye dhe përshtat Dokumenti ISSAI/IFPP 5100 “Udhëzues mbi auditimet e sistemeve të informacionit”. Objektivi i këtij Udhëzuesi është të ofrojë udhëzime për audituesit se si të kryejnë auditime të performancës dhe/ose të përputhshmërisë në lidhje me natyrën specifike të Sistemeve të Informacionit ose ku auditimi i sistemeve të

informacionit mund të jetë pjesë e një angazhimi më të madh auditues që mund të jetë financiar, përputhshmërie ose performance. Në vijimësi të trajnimeve në fushën e IT-së u realizua dhe një trajnim online me stafin auditues edhe mbi ISSAI/IFPP-5100.

- U përkthye dhe përshtat Udhëzuesi ISAM “Modeli i Auditimit të OZHQ-ve të IDI-t, version pilot, Mars 2020”, i publikuar nga INTOSAI/IDI, në përmbushje të Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional për vitin 2022. ISAM është një udhëzues praktik që synon të mbështesë SAI-t në kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë të zbatimit të OZHQ-ve bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI). Ai bazohet në pesë parime: fokus në rezultat, njohja e diversitetit të SAI-ve, themelet e SAI-ve, gjithëpërfshirja dhe vlera e shtuar. ISAM e përkufizon auditimin e zbatimit të OZHQ-ve si një auditim të performancës që fokusohet në arritjen e objektivave të rënë dakord në nivel kombëtar të lidhura me objektivat e OZHQ-ve.
- U finalizua me sukses puna për hartimin e Udhëzuesit të Fushave me Risk për auditimet e Performancës, i cili u miratua me Vendimin nr. 8, datë 13.01.2023, të Kryetarit të KLSH-së.
- U finalizua dhe publikua Raporti i Vetëvlerësimit të Performancës me Vendimin nr. 225, datë 2.12.2022, i cili këtë vit, ndoqi modelin e miratuar nga Grupi i Punës së INTOSAI-t “Mbi vlerat dhe përfitimet e SAI-ve” (WGVBS), si një metodologji për t'u ndjekur në vijim nga KLSH si praktikë e mirë.
- Janë në proces dhe pritet finalizimi gjatë vitit 2023 i:
  - (i) Rregullores së Procedurave të Auditimit, ndryshim i cili synon përdorimin e këtij dokumenti në mënyrë të përshtatshme sipas rrethanave praktike, dhe
  - (ii) Udhëzuesit të Auditimit të Buxhetit, i cili ka për qëllim standardizimin e hartimit të Raportit të Zbatimit të Buxhetit, si dhe përcaktimin e metodave dhe teknikave audituese që duhet të aplikohen.

Në lidhje me **cilësinë e punës së auditimit**, KLSH në zbatim të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit (ISSAI) 40 “Kontrolli i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit”, si pjesë përbërëse e kuadrit rregullator të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë së auditimit, ka hartuar edhe Udhëzuesin për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit. Në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe Udhëzuesit, struktura e ngritur për këtë qëllim, Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, kryen kontrole të cilësisë “në të nxehtë” dhe procedura të kontrollit “në të ftohtë” në bazë vjetore të dosjeve të auditimit. Objektivi parësor i kontrollit të cilësisë së auditimit është të arrijë që auditimet të kryhen duke respektuar Standardet e auditimit, Rregulloren e Procedurave dhe manualet përkatëse për të gjitha fazat e auditimit: planifikim, auditim në terren dhe raportim. Me Urdhrin Nr. 7 datë 11.01.2022 të Kryetarit të KLSH-së “Për kontrollin e sigurimit të cilësisë në procesin auditues për vitin 2021” është ngritur edhe grupi i punës i cili kryen kontrollin e cilësisë së dosjeve të auditimit dhe përgatit raportin përkatës për vitin paraardhës.

Në përputhje me planin strategjik të zhvillimit 2018 – 2022, KLSH ka ndjekur planin e aktiviteteve të parashikuara në funksion të objektivit për zhvillimin e vazhdueshëm të **kapaciteteve profesionale**. Për këtë qëllim janë hartuar dhe miratuar Programet Vjetore të Trajnimit duke

synuar që ndërtimi i kapaciteteve të mbështetet në metodologji të reja e të përditësuara dhe në aplikimin e qasjeve moderne të auditimit.

Me Vendimin e Kryetarit nr. 14 datë 8.02.2021 u miratua indikator i 25 ditë trajnimi në vit për çdo auditues.

Për vitin 2022, çdo auditues ka një mesatare 26.5 ditë trajnimi, nga 25 ditë trajnimi/auditues të planifikuara.

**Ndikimi i punës së auditimit** ka treguar njëfarë përparimi. Kontrolli i Lartë i Shtetit vijon të përpilojë raporte vjetore për performancën e tij, t'i publikojë ato në faqen e tij të internetit dhe t'i raportojë Kuvendit. Në vitin 2021, Kontrolli i Lartë i Shtetit raportoi se 80% e rekomandimeve të pranuar janë në proces zbatimi dhe disa prej tyre janë zbatuar plotësisht.

Në vitin 2021, nga auditimet mbi zbatimin e rekomandimeve rezultoi se janë pranuar 93% e rekomandimeve të lëna nga KLSH nga të cilat janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht 55% e tyre, krahasuar me vitin 2020 ku këta tregues ishin në nivelin 94% rekomandime të pranuar nga të cilat 47% të zbatuara.

Edhe gjatë vitit 2021, ka vijuar përditësimi i platformës elektronike të Kuvendit të Shqipërisë, për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë dhe statusin e implementimit të tyre.

Memorandumi i Mirëkuptimit i vitit 2017 ndërmjet KLSH-së dhe Ministrisë së Financave për monitorimin e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit rezultoi në krijimin e një sekretariati teknik me përfaqësues të të dyja palëve, i cili ka funksionuar pjesërisht gjatë vitit 2021 për shkak të ndryshimeve në përbërjen e këtij sekretariati. Sa i takon aktivitetet e parashikuara në agjendën e vitit 2022 pritet angazhim nga ana e MFE.

KLSH përmes komunikimit të vazhdueshëm me mediat dhe qytetarët, është angazhuar për rritjen e transparencës, një tregues që ka ardhur në rritje nga viti në vit. Gjatë vitit 2022, vetëm në shtypin e shkruar janë publikuar mbi 300 artikuj për veprimtarinë audituese të KLSH-së, si dhe mbi 1500 artikuj dhe kronika në median audio-vizive dhe online, që i referohen kryesisht raporteve përfundimtare të auditimit të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, si dhe njoftimeve për shtyp.

Gjatë vitit 2022, KLSH ka vijuar me përmbushjen e **detyrimit për raportim në Kuvendin e Shqipërisë** sipas afateve të parashikuara. Raporti i Performancës së Institucionit për vitin 2021 i është paraqitur Komisionit për Ekonominë dhe Financat në mars 2022, ndërsa në tetor 2022 i është paraqitur këtij Komisioni, Raporti për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2021. KLSH ka dërguar gjithashtu në prill të vitit 2021 pranë Kuvendit, por edhe pranë Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, raportin “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e evaduara për periudhën janar – qershor 2020” dhe në dhjetor 2021 raportin “Për ndjekjen e

zbatimit të rekomandimeve për auditimet e evaduara për periudhën korrik – dhjetor 2020”. Në muajin shkurt 2022 është përcjellë “Raporti përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën janar – dhjetor 2020”, si dhe në qershor 2022 raporti “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e evaduara për periudhën janar – qershor 2021”. Më datë 10 shkurt 2023 është përcjellë Raporti përmbledhës “Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të përfunduara për periudhën janar – dhjetor 2021”.

Gjatë vitit 2021, KLSH ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë, 57 raporte përfundimtare auditimi të cilat i përkasin veprimtarisë audituese të vitit 2021, ndërsa gjatë vitit 2022, janë dërguar 155 raporte përfundimtare auditimi.

Raportet përfundimtare të auditimit publikohen rregullisht në faqen e internetit të KLSH-së. Konkretisht gjatë vitit 2021 u publikuan 100 raporte auditimi dhe gjatë vitit 2022 janë publikuar 166 raporte përfundimtare auditimi. Njëkohësisht publikohen periodikisht edhe Buletinet Statistike.

### **Mbrojtja e interesave financiare të BE-së**

Shqipëria ka siguruar **njëfarë niveli përafrimi me *acquis*** në këtë fushë. **Shërbimi kombëtar i koordinimit kundër mashtrimit** ka krijuar një rrjet që përfshin autoritete të tjera, si Struktura e Specializuar kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, i cili mblidhet rregullisht. Manuali i procedurave për parregullsitë u rishikua dhe u miratua në dhjetor 2021. Shqipëria **bashkëpunon me Komisionin Evropian/OLAF** për hetime dhe në vitin 2021 ka raportuar pesë raste parregullsie dhe mashtrime të dyshuara.

Shërbimi kombëtar i koordinimit kundër mashtrimit (AFCOS) është një njësi brenda Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Rrjeti AFCOS, që përfshin Institucionet/autoritetet kombëtarë të cilat janë të përfshira në parandalimin, raportimin dhe eliminimin e parregullsive, në mbrojtje të interesave financiare të Bashkimit Evropian, është ngritur dhe organizon takime të rregullta.

Me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 104, datë 23.03.2022 “Për një shtesë në Urdhrin nr. 84, datë 9.12.2015 “Për caktimin e rrjetit të raportimit të shërbimit AFCOS”, të ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është shtuar në Rrjetin e Raportimit të Shërbimit AFCOS.

Shqipëria bashkëpunon me Komisionin Evropian gjatë hetimeve dhe raporton në Komision për parregullsitë dhe rastet e dyshuara të mashtrimit. Shqipëria përgjatë vitit 2019 raportoi tre parregullsi përmes Sistemit Online të Menaxhimit të Parregullsive, të cilat pasi janë ndjekur dhe trajtuar sipas procedurave përkatëse janë mbyllur me sukses. Përgjatë vitit 2020 dhe 2021 janë raportuar në sistem dy parregullsi, të cilat vazhdojnë të jenë të hapura. Në total përmes sistemit janë raportuar 5 parregullsi që prej vitit 2019. Manuali për menaxhimin e parregullsive me fondet e BE-së është miratuar nga Zyrtari i Parë Autorizues (NAO) për fondet e BE-së.



Komisioni Evropian ka zhvilluar një sistem elektronik të Menaxhimit të Parregullsisë, i cili tashmë është funksional. Ky sistem (IMS) u mundëson përfituesve të IPA II, të raportojnë për parregullsitë e zbuluara, përfshirë mashtrimin, dhe ndjekjen e tyre në nivel kombëtar.

Drejtorja e Fondit Kombëtar, Drejtorja e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktiveve (CFCU), Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Drejtorja Mbështetëse e Zyrtarit Autorizues Kombëtar (NAOSD) dhe AFCOS/DIFP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kanë akses në sistemin IMS.

Shqipëria ka tashmë një historik solid të të dhënave për parregullsitë e raportuara, i dokumentuar nëpërmjet sistemit AFIS-IMS, por jo vetëm.

Mbarëvajtja dhe sigurimi i realizimit të këtij procesi të rëndësishëm, e konkretisht lidhur me identifikimin, raportimin dhe eliminimin e parregullsisë realizohet/menaxhohet nga Zyrtari Kombëtar Autorizues, nëpërmjet Drejtorisë Mbështetëse të ZKA-së.

Dokumentohet një regjistër/gjurmë për hetimet e kryera, si për ato që janë kryer në bashkëpunim me OLAF, edhe për ato që janë kryer me kërkesë të ZKA-së, të cilat kanë pasur për qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Regjistri lidhur me rastet e hetimeve të kryera nga OLAF, si dhe për ato të kryera nga njësi përgjegjëse pranë DIFP-së, administrohet pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik/AFCOS në referencë të kërkesave të Zëvendësministrit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në cilësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues për fondet e BE-së), me mbështetjen e Zyrës NAO.

DIFP/AFCOS ka bashkëpunuar rregullisht me Autoritet Kombëtare të Rrjetit AFCOS, në varësi të objektit të parregullsisë/çështjes, apo informacionit të kërkuar nga OLAF; AFCOS ka mundësuar për OLAF kontaktin me Përfaqësuesit e Autoriteteve Kombëtare të përfshira në këtë rrjet, në funksion të bashkëpunimit operacional për rastet e hetimit të kryera nga OLAF, si dhe ka asistuar në dhënien e informacionit të kërkuar nga OLAF.

DIFP/AFCOS ka asistuar/shoqëruar investiguesit e OLAF në misionet e investigimit të kryera në Shqipëri, për hetimin e parregullsisë të identifikuar nga OLAF.

### **Mbrojtja e euros nga falsifikimi**

Shqipëria vijoi **përafrimin e mëtejshëm me *acquis*** në lidhje me përcaktimin e falsifikimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike, si dhe mbi procedurat për grumbullimin, ruajtjen dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi. Në gusht 2021, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloret për medaljet dhe xhetonat të ngjashëm me monedhën metalike euro, si dhe për kriteret e riprodhimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike. **Analiza teknike** kryhet nga Qendra Kombëtare e Analizave të Bankës së Shqipërisë dhe Instituti i Policisë Shkencore. Në vitin 2021, Shqipëria sekuestroi 569 monedha metalike dhe kartëmonedha euro në një shumë totale rreth 9 600 euro, e

cila përfaqëson 38% të të gjitha monedhave të falsifikuara të sekuestruara në vend, krahasuar me 18% në 2020.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër falsifikimit të monedhës të vitit 1929, në nëntor të vitit 2019. Kuadri ligjor kombëtar është përafshuar me *acquis* të BE-së për mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave metalike me struktura dhe kapacitet e duhura që bashkëpunojnë kundër falsifikimit me Komisionin Evropian, Bankën Qendrore Evropiane, ato analoge në vendet anëtare të BE-së dhe ndërkombëtare.

Kuadri rregullator aktual garanton procedura detyruese për kontrollin e vërtetësisë, tërheqjen e menjëhershme të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara të falsifikuara të zbuluara në qarkullim, si dhe dorëzimin e tyre për analize teknike në Bankën Shqipërisë.

Identifikimi, analiza teknike dhe klasifikimi i monedhave të falsifikuara, si dhe mbledhja dhe analiza e të dhënave teknike e statistikore kryhet në Qendrën e Analizës në Bankës së Shqipërisë.

Përgjatë viteve 2015 – 2022, në qarkullim janë identifikuar dhe kryer analiza teknike për 1 178 kartëmonedha dhe 1 169 monedha metalike euro të falsifikuara, pothuajse të gjitha i përkasin klasave të përbashkëta evropiane të falsifikimit.

Bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është i vazhdueshëm. Në vitin 2018, Shqipëria është bashkuar në platformën e ekspertëve të Europol-it. Për mbrojtjen e monedhës euro nga falsifikimi Banka e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për kartëmonedhat me Bankën Qendrore Evropiane në vitin 2021, dhe për monedhat metalike me DG ECFIN Komisioni Evropian në vitin 2019.

Shqipëria merr pjesë dhe përfiton në aktivitetet në kuadër të programeve Pericles 2020.

### 32.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (institucioni lider);
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit;
3. Banka e Shqipërisë;
4. Ministria e Brendshme;
5. Ministria e Brendshme /Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
7. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
8. Ministria e Drejtësisë;
9. Agjencia e Auditimit të Projekteve të Asistencës së Akredituar nga BE;
10. Agjencia për Zhvillim Bujqësor;
11. Instituti i Statistikave (INSTAT).

## 32.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

### **Kontrolli i brendshëm financiar publik**

#### *Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet*

Kontrolli i brendshëm nuk është mundësuar ende në të gjitha njësitë buxhetore.

**Përgjegjësia menaxheriale** nuk është ende plotësisht e rregulluar në legjislacion dhe në praktikën administrative. Në praktikë, një numër shumë i vogël vendimesh administrative delegohen në nivele më të ulëta për shkak të sistemit të centralizuar të vendimmarrjes.

Rishfaqja e detyrimeve të prapambetura është një tregues për atribuimin ende jo plotësisht efektiv të përgjegjësive dhe kontrolleve të angazhimeve financiare.

Shqipëria duhet të zbatojë udhëzimet e miratuara për delegimin e përgjegjësive financiare dhe të nxjerrë udhëzime për delegimin e përgjegjësive menaxheriale me qëllim përmirësimin e llogaridhënies menaxheriale. Menaxhimi i riskut është ende në një fazë të hershme në të gjitha nivelet dhe duhet të përfshihet më mirë në menaxhimin e proceseve financiare dhe operacionale.

Shqipëria duhet të monitorojë dhe ndjekë zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportin vjetor të KBFP-së në institucionet buxhetore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit, por nevojiten përpjekje të forta për zbatimin e reformave të KBFP-së përtej Ministrisë. Procedurat e kontrollit të cilësisë së auditimit të brendshëm ende duhet të jenë në përputhje me standardet dhe të bëhen plotësisht funksionale.

Qeveria qendrore duhet të ndajë qartësisht përgjegjësitë institucionale në drejtimin e reformave të KBFP-së, në një qasje të koordinuar me administratën publike. Nevojiten përpjekje të forta për zbatimin e reformave të KBFP-së përtej Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Prioritetet dhe masat konkrete në fushën e kontrollit të brendshëm aktualisht përfshihen në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019 – 2022 dhe në Dokumentin e Politikave për zbatimin e mëtejshëm të KBFP 2021 – 2022. Disa masa për zbatimin e KBFP-së trajtohen edhe në strategjinë e Reformës së Administratës Publike dhe planin e saj të veprimit. Këto prioritate në zhvillimin e KBFP-së në Republikën e Shqipërisë janë konkretizuar me miratimin e Strategjisë MFP 2019 – 2022 dhe Dokumentit të Politikave të KBFP-së për periudhën 2021 – 2022, duke përcaktuar rëndësinë e zhvillimit të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe linjave të raportimit, zbatimit të MFK-së dhe AB, detyrimin ligjor të menaxherëve të të gjitha njësiteve publike për të krijuar të një sistem funksional të kontrollit të brendshëm në institucionet e tyre si dhe përmirësimin dhe miratimin e kuadrit rregullator të nevojshëm për zbatimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Pavarësisht masave të ndërmarra, nga

vlerësimet e kryera mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, evidentohet nevoja për angazhim të mëtejshëm në zbatimin e parimeve themelore të kontrollit të brendshëm në përputhje me kuadrin legjislativ të vendosur në Shqipëri.

Pengesat kryesore në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike përfshijnë kryesisht moskuptimin e duhur të qëllimit dhe përfitimeve të zbatimit të KBFP -së në nivelin menaxherial, menaxhimi aktiv i riskut dhe përfshirja e tij në proceset financiare dhe operacionale të njësisë, monitorimin dhe raportimin në kohën e duhur dhe me cilësi të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, mosidentifikimi i qartë i proceseve të punës, roleve dhe përgjegjësi në procedura të ndryshme.

Përsa i përket përgjegjshmërisë menaxheriale dhe instrumenteve për zbatimin e saj, evidentohet se pavarësisht numrit në rritje të njësiave, menaxherët e të cilave delegojnë në nivele më të ulëta disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës, ende nevojitet angazhim për zbatimin e procedurave të sakta të delegimit në funksion të përmirësimit të përgjegjshmërisë menaxheriale. Në këto kushte, theksohet nevoja për zbatimin e mëtejshëm të udhëzimit për delegimin e detyrave dhe përgjegjësiave edhe në proceset operacionale dhe administrative, përveç atyre financiare.

Vetëvlerësimi nga ana e njësiave të qeverisjes së përgjithshme zbulon gjithashtu se ekzistenca e politikave dhe kuadrin rregullator adekuat është parakushti kryesor, por jo i vetmi për mirëfunksionimin e sistemit. Prandaj, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet stimujve për menaxhimin e lartë për të kuptuar politikat dhe për të siguruar respektimin e kuadrin rregullator.

Me rishikimin dhe përmirësimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin mundësohet saktësimi dhe përmirësimi i cilësisë së parimeve, rregullave, procedurave, strukturave administrative si edhe metodave për përmirësimin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kuadër të rritjes së efektivitetit të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike. Në këtë kontekst, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit do të vijojë me rishikimin dhe përmirësimin e kuadrin rregullator të fushës në mbështetje të mirëfunksionimit të veprimtarisë së njësiave publike si dhe ofrimin e asistencës për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike.

Ligji për auditimin e brendshëm në sektorin publik duhet të ndryshohet mbështetur në analizën e mangësive të realizuar nga Drejtoria e Harmonizimit, e Auditit të Brendshëm, dhe ekspertët e SIGMA-s dhe ndryshimet në ligj duhet të pasohen me ndryshime të tjera të nevojshme në aktet e tjera nënligjore. Manuali i auditimit të brendshëm është rishikuar në këndvështrimin e dhënies së udhëzimeve shtesë për çështje të caktuara dhe për ta bërë një dokument plotësisht të aplikueshëm në praktikë. Auditimi i bazuar në rrezik duhet të udhëheqë qasjen e auditimit dhe efektiviteti i auditimeve duhet të përmirësohet përmes vlerësimit të rrezikut. Krijimi dhe funksionimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në disa raste nuk sigurohet në përputhje me dispozitat e Ligjit të AB. Ende ka një numër Njësish të AB të cilat nuk përmbushin kërkesën për të pasur së paku tre punonjës si staf auditues. Numri i vendeve të lira në strukturat e auditimit të brendshëm mbetet

thua jse në të njëjtat nivele rreth 11%, dhe vakancat janë kryesisht në njësitë e qeverisjes vendore. Ndryshimet në kuadrin ligjor të auditimit të brendshëm kërkojnë dhe përditësime në aktet e tjera nënligjore si dhe hartimin e udhëzuesve specifikë për fusha të rëndësishme të auditimit të tilla si auditimi i performancës, risku i mashtrimit dhe korrupsionit etj. Trajnimi i audituesve duhet të adresojë kërkesat kyçe në rritje të audituesve për forcimin e kapaciteteve dhe aftësive audituese.

Sa i përket **praktikës së auditimit të brendshëm**, funksioni i auditimit të brendshëm ende nuk lëshon opinione auditimi për efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nëpër njësitë buxhetore. Cilësia e aktiviteteve të auditimit është ende vetëm pjesërisht në përputhje me Standardet IIA dhe kërkesat ligjore. Procedurat e kontrollit të brendshëm të cilësisë së auditimit të brendshëm duhet të bëhen në përputhje me standardet dhe plotësisht funksionale. Monitorimi i zbatimit efektiv dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit të brendshëm duhet të përmirësohet. Kapacitetet dhe aftësitë profesionale të audituesve të brendshëm duhet të forcohen dhe rriten më tej.

Kapaciteti i **Njërive Qendrore të Harmonizimit (NjQH)** duhet të forcohet më tej.

## **Auditimi i jashtëm**

### *Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet*

Shqipëria duhet të rrisë kontrollin parlamentar të organeve të audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm, përmes dëgjësive më të shpeshta parlamentare dhe krijimit të një kuadri monitorues parlamentar për të vlerësuar rregullisht veprimet e qeverisë për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Kërkohet të bëhen ndryshime ligjore për të forcuar qëllimin e mandatit të auditimit për të mbuluar të gjitha entet publike.

Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), **kuadri kushtetues dhe ligjor** i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Suprem të Auditimit (KLSH). Identifikimi i nevojave për ndryshime të Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të cilat forcojnë fushën e mandatit të auditimit, janë në shqyrtim të grupit të punës së ngritur për këtë qëllim.

KLSH duhet të përgatisë dhe miratojë një plan të ri zhvillimi për vitin 2023 e në vijim.

**Cilësia e punës së auditimit** duhet të përmirësohet më tej për të përmbushur plotësisht standardet INTOSAI.

Pavarësisht shkallës së lartë, me më shumë se 90% të rekomandimeve të pranuar nga institucionet përkatëse, shkalla e rekomandimeve të zbatuara plotësisht duhet të përmirësohet më tej (në vitin 2021 shkalla ishte vetëm 50%).

Këto prioritete do të vijojnë të jenë në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2023 – 2027, dokument i cili po përgatitet me mbështetjen e IDI. KLSH do të vijojë:

- Të rrisë impaktin e veprimtarisë audituese nëpërmjet raporteve cilësore, relevante dhe të qarta në funksion të llogaridhënies dhe transparencës;
- Të rrisë komunikimin me subjektet e audituara dhe konsultimet me të gjitha palët e interesit dhe partnerët ndërkombëtarë në identifikimin e çështjeve me interes të përbashkët me qëllim përcjelljen e një mesazhi të qartë dhe thelbësor të auditimit për parandalimin e keqpërdorimit të fondeve publike, si dhe për t'ju ardhur në ndihmë organeve ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit;
- Të kryejë auditime tematike të veçanta për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve me qëllim evidentimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve dhe hartimin e raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve;
- Të bashkëpunojë për ngritjen e një nënkomisioni parlamentar, pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së, që do të shërbejë në përmbushjen e këtyre objektiveve.

## **Mbrojtja e interesave financiare të BE-së**

### *Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet*

Shqipëria duhet të përafrojë plotësisht Direktivën e BE 2017/1371 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 5 korrik 2017 “Për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të Unionit me anë të ligjit penal”. Një strategji kombëtare kundër mashtrimit duhet ende të miratohet. Megjithëse bashkëpunimi me shërbimin e koordinimit kundër mashtrimit për hetimet është përmirësuar, nevojiten akoma më shumë përpjekje për zhvillimin e një historiku solid për raportimin e parregullsive dhe për bashkëpunimin në hetime, veçanërisht në lidhje me autoritetet e zbatimit të ligjit

Përafrimi i kësaj direktive është parashikuar në aktet e Ministrisë së Drejtësisë për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, në kushtet kur Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian në aspektin penal si dhe është lider për kapitullin 23.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ strukturat respektive përgjegjëse të saj, ku bën pjesë edhe DIFP/AFCOS, do të kenë rol mbështetës në përafrimin e kësaj direktive, në përputhje me fushën e përgjegjësisë të çdo strukture.

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit (2024), e cila synon mbrojtjen e interesave financiare të BE-së është një mangësi e identifikuar gjatë procesit *screening*, për kapitullin 32 “Kontrolli financiar”, si dhe rekomandimeve në Raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë.
- Hartimi i kësaj strategjie ishte parashikuar të niste në tremujorin e dytë 2020, por për shkak të pandemisë COVID-19, u shty për në vitin 2022.

- Grupi i punës është krijuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 127, datë 15.04.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit “Për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian”. Grupi i punës përfshin përfaqësues nga strukturat operative dhe menaxhuese të fondeve të BE-së; autoritetet kombëtare të përfshira në parandalimin, raportimin dhe eliminimin e parregullsive, si dhe anëtarë të rrjetit të AFCOS.

Në kushtet kur ky proces kërkon një bashkëpunim dhe ndërveprim institucional të vazhdueshëm, ndërmjet përfaqësuesve të rrjetit AFCOS, strukturave menaxhuese dhe operuese në MFE, OLAF, si dhe nga ana tjetër, për vetë rëndësinë që ka ky proces, asistencë teknike vlerësohet e domosdoshme, në funksion të mbarëvajtjes së këtij procesi.

Për hartimin e kësaj strategjie DIFP/AFCOS do të vijojë me koordinimin e mundësimit të asistencës teknike nga OLAF, nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm që ka me këtë strukturë.

Strategjia është parashikuar të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave brenda 3 mujorit të katërt të vitit 2024.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve/burimeve njerëzore në Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik/në Sektorin e Sinjalizimit, Investigimit, Monitorimit dhe AFCOS, do të ndërmerren hapat respektivë për plotësimin e dy vendeve vakante në strukturën e AFCOS.

## **Mbrojtja e euros nga falsifikimi**

### *Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet*

Bashkëpunimi ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme për kryerjen e analizës teknike të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të falsifikuara duhet të formalizohet.

# GRUPIMI II: TREGU I BRENDSHËM

## KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

### 1.1 Përmbajtja e kapitullit

Parimi i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton që produktet duhet të tregtohen në mënyrë të lirë nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian në një tjetër. Në një numër sektorësh ky parim i përgjithshëm plotësohet nga kuadri rregullator i harmonizuar në “qasjen e vjetër” (vendosja e specifikave të sakta në mallrat) ose “qasja e re” (vendosja e kërkesave të përgjithshme në mallrat). Legjislacioni i harmonizuar evropian në lidhje me mallrat, i cili duhet të transpozohet, përfaqësohet në pjesën më të madhe të *acquis* në këtë kapitull. Përveç kësaj, kjo kërkon kapacitete të mjaftueshme administrative të cilat janë thelbësore në notifikimin e kufizimeve në tregti si dhe për të zbatuar masa horizontale dhe procedurale në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

### 1.2 Struktura e kapitullit

1. **Parimet e përgjithshme**
  - 1.1 Masat me efekt të njëjtë me kufizimet sasiore
  - 1.2 Njohja e ndërsjellë e produkteve
  - 1.3 Shkëmbimi i informacionit mbi pengesat në lëvizjen e lirë të mallrave
2. **Çështjet horizontale**
  - 2.1 Standardizimi
  - 2.2 Akreditimi
  - 2.3 Vlerësimi i konformitetit
  - 2.4 Metrologjia
  - 2.5 Mbikëqyrja e tregut
3. **Direktivat e përjasjes së vjetër**
  - 3.1 Mjetet motorike
  - 3.2 Kimikatet
  - 3.3 Praktikat e mira laboratorike
  - 3.4 Prekursorët e drogave
  - 3.5 Detergjentet
  - 3.6 Plehurat kimike
4. **Direktivat e përjasjes së re**
  - 4.1 Pajisjet elektrike brenda disa kufijve të tensionit
  - 4.2 Pajisjet e thjeshta nën presion
  - 4.3 Siguria e lodrave
  - 4.4 Siguria e makinerive
  - 4.5 Pajisjet mbrojtëse personale



- 4.6 Lëndët plasëse për përdorime civile dhe fishekjarrët
- 4.7 Pajisjet dhe sistemet në ambiente potencialisht shpërthyes
- 4.8 Ashensorët
- 4.9 Instrumentet e peshimit jo automatik
- 4.10 Instrumentet matës
- 4.11 Pajisjet nën presion
- 4.12 Bojlerët me ujë të nxehtë
- 4.13 Pajisjet e gazit
- 4.14 Pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit
- 4.15 Përputhshmëria elektromagnetike
- 4.16 Anijet çlodhëse
- 4.17 Instalime teleferike të projektuara për transport personash
- 4.18 Produktet e ndërtimit
- 4.19 Pajisjet e transportueshme nën presion
- 4.20 Emetimi i zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura
- 4.21 Limitet e emetimit dhe aprovimi i tipit të motorëve për përdorim jo-rrugor
- 4.22 Ecodesign për produktet me ndikim në energji
- 4.23 Pajisjet aerosol
- 4.24 Parapaketimet
- 4.25 Shishet enëmatëse
- 4.26 Njësitë matëse
- 4.27 Informacioni i konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet me ndikim në energji
- 5. **Masat procedurale**
- 5.1 Informacioni mbi rregulloret teknike
- 5.2 Armët e zjarrit
- 5.3 Transferimi i produktet në fushën e mbrojtjes
- 5.4 Xhami i kristalit
- 5.5 Tekstile
- 5.6 Këpucë
- 5.7 Transparenca e cmimeve të produkteve farmaceutike
- 5.8 Kthimin e objekteve kulturore të zhvendosura në mënyrë të paligjshme

### 1.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar me kapitullin 1 të legjislacionit evropian buron nga neni 70 dhe 75 i MSA-së.

Këto dispozita detyrojnë Shqipërinë që teknikisht të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të hyjë në fuqi. Kështu, tashmë në këtë fazë të procesit të para-anëtarësimit, organet e ndryshme shtetërore duhet të jenë të përfshira në ushtrimin e përafritimit të legjislacionit shqiptar me atë të *acquis* që është në fuqi.

Për më tepër, kur legjislacioni i BE-së është subjekt konstant zhvillimi, përfrimi i ligjeve nuk do të jetë i plotë me përshtatjen e legjislacionit shqiptar me atë të legjislacionit evropian aktualisht në fuqi. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve të BE-së është i nevojshëm si për përpjekjet e paraprimit, ashtu dhe përgatitjen e Shqipërisë si realitet i përditshëm për anëtarësimin në të ardhmen në BE.

Në kuadër të MSA-së, Partneriteti Evropian me Shqipërinë është instrumenti kryesor për të ndihmuar autoritetet shqiptare në realizimin e perspektivës evropiane të vendit.

Parimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton se produktet duhet të tregtohen lirish nga një vend i Bashkimit Evropian në një tjetër. Lëvizja e lirë e mallrave është faktor kyç në rritjen dhe zhvillimin e tregut të brendshëm. Ky parim është përcaktuar në nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), duke parandaluar Shtetet Anëtare të miratojnë ose të ruajnë kufizime të pajustificuara në tregtinë brenda BE-së.

Dispozitat e TFBE-së nuk përjashtojnë ndalimet e justifikuara për shkak të moralit publik, politikës publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose mbrojtjes së pronës industriale dhe tregtare, si dhe kërkesave të tjera të detyrueshme të njohura nga Gjykata e Drejtësisë (p.sh. mbrojtjen e mjedisit). Megjithatë, ndalesa të tilla duhet të mbeten proporcionale dhe nuk duhet të përbëjnë diskriminim arbitrar ose një kufizim të fshehtë në lidhje me tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Masat që kanë efekt të njëjtë me kufizimet sasiore janë të ndaluara me përjashtim të një grupi të vogël masash kufizuese. Kjo konkretisht nënkupton eliminimin e pengesave teknike dhe përmbushjen e parimit të njohjes reciproke. Dispozitat administrative relevante duhet të miratohen për të zbatuar procedurat e njohjes reciproke të mallrave të tregtuara ligjërisht në një shtet tjetër anëtar, të përcaktuara në Rregulloren (EU) 2019/515 dhe shkëmbimit të informacionit në Rregulloren “Strawberry” (KE) Nr. 2679/98.

Në një numër sektorësh parimi i përgjithshëm plotësohet nga një kornizë rregulluese e harmonizuar. Masat horizontale përcaktojnë infrastrukturën e cilësisë që Shtetet Anëtare duhet të vendosin në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Legjislacioni i harmonizuar në lidhje me produktet evropiane, i cili duhet të transpozohet nga çdo shtet anëtar, përfaqëson pjesën më të madhe të *acquis* së këtij kapitulli. Ajo bazohet në “përqasjen e vjetër” që imponon specifikimet specifike të produktit) dhe “përqasjen e re dhe globale” (imponon kërkesat e përgjithshme të produktit).

Legjislacioni në kuadër të përqasjes së re përfshin pajisjet e tensionit të ulët (LVD), përputhshmërinë elektromagnetike (EMC), lodrat, makineritë, ashensorët, emetimet e zhurmave në ambient, shkarkimet ndotëse nga pajisjet motorike të lëvizshme në rrugë, pajisjet personale

mbrojtëse (PPE) sistemet mbrojtëse të destinuar për përdorim në atmosfera shpërthyes (ATEX), aparate të gazit, enë nën presion, teleferikët, prodhimet e ndërtimit, anijet rekreative, kërkesat e projektimit ekologjik për produktet e lidhura me energjinë (ERP), etj. Legjislacioni i përjasjes së vjetër mbulon fushat e automjeteve, kimikateve, detergjenteve, prekursorët e drogave, praktikat laboratorike.

Zbatimi në mënyrën e duhur i një sërë masash procedurale kërkojnë gjithashtu kapacitete të mjaftueshme administrative. Këto përfshijnë procedurën e njohjes në fushën e standardeve teknike dhe rregulloreve të përcaktuara në Direktivën 1535/2015/EU, legjislacionin mbi tregtinë e armëve, produktet e mbrojtjes, xhamin e kristaltë, këpucët, etiketimin e tekstilit, çmimet e produkteve mjekësore dhe Direktivën 2014/60/BE për kthimin e objekteve kulturore të zhvendosura në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar në atë të një shteti tjetër anëtar.

#### 1.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Rreth 55% (30 akte) e akteve nën këtë kapitull janë harmonizuar pjesërisht, ndërkohë që 45% janë të paharmonizuara. Gjatë periudhës raportuese ka pasur një progres të limituar në përafrimin sektorial me legjislacionin e produkteve të “përjasjes së re dhe globale” dhe në akreditimin e trupave të tjerë të vlerësimit të konformitetit.

#### **Parimet e përgjithshme**

Sa i përket fushës së pa harmonizuar dhe aplikimit të parimeve të parashikuara nga nenet 34 – 36 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian, Shqipëria ka përgatitur Planin e Veprimit për heqjen e masave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore për tregtinë në mallra (Faza e 1-rë). Gjatë vitit 2022 ka përfunduar faza e parë pilot, ku janë analizuar 60 akte ligjore që rregullojnë vendosjen në treg për 18 sektorë/produkte (kimikatet, pajisjet mjeksore, hidrokarburet, produktet farmaceutike, lodra, ashensore, produktet e mbrojtjes së bimeve, fusha e veterinarisë, etj). Në total rezultojnë 28 masa/barriera të identifikuara: 21 masa të dakordësuara/planifikuara për t'u shfuqizuar, 2 masa që do të mbahen, 3 masa të cilat do duhet të konsultohen më tej me një grup më të gjerë aktorësh (hidrokarburet dhe vajrat lubrifikantë), si dhe 1 masë që është shfuqizuar/adresuar në shkurt 2022. Plani i Veprimit përmban ndër të tjera edhe masa afatshkurtra dhe afatgjatë për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative, me qëllim për t'u përgatitur gradualisht për detyrimet që ekzistojnë në fushën e paharmonizuar. Faza e dytë ku do të synohet shqyrtimi i të gjithë sektorëve produkteve do të vijojë gjatë periudhës 2023 – 2024.

#### **Çështjet horizontale**

Parimet e tregtimit të produkteve dhe mbikëqyrjes së tregut në Shqipëri rregullohen nga:

- Ligji Nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtinë dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore” (i cili harmonizon pjesërisht Vendimin 768/2008/KE dhe Rregulloren 765/2008/KE, tashmë të ndryshuar me Rregulloren 2019/1020); si edhe
- legjislacioni specifik që rregullon veprimtarinë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut).

Me qëllim krijimin e një kuadri gjithpërfshirës për harmonizimin e plotë në fushën e harmonizuar, MFE ka koordinuar përgatitjen e Roadmap-i/Udhërrëfyese i cili përmbledh një analizë të situatës aktuale për çdo akt europian që bie nën kapotullin 1, identifikimin e institucioneve përgjegjëse për harmonizimin dhe zbatimin, identifikimin e mangësive kundrejt kërkesave europiane dhe planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë (deri në 2030) për harmonizimin e plotë në këtë fushë. Dokumenti është finalizuar dhe pas konsultimit me grupet e interesit (dhjetor 2022) dokumenti do të shërbëjë si bazë për përditësimet e përvitshme të PKIE-së.

### *Mbikëqyrja e tregut*

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve zbatuese të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është kryer nëpërmjet ndryshimit të struktura të ISHMT si dhe nëpërmjet rritjes së numrit të inspektorëve. Struktura e inspektoratit është e plotësuar në nivelin 80%, rekrutimi i vendeve vakante të mbetura është në proces. Në shtator 2020, ISHMT u zhvendos në ambientet e reja, ku u numri i zyrave u katërfishua dhe çdo punonjës i institucionit ka hapësirën personale të punës gjë që çon në përmirësimin e lehtësimin e kryerjes së detyrave operacionale. ISHMT është pajisur me 23 pajisje testuese që do të ndihmojnë inspektorët të identifikojnë jo-konformitetet në produkte. Këto pajisje do të jenë të dobishme për inspektorët në evidentimin e jo-konformiteteve në parapaketime, pajisje elektrike, lodra, makineri, ashensorë etj.

Të gjithë inspektorët janë trajnuar vazhdimisht gjatë 2022 (më së shumti online), me mbështetjen e GIZ në kuadër të Projektit SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe, mbi direktivat/rregulloret të cilat përfshihen në kapitullin 1. Konkretisht janë realizuar 12 trajnime në të cilat janë trajtuar Rregullorja e re për mbikëqyrjen e tregut si dhe Direktivat e produkteve që janë në fushën e përgjegjësisë së kontrollit të ISHMT si NAWI, MID, Machinery, SPVD, GAR, LVD, PED, PPE, Toys, pajisjet e aerosolit. Gjithashtu ISHMT ka marrë pjesë në 2 trajnime organizuar në kuadër të Projekti “Përmirësimi i menaxhimit të kimikateve në Shqipëri” organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim (KEMI). ISHMT është një nga institucionet përgjegjëse për implementin e kërkesave të parashikuara në këtë legjislacion sa i përket produkteve që bëhen të disponueshëm për konsumatorët lidhur me kriteret për limitimin dhe ndalimin e kimikateve të rrezikshme në disa artikuj, si dhe për kërkesat e klasifikimit/paketimit/etiketimit, ndaj pjesëmarrja në këto trajnime janë veçanërisht të rëndësishme duke qenë dhe një kuadër ligjor i ri në zbatim. Takimet online dhe trajnimet lidhur me këto çështje kanë qenë të vazhdueshme.

### *Standardizimi*

Legjislacioni në fushën e standardizimit siguron qartë rregulla dhe procedura në përputhje me ato të përdorura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, si CEN, CENELEC, ETSI, ISO dhe IEC. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382, datë 27.06.2018 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit”, të ndryshuar me Vendimin nr. 673, datë 10.11.2021 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 382, datë 27.06.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” ka transpozuar plotësisht Rregulloren e BE-së Nr. 1025/2012 “Për standardizimin evropian”.

Përveç legjislacionit në fuqi, të gjitha proceset e standardizimit bazohen në rregulloret e brendshme të DPS që janë në përputhje me rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është anëtare me të drejta të plota në Institutin Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI) dhe anëtar i asociuar (pa të drejtë vote) i Komitetit Evropian për Standardizimin (CEN) dhe Komitetit Evropian për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC), anëtar korrespondent (pa të drejtë vote) në Organizatën Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) dhe anëtare me të drejta të kufizuara vote (vetëm për 3 Komitete Teknike) në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC).
- Më 14 Qershor 2021 DPS aplikoi në CEN & CENELEC, duke dërguar gjithë dokumentacionin për t’u pranuar si anëtar i plotë i CEN dhe i CENELEC. Së bashku me aplikimin zyrtar u paraqitën gjithashtu, dosja me materialet ku sigurohen informacione të hollësishme për të demonstruar se DPS plotëson kriteret për anëtarësimin e plotë në CEN dhe CENELEC të përcaktuara në Rregullat e Brendshme të CEN – CENELEC Pjesa 1 – Organizimi dhe struktura (korrik 2018), 1D “Kërkesat e anëtarësimin në CEN dhe CENELEC”.
- Më 25 dhe 26 Maj 2022, në zyrat e DPS, u krye auditi nga ekspertë të CEN&CENELEC, procedurë kjo që përcaktohet në Udhëzuesin 22 të CEN&CENELEC “Për strukturën organizative dhe proceset për vlerësimin e kriterëve të anëtarësimin në CEN dhe CENELEC. Në fund të vizitës audituese ekspertët përpiluan raportin me gjetjet jo konform kriterëve dhe draft planin e punës me rekomandimet për rregullimin/ përmirësimin e tyre.
- Janë adoptuar mbi 95% e standardeve të CEN&CENELEC dhe 90% të standardeve të telekomunikacionit të publikuara nga ETSI, 16% të standardeve ndërkombëtare të fushës elektroteknike të publikuara nga IEC, dhe 18% të standardeve ndërkombëtare të publikuara nga ISO.
- Gjatë kësaj periudhe është realizuar hedhja e të dhënave të plan bizneseve për 60 Komitetet Teknike (KT) të DPS-së si dhe është realizuar lidhja e Kryetarëve dhe Anëtarëve të KT-ve në Databazë.

Lidhur me mirëmbajtjen e databazës është krijuar Grupi i Punës i përbërë nga përfaqësues të MFE-së, të AKSHI dhe të DPS, i cili do të vendosë nëse databaza e standardeve ka nevojë për mirëmbajtje apo zhvillim.

*Akreditimi*

Ligji Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” ka harmonizuar dispozitat përkatëse për akreditimin të Rregullores (KE) Nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 korrik 2008 Kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut. Ky ligj rregullon funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, bordit të saj të akreditimit, grupeve teknike të punës dhe çështje të tjera procedurale të procesit të akreditimit. Në raport progresin e vitit 2022 është cilësuar se legjislacioni në fushën e akreditimit nuk është i harmonizuar në mënyrë të plotë me Rregulloren (KE) 765/2008, prandaj është planifikuar që gjatë vitit 2023 do të arrihet përafrimi në mënyrë të plotë. Aktet dytësore në fushën e akreditimit janë miratuar në korrik – shtator 2015, por është parashikuar edhe një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 737 datë 9.09.2015, i ndryshuar në lidhje me tarifatat për akreditim. Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 2 datë 12.01.2021 është miratuar struktura dhe organika e re e DPA.

Struktura administrative përgjegjëse për akreditimin është e ngritur dhe është funksionale që nga viti 2004. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) funksionon nën varësinë e Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë si një organ i pavarur dhe i paanshëm.

DPA kryen veprimtarinë e akreditimit me kompetencë dhe është anëtare me të drejta të plota në organizatën e Bashkëpunimit Evropian për Akreditim (EA) dhe anëtare nënshkruese e EA MLA në fushën e testimit, certifikimit të sistemit të menaxhimit, certifikimit të personave dhe organeve të inspektimit. DPA është anëtare nënshkruese e ILAC MRA në fushën e testimit dhe inspektimit dhe IAF MLA për certifikimin e sistemit të menaxhimit dhe certifikimin e personave.

### *Metrologjia*

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) është anëtar i EURAMET si dhe anëtar i asociuar i WELMEC. DPM ka implementuar dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DPM-së në laboratorët e DMSHI-së, në përputhje me standardin e ri SSH ISO/IEC 17025:2017 “Kompetencat teknike të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit”.

Në lidhje me vlerësimin e menaxhimit të Cilësisë së DPM-së, u organizua dhe u realizua me sukses vlerësimi i laboratorëve të masës, volumeve, presionit nga Organizata Evropiane e Metrologjisë EURAMET dhe projekti EURAMET Nr. 1465, në lidhje me plotësimin e kërkesave të standardit të ri ISO/IEC 17025:2017 dhe Marrëveshjes Ndërkombëtare të Njohjes së Ndërsjellë (CIPM MRA).

Sistemi Menaxhimit të Cilësisë mori besueshmërinë e Organizatës Evropiane (EURAMET) në Prill të vitit 2019 dhe hapi rrugën për ripublikimin e aftësive matëse dhe kalibruese (CMC) të fushës së masës në databazën e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave, BIPM KCDB.

Projekti me PTB-në “Fondi Rajonal i Konsulencës të Infrastrukturës të Cilësisë”, përfundoi në shtator të këtij viti dhe ofroi mbështetje për laboratorin e temperaturës, laboratorin elektrik, laboratorin e gjatësisë, laboratorin e kimisë dhe fushën e testeve të zotësisë.

Aftësitë matëse dhe kalibruese (CMC) të laboratorit të presionit dhe volumeve, janë deklaruar në databasën e Byrosë Ndërkombëtare të Masave dhe Peshave, BIPM KCDB gjatë vitit 2021.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, nëpërmjet laboratorit elektrik ka realizuar pjesmarrjen në projektin me PTB për realizimin e krahasimeve dhe testeve laboratorike sipas standardit ISO/IEC 17043: 2010. Ky proces ju erdhi në ndihmë laboratorëve dhe subjekteve vendas në fushën e matësive të energjisë elektrike, pasi kriteri kryesor për t'u akredituar është realizimi i një krahasimi apo testi zotësie. Aktualisht këto krahasime do të realizohen brenda Republikës së Shqipërisë dhe me më pak kosto financiare.

Gjithashtu është në proces, ndërkrahasimi i fushës së temperaturës dhe lagështisë si projekt i EURAMET-it me pilot INRIM, Itali. Ka përfunduar krahasimi ndërlaboratorik bilateral në fushën e presionit me Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, ku DPM kishte rolin e laboratorit pilot.. Në bashkëpunim me Institutin e Metrologjisë Greke (EIM), u realizuan krahasimet ndërlaboratorike bilaterale në fushën e gjatësisë, temperaturës dhe lagështirës, si dhe në fushën elektrike. Ndërkohë ka përfunduar edhe testi i zotësisë në fushën e kimit me Institutin e Metrologjisë Gjermane (PTB).

### **Direktivat e Përqasjes së Vjetër**

Në lidhje me **kimikatet**, Ligji Nr. 27/2016 “Për Menaxhimin e Kimikateve” dhe aktet nënligjore zbatuese të tij janë pjesërisht në përputhje me dispozitat e Rregullores për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH) dhe akteve të tjera përkatëse të acquis. Paketa ligjore me bazë REACH (1 ligj dhe 3 VKM) ka transpozuar në legjislacionin kombëtar të gjithë elementët e mundshëm të Rregullores së BE 1907/2006, të cilat mund të përafrohen nga vendet candidate. Legjislacioni kombëtar për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin kimik (CLP) është në përputhje me Sistemin e Harmonizuar të Kombeve të Bashkuara për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve. Projekti “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve”, ka filluar implementimin nga Marsi 2019, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze / SIDA, do të zbatohet nga Agjencia Suedeze e Kimikateve (KemI) për një periudhë 3 vjeçare, duke kontribuar në ngritjen e aftësive teknike dhe administrative të institucioneve të përfshira në fushën e kimikateve, si dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar në këtë fushë.

Sa i takon **detergjenteve**, Rregullorja 648/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 mars 2004 mbi detergjentet, është pjesërisht e harmonizuar nëpërmjet ligjit nr. 10216/2010 “Për detergjentet”; VKM-së Nr. 669 datë 28.09.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet” dhe VKM-së Nr. 220, datë 28.3.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”. Legjislacioni për detergjentet, hartuar në vitin 2010, referon në një pjesë të madhe të tij, legjislacionin për kimikatet, i cili është rishikuar pothuajse plotësisht me miratimin e ligjit “Për menaxhimin e kimikateve”, në vitin 2016 dhe akteve nënligjore të zbatim të tij (REACH and CLP Regulation). Nga ana tjetër vetë Rregullorja Nr 648/2004, ka pësuar ndër

vite disa ndryshime që, pas një vlerësimi të ecurisë së zbatimit të ligjit dhe zhvillimeve të vullshme të hedhjes në treg të shumëllojshmërisë së detergjenteve, del e domosdoshme përshtatja e ndryshimeve në legjislacionin aktual. Konkretisht, një ndryshim i rëndësishëm, ka të bëjë me përfshirjen në fushën e zbatimit të ligjit të detergjenteve për lavapjatë, lavanderi si dhe kufizimet për përmbajtjen e fosfateve dhe përbërësve të tjerë të fosforit. Është përgatitur Projekt-Ligji “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10216/2010 “ Për detergjentët” , RIA- përkatëse dhe parashikohet të vijohet me procesin e konsultimit dhe miratimin brenda 6 mujorit të dytë të 2024.

Në lidhje me **mjetet motorike**, Ministria përgjegjëse për transportin ka transpozuar në legjislacionin shqiptar 3 direktiva kuadër për mjetet rrugore, motomjetet dhe traktorët bujqësore dhe pyjorë përkatësisht: direktiva 2007/46/EU, direktiva 2002/24/EU dhe direktiva 2003/37/EU përmes akteve nënligjorë të miratuara nga Ministria me udhëzimet:

- Nr. 11, datë 6.6.2011 “Mbi miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre dhe sistemeve, komponentëve dhe njësive teknike të veçanta të tyre”;
- Nr. 12, datë 6.6.2011 “Mbi miratimin e tipit të motorëve me dy dhe tre rrota”;
- Nr. 10, datë 30.5.2011 “Mbi miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë dhe pyjorë dhe makinerive ndërkëmbyeshme të tërhequra së bashku me sistemet e tyre, komponentët dhe njësitë teknike të veçanta.”

Ndërkohë këto direktiva janë shfuqizuar dhe aktualisht janë miratuara 3 rregullore të reja Evropiane që kanë të njëjtin objekt me direktivat e shfuqizuara (Rregullorja 2018/858 “Mbi miratimin dhe mbikëqyrjen e tregut të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, komponentëve dhe njësive teknike të veçanta që përdoren në to”; Rregullorja Nr. 168/2013 “Mbi miratimin e tipit dhe mbikëqyrjen e tregut të motorëve me 2 3 dhe 4 rrota, si dhe Rregullorja 167/2013 “Mbi miratimin e tipit dhe mbikëqyrjen e tregut të traktorëve bujqësorë dhe pyjorë.”

## **Direktivat e Përqasjes së Re**

Shqipëria ka harmonizuar pjesërisht rreth 15 direktiva/rregullore që bien nën përqasjen e re, ku përfshihen: pajisjet e tensionit të ulët, përputhshmëria elektromagnetike, lodrat, ashensorë dhe komponentët e tij, makineritë, emetimi i zhurmave nga pajisjet për përdorim në ambiente të jashtme, pajisjet në presion, pajisjet e transportueshme nën presion, pajisjet radio, instrumentet matëse, instrumentet jo-automatike të peshimit, pajisjet aerosol, parapaketimet, shishet enëmatëse, lëndët plasëse për përdorim civil dhe fishekzjarrët.

Sipas fushës së përgjegjësisë, institucionet zbatuese përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut janë Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Inspektorati Shtetëror, Teknik dhe Industrial, Autoriteti i Komunikimeve elektronike dhe Postare (pajisjet radio).

Kontrolli i lëndëve plasëse për përdorim civil dhe artikujve piroteknike realizohet nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për prodhimin, importin eksportin dhe kontrollin mbi konformitetin të lëndëve



plasëse për përdorim civil dhe artikujve piroteknike, ndërsa Ministrinë e tjera janë përgjegjëse për përdorimin, asgjësimin, magazinimin dhe transportin e këtyre mallrave.

Me qëllim implementimin e Legjislacionit përkatës në fushën e lëndëve plasëse dhe artikujve piroteknike të miratuar në vitin 2021, gjatë vitit 2022 janë përgatitur aktet nënligjore për të rregulluar procedurat e prodhimit, importit, eksportit, transitit, magazinimit dhe asgjësimit të këtyre produkteve. Këto akte sipas fushave të kompetencës po përgatiten nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme.

## **Masat procedurale**

Sa i përket fushës së **tekstileve, xhamit kristal dhe veshjeve të këmbës**, legjislacioni përkatës evropian është pjesërisht i harmonizuar respektivisht me VKM nr. 1058/2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketime markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”, VKM Nr. 221/2012 “Për miratimin e rregullave teknike “për etiketimin e produkteve të qelqit kristal” dhe VKM Nr. 222/2012 “Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”. ISHMT është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut për këto produkte.

Lidhur me **armët**, prioriteti për Shqipërinë ka qenë, është dhe do të vazhdojë të jetë krijimi i një mjedisi më të sigurt për qytetarët e tij dhe të huaj, bizneset dhe shoqërinë në përgjithësi. Posedimi i paautorizuar i armëve të zjarrit në vendin tonë aktualisht është shqetësim, për shkak të situatës së trashëguar ndër vite, por edhe për shkak të një rritje të qarkullimit të mallrave dhe njerëzve, gjë që sjell edhe rritje të aktivitetit kriminal në fushën e armëve të zjarrit, trafikimit të paligjshëm në armë dhe municione.

Parlamenti shqiptar ka miratuar një numër ligjesh të cilat synojnë një kontroll më efektiv të armeve. Me aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimet e Ministrisë të Brendshme ose institucioneve të tjera të ngarkuara me ligj, paketa e akteve ligjore dhe nënligjore në Shqipëri është e plotë për të lejuar aktivitete të ligjshme me armë për ato kategori që plotësojnë kushtet dhe kriteret, por edhe për të penalizuar ata qytetarë që synojnë të kryejnë dhe organizojnë veprimtari të paligjshme në këtë drejtim.

Vendi ynë ka marrëveshje të mëdha ndërkombëtare për kontrollin e armëve, duke përfshirë: Traktatin e Tregtisë së Armëve, Programin e Veprimit të Armëve të Vogla dhe Armët e Lehta, Protokollin e Armëve të Zjarrit, dhe ka përqafuar nismat rajonale për të forcuar kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW), në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në të gjithë rajonin. Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është pjesërisht i përafuar me Direktivën 2014/60/BE dhe Rregulloren e Këshillit Nr. 116/2009 për sa i përket lëvizjes së lirë të pasurive kulturore. Në zbatim të ligjit, është miratuar VKM Nr. 432, datë 26.6.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”, si dhe Urdhri Nr. 136, datë 21.10.2019 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organizimit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”.

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) është përgjegjës për administrimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, me qëllim identifikimin, regjistrimin, ruajtjen dhe lidhjen në kohë reale online të këtij shërbimi me institucionet shtetërore, subjektet private (Fizike/Juridike) që posedojnë dhe administrojnë Fonde të Pasurive Kulturore për regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë për objektet pasuri kulturore në pronësi publike dhe private, shërbimin doganor të Republikës së Shqipërisë për monitorimin e lëvizjeve dhe të pronësisë së objekteve të pasurive kulturore në pronësi publike dhe private brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe me Policinë e Shtetit për shkëmbim informacioni në sistem lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore në vend dhe denoncimet nga institucionet ndërkombëtare që operojnë brenda dhe jashtë vendit, sekuestrimin e objekteve pasuri kulturore.

### *Mbikëqyrja e tregut*

ISHMT ka vijuar me aktivitetin mbikëqyrës përgjatë gjithë vitit 2022, për të garantuar vendosjen e produkteve të sigurta në tregun shqiptar dhe rritjen e nivelit të mbrojtjes së konsumatorit. Në këtë kuadër, ISHMT ka ushtruar kontrolle proaktive dhe mbi bazë ankese apo indicie nga aktiviteti mbikëqyrës, dhe konkretisht ka realizuar 2146 inspektime, në fushat e parapaketimeve, instrumenteve matës, lodrave, detergjenteve, këpucëve, tekstileve, produkteve elektrike, produkteve mekanike etj. Përgjatë këtyre inspektimeve janë kontrolluar për konformitetin me kërkesat ligjore përkatëse rreth 9275 produkte nga të cilat 703 kanë rezultuar jo në përputhje. Për shkeljet e konstatuar në treg janë marrë 237 masa administrative nga të cilat 159 gjoba, 52 paralajmërime dhe 26 masa urgjente. Si rezultat janë vendosur nën masën ndalimi i tregtimit dhe shkatërrimi i mëtejshëm për 54 produkte nga të cilat 22 artikuj lodra dhe 32 produkte elektrike, në total (3090 copë).

### *Standardizimi*

Legjislacioni në fushën e standardizimit siguron rregulla dhe procedura në përputhje me ato të përdorura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, të tilla si CEN, CENELEC, ETSI, ISO dhe IEC. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382, datë 27.06.2018 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 673, datë 10.11.2021 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 382, datë 27.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” ka transpozuar plotësisht Rregulloren e BE-së Nr. 1025/2012 “Për standardizimin evropian”.

Për periudhën shtator 2021 – tetor 2022 janë miratuar gjithsej 2 778 standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare, nga ku:

- **894** standarde të publikuara nga CEN;
- **625** standarde të publikuara nga CENELEC;
- **580** standarde të publikuara nga ETSI;

- **446** standarde të publikuara nga ISO;
- **233** standarde të publikuara nga IEC.

Janë miratuar **100%** të standardeve të harmonizuara evropiane si standarde të harmonizuara shqiptare. Janë shfuqizuar **433** standarde dhe dokumente standardizimi siç janë shfuqizuar nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardeve.

Struktura e arkivit të standardeve shqiptare, sipas origjinës së tyre, përbëhet nga: **79% e EN, 17% e standardeve ndërkombëtare (ISO / IEC), 5% standarde puro shqiptare.**

### *Akreditimi*

Në 12 janar 2021, u miratua struktura dhe organika e DPA me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 2 “Për miratimin e strukturës dhe skemës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”. Numri i personelit të DPA-së u rrit nga 14 në 20 dhe drejtoria e akreditimit u nda në dy drejtori: drejtoria e laboratorëve të testimit, kalibrimit dhe mjekësorë dhe drejtoria e organeve të certifikimit dhe inspektimit. Ndërkohë është krijuar pozicioni i menaxherit të cilësisë i cili ishte kryer deri më tani nga një anëtar i stafit të DPA-së, pozicioni i Drejtorit të drejtorisë së laboratorëve të testimit, kalibrimit dhe mjekësorë dhe pozicioni i Drejtorit të drejtorisë së organeve të certifikues dhe inspektues. Struktura e re do t’i përgjigjet më shumë nevojave të tregut për shërbimin e akreditimit. Struktura e re filloi të zbatohet në 1 mars 2021.

Pas përfundimit me sukses të vlerësimit të ndërsjelltë në Shkurt-Prill 2021, EA ka konfirmuar që Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) funksionon në përputhje me kërkesat e specifikuara (ISO/IEC 17011 dhe Rregullorja Evropiane 765/2008). EA vendosi mirëmbajtjen e statusin nënshkrues në fushat e testimit, inspektimit, certifikimit të personave dhe certifikimit të sistemeve të menaxhimit është marrë më 27 tetor 2021.

Në 26 shtator 2022, DPA është panuar anëtare nënshkruese e IAF MLA në fushën e certifikimit të personave.

Në kuadrin e procesit të derregullimit, DPA implementoi një sistem elektronik të shërbimit të akreditimit i cili përfshin aplikimin online, ngarkimin e dokumentacionit të akreditimit, dërgimin e faturave, raporteve dhe korrespondencave nga të dy palët, dhe dërgimin e certifikatës së akreditimit në OVK. Ky sistem gjithashtu parashikon: thjeshtimin e procedurave dhe kursimin e kohës për komunikim, regjistrimin në çdo kohë të ndonjë veprimi të ndërmarrë, shkurtimin e afateve të procedurës së akreditimit, dhe do të jetë një mënyrë e mirë për të kontrolluar procesin e akreditimit për të siguruar paanshmërinë

Aktualisht janë akredituar në total 102 organe të vlerësimit të konformitetit nga DPA. Shifrat e akreditimit deri në tetor 2022 janë si më poshtë:

- 48 Laboratorë testues;
- 5 laboratorë mjekësorë;

- 1 laborator kalibrues;
- 28 trupa inspektues;
- 12 trupa certifikues të personave;
- 8 trupa certifikues të sistemeve të menaxhimit.

### *Metrologjia*

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për vitin 2021 ka realizuar të ardhura në vlerë 45 075 089 lekë (pa TVSH) përkatësisht për 36 106 instrumente matës të verifikuar dhe kalibruar. Të ardhurat nga shërbimet deri në fund të tetorit të vitit 2022 janë 58 317 951 leke (pa TVSH).

Gjatë viteve 2021 – 2022 puna për harmonizimin e legjislacionit vendas me *acquis* i Bashkimit Evropian ka vazhduar dhe janë miratuar :

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 261, datë 29.04.2022 “Për njësitë e matjes”,
- Ndryshimi i Udhëzimit Nr. 1897/3, datë 03.08.2016 “Për kërkesat dhe procedurat e miratimit të sistemit për parapaketimet” i cili është miratuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 15.01.2021 të Ministrit të MFE;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 349, datë 16.6.2021 “Për miratimin e rregullores për shishet enë matëse”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 443, datë 22.7.2021 “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”.

Gjatë vitit 2021 – 2022 është rritur numri i verifikimeve dhe kalibrimeve të instrumenteve matës. Evidentohet një përmirësim i ndjeshëm i shërbimit metrologjik konkretisht në fushën e verifikimit dhe kalibrimit, duke ulur në nivelin zero, ankesat nga konsumatori dhe bizneset.

Është realizuar pjesëmarrja në Komitetet Teknike, sipas fushave përkatëse të kalibrimit dhe në vazhdimësi trajnimi i stafit teknik të institucionit.

### **Direktivat përqasjes së re**

Sa i përket harmonizimit të legjislacionit, janë miratuar aktet e mëposhtme:

- VKM Nr. 349, datë 16.6.2021 “Për miratimin e rregullores për shishet enë matëse”;
- VKM Nr. 443, datë 22.7.2021 “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”;
- VKM Nr. 925, datë 25.11.2020 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për pajisjet e aerosolit”, i cili përaftron pjesërisht Direktivën e Këshillit Evropian 75/324/KE të datës 20 Maj 1975 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me pajisjet e aerosolit;
- VKM Nr. 378 datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” i cili përaftron pjesërisht Direktivën 2014/53/EU;
- Ligji 73/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e **artikujve piroteknikë**”, i cili harmonizon pjesërisht Direktivën 2013/29/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit,

datë 12 qershor 2013 “Për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të artikujve piroteknikë”;

- Ligji 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e **lëndëve plasëse për përdorim civil**” i cili harmonizon pjesërisht Direktivën 2014/28/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

Gjatë vitit 2021 ka vijuar përafrimi i legjislacionit me acquis-në e BE-së dhe është miratuar rregulli teknik në vijim:

-Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 674, datë 10.11.2021 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP) dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, i cili përafron pjesërisht Rregulloren e (BE) 2016/425 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 09 Mars 2016 mbi pajisjet mbrojtëse personale.

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, gjatë vitit 2022 situata paraqitet si më poshtë:

Inspektorati Shtetëror për mbikëqyrjen e Tregut ka realizuar inspektime mbi:

- **Lodrat:** janë kryer 24 inspektime dhe janë marrë 12 masa administrative (6 gjobë, dhe 6 masa urgjente ndalim tregtimi dhe shkatërrim produkti). Në total janë kontrolluar 353 produkte nga të cilat 44 kanë rezultuar jo në konformitet.
- **LVD & EMC:** u kryen 246 inspektime nga Sektori i Produkteve Elektrike mbi përputhshmërinë e produkteve në lidhje me LVD dhe EMC. Gjithsej 877 produkte u kontrolluan në lidhje me Markën CE dhe në lidhje me Deklaratën e Konformitetit (pajisje shtëpiake, lavatriçe, fshesa me korrent, kondicionerë, frigoriferë, karikues, si dhe produkte të tjera të ndryshme elektrike që bien nën GPSD), nga të cilat 75 produkte nuk ishin në përputhje me konformitetin formal dhe për 32 produkte u mor masa e ndalimit të tregtimit dhe shkatërrimi tyre.) Këto produkte ishin në kategoritë e: karikuesve, ngrohësve elektrikë, llambave LED, adaptorë, kablllo zgjatues, Frigorifer etj. (Nje total prej gati 1090 njësi). Janë vendosur 57 masa administrative ku 15 të vendosura në formën e masave urgjente “Ndalimi i Përhershëm i Tregtisë dhe shkatërrimi i produkteve”<sup>40</sup> gjoba dhe 2 në formë paralajmërimi.
- **RED:** janë kryer 42 inspektime nga sektori i produkteve elektrike mbi përputhshmërinë e produkteve në lidhje me RED (Gjatë këtyre inspektimeve u kontrollua edhe përputhshmëria e produkteve të tjera elektrike që bien në direktiva të tjera). Gjithsej 357 produkte u kontrolluan për Markën CE dhe për 34 prej tyre u kërkua DoC. Të gjitha produktet u gjetën në përputhje. Asnjë masë administrative nuk është marrë.
- **Makineritë:** janë kryer inspektime në 29 subjekte. Në total janë kontrolluar 87 produkte të cilat kanë rezultuar në konformitet.
- **Ashensorët:** janë kryer 302 inspektime mbi mbi sigurinë e Ashensorëve. Në total janë kontrolluar 552 Ashensorë nga të cilat 247 rezultuan jo në konformitet dhe janë marrë 88 masa administrative (39 gjoba, 3 masa urgjente si dhe 46 paralajmërimet).

- **Pajisjet e mbrojtjes personale:** janë kryer inspektime në 8 subjekte dhe është marrë 1 masë administrative me gjobë. Në total janë kontrolluar 32 produkte nga të cilat rezultuan në konformitet.
- **Pajisjet e gazit:** ende nuk është kryer ndonjë inspektim për pajisjet me gaz. Fokusi kryesor i sektorit përgjegjës ka qenë regjistrimi i ashensorëve, dhe për faktin se nuk ka importues të mëdhenj që fokusohen tërësisht në pajisjet me gaz, në inspektimet mbi produktet e grupit të tjerë, nëse vërehen pajisje të gazta ato kontrollohen nëse përputhen me kërkesat e rregullit teknik ne fuqi. Deri në shtator 2022, asnjë produkt që bie në këtë direktivë nuk është ndaluar nga tregtimi.
- **Enët e thjeshta ne presion (SPVD):** ende nuk është kryer ndonjë inspektim për enët e thjeshta ne presion. Fokusi kryesor i sektorit ka qenë regjistrimi i ashensorëve, dhe për faktin se nuk ka importues të mëdhenj që fokusohen tërësisht në pajisjet me gaz, në inspektimet mbi produktet e grupit të tjerë, nëse vërehen pajisje të gazta ato kontrollohen nëse përputhen me kërkesat e rregullit teknik ne fuqi. Deri në shtator 2021, asnjë produkt që bie në këtë direktivë nuk është ndaluar nga tregtimi.
- **Emetimi i zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim jashtë (OND)** ende nuk është kryer ndonjë inspektim në OND. Fokusi kryesor i sektorit ka qenë regjistrimi i ashensorëve, dhe për faktin se nuk ka importues të mëdhenj që fokusohen tërësisht në OND. Gjatë inspektimeve mbi produktet e grupeve të tjerë, nëse vërehen OND ato kontrollohen nëse janë ne përputhen me kërkesat e direktivës.
- **Artikujt Piroteknik:** ende nuk është kryer ndonjë inspektim në lidhje me artikujt piroteknik. Në përdhën nëntor- dhjetor 2022, është bërë planifikimi për realizimin e inspektimeve për artikujt piroteknik, që janë në fushën e përgjegjësisë së kontrollit të ISHMT (për përdorim nga publiku).
- **Pajisjet e Aerosolit** Direktiva e pajisjeve të aerosolëve u transpozua në legjislacionin shqiptar vetëm në fund të vitit 2020 dhe inspektorët nuk kanë kryer ende asnjë inspektim për zbatimin e tij.
- **Parapaketimet:** janë zhvilluar 283 inspektime. Në total janë kontrolluar 1351 produkte, të cilat kanë rezultuar në konformitet.
- **Instrumentet e Peshimit Jo-automatik:** në Shtator 2020 kanë filluar inspektimet e para të thelluara në importues dhe prodhues të këtyre instrumenteve. Për vitin 2022 janë zhvilluar 1 inspektim produktet e të cilit kanë rezultuar në konformitet.
- **Instrumentet Matës:** në Shtator 2020 kanë filluar inspektimet e para të thelluara në importues të këtyre instrumenteve. Sektori i Inspektimit Metrologjik në ISHMT për vitin 2022 ka zhvilluar 280 inspektime edhe janë kontrolluar 1364 produkte nga të cilat 8 kanë rezultuar jo në konformitet, dhe janë vendosur 4 masa administrative në formën e gjobës
- **Shishet si enë matëse:** Sektori i Inspektimit Metrologjik në ISHMT për vitin 2022 ende nuk ka kryer ndonjë inspektim për Shishet si ene matëse. Shpesh këto inspektime kanë shkuar së bashku me ato të para-paketimit dhe informacioni është kryesisht i përzier.
- **Njësitë matëse (Units of measurements):** Sektori i Inspektimit Metrologjik në ISHMT ndër vite ka kryer inspektime për Njësitë e Matjeve, për vitin 2022 këto inspektime kanë shkuar sipas atyre të para-paketimit dhe informacioni është kryesisht i përzier. Ajo që dihet

është fakti se asnjëherë nuk është marrë një masë paralajmëruese ose korigjuese gjatë këtyre inspektimeve në njësitë e matjeve.

- **Informacioni i konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet me ndikim në energji:** Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Sektori i Produkteve Elektrike në ISHMT që ka të rekrutuar 4 nga 7 punonjës. Për zbatimin e këtij legjislacioni nuk janë zhvilluar inspektime të dedikuara, por subjektet janë informuar mbi të gjatë kontrolleve që ka zhvilluar Sektori i Produkteve Elektrike në ISHMT. Deri tani kontrollet kanë qenë vetëm mbi dokumentacionin dhe nuk është konstatuar asnjë produkt jo në konformitet por që janë udhëzuar subjektet në lidhje me afishimin e duhur të etiketave përkatëse.

## **Direktivat e përqasjes së vjetër**

Në zbatim të Ligjit 27/2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, është ngritur Zyra e Kimikateve, e cila do të ketë në përbërje të saj një strukturë 1 Përgjegjës Sektori dhe 3 Specialistë.

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, gjatë vitit 2022, janë zhvilluar inspektime nga ISHMT lidhur me **detergjentet, tekstilet, veshjet e këmbës, dhe qelqin e kristaltë:**

- **Detergjentet:** janë kryer 70 inspektime dhe janë marrë 5 masa administrative (gjobë). Në total janë kontrolluar 362 produkte nga të cilat 17 kanë rezultuar jo në konformitet.
- **Veshjet e këmbës:** janë kryer 23 inspektime Në total janë kontrolluar 403 produkte të cilat kanë rezultuar në konformitet.
- **Tekstile:** janë kryer 41 inspektime ku 24 prej tyre u realizuan me mostër marrje për kryerjen e testeve laboratorike. Rezulto se janë marrë 5 masa administrative në formën e gjobës. Në total janë kontrolluar 300 produkte nga të cilat 19 kanë rezultuar jo në konformitet.

## **Masat procedurale**

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, meqenëse ISHMT është një institucion i ri është përpjekur të menaxhojë burimet e tij njerëzore me kapacitete të vogla në dispozicion për të mbuluar fushat që janë evidentuar si më problematike dhe që kanë nevojë për veprim të menjëhershëm.

Në vitin 2020 u miratua Ligji Nr. 152/2020, datë 17.12.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 74/2014 “Për armët”. Ligji është përafuar pjesërisht me Direktivën (BE) 2017/853 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 Maj 2017 që ndryshon Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991 “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”. Gjithashtu ligji ka përaftrim të pjesshëm dhe me Rregulloren Nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 mars 2012, në zbatim të nenit 10, të protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse të tyre dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe që vendos masat për autorizimin e importit, eksportit dhe transitit të armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse të tyre dhe municioneve.

Ministria e Brendshme në vitin 2021 ka draftuar dhe miratuar 7 akte nënligjore në zbatim të Ligjit 74/2014 “Për armët” në lidhje me procedurat licencimit të veprimtarive të lejuara me armët, rregullat e sigurisë për armët, regjimin e hyrje/daljes dhe markimit të armëve të zjarrit etj. Duke rregulluar aspekte procedurale dhe harmonizuar më tej legjislacionin në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta me atë të Bashkimit Evropian. Këto vendime janë si më poshtë vijon:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 269, datë 12.5.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 94, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për armët, në rastet e deklarimit të vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”;
2. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 270, datë 12.5.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 96, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe paaftësisë për armët e koleksionit”;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 271, datë 12.5.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 275, datë 01.04.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e sigurisë armëve”;
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 272, datë 12.5.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 348, datë 29.04.2015 “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në territorin e Republikës së Shqipërisë”;
5. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 289, datë 19.5.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 95, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme”;
6. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 303, datë 26.5.2021 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit”;
7. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 462, datë 30.7.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”.

Përgjatë vitit 2022, në zbatim të Konventës së UNESCO 1970 “Për mjetet e ndalimit dhe parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurive kulturore”, Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, kanë kryer proceset si vijon:

1. Nënshkrimi i Memorandum Mirëkuptimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për një periudhë 5 vjeçare, në lidhje me vendosjen e kufizimeve të importit për kategoritë e materialeve arkeologjike dhe etnografike të Shqipërisë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në përputhje me legjislacionin e tyre, përfshirë edhe Aktin për Zbatimin e Konventës për Pasurinë Kulturore, do të kufizojnë importimin në Shtetet e Bashkuara të kategorive të caktuara të materialeve arkeologjike, që datojnë nga 300,000 vite më parë deri në vitin 1750 P.K. dhe kategori të caktuara të materialit etnologjik, që datojnë për afërsisht nga viti



400 P. K. deri në vitin 1913, të cilat mund të përfshijnë kategori të elementeve arkitekturore nga strukturat historike ose fetare; objekte funerale; objekte rituale dhe ceremoniale; piktura; dokumente të shkruara; tekstile; si edhe armë e parzmore të identifikuar në listën që do të shpallet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

- Në kuadër të këtij Memorandumi Bashkëpunimi në datat 24 prill 2022 – 14 maj 2022 u zhvillua në SHBA Programi i Lidhshimit të Vizitorit Ndërkombëtar “Combating Trafficking of Cultural Property” organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Ky program shërbeu si një praktikë e vlefshme ndërkombëtare në fushën e antitrafikut të pasurive kulturore.
2. Në kuadër të procesit gjyqësor të vitit 2013 në të cilin u sekuestruan një numër i konsiderueshëm ikonash, nga Republika e Maqedonisë së Veriut u ngrit pretendimi se 20 ikona i përkisnin kishave të Maqedonisë. Pas verifikimi të kryer u arrit në konkluzionin se origjina e ikonave ishte nga kishat e Maqedonisë dhe sot jemi në procesin e rikthimit të tyre ndërmjet një marrëveshje dypalëshe me Maqedoninë e Veriut, e cila pritet të nënshkruhet në fillim të vitit 2023.

Gjithashtu Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore janë përfituese të projektit “Support to the Ministry of Culture to advance in the approximation of the National legal Framework on cultural heritage with EU Acquis heritage with EU Acquis”. Synimi i këtij projekti është dhënia e kontributit për përafrimin e Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë” në përputhje me EU *acquis*, në nenet që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së IKRTK dhe lidhen me identifikimin, mbrojtjen, tregtimin, importin dhe eksportin e pasurive kulturore.

- Sugjerimi kryesor i eksperteve të projektit është amendimi i ligjit, konkretisht neni 121 që lidhet me qarkullimin ndërkombëtar të pasurive kulturore dhe nenet 125, 128, 129 që parashikojnë procedurat e importit dhe eksportit të pasurive kulturore.

**Sa i takon ngritjes së kapaciteteve të anëtarëve të GNPIE-së**, më mbështetjen e projektit SANECA/GIZ në bashkëpunim me ASPA dhe zbatim nga College of Europe, gjatë vitit 2022, u organizuan 11 trajnime për anëtarët e GNPIE (mars – tetor 2022). Trajnimet trajtuan tema të tilla si: kuadri dhe parimet e përgjithshme të lëvizjes së lirë të mallrave, negociatat e anëtarësimit në kapitull, institucionet dhe organizmat relevante, si dhe *acquis* e BE-së lidhur me fushën e paharmonizuar, çështjet horizontale, infrastruktura e cilësisë, si dhe një sërë aktesh që mbulojnë disa prej produkteve nën këtë fushë. Objektivi kryesor i trajnimeve ishte forcimi i njohurive për kërkesat e *acquis* dhe pasja e një panorame më të qartë lidhur me procesin e negociatave. Në trajnime morën pjesë rreth 65 anëtarë të GNPIE-ve.

Lidhur me përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e përgatitjes së negociatave për integrim në Kapitullin 1 përmes tryezës përkatëse të konsultimit të ngritur në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar në total 7 aktivitete të natyrës informuese/trajnuese dhe konsultuese. Ndër më të rëndësishmit kanë qenë takimet e zhvilluara me mbështetjen e projektit SANECA mbi metodologjinë e re të hartimit dhe monitorimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian, masat e planifikuara për të harmonizuar rregullat e reja të BE-

së për tregtimin e produkteve jo-ushqimore dhe mbikëqyrjen e tregut, takimet informuese mbi rregullat e reja teknike për parapaketimet, shishet enëmatëse dhe pajisjet me presion të ulët, të harmonizuara me direktivat përkatëse të Komisionit, etj.

Në aktivitetet e organizuara, përveç anëtarëve të Platformës për kapitullin 1 janë ftuar edhe përfaqësues të sektorit privat si p.sh: operatorë ekonomikë dhe shoqata biznesi. Në aktivitetet me karakter informues/trajnuar janë ftuar edhe ekspertë të fushës përkatëse dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga vendet e rajonit për të ndarë përvojën e tyre dhe mësimet e mësuara gjatë procesit të përgatitjes së negociatave për çështjet në fjalë, si dhe për rëndësinë që dialogu social ka në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave.

### 1.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministër Shteti dhe Kryenegociator
- Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit
- Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit
- Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Inspektorati Shtetëror, Teknik dhe Industrial
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Brendshme/ Policia e Shtetit
- Ministria e Kulturës
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

### 1.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

#### **Parimet e përgjithshme**

Sa i përket fushës së pabarmonizuar dhe aplikimit të parimeve të parashikuara nga nenet 34 – 36 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian, Shqipëria ende nuk ka një plan të plotë veprimi për heqjen e masave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore për tregtinë në mallra, detyrim ky që rrjedh drejtpërdrejt nga MSA. Megjithatë, faza e parë e këtij Plani Veprimi ka përfunduar me analizën e 18 produkteve/sectorëve. Prioritet në këtë fushë mbetet vijimi i fazës së dytë duke synuar vlerësimin dhe shqyrtimi e barrierave për të gjithë produktet.

Ndërkohë dy rregulloret kyçe më këtë fushë lidhur me njohjen e ndërsjellë të produkteve të tregtuara ligjërisht në një shtet tjetër anëtar (Rregullorja 2019/515) dhe me shkëmbimin në kohë reale të informacionit ndërmjet shteteve anëtare në rastet e ekzistencës së pengesave që mund të pengojnë lëvizjen e lirë të mallrave (Rregullorja Strawberry 2679/98), nuk janë të harmonizuara në legjislacionin tonë, duke qenë se ato janë relevante pas anëtarësimit në BE. Gjithsesi, masat paraprake që mund të ndërmerren paraprakisht do të jenë pjesë e Planit të Veprimit, për të bërë të mundur përgatitjen në avancë të strukturës institucionale që do të jetë përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që përcaktojnë këto rregullore.

Në përfundim të analizës së mangësive ligjore dhe institucionale të finalizuar nga GNPIE e kapitullit 1, lidhur me VKM nr. 378 datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” i cili përfron pjesërisht Direktivën 2014/53/EU, është rekomanduar amendimi i saj me qëllim transpozimin më të mirë të pikës 3, të nenit 21 të Direktivës 2014/53/EU.

### **Çështjet horizontale**

Në përfundim të hartimit të Roadmap-it në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, i cili përcakton masat ligjore dhe institucionale afatmesme dhe afatgjatë për harmonizimin e plotë në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, prioritet në periudhën në vijim mbetet zbatimi i tij sipas planifikimeve dhe monitorimi i tij për të evituar vonesa dhe mangësi.

### **Përqasja e re**

Sa i përket përqasjes së re, rreth 37 % e akteve të *acquis* që bien në këtë nënkapitull nuk janë të transpozuara ende në legjislacionin shqiptar (p.sh. *acquis* që lidhet me pajisjet dhe sistemet në ambiente potencialisht shpërthyes, instalimet teleferike të projektuara për transport personash, produktet e ndërtimit, pajisjet e thjeshta nën presion, pajisjet e gazit etj.). Me qëllim arritjen e një shkalle më të lartë të transpozimit, mbështetur edhe në rekomandimet e dhëna në Raport Progresin për Shqipërinë, nevojitet vijimi i punës për përafrimin e *acquis* në këtë nënkapitull. Gjithashtu, nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, si përmes shtimit të numrit të stafit, ashtu edhe ndërmarrjes së masave për rritjen e ekspertizës nëpërmjet trajnimeve apo instrumenteve të tjera, në strukturat e ngarkuara me hartimin dhe monitorimin e legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

### **Përqasja e vjetër**

Sa i përket përqasjes së vjetër, rreth 50% e akteve të *acquis* që bien në këtë nënkapitull nuk janë të transpozuara ende në legjislacionin shqiptar (p.sh. *acquis* që lidhet me mjetet motorike, praktikat e mira laboratorike, prekursorët e drogave). Me qëllim arritjen e një shkalle më të lartë të transpozimit, mbështetur edhe në rekomandimet e dhëna në Raport Progresin për Shqipërinë, nevojitet vijimi i punës për përafrimin e *acquis* në këtë nënkapitull. Gjithashtu, nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, si përmes shtimit të numrit të stafit, ashtu edhe

ndërmarrjes së masave për rritjen e ekspertizës nëpërmjet trajnimeve apo instrumenteve të tjera, në strukturat e ngarkuara me hartimin dhe monitorimin e legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

## **Masat procedurale**

Sa i përket masave procedurale, rreth 35% e akteve të *acquis* që bien në këtë nënkapitull nuk janë të transpozuar ende në legjislacionin shqiptar (p.sh. *acquis* që lidhet me informacionin mbi rregulloret teknike, transparenca e çmimeve të produkteve farmaceutike etj.). Me qëllim arritjen e një shkalle më të lartë të transpozimit, nevojitet vijimi i punës për përafrimin e *acquis* në këtë nënkapitull. Gjithashtu, nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, si përmes shtimit të numrit të stafit, ashtu edhe ndërmarrjes së masave për rritjen e ekspertizës nëpërmjet trajnimeve apo instrumenteve të tjera, në strukturat e ngarkuara me hartimin dhe monitorimin e legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Mbështetur në dokumentin “Analiza e mangësive institucionale dhe administrative (IAGA)”, janë evidentuar mangësitë në kapacitetet institucionale, kryesisht për arsye të numrit të limituar të stafit të strukturës së ngarkuar me çështjet e lëvizjes së lirë të mallrave, megjithëse së fundmi (Shtator 2022) është miratuar struktura e re dhe krijohet një drejtori për tregun e brendshëm, ku për çështjet e lëvizjes së lirë të mallrave parashikohet krijimi i një sektori të veçantë. Plotësimi i stafit parashikohet të kryhet gjatë viteve 2023-2024. Aktualisht, deri në plotësimin e strukturës së re, numri i punonjësve që vijnë të mbulojnë çështjet e lëvizjes së lirë të mallrave të Kapitullit 1 dhe mbrojtjes së konsumatorëve të Kapitullit 28, mbetet 3.

## **Prioritetet:**

- Vijimi i punës për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit të pabarmonizuar të BE-së;
- Vijimi i fazës së dytë të Planit të Veprimit për përputhshmërinë me nenet 34 – 36 TFBE, për eliminimin e masave me efekt të njëjtë me kufizimet sasiore (Planit të Veprimit në fushën e pabarmonizuar)
- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve zbatuese dhe në veçanti të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut;
- Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit, përmes funksionimit të Tryezës së Rrumbullakët për Kapitullin 1, tashmë të ngritur në kuadër të Platformës së Partneriteti për Integrimin Evropian;
- Rritja e kapaciteteve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, lidhur me përfundimin e fazës screening dhe me tej me procesin e bisedimeve të anëtarësimit për Kapitullin 1;
- Legjislacioni për produktet e mbrojtjes dhe prokurimin nuk është i përafruar me *acquis*-në.

## **Masat ligjore të planifikuara 2023 – 2025**

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e gazit dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, që synon përafrimin e

pjesshëm me Rregulloren (BE) 2016/426 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 9 Mars 2016 mbi pajisjet e gazit. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2023;**

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e inspektimit dhe verifikimit të praktikës së mirë laboratorike”, që synon përafrimin e pjesshëm me Direktivën 2004/9/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Shkurt 2004 mbi inspektimin dhe verifikimin e praktikës së mirë laboratorike (GLP). **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024;**
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, që synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren BE 2019/1020 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 Qershor 2019 mbi mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2025;**
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, që synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren BE 2019/1020 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 Qershor 2019 mbi mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve, si dhe Rregulloren BE 2019/515 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 19 Mars 2019 mbi njohjen reciproke të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024;**
- Projektligji “Mbi përcaktimin e autorizimeve të eksportit, dhe masat për importin, transitin e armeve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve”, i cili synon harmonizimin e Rregullores 258/2012. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024;**
- Projekt Ligji “Për produktet e ndërtimit” i cili synon harmonizimin e pjesshëm të Rregullores 305/2011 mbi përcaktimin e kushteve të harmonizuara për tregtimin e produkteve të ndërtimit dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 89/106/KEE; **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024;**
- Projekt VKM për një ndryshim në VKM nr. 378 datë 5.6.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” i cili përafuron pjesërisht Direktivën 2014/53/EU, me qëllim transpozimin më të mirë të pikës 3, të nenit 21 të Direktivës 2014/53/EU. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2023;**
- Projektligji “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10216/2010 “Për detergjentët”Sa i takon **detergjenteve**, i cili përafuron pjesërisht Rregulloren 648/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 mars 2004 mbi detergjentët. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024;**
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse”. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2023.**

## KAPITULLI 2: LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE

### 2.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve parashikon që qytetarët e një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar, duke u mundësuar atyre të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët vendas. Lëvizja e lirë e personave bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati mbi Funkionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Këto parime përfshijnë heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të punëtorëve, qasjen e barabartë në tregun e punës dhe ndalimin e diskriminimit. *Acquis* në këtë kapitull parashikon që shtetasit e BE-së kanë të drejtë të lëvizin dhe të punojnë në vende të tjera anëtare të BE-së, të qëndrojnë aty për këtë qëllim së bashku me familjet e tyre dhe të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët kombëtarë sa i përket kushteve të punës, si dhe çështjeve sociale dhe tatimore. Për më tepër, *acquis* përfshin instrumentet e BE-së për koordinimin e sistemeve të ndryshme kombëtare të sigurisë sociale.

### 2.2 Struktura e kapitullit

- Aksesit në tregun e punës;
- Bashkëndimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

### 2.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit përmban detyrime të shumta, që burojnë nga dispozitat e neneve 48 dhe 49 të MSA, në fushën e qasjes në tregun e punës për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, lëvizjen e punëtorëve, kushtet e punësimit dhe trajnimit profesional. Aspekte të tjera të lëvizjes së lirë të punëtorëve kanë të bëjnë me promovimin e shkëmbimeve rinore dhe përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për punësimin dhe formimin profesional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon që, në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme, Shqipëria dhe Shtetet Anëtare të BE-së të sigurojnë që shtetasit e vendit partner të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e tyre nuk janë objekt diskriminimi, për sa i përket kombësisë, kushteve të punës, shpërblimit apo pushimit nga puna.

Detyrimi i Shqipërisë për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore buron nga nenet 48 e 99 të MSA-së. Nenet 46, 47, 49, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 70 MSA përcaktojnë shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e aksesit në tregun e punës për qytetarët e BE-së.

Trajtimi i punëtorëve që janë shtetas shqiptarë dhe të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar rregullohet sipas Neneve 46 dhe 47 të MSA.

#### 2.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Në dokumentin “Raporti për Shqipërinë 2022” të Komisionit Evropian për kapitullin 2 “Liria e lëvizjes së punëtorëve”, Shqipëria ka arritur një farë niveli të përgatitjes. Progres është bërë në këtë fushë, veçanërisht me lëvizjen e lirë të anëtarëve të familjes së qytetarëve të BE-së; në forcimin e marrëveshjeve dypalëshe të sigurimeve shoqërore dhe në përgatitjen për t’u bashkuar me Rrjetit Evropian të Punësimit (EURES) pas aderimit.

##### *Aksesi në tregun e punës*

Shtetasit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (BE) kanë të drejtë të punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa patur detyrimin të pajisen më parë me një miratim për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Kjo mundësohet nga dispozitat e ligjit për të huajt dhe akteve të tij nënligjore, të cilat parashikojnë se shtetasit e Shteteve Anëtare të BE ose vendi Shengen nuk kanë detyrimin të pajisen me një miratim për punësim nga AKPA apo me një miratim për vetëpunësim, në mënyrë që të punojnë në tregun e punës në vend.

Përshtatshmëria e skemave të sigurimeve shoqërore dhe njohja e pensioneve profesionale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe. Politikat e pranimit të emigrantëve nuk vendosin pengesa ndaj vendbanimit të përhershëm të familjarëve të punëtorëve nga vendet e BE-së.

Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me detyrimet e integritit evropian në kuadër të kapitullit 2, synon të krijojë mundësi për qasje të barabartë dhe pa diskriminim në tregun e punës, formimit profesional, lëvizjes së punëtorëve të BE, si dhe kushteve të punësimit, njësoj si shtetasit shqiptarë.

Shtetasit e Shteteve Anëtare të BE dhe vendeve të zonës Shengen, në zbatim të ligjit Ligji 79/2021 për të huajt, përjashtohen nga kufizimet e kuotave numerike që vendos ligji për hyrjen e shtetasve të huaj në tregun e punës në vend.

Ligji 79/2021 “Për të huajt”, Ky ligj ,synon përafrim me *acquis* e BE në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve dhe imigrimit për motive punësimi. Një risi e këtij ligji ishte bashkimi i dy lejeve dhe procedurave për qëndrimin dhe punësimin e të huajve në vend në një leje unike. Me miratimin e ligjit të ri 79/2021 “Për të huajt”, institucionet shqiptare (Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë) kanë filluar punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i cili përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, programet aktive dhe pasive të tregut të punës dhe

organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Sipas këtij ligji, shtetasit e BE-së që hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime punësimi, kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbimet e ofruara në strukturën rajonale/lokale. (Neni 4). Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, e ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 554, datë 31.4.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, siguron përmbushjen e këtyre të drejtave.

Ligji nr. 7961/1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet edhe ndaj shtetasve të BE dhe anëtarëve të familjeve të tyre njësoj si për shtetasit shqiptarë për çështje që lidhen me punësimin e tyre dhe marrëdhëniet e punës, të cilat nuk mbulohen nga ligji 108/2013 për të huajt (neni 4). Sipas nenit 9 të këtij Kodi, : “1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët....”.

Në shkurt të vitit 2022 Shqipëria iu bashkua vendeve që kanë ratifikuar Konventën C190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 2019(NR.190). Kjo konventë pranon të drejtën e gjithsecilit për një botë pune pa dhunë dhe ngacmim, duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin me baza gjinore. Me ratifikimin e kësaj Konvente me qëllim parandalimin dhe eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, çdo anëtar respekton, promovon dhe realizon parimet dhe të drejtat themelore në punë, lirinë e shoqërimit dhe njohjen efektive të së drejtës së negociatave kolektive, eliminimin e të gjitha formave të punës me forcë apo të detyruar, eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin si dhe promovimin e punës së denjë.

Lidhur me përgatitjen për t’iu bashkuar EURES (Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit), Shqipëria ka krijuar një databazë të integruar për sistemin e shërbimit të punësimit. Kjo do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet departamenteve TI të gjendjeve civile, të sistemit tatimor, sistemit të kujdesit të detyrueshëm shëndetësor dhe sistemit të ndihmës ekonomike.

Me qëllim përgatitjen e Shqipërisë për t’iu bashkuar ELA (European Labour Authority) dhe në kuadër të projektit të ILO-s “Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale 2- ESAP II”, i cili fokusohet në shkëmbimin e përvojave ndërmjet Inspektorateve të Punës të Ballkanit Perëndimor, me fokus punën e padeklaruar, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ky bashkëpunim ka konsistuar në kryerjen e inspektimeve të përbashkëta, pjesëmarrje në konferenca të përbashkëta në kuadër të Javës Evropiane të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë,



shkëmbim përvojash në fushën e inspektimit të punës dhe legjislacionit rregullator në fuqi, vizitave vlerësuese ndërmjet Inspektorateve të Punës ku u plotësua një pyetësor lidhur me bazën ligjore, funksionin dhe procedurën si dhe fushëveprimin e punës së Inspektorateve të Punës.

Qytetarët italianë, të cilët përbëjnë numrin më të madh të qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës, janë të punësuar kryesisht në fushën e mjekësisë, shërbimeve, marketingut, tregtisë, industrisë përpunuese, informacionit dhe telekomunikacionit. Qytetarët rumunë, të cilët janë grupi i dytë më i madh i qytetarëve të BE-së që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, janë të punësuar kryesisht në fushën e tregtisë dhe shërbimeve dhe call centers.

Me qëllim përmirësimit të kushteve të punës së punonjësve, me urdhër të Kryeministrit më 24 nëntor 2020 u miratua struktura e re e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, një organ që kontrollon zbatimin e legjislacionit të punës në subjektet që veprojnë në Republika e Shqipërisë.

Kjo strukturë solli një rritje të stafit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si dhe një riorganizim të tij, ku një vend të veçantë zë krijimi i Sektorit të Analizës së Riskut, ku pjesë e punës së tij përfshin analizën e riskut, procesin e menaxhimit të riskut për planifikimin dhe monitorimin e inspektimit në terren.

Centralizimi i procesit të analizës së riskut do të mundësojë organit të inspektimit të punës , një pamje të qartë të risqeve si dhe ndërmarrjen e strategjive të duhura.

*Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore*

Koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, në pajtim me Nenin 48 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, MFE ka ndërmarrë angazhimin për të koordinuar skemat e sigurimeve shoqërore, për të siguruar lirinë e lëvizjes së shtetasve shqiptarë dhe gjithashtu të drejtën e punëtorëve për të mbrojtur dhe garantuar me elementet e sigurimeve shoqërore. Procesi i koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore me vendet e tjera është një nga angazhimet thelbësore për t'u bërë pjesë e familjes evropiane.

Marrëveshjet dypalëshe mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve përkatëse janë ratifikuar dhe kanë hyrë në fuqi me: Republikën Turke, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Dukatin e Madh të Luksemburgut, Hungarinë, Republikën Çeke, Republikën Federale të Gjermanisë , Mbretërinë e Belgjikës, Republikën e Austrisë dhe Bullgari.

Me Republikën e Kosovës marrëveshja u ratifikua nga parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 23, datë 10.3.2022 dhe hyri në fuqi më 01.07.2022 si dhe me Kanadanë marrëveshja u ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 58, datë 12.09.2019 dhe hyri në fuqi më 01.08.2022.

Priten të hyjnë në fuqi marrëveshjet dypalëshe me:

- Rumaninë, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 42 datë 14.04.2016;

Marrëveshja me Konfederatën Zvicerane, u ratifikua nga parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 59, datë 05.08.2022 dhe jemi në pritje të hyrjes në fuqi.

Marrëveshja me Republikën e Bullgarisë është miratuar në parim me VKM Nr. 820, datë 24.12.2021, dhe jemi në pritje të një date nga pala bullgare për nënshkrimin e marrëveshjes.

Me Republikën e Italisë u mbajt raundi i parë i negociatave në Tiranë, në datë 25 – 26 Korrik 2022. Marrëveshja u parafirmos dhe u miratua në parim me VKM nr. 634, datë 30.9.2022. Jemi në pritje të një date për nënshkrimin e marrëveshjes nga pala Italiane.

Me Republikën e Greqisë u mbajt një takim paraprak prezantues për skemat e sigurimeve shoqërore në datat 6-7 Shtator 2022 në Athinë.

Me Republikën Kroate u mbajt raundi i parë i negociatave në Tiranë, në datat 21-22 Shtator 2022. Raundi i dytë do të mbahet në dhjetor 2022 në Zagreb, Kroaci.

Republika e Shqipërisë ka shprehur interesin për iniciimin e diskutimeve paraprake me Holandën, Suedinë, Norvegjinë, Danimarkën, Finlandën, Francën, Spanjën, Slloveninë, Serbinë, Poloninë, Anglinë, Moldavinë dhe Izraelin për të patur një marrëveshje në fushën e Sigurimeve Shoqërore.

#### *Aksesi në tregun e punës*

Me VKM-në Nr. 659/2019 u miratuan në tetor 2019 “Strategjia për Punësimin dhe Aftësitë” dhe Plani i saj i Veprimit. Vizioni i Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive është: “Aftësi më të larta dhe punë më e mirë për të gjithë gratë dhe burrat”. Strategjia rishikoi treguesit deri në vitin 2022, duke u bazuar në të dhëna të konfirmuara nga bashkëpunimi i ngushtë me INSTAT. Për më tepër, Plani i Veprimit 2019 – 2022 dhe treguesit për zbatimin e tij, detajojnë buxhetin e planifikuar për secilën masë, në bashkëpunim dhe me kontributin e donatorëve. Secila masë do të zbatohet nga mbështetja e parashikuar në SRC, si dhe nga projektet e donatorëve që janë duke u zbatuar, si dhe nga projektet e aprovuara që do të fillojnë të zbatohen.

Qëllimi i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS 2019-2022) dhe planit të saj të veprimit është të promovojë vende pune cilësore dhe mundësi për të gjithë gratë dhe burrat shqiptarë gjatë ciklit të tyre jetësor. Ky qëllim synohet të realizohet nëpërmjet një sërë veprimesh plotësuese dhe të ndërlidhura që mbështesin njëkohësisht ofertën e punës dhe inkurajojnë kërkesën për punë, si dhe adresojnë çështjet e përfshirjes sociale. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (NESS) 2019-2022, dhe plani i veprimit përkatës është në vitin e fundit të zbatimit.

Është në proces hartimi i Strategjisë së re Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030 dhe objektivi kryesor i saj është identifikimi dhe hartimi i politikave të përshtatshme nxitëse në vend për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore me qëllim krijimin e punësimit cilësor dhe trajnimit të vazhdueshëm për të gjithë. Plani i veprimit do të fokusohet në mundësimin e punësimit të denjë përmes zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës dhe zhvillimit

të aftësive dhe përputhjen më të mirë të kërkesës me ofertën në tregun e punës për punësim më të lartë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), si institucioni udhëheqës në procesin e zbatimit të Strategjisë, koordinon punën e saj me strategjitë dhe politikat e tjera sektoriale për të arritur ndikim të rëndësishëm në tregun e punës. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (NAVETQ) dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISSHSHP) janë institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësimit. Përveç kësaj, MFE-ja koordinon ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHSP), Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe institucione të tjera përkatëse.

Miratimi i ligjit 79/2021 “Për të huajt” dhe miratimi i akteve nënligjore të poshtëshënuara:

- Urdhër nr. 178, datë 22.6.2022 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit Vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si investitor”;
- Urdhër nr. 180, datë 22.6.2022 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit Vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si i vetëpunësuar”;
- Udhëzim nr. 19, datë 22.6.2022 “Për deklarin për punësim”;
- Udhëzimin nr. 18, datë 22.6.2022 “Për miratimin e procedurave të bashkëpunimit ndërinstytucional për përcaktimin e kuotave për punësim”.

Në bashkëpunim me ministrinë e tjera ndër të cilat më kryesore Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme janë në përfundim aktet e tjera nënligjore.

Në dispozitat e ligjit 79/2021 “Për të huajt”, është synuar përafrim më i plotë me nenet 23 dhe 24 të Direktivës 2004/38/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 29 prillit 2004 mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të Shteteve Anëtare duke ndryshuar Rregulloren (KEE) Nr. 1612/68/360/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE, dhe 93/96/KEE.

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.

Ndryshimi i programeve të nxitjes së punësimit dhe shërbimeve të punësimit, është realizuar nëpërmjet miratimit të 5 (pesë) vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe 8 (tetë) programeve, përfshirë edhe programet për të nxitur punësimin e personave të dalë të papunë për shkak të COVID-19.

Me qëllim përmirësimit të kushteve të punës të punëmarrësve, me urdhër të Kryeministrit në 24 nëntor 2020 u miratua struktura e re e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si organ që kontrollon zbatimin e legjisllacionit të punës në subjektet që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë.

Kjo strukturë solli rritje të stafit të SLISS si dhe një riorganizim të saj, ku një vend të posaçëm zë krijimi i Sektorit të Analizës së Riskut, i cili pjesë të punës së tij ka analizën e riskut, procesin e menaxhimit të risqeve për planifikimin dhe monitorimin e punës inspektuese të terrenit.

Procesi i analizës së Riskut duke qenë i centralizuar do të sigurojë që trupa inspektuese e punës të ketë një pamje të plotë të risqeve dhe të ndër marrë strategjitë e duhura.

### *Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore*

Lidhur me shtetet e mëposhtme, statusi i lidhjes së marrëveshjeve, paraqitet sa vijon:

- **Bullgaria** – u miratuar në parim me VKM Nr. 820, datë 24.12.2021 dhe jemi në pritje të një date nga pala bullgare për nënshkrimin e marrëveshjes;
- **Italia** - u miratua në parim me VKM nr. 634, datë 30.9.2022. Jemi në pritje të një date për nënshkrimin e marrëveshjes nga pala Italiane;
- **Greqia** – me takime paraprake prezantuese;
- **Kroacia** - raundi i parë i negociatave u mbajt në Tiranë, në datat 21-22 Shtator 2022. Raundi i dytë do të mbahet në dhjetor 2022 në Zagreb, Kroaci;
- **Mali i Zi** – është shprehur interesimi i palës malazeze për hapjen e bisedimeve për dakordësimin e një marrëveshjeje dypalëshe.

Në përgjithësi kuadri ligjor nuk është ende plotësisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së.

### 2.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

### 2.6 Mangësitë e Identifikuara dhe prioritet

Në vijim të miratimit të ligjit 79/2021 Për të huajt, lind nevoja e përshtatjes të akteve nënligjore me ligjin e ri, si dhe e trajnimeve të punonjësve të AKPA dhe hartimit të manualeve për zbatimin e duhur të legjislacionit në fuqi.

Nevojitet një analizë e përditësuar e mangësive ligjore dhe institucionale për aktet ligjore të këtij kapitulli me legjislacionin vendas, trajnime të punonjësve të institucioneve të përfshira në përafrimin e legjislacionit të këtij kapitulli dhe takime periodike të GNP së këtij kapitulli. Në lidhje me aksesin në tregun e punës, është e nevojshme analiza sektor për sektor lidhur me aksesin e shtetasve të BE në to dhe barrierat që ekzistojnë. Duke parë që punonjësit e Sektorit të Politikave të Punësimit dhe Migratore janë të angazhuar edhe në kapituj të tjerë, asistenca me ekspertizë dhe burime njerëzore në këtë drejtim është e nevojshme

Fokusi kryesor i Institucioneve të Qeverisë Shqiptare është:

- Të përafrojnë legjislacionin e BE-së për lëvizjen e lirë të punëtorëve dhe të vijojë përmisimi i mëtejshëm i sistemit IT të shërbimeve të Punësimit që të krijojë mundësinë e lidhjes me EURES. Kjo do të thotë se qytetarët e BE-së do të kenë akses për punësim në Shqipëri dhe do të trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit shqiptarë në aspektin e punësimit, kushtet e punësimit, shpërblimit, studimit dhe formimit profesional.
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi në fushën e të huajve, punësimit, formimit e arsimit profesional si dhe i kushteve të punës dhe marrëdhënieve të punës, për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, si dhe te punojë në përafrimin e vazhdueshëm të tij me *acquis* në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve.

Në adresim të rekomandimeve të Komisionit Evropian, Qeveria shqiptare ka përqendruar përpjekjet e saj në koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore për qytetarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, si dhe punëtorët e Shteteve Anëtare të BE-së të punësuar në Shqipëri. Kjo përfshin nënshkrimin e marrëveshjeve të mbrojtjes sociale me shumë vende. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punëve të Jashtme po punon për të forcuar koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me vendet ku ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve shqiptarë, veçanërisht në Itali dhe Greqi. Për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore ekzistojnë marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me: Belgjikën, Republikën Çeke, Gjermaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Austrinë, Rumaninë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kanadanë, Kosovën dhe Turqinë.

## KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

### 3.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë të **drejtën e vendosjes** (themelimit) të qytetarëve dhe personave juridikë të BE-së në të gjitha Vendet Anëtare dhe që **liria për të ofruar shërbime ndërkufitare**

të mos pengohen nga legjislacioni kombëtar, me disa përjashtime të përcaktuara në Traktat. *Acquis* gjithashtu harmonizon rregullat për profesionet e rregulluara për të siguruar **njohjen të ndërsjellë të kualifikimeve profesionale** ndërmjet Vendeve Anëtare: për disa profesione të rregulluara, duhet të duhet të respektohen kushtet minimale të formimit, të harmonizuara në BE, në mënyrë që titulli profesional të njihet automatikisht në një shtet anëtar të BE-së, të ndryshëm nga ai në të cilin është fituar kualifikimi. Në fushën e **shërbimeve postare**, *acquis* synon të hapë sektorin postar ndaj konkurrencës në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një kuadri rregullator që siguron detyrimin e shërbimit universal.

### 3.2 Struktura e kapitullit

- E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve;
- Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale;
- Shërbimet postare.

### 3.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Nenet e MSA-së që kanë lidhen me këtë kapitull janë: 50, 57, 58, 70 dhe 100.

Neni 50 kërkon që Shqipëria të lehtësojë krijimin e veprimtarisë në territorin e saj nga kompanitë dhe shtetasit e Komunitetit (duke përfshirë filialet dhe degët), duke u dhënë atyre trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u akordohet kompanive të saj ose ndonjë kompanie të vendeve të treta, cilido qoftë regjimi më i favorshëm. Neni 57 kërkon që të dy palët të ndërmarrin hapat e domosdoshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga kompanitë përkatëse ose shtetasit të cilët janë themeluar në një palë të ndryshme nga ajo e palës për të cilin shërbimet janë të destinuara. Në hap me këtë proces liberalizimi, palëve u kërkohet të lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë që ofrojnë shërbime ose që janë të punësuar nga ofruesi i shërbimit si personel kyç. Neni 58 kërkon që Shqipëria të mos vendosë ndonjë masë apo të ndërmarrë ndonjë veprim të ri që bën që kushtet për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit e BE-së të jenë më strikte në krahasim me situatën ekzistuese përpara hyrjes në fuqi të MSA-së.

Sipas neni 70 të MSA-së, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së, si dhe të sigurojë që si legjislacioni ekzistues ashtu dhe ai i ardhshëm të zbatohet siç duhet.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se e drejta e vendosjes e shtetasve dhe personave juridikë të BE-së në çdo Shtet Anëtar dhe liria për të ofruar shërbime ndërkuftare, siç parashikohen në nenin 49 dhe 56 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE) nuk pengohen nga legjislacioni kombëtar, me disa përjashtime të përcaktuara në Traktat.

*Acquis* kyç në këtë fushë është Direktiva 2006/123/KE për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve). Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GjED) në lidhje me nenet 49 dhe 56 është gjithashtu pjesë e *acquis*.

*Acquis* në këtë kapitull është i një natyre horizontale dhe mund të ndahet në tre fusha të përgjithshme:

- i) E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime (nenet 49 dhe 56 të TFBE dhe Direktiva e Shërbimeve);
- ii) Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale (kryesisht Direktiva 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale, e ndryshuar së fundmi nga Direktiva 2013/55/KE – Direktiva e Kualifikimeve Profesionale);
- iii) Shërbimet postare (kryesisht Direktiva 97/67/KE mbi rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, e ndryshuar – Direktiva e Shërbimeve Postare) çka përbëhet nga një kuadër rregullator specifik për sektorin që garanton ofrimin e shërbimeve postare universale dhe krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare.

Lidhur me të *drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime (ndërkufitare)*, Direktiva e Shërbimeve përmban dispozita që synojnë lehtësimin e ofrimit të shërbimeve si dhe ofrimin e shërbimeve të përkohshme ndërkufitare në një Vend tjetër Anëtar. Direktiva është një instrument horizontal që mbulon një gamë të gjerë shërbimesh të ndryshme dhe ka të ngjarë të ndikojë në një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore e nënligjore kombëtare. Zbatimi i saj kërkon që Vendet Anëtare të ndërmarrin një kombinim masash legjislative dhe jo-legjislative (masa organizative ose praktike) për të mundësuar tregtinë e lirë të shërbimeve.

Për këtë arsye, dhe për sa i përket legjislacionit zbatues, kërkohet një përzierje masash legjislative horizontale dhe specifike, të cilat ka të ngjarë të përfshijnë ndryshimin e ligjeve ekzistuese, si dhe miratimin e legjislacionit të ri specifik dhe një ligji horizontal kornizë. Dispozitat e Direktivës bazohen kryesisht në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila mbetet plotësisht e zbatueshme. Direktiva kërkon caktimin e një pike të vetme kontakti (PVK) ku ofruesit e shërbimeve mund të marrin elektronikisht informacion mbi kërkesat për akses dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimit, duke përfshirë aplikimin elektronik për marrjen e skemës së kërkuar të autorizimit. Përveç kësaj, autoritetet e Vendeve Anëtare duhet të marrin pjesë në një sistem elektronik për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve administrative (Sistemi i Informacionit të Tregut të Brendshëm ose IMI) i cili lejon bashkëpunimin në mbikëqyrjen e aktiviteteve të shërbimit dhe shkëmbimin efektiv të informacionit ndërmjet Vendeve Anëtare.

*Lidhur me njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale*, Direktiva e Kualifikimeve Profesionale përcakton rregullat për njohjen e kualifikimeve profesionale ndërmjet Vendeve Anëtare për të lehtësuar hyrjen në profesione të rregulluara dhe ushtrimin e tyre. Direktiva parashikon njohje automatike për një sërë profesionesh në bazë të kritereve minimale të formimit, të harmonizuara në BE, siç për mjekë, infermierë, mami, dentistë, farmacistë, arkitektë dhe kirurgë veterinarë (të ashtuquajturat "profesione sektoriale"), një sistem automatik njohjeje bazuar në

përvojë profesionale për profesionet e tregtisë, industrisë dhe zejtarisë, një sistem i përgjithshëm për njohjen e kualifikimeve profesionale, i cili zbatohet për të gjitha profesionet, p.sh., mësuesin, përkthyesin, agjentin imobiliar etj., dhe për ato profesione që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga sistemet automatike të njohjes. Së fundi, Direktiva parashikon gjithashtu një sistem të ri të ofrimit të shërbimeve ndërkufitare në kuadrin e profesioneve të rregulluara.

Nga ana tjetër, disa profesione rregullohen nga *acquis* specifik. Për shembull, avokatët rregullohen nga Direktiva 77/249/KEE që disiplinon shërbimet ndërkufitare të avokatëve dhe Direktiva 98/5/KE që rregullon vendosjen e avokatëve në një Vend tjetër Anëtar. Agjentët tregtarë mbulohen nga Direktiva 86/653/KEE e cila harmonizon të drejtat dhe detyrimet e agjentëve tregtarë, përfshirë shpërblimin, lidhjen dhe përfundimin e kontratave të agjencisë etj. Profesionet e përfshira në tregtinë e produkteve toksike, p.sh. pesticideve, substancave toksike, produkteve medicinale etj., rregullohen nga Direktiva 74/557/KEE për vendosjen e personave të vetëpunësuar dhe ndërmjetësve që angazhohen në tregtinë e produkteve toksike dhe nga Direktiva 74/556/KEE mbi masat kalimtare në lidhje me tregtinë e produkteve toksike dhe përdorimin profesional të këtyre produkteve. Profesionet e tjera të rregulluara nga *acquis* specifik, p.sh., detarët, audituesit ligjorë, ndërmjetësit në sigurime etj., trajtohen nën kapitujt e tjerë të *acquis*, siç nga Kapitulli 14, Kapitulli 6, Kapitulli 9 përkatësisht.

Për të shmangur fragmentimin e tregut të brendshëm dhe për të eliminuar barrierat për hyrjen në profesion të rregulluar dhe ushtrimin e tij, BE-ja ka miratuar gjithashtu Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit përpara miratimit të legjislacionit të ri për profesionet (Direktiva e Testit të Proporcionalitetit), e cila siguron respektim të vazhdueshëm të parimit të mosdiskriminimit mbi bazë shtetësie dhe të proporcionalitetit sa herë rregullohet hyrja në profesion apo ushtrimi i tij.

*Lidhur me shërbimet postare*, Direktiva e Shërbimeve Postare vendos një kuadër rregullator për shërbimet postare evropiane në funksion të liberalizimit gradual të tregut të shërbimeve postare. Tregu postar është hapur gradualisht ndaj konkurrencës dhe është liberalizuar plotësisht që nga janari 2013.

Synimet kryesore të Direktivës së Shërbimeve Postare janë të sigurojë shërbime postare universale me cilësi të lartë për konsumatorët dhe bizneset dhe me çmime të përballeshme, të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, veçanërisht në lidhje me kohën e dërgesave, të vendosë autoritete kombëtare rregullatore të pavarura (AKRRP) që disponojnë burime të mjaftueshme dhe u është ngarkuar rregullimi i postave (mbikëqyrja, statistikat, autorizimet, kontrolli i tarifave, kontabiliteti, procedurat e ankesave etj.).

Përveç kësaj, për të mundësuar që konsumatorët dhe shoqëritë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), të blejnë dhe shesin produkte online në mënyrë më të lehtë dhe më të sigurt në të gjithë Unionin, BE-ja miratoi në 2018 Rregulloren (BE) 2018/644 për shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove të vogla, të cilat do të rrisin transparencën e çmimeve dhe mbikëqyrjen rregullatore të shërbimeve të dërgesave ndërkufitare të pakove të vogla, në mënyrë



që konsumatorët individualë dhe shitësit e vegjël me pakicë që operojnë online të mund të përfitojnë nga dërgesa më ekonomike.

Së fundi, Unioni krijoi Grupin e Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Postare (GRRESHP) i cili është një grup këshillimor që lehtëson konsultimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Autoriteteve Kombëtare Rregullatore të Pavarura (AKRRP) në vendet e BE-së dhe ndërmjet AKRRP-ve dhe Komisionit të BE-së për të ndihmuar në konsolidimin e tregut të brendshëm për shërbimet postare dhe siguruar zbatimin konsistent të legjislacionit postar/të dërgesave postare. Vendet candidate marrin pjesë në të si vëzhgues.

### 3.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

#### ***Situata aktuale në Shqipëri***

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime. Sipas Raportit të Progresit të KE-së për vitin 2022, është arritur njëfarë progresi veçanërisht në fushën e shërbimeve postare përmes harmonizimit ligjor të bërë në fushën e shërbimeve të dërgesave ndërkufitare të pakove të vogla. Ndërsa ushtrimi i shqyrtimit analitik të legjislacionit që do të përafrohet me Direktivën e Shërbimeve ka vijuar me një shtrirje më të gjerë, duke përfshirë më shumë sektorë shërbimi objekt kontrolli të përputhshmërisë me *acquis*.

Rekomandimet e Komisionit të BE-së të vitit 2021 mbeten ende të vlefshme dhe Shqipëria duhet që në veçanti:

- të përfundojë shqyrtimin analitik të legjislacionit ekzistues për të identifikuar pengesat për lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve me synimin për të përafruar më tej legjislacionin vendas me Direktivën e Shërbimeve;
- të shtojë përpjekjet për të përafruar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së dhe të sigurojë kapacitetet e duhura institucionale në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

#### ***E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime***

Shërbimet rregullohen nga Ligji Nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” (Ligji për Shërbimet) i cili transponon pjesërisht Direktivën e Shërbimeve të BE-së. Ndërsa regjimi i përgjithshëm i themelimit dhe regjistrimit të biznesit rregullohet me Ligjin nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe me Ligjin nr. 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar. Ligji Nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon regjimin e përgjithshëm të dhënies së autorizimeve për bizneset (persona fizikë dhe juridikë), ndërsa parimet kryesore të Direktivës së Shërbimeve të BE-së janë gjithashtu të pasqyruara në Ligjin Nr. 44/2015 “Për kodin e procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” i cili përcakton ndër të tjera të drejtën e informimit, procedurat elektronike, kushtet për dhënien e autorizimeve, përfshirë miratimin në heshtje.

Ligji Nr. 66/2016 për shërbimet transponon shumicën e dispozitave kyçe të Direktivës së Shërbimeve në lidhje me të drejtën e vendosjes (themelimit). Ligji u garanton personave fizikë dhe juridikë (vendas dhe të huaj) akses në treg dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimit pa diskriminim, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në bazë shtetësie: Këtë ligji e garanton për shembull duke ndaluar kritere të tilla si shtetësia, vendbanimi ose kufizime në strukturën aksionere të shoqërive dhe testet ekonomike. Ligji siguron akses në shërbime pa diskriminim si për marrësit vendas të shërbimeve ashtu dhe për ata të huaj, ofron standarde cilësore për ofrimin e shërbimeve dhe kërkon ngritjen e një pike të vetme kontakti (Pika e Vetme e Kontaktit) si pjesë e portalit e-Albania, i cili rregullohet më tej me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 1147/2020. e-Albania vepron si një sportel me një ndalesë për ofruesit e shërbimeve dhe përfituesit e tyre për të marrë informacion mbi kërkesat për akses dhe ushtrim të aktivitetit të shërbimit, detajet e kontaktit të autoriteteve kompetente që rregullojnë aksesin në treg për aktivitetet përkatëse të shërbimit, shoqatat apo organizatat nga të cilët ofruesit dhe marrësit mund të marrin ndihmë, mjetet juridike në rast mosmarrëveshjeje dhe mundësinë për të përfunduar procedurat dhe formalitetet online për të aksesuar apo ushtruar aktivitetin përkatës të shërbimit.

Legjislacioni vertikal, pra legjislacioni sektorial që rregullon aksesin dhe ushtrimin e aktiviteteve specifike të shërbimit në sektorë të ndryshëm, p.sh. në turizëm, tregti, shërbime biznesi etj., duhet të jenë në përputhje me parimet e përcaktuara në Ligjin për Shërbimet dhe, rrjedhimisht, me Direktivën e Shërbimeve të BE-së. Autoritetet kompetente duhet të rishikojnë legjislacionin ekzistues sektorial në juridiksionin e tyre për përputhshmëri me Ligjin për Shërbimet dhe Direktivën e Shërbimeve të BE-së, duke siguruar gjithashtu përputhshmëri me to të legjislacionit të ardhshëm përmes një një sistemi njoftimi të përcaktuar me Ligjin për Shërbimet.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) funksionon si një sportel me një ndalesë për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve. QKB administron Regjistrin Tregtar/të Shoqërive dhe Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve. QKB operon nëpërmjet sporteleve të shërbimit në të gjithë vendin (35 në total), si dhe përmes portalit e-Albania.

Që nga viti 2015, QKB ofron shumicën e shërbimeve të saj online dhe pa pagesë. Ndërkohë, duke filluar nga viti 2020, shërbimet e regjistrimit të personave fizikë, pezullimi dhe aktivizimi i veprimtarisë së subjekteve, si dhe pajisja me licencë/leje ofrohen vetëm online nëpërmjet e-Albania. Mbi një milion përdorues të regjistruar të e-Albania përfitojnë nga mbi 500,000 shërbime elektronike në muaj.

### ***Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale***

Profesionet e rregulluara në Shqipëri rregullohen nga Ligji Nr. 10 171/2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për profesionet e rregulluara). Profesionet që përcaktohen shprehimisht nga ky ligj përfshijnë profesionin e mjekut, dentistit, farmacistit, infermierit, mamisë, fizioterapistit, kirurgut veterinar, arkitektit, inxhinierit, mësuesit, punonjësit social dhe psikologut. Qeveria ka miratuar gjithashtu një listë të specialiteteve për

profesionet e rregulluara të sipërpërmendura (VKM Nr. 649/2011). Profesionet e tjera të rregulluara përcaktohen rast pas rasti nga legjislacioni specifik (sektorial).

Sipas Ligjit për profesionet e rregulluara, profesionet e rregulluara janë aktivitete ose grupe veprimtarish profesionale, ushtrimi i të cilave ose njëra nga format e ushtrimit është e rregulluar me ligj ose akt nënligjor dhe është e lidhur me një nivel të caktuar formimi ose posedim të kualifikimeve të caktuara profesionale. Kualifikimet profesionale përkufizohen si kualifikime që dëshmojnë me diplomë, dëshmi aftësish ose përvojë pune. Ata që dëshirojnë të ushtrojnë një profesion të rregulluar në Shqipëri duhet të kenë mbaruar programin përkatës të studimit, të akredituar dhe/ose të kenë kualifikime profesionale në profesionin e synuar, të vërtetuara me dokumente zyrtare të lëshuara në Shqipëri ose jashtë vendit dhe të njohura në Shqipëri në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

E drejta për të ushtruar një profesion të rregulluar i jepet çdo personi që plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin për Profesionet e Rregulluara ose në legjislacionin tjetër specifik (sektorial). Për profesionet e përcaktuara posaçërisht në Ligjin për profesionet e rregulluara është e detyrueshme kryerja e praktikës përkatëse profesionale, dhënia e provimit të shtetit dhe regjistrimi në urdhrin përkatës profesional ose autoritetin përgjegjës. Ata që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit jashtë vendit ose kanë dhënë provimin e shtetit në një juridiksion të huaj, p.sh. në Shtetet Anëtare të BE/ZEE, në SHBA, Kanada, Japoni ose vende të tjera me të cilat Shqipëria ka lidhur marrëveshje dypalëshe përkatëse, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit në Shqipëri, me kusht që të kenë përfunduar studimet përkatëse të arsimit të lartë (VKM Nr. 952/2012).

Legjislacioni shqiptar nuk bën asnjë dallim ndërmjet njohjes së kualifikimeve për qëllime studimi ose pune. Përkundrazi, i takon autoritetit kompetent përkatës ose urdhrin profesional që të përcaktojë kushtet që profesionistët me kualifikime të huaja (profesionale) të ushtrojnë profesionin e tyre në vend.

Megjithatë, për sa i përket njohjes së kualifikimeve profesionale të marra në nivelin e arsimit të lartë, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) janë përgjegjëse për njohjen e diplomave, certifikatave dhe titujve të marrë jashtë vendit për qëllime studimi ose punësimi, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe aktet nënligjore përkatëse.

Ndërsa sa i përket njohjes së kualifikimeve profesionale në nivelin e arsimit profesional (AFP) të marra jashtë vendit, është përgjegjësi e MFE-së t'i njohë ato, në përputhje me Ligjin Nr. 15/2017 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional. MFE përfshin gjithashtu Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) në procesin e njohjes.

Aplikimi për njohjen e kualifikimeve akademike dorëzohet online nëpërmjet portalit e-Albania, ndërsa dokumentet dorëzohen online dhe në letër (edhe me postë). Ndërsa aplikimi për njohjen e kualifikimeve të AFP-së bëhet vetëm offline.

Qeveria nuk ka miratuar ndonjë listë kombëtare të profesioneve të rregulluara dhe deri më sot nuk është transpozuar ndonjë sistem njohjeje i kualifikimeve profesionale sipas *acquis*.

### ***Shërbimet postare***

Në fushën e shërbimeve postare, legjislacioni është i përafuar plotësisht me Direktivën 97/67/KE, të ndryshuar: konkretisht Ligji Nr.46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” harmonizohet plotësisht me direktivën në fjalë. Rregullat për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal (OSHU), përcaktimin e zonës minimale për ofrimin e shërbimit universal dhe për kompensimin e kostove neto të ofruesit të shërbimit universal janë në fuqi. Po kështu janë në fuqi dhe aktet nënligjore në lidhje me transparencën e kontabilitetit dhe llogaritjen e kostove të OSHU-së dhe rregullat për inspektimin e tregut postar, transparencën dhe besueshmërinë e të dhënave statistikore dhe financiare të operatorëve të tregut dhe rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve operator me operator apo operator me konsumator. Në vitin 2021 Qeveria transpozoi plotësisht edhe Rregulloren (BE) 2018/644 për shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove të vogla.

Tregu postar ka qenë i hapur ndaj konkurrencës që nga viti 2017. Në treg ekziston një OSHU, Posta Shqiptare Sh.A dhe 33 ofrues të tjerë të shërbimeve postare të autorizuar nga autoriteti rregullator kombëtar, AKEP (Autoriteti Kombëtar i Komunikimeve Elektronike e Postare). Prej mbi 10 vitesh, tregu postar shqiptar shërbehet edhe nga kompani të mëdha postare ndërkombëtare si DHL, TNT, FEDEX etj., të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme të tregut, veçanërisht në postën ekspres.

Tregu është i qëndrueshëm për sa i përket vëllimit të përgjithshëm të dërgesave postare, në ndryshim nga tendencat e tregut botëror postar, ku veçanërisht volumi për dërgesat postare të letrave është ulur. Megjithatë, numri mesatar i dërgesave postare për individ në Shqipëri është shumë më i ulët krahasuar me vendet e tjera evropiane. Në Shqipëri, një individ dërgon mesatarisht 10 dërgesa postare në vit, ndërsa në vendet e Evropës Lindore ky tregues është 30 dhe në Evropën Perëndimore arrin në 191 dërgesa për frymë.

Pavarësisht liberalizimit të plotë të tregut në vitin 2015, ka një përqendrim të lartë të tregut tek ofruesi i shërbimit universal, pra te Posta Shqiptare Sh.A. Ky i fundit dominon tregun me 65% të totalit të të ardhurave, të cilat në vitin 2020 u vlerësuan në 2.8 miliardë lekë. Gjithashtu, Posta Shqiptare Sh.A. zë mbi 80% të të gjitha objekteve postare të përpunuara në treg.

### **Përmbledhje e arritjeve kryesore**

#### ***Lidhur me përgatitjet për negociatat e anëtarësimit***

Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për Integrimin në BE për Kapitullin 3 mbështetet nga projekti GIZ SANECA për përgatitjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Në këtë kuadër, GNP ka përgatitur analizën e mangësive ligjore, institucionale dhe administrative për këtë kapitull në vitin 2020 dhe e ka rishikuar atë së fundmi në vitin 2021. Kjo u ka mundësuar anëtarëve të GNP-së të kontribuojnë në mënyrë efektive çdo vit në PKIE dhe të monitorojnë progresin në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Ndërsa në maj 2021, MFE-ja ka ngritur Tryezën e Konsultimeve për Kapitullin 3 në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrim Evropian (PPIE), e mbështetur nga një metodologji për identifikimin dhe hartëzimin e palëve të interesit. Në fillim të vitit 2021, MFE së bashku me SANECA, mbajtën sesione informuese për të rritur ndërgjegjësimin e sektorit privat dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen në Platformë. Tryeza e Konsultimeve e PPIE për Kapitullin 3 disponon tanime rregullore e saj të brendshme për të funksionuar si një platformë konsultimi ndërmjet sektorit shtetëror dhe privat, përfshirë OJQ-të, në procesin e anëtarësimit. Në vitin 2022, Tryeza e Konsultimeve për Kapitullin 3 mbajti disa sesione tematike trajnimi/informuese në lidhje me PKIE-në (metodologjinë, rëndësinë, implikimet për shoqërinë civile dhe kontributin e tyre të mundshëm në të), Direktivën e Shërbimeve të BE-së dhe praktikat më të mira rajonale për përafrimin me të, si dhe mbi Direktivën për Kualifikimet Profesionale dhe praktikat rajonale në lidhje me përafrimin me *acquis*.

Një sërë trajnimesh u organizuan në prill dhe maj 2022 së bashku me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Kolegjin e Evropës (*College of Europe*), ky i fundit me famë ndërkombëtare, për të përgatitur anëtarët e GNP-së për bisedimet e anëtarësimit, si në aspektin procedural ashtu edhe në përmbajtje. Sesionet e trajnimit u fokusuan në kërkesat e *acquis* në lidhje me lirinë e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime, njohjen e kualifikimeve profesionale (me theks në sistemet përkatëse të njohjes), ndërlidhjen midis Direktivës së Shërbimeve të BE-së dhe Direktivës për Kualifikimet Profesionale, si dhe mbi kërkesat e *acquis* në fushën e shërbimeve postare e më gjerësisht mbi kompleksitetin e procesit të anëtarësimit dhe praktikat më të mira për t'u përgatitur. Trajnimet synuan gjithashtu përgatitjen e GNP-së për takimet e ardhshme dypalëshe *screening* që do të mbahen në janar 2023.

Në datë 20.12.2022 me asistencë të projektit SANECA, Ministria e Financave dhe Ekonomisë organizoi takimin “Mock Exercise” ku u stimuluan prezantimet përkatëse që do të paraqiten në Takimin Dypalësh për kapitullin 3 nga përfaqësuesit e Ministrive dhe institucioneve përkatëse.

### ***E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare***

Pas rekomandimit të Komisionit Evropian për të finalizuar shqyrtimin analitik të legjislacionit ekzistues (*screening*) në mënyrë që të identifikohen pengesat për lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe për të harmonizuar më tej legjislacionin me Direktivën e Shërbimeve, MFE e mbështetur nga projekti GIZ SANECA, përfundoi *screening* të legjislacionit sektorial për shërbimet që rezultoi në 38 sektorë shërbimesh të identifikuar të shqyrtuar tashmë: sektorët objekt *screening* përfshijnë nga shërbimet e biznesit te mjedisi, bujqësia, minierat deri te shërbimet tregtare.

Screening është kryer sipas një qasjeje me tre faza: 11 sektorët e parë prioritarë janë shqyrtuar brenda vitit 2020, ndërsa 9 sektorë të tjerë janë shqyrtuar brenda vitit 2021. 18 sektorët e mbetur janë shqyrtuar brenda nëntorit 2022.

*Screening* është kryer në bashkëpunim me autoritetet kompetente përkatëse, përgjegjëse për aksesin në treg në sektorë të caktuar dhe ka ndjekur një qasje me 2 hapa. Si fillim, *screening* identifikues i cili u fokusua në identifikimin e gamës më të gjerë të mundshme të shërbimeve që bien në fushëveprimin e Direktivës së Shërbimeve dhe identifikimi i legjislacionit kombëtar (ligje, rregullore, akte të tjera nënligjore) të identifikuar si në përputhje/ose jo me Direktivën e Shërbimeve. Së dyti, *screening* progresiv që çoi në një analizë më të thellë në lidhje me kriteret e evidentuara në legjislacionin kombëtar për të cilat është dashur vlerësuar proporcionaliteti, si dhe kërkohej justifikimi përkatës, çka u realizua në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente, sipas rastit.

Si rezultat i kësaj reforme legjislativë 30 mujore që filloi në vend, nga 275 akte kombëtare të shqyrtuara në total, 122 pjesë (51 ligje dhe 71 akte nënligjore) do të duhet të ndryshohen (44%) në mënyrë që të akomodojnë artikujt e tyre me nenet e Direktivës së Shërbimeve. Në dhjetor të vitit 2022, u përgatit një raport *screening* i cili përfshin gjetjet e shqyrtimit analitik dhe do të ndihmojë MFE-në, Institucionet dhe autoritetet e tjera kompetente në përgatitjen e një plani veprimi për përafrimin me Direktivën e Shërbimeve në vitin 2023.

### **Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale**

Për t'iu përgjigjur rekomandimit të Komisionit Evropian për të rritur përpjekjet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së dhe për të siguruar kapacitetin e duhur institucional në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, Grupi i Punës i Kapitullit 3, i udhëhequr nga MAS dhe në bashkëpunim me MFE, ka avancuar përgatitjen e Udhërrëfyesit për përafrimin me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Përgatitjet mbështeten nga projekti GIZ SANECA, i cili ka vënë në dispozicion ekspertizë ndërkombëtare dhe kombëtare për këtë qëllim.

Në përputhje me Konceptin e tij të qartë për përgatitjen e Udhërrëfyesit (Prill 2021) dhe pas trajnimeve të dedikuara për anëtarët e GNP-së (dhjetor 2021) mbi përmbajtjen dhe procesin e përgatitjes së dokumentit, Grupi Ndërinstitucional përgatiti një draft Udhërrëfyes në qershor 2022, i cili përmban një analizë të detajuar të përputhshmërisë së kuadrit rregullator dhe institucional vendas me Direktivën e Kualifikimeve Profesionale, Direktivën e Testit të Proporcionalitetit, si dhe me *acquis* specifik për disa profesione të rregulluara, siç *acquis* për avokatët, agjentët tregtarë dhe tregtarët e produkteve toksike. Çka është me e rëndësishme, Udhërrëfyesi përmban një plan veprimi me masa për përafrimin me *acquis* (p.sh., iniciativa legjislativë për të transpozuar Direktivën e Kualifikimeve Profesionale, ndryshime legjislativë për zbatimin e kërkesave minimale të formimit për profesionet sektoriale, shqyrtimin analitik (*screening*) për të siguruar që legjislacioni sektorial të jetë në përputhje me regjimin e përgjithshëm të njohjes etj.). Në planin e

veprimet janë përfshirë gjithashtu përgjegjësitë institucionale dhe afatet për harmonizim të mëtejshëm.

Përveç kësaj, më shumë se 300 profesione të rregulluara u identifikuan gjatë fazës përgatitore të Udhërrëfyesit, përfshirë legjislacionin përkatës. Në total janë shqyrtuar më shumë se 100 akte ligjore/nënligjore që lidhen me sistemin shqiptar të njohjes së kualifikimeve profesionale dhe profesioneve të rregulluara.

Draft Udhërrëfyesi u konsultua së brendshmi, përkatësisht me anëtarët e GNP-së, urdhrat profesionalë dhe institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat që ofrojnë programe studimi për profesionet sektoriale, në një seri prej shtatë takimesh konsultimi. Drafti i konsoliduar i Udhërrëfyesit është konsultuar me sektorin privat, konkretisht me shoqatat profesionale, ndërmjetësit në tregun e punës, dhomat e tregtisë, etj., në kuadër të Tryezës së Konsultimeve të Kapitullit 3 të PPIE. Për këto qëllim janë mbajtur 3 sesione konsultimi në nëntor 2022. Udhërrëfyesi është planifikuar të finalizohet në dhjetor 2022.

Gjithashtu, në kuadër të Procesit të Berlinit Shqipëria ka nënshkruar së fundmi *Marrëveshjen për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale për Mjekët, Stomatologët dhe Arkitektët* (nëntor 2022) me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që marrin pjesë në këtë nismë, si pjesë e Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM) 2021-2024. Marrëveshja, që është ndërmjetësuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), vendos në rajon sistemin e njohjes automatike të BE-së për profesione të caktuara me qëllim lëvizjen e lirë të profesionistëve dhe pritet të zgjerohet në të ardhmen e afërt për të përfshirë katër profesione të tjera (mamiçet, infermierët, farmacistët dhe veterinerët).

Një tjetër marrëveshje është në proces përgatitjeje, përkatësisht vendosja e një kuadri për njohjen e kualifikimeve profesionale bazuar në Sistemin e Përgjithshëm të Njohjes të BE-së për një sektor pilot (inxhinierinë) me shtrirje graduale çdo vit në sektorë të tjerë që mbulohen nga sistemi i përgjithshëm.

## **Shërbimet postare**

Shqipëria është plotësisht e përafruar me acquis për shërbimet postare, veçanërisht përmes transpozimit të plotë të acquis në Ligjin Nr. 46/2015 për shërbimet postare, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe së fundmi përmes transpozimit të Rregullores (BE) 2018/644 mbi Shërbimet e dërgesave ndërkufitare për pakot e vogla postare përmes Udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Nr. 5/2021.

Ndërkohë, trendet e konsumit të shërbimeve postare dhe tranzicioni digjital e shtynë qeverinë t'i adresojë këto zhvillime e ndryshime në tregun postar duke miratuar në fillim të vitit 2022 Dokumentin e ri të Politikës për Sektorin e Shërbimeve Postare 2021+. Qeveria synon të përmirësojë cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimeve postare bazuar në teknologjitë e reja dhe zgjidhjet inovative, ndër të tjera, përmes infrastrukturës moderne postare (qendra moderne e

tranzitit), integritit të sa më shumë shërbimeve postare dhe financiare së bashku, qarkullimit të lirë të objekteve postare në një mjedis të vetëm postar, i përbërë nga rrjete të ndërlidhura, si dhe duke zhvilluar tregtinë elektronike (*e-commerce*) në vend dhe rajon nëpërmjet rritjes së cilësisë së shërbimit dhe infrastrukturës mbështetëse.

### 3.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

#### *Ministritë*

- Ministër Shteti dhe Kryenegociator
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR/MARD)
- Ministria e Kulturës (MK/MoJ)
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS/MES)<sup>48</sup>
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)<sup>49</sup>
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS/MoHSP)
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)<sup>50</sup>
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB/MoI)
- Ministria e Drejtësisë (MD/MoJ)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM/MTE)

#### *Institucionet varësie*

- Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA/ CES)
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP/IoPH)
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH/GDSP)
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK/ NAVETQ)
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI/NAIS)
- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI/NASRI)
- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)
- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB/ NBC)
- Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL)

#### *Institucione të pavarura/autonome*

- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP/ EPCA)
- Banka e Shqipërisë (BSH/BoA)
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF/FSA)
- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI/GDIP)
- Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT)

---

<sup>48</sup> MAS drejton GNP-në në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

<sup>49</sup> MFE drejton të gjithë GNP-në e Kapitullit 3, përfshirë në fushën e së drejtës së vendosës dhe lirisë së lëvizjes të shërbimeve.

<sup>50</sup> MIE drejton GNP-në në fushën e shërbimeve postare.



### *Urdhra profesionale*

- Dhoma Kombëtare e Avokatisë
- Dhoma Kombëtare e Zejeve
- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
- Urdhri i Psikologut
- Urdhri Profesional i Stomatologëve
- Urdhri Profesional i Mjekëve
- Urdhri Profesional i Infermierit
- Urdhri Profesional i Farmacistëve
- Urdhri Profesional i Veterinerëve

### 3.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

#### ***Lidhur me përgatitjet për negociatat e anëtarësimit***

##### *Mangësitë e identifikuara:*

- Kapacitete institucionale dhe administrative të dobëta për përgatitjet e duhura për takimet dypalëshe screening dhe hapat pasues në procesin e anëtarësimit;
- Nevoja për të përmirësuar kapacitetet institucionale/administrative për funksionimin e duhur të Tryezës së Konsultimit të PPIE për Kapitullin 3, në veçanti për të përmirësuar cilësinë e konsultimeve me sektorin privat mbi masat për harmonizim.

##### *Prioritetet:*

- Masa për rritjen e kapaciteteve për përgatitjen e takimeve dypalëshe screening (p.sh. për përgatitjen e prezantimeve mbi situatën e përafrimit me acquis) dhe për përgatitjen e dokumenteve të tjera që kërkohen në procesin e anëtarësimit;
- Ngritja e kapaciteteve në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Tryezës së Konsultimit të PPIE për Kapitullin 3, në veçanti për të përmirësuar nivelin dhe cilësinë e konsultimeve me sektorin privat mbi masat për përafrimin me acquis në Kapitullin 3.

#### ***E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare***

##### *Mangësitë e identifikuara:*

- Mospërfundimi i shqyrtimit të legjislacionit sektorial kundrejt Direktivës së Shërbimeve të BE-së;
- Mospërputhja e plotë e Ligjit për Shërbimet me Direktivën e BE-së, veçanërisht në lidhje me ofrimin e shërbimeve ndërkufitare, garancitë për përgjegjësinë profesionale dhe shërbimet multidisiplinare;
- Kapacitete institucionale dhe administrative të dobëta për të siguruar përputhshmëri të vazhdueshme me Direktivën e Shërbimeve të BE-së (me Ligjin për Shërbimet) dhe zbatimin e duhur të Direktivës.

*Prioritetet:*

- Finalizimi i shqyrtimit të legjislacionit sektorial për përputhshmëri me Direktivën e Shërbimeve të BE-së, brenda vitit 2022;
- Përgatitja e një plani veprimi për harmonizim me Direktivën e Shërbimeve të BE-së bazuar në rezultatet e shqyrtimit analitik, brenda vitit 2023;
- Transpozimi i plotë i Direktivës së BE-së për Shërbimet, brenda vitit 2025;
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për të siguruar përputhshmëri të vazhdueshme me Direktivën e Shërbimeve të BE-së dhe zbatimin e duhur të saj (vazhdimisht).

***Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale***

*Mangësitë e identifikuara:*

- Mosrealizimi i konsultimeve të jashtme për Udhërrëfyesin për përafrim me acquis për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe mosfinalizimi i Udhërrëfyesit;
- Mungesa e harmonizimit me Direktivën e Kualifikimeve Profesionale, Direktivën e Testit të Proporcionalitetit dhe acquis specifik për disa profesione të rregulluara (avokatët, agjentët tregtarë, tregtarët e produkteve toksike);
- Mungesa e kapaciteteve institucionale/administrative për të koordinuar dhe menaxhuar procesin e harmonizimit, duke përfshirë sigurimin e përputhshmërisë me regjimin e përgjithshëm të njohjes të parashikuar nga acquis;

*Prioritetet:*

- Finalizimi i Udhërrëfyesit, brenda vitit 2022;
- Përafrimi me Direktivën e Kualifikimeve Profesionale dhe Direktivën e Testit të Proporcionalitetit, brenda vitit 2025;
- Përafrimi me kriteret minimale të formimit për profesionet sektoriale, brenda vitit 2023;
- Përafrimi me acquis specifik për disa profesione të rregulluara (avokat, agjentë tregtarë, tregtarë të produkteve toksike);
- Rritja e kapaciteteve institucionale/administrative për të koordinuar/menaxhuar procesin e harmonizimit dhe për të siguruar përputhshmëri me regjimin e përgjithshëm të njohjes, brenda vitit 2025.

***Shërbimet postare***

*Mangësitë e identifikuara:*

Asnjë

*Prioritetet:*

- Zbatimi i vazhdueshëm i legjislacionit të harmonizuar plotësisht, përfshirë legjislacionit për shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove të vogla dhe veçanërisht monitorimi i tarifave për këto shërbime nga AKEP (nga janari 2022 e në vazhdim);
- Zbatimi i Dokumentit të ri të Politikës për Sektorin e Shërbimeve Postare 2021+.

## KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

### 4.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet anëtare duhet të heqin, me disa përjashtime, të gjitha kufizimet për lëvizjen e kapitalit si brenda BE-së ashtu edhe ndërmjet Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. *Acquis* përfshin gjithashtu edhe rregullat në lidhje me pagesat ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i kërkon bankave dhe operatorëve të tjerë ekonomikë, veçanërisht kur kanë të bëjnë me veprime me vlerë të lartë dhe me transaksione të mëdha në *cash*, të identifikojnë klientët dhe të raportojnë transaksionet e dyshuara. Një kërkesë kryesore për të luftuar krimin financiar është krijimi i kapaciteteve efektive të administrimit dhe zbatimit, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrëse, të zbatimit të ligjit dhe të prokurorisë.

Më datë 7 Tetor 2022, në Bruksel u mbajt takimi shpjegues për kapitullin 4 “Lëvizja e Lirë e kapitalit”. Gjatë takimit shpjegues u prezantuan zhvillimet më të fundit të *acquis* në këtë fushë. Në fushën e Lëvizjes së Lirë të Kapitalit, Direktiva 2019/1153 përcakton rregulla që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen e veprave të caktuara penale. Liberalizimi i pagesave është një kërkesë thelbësore për lëvizjen e lirë të kapitalit.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) parashikon gjithashtu detyrime për krijimin e kushteve për liberalizimin e shitjes së tokave bujqësore, ashtu sikurse bazuar dhe në Direktivën 88/361/EEC mbi zbatimin e nenit 67 të Traktatit, dhe nenet 63-66 të Traktatit të funksionimit të Bashkimit Evropian (TFEU) krijojnë detyrimin për të përafuar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Praktika e Gjykatës së Drejtësisë është po ashtu e rëndësishme për ligjet që miratohen nga vendet anëtarë ose vendet e treta. Më tej, në *acquis*-në e përditësuar është dhe Komunikimi nga Komisioni (COM/2018/547 final) mbi mbrojtjen e investimeve intra-EU.

Ashtu si dhe për komponentët e tjerë, është e nevojshme që të eliminohen të gjitha kufizimet në lëvizjet e pagesave midis Shteteve Anëtare, si dhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta me përjashtime në rrethana të caktuara. Garantimi i lëvizjes së lirë të pagesave kontribuon gjithashtu në rritjen ekonomike duke mundësuar promovimin e përdorimit të euros si brenda Bashkimit Evropian, ashtu dhe si një monedhë ndërkombëtare. Në këtë kuadër, *acquis*-i i Bashkimit Evropian synon pikërisht krijimin e Zonës Unike të Pagesave në Euro (Single Euro Payment Area), e cila vepron në të njëjtat rregulla në të gjithë tregun për sa i përket rregullimit të shërbimeve të pagesave

dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe njëkohësisht promovon pagesat elektronike dhe nxitjen e konkurrencës nëpërmjet prezantimit të aktorëve të rinj.

Direktiva 2015/2366/BE për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm<sup>51</sup>, ka për qëllim lehtësimin e transaksioneve të pagesave brenda BE-së, duke krijuar një kornizë ligjore për Zonën Unike të Pagesave në Euro (Single Euro Payment Area- SEPA). Një direktivë tjetër e rëndësishme është edhe Direktiva e Parasë Elektronike 2009/110/EC<sup>52</sup>, e cila parashikon kornizën legislative për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të parasë elektronike, si dhe krijon një treg të vetëm në shërbimet e parasë elektronike, duke synuar nxitjen e përdorimit të këtyre shërbimeve nga publiku i gjerë, pavarësisht faktit se nuk disponon një llogari bankare. Të dyja këto direktiva, plotësohen edhe më tej nga Direktiva 2014/92/EU “Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike” (PAD), e parashikuar në listën e *acquis* të Kapitullit 9.

Akt tjetër i rëndësishëm, i cili mbështet funksionimin e SEPA-s është Rregullorja (KE) Nr. 924/2009 për pagesat ndërkufitare, e cila rregullon tarifën e vendosura nga një institucion për transaksionet e pagesave elektronike në euro dhe valuta të tjera të njoftuara të Shtetit Anëtar (p.sh. transfertat e kredive, debitime të drejtpërdrejta, pagesa me karta, tërheqje nga ATM-të).

Gjithashtu, edhe Rregullorja e BE-së nr. 260/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 mars 2012, që përcakton kërkesat teknike dhe të biznesit për transfertat e kreditit dhe debitë direkte në euro dhe ndryshon Rregulloren (KE) nr. 924/2009, është një akt i rëndësishëm për rregullimin e transfertave të kreditit dhe debitimeve direkte në euro brenda Zonës Unike të Pagesave në Euro (Single Euro Payment Area - SEPA).

Rregullorja (BE) 2015/751 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2015 “Mbi tarifën e këmbimit për transaksionet e pagesave me kartë” synon të rregullojë tarifën e këmbimit të aplikuar nga ofruesit e shërbimeve të pagesave tek përdoruesit e kartave të debitit dhe të kreditit duke vendosur një vlerë tavan.

Për më tepër, pjesë e *acquis* së këtij kapitulli është rregulloja e re e përditësuar, titulluar Rregullore (BE) 2019/518 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 924/2009 në lidhje me tarifën e caktuar mbi pagesat ndërkufitare në BE dhe ndryshime në konvertimin e monedhës.

Pjesa kryesore e legjislacionit në fushën kundër pastrimit të parave është Direktiva (EU) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, e cila ndryshon Rregulloren (EU) 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën

---

<sup>51</sup> që ndryshon Direktivat 2002/65 / EC, 2009/110 / EC dhe 2013/36 / BE dhe Rregulloren (BE) Nr. 1093/2010 dhe shfuqizon Direktivën 2007/64 / EC.

<sup>52</sup> që ndryshon Direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC dhe shfuqizon Direktivën 2000/46/EC.

2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC. Direktiva kërkon që subjektet që i nënshtrohen asaj të zbatojnë kujdesin e duhur ndaj klientit dhe të raportojnë transaksione të dyshimta, si dhe të marrin masa të rëndësishme mbështetëse, të tilla si ruajtja e të dhënave, trajnimi dhe vendosja e procedurave të brendshme. Për më tepër, Rregullorja (EC) 1889/2005, e cila rregullon paratë *cash* që hyjnë ose dalin nga BE, dhe Rregullorja (EC) 1781/2006 (që do të zëvendësohet nga Rregullorja (EU) 2015/847) parashikojnë që transferimet e fondeve duhet të shoqërohen me informacione kuptimplota mbi paguesin për të siguruar gjurmueshmërinë e plotë të fondeve. Më tej, kjo Direktivë (BE) 2015/849 u plotësua nga Rregulloja (BE) 2016/1675; Rregullorja (BE) 2018/1108; Rregulloja e deleguar e Komisionit (BE) 2019/758; dhe u amendua nga Direktiva 2018/843.

Për të luftuar me sukses krimin financiar, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të ketë një kapacitet efektiv administrativ dhe zbatues, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë.

#### 4.2 Struktura e kapitullit

- Lëvizjet e kapitalit dhe pagesat
- Sistemet e pagesave
- Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

#### 4.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 60-62 dhe 70 të MSA-së. Pastrimi i parave është parashikuar në nenet 4 dhe 82 të MSA-së.

Neni 62 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit parasheh që gjatë tre viteve të para pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe që deri në fund të vitit të tretë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit.

#### 4.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Sipas Raport Progresit të vitit 2022, Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Është arritur një progres i lehtë në zbatimin e rekomandimeve të Moneyval dhe të Planit të Veprimit të FATF-së, ndërkohë që është bërë përparim i kufizuar në

mundësimin e shtetasve të BE-së për të zotëruar tokën. Gjithashtu progres është shënuar në rritjen e edukimit financiar dhe në zbatimin e legjislacionit kombëtar të sistemit të pagesave.

### *Lëvizjet e kapitalit dhe pagesat*

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë është përfshirë në hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”. Ligji i ri synon të heqë kufizimet e blerjes së tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave.

Në takimin shpjegues mbajtur me 7.10.2022 janë dhënë shpjegime për rëndësinë e hartimit të ligjit bazuar dhe në vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për të përcaktuar rregulla që nuk vijnë ndesh me praktiken e gjykatës. Kjo është një nga arsytet e shtyrjes së ligjit pasi do parashikohen dhe rregullime të tjera dhe jo vetëm liberalizimi.

Edhe pse procesi i liberalizimit të blerjes së pasurive të paluajtshme nga qytetarët e BE-së duhet të kishte hyrë në fuqi në vitin 2016 si një detyrim që rrjedh nga MSA, arsytet e mosrealizimit lidhet ngushtë me procesin e regjistrimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe marrjes së certifikatave të pronësisë; kthimin dhe kompensimin e ish-pronarëve, siç është shprehur në nenin 3 (të këtij Ligji nr. 8337), ndërsa në nenin 4 adresohet se për këto kategori të pasurive të paluajtshme nuk lejohet kalimi i së drejtës së pronësisë mbi to për persona fizikë e juridikë të huaj.

Për këtë qëllim janë miratuar: Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ligj që parashikon një sistem të rregulluar dhe të harmonizuar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian e shteteve të tyre anëtare” në nene 50/b dhe 61/2, është Këshilli i Stabilizim-Asociimit që vendos shqyrtimin e modaliteteve.

Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nga shqyrtimi i bazës ligjore në fuqi për pyjet (screening), kryesisht ligji 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", rezulton që të mos kemi detyrime apo shtërngesa ligjore të cilat duhen amenduar, sa i takon detyrimeve që burojnë nga implementimi i kapitullit IV, "Lëvizja e lirë e kapitalit", përfundim ky i arritur dhe pas konsultës e akteve ligjore në bashkëpunim me kolegët e Ministrisë së Drejtësisë.

Projektligji i parashikuar për vitin 2022 është shtyrë për tu miratuar vitin 2025 për të vlerësuar ndikimet që do sjell hyrja në fuqi e ligjit. Po ashtu vlerësohet se data e liberalizimit të plotë të jetë pjesë e negociatave për të dakordësuar një periudhë të mëvonshme të hyrjes në fuqi të ligjit.

Nga ana tjetër MBZHR po vlerëson të hartojë një ligj të ri, dhe jo vetëm ndryshime në ligjin 8337/1998, me qëllim që të rregullojë jo vetëm të drejtën e blerjes por të vendosë dhe rregullime të tjera.

Një çështje tjetër mbetet mos miratimin i Projektligjit ‘Për investimet’ i cili vazhdon të jetë në proces koordinimi me institucionet e tjera relevante, përfundimi i të cilit është ende i pacaktuar.

### ***Sistemet e pagesave***

Bankat e huaja kanë të drejtë të hapin degë në Shqipëri, si dhe të ofrojnë pagesa ndërkufitare. Kuadri rregullativ i Bankës së Shqipërisë (BSH) rregullon sistemet dhe instrumentet e pagesave dhe lejon që transaksionet e pagesave të mund të kryhen jo vetëm nga bankat, por edhe nga institucionet financiare jo-banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Kuadri ligjor dhe rregullator për pagesat elektronike në Shqipëri mbetet i njëjtë për pagesat kombëtare dhe ato ndërkufitare, pa krijuar kufizime. Nga ana tjetër, Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave (KKSP) ka krijuar kushtet e nevojshme rregullatore për pjesëmarrjen në të, të përfaqësuesve të institucioneve financiare jo-banka dhe operatorëve të sistemit. Ndërkohë vijon zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018 – 2023), ku zhvillime janë shënuar veçanërisht me miratimin e akteve rregullatore në mbështetje të ligjit “Për shërbimet e Pagesave” të miratuar në vitin 2020, i cili përafrohet me Direktivën II të Shërbimeve të Pagesave (PSD II).

Vlen të theksohet se Direktiva e Parasë Elektronike 2009/110/EC është transpozuar pjesërisht në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në kuadrin rregullativ në zbatim. Banka e Shqipërisë ka hartuar gjatë vitit 2022, projekt-rregulloren “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike” (që përafrohet më tej dispozitat e Direktivës së Parasë Elektronike 2009/110/KE), si dhe disa ndryshime e shfuqizime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”, të parashikuara në PKIE 2022 – 2024, të cilat pritet të miratohen brenda vitit 2022.

Me hyrjen në fuqi të rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike”, është parashikuar edhe shfuqizimi i rregullores nr. 11, datë 06.02.2008 “Për instrumentet e pagesave elektronike”, pasi tashmë kërkesat e kësaj të fundit mbuloheh kryesisht nga Ligji “Për shërbimet e pagesave” dhe rregullorja e re “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike”.

Aktualisht, në tregun shqiptar operojnë 9 institucione të parasë elektronike, duke shënuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, si dhe dy (Bankat Intesa Sanpaolo dhe Credins) nga 12 bankat që operojnë në treg, ofrojnë produkte të parapaguara. Institucionet e parasë elektronike ofrojnë modele të ndryshme të shërbimeve të pagesave të cilat plotësojnë nevojat e ndryshme në tregun shqiptar. Gjatë viteve të fundit ka patur një prirje në rritje e instrumenteve të parapaguara të emetuara nga këto institucione, si dhe një zgjerim i konsiderueshëm i terminaleve ku mund të përdoren këto instrumente si mjet pagese.

Në muajin janar të 2022, Banka e Shqipërisë filloi operimin e sistemit AIPS-EURO, në të cilin shlyhen transaksionet në euro për klientët e bankave dhe i cili vlerësohet të sjellë reduktimin e përdorimit të parasë *cash* në ekonominë shqiptare. Më tej, përsa i përket zhvillimeve

infrastrukturore, Banka e Shqipërisë po punon për zhvillimin e Projektit *Instant Payment*. Në këtë kuadër, bazuar në raportin e hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore, në të cilin analizohen të gjithë skenarët e mundshëm të realizimit të projektit, avantazhet dhe disavantazhet, duke evidentuar skenarin më të realizueshëm në kontekstin shqiptar. Banka e Shqipërisë ka nisur një konsultim me aktorët e tregut me qëllim për të vendosur dhe zhvilluar zgjidhjen më të mirë të *instant payment* në Shqipëri.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, gjatë kësaj periudhe janë hartuar aktet ligjore e nënligjore në kuadër të transpozimit të Direktivës 2014/92/EU “Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike”, të cilët janë konsultuar edhe me ofruesit e shërbimeve të pagesave. Më konkretisht, projekt-ligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”<sup>53</sup>, është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsultim publik, ndërsa projekt-rregullorja “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave”<sup>54</sup>, parashikohet të miratohet brenda vitit 2022.

Transpozimi i kërkesave të Direktivës 2014/92/EU për llogarinë bazike në projekt-ligjin “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, parashikohet që do të mundësojë ofrimin e shërbimeve të pagesave me kosto të përbalueshme dhe që kanë në qendër klientin, nëpërmjet krijimit të produktit të llogarisë bazike për ata konsumatorë që nuk zotërojnë llogari bankare, si dhe tarifimit të diferencuar për kategori të ndryshme klientësh, si nxitës për rritjen e përdorimit të pagesave. Informacioni mbi transpozimin e Direktivës 2014/92/EU gjendet edhe në Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të Ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar punën për plotësimin e kuadrit rregullativ përkatës në përputhje edhe me *acquis* të BE-së, ku më konkretisht mund të përmendim:

- Me vendimin nr. 7, datë 2.2.2022, u miratua rregullorja “Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave”, e në zbatim të dispozitave të nenit 16, 21 dhe 31 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”;
- U miratua Udhëzimi nr. 1, datë 2.3.2022 “Për kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional, ose të garancive të tjera të krahasueshme”, që përfron kërkesat e Udhëzuesit të EBA/GL/2017/08<sup>55</sup>, lidhur me kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional dhe të garancive të tjera të krahasueshme;

---

<sup>53</sup> i cili transponon kapitujt e Direktivës që kanë të bëjnë me aksesin në llogarinë e pagesave me shërbime bazike.

<sup>54</sup> e cila transponon kapitujt e Direktivës që trajtojnë kërkesat e transparencës dhe krahasueshmërisë së tarifave, si dhe të transferimit të llogarive të pagesave.

<sup>55</sup> EBA/GL/2017/08 on the criteria on how to stipulate the minimum monetary amount of the professional indemnity insurance or other comparable guarantee.



- Me vendimin nr. 29, datë 1.6.2022 u miratua rregullorja “Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit”, e cila përaftron kërkesat e Rregullores Evropiane 2018/389/EU<sup>56</sup>, lidhur me kërkesat për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit;

Gjithashtu, është hartuar projekt-rregullorja “Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave”.

### ***Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit***

Në kuadër të miratimit të akteve nënligjore, DPPPP, ka hartuar projekt Udhëzimin “Për Metodatat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e përfshira në veprimtari financiare” është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për të cilat jemi në pritje të miratimit të tyre. Në nenin 10 të projekt udhëzimit shpjegohen të dhënat që duhet të mbahen nga shërbimet e transferimit të parave ose të vlerave, konkretisht të dhënat që duhet të mbajnë subjektet, të cilat kryejnë veprimtaritë e të cilëve përfshijnë transfertat parash ose vlerash, për dërguesin dhe për përfituesin. Këto ndryshime reflektojnë parashikimet e rregullores të BE 2015/847 “Mbi informacionin që shoqëron transfertat e fondeve”.

Në periudhën janar – tetor 2022, numri i raportimeve të aktiviteteve të dyshimta (RAD) është 1545, ndërsa numri i shpërndarjeve në agjencitë ligjzbatuese është 160. Regjimi i STR-ve (Suspicious Transaction Reporting) është në të vërtetë i kënaqshëm dhe në përputhje me rreziqet e identifikuara nga autoritetet përkatëse. Trajnim i vazhdueshëm sigurohet edhe për stafin.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është një nga prioritetet më kryesore të Qeverisë Shqiptare dhe është e lidhur ngushtë me zbatimin e Planit të Veprimit të ICRG/FATF.

Që nga shkurti 2020, Shqipëria ka ndërmarrë një angazhim politik të nivelit të lartë për të punuar me FATF (Financial Action Task Force) dhe MONEYVAL për të forcuar efektivitetin e regjimit të saj në Luftën kundër Pastrimit të parave/Financimit të terrorizmit.

- Vendimi nr. 1 datë 19.02.2020 “Për krijimin e grupit ndër-institucional të punës për përmbushjen e rekomandimeve të ICRG-FATF” u miratua pikërisht për të shërbyer si bazë e bashkëpunimit ndër-institucional për zbatimin e plotë të këtij Plani Veprimi.

Lidhur me ecurinë është konstatuar nga ekspertët e ICRG se Shqipëria vazhdon të përparojë në zbatimin e Planit të Veprimit të ICRG/FATF.

---

<sup>56</sup> Commission Delegated Regulation (EU) 2018/389 of 27 November 2017 supplementing Directive (EU) 2015/2366 of the European Parliament and of the Council with regard to regulatory technical standards for strong customer authentication and common and secure open standards of communication.

Tashmë, vetëm një (1) pikë veprimi ka mbetur “Pjesërisht e adresuar” (19 pika të Planit të Veprimit gjithsej) lidhur me aktakuzat për veprat penale të Pastrimit të parave, me fokus të veçantë në rastet me vepër penale të huaj.

Shqipëria ka vazhduar të përmirësojë kuadrin e saj ligjor në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përmes përafrimit me direktivat 4 dhe 5 të BE-së kundër pastrimit të parave. Shqipëria ka përmirësuar masat për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke treguar progres të mirë në nivelin e përputhshmërisë me rekomandimet e FATF.

#### 4.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

#### 4.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

##### *Mangësitë e identifikuara*

- Shtyrja e miratimit të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”

##### *Prioritetet*

Sipas raportit të progresit të BE-së 2022, nevojitet:

- të finalizojë zbatimin e Planit të Veprimit FATF dhe të vijojë të adresojë rekomandimet Moneyval;
- të shmangë rrezikimin e progresit në këtë sektor duke miratuar një taksë dhe amnisti penale ndaj këshillës së BE-së dhe Moneyval;
- të bëjë progres në miratimin e legjislacionit përkatës që do t’i siguronte shtetasit e BE-së me të drejtën për të zotëruar tokë, e cila është e mëvetësishme që prej vitit 2016.

Tërësia e prioritetëve është listuar si më poshtë.

- 1) Zbatimi i planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël 2018-2023. Kjo strategji, synon nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë dhe promovimin e përdorimit të pagesave elektronike në ekonominë shqiptare.
- 2) Do të vazhdohet me zbatimin e rekomandimeve të raportit Moneyval dhe përafrimin me *acquis* të BE-së për kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit.

## KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE

### 6.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni për shoqëritë tregtare përfshin rregulla mbi formimin, regjistrimin, bashkimin dhe ndarjen e kompanive. Në fushën e raportimit financiar, *acquis* përcakton rregulla për paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara, përfshirë rregullat e thjeshtuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa subjekte të interesit publik. Për më tepër, *acquis* përcakton rregulla për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore. Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së themelimit.

### 6.2 Struktura e kapitullit

- Legjislacioni tregtar
- Kontabiliteti dhe auditimi ligjor

### 6.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Në përputhje me detyrimet e parashikuara në nenet 70 (3), 49, 50 (1), 51 (1), 55 (1) dhe 56 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria është e angazhuar të përafrojë legjislacionin e shoqërive tregtare me *acquis* të BE-së.

Neni 49 kërkon që legjislacioni shqiptar të ketë koncepte të përcaktuara qartë për shoqëritë tregtare, filialet, degët dhe ndërmarrjet.

Përveç kësaj, neni 50 parashikon lehtësimin e fillimit të aktiviteteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shoqëritë dhe qytetarët e BE-së, duke garantuar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive në një vend të tretë, si dhe bashkëpunëtorët dhe degët e tyre.

Neni 51 i MSA-së parashikon që çdo Palë mund të rregullojë vendosjen dhe funksionimin e shoqërive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregullore nuk krijojnë diskriminim ndaj shoqërive dhe shtetasve të Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj. Krijimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor tregtar në përputhje me standardet e BE-së, krijimi i shoqërive tregtare, zvogëlimi i barrierave të hapjes së biznesit, thjeshtësimi dhe standardizimi i praktikave të biznesit në përputhje me praktikat ndërkombëtare.

Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së themelimit.

Në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, Direktiva për bashkërendimin e masave mbrojtëse që kërkohet nga shoqëritë tregtare për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta (2009/101/KE -Direktiva e mëparshme për Shoqëritë tregtare) përfshin masat mbrojtëse që parashikojnë kërkesat e detyrueshme dhënien e informacioneve shpjeguese, duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e detyrimeve të lidhura nga shoqëritë tregtare, si dhe duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva (89/666/KEE) parashikon gjithashtu kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me degët e hapura në një Shtet Anëtar të qeverisur nga ligji i një shteti tjetër. Direktiva 2012/30/BE (e ndryshuar nga Direktiva 77/91/KEE) përmban rregulla për formimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre. Direktiva 2009/102/KE kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë që ligji i tyre i brendshëm të njohë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me një dege.

Direktivat 2011/35/BE dhe Direktiva 82/891/KEE harmonizojnë rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve në kontekstin e bashkimit të brendshëm dhe ndarjeve të shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva 2009/109/KE paraqet kërkesa të thjeshtuara për raportim dhe dokumentim në rastin e bashkimeve dhe ndarjeve. Direktiva 2005/56/KE për bashkimet ndërkufitare parashikon rregullat dhe procedurat për të lehtësuar bashkimet ndërkufitare të shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuara. Direktiva 2004/25/KE për marrjet e ofertave të blerjeve (take over bids) përcakton rregullat e harmonizuara për të lehtësuar blerjet ndërkufitare brenda BE-së, si dhe përmirësimin e transparencës dhe mbrojtjen e aksionarëve të pakicave në kontekstin e marrjeve të tilla. Direktiva 2012/17/BE për ndërlidhjen e regjistrave qendrorë, tregtarë dhe të shoqërive përcakton krijimin e sistemit të interkonjeksionit të regjistrave të biznesit, që përfshin një platformë qendrore evropiane përmes së cilës regjistrat kombëtarë të biznesit do t'i bëjnë të disponueshme informacionet e tyre në lidhje me mekanizmat e zbulimit ndërkufitar, duke përfshirë edhe portalin e-Drejtësisë.

*Acquis* e BE-së gjithashtu parashikon forma të caktuara evropiane ligjore: p.sh. Grupimi Evropian i Interesit Ekonomik (GEIE - Rregullorja 2137/85) dhe Shoqëria Evropiane (Societas Europaea ose SE - Rregullorja 2157/2001), duke lënë disa aspekte të strukturës së tyre të brendshme dhe të funksionimit të rregullohen përmes legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare.

Direktiva 2007/36/KE e të drejtave të aksionarëve paraqet standardet minimale për ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve në shoqëritë e listuara. Rekomandimet e Komisionit (2004/913/KE, 2005/162/KE dhe 2009/385/KE, dhe 2009/384/KE) adresojnë parimet e një qeverisje korporatash për institucionet financiare në lidhje me shpërblimin e drejtorëve, pavarësinë e drejtorëve joekzekutivë dhe komisionet e bordit. Rekomandimi i Komisionit 2014/208/BE mbi cilësinë e raportimit të qeverisjes së korporatave jep udhëzime se si shoqëritë e listuara duhet të shpjegojnë ndryshimet nga rekomandimet e kodeve përkatëse të qeverisjes së korporatave. Direktiva 2004/109/KE kërkon harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me shoqëritë e listuara.

Në fushën e kontabilitetit, *acquis* përfshin njohjen, vlerësimin dhe shpalosjen e rregullave dhe skemave për bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe humbjes për pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara (Direktiva 2013/34/BE) të shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Kjo direktivë gjithashtu përcakton se kush ka nevojë për një auditim, si dhe detyrimet e publikimit. Përveç kësaj, Rregullorja (KE) Nr. 1606/2002 mbi aplikimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, kërkon që shoqëritë tregtare të BE-së të listuara në një treg të rregulluar të hartojnë pasqyrat financiare të tyre të konsoliduara në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat janë miratuar nga Bashkimi Evropian. Sipas kësaj rregulloreje, Shtetet Anëtare gjithashtu mund të vendosin të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për pasqyrat financiare individuale dhe / ose të konsoliduara të shoqërive tregtare.

Direktiva 2006/43/KE për auditimet ligjore harmonizon rregullat duke përfshirë, ndër të tjera, miratimin dhe regjistrimin e audituesve ligjorë, sigurimin e jashtëm të cilësisë, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e audituesit dhe zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Amendimi i Direktivës 2014/56/BE përcakton kërkesat shtesë për të përmirësuar cilësinë e auditimit, me fokus në pavarësinë e audituesit, raportet e auditimit dhe mbikëqyrjen e auditimit publik. Rregullorja e re 537/2014/BE paraqet kërkesa specifike lidhur me auditimin ligjor të Njësisive të Interesit Publik (NJIP). NJIP-të janë institucione të kreditit, shoqëri të listuara, ndërmarrje të sigurimeve, dhe subjektet të tjera të përcaktuara si të tilla nga Shtetet Anëtare. Rregullorja gjithashtu parashton kërkesa specifike për organizimin e sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe kontrollon firmat e auditimit të cilat auditojnë PIE-të.

#### 6.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

##### **Situata aktuale në Shqipëri**

Sipas Raportit të Komisionit Evropian 2022 për Kapitullin 6, konstatohet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim dhe rekomandohet të finalizohet rishikimi i legjisllacionit ekzistues në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare për të identifikuar amendamentet e nevojshme për të përfunduar harmonizimin me *acquis* të BE-së dhe për të bërë progres në miratimin e ndryshimeve të tilla. Ky vlerësim është i njëjtë me atë të vitit 2021.

Në fushën e së drejtës për shoqëritë tregtare, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur. Sipas raportit të progresit të BE-së 2022, megjithëse ka disa përafrime me *acquis* të BE-së në një sërë fushash të së drejtës së kompanive, nuk ka pasur përparim legjislativ në periudhën raportuese. Nevojitet harmonizim i mëtejshëm me *acquis* të ligjit për shoqëritë 2019 për përdorimin e mjeteve dixhitale dhe për operacionet ndërkufitare, si dhe me rregullat për inkurajimin e angazhimit afatgjatë të aksionarëve. Një kod i qeverisjes së korporatës për kompanitë e listuara ende duhet të zhvillohet. Referuar rekomandimeve të adresuara nga Komisioni Evropian, në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, legjislacioni shqiptar është përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” rregullon formimin, organizimin dhe zhvillimin e organizatave të biznesit në Shqipëri. Ligji përputhet kryesisht me legjislacionin përkatës të BE-së, me amendimet e bëra me kalimin e kohës. Qendra Kombëtare e Biznesit është përgjegjëse për trajtimin e procedurave për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve dhe për regjistrimin e pronarëve përfitues. Aktualisht, duke filluar nga data 1 maj 2022, të gjitha shërbimet e QKB-së ofrohen online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, me procedura të thjeshta, brenda afateve të shkurtra dhe pa kosto për biznesin.

Më 14.05.2020 u miratua Ligji 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, i cili hyri në fuqi më 01.09.2020. Ligji “Për tregjet e kapitalit” është përafruar pjesërisht me rregulloret dhe direktivat e Bashkimit Evropian, specifikisht me Direktivën e Tregjeve në Instrumentet Financiare (MIFID II).

Projektregulloret në zbatim të ligjit të ri për tregjet e kapitalit, përfshirë rregulloren e transparencës së shoqërive të listuara, janë përgatitur nga konsulentë të huaj në kuadër të një projekti të financuar nga Sekretariati Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) dhe me mbështetje të Bankës Botërore. Projektregullorja “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara” është në përputhje me Direktivën 2004/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, për harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth emetuesve, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. Kjo rregullore është dërguar për konsultim publik dhe po kalon të gjitha etapat procedurale deri në miratimin përfundimtar të saj.

Ka përfunduar infrastruktura teknike për aplikimin e nënshkrimit elektronik (e-signature). Janë akredituar dy ofrues të Shërbimit të Certifikimit (CSHC): një publik- Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), dhe një CSHC private, “Aleat Ltd”.

Në kuadër të reformës për lehtësimin e klimës së biznesit në Shqipëri dhe si pjesë e Programit Kombëtar të Reformës Ekonomike 2014-2017, si dhe për përmirësimin e treguesve të “Doing Business”, në vitin 2015, qeveria shqiptare ndërmori një tjetër reformë në fushën e regjistrimit dhe licencimit të biznesit.

Në kuadër të kësaj reforme, u miratua dhe hyri në fuqi Ligji Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i cili synon të lehtësojë kostot e të bërit biznes, kryesisht për SME-të.

Me krijimin e një one-stop-shop të unifikuar për regjistrimin dhe licencimin e biznesit dhe për regjistrimin e pronarëve përfitues, krijohet modeli i konsolidimit të shërbimeve të biznesit në një dritare të vetme shërbimi, për të reduktuar maksimalisht vizitat fizike në shumë institucione dhe për të lejuar unifikimin e mëtejshëm të shërbimeve nëpërmjet sistemit online.

Krijimi i one-stop shop për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve dhe për regjistrimin e pronarëve përfitues ofroi thjeshtësi për biznesin, jo vetëm për regjistrimin dhe licencimin dhe regjistrimin e pronarëve përfitues, por edhe duke ofruar nëpërmjet kësaj qendre një proces të unifikuar konsultimi për regjistrimin dhe licencimin e biznesit dhe për regjistrimin e pronarëve përfitues , si dhe mbi kërkesat dhe kriteret e regjistrimit të pronarëve përfitues.

QKB administron regjistrin tregtar (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit dhe ai mbahet në format elektronik, dhe Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimet dhe Lejeve (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike për të gjitha licencat / lejet e lëshuara në Shqipëri si dhe Regjistrin e Pronarëve Përfitues, i cili është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilin regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin e raportimit të tyre, që mbledh në kohë reale të dhënat e regjistruara në regjistrat respektivë shtetërorë të administruara nga institucionet shtetërore përkatëse, si dhe shërben si arkiv elektronik zyrtar dhe siguron transparencën në fushën e pronarëve përfitues.

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë reformën e dixhitalizimit të shërbimeve publike, me qëllim kryesor shmangien e shërbimit fizik, si dhe thjeshtimin dhe lehtësimin e të gjithë procesit falë infrastrukturës dixhitale.

Në kuadër të kësaj reforme, duke nisur nga viti 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për ofrimin e shërbimeve të saj në fushën e regjistrimit dhe licencimit të bizneseve, si dhe regjistrimin e pronarëve përfituesve vetëm online nëpërmjet portalit të qeverisë e-Albania.

Aktualisht, duke filluar nga data 1 maj 2022, të gjitha shërbimet e QKB-së ofrohen vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, me procedura të thjeshta, brenda afateve të shkurtra dhe pa kosto për biznesin.

Ligji Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, është amenduar në shkurt të vitit 2015 me Ligjin Nr. 8/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007” “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, duke u përshtatur më tej me Direktivën 2009/101/KE me qëllim dorëzimin në formë elektronike të bilanceve vjetore dhe raporteve të auditimit nga shoqëritë tregtare.

Subjekti do të regjistrojë dhe dorëzojë në regjistrin tregtar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e progresit të aktivitetit dhe raportin e auditimit, të mbajtur në përputhje me kërkesat ligjore, në

rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Dorëzimi i tyre bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit e-Albania.

Me qëllim përmirësimit akoma edhe me tej të procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, është implementuar projekti “Përmirësimi i cilësisë së Raportimit Financiar” me ndihmën e Bankës Botërore. Me anë të këtij projekti është mundësuar:

- Përcaktimi qartësisht i dokumenteve që duhet të hartohen nga subjektet, në varësi të klasifikimit të tyre, gjatë procesit të raportimit financiar;
- Rritja e mëtejshme të transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar;
- Përpunimi dhe gjenerimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare
- Zbatimi i formatit (sistemit) të ri për dërgimin e deklaratave të shërbimit në QKB, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, duke përdorur një format komunikimi elektronik (XML).

Pra, ligjërish dhe teknikisht, është mundësuar që pasqyrat financiare dhe raportet përkatëse të depozitohen në mënyrë elektronike në regjistrin tregtar. Aktualisht, po punohet për bërjen e zhvillimeve të nevojshme në sistemin elektronik me qëllim publikimin e një prej raporteve të dorëzuara nga subjektet, së bashku me pasqyrat financiare, që për arsye teknike nuk kanë mundur të publikohen.

Progres i mëtejshëm është bërë me miratimin e Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” që përafron legjislacionin shqiptar me kërkesat e direktivës 2005/56/KE të BE-së, datë 26 tetor 2005 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar” e ndryshuar. Me miratimin e Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare” u mundësua bashkimi ndërkufitar i një shoqërie të huaj dhe shoqërie shqiptare. Gjithashtu, në përputhje me dispozitat e ligjit të sipërpërmendur, Qendra Kombëtare e Biznesit ka zhvilluar funksione të reja në regjistrin elektronik tregtar, të cilat mundësojnë aplikimin për bashkim ndërkufitar ndërmjet një shoqërie të huaj dhe një shoqërie shqiptare. Megjithatë, aktualisht aplikimi mund të bëhet vetëm për bashkimin ndërkufitar që rezulton në krijimin e një shoqërie të re shqiptare.

Bazuar në rekomandimet e MONEYVAL, është miratuar Ligji Nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore përkatëse. Me miratimin e këtij ligji, u bë i mundur përcaktimi i pronarit përfitues, subjekteve raportuese që kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë në regjistër të dhënat e pronarëve të tyre përfitues dhe procedura dhe afatet e nevojshme për regjistrimin e të dhënave të pronarët përfitues. Gjithashtu, me miratimin e këtij ligji, u krijua Regjistri i Pronarëve Përfitues, i cili administrohet nga QKB. Regjistri i Pronarëve Përfitues është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilën regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin t’i raportojnë, i cili mbledh në kohë reale të dhënat e regjistruara në regjistrat shtetërorë përkatës të administruar nga institucionet shtetërore



përkatëse, si dhe shërben si arkiv zyrtar elektronik dhe siguron transparencë në fushën e pronarëve përfitues.

Përsa i përket ofertave të marrjes në detyrë, Shqipëria ka transpozuar plotësisht Direktivën 2004/25/KE “Për ofertat e marrjes në detyrë” sipas Ligjit Nr. 10236 datë 18.2.2010 “Për marrjen nën kontroll të shoqërive me ofertë publike”.

*Në fushën e kontabilitetit të korporatave*, prej vitit 2008 janë shpallur të detyrueshme për zbatim Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (përfshirë përditësimet e vazhdueshme të tyre) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit përmirësuar janë në fuqi nga 01 janari 2015. Kërkesat e standardeve kombëtare të përmirësuar janë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) për Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla (SME-të), ndërsa paraqitja e pasqyrave financiare është plotësisht e përafuar me kërkesat e Direktivës së BE-së 2013/34 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e amenduar (Direktiva e Kontabilitetit).

Në lidhje me këtë nënfushë, është arritur progres në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së në fushën e kontabilitetit të korporatave përmes miratimit të ligji të kontabilitetit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili synonte përafrimin e mëtejshëm me *acquis* në fushën e kontabilitetit të shoqërive tregtare, konkretisht me Direktivën Nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 26 qershor 2013, ku progres vihet re dhe në zbatimin e këtij ligji.

Kapaciteti i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i cili përkthen pa ndryshime nga origjinali SNRF-të, harton dhe mirëmban standardet e kontabilitetit si dhe monitoron zbatimin e të dyja seteve të raportimit financiar, duhet të përforcohet dhe më shumë. Gjithsesi, në ndryshimet ligjore të reja, në ligjin e ri të kontabilitetit, është parashikuar detyrë specifike për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, në nenin 24, pika f) e cila përcakton “të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar”, e cila nuk ka qenë e përfshirë në ligjin e mëparshëm.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka rishikuar shënimet shpjeguese për njësitë e vogla të përcaktuara në SKK, në mënyrë që t’i pakësojë ato në masën e parashikuar në Direktivën 34/2013, art. 16 “Përmbajtja e shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare në lidhje me të gjitha ndërmarrjet” dhe pikat (a), (m), (p), (q) dhe (r) të Artit. 17 (1) “Shënime shpjeguese për njësitë e mesme dhe të mëdha dhe njësitë me interes publik”.

Rishikimi i shënimeve shpjeguese ka përfunduar dhe ndryshimet janë shpallur të detyrueshme për zbatim nga ministri përgjegjës për financat me Urdhrin nr. 42, datë 11.02.2022.

Gjithashtu, nëpërmjet përdorimit të SNRF -të në Shqipëri, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha PIE-të (përveç atyre njërive ekonomike që klasifikohen si PIE-të për shkak të natyrës, madhësisë dhe numrit të punonjësve të tyre, por nuk i kalojnë pragjet e përcaktuara në Ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Art. 4, pika 1.3), kemi përafrim të plotë me Rregulloren

Nr. 1606/2002 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 19 Korrik 2002 mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Gjatë vitit 2022, vijon procesi i nisur që në vitin 2021 për rishikimin e udhëzuesve për zbatimin e SKK-ve me qëllim përmirësimin e cilësisë së zbatimit të standardeve nga profesionistët dhe përdoruesit e informacionit financiar.

Gjithashtu, po rishikohen të plota të gjitha SKK për NVM-të për t'i bërë ato të pajtueshme me kërkesat e SNRF për SME si dhe për të reflektuar disa prej kërkesave të Direktivës së Kontabilitetit në BE, të cilat nuk u përfshinë në ligjin e kontabilitetit, i cili hyri në fuqi nga janari 2019.

Ligji i ri nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” është harmonizuar pjesërisht me Direktivën Nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 26 qershor 2013. Gjithashtu, nëpërmjet përdorimit të Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar SNRF-të në Shqipëri, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha njësi ekonomike me interes publik PIE-të (përveç atyre njësi ekonomike që klasifikohen si PIE-të për shkak të natyrës, madhësisë dhe numrit të punonjësve të tyre, por nuk i kalojnë pragjet e përcaktuara në Ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Art. 4, pika 1.3), kemi përafrim të plotë me Rregulloren nr. 1606/2002 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 19 Korrik 2002 mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Gjithashtu, KKK ka publikuar Udhëzuesin për përgatitjen e raportit jofinanciar, si metodologji për raportimin e informacionit jofinanciar, i cili transponon Komunikatën e Komisionit Evropian “Udhëzues për raportimin jo-financiar” (COMMUNICATION FROM THE EUROPEAN COMMISSION Guidelines on non-financial reporting (methodology for reporting non-financial information) (2017/C 215/01).

*Në lidhje me fushën e auditimit ligjor*, Ligji Nr. 10091 datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar synoi krijimin e bordit të mbikëqyrjes publike si një strukturë e përhershme nga burimet e veta financiare. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), i themeluar si autoritet i pavarur rregullator me burimet e tij financiare shërben për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë e auditimeve të kryera.

Gjatë vitit 2019, në zbatim të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 të auditimit ligjor, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 17 datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, gjatë periudhës 2018 – 2021, u fokusua në krijimin e kuadrit të nevojshëm rregullator, si kërkesë e parashikimeve ligjore, duke hartuar e miratuar një sërë rregulloresh që lidhen me funksionimin e strukturës së tij mbështetëse, mbledhjen e të ardhurave, kryerjen e kontrollit të sigurimit të cilësisë, investigimin dhe disiplinën.

Prej korrikut të vitit 2019 është bërë e mundur zbatimi i rregullores Nr. 4 “Për investigimin dhe procedurat e marrjen e masave disiplinore” nëpërmjet krijimit të strukturave të përshtatshme, për implementimin e saj, si pjesë integrale e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka emëruar Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës, i cili prej korrikut të vitit 2019 ka propozuar marrjen e masave disiplinore për auditues ligjorë/shoqëri auditimi, si dhe në shqyrtim të kontabilistëve të miratuar në proces.

Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës i Bordit të Mbikëqyrjes Publike vijon aktivitetin për shqyrtimin e papajtueshmërive të subjekteve të mbikëqyrura dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse lidhur me të gjitha subjektet që ka indicie dhe konstatohen gjetje që ofrojnë shërbime të auditimit apo kontabiliteti në mënyrë të paligjshme që bien ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor ,organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve kryesore të tij, BMP luan rol aktiv për bashkëpunimin me institucione të tjera të tilla si, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe institucione të tjera rregullatore me qëllim realizimin e vizionit mbikëqyrës. Në këtë kuadër është zhvilluar më tej bashkëpunimi ndërmjet BMP-së dhe rregullatorëve financiarë (Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) me fokus në çështjet e auditimit.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike është gjithashtu në proces të përmbushjes së gjithë kërkesave të parashtruara në rekomandimet e Moneyval dhe të planit të veprimit të ICRG/FATF. Në këtë kuadër, të tilla kërkesa janë përfshirë edhe në procesin e kontrollit të cilësisë së audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka përfunduar procesin e përafrimit të Rregullores 537/2014 të KE (Rregullorja 537/2014 për auditimin) mbi kërkesat e posaçme në lidhje me auditimin ligjor të njësisve ekonomike me interes publik, për sa është e aplikueshme, nëpërmjet Rregullores Nr. 7 datë 02.10.2018 “Për procedurat dhe metodologjinë e Kontrollit të Cilësisë të Auditimit Ligjor”. Në këtë kontekst, janë përafuar neni 4, neni 5, neni 15, përafrim i pjesshëm i nenit 27, i rregullores 537/2014 për auditimin. Gjithashtu, një pjesë e madhe e dispozitave të Direktivës 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 17 Maj 2006 mbi auditim ligjor të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, që ndryshon Direktivën e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit 84/253/KEE, janë të reflektuara edhe në dispozitat e ligjit 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar. Ato dispozita të cilat janë përafuar pjesërisht ose nuk janë përafuar me ligjin e auditimit dhe me rregulloren nr. 7 datë 02.10.2018 “Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë të auditimit ligjor”, të cilat janë dispozita të pazbatueshme në kontekstin tonë ose janë të parëndësishme për momentin, do të rishikohen në periudhat në vijim.

## **Përmbledhje e arritjeve kryesore**

## *Shoqëritë tregtare*

Progres i mëtejshëm është bërë me miratimin e Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” që përaftron legjislacionin shqiptar me kërkesat e direktivës 2005/56/KE të BE-së, datë 26 tetor 2005 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar” e ndryshuar. Me miratimin e Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare” u mundësua bashkimi ndërkufitar i një shoqërie të huaj dhe shoqërie shqiptare. Gjithashtu, në përputhje me dispozitat e ligjit të sipërpërmendur, Qendra Kombëtare e Biznesit ka zhvilluar funksione të reja në regjistrin elektronik tregtar, të cilat mundësojnë aplikimin për bashkim ndërkufitar ndërmjet një shoqërie të huaj dhe një shoqërie shqiptare. Megjithatë, aktualisht aplikimi mund të bëhet vetëm për bashkimin ndërkufitar që rezulton në krijimin e një shoqërie të re shqiptare.

Në shkurt 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) nënshkroi një marrëveshje për pjesëmarrjen e regjistrimit tregtar shqiptar në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtar të Europës Juglindore (BIFIDEX). Falë këtij projekti, mundësohet komunikimi në kohë reale i të dhënave të besueshme, të përditësuara për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në regjistrat tregtarë të vendeve pjesëmarrëse, si dhe baza për krijimin e shërbimeve globale për të gjitha subjektet në vendet pjesëmarrëse. Portali Rajonal i Regjistrave Tregtar të Europës Juglindore (BIFIDEX) mundëson gjithashtu ndërlidhjen e bizneseve shqiptare me ato të rajonit, duke mundësuar rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të vendeve të rajonit.

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë reformën e dixhitalizimit të shërbimeve publike, me qëllim kryesor shmangien e shërbimit fizik, si dhe thjeshtimin dhe lehtësimin e të gjithë procesit falë infrastrukturës dixhitale.

Në kuadër të kësaj reforme, duke nisur nga viti 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për ofrimin e shërbimeve të saj në fushën e regjistrimit dhe licencimit të bizneseve, si dhe regjistrimin e pronarëve përfituesve online nëpërmjet portalit të qeverisë e-Albania.

Aktualisht, duke filluar nga data 1 maj 2022, të gjitha shërbimet e QKB-së ofrohen online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, me procedura të thjeshta, brenda afateve të shkurtra dhe pa kosto për biznesin.

Gjithashtu, me finalizimin e rishikimit të legjislacionit ekzistues në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare për të identifikuar ndryshimet e nevojshme për të përfunduar harmonizimin me acquis të BE-së dhe për të bërë përparim në futjen e këtyre ndryshimeve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vijojë me procesin e analizës së mangësive ligjore dhe kryerjes së amendimeve të ligjit të shoqërive tregtare.

## **Kontabiliteti**

Në kuadër të rekomandimit të KE, ku sipas së cilit në fushën e kontabilitetit të shoqërive ligji i ri për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare është përafuar pjesërisht me Direktivën, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka rishikuar shënimet shpjeguese për njësitë e vogla të përcaktuara në SKK, në mënyrë që t'i pakësojë ato në masën e parashikuar në Direktivën 34/2013, art. 16 “Përmbajtja e shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare në lidhje me të gjitha ndërmarrjet” dhe pikat (a), (m), (p), (q) dhe (r) të Artit. 17 (1) “Shënimet shpjeguese për njësitë e mesme dhe të mëdha dhe njësitë me interes publik”. Shënimet shpjeguese kanë përfunduar dhe janë publikuar për komente në faqen e KKK. Procesi pritet të përfundojë në 20 janar 2022.

Në përputhje me praktikën vjetore të BSNK-së, është përgatitur versioni i konsoliduar i SNRF-ve (2022) në gjuhën shqipe dhe është publikuar në faqen e internetit të KKK.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar arritjet si më poshtë vijon:

- Ka përfunduar rishikimi i të gjithë udhëzuesve për zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (1 – 14).
- Është në proces rishikimi i thelluar i të gjitha SKK-ve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë janë shpallur ndryshimet si më poshtë vijon:

- Shpalljen e ndryshimeve të shënimeve shpjeguese të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) për njësitë ekonomike të vogla;
- Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike”, (SKK 15”);
- Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17
- “Kontratat e Sigurimit”;
- Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 16
- “Qiratë”.

## **Auditimi**

BMP ka realizuar një proces mbikëqyrje që mbështetet mbi një analizë risku dhe një metodologji të mirëfilltë në kryerjen e kontrollit të cilësisë ndaj auditimeve ligjore. Me qëllim rishikimin e cilësisë së auditimit dhe sigurimin e promovimit të përmirësimit të cilësisë së auditimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, BMP gjatë 2019 – 2022 ka realizuar inspektimin e 30 shoqërive audituese/audituesve ligjorë dhe 49 angazhimeve individuale të realizuara nga subjektet e kontrolluara. Ndërkohë, në të njëjtën periudhë kohore është realizuar inspektimi tematik për çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit për 9 subjekte të tjera.

Gjithashtu, për herë të parë, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka publikuar renditjen në tregun e auditimit për personat fizikë dhe personat juridikë të ndarë përkatësisht sipas formës së organizimit, duke konsideruar volumin e të ardhurave nga shërbimet e auditimit dhe volumin e

numrit të klientëve. Publikimi i konsoliduar i renditjes, sipas këtyre dy kriterëve, është bërë pavarësisht formës juridike të organizimit. Ky publikim është i pari në llojin e tij në 23 vite që ekziston profesioni kontabël.

Në zbatim të rregullores Nr. 12 datë 02.07.2020 të BMP-së “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, që shërben si udhëzues për matjen e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si pjesë e rregullores dhe manualit për mbikëqyrjen e subjekteve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, BMP ka miratuar një plan inspektimi për vitin 2022, për inspektimin tematik të 4 subjekteve audituesë ligjorë dhe 2 subjekte kontabilistë të miratuar.

Në kuadër të rekomandimeve të KE, gjatë gjithë periudhës, inspektorët e BMP-së kanë kryer inspektimin në vend të Komitetit të Regjistrimit të IEKA-s, në lidhje me procedurat e ndjekura mbi veprimtarinë e regjistrimit të saj. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, me mbështetjen e Bankës Botërore, BMP ka rishikuar dhe përmirësuar kuadrin rregullator të provimeve për kandidatët për auditues ligjor dhe kontabilist i miratuar, përkatësisht rregulloren Nr. 2 datë 22.02.2018 “Për funksionimin e komisionit të provimeve të aftësive profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar”, e ndryshuar me Vendimin nr. 69, datë 16.10.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Në kuadër të rekomandimeve të KE, ku evidentohet se Shqipëria duhet të vazhdojë të forcojë kapacitetin e BMP dhe të harmonizohet me rregullat e auditimit ligjor, gjatë vitit 2022, kanë përfunduar 8 inspektime të kontrollit të sigurimit të cilësisë për audituesit ligjorë me përvojë më pak se 5-vite, janë realizuar 5 ndjekje investigimesh me procedurë të kontrollit të cilësisë dhe ndërkohë janë në proces 4 inspektime të sigurimit të cilësisë..

Me ringritjen e Komisionit të Investigimit dhe Masave Disiplinore të BMP ’së, ka vijuar aktivitetin për shqyrtimin e papajtueshmërive të subjekteve të mbikëqyrura dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse. Konkretisht, BMP ka ndërmarrë:

- 1 masë disiplinore “Pezullim i përkohshëm i kufizuar, në kategorinë e shërbimit të auditimit dhe shërbimeve lidhur me të për një afat 6 muaj”;
- 1 masë “Pezullim license për 12 muaj”, bazuar në nenin nr. 55, pika d e Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor ,organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar;
- 21 masa administrative gjobë për auditues ligjorë / shoqëri auditimi të cilët kanë audituar me një auditues të vetëm shoqëritë aksionare ose shoqëritë që raportojnë sipas kuadrit të raportimit financiar SNRF;
- 1 masë “Pezullim me kusht për plotësim dokumentacioni, për një afat 15 ditë”;
- 1 masë administrative me gjobë në vlerën 5.000.000 lekë për papajtueshmëri me Ligjin Nr. 10091/2009, i ndryshuar, sipas nenit 58 pika 1, ku përcaktohet se: “Ushtrimi i profesionit të audituesit ligjor apo përdorimi i emërtimeve si shoqëri audituese, pa qenë i regjistruar më parë në regjistrin publik të Audituesve ligjorë, si dhe përdorimi i çfarëdo titulli, që

*synon të krijojë ngjashmëri ose konfuzion me këta tituj profesionalë apo emërtime, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 5.000.000 deri në 10.000.000 lekë.”*

Komisioni i Investigimit dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike do të vijojnë aktivitetin për shqyrtimin e papajtueshmërive të subjekteve të mbikëqyrura dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse lidhur me të gjitha subjektet që ka indicie dhe konstatohen gjetje që ofrojnë shërbime të auditimit apo kontabiliteti në mënyrë të paligjshme që bien ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor ,organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*”, i ndryshuar, si dhe do shqyrtohen të gjitha rastet e ushtrimit të veprimtarisë së audituesve ligjorë që bien ndesh me dispozitat e ligjit 10091/2009.

BMP do të vijojë realizimin e veprimtarisë së vet, me fokus të veçantë kontrollin e cilësisë ndaj auditimeve të njërive ekonomike me interes publik, si dhe marrjen e masave disiplinore në rastet përkatëse.

#### 6.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Bordi i Mbikëqyrjes Publike
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Banka e Shqipërisë

#### 6.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

##### Shoqëritë Tregtare

Prioritetet në këtë fushë janë:

Sipas raportit të BE-së, në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet në veçanti të konsiderojë:

- Rishikimin e legjislacionit ekzistues në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare me qëllim identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për të përfunduar përafrimin me *acquis* të BE-së,
- Përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe auditimin me *acquis* më të fundit të BE-së në këto fusha.

Mangësitë e identifikuara:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë po bashkërendon me donatorët potencialë mbi mundësinë e ofrimit të një asistencë teknike prej tyre në MFE për të ndihmuar gjatë procesit të analizës së mangësive dhe kryerjes së amendamenteve të ligjit, të nevojshme për të përfunduar përafrimin me *acquis* të BE-së.

## Kontabiliteti dhe Auditimi

Prioritetet në këtë fushë janë:

Në përmbushje të rekomandimeve të Komisionit Evropian si dhe analizës së arritjeve dhe mangësive në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, në lidhje me kapitullin 6 vlerësohen prioritetet si më poshtë:

- Përafrimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për kontabilitetin me *acquis* më të fundit të BE-së në këtë fushë.
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe harmonizimi me rregullat e auditimit ligjor të BE.

Mangësitë e identifikuar:

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka nevojë për draftimin e një metodologjie monitorimi si dhe të rrisë kapacitetet njerëzore për monitorimin e implementimit të NAS dhe IFRS në pasqyrat financiare vjetore.

Nga tabelat e përputhshmërisë që shoqëron miratimin e ligjit, vihet re që ka ende disa çështje si pragjet apo kufijtë, të cilat nuk janë në përputhje të plotë me Direktivën. Kjo ndodh për shkak se kërkesat e paraqitura në këto nene janë:

1. Opsionale edhe për shtetet anëtare; ose
2. jo relevante ose jo të zbatueshme për njësitë ekonomike shqiptare.

Ndërsa, referuar fushës së auditimit ligjor, Ligji Nr. 10091 datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, është në një nivel shumë të gjerë në përputhje me kërkesat e vendosura nga Direktiva 2014/56/BE si dhe Rregullorja e re 537/2014/BE. Nga tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë këtë ligj, vihet re që ka ende disa çështje specifike, të cilat nuk janë në përputhje të plotë me Direktivën dhe Rregulloren.

Në këtë kuadër, në bashkëpunim me Bankën Botërore, janë marrë masat për amendimin e mëtejshëm të këtij projekt-akti, në kuadër të përputhshmërisë (harmonizimit) së mëtejshme me *acquis* të Bashkimit Evropian, në vijim të procesit të integritetit të vendit tonë në Bahskimin Evropian. Çështjet kryesore që do të rregullojë projektakti lidhen me:

- a) Mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Njësisve Ekonomike me Interes Publik (PIE) përse i përket çështjeve të auditimit të tyre;



- b) Raportimi që duhet të realizohet nga audituesit në lidhje me konsolidimin e pasqyrave financiare;
- c) Ngritja e strukturave të kontrollit të brendshëm dhe mënyra e funksionimit të tyre në shoqëritë e auditimit;
- d) Masat që duhet të merren nga audituesit në lidhje me pavarësinë dhe objektivitetin e tyre.

## KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

### 7.1 Përmbajtja e kapitullit

*Acquis* mbi të drejtat e pronësisë intelektuale specifikon rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Dispozita të veçanta zbatohen për mbrojtjen e bazave të të dhënave, programeve kompjuterike, topografive të gjysmëpërçuesve, transmetimit satelitor dhe ritransmetimit kabllor. Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, *acquis* përcakton rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të markave dhe disenjove. Dispozita të tjera specifike zbatohen për shpikjet bioteknologjike, farmaceutike dhe produktet për mbrojtjen e bimëve. *Acquis* gjithashtu përcakton një markë tregtare të Komunitetit dhe dizajnin e Komunitetit. Së fundi, *acquis* përmban rregulla të harmonizuara për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si dhe të drejtave të pronësisë industriale. Kërkohen mekanizma të përshtatshëm zbatues, në veçanti kapacitete efektive të zbatimit.

### 7.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli Pronësia Intelektuale ndahet në tre nënkapituj si më poshtë:

- Pronësia industriale
- E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura
- Zbatimi i të drejtave të pronësisë industriale

### 7.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së. Përafrimi i ligjit shqiptar me *acquis* të BE-së për pronësinë intelektuale ka filluar shumë vite më parë dhe tashmë ka arritur nivele të mira përputhshmërie.

Neni 73 Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se:

- Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, Shqipëria dhe Bashkimi Evropian konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.
- Shqipëria merr përsipër masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje si dhe një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.
- Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.
- Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.
- Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe sigurimi i një niveli mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e Qeverisë Shqiptare parashikuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, (neni 73). Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e pronësisë intelektuale me *acquis*, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

Për sa i përket legjislacionit të Bashkimit Evropian, ai pjesërisht duhet të transpozohet përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Por, disa nga aktet ligjore që rregullojnë pronësinë intelektuale do të fillojnë të zbatohen vetëm pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Veçanërisht, Rregullorja 2017/1001 për markën e BE-së, Rregullorja 6/2002 për dizajnin e Komunitetit, Rregullorja 1257/2012 për Konventën Evropiane të Patentave, Rregullorja 1260/2012 për regjimin gjuhësor për Patentat Evropiane, përmbajnë regjime vetë-ekzekutuese të cilat do të zbatohen plotësisht për Shqipërinë vetëm pas aderimit.

Duhet të theksohet gjithashtu se në fushën e pronësisë intelektuale (përfshirë pronësinë industriale), Shqipëria, ashtu si shumë vende të tjera candidate dhe vetë shtetet anëtare të BE-së, është gjithashtu palë në një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare. Për shembull, pas anëtarësimit të saj në Organizatën Botërore të Tregtisë, Shqipëria është palë e Marrëveshjes për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPS). Ajo është gjithashtu palë në disa Marrëveshje të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Së bashku, ato formojnë një grup rregullash që duhet të pasqyrohen në rendin juridik kombëtar.

#### 7.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje/është e përgatitur mesatarisht për të drejtat e pronësisë intelektuale. Më datë 19 – 20 janar 2023 u zhvillua në Bruksel takimi bilateral midis BE dhe

Shqipërisë për Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale”. U përgatitën 22 prezantime nga pala shqiptare për takimin bilateral. Shqipëria ka marrë angazhimin që të zbatojë acquis e BE-së dhe për këtë deri në vitin 2025 do të përfundojë reformën ligjore në fushën e pronësisë industriale në përputhje me acquis e BE-së, duke hartuar një ligj më vete për çdo objekt të pronësisë industriale.

Dokumenti më i rëndësishëm në fushën e pronësisë intelektuale është Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022 – 2025 e miratuar me VKM nr. 350 datë 26.05.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022 – 2025”. Hartimi i Strategjisë u mbështet me ekspertizë teknike nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale. Kjo është strategjia e tretë në fushën e pronësisë intelektuale dhe se tashmë institucionet shqiptare janë më se të ndërgjegjësuar për detyrat e veta funksionale në procesin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për pronësinë intelektuale. Miratimi i kësaj Strategjie dhe zbatimi i saj synojnë pronësinë intelektuale. Miratimi i kësaj Strategjie dhe zbatimi i saj synojnë zhvillimin e kuadrit zhvillimin e kuadrit ligjor dhe forcimin e zbatimit të tij nga të gjitha ministrinë dhe institucionet sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë.

Në kuadër të kësaj strategjie në fushën e pronësisë intelektuale Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale do të ndërmarrë një reformë ligjore në fushën e pronësisë industriale duke hartuar një ligj të veçantë për çdo objekt të pronësisë industriale. DPPI ka filluar punën në lidhje me hartimin e dy ligjeve të para, atë të markave tregtare dhe ligjit për patentat dhe modelet e përdorimit.

Deri në përfundim të Strategjisë Kombëtare në fushën e Pronësisë Intelektuale DPPI do të ketë përfunduar miratimin e 4 ligjeve të veçanta për çdo objekt të pronësisë industriale.

Në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, është përafuar plotësisht me:

- Direktivën 2006/116/KE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura” e amenduar;
- Direktivën 2004/48/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- Direktivën 2001/29/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 maj 2001 mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit;
- Direktivën 2001/84/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 27 shtator 2001 mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre origjinale të artit;
- Direktivën 96/9/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave;
- Direktivën 2009/24/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009 mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike;
- Direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën e kreditimit dhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale”.

- Direktivën 2011/77/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, datë 27 shtator 2011 që ndryshon Direktivën 2006/116/KE mbi afatin e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe disa të drejtave të lidhura me to.

Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993 mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllore;
- Direktivën 2014/26/ BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi-territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm;
- Direktivën 2012/28/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 25 tetor 2012 për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor;
- Direktivën 2017/1564/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 13 shtator 2017 mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara dhe ndryshimin e Direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit.”

Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” është ndryshuar së fundmi për të përafuar më tej në legjislacionin shqiptar Direktivën 2012/28/BE me synim për të zgjidhur problemin konkret të përcaktimit ligjor të statusit të veprës pa autor dhe të pasojave përkatëse në lidhje me përdoruesit dhe përdorimet e lejuara të veprave apo të fonogrameve që konsiderohen si vepra pa autor, si dhe Direktivën 2017/1564/BE me qëllim përcaktimin e mënyrës së përdorimit të lejuar dhe realizimin e kopjeve në format të aksesueshëm nga personat përfitues apo subjektet e autorizuar; Ndryshime lidhur me funksionimin dhe organizimin e sportelit unik.

Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, kuadri ligjor përfshin së pari, Ligjin Nr. 9947 “Për pronësinë industriale”, (i ndryshuar). Ky Ligj është plotësisht i përafuar me *acquis* e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 98/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 korrikut 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;
- Direktiva 98/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të disenjove;
- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 6/2002 e datës 12 dhjetor 2001 mbi disenjot e Komunitetit;
- Direktiva 87/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Dhjetor 1986 mbi mbrojtjen ligjore të topografive dhe produkteve gjysmëpërçues;
- Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;

- Direktiva 2015/2436/KE, dt. 16.12.2015 për harmonizimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat tregtare;
- Rregullorja Nr. 1151/2012/KE të datës. 21.11.2012 për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore;
- Rregullorja Nr. (KEE) Nr. 1308/2013/KE dt. 17.12.2013 për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe shfuqizimin e rregulloreve (KEE) Nr. 922/72, (KEE) Nr. 234/79, (KE) Nr. 1037/2001 dhe (KE) Nr. 1234/2007”.
- Direktiva 2016/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 maj 2016 mbi mbrojtjen e njohurive dhe informacioneve të biznesit kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të tyre të paligjshëm (sekreti tregtar).

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale si dhe Drejtoria e të Drejtës së Autorit pranë Ministrisë së Kulturës janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuara direkt me çështjet e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale bashkëpunon me Drejtorinë e të Drejtave të Autorit në aktivitete të përbashkëta, siç parashikohet edhe në dokumentet strategjike.

Të dy institucionet përgatisin, promovojnë, shpërndajnë materiale informative, organizojnë fushata sensibilizimi për institucionet, grupet e interesit dhe publikun nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar, si dhe aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si seminare, konferenca, trajnime etj. Ato bashkëpunojnë me një sërë institucioneve të tjera, siç janë Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve etj., të cilat janë pjesë e mekanizmit zbatues të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunimi ndërinstitucional, ka rezultuar i suksesshëm në rritjen e ndërgjegjësimit, vendosjen e ekuilibrave të duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të Pronësisë Intelektuale dhe interesave të përdoruesve dhe luftën kundër informalitetit.

Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale rritet çdo vit në përputhje me zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe ndërgjegjësimin e subjekteve tregtare për rëndësinë e të drejtave të pronësisë industriale.

Gjatë vitit 2022, DPPI ka zhvilluar takime ndërgjegjësuëse me bizneset në 7 qytete të Shqipërisë. DPPI zhvilloi po ashtu, një workshop kombëtar për lancimin e versionit shqip “Idetë sipërmarrëse: Një udhëzues për pronësinë intelektuale për startup-et”. Ky botim ofron udhëzime mbi mënyrën se si bizneset e reja (start-up) mund ta përdorin sistemin e pronësisë intelektuale për të qëndruar konkurrues dhe kuptuar rreziqet që mund të lindin nëse sistemi i pronësisë intelektuale shpërfillet.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale nënshkroi ripërtëritjen e memorandumit të mirëkuptimit me Zyrën Turke të Patentave dhe Markave më datë 15 korrik 2022 dhe është duke rinovuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Zyrën e Patentave të Republikës së Polonisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) në kuadër të projektit të ndërmarrë mbi Studimin, Identifikimin dhe Regjistrimin e Markave Tregtare si dhe Disenjove Industriale në RSH si dhe në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 gjatë muajit nëntor-dhjetor, ka zhvilluar në qytetet kryesore të vendit, takime dhe panairë me biznese dhe artizanë mbi promovimin e produkteve “Made in Albania”.

Në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale DPPI ndërmori një serë aktivitete të përgjatë gjithë muajit prill të vitit 2022, si Konferencën Kombëtare të Pronësisë Intelektuale me sloganin “Pronësia Intelektuale dhe Rinia - Inovacion për një të ardhme më të mirë”, leksione të hapura me studentët e disa institucioneve të arsimit të lartë, organizimin e një workshopi me teme Komercializimin e Pronësisë Intelektuale, si dhe ngritjen e dy stendave në Tiranë që mundësuan shpërndarjen e broshurave dhe materialeve promovuese mbi objektet e PI-së.

Përgjatë vitit 2022, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë paraqitur për regjistrim marke në total 1 165 aplikime, në krahasim me 1 404 aplikime në vitin 2021. Nëse do t'i referohemi periudhës 2015 – 2022, trendi i aplikimeve kombëtare ka qenë një trend rritës. Në totalin prej 1 165 të aplikimeve kombëtare për regjistrim marke, aplikimet nga subjektet shqiptare në vitin 2022 arritën në 735. Në numrin total të aplikimeve në % për vitin 2022, aplikimet ndërkombëtare zënë 63% kurse aplikimet kombëtare zënë 37 % nga të cilat aplikime kombëtare nga aplikantë të huaj zënë rreth 13.6% dhe aplikimet me aplikant vendas zënë 23.3%. Në numrin total të aplikimeve në % për vitin 2021, aplikimet ndërkombëtare zënë 65%, aplikimet kombëtare nga aplikantë të huaj 13% dhe aplikimet vendase zënë 22%. Gjatë vitit 2022, janë lëshuar në total 963 certifikata regjistrimi marke kombëtare. Kurse nga Marrëveshja e Madridit për vitin 2022 janë regjistruar 2016 aplikime ndërkombëtarë. Gjatë vitit 2022 sektori i Patentave dhe Modeleve të Përdorimit ka pasur 621 aplikime për patenta nga të cilat 20 janë aplikime për patenta kombëtare me aplikantë shtetas shqiptarë dhe 601 aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga Zyra Evropiane e Patentave të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Numri i aplikimeve për patenta kombëtare është 20 për vitin 2022 pra është në nivel të përafërt krahasuar me 23 aplikime për patenta kombëtare në vitin 2021.

Një tjetër prioritet i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale ishte forcimi dhe fuqizimi i Qendrës së Trajnimeve të DPPI. Qendra e Trajnimeve ka ofruar një sërë trajnimesh në fushën e pronësisë intelektuale për pjesëmarrësit dhe grupet e ndryshme të interesit. Për herë të parë në këtë qendër, përmes aplikacionit online në portalin e-Albania, u ofruan trajnime me certifikatë për përfaqësuesit e autorizuar.

Trajnimi i mësuesve në shkallë vendi në lidhje me lëndën e pronësisë intelektuale u realizua përgjatë vitit 2022, si një indikator shumë i qëndrueshëm në edukimin e brezave në fushën e pronësisë intelektuale. Në trajnime morën pjesë mësues nga Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë dhe Kukës.

Drejtoria e të Drejtave të Autorit, pjesë e Ministrisë së Kulturës, ushtron veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i

ndryshuar. Kjo Drejtoria bashkëpunon me autoritetet shtetërore kompetente, aktorë të cilët kanë një rol të rëndësishëm në fushën e të drejtave të autorit.

Ministria e Kulturës gjatë vitit 2021 përgatiti ndryshimet në Ligjin Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” për të përafuar më tej legjislacionin e Bashkimit Evropian, konkretisht duke përafuar pjesërisht Direktivën (BE) 2017/1564 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 shtator 2017 mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, dhe amendimin e Direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit dhe Direktivën 2012/28/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetor 2012 për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor. Ky projektligj u konsultua me shërbimet e Komisionit Evropian. Ligji nr. 37/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” është miratuar më datë 14.04.2022 dhe ka hyrë në fuqi në datë 11 gusht 2022.

Administrimi kolektiv kryhet nga agjencitë e administrimit të të drejtave të autorit, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre të titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Agjencia e administrimit kolektiv licencohet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga Drejtoria e të Drejtës të Autorit (DDA). Licenca e agjencive të administrimit kolektiv për ushtrimin e veprimtarisë është e vlefshme për 3 vjet si dhe mund të jetë e rinovueshme. Agjencitë e administrimit kolektiv monitorohen nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit mbi të gjithë veprimtarinë e funksionimit të tyre. Aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e administrimit kolektiv katër agjenci të administrimit kolektiv.

Sporteli unik kryen shërbimet për funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv, të mbrojtura nga të gjitha agjencitë e administrimit kolektiv të licencuara. Sporteli unik krijohet si subjekt juridik dhe regjistrohet si organizatë jofitimprurëse në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Përfshirja e shërbimeve të ofruara nga Drejtoria për të Drejtat e Autorit në portalin unik qeveritar e-albania ka sjellë lehtësi për autorët dhe mbajtësit e të drejtave. Gjatë vitit 2022, janë kryer 230 regjistrime për të drejtën e autorit dhe kalim të drejtave të autori.

Përgjatë vitit 2021 me urdhër të Ministrit të Kulturës janë licencuar katër agjenci të administrimit kolektiv:

1. Agjencia “ALBAUTOR” për të drejtat e autorëve për veprat muzikore me apo pa tekst;
2. Agjencia “AKDIE” për të mbrojtur të drejtat e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave;
3. Agjencia “FMAA” në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale;

4. Agjencia e Administrimit Kolektiv “Faber Collective Phonogram” në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit.

Në fushën e zbatimit të pronësisë intelektuale, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut (ISHMT) është përgjegjës dhe garantues i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm nëpërmjet inspektimeve të planifikuara dhe në bazë të kërkesë ankesave të paraqitura nga mbajtësit e të drejtave.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 20.01.2016. Veprimtaria e ISHMT mbështetet në Ligjin Nr. 10433, date 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjet specifike, Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe Ligji Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar.

ISHMT me mbështetjen e projektit Shqiptaro-Zviceran ALSIP ka përfunduar hartimin e metodologjisë së analizës dhe vlerësimit të riskut për pronësinë industriale. Ky dokument i ka mundësuar ISHMT të fillojë që nga muaji shtator 2022 inspektimet ex-officio.

Është në proces konsultimi draft udhëzimi për shkatërrimin e mallrave të falsifikuara dhe pirate për të drejtat e pronësisë industriale. Ky dokument u hartua me mbështetjen nga projekti ALSIP dhe do të mundësojë procedurat e rregullta të nxjerrjes nga kanalet tregtare të mallrave cenuese të identifikuar në treg.

Është në proces hartimi i manualeve të inspektimit për të drejtat e pronësisë intelektuale. Ky dokument do të jetë një mjet në ndihmë të inspektorëve për zbatimin sa më të bazuar dhe të unifikuar të praktikave të inspektimit. Ky dokument po hartohet me mbështetjen nga projekti ALSIP.

Është në proces konsultimi me Inspektoratin Qendror metodologjia e vendosjes së masave administrative në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Ky dokument është hartuar me grup pune nga ISHMT.

Në periudhën 2022 – 2025 në përputhje me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për pronësinë industriale”, ISHMT po harton me mbështetjen e projektit ALSIP një projektligj mbi funksionet e ISHMT për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale ku do të parashikohen procedura më të detajuara administrative me qëllim për të zgjidhur disa nga problematikat e hasura në praktikë, inspektimet për shkeljet online, forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, procedura ligjore të përmirësuara të bllokimit dhe shkatërrimit të mallrave të falsifikuara, sipas sugjerimeve të ekspertëve të projektit AL 17 IPA FI 01 20 “Strengthening the Protection and the Enforcement of Intellectual Property Rights”.

Organika e ISHMT përfshin ndër të tjera Drejtorinë e Pronësisë Intelektuale të përbërë nga Sektori i së Drejtës së Autorit (SDA) dhe Sektori i Pronësisë Industriale (SPI). Sektori i së Drejtës së



Autorit përbëhet nga 1+9 inspektorë, dhe Sektori i Pronësisë Industriale përbëhet nga 1+6 inspektorë.

Për forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe administrative ISHMT ka aplikuar dhe ka përfituar mbështetjen e TAIEX të KE për organizimin e një workshopi me temë “Zbatimi i pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm”, ku morën pjesë 24 punonjës të ISHMT si dhe u ftuan pjesëmarrës nga DPPI, DDA, AMA, DPD, DPP.

Gjatë vitit 2022 janë kryer 350 inspektime mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to dhe janë vendosur 45 masa administrative, si dhe janë kryer 107 inspektime për cenimin e të drejtave të pronësisë industriale për të cilat janë vendosur 28 masa administrative me gjobë, si dhe dy vendime për bllokim të përhershëm dhe shkatërrim të mallrave të falsifikuara.

Të gjitha këto procese inspektimi janë kryer online me anë të sistemit e-inspektimi duke i kushtuar rëndësi të veçantë procedurave të rregullta ligjore dhe transparencës.

Në kuadër të krijimit të bashkëpunimi ndërinstytucional, me qëllim shkëmbimin e informacionit sa më të shpejtë si dhe zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese në fushën e PI, ISHMT në vitin 2021 nënshkroi marrëveshje mirëkuptimi me DPPI. Në vitin 2022 u finalizua nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me DDA Ministria e Kulturës dhe me Inter-agjensinë për Kontrollin e Tregut (DIMEA) – Ministria e Zhvillimit dhe Investimeve të Republikës së Greqisë. Është në proces nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

ISHMT ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese me përfaqësues të biznesit, institucioneve të arsimit të lartë dhe përfaqësues të autorizuar të mbajtësve të të drejtave të PI. Këto aktivitete synojnë uljen e rasteve të shkeljeve në treg dhe rritjen e kërkesë ankesave për inspektim.

Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (DMPI) është strukturë përbërëse e Departamentit Operativ – Hetimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Staf i saj është i përbërë nga një drejtor dhe katër specialistë.

Objekti i punës së DMPI- së është të zbatojë legjislacionin për mbrojtjen e pronësisë intelektuale sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi për territorin doganor shqiptar, të koordinojë punën ndërmjet drejtorive të tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, institucioneve të treta dhe/ose grupeve të interesit për çështjet e pronësisë intelektuale, të administrojë me profesionalizëm kërkesat e/i interesuarve të paraqitura pranë D.M.P.I-së, duke mbajtur në vëmendje respektimin e afateve kohore, procedurale dhe trajtimin e çështjeve në mënyrë profesionale.

Baza ligjore mbi të cilën vepron sistemi doganor është: Marrëveshja TRIPS, nenet 51-60, Ligji Nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.

102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 10.11.2017, i ndryshuar ka përafuar pjesërisht në nenet 364 – 392, Rregulloren (BE) Nr. 608/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 12 qershor 2013 në lidhje me zbatimin nga doganat të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1383/2003.

Me mbështetjen e Bashkimit Evropian është vënë në përdorim sistemi Ines + (databaza e të dhënave për aplikim për veprim dhe e mallrave të konstatuara si cenuese të të drejtave të pronësisë intelektuale) dhe është trajnuar administrata doganore për përdorimin e saj dhe janë përgatitur manualët e përdorimit të sistemit Ines +.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka trajtuar 130 aplikime për mbrojtje të dorëzuar në bazë Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndër të cilat 144 aplikime janë miratuar dhe 5 janë refuzuar për arsye të ndryshme.

Administrata Doganore Shqiptare, gjatë vitit 2022 ka pezulluar për çlirim për qarkullim të lirë mallra të cilat cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale, si më poshtë vijon:

- 1 000 copë portofola (400 copë Louis Vuitton, 300 copë Tommy Hilfinger dhe 300 copë Gucci;
- 3 600 palë shollë këpucësh Timberland;
- 1 140 copë ( paketim 400ml) instekticid H10;
- 260 palë atlete sportive Champion.

Drejtorja për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale ka koordinuar dhe organizuar operacione të përbashkëta ndërinstitucionale si me strukturat brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe me struktura ndërkombëtare. DMPI mori pjesë aktive në operacion Balkan Gate që u finalizuar me 1 kapje të një sasisë atlete sportiv.

Përgjatë vitit 2022 në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale janë zhvilluar trajnime teorike dhe praktike mbi përditësimin e njohurive legjislacionin për Pronësinë Industriale me metodën “Trajnim në vendin e punës”, dhe mbi përdorimin e sistemit Ines +. Numri i stafit doganor të trajnuar në total është 40 veta ka zhvilluar dhe ka marrë pjesë në trajnime në fushën e pronësisë intelektuale.

Shkolla e Magjistraturës vazhdon të jetë një institucion shumë i rëndësishëm që ofron kualifikime profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët nëpërmjet programeve të saj të trajnimit profesional, të cilat përfshijnë:

- Programi i Trajnimit Fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Programi i Trajnimit të Vazhduar për Gjyqtarët dhe Prokurorët (në detyrë);

Për sa i përket vitit akademik 2022 – 2023 “Programi i trajnimit fillestar” për çështjet e pronësisë intelektuale, është një kurrikul për mësimdhënie semestrale. Ky zhvillim dhe progres pasqyron

progresin e bërë drejt aplikimit në shkollë të kurrikulave të reja të modernizuara në bazë të kompetencave profesionale.

Lidhur me “Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm”, programi konsiston në një përmbajtje tematike gjithëpërfshirëse, të diktuar nga vlerësimi i nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, bazuar në problemet praktike, reformën në drejtësi dhe përafrimin me *acquis* si dhe me standardet ndërkombëtare, ndryshimet ligjore, probleme ligjore dhe sociale etj. Trajnimet zhvillohen për një vit akademik.

Aktivitetet trajnuese të organizuara mbi temat e Pronësisë Intelektuale bëhen në bazë të vlerësimit të nevojës që shkolla bën në fillim të çdo viti akademik. Për vitin akademik 2022 – 2023, Shkolla e Magjistraturës ka parashikuar organizimin e një seminari trajnimi me temën e hetimit dhe gjyqimit të veprave penale që lidhen me shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) si autoritetin rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në Republikën e Shqipërisë.

Roli i AMA-s në mbrojtjen e drejtave të autorit, veçanërisht atyre të transmetimit, realizohet nëpërmjet kompetencave kontrolluese/monitoruese dhe sanksionuese, që ligji i ka dhënë.

#### 7.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale;
- Ministria e Kulturës/Drejtoria për të Drejtën e Autorit;
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Policia e Shtetit – Drejtoria e Krimin Ekonomik;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Shkolla e Magjistraturës.

#### 7.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Zbatimi i dokumentit të rëndësishëm në fushën e pronësisë intelektuale “Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022 – 2025” mbetet një nga prioritetet e institucioneve ligjzbatuese përgjegjëse për pronësinë industriale. Plani i veprimit i këtij dokumenti është shumë intensiv me

shumë objektiva dhe aktivitete të parashikuara për tu realizuar, duke filluar që nga përmirësimi i kuadrit ligjor dhe deri të rritja e ndërgjegjësimit për publikun e gjerë në tërësi dhe grupet e ndryshme të interesit.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe kërkesat e negociatave të anëtarësimit mbetet një prioritet i Ministrisë së Kulturës/ Drejtorisë së të Drejtave të Autorit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/ Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Në lidhje me përafrimin e legjislacionit duhet pasur parasysh se një pjesë e *acquis* së Bashkimit Evropian për pronësinë industriale do të harmonizohet plotësisht vetëm kur Shqipëria të jetë shtet anëtar në BE.

Në periudhën 2022 – 2025 për sa i takon harkut kohor të zbatimit të Strategjisë së re, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale do të ndër marrë një reformë të re ligjore në fushën e pronësisë industriale, duke hartuar një ligj të ri për çdo objekt të pronësisë industriale, ashtu siç e kanë dhe shumë vende të zhvilluara si dhe duke përafruar të gjitha direktivat e fushës për çdo objekt të pronësisë industriale.

Deri në vitin 2025, DPPI do të përafrojë legjislacionin në fushën e pronësisë industriale me direktivat/rregulloret e BE për pjesën e mbetur, pa prekur nenet që janë kusht që plotësohet me hyrjen në BE si më poshtë:

1. Direktiva (BE) 2015/2436 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare e datës 16 dhjetor 2015;
2. Rregullorja (BE) 2017/1001 për markën tregtare të Bashkimit Evropian e datës 14 qershor 2017;
3. Direktiva 98/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 për mbrojtjen ligjore të disenjove;
4. Rregullorja (KE) nr. 816/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 maj 2006 mbi licencimin e detyrueshëm të patentave në lidhje me prodhimin e produkteve farmaceutike për eksport në vendet me probleme të shëndetit publik.
5. Rregullorja 2019/933 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2019 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr. 469/2009 në lidhje me certifikatën shtesë të mbrojtjes për produktet medicinale
6. Rregullorja (KE) nr. 469/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 maj 2009 në lidhje me certifikatën shtesë të mbrojtjes për ilaçet produkte.

Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit të ri në fushën e pronësisë industriale do të kërkojë më shumë trajnime të thelluara dhe lind nevoja që të ketë shtim kapacitetesh administrative.

Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar është një ligj i harmonizuar dhe i integruar me Direktivat e Bashkimit Evropian. Megjithatë, përafrimi i legjislacionit do të vijojë në përputhje me zhvillimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2023 Drejtoria për të Drejtat e Autorit do të plotësojë kuadrin ligjor me aktet nënligjore të cilat do të dalin në zbatim të ligjit nr. 37/2022. Këto akte nënligjore nuk synojnë për afrimin e mëtejshëm të legjislacionit me *acquis*.

1. Vendim i Këshillit të Ministrave “Për procedurën dhe mënyrën e kompensimit të drejtë për përdorimin e veprës pa autor”;
2. Vendim i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e elementëve të regjistrimit të të dhënave të hapura për publikun, dokumentar dhe elektronik”.

Miratohen 3 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit aktet nënligjore si vijon:

3. Udhëzimi i Ministrit të Kulturës “Mbi organizimin dhe funksionimin e sportelit unik”;
4. Udhëzimi i Ministrit të Kulturës “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar.

Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit kanë hartuar termat e referencës për realizimin e procedurës me objekt “Ngritja e platformës digjitale për të drejtën e autorit”. Gjatë vitit 2023 pritet të ngrihet platforma për të drejtën e autorit në të cilën përfshihen: baza e të dhënave për veprat e regjistruara pranë DDA; baza e të dhënave për kontratat e kalimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to; baza e të dhënave për veprat pa autor.

Nëpërmjet platformës do të gjenerohet informacion për të gjithë të interesuarit në fushën e të drejtës së autorit, do të reduktohet puna manuale dhe do të kryhet digjitalizimi i arshivës fizike.

Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë dhe subjekteve përdorues do të jetë një tjetër fushë ku do të fokusohet aktiviteti i institucioneve të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.

Institucionet e angazhuara në ndjekjen e zbatimit të legjislacionit përballen në aktivitetin e tyre me një nivel të ulët ndërgjegjësimi nga ana e operatorëve ekonomikë mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Është e nevojshme kryerja e aktiviteteve ndërgjegjësuëse e subjekteve tregtare, përdorues të objekteve të pronësisë intelektuale, por edhe i mbajtësve të të drejtave për të kuptuar më mirë sistemin e mbrojtjes të të drejtave të tyre në mënyrë që të krijohet edhe bashkëpunimi me ISHMT për të rritur efikasitetin e inspektimeve. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve është parashikuar edhe në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022 – 2025.

Është i nevojshëm forcimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të stafit të ISHMT dhe përmirësimit të mjeteve logjistike në dispozicion të inspektorëve, si dhe digjitalizimi i të dhënave.

Inspektimet për respektimin e të drejtave të autorit dhe të pronësisë industriale do të përfshijnë inspektime të planifikuara, inspektim ex-officio dhe inspektime mbi bazë të kërkesë ankesave.

Për Sektorin e të Drejtave të Autorit në zbatim të Ligjit Nr. 35 datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, prioritet do të jenë këto fusha inspektimi:

- Inspektimi i programeve kompjuterike;
- Inspektimi i fotokopjeve;
- Inspektimi i veprave audio-vizuale;
- Inspektimi i shtëpive botuese;
- Inspektimi i shtypshkronjave.

Për Sektorin e Pronësisë Industriale në zbatim të Ligjit Nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale” (i ndryshuar), prioritet do të jetë trajtimi i çështjeve dhe kryerja e inspektimeve mbi bazën e kërkesë-ankesave që do të depozitohen pranë ISHMT për shkeljen e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale. Rritja e kërkesë ankesave për cenimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe mbledhja e informacionit për analizën dhe vlerësimin e riskut për kryerjen sa më eficente të inspektimeve ex-officio për të ndaluar mallrat e falsifikuara dhe pirate që qarkullojnë në treg.

Së fundmi, të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale do të forcojnë bashkëpunimin mes tyre, edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë së re të Pronësisë Intelektuale, dhe me institucionet homologe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe në vendet e rajonit.

Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025, ministritë dhe institucionet shqiptare të përfshira në zhvillimin dhe mbrojtjes e të drejtave të pronësisë intelektuale do të fokusohen në këto prioritete kyçe:

- Miratimi i akteve zbatuese për ndryshimet në Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të;
- Përmirësimi i funksionimit të organizatave të menaxhimit kolektiv dhe pagesës së honorarëve për mbajtësit e të drejtave;
- Harmonizimi i legjislacionit për të drejtat e pronësisë industriale dhe i sistemit të zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

## KAPITULLI 8: POLITIKA E KONKURENCËS

### 8.1. Përmbajtja e kapitullit

Politika e konkurrencës në Bashkimin Evropian është një pjesë thelbësore e funksionimit të tregut të brendshëm. Qëllimi i saj është të sigurojë për të gjithë në Evropë mallra dhe shërbime me cilësi më të mirë dhe me çmime më të ulëta duke synuar promovimin dhe mbrojtjen e konkurrencës.

Politika e konkurrencës ka të bëjë me zbatimin e rregullave për t'u siguruar që ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të lirë dhe efektive me njëra-tjetrën. Kjo inkurajon ndërmarrjen dhe efikasitetin, krijon një zgjedhje më të gjerë për konsumatorët dhe ndihmon në uljen e çmimeve dhe përmirësimin e cilësisë.

*Acquis* në këtë kapitull përfshin si politikat anti-trust ashtu edhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Kuadri ligjor përfshin rregulla dhe procedura për të luftuar sjelljet anti-konkurrese (marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimin me pozitën dominuese), për të shqyrtuar përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve dhe për të parandaluar qeveritë nga dhënia e ndihmës shtetërore që shtrembëron konkurrencën në tregun e brendshëm. Në përgjithësi, rregullat e konkurrencës janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjithë Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë plotësisht me Komisionin për zbatimin e tyre.

## 8.2 Struktura e kapitullit

1. Politika e konkurrencës
2. Ndihma shtetërore
3. Liberalizimi

## 8.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikat e konkurrencës, rregullohet në disa nene të MSA-së. Së pari, në Titullin IV “Përafrimi i legjislacionit, imponimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës”, neni 70 përcakton se Shqipëria do të përpiqet që të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të Komunitetit dhe se do të sigurohet që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

Neni 71 “Konkurrenca dhe dispozitat e tjera ekonomike”, përcakton qartë se dispozitat në vijim pjesë të këtij neni, si marrëveshjet e ndaluara ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe ndërmarrjesh dhe praktika të koordinuara ndërmjet ndërmarrjeve të cilat kanë si objekt të tyre ose pasojë, parandalim, kufizim ose shtrembërim të konkurrencës; abuzim me pozitën dominuese, nga një ose më shumë ndërmarrje në territorin e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre; çdo ndihme shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara, nuk janë në përputhje me funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Me qëllim përmbajtjes jo vetëm të dispozitave të MSA por edhe të legjislacionit të BE, Shqipëria është angazhuar në përafrimin e legjislacionit të saj të brendshëm me atë të BE.

#### 8.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Qëllimi i Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Dispozitat e ligjit zbatohen si në rastet e marrëveshjeve të ndaluara midis ndërmarrjeve, abuzimit me pozitën dominuese dhe procedurat e kontrollit të përqendrimeve midis ndërmarrjeve.

Rregullat e BE gjithashtu përcaktojnë një sistem të kontrollit të ndihmës shtetërore. Qeveritë lejohen të japin ndihmë shtetërore vetëm nëse plotësohen kushtet kufizuese, me qëllim parandalimin e shtrembërimit të konkurrencës.

#### **Konkurrenca**

Kuadri ligjor në fushën e konkurrencës është gjerësisht në të njëjtën linjë me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (SAA). Ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar është plotësisht i përfaruar me nenin 101 TFEU (Marrëveshjet e ndaluara) dhe nenin 102 TFEU (Abuzimi me pozitën dominuese). Ligji parashikon procedura paraprake për kontrollin e përqendrimeve, në linjë me Rregulloren e Përqendrimeve të BE. Kuadri ligjor zbatues është plotësisht i përafuar me rregulloret përkatëse të BE dhe me Udhëzimet e Komisionit Evropian.

Autoriteti i Konkurrencës e mbështet veprimtarinë e tij në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në një set të plotë aktesh nënligjore, përfshirë rregullore dhe udhëzime konkrete. Ligji dhe kuadri ligjor dytësor janë plotësisht të përfaruar me kuadrin ligjor të BE-së në fushën e konkurrencës, nenin 101 TFEU (Marrëveshjet e ndaluara) dhe nenin 102 TFEU (Abuzimi me pozitën dominuese). Gjithashtu ligji parashikon procedura paraprake për kontrollin e përqendrimeve, në linjë me Rregulloren e Përqendrimeve të BE-së. Kuadri ligjor zbatues është plotësisht i përafuar me rregulloret përkatëse të BE-së dhe me Udhëzimet e Komisionit Evropian, te tilla si Rregullorja e Këshillit Evropian (KE) nr. 1/2003, datë 16 dhjetor 2002 për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenin 81 dhe 82 të Traktatit; Rregullorja e Këshillit Evropian (KE) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” (Rregullorja e Përqendrimeve të KE); Njoftimin e Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës; Njoftimin e Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve; Udhëzimin për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003; Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis), etj, si dhe akte të tjera ligjore të BE-së etj.

Bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 9121/2003, Autoriteti i Konkurrencës është një autoritet i pavarur, i cili në respektim të nenit 24 të Ligjit, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës paraqet dhe raporton pranë Kuvendit të Shqipërisë raportin vjetor të Autoritetit.



Në nenin 24 të Ligjit janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit ku është përcaktuar se Komisioni i Konkurrencës mund të miratojë akte nënligjore zbatuese, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve në zbatim të ligjit. Në zbatim të nenit 41 të Ligjit, Autoriteti i Konkurrencës me nismën e vet, më kërkesë të Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatorë të sektorëve përkatës, mund të kryejë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, nëse dyshohet se konkurrenca në treg është kufizuar ose shtrembëruar.

Në mbështetje të nenit 42 dhe 43 të Ligjit, Autoriteti i Konkurrencës fillon procedurat e hetimit paraprak ose të hetimit të thelluar lidhur me kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës në treg.

Neni 44 i Ligjit parashikon së në rastet e një rreziku të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit, mund të merren masa të përkohshme. Detyrimet ndaj ndërmarrjeve përfshirë edhe masat strukturore lidhur me ndalimin e shkeljeve të konkurrencës përcaktohen në nenin 45 të Ligjit. Në këtë nen janë përcaktuar edhe rastet kur ndërmarrjet e interesuara marrin angazhime në formën e kushteve dhe detyrimeve, në përgjigje të vërejtjeve të bëra nga Autoriteti i Konkurrencës në vlerësimin paraprak.

Procedurat e kontrollit të përqendrimeve janë parashikuar në nenet 53-64 të Ligjit lidhur me analizën dhe vlerësimin që kryhet nga Autoriteti i Konkurrencës. Dispozitat ligjore parashikojnë procedurën paraprake në rastet kur përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg, apo procedurën e thelluar kur konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

Ligji, në nenet 69 dhe 70 të tij parashikon detyrimin që kanë organet e administratës qendrore dhe vendore për të kërkuar vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ që ka të bëjë me kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara për ndërmarrje ose për produkte të caktuara apo imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes. Dispozitat ligjore parashikojnë detyrimin që kanë autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë që gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike, të zbatojnë dispozitat e ligjit të konkurrencës dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

Lidhur me kapacitetet administrative, stafi i Autoritetit të Konkurrencës ka përfituar nga një seri trajnimesh:

1. Në kuadër të projektit IPA 2015, Binjakëzim me Autoritetin Spanjoll të Konkurrencës (CNMC- Komisioni Kombëtar Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën), projekt twinning i financuar nga Komisioni Evropian me titull: “Forcim kapacitetesh për Autoritetin e Konkurrencës për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”;
2. Në kuadër të projektit me EBRD, ku Autoriteti i Konkurrencës ishte përfitues i projektit me titull “Asistencë teknike për Autoritetin e Konkurrencës, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”, etj.;

### 3. Në kuadër të OECD/RCC, UNCTAD, etj.

Në vitin 2022 është miratuar Udhëzimi “Mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” i përafuar me Udhëzimin mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga Njoftimi De Minimis, Dokument i Komisionit Evropian, version i datës 3.06.2015 (Bruksel 25.06.2014/SWD (2014) 198), dhe është miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës me Vendimin nr. 890, datë 10.06.2022 miratoi “Udhëzim mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël” .

Aktet nënligjore të miratuara nga Autoriteti i Konkurrencës, përcaktojnë në mënyrë të detajuar procedurat të cilat ndihmojnë Autoritetin e Konkurrencës në realizimin e misionit sipas objektit të ligjit, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar procesin e përafritimit të legjislacionit me atë të *acquis* të BE-së. Veprimtaria e institucionit ka qenë në zbatim të ligjit të konkurrencës, Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021”, si dhe të detyrave të përcaktuara në Raportet e Komisionit Evropian, në takimet e Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit”, takimet e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, etj.

Gjatë periudhës 1 janar 2022 – 30 nëntor 2022, Komisioni i Konkurrencës ka aprovuar në total 80 (tetëdhjetë) vendime ku përmendim vendime lidhur me hapjen e procedurave hetimore për shkelje të dyshuara të nenit 4 (marrëveshje të ndaluara) dhe 9 (abuzim me pozitën dominuese), vendime për autorizim përqendrimesh, vendime për vendosje sanksionesh, vendime për dhënien e kushteve dhe detyrimeve, vendime për marrjen e masave të përkohshme, për miratim aktesh nënligjore etj.

Në lidhje me zbatimin e nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, kanë qenë objekt hetimi nga Autoriteti i Konkurrencës për marrëveshje të ndaluara, tregu i prokurimit publik të blerjes së ushqimeve; tregu i prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.); tregu i importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure; tregu i shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve para-mjekësore (ku përfshihen importi dhe tregtimi me shumicë i maskave; importi, prodhimi dhe tregtimi me shumicë i alkooleve dhe gel-dezinfektues; importi dhe tregtimi me shumicë i termometrave).

Në lidhje me zbatimin e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, përsa i përket rasteve të abuzimit me pozitën dominuese, janë realizuar hetime në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve; në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jobanka; në tregun e ngarkim- shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN.

Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 9121/2003, Autoriteti i Konkurrencës ka kryer një hetim të përgjithshëm në tregun e shërbimet spitalore, duke përfshirë të gjitha shërbimet e ofruara nga spitalet publike dhe jopublike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me kontrollin e përqendrimeve, janë zbatuar dispozitat ligjore për përqendrimet në tregje dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare të tillë si tregu i shërbimeve mediatike audio, tregu i prodhimit të energjisë elektrike, duke përmendur edhe një numër të konsiderueshëm njoftimesh dhe transaksionesh që kanë ndodhur në tregun ndërkombëtar, pa sjellë pasoja mbi konkurrencën në tregun e brendshëm.

Me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 757, datë 23.12.2020 “Miratimi i dokumentit – “Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit”, është miratuar dokumenti “Advokacia e Konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit”. Ky dokument synon promovimin e një mjedisi konkurrues, duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjitha institucionet shtetërore dhe rregullatorë për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe komunitetit të biznesit, lidhur me përfitimet që sjell një konkurrencë e lirë dhe efektive në treg; Përpjekjet e Autoritetit të Konkurrencës, duke përforcuar, nga njëra anë, rolin advokues të institucionit dhe nga ana tjetër, strategjinë e komunikimit, në drejtim të një grupi të larmishëm të palëve të synuara të interesit.

## **Ndihma shtetërore**

Kuadri legjislativ për ndihmën shtetërore përputhet gjerësisht me *acquis* të BE-së dhe MSA-së. Ligji për ndihmën shtetërore pasqyron kryesisht nenet 107 dhe 108 TFEU. Legjislacioni zbatues është përafuar pjesërisht me *acquis* të BE-së në disa fusha, p.sh. Rregullorja e Përgjithshme e Përrjashtimit në Bllok. Nevojitet një harmonizim i mëtejshëm me legjislacionin zbatues të BE-së për kontrollin e ndihmës shtetërore. Sa i përket kornizës institucionale, Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për ndihmën shtetërore, i mbështetur nga struktura tekniko-administrative sekretariati për ndihmën shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

Sipas Ligjit nr. 9374/2005 “Për ndihmën shtetërore, i ndryshuar, masat e reja të ndihmës duhet t’i njoftohen KNSH, e cila duhet t’i vlerësojë ato në përputhje me ligjin e ndihmës shtetërore përpara se të zbatohen. KSA mund të urdhërojë rikuperimin e ndihmës së paligjshme dhe të papajtueshme, por nuk e ka bërë atë deri më tani. Vendimet e tij i nënshtrohen apelit gjyqësor.

Në përgjithësi Shqipëria ka plotësuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në këtë fushë. Ligji shqiptar për ndihmën shtetërore, Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën Shtetërore” është amenduar dhe është plotësisht i përfaruar me direktivat e mëposhtme të BE-së: Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1407/2013 e datës 18 dhjetor 2013 “Për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën de minimis”; Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 651/2014 e datës 17 qershor 2014 për disa kategori ndihme të përputhshme me tregun e brendshëm në zbatim të neneve 107 dhe 108 të Tekstit të Traktatit ; Rregulloren e Komisionit “Për ndihmën De minimis” nr. 1407/2013; Rregulloren e Komisionit (BE) Nr.

651/2014 e 17 qershor 2014 “Për deklarimin e disa kategorive të ndihmës shtetërore në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të Nenit 107 dhe 108 të Traktatit”; Vendimi i Komisionit Evropian “Për zbatimin e Nenit 106(2) TFBE “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve që janë mandatuar për të ofruar shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik”.

Baza ligjore e miratuar e ndihmon strukturën e ndihmës shtetërore në veprimtarinë e saj dhe realizimin e misionit dhe të objektit të ligjit, në kuadër të ndalimit të çdo ndihme të dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.

Gjatë periudhës 1 janar 2022 – 30 nëntor 2022, Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka aprovuar si vijon:

- Vendim i KNSH Nr. 104/2022 “Autorizim i Ndihmës Shtetërore “Ndhima sociale për pasagjeret e fluturimeve ajrore”
- Vendim i KNSH Nr. 105/2022 “Autorizim i Ndihmës Shtetërore “Mbështetje për bizneset fillestare dhe lehtësuesit e fillimit”
- Vendim i KNSH Nr. 106/2022 “Autorizim i Ndihmës Shtetërore “Për Aeroportin Ndërkombëtar te Vlorës”
- Vendimi i KNSH Nr. 107/2022 “Për një amendament në Vendimin e Komisioni i Ndihmës Shtetërore nr. 99, date 16.10.2022 “Autorizim i Ndihmës Shtetërore” “Mbështetje financiare (grant) për biznese te reja “te gjelbëria”, te cilat bazohen ne një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese qe përpiqen te kthehen ne një biznes “të gjelbër” duke futu element te gjelbër”
- Vendimi i KNSH nr. 108/2022 “ Për vlerësimin e njoftimit te projektit “Marina Durres”

Në lidhje me liberalizimin, ligjet për mbrojtjen e konkurrencës dhe për ndihmën shtetërore janë të zbatueshme për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, përveç rasteve kur zbatimi i tyre pengon kryerjen e detyrave të veçanta të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik që u caktohen atyre.

#### 8.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Autoriteti i Konkurrencës;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Komisioni i Ndihmës Shtetërore;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural ;
- Ministria e Kulturës;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Instituti i Statistikave.

## 8.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Autoriteti i Konkurrencës i kushton rëndësinë e duhur mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet zbatimit të rregullave dhe parimeve të konkurrencës në zbatim të dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi. Komisioni Evropian në Raportin për vitin 2022 shprehet se Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje / është e përgatitur mesatarisht në politikën e konkurrencës.

Bazuar në takimin shpjegues në kuadër të procesit *screening* për Kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, të datave 4 – 6 nëntor 2019 të mbajtur në Bruksel, janë identifikuar aktet e BE-së të cilat janë përafuar plotësisht ose pjesërisht si dhe akte të cilat do të parashikohen për t’u përafuar në të ardhmen. Mbi këtë bazë është hartuar analiza e mangësive ligjore si dhe janë parashikuar nismat konkrete ligjore për të përfuar në vitet në vijim.

Disa nga prioritetet e PKIE 2023 – 2025 në fushën e konkurrencës janë hartimi i disa udhëzimeve për te plotësuar kuadrin ligjor dytësor, të tilla si:

Për vitin 2023 në fushën e konkurrencës është parashikuar Udhëzuesi “Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për raste individuale, në përputhje me Njoftimin e Komisionit mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 101 dhe 102 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian për raste individuale (letra udhëzuese) (C (2022) 6925 final). Ky udhëzues është parashikuar për t’u miratuar në tremujorin e dytë të vitit 2023.

Gjatë vitit 2023, në tremujorin e tretë është parashikuar të miratohet “Manuali i Procedurave të sjelljeve anti-konkurrese”, në përputhje me “Manualin e procedurave të sjelljeve anti-konkurrese (Dokument i Komisionit Evropian, Nëntor 2019)” dhe në tremujorin e katër të këtij viti është parashikuar “Udhëzues “Mbi praktikatat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat e ndjekura në zbatim të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në rastet e përqendrimeve” në përputhje me Praktikatat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe sipas rregullores së Përqendrimeve (2 qershor 2015/Dokument i Komisionit Evropian).

Për vitin 2024 në fushën e konkurrencës janë parashikuar Udhëzues “Mbi referimin e rasteve në lidhje me përqendrimet” në përputhje me Njoftimin e Komisionit për referimin e rasteve në lidhje me përqendrimet (2005/C 56/02), i cili parashikohet të miratohet tremujorin e tretë të vitit 2024 dhe Udhëzim “Mbi marrëveshjet kolektive në lidhje me kushtet e punës së të vetëpunësuarve” në përputhje me Udhëzimin për zbatimin e të drejtës së BE-së për konkurrencën mbi marrëveshjet

kolektive në lidhje me kushtet e punës së të vetëpunësuarve, i cili parashikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024.

Për vitin 2025 në fushën e konkurrencës janë parashikuar Udhëzimi “Mbi marrëveshjet vertikale” në përputhje me Udhëzimin mbi kufizimet vertikale (2022/C 248/01) (Udhëzim mbi marrëveshjet vertikale), i cili parashikohet të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2025 dhe Rregullorja “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara” në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2022/720 (Rregullorja për përjashtimin në bllok të marrëveshjeve vertikale, “VBER”) e cila parashikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2025.

Raporti i Komisionit për vitin 2022, në përshkrimin e situatës në Shqipërisë për sa i përket politikës së konkurrencës, ka vijuar me dhënien e disa rekomandimeve drejtuar Komisionit të Ndhmës Shtetërore, të cilat kanë të bëjnë me:

- të sigurojë pavarësinë operationale të KNSH-së dhe të rrisë ndjeshëm kapacitetin administrativ të sekretariatit të KNSH-së;
- të përafrojë më tej kuadrin ligjor në fushën e ndihmës shtetërore me *acquis* të BE-së;
- të shtohen përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e KNSH-së në lidhje me ministritë e linjës, autoritetet rajonale dhe vendore, në mënyrë që të sigurohet njoftimi paraprak i masave të ndihmës dhe të forcohet zbatimi i rregullave të ndihmës shtetërore.

Strukturat e ndihmës shtetërore do të punojnë për:

- Zbatimi i Urdhrit të Kryeministrit nr. 128/2019 “Për krijimin e grupit ndërmintor të punës për ndihmën shtetërore”;
- Ofrimi i advokimit dhe mbështetjes për njoftimin e skemave të ndihmës (ministritë e linjës dhe autoritetet rajonale dhe vendore) me qëllim kuptimin dhe zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore.

Në këtë kuadër Komisioni për Ndhmën Shtetërore për ndjekjen e rekomandime të sipërpërmendur si dhe institucionet e tjera pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, do të përpiqen që të sigurojnë që kuadri ligjor ekzistues i këtij kapitulli dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të BE dhe se do të sigurohet që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet në mënyrën e duhur.

## KAPITULLI 9: SHËRBIMET FINANCIARE

### 9.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e shërbimeve financiare synon të garantojë konkurrencën e barabartë midis institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre financiar, veçanërisht në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve private, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve. Acquis i

këtij kapitulli përfshin rregulla mbi licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve.

## 9.2 Struktura e kapitullit

- Bankat dhe konglomeratet financiare
- Sigurimet dhe pensionet
- Infrastruktura e tregut financiar

## 9.3 Kërkesat e MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Përafrimi i kuadrit ligjor në fushën e shërbimeve financiare me acquis, lind si detyrim për përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të neneve 50, 57, 70,82 dhe 89 të MSA-së.

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përmban rregulla për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve private, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve.

## 9.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Sipas Raport Progresit të vitit 2022, Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e shërbimeve financiare. Një progres i mirë është bërë në drejtim të rekomandimeve të vitit të kaluar në lidhje me përafrimin e mëtejshëm me kërkesat e Bazel III, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe pagesat në vlerë të vogël, dhe nga implementimi i pjesshëm i politikave mbi kreditë me probleme, që solli një reduktim të këtyre të fundit (kredive me probleme). Progres u shënuar gjithashtu edhe në sigurimin e detyrueshëm dhe investimet kolektive.

“Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve private, legjislacioni për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit është përafëruar me acquis më të rëndësishme të BE-së. Kuadri nënligjor u miratua gjatë periudhës së raportimit, duke mundur zbatimin e plotë të ligjit, përfshirë edhe një aplikacion për llogaritjen e dëmeve personale në rastet e aksidenteve rrugore,” nënvizon Progresi Raporti. Raporti nënvizon edhe aderimin e AMF-së në Memorandumin Shumëpalësh të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), për bashkëpunim ndërkombëtar në mbikëqyrje dhe shkëmbim informacioni.

### ***Bankat dhe konglomeratet financiare***

Banka e Shqipërisë ka ndjekur me vëmendje zhvillimet në tregjet ndërkombëtare dhe efektet e mundshme që ato mund të kenë në sistemin bankar shqiptar, duke reaguar edhe nëpërmjet masave të marra gjatë vitit 2022. Ecuria e sistemit bankar paraqitet e mirë dhe me tregues në përmirësim të qëndrueshëm. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit paraqitet në nivelin 19.26% në shtator 2022, i cili vjen në rritje me 1.26 pikë përqindje në krahasim me muajin dhjetor 2021 dhe mbetet larg minimumit rregullator të kërkuar prej 12%. Edhe treguesi i likuiditetit ka mbetur në nivele të larta prej afro 40%, përkundrejt minimumit të kërkuar prej 20%. Portofoli i kredisë ka ardhur në rritje konstante gjatë vitit 2022, duke rezultuar në 7.1% në fund të shtatorit, një tendencë kjo e kënaqshme dhe e qëndrueshme që nga viti 2021. Treguesi i kredive me probleme vijoi tendencën rënëse të viteve të fundit, duke arritur në nivelin 5.06% në fund të muajit shtator 2022, përkundrejt nivelit prej 5.68% në fund të vitit të kaluar. Ky është niveli më i ulët që ka arritur ky tregues që nga viti 2008, kur shfaqti tendencat e para rritëse.

Ecuria e kredive, veçanërisht për vitin e ardhshëm do të varet kryesisht nga zhvillimet e paqëndrueshme politike ndërkombëtare, të cilat janë reflektuar edhe në vendime ekonomike. Rritja e normave të interesit të ndërmarrë nga autoritetet qendrore në përgjigje të rritjes së pazakontë të inflacionit, do të ketë ndikim në përmbushjen e detyrimeve të huave kundrejt bankave. Rritja e kësteve të kredisë mund të sjellë vështirësi në shlyerjen e rregullt të huave, çka mund të shoqërohet edhe me rritje të kredive me probleme.

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për hartimin e akteve të reja ligjore e nënligjore dhe për rishikimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës në fuqi, me qëllim përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe me standardet e Komitetit të Bazelit në lidhje me kërkesat e Bazel III, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin për Bankën e Shqipërisë nga dokumentet strategjike të integritimit evropian, të tilla si Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, raportet vjetore të Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, objektivat strategjike, etj.

Më konkretisht, Banka e Shqipërisë ka shënuar arritje të mëtejshme në përafrimin e kërkesave të Rregullores 575/2013/EU<sup>57</sup> (CRR), si dhe të rregulloreve të tjera të BE-së që ndryshojnë apo plotësojnë këtë rregullore, veçanërisht në drejtim të rishikimit të kërkesave të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit (për rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe titullzimin); në përafrimin e kërkesave të Direktivës 2013/36/EU dhe të disa udhëzuesve të Autoritetit Bankar Evropian, për hartimin e udhëzimit për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP) për bankat; në rishikimin e kërkesave për qeverisjen efektive të bankave dhe për mbrojtjen e konsumatorit; etj.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të përafrimit të vazhdueshëm me aktet e BE-së ose me kërkesat e Bazel III:

- Miratoi Udhëzimin e ri nr. 2, datë 1.12.2021 “Mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit”, i cili parashikon kërkesat mbikëqyrëse për bankat, në

---

<sup>57</sup> Rregullore (BE) Nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 "Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit, dhe që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 648/2012".



lidhje me strategjitë, politikat, proceset dhe sistemet e brendshme për identifikimin, matjen, administrimin dhe monitorimin e rrezikut të likuiditetit, në mënyrë që të sigurohen nivele të përshtatshme të rezervave të likuiditetit. Udhëzimi është hartuar në përputhje me kërkesat e Direktivës evropiane 2013/36/EU mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP) dhe të disa udhëzuesve të Autoritetit Bankar Evropian (EBA);

- Miratoi me vendimin nr. 68, datë 22.12.2021, ndryshimet në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, në përputhje me kërkesat e rregulloreve evropiane CRR (2013/575/EU) dhe CRR2 (2019/876/EU), në lidhje me kërkesat për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë;
- Miratoi me vendimin nr. 69, datë 22.12.2021, ndryshimet në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, që synojnë një përafrim të mëtejshëm me kërkesat e Direktivës 2008/48/BE “Mbi marrëveshjen e kredisë për konsumatorët” dhe rishikimet e mëtejshme të saj, me qëllim përmirësimin e kërkesave të autoritetit rregullator për mbrojtjen e konsumatorit;
- Miratoi me vendimin nr.21, datë 6.4.2022, ndryshimet në rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullativ e mbikëqyrës për qeverisjen e bankave. Në këtë kontekst, u hartua edhe një udhëzues “Për drejtimin e brendshëm dhe efektiv të bankave”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë;
- Miratoi me vendimin nr.44, datë 2.11.2022, disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, në përputhje me: a) dispozitat e rishikuara të rregullores (EU) 575/2013<sup>58</sup> dhe të rregullores (EU) 2017/2402<sup>59</sup> të ndryshuar, për titullzimin, si dhe me b) kërkesat e rregullores (EU) 575/2013 dhe standardet teknike të hartuara në zbatim të saj për rrezikun e tregut;
- Miratoi me vendimin nr.45, datë 2.11.2022, disa ndryshime në rregulloren “Për kapitalin rregullator të bankës”, të cilat synojnë sigurimin e konsistencës për sa lidhet me referencat e ndryshuara të neneve të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet vendimit nr. 6, datë 2.2.2022 “Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat”, miratoi pezullimin e shpërndarjes nga bankat deri më 31 dhjetor 2022, të fitimit të vitit 2021 dhe të fitimit që do të realizohet gjatë vitit 2022. Kjo është një masë e rëndësishme e ndërmarrë për të tretin vit radhazi, që ndikon në ruajtjen e niveleve të kapitalit të bankave.

Një vëmendje e veçantë gjatë viteve 2021-2022 i është kushtuar hartimit dhe miratimit të kuadrit rregullativ në zbatim të dispozitave të ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, i cili përafron akte të BE-së (udhëzime të EBA-s, rregullore të BE-së, të hartuara në zbatim të Direktivës

---

<sup>58</sup> Ndryshuar me rregulloren “Regulation 2017/2401/EU amending Regulation (EU) No 575/2013 as regards the requirements for own funds for securitization positions”, e cila ndryshon dhe zëvendëson plotësisht dispozitat e Kreut V (Securitization) të rregullores së BE-së 575/2013.

<sup>59</sup> “Regulation 2017/2402/EU laying down a general framework for securitisation and creating a specific framework for simple, transparent and standardised securitization”.

2015/2366/KE<sup>60</sup> (PSD2)) që lidhen me çështje të shërbimeve të pagesave, si dhe të kuadrit rregullativ që përaftron kërkesat e Direktivës së Parasë Elektronike<sup>61</sup>, të trajtuar më në detaje në Kapitullin 4.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 ka vijuar puna për transpozimin e Direktivës 2014/92/KE “Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike” (PAD), si dhe të tre rregulloreve përkatëse<sup>62</sup> në zbatim të saj, në kuadrin ligjor e rregullativ shqiptar. Për transpozimin e kapitujve të Direktivës që kanë të bëjnë me aksesin në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, u hartua projekt-ligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, i cili është përcjellë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsultim publik.

Ndërsa kapitujt e Direktivës 2014/92/KE që trajtojnë kërkesat e transparencës dhe krahasueshmërisë së tarifave, si dhe të transferimit të llogarive të pagesave si dhe tre rregulloret përkatëse të BE-së në zbatim të saj, janë transpozuar në rregulloren “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave”, e cila parashikohet të miratohet brenda vitit 2022.

Gjatë vitit 2021, me asistencën teknike të Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD) dhe PricewaterhouseCoopers (PwC) Spanjë, u krye një vlerësim i pavarur i kuadrit mbikëqyrës aktual për bankat, nën një qasje gjithëpërfshirëse, duke u mbështetur në metodologjinë dhe pyetësonin e hartuar nga EBA për këtë qëllim.

Në fillim të vitit 2022, u krye edhe një rivlerësim i nivelit të ekuivalencës, sipas metodologjisë së re të publikuar nga EBA në fillim të vitit 2022. Kjo analizë konkludoi se kuadri rregullativ e procedural, si dhe praktikat mbikëqyrëse, qëndrojnë në një nivel të lartë ekuivalence dhe të përafuara me standardet e aplikueshme në vendet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në drejtim të kërkesave për kapital, teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, ekspozimeve të mëdha, likuiditetit, levës financiare, titullzimit, mbikëqyrjes makroprudenciale, sekretit profesional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Në mesin e vitit 2022, Banka e Shqipërisë paraqiti zyrtarisht kërkesën te EBA për të përfshirë Shqipërinë në kalendarin e tyre dhe për të filluar procesin e vlerësimit të ekuivalencës brenda vitit 2022.

## Politika makroprudenciale

Sektori bankar shqiptar ka përballuar disa goditje duke nisur që prej fundit të vitit 2019.

---

60 Direktiva (BE) 2015/2366 për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm.

61 Direktiva 2009/110/KE për krijimin, ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike.

62 Rregullore 2018/32/BE që plotëson Direktivën 2014/92/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me standardet teknike rregullatore për terminologjinë e standardizuar të Bashkimit Evropian për shërbimet më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese; Rregullore 2018/33/BE që përcakton standardet teknike zbatuese në lidhje me formatin e standardizuar të paraqitjes së pasqyrës së tarifave dhe simbolit të saj të përbashkët sipas Direktivës 2014/92/BE; dhe Rregullore 2018/34/BE që përcakton standardet teknike zbatuese në lidhje me formatin e standardizuar të paraqitjes së dokumentit të informacionit tarifor dhe simbolit të tij të përbashkët sipas Direktivës 2014/92/BE.

Ndihmuar nga nivele të shëndetshme të kapitalit para pandemisë dhe fleksibiliteti i përkohshëm rregullativ gjatë pandemisë, sektori bankar mbetet i mirëkapitalizuar, likuid dhe fitimprurës, mbështetur dhe nga përpjekjet e vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë për të forcuar kuadrin rregullativ dhe ndërmarrjen e masave me natyrë prudeniale. Gjithsesi, vitet 2022 dhe 2023 pritet të jenë periudha sfiduese për ekonominë shqiptare dhe aktivitetin e sektorit bankar si rezultat i inflacionit të lartë, mundësisë për rritje të mëtejshme të normave të interesit dhe ngadalësim të rritjes ekonomike. Banka e Shqipërisë po ndërmerr hapa aktivë për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të sektorit bankar nëpërmjet përfundimit të monitorimit të rrezikut të kredisë, komunikimit më intensiv me bankat, mbikëqyrjes vigjilente si dhe harmonizimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullator bankar me standardet e BE-së.

Në këto kushte, në zbatim të rregullores “Për shtesat makroprudeniale të kapitalit”, është vijuar me publikimin e vendimeve të Guvernatorit<sup>63</sup>, për zbatimin e këtyre shtesave.

- Përbushja nga ana e bankave e kërkesave për shtesat e kapitalit sipas Rregullores vlerësohet çdo tremujor nga Banka e Shqipërisë në bazë të një pakete të posaçme raportimi. Shtesa për rrezikun sistemik nuk është ende operacionale. Banka e Shqipërisë po punon për të operacionalizuar këtë instrument, me qëllim përdorimin e tij si një mjet makroprudencial për të adresuar rrezikun sistemik strukturor që rrjedh nga niveli i lartë i euroizimit në ekonominë shqiptare. Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet nxitjes së përdorimit të monedhës vendase në ndërmjetësimin financiar dhe në të njëjtën kohë duke forcuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar përballë ekspozimeve ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. Metodologjia e kalibrimit të këtij instrumenti është në proces.
- Gjatë vitit 2022 janë bërë hapa para në drejtim të masave rregullative makroprudeniale me bazë kredimarrësin. Banka e Shqipërisë ka përgatitur një projekt rregullorë e cila synon të përmirësojë procesin e mbledhjes së informacionit mbi ekspozimet e sektorit bankar në kredi dhe investime në sektorin e pronave të paluajtshme rezidenciale dhe tregtare. Rregullorja do të sigurojë që ky informacion mbështetet në përkufizime të njëtrajtësuar dhe do të mundësojë llogaritjen e treguesve bazë për standardet e kreditimit për pasuri të paluajtshme duke përfshirë treguesit e huasë ndaj vlerës (LTV), huasë ndaj të ardhurave (LTI) dhe shërbimit të huasë ndaj të ardhurave (LSTI). Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë ka marrë në konsideratë rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB/2016/14 ndryshuar nga ESRB/2019/3). Gjithashtu, projekt rregullorja i njeh Bankës së Shqipërisë autoritetin që të përdorë këta tregues si instrumente makroprudeniale, duke aplikuar kufizime, në rastet kur bëhet e nevojshme për të kontrolluar huadhënien për prona të paluajtshme për sektorin e individëve dhe bizneseve. Projekt rregullorja është publikuar në faqen e Bankës së Shqipërisë në seksionin e akteve në proces konsultimi dhe është në proces konsultimi me sektorin bankar.

---

<sup>63</sup> Mund të gjenden në adresën:

[https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti\\_Financiar/Politika\\_makroprudeniale/Instrumentet\\_e\\_politikes\\_makroprudeniale/Instrumentet\\_dhe\\_Vendimet/](https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudeniale/Instrumentet_e_politikes_makroprudeniale/Instrumentet_dhe_Vendimet/)

## Ndërhyrja e jashtëzakonshme

Në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, Banka e Shqipërisë ka vijuar më tej aktivitetin e saj në drejtim të forcimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme nëpërmjet planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe heqjes së pengesave potenciale, plotësimin të kuadrit metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, si dhe operacionalizimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Pas përfundimit të ciklit të plotë të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për secilën nga bankat në tregun bankar shqiptar për vitin 2021, një përmbledhje e tij iu dërgua secilës prej bankave, duke u fokusuar në analizën strategjike të biznesit, kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar si dhe vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Gjatë vitit 2022, Banka e Shqipërisë ka punuar për përditësimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për ciklin e vitit 2022, pas raportimit të informacionit nga bankat në muajin korrik 2022. Gjithashtu, ka përfunduar identifikimi dhe vlerësimi i funksioneve ekonomike me rëndësi kritike si dhe vlerësimin e interesit publik.

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me synim fuqizimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, ka kryer inspektimin në vend në banka. Në përfundim të tij, Banka e Shqipërisë përgatiti raportin e inspektimit, në të cilin përshkruhet aftësia e bankave për ndërhyrje të jashtëzakonshme sipas strategjisë së përzgjedhur, si dhe la një sërë rekomandimesh për heqjen e pengesave potenciale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë si vëzhguese në Kolegjet e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për dy grupe bankare, filialet e të cilave operojnë në Shqipëri, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me Bordin e Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme – (“SRB”).

Përsa i përket zhvillimit të kuadrit metodologjik, në zbatim të rregullores nr. 78/2020 “Mbi kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” Banka e Shqipërisë ka përditësuar dokumentin metodologjik për ciklin e planeve për vitin 2022, për të përcaktuar mënyrën e llogaritjes së kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar – MREL, për bankat. Banka e Shqipërisë, gjithashtu, është angazhuar në përgatitjen e dy dokumenteve metodologjike që lidhen me (i) vazhdimësinë operacionale në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe (ii) planin e riorganizimit të biznesit.

Lidhur me operacionalizimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka realizuar përlllogaritjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe kontributin vjetor përkatës për secilën bankë, i cili u pagua brenda muajit prill 2022. Banka e Shqipërisë, monitoron rregullisht, investimin dhe performancën e mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në bazë të raportimit periodik tremujor nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, si administrator i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

## *Sigurimet dhe pensionet*

Për sa i përket tregjeve nën mbikëqyrje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka vazhduar përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës me kërkesat e acquis së BE-së.

AMF ka miratuar të gjitha rregulloret në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj.

Autoriteti ka vijuar të mbikëqyrë dhe të analizojë treguesit e shoqërive që operojnë në tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin e tyre financiar, si në nivel individual, ashtu edhe në nivel tregu. Shoqëritë e sigurimit shfaqën qëndrueshmëri dhe situata financiare e tyre u paraqit me një nivel të përshtatshëm likuiditeti, duke ruajtur treguesit në nivel tregu.

Në janar – shtator 2022, tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 9.46%. Volumi i primeve të shkruara bruto arriti shifrën 15.51 miliardë lekë. Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve sipas të dhënave të raportuara në 30.06.2022, është 42.72 miliardë lekë, me rritje prej rreth 5.29% krahasuar me fund vitin 2021.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në Mars 2022 është bërë anëtar i Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS). AMF miratoi MMoU me vendimin e Bordit nr.87, datë 30.03.2022. Aderimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve.

AMF ka vazhduar bashkëpunimin me konsulentët e Bankës Botërore për zbatimin e projektit të financiar nga SECO, "Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare -"Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve".

AMF ka hartuar projektligjin "Për fondet e pensionit privat" i cili përfshon pjesërisht Direktivën (BE) 2016/2341 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 14 dhjetor 2016 "Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II).

Projektligji synon zhvillimin e tregut për fondet e pensioneve private, përshtatjen e kuadrit ligjor me legjislacionin dhe direktivat evropiane, si dhe vendosjen e rregullave të qarta në lidhje me transparencën dhe qeverisjen e shoqërive administruese të fondeve të pensioneve.

Projektligji i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të vazhduar procesin e miratimit.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.09.2022 tregon një total të aktiveve neto prej 5.45 miliardë lekë me një rritje prej afro 870.32 milionë lekë, ose 18.98% krahasuar me fundin e vitit 2021.

AMF po punon për hartimin e Strategjisë së Edukimit Financiar për vitet në vijim. Strategjia do të përcaktojë prioritetet e AMF në këtë drejtim dhe ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e

mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje në mënyrë të sigurt, transparente dhe efikase, për të lehtësuar qasjen në produktet financiare. Kjo nënkupton rritjen e besimit në institucionet financiare dhe forcimin e integritetit të tregut, si dhe reduktimin e rreziqeve dhe kontributin në stabilitetin e sistemit financiar në tërësi.

### *Infrastruktura e tregut financiar*

AMF ka intensifikuar vazhdimisht përpjekjet për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të krijuar një bazë të nevojshme rregullatore për zhvillimin e qëndrueshëm të tregut financiar jobankar. Sipas angazhimeve në kuadrin e MSA-së, AMF ka vazhduar punën për përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit ekzistues me direktivat e BE-së.

Subjektet që operojnë në tregjet e kapitalit kishin detyrimin e përshtatshmërisë me kërkesat e ligjit të ri të tregjeve të kapitalit brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij. Për këtë qëllim, puna e AMF-së gjatë periudhës raportuese është fokusuar në monitorimin e kujdesshëm të këtij procesi, i cili mund të konsiderohet pothuajse i përfunduar. Për rrjedhojë, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në tregjet e kapitalit, përfshirë shoqëritë komisionere dhe bankat, si dhe Bursa e Titujve dhe Depozitari Qendror i Titujve, kanë respektuar kërkesat e ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.

Në kuadër të projektit të financuar nga SECO, me mbështetjen e Bankës Botërore, projektregulloret e kërkuara nga ligji i ri për tregjet e kapitalit janë përgatitur nga konsulentë të huaj.

Fokusi kryesor gjatë periudhës raportuese ka vazhduar të jetë finalizimi i procesit të hartimit të rregulloreve. Konsulentët kanë hartuar tashmë 13 projektregullore, të cilat plotësojnë kuadrin rregullator të tregjeve të kapitalit. Të gjitha projektregulloret tashmë janë të përkthyer në shqip dhe po kalojnë të gjitha fazat deri në miratimin përfundimtar të tyre. Katër rregullore janë dërguar për konsultim publik.

- Rregullorja “Për formën dhe përmbajtjen e prospektit që publikohet kur titujt i ofrohen publikut dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar” është në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/1129 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 14 qershor 2017 për prospektin që do të publikohet kur titujt ofrohen për publikun ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, duke shfuqizuar Direktivën 2003/71/KE, si dhe me Rregulloren e deleguar nga Komisioni (BE) 2019/980 e datës 14 mars 2019, plotësuese e rregullore (BE) 2017/1129.
- Rregullorja “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara” është në përputhje me Direktivën 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 15 dhjetor 2004, për harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth emetuesve, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe që ndryshon direktivën 2001/34/KE.

- Rregullorja për “Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi”, që është në përputhje me Rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2017/565, e datës 25 prill 2016 që plotëson direktivën 2014/65/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian në lidhje me kërkesat organizative dhe kushtet e funksionimit për shoqëritë komisionere dhe termat e përcaktuara për qëllimet e asaj direktive.
- Rregullorja për “Mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere” që është në përputhje me Rregulloren e (BE) 2019/2033 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 27 nëntor 2019 mbi kërkesat prudenciale të shoqërive komisionere dhe ndryshimin e Rregulloreve (BE) Nr. 1093/2010, (BE) Nr 575/2013, (BE) Nr 600/2014 dhe (BE) Nr 806/2014, si dhe me Direktivën e (BE) 2019/2034 mbi mbikëqyrjen prudenciale të shoqërive komisionere dhe ndryshimin e Direktivave 2002/87/KE, 2009/65/KE, 2011/61/BE, 2013/36/BE, 2014/59/BE dhe 2014/65/BE.

Krahas ngritjes së infrastrukturës së nevojshme, AMF në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar një dokument politikash për zhvillimin e tregjeve të kapitalit. Dokumenti thekson nevojën dhe planet e veprimit që duhen ndjekur në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së emetuesit në treg, zgjerimit të investitorëve si dhe përmirësimit të efikasitetit të tregjeve të kapitalit.

AMF ka miratuar të gjitha rregulloret në zbatim të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj.

Shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, fondet e investimeve dhe depozitarët e tyre u përfshinë në procesin e përshtatjes së veprimtarisë së tyre me kërkesat e kuadrit rregullator të përcaktuar nga Ligji nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij. Gjatë këtij procesi, AMF shqyrtoi raportet e përputhshmërisë dhe dokumentacionin e paraqitur dhe Bordi i AMF-së mori vendimet përkatëse.

Për të mbrojtur konsumatorët dhe për të ruajtur stabilitetin financiar të tregut, Bordi i AMF-së me vendimin nr. 88, datë 28.04.2022, miratoi udhëzimin “Mbi pritshmëritë rregullore për tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive për periudhën prill – qershor 2022”, dhe kërkoi nga shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të rrisin frekuencën e raportimit në AMF për shlyerjet neto dhe treguesit e likuiditetit, mbi rezultatet e stres testeve dhe informacion mbi ndryshimin e vlerës së treguesit SRRI.

AMF miratoi me vendimin e Bordit nr.105, datë 31.05.2022 manualin për mbikëqyrjen me bazë rreziku të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Qëllimi i këtij manuali është t'i sigurojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare një material referues për të mundësuar zbatimin e përputhshmërisë dhe mbikëqyrjes së bazuar në rrezik të sektorit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Shqipëri sipas ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.09.2022 është 34,231 me një zbritje prej 14.54% krahasuar me 31.12.2021. Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve më 30.09.2022, vlera neto e aseteve të fondeve arriti rreth 53.76 miliardë lekë me një ulje prej 30.8% krahasuar me 31.12.2021.

#### 9.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Agjencia e Sigurimit të Depozitave ( ASD)
- Instituti i Statistikave (INSTAT)

#### 9.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

##### *Prioritetet*

Sipas raportit të progresit të BE-së 2022, nevojitet:

- të finalizojë hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike për edukimin financiar dhe zhvillimin e tregut të kapitalit;
- të përmirësojë ekzekutimin e kolateralit, duke përfshirë zgjidhjen e ngërçit në shërbimet e përmbarimit privat;
- të rritë përdorimin e monedhës kombëtare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare po punon për finalizimin e dokumentave strategjikë.

Banka e Shqipërisë gjatë 2-3 viteve të fundit ka transpozuar në vazhdimësi një pjesë të konsiderueshme të kërkesave të rishikuara të BE-së, veçanërisht në lidhje me kërkesat për kapital për rrezikun e kredisë, rrezikun e kundërpartisë, rrezikun e tregut dhe pozicionet në titullzime; për raportin e levës financiare; për treguesit e likuiditetit (raportin e mbulimit me likuiditet dhe raportin neto të financimit të qëndrueshëm); për ekspozimet e mëdha, etj.

Bazuar edhe në prioritetet e renditura në vijim, gjatë periudhës afatmesme 2023-2025, Banka e Shqipërisë parashikon që të vijojë me përafrimin e kuadrit rregullativ, veçanërisht për kërkesat e përditësuara të BE-së apo Bazelit, në lidhje me kapitalin rregullator dhe publikimin e informacionit.

Gjithashtu brenda vitit 2023 parashikohet të finalizohet puna për transpozimin e Direktivës 2014/92/KE “Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e



llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike” në projektligjin “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, për sa i përket kapitujve të Direktivës 2014/92/KE që trajtojnë kërkesat për aksesin në llogarinë e pagesave me shërbime bazike.

### **Prioritetet e Bankës së Shqipërisë:**

- Përafrimi i kuadrit rregullator e metodologjik me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përshtatja e parimeve të Komitetit të Bazelit dhe adresimi i problematikave të vërejtura dhe sugjerimeve të paraqitura nga ana e subjekteve të mbikëqyrura.
- Në periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë synon të punojë për zgjerimin dhe përmirësimin e instrumenteve makroprudenciale, paralelisht me zhvillimet e tregut financiar dhe rreziqeve të mundshme. Në këtë drejtim, fokusi afatshkurtër është operacionalizimi i Shtesës Sistemike të Rrezikut (SyRB) dhe në ndërtimin e kuadrit rregullator për përdorimin e instrumenteve të bazuara në huamarrës si kufijtë e LTV dhe DTI.
- Harmonizimi i vazhdueshëm i politikës monetare, fiskale dhe makroprudenciale.
- Zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe fuqizimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka në përputhje me kuadrin rregullator dhe metodologjik të Bashkimit Evropian dhe praktikatat më të mira.

### **Prioritetet e AMF-së janë:**

- Plotësimi i bazës rregullatore;
- Përafrimi me standardet më të mira ndërkombëtare në praktikatat mbikëqyrëse;
- Zhvillimi i tregjeve nën mbikëqyrje;
- Monitorimi i treguesve financiarë dhe subjekteve nën mbikëqyrje;

*Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë janë institucione të pavarura të cilat financohen nga burimet e veta dhe jo nga Buxheti i Shtetit.*

## **KAPITULLI 28: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETIT**

### **28.1 Përmbajtja e kapitullit**

Kapitulli 28 për pjesën e mbrojtjes së konsumatorit, mbulon mbrojtjen e interesit publik për çështje të sigurisë së produkteve dhe interesave ekonomike të konsumatorëve, për aspekte të lidhura me politikën, legjislacionin dhe zbatimin e tij, etj.

Pjesa e shëndetit, përfshin standardet për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave dhe organeve si dhe barnave për përdorim njerëzor dhe veterinar. Gjithashtu, këtu përfshihen pajisjet mjekësore, produktet kozmetike, shëndeti mendor, parandalimi i abuzimit me drogën, pabarazia

shëndetësore, ushqyerja, reduktimi i dëmeve të lidhura me alkoolin, shfaqja e kancerit, mjedise të shëndetshme duke përfshirë parandalimin e lëndimeve, promovimin e sigurisë, plakjen aktive dhe të shëndetshme si dhe veprimin evropian në fushën e sëmundjeve të rralla.

## 28.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 28 është i ndarë në dy nënkapituj:

- Mbrojtja e Konsumatorit;
- Mbrojtja e Shëndetit

## 28.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Angazhimet në fushën e mbrojtjes së konsumatorit janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga nenet 70 dhe 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe të dispozitave përkatëse të acquis së BE-së.

Detyrimi për të përafuar ligjin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 i MSA-së dhe Kriteret e Kopenhagës.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit përmban gjithashtu një dispozitë të përshtatur që merret me mbrojtjen e konsumatorit. Neni 76 i MSA-së kërkon që Shqipëria të sigurojë një politikë të mbrojtjes aktive të konsumatorit; të harmonizojë legjislacionin dhe të sigurojë mbrojtje efektive ligjore të konsumatorëve.

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit përfshin masat rregullatore, rekomandimet për Shtetet Anëtare, koordinimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të Shteteve Anëtare duke përfshirë mbështetjen financiare. Shtetet Anëtare duhet të transpozojnë acquis në legjislacionin kombëtar dhe të krijojnë struktura të përshtatshme administrative të cilat lejojnë mbikëqyrje efektive të tregut dhe zbatimin e acquis. Duhet të sigurohen gjithashtu mekanizma të përshtatshëm gjyqësorë edhe jashtë gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe informimin dhe edukimin e konsumatorit dhe një rol për organizatat e konsumatorit.

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit përbëhet nga legjislacioni për sigurinë e produkteve dhe Sistemin e Alarmit të Bashkimit Evropian (RAPEX), imitimet e rrezikshme, përgjegjësinë për produktet me defekte, bashkëpunimin ndërkuftar të zbatimit, dëmshpërblimin e konsumatorit, shitjen e mallrave të konsumit dhe garancitë përkatëse, kushtet e padrejta të kontratave, treguesit e çmimeve, të drejtat e konsumatorit, kredia konsumatore, praktikatat e padrejta tregtare, etj.

Për sa i përket shëndetit publik, acquis përbëhet nga masat që lidhen me kontrollin e duhanit, kërcënimet serioze për shëndetin ndërkuftar, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, gjakun, indet,

qelizat dhe organet, të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, produktet medicinale dhe kozmetikë, pajisjet medicinale, etc..

Në lidhje me gjakun, *acquis* përbëhet nga masat që lidhen me forcimin e kapaciteteve për implementimin e legjislacionit EU përcaktimin dhe forcimin e kapaciteteve të autoriteteve kompetente pavarura për autorizimin, licencimin, akreditimin, inspektimin, vigjilencën dhe raportimin.

#### 28.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Njëfarë përparimi ka pasur në lidhje me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve.

Sa i përket situatës aktuale në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, Shqipëria ka zhvilluar përgjatë shumë viteve një politikë dhe një kuadër legjislativ të posaçëm për çështjet e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrjes së tregut. Në periudhën pas përfundimit të Strategjisë Ndër-sektoriale “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut, 2020”, lindi nevoja që të sigurohet plotësimi i boshllëkut, si një përgjigje efektive ndaj të gjitha prioritetëve të reja në zhvillimin e vendit, nëpërmjet hartimit të një dokumenti të ri strategjik. Për këtë qëllim MFE ndërmori iniciativën për hartimin e një Strategjie të re “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2023-2030”. Me Urdhër të Kryeministrit është krijuar Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e strategjisë, me përfaqësues nga ministrinë e linjës; institucione të tjera shtetërore, entet dhe autoritetet e tjera rregullatorë, etj.

Strategjia do të ketë karakter ndër-sektorial, do të përcaktojë vizionin, qëllimin, objektivat, si dhe do të mbulojë një spektër të gjerë çështjesh nëpërmjet tre shtyllave kryesore:

I. Siguria e produkteve: produkteve ushqimore dhe e produkteve jo-ushqimore; barnat për përdorim njerëzor; kozmetika; fusha e infrastrukturës së cilësisë; mbikëqyrja e tregut; etj.

II. Çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me aspektet e sigurisë (interesat ekonomike): praktikat tregtare; zbatimi i të drejtave të konsumatorëve; zgjidhja alternative dhe online e mosmarrëveshjeve; mjedisi; turizmi; digjitalizimi; etj.

III. Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe i subjekteve, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional dhe me të gjithë aktorët e tjerë: organizatat e konsumatorëve, shoqëria civile, biznesi, akademikët, etj.

Për sa i përket çështjeve që nuk lidhen me sigurinë, ligji horizontal 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar, është i përafuar gjerësisht me direktivat kryesore në këtë fushë, siç janë Direktiva mbi kushtet e padrejta të kontratave, Direktiva e shitjes së mallrave dhe garancive, Direktiva e mbi publicitetet çorientues dhe krahasues, Direktiva e praktikave të padrejta tregtare, Direktiva e kredisë së konsumatorit, etj. Ndryshimi më i fundit i këtij ligji të miratuar në tetor 2018 (Ligji 71/2018), ka rritur më tej shkallën e përafrimit duke e harmonizuar pjesërisht me Direktivën

2011/83 për të drejtat e konsumatorit dhe Direktivën 2013/11 mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ADR). Parimet themelore të disa çështjeve të tjera të lidhura me konsumatorin janë të rregulluara me Ligjin 9902/2008, dhe më tej janë përpunuar me legjislacionin sekondar, siç janë kontratat në largësi të shërbimeve financiare, paketat e udhëtimit, zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, etj.

Në lidhje me zbatueshmërinë e çështjeve të mësipërme, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK) është organi kryesor përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve. Kapaciteti i KMK forcohet vazhdimisht përmes trajnimeve mbi legjislacionin e BE-së dhe praktikave të zbatimit. Në Takimin e 12 të Nën-komitetit BE – Shqipëri “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”, nga ana e Komisionit Evropian u vlerësua puna e Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit, duke theksuar se ky institucion po lëviz në drejtimin e duhur. Aktivitetet e KMK drejtohen kryesisht në mbrojtjen e interesave të përgjithshme të konsumatorëve, por njëkohësisht u jepet zgjidhje dhe ankesave individuale të konsumatorit. Me ngritjen e strukturës për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, ankesat individuale të konsumatorëve do të gjejnë trajtim/zgjidhje nga kjo strukturë e re. Komisioni është organ vendimmarrës dhe ka marre vendime në lidhje me kushtet standarde të kontratës në sektorin e shërbimeve, siç janë energjia elektrike, uji, interneti, telekomunikacioni, institucionet e arsimit të lartë. Masat e dhëna nga KMK kanë synuar gjetjen dhe eliminimin e kushteve të padrejta në këto kontrata. Transparenca dhe përgjegjësia e këtij organi sigurohet duke publikuar vendimet e saj dhe raportet vjetore në faqen e internetit të KMK-së. Kjo faqe interneti, që funksionon që nga viti 2015, ka rritur gjithashtu mundësinë e përdorimit të informacionit nga konsumatorët pasi përmban të gjithë legjislacionin, informacionin dhe materialet për ndërgjegjësimin e tyre, si dhe informacionin mbi aktivitetet, si dhe raportet vjetore të KMK. Konsumatorët mund të paraqesin ankesat e tyre edhe përmes kësaj faqe interneti.

Në 22 Dhjetor 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar disa ndryshime në Rregulloren nr. 48, datë 01.07.2015 “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare” në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Këto ndryshime synojnë një harmonizim më të lartë me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian 2008/48/BE “Mbi marrëveshjen e kredisë për konsumatorët” që rregullojnë marrëveshjet e kredisë konsumatore dhe të kredisë hipotekore për individët me qëllim rritjen e kërkesave të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe janë në përshtatje me detyrimet që rrjedhin për Bankën e Shqipërisë nga dokumentet strategjike të integritimit evropian, raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe planit kombëtar për integrimin evropian (PKIE) 2021 – 2023.

Më konkretisht ndryshimet adresojnë kryesisht dispozitat të tilla si: a) përkufizimi i tejkallimit të limitit, shërbimet ndihmëse (sekondare) etj.; b) plotësimin e e informacionit para-kontraktor dhe atij kontraktor me disa elementë shtesë të tilla si pagesat e shtyra; c) e drejta e konsumatorit të pajiset me kërkesë të tij pa komision me kopje të draft kontratës së kredisë; d) kur amortizimi i kapitalit të një marrëveshje kredie me një kohëzgjatje fikse, të drejtën e konsumatorit të marrë me

kërkesë të tij dhe pa kosto, në çdo moment gjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë gjendjen e llogarisë në formën e një table amortizimi; e) parashikimin e një kërkesë të re në rastin e tejkalimit; f) këto amendime janë reflektuar gjithashtu në aneksin 1 të rregullores “informacioni standard para-kontraktor i kredisë konsumatore”; etj..

Sa i përket Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bordi i AMF-së ka miratuar një strategji për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit 2017 – 2020, nëpërmjet së cilës synohet përafrimi sa më i plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Strategjia “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje” 2017 – 2020, u përmbyll me realizimin e objektivave të qarta, por edhe me vetëdijen, që në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm të tregut dhe institucionet financiare e arsimore ta kalojmë edukimin financiar në një nivel tjetër dhe me synimin për të hartuar dhe nisur zbatimin e një strategjie të dytë edukimi për Institucionin, duke marrë nga eksperiencat më të mira në mbarë botën sipas sugjerimeve të OECD-së.

Hyrja në fuqi e ligjit 52/2014 “Për Sigurimin dhe Ri-sigurimin” ka mundësuar të gjithë kuadrin ligjor të nevojshëm për të mbështetur zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve si edhe janë rregulluar parimet themelore të disa çështjeve të tjera të lidhura me konsumatorin.

Gjatë vitit 2020, AMF ka mundësuar sistemin e të dhënave të historikut të dëmeve për pronarin dhe drejtuesit e mjeteve. Gjithashtu konsumatori/investitori mund të kontrollojë në çdo kohë, nëpërmjet një kodi unik të gjeneruar nga sistemi i integruar me shoqëritë e sigurimit, statusin e trajtimit të dosjes së tij të dëmshpërblimit.

Gjithashtu, AMF ka publikuar në faqen web Kartën e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit. Kjo Kartë përcakton të drejtat themelore që gëzon konsumatori dhe investitori në marrjen e shërbimeve në tregun financiar jo-bankar, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si edhe ligjeve specifike, të cilat rregullojnë secilin treg financiar jo-bankar. Ky dokument paraqet informacion të përmbledhur dhe të qartë, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Që prej vitit 2020 është hartuar dhe është publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare fjalori i termave financiar, me qëllim informimin e konsumatorit me termat e tregut financiar jo-bankar, produktet, shërbimet e ofruara etj.

Në kuadër të angazhimit të Shqipërisë në CEFTA, përveç fushës së tregtisë elektronike dhe mbrojtjes së konsumatorëve, mbi hartimin e Projektvendimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore “Për lehtësimin e tregtisë elektronike”, janë zhvilluar negociatat edhe në lidhje me hartimin e një tjetër Projektvendimi të këtij Komitetit “Mbi parandalimin e bllokimeve gjeografike të pajustificuara”. Nëpërmjet këtyre vendimeve synohet nxitja e tregtisë elektronike, e aksesit dhe lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve dhe aspekteve

te lidhura me mbrojtjen e konsumatorit në të gjithë tregun rajonal, si dhe harmonizimi i tyre me dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Aktualisht, projektvendimet nuk janë miratuar ende nga palët nënshkruese të CEFTA-s. Mbas këtij procesi do të ndiqen procedurat e brendshme për ratifikimin e tyre.

Për sa i përket çështjeve të lidhura me sigurinë, legjislacioni shqiptar (Ligji Nr. 10480/2011 për “Sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”) është përafuar gjerësisht me Direktivën e Përgjithshme të Sigurisë së Produkteve 2001/95/EC. Kodi Civil shqiptar, edhe pse pjesërisht, rregullon disa aspekte të parashikuara nga Direktiva 85/374/EEE mbi përgjegjësinë për produktet me defekt. Sa i përket zbatimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), i krijuar në vitin 2016, është institucioni përgjegjës për të siguruar që produkti i vendosur në treg është i sigurt për konsumatorët.

Në çështjet që lidhen me sigurinë e produkteve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, krijuar me VKM Nr. 36/2016, përgjatë periudhës 2021-2022 ka vijuar të plotësoj organikën e saj dhe ka aktualisht 67 punonjës nga 80 punonjës që duhet të ketë në total në bazë të organigramës të miratuar më 01.06.2020 e cila ka pësuar një rritje nga 69 pozicione në 80 pozicione në total, 50 prej të cilëve janë inspektorë. Po vijon, procesi i plotësimit të vendeve vakante të mbetura nëpërmjet procedurave të konkurrimit të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike dhe pritet që stafi të rritet edhe më tej brenda vitit 2022. Legjislacioni kombëtar përputhet pjesërisht me *acquis* të BE-së.

Sa i përket arritjeve kryesore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, në kuadër të Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve, gjatë viteve janë miratuar aktet nënligjore si me poshtë:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1089, datë 24.12.2020 “Për krijimin dhe mënyrën e -organizimit e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, si dhe për përcaktimin e kriterëve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”, si dhe
- Urdhri i Kryeministrit nr. 64, datë 30.7.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve”.

Ligji i mbrojtjes së konsumatorëve dhe baza ligjore e sipërpërmendur kanë përcaktuar ngritjen e Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (DPZAM), si institucion varësie pranë Ministrisë përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve, aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Misioni i DPZAM do të jetë garantimi i mbrojtjes së interesave të konsumatorëve në treg, përmes zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, që rrjedhin nga kontratat e shitjes apo shërbimit ndërmjet tyre e që janë në fushën e saj të përgjegjësisë. Kjo strukturë pritet të ngrihet e të jetë funksionale brenda vitit 2023, në ndjekje të procedurave të rekrutimit të nëpunësve të administratës publike.

Për të siguruar harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit me *acquis* të BE-së në fushën e tregimit në distancë të shërbimeve financiare, sipas planifikimit në PKIE

2020 – 2022, është miratuar VKM nr. 736, datë 3.12.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 615, datë 7.9.2011 “Për tregtimin në largësi të shërbimeve financiare të konsumatorëve”.

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve gjatë vitit 2022, ka vijuar funksionimin në drejtim të zbatimit të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet zhvillimit të dy mbledhjeve, duke marrë në shqyrtim rreth 20 çështje, 9 prej të cilave të lidhura me mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik të konsumatorëve. Gjithashtu janë shqyrtuar ankesat e konsumatorëve, të paraqitura nga konsumatorë individuale, shoqata e konsumatorëve dhe pushteti lokal. Ankesat kanë gjetur zgjidhje nëpërmjet 4 vendimeve të KMK apo nga procedurat e ndërmjetësimit të ndjekura nga KMK. Gjithashtu, ankesat e tjera i kanë kaluar për kompetencë institucioneve të tjera sipas fushës së përgjegjësisë: ISHMT, AKEP, Banka e Shqipërisë, etj.

ISHMT përgjatë vitit 2022 ka vijuar punën për kontrollin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga ana e operatorëve ekonomik lidhur me të drejtat e konsumatorëve. Për këtë inspektimet janë zhvilluar në dy drejtime: ato të programuara nga ISHMT dhe ato të iniciuara nga ankesat e konsumatorëve.

- Inspektimet e programuara janë zhvilluar kryesisht në lidhje me detyrimin për dhënien e informacionit të domosdoshëm konsumatorëve nëpërmjet etiketimit, informacionit në gjuhën shqipe si dhe treguesin e çmimit. Në total janë inspektuar 119 operatorë ekonomik, nga të cilët 104 janë evidentuar në respektim të detyrimeve ligjore dhe 15 prej tyre janë sanksionuar me masë administrative (11 gjoba dhe 3 paralajmërime në përputhje me ligjin Nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar. Përveç kontrolleve me objekt kryesor mbrojtjen konsumatore referuar si më lartë, janë realizuar edhe 426 inspektimeve të planifikuara lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore për sigurinë e produkteve jo-ushqimore si produkte elektrike, detergjentë, tekstile, artikuj për fëmijë, apo kontrollin e para-paketimeve (kryesisht produkte të shportës). Përgjatë këtyre kontrolleve është verifikuar edhe zbatueshmëria e detyrimeve që parashikohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatore, nga ku kanë rezultuar 12 subjekte në shkelje të kërkesave ligjore, për të cilat është vendosur masë administrative gjobë.
- Në lidhje me ndjekjen e ankesave për mbrojtjen e konsumatorit janë përfshirë të gjithë sektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve në ISHMT. Ankesat e paraqitura në pjesën thelbësore të tyre kanë patur për objekt mosrespektimin e kërkesave të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e konsumatore lidhur me detyrimin e informimit (mospërputhje e peshës/sasisë së deklaruar me peshën reale), etiketimin, detyrimin e dhënies së informacionit në gjuhën shqipe, treguesin e çmimit, si dhe garancinë ligjore. Janë ndjekur 14 ankesa që lidhen me produkte nga më të ndryshmet si: elektroshtëpiake, mobilje, argjendari, këpucë apo produkte të shportës si dhe karburanti gazi (sa i përket sasisë e gazit). Nga trajtimi i këtyre ankesave janë iniciuar 45 inspektime të cilat kanë rezultuar në vendosjen e 5 masave administrative për subjektet tregtare. Po kështu janë paraqitur 14 ankesa të tjera nga qytetar në lidhje me sigurinë e produkteve/ instalimeve (ashensorë). Të gjitha ankesat e trajtuara janë zgjidhur në favor të konsumatorëve duke u kompensuar sipas të drejtave që garantohen nëpërmjet ligjit të mbrojtjes konsumatore apo duke garantuar vendosjen e produkteve/instalimeve në konformitet. Një pjesë e ankesave i janë drejtuar ISHMT nëpërmjet faqes online (rubrika ANKOHU:

<http://ishmt.gov.al/formular-ankese/>), adresës së emailit ([info@ishmt.gov.al](mailto:info@ishmt.gov.al)) dhe nëpërmjet adresës postare (Rruga Shyqyri Bërxolli, Nr 65, Tirana 1001). Pjesa tjetër e ankesave janë përcjellë ne ISHMT nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Agjencia për mbrojtjen e konsumatorit e Bashkisë Tiranë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, ISHMT ka vijuar të punojë në drejtim të fuqizimit të mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore të stafit, të cilëve ju është dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm mbi procedurat që duhet të ndiqen për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve. Një nga trajnimet e organizuara me ekspert të fushës së mbrojtjes konsumatore ka patur në fokus të veçantë garancinë kontraktuale dhe atë ligjore, me qëllim përmirësimin e njohurive të inspektorëve të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve për ndjekjen me efikasitet të ankesave konsumatore me këtë objekt. Po kështu, stafi i ISHMT gjatë vitit 2022 ka marrë pjesë në trajnimet online të organizuara me mbështetjen e GIZ në kuadër të Projektit SANECA/GIZ, në bashkëpunim me ASPA dhe College of Europe, mbi direktivat/rregulloret veçanërisht trajnimet ku janë trajtuar çështjet që lidhen drejtpërdrejtë me fushën e përgjegjësisë së ISHMT në implementim sa i përket të drejtave të konsumatorëve si dhe rregullorja e re për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo-ushqimore.

Prej vitit 2018, ISHMT disponon website-n e saj zyrtar, ku përveç materialeve informuese që janë të publikuar si për konsumatorët edhe për bizneset, ka një seksion të posaçëm ku qytetarët mund të drejtojnë ankesat e tyre. Gjatë vitit 2022, përveç inspektimit si përgjegjësi kryesore, ISHMT ka vijuar me shpërndarjen e broshurave për informimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe operatorëve ekonomik mbi të drejtat e konsumatorit dhe mundësitë e ankimit pranë ISHMT. Si për çdo vit, në kuadër të 1 Qershorit, Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve ISHMT ka organizuar aktivitetin sensibilizues në bashkëpunim edhe me Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorëve të Bashkisë Tiranë mbi rëndësinë e kujdesit në përzgjedhjen e produkte të sigurta për jetën dhe shëndetin e fëmijëve. Gjatë këtij aktiviteti u shpërndanë broshura informuese mbi artikuj si biçikleta, artikuj të kujdesit ndaj tyre (takëme dhe tavolinat e ngrënies, karroca, rrethore, krevate, biberona, etj.) dhe konsumatorët (prindërit, familjarët) u këshilluan mbi kontrollin e elementëve të sigurisë si fiksimi i standardeve në këto artikuj, paralajmërimet e moshës, instruksionet e përdorimit dhe të mirëmbajtjes, të cilat duhen kontrolluar përpara se t'i blejnë për fëmijët e tyre.

Sa i përket Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, deri në muajin shtator 2020 janë trajtuar mbi 150 ankesa nga Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore, të cilat krahasuar me një vit më parë përbëjnë rreth 60% më tepër ankesa të trajtuara. Metodika e trajtimit të ankesave rregullohet nga Rregullorja 35 “Për trajtimin e ankesave të konsumatorëve”.

Me ndryshimet strukturore të vitit 2020, Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore u forcua në kapacitete duke u kthyer në Departament.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), gjatë vitit 2021 ka pasur vetëm 1 (një) ankesë që lidhet me mbrojtjen e konsumatorit. Ankesa i është drejtuar Agjencisë për Mbrojtjen e Konsumatorit ndërsa AMA-s për dijeni.



Në vijim të procedurave tona, AMA i kërkoi kompanisë “DIGIT-ALB” sh.a., ndaj së cilës adresohet ankesa, kontratën që kishte me abonentët e saj. Sipas kontratës së depozituar në AMA, “përmbajtjet programore janë subjekt i ndryshimeve që mund të ndërmarrë subjekti/kompania”.

Sa i përket shëndetit publik, nuk ka pasur progres në rekomandimet e vitit të kaluar. Për shëndetin publik, pandemia COVID-19 ka treguar një nevojë të shtuar për gatishmëri emergjente dhe për të rritur kapacitetin e infrastrukturës shëndetësore emergjente. Për të zbatuar qasjen “One Health” si dhe gatishmërinë shëndetësore për të gjitha rreziqet është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 2143, datë 23.05.2022 i cili përmirëson edhe shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin. Gjithashtu, duhet bërë më shumë në përgjithësi për të forcuar kuadrin e politikave dhe për të siguruar që të gjithë në Shqipëri të kenë mbulim cilësor të kujdesit shëndetësor.

Sa i përket **gjakut**, indeksi i dhurimit është 10.2 dhurime për 1000 banorë (të dhënat e vitit 2020) dhe 19% e tyre janë dhurime vullnetare. Gjaku i dhuruar në nivel kombëtar testohet për agjentë infektivë në një qendër të vetme në Tiranë, ndërkohë që akoma nuk është centralizuar testimi imuno-hematologjik dhe përpunimi i gjakut në qendrat rajonale. Legjislacioni është harmonizuar në pjesën më të madhe të tij me Direktivën 2002/98/EC dhe direktivat zbatuese të saj edhe pse akoma ka nevojë për ndërhyrje specifike për një harmonizim të plotë me legjislacionin EU.

**Sa i përket sëmundjeve të rralla**, në bashkëpunim me Bankën Botërore, po zbatohet Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 miratuar me VKM Nr. 210, datë 6.04.2022. Në fushën e kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, ekziston baza ligjore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe është hartuar për të qenë në përputhje me acquis. Ekziston një sistem kombëtar alarmi dhe mbikëqyrjeje për sëmundjet ngjitëse. Shkalla kombëtare e mbulimit të imunizimit është 97%. Për kontrollin e duhanit është duke u zbatuar ligji për mbrojtjen e shëndetit publik kundër produkteve të duhanit, i cili është hartuar për t’u harmonizuar me acquis. Për parandalimin e abuzimit me drogën dhe reduktimin e dëmeve, janë zhvilluar disa aktivitete parandaluese, kryesisht të iniciuara nga Departamenti i Promovimit të Shëndetit dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Komiteti Ndër-sektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit ka miratuar gjatë viteve 2020-21 vendimet si më poshtë:

- Vendim Nr. 7, datë 19.2.2020 “Për miratimin e fotove të paralajmërimeve për efektet - shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë” përafuar me Direktivën e Deleguar të Komisionit 2014/109/BE të datës 10.10.2014 që ndryshon Aneksin II të Direktivës 2014/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke krijuar bibliotekën e paralajmërimeve me fotografi që do të përdoren në produktet e duhanit;
- Vendim nr. 8, datë 29.1.2021 “Për disa ndryshime në vendimin e Komitetit Ndër-sektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit nr. 7, datë 19.2.2020 “Për miratimin e

disa shtesave dhe ndryshimeve të fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë”.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit evropian mbi të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe në zbatim të politikave dhe strategjive të qeverisë shqiptare, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor operon përmes zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare bilaterale (kryesisht me vende anëtare të Bashkimit Evropian) të ratifikuara si më poshtë vijojnë:

- Ligji nr. 9066, datë 15.5.2003, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;
- Ligji nr. 35/2014, datë 3.4.2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;
- Ligji nr. 42/2015, datë 16.4.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligji nr. 123/2015, datë 12.11.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligji nr. 151/2015, datë 21.12.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligji Nr. 23/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Mbrojtjen Shoqërore dhe të Protokollit përfundimtar të saj”;
- Ligji Nr. 34/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për Mbrojtjen Shoqërore”;
- Ligji Nr. 42/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për Mbrojtjen Shoqërore”.

Në bazë të Marrëveshjeve të lartpërmendura Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është institucioni përgjegjës për ndjekjen e procedurave administrative lidhur me lëshimin e formularëve të sigurimeve shëndetësore. Në Marrëveshje parashikohen rastet kur një person i siguruar, që ka fituar të drejtën e përfitimit në natyrë sipas legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese fiton të drejtën e përfitimeve në natyrë në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Në këtë rast përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente (FSDKSH) nga agjencia e vendit të qëndrimit, e cila është përgjegjëse për rimbursimin e përfitimeve në natyrë sipas legjislacionit në fuqi.

Programi Kombëtar i **Kujdesit Shëndetësor** siguron kujdes shëndetësor në vendbanime, kryesisht për grupet e marginalizuara rome dhe egjiptiane. Në kuadër të iniciativave të ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë ofruar shërbime të dedikuara falas për gratë rome dhe egjiptiane për pap test, vizita falas dhe të gjitha shërbimet që u nevojiten. Qëllimi i kësaj iniciative është rritja e aksesit ndaj shërbimeve për gratë e marginalizuara që synojnë parandalimin e sëmundjeve nëpërmjet kontrolleve të hershme. Janë zhvilluar aktivitete/trajtime në fushën e

ndërgjegjësimin për HIV në komunitetin Rom dhe Egjiptian. Aktivitetet/trajnimet kanë pasur qëllim që duke përfshirë edhe anëtarë nga komuniteti Rom dhe Egjiptianë të rrisin informacionin mbi infeksionin HIV dhe në këtë grup popullate. Roli i këtyre aktiviteteve është i rëndësishëm për të lehtësuar komunikimin me familjarët gjatë vizitave në shtëpi.

Në lidhje me pajisjet mjekësore, është miratuar Ligji 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” në zbatim të rregullores evropiane për pajisjet mjekësore. Rishikimi i ligjit është bërë në vijim të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe ka si qëllim rritjen e sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve mjekësore pas vendosjes së tyre në treg dhe rritjen e aksesit për pacientet. Ligji parashikon pajisjen me licencë të tregtuesve me shumicë të pajisjeve mjekësore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përgatitur aktin nënligjor që përcakton kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimit për të garantuar cilësinë dhe ruajtjen e standardeve më të mira mbi pajisjet mjekësore që prodhohen në vend. Ndryshimet ligjore rregullojnë edhe tregtimin e pajisjeve mjekësore përmes internetit, dhe gjithashtu forcon masat e marra për çdo subjekt që shkel ligjin.

Sa i përket përgatitjeve për takimin bilateral në kuadër të fazës screening, gjatë vitit 2021 GNPIE ka vijuar punën për përmbushjen e Planit të Hapave Kyç. Si rezultat, është rishikuar dhe përditësuar në shkurt 2021, Analiza e Mangësive Ligjore (Screening List) dhe Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative, të finalizuara më herët në shtator 2020, duke dhënë një panoramë më të qartë lidhur me mangësitë dhe masat që duhen ndërmarrë në vazhdim për t'i adresuar ato. Ndonëse pjesa që i takon nënkaptullit të shëndetit publik, ka ende nevojë për plotësim të mëtejshme, këto dokumente janë një bazë e mirë pune për përgatitjen e prezantimit për takimin dypalësh.

Shqipëria ishte një nga vendet e para që mori të gjithë masat e nevojshme për t'ju përgjigjur në kohë dhe me efikasitet pandemisë COVID – 19, duke filluar nga garantimi i mjeteve të mbrojtjes personale për stafin shëndetësor në të gjithë nivelet e sistemit shëndet publik, parësor dhe spitalor, forcimin e kapaciteteve të terapisë intensive dhe sub-intensive duke dedikuar 550 shtretër 80% e tyre me linja oksigjeni dhe ku gjysma e tyre janë kapacitete të reja në sistem, spitalet covid dhe njësitë e terapisë intensive në spitalet publike u pajisën me aparaturë të reja bio-mjekësore, u rrit me 67% kapaciteti i aparaturave jetë-shpëtuese respiratore në terapisë intensive dhe sub-intensive, si dhe u alokuan fonde për blerjen e pajisjeve të rënda bio-mjekësore për shërbimin e imazherisë dhe diagnostikës. U garantua testimi dhe diagnostikimi pa pagesë për qytetarët ndaj COVID – 19 në të gjithë strukturat publike të kujdesit parësor dhe atij spitalor. Gjithashtu u realizuar terapisë e mjekimit me barna sipas protokolleve të shërbimeve spitalore të njëjta me vendet e tjera pa asnjë mungesë, si dhe u siguroi terapia me plazëm sipas protokolleve për pacientët e hospitalizuar.

Në tetor të vitit 2020 me Vendim të Këshillit të Ministrave u miratua mbulimi në masën 100% të protokollit të mjekimit ambulator për të gjithë qytetarët me dy skema mjekimi (skema e lehtë dhe skema e moderuar). Për menaxhimin e pandemisë COVID–19, me mbështetjen e Zyrës së OBSH-

së në Tiranë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përgatiti dokumentet e mëposhtme strategjike:

- Plani i veprimit i Shqipërisë - Parandalimi, përgatitja dhe përgjigja Kundër COVID – 19;
- Strategjia e rihapjes;
- Strategjia e Përgjigjes Vjeshtë - Dimër 2020 – 2021;
- Plani Kombëtar i Vaksinimit ndaj COVID - 19

Në kuadër të vaksinimit ndaj COVID – 19, Shqipëria ishte një nga vendet e para në rajon që siguroi vaksinën ndaj COVID – 19, duke filluar aplikimin e saj në Janar të vitit 2021. Numri total i dozave të aplikuara deri më 31 tetor, 2022 është 2,987,733 doza dhe mbulesa vaksinale për popullatën e targetuar me dy doza është 57%. Për personelin shëndetësor në vijën e parë të luftës kundër Covid-19 është përcaktuar shpërblimi financiar 1,000 euro mbi pagën mujore dhe 500 euro mbi pagën për stafin mbështetës. Gjatë viteve të pandemisë COVID – 19, si dhe krizës së shkaktuar nga lufta në Ukrainë janë alokuar paketa të mbështetjes financiare të rezistencës sociale në mbrojtje të kategorive më vulnerabël, duke zgjeruar financimin e programit të mbrojtjes sociale, duke:

- Dyfishuar masat e pagesave për çdo familje në kohën e pandemisë;
- Rritur 20% masën e pagesës së Ndihmës Ekonomike, për 64 mijë familjet përfituese;
- Trefishuar masën e pagesës për jetimët, viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje;
- Dyfishuar masën e NE për nënat kryefamiljare dhe familjet me shumë fëmijë;
- Dyfishuar masën e NE për të moshuarit mbi 65 vjeç, të vetmuar, dhe ata pa pension pleqërie apo pension social.

Programet e parandalimit dhe kujdesit parësor synojnë mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit, si dhe parandalimin dhe diagnostikimin në kohë. Aktualisht nga buxheti i shtetit financohen programet kombëtare të parandalimit të shtrira në formë kapilare në të gjithë sistemin publik shëndetësor: Programi Kombëtar i Kontrollit Mjekësor Bazë (viti 2015); Programi Kombëtar i Depistimit, Diagnostikimit dhe Trajtimit të Kancerit të Gjirit (viti 2018 duke rezultuar rreth 20 mijë gra që e kryejnë mamografinë afër vendbanimit në strukturat tona publike); Programi Kombëtar i Depistimit dhe Diagnostikimit të Kancerit të Qafës së Mitrës (viti 2019 deri më tani më shumë se 40,000 gra janë ekzaminuar dhe u janë ofruar shërbime të specializuara kur ka qene e nevojshme.); Programi Kombëtar të Kujdesit të Shikimit të Fëmijët (viti 2022); dhe Programi Kombëtar i Depistimit të Shëndetit dhe Kujdesit Dentar (viti 2022). Nëpërmjet Programit të Rindërtimit të qendrave shëndetësore dhe shpërndarjes së tyre kapilare në territor është garantuar aksesueshmëria dhe cilësia e sistemit shëndetësor publik për qytetarët. Për periudhën 2018 – 2022 janë rikonstruktuar mbi 340 qendra shëndetësore dhe ambulanca.

Tashmë ka një statut të ri të qendrave shëndetësore nëpërmjet të cilin garantohet një racionalizim më i mirë i burimeve njerëzore, unifikim i shërbimit shëndetësor në kujdes parësor duke u shtuar gama e shërbimeve shëndetësore që do të ofrohen për qytetarët afër vendbanimit, fuqizimin e rolit dhe profilit të infermierit, përfshirjen e psikologut apo punonjësit social si pjesë e strukturave të qendrave shëndetësore për të ofruar për herë të parë një shërbim të ri atë socio - shëndetësor.

Janë miratuar protokollet e reja për trajtimin e sëmundjeve jo të transmetueshme në kujdes parësor, protokollet e shëndetit mendor, ofrimin të kujdesit në banesë dhe shumë shpejt përfundojmë rishikimin dhe përditësimin sipas protokolleve ndërkombëtare të mirëritjes së fëmijëve.

Gjithashtu, me krijimin e qendrave të mjekësisë familjare me shërbim 24 orë për qytetarët me shërbime të integruara socio – shëndetësore si një nga shtyllat e reformës së ndërmarrë në transformimin e kujdesit parësorë që po pilotohet në 20 qendra brenda këtij viti, është garantuar një qasje e integruar e funksionimit të sistemit shëndetësor publik, që ofron një shërbim shëndetësor cilësor, të aksesueshëm dhe të sigurt për grupet vulnerabël, të moshuarit, fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të politikave të saj për mbulimin shëndetësor me cilësi dhe aksesueshmëri ka bërë të mundur që fondi i dedikuar për Listën e Barnave me Rimbursim për vitin 2022 të rritet me të paktën 6%, duke garantuar kështu mbulimin në masën 100% të alternativës së parë të mjekimit për diagnozë për mbi 450 mijë qytetarë kronik që janë pjesë e skemës së rimbursimit në shërbim ambulator dhe spitalor.

Ka filluar zbatimin programi i kontrollit të fëmijëve për probleme dëgjimi në maternitete, duke përfshirë implantin koklear për fëmijët me dëmtim të dëgjimit, me financim të plotë nga buxheti i shtetit.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 210, datë 06.04.2022, u miratua Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021 – 2030. Me Urdhër Ministri u miratuan më tej dokumentet strategjik si më poshtë vijon:

- Plani i Veprimit për Promocionin Shëndetësor 2022 – 2030;
- Programi i Parandalimit të Sëmundjeve jo të transmetueshme 2021 – 2030;
- Programi Kombëtar i Kontrollit të Kancerit 2022 – 2030;
- Plani Kombëtar i Vaksinimit ndaj COVID – 19 2023 – 2026;
- Plani i Vaksinimit ndaj Lisë së Majmunit (MPX);
- Plani i Veprimit për sigurimin e kontraceptivëve 2023 2026.

Regjistri i kancerit tashmë është funksional në Shqipëri. Informacioni grumbullohet nga të gjithë spitalet publike dhe private. Është ndërtuar database përkatës në Institutin e Shëndetit Publik me të dhëna mbi të gjitha rastet e reja të diagnostikuara me kancer për periudhën 2015-2019. Ka përfunduar edhe raporti kombëtar i kancereve, bazuar në të dhëna të këtij regjistri. Gjithashtu janë mbledhur të dhënat mbi incidencën e kancereve për periudhën e pandemisë 2020-2021.

Në Planin e ri të Kontrollit të Kancereve 2022-2030, mbulohen të gjitha fushat e kontrollit përfshire parandalimin, depistimin, diagnozën e hershme, trajtimin, kujdesin paliativ, sistemet e informacionit dhe koordinimin.

Falë politikave të ndërmarra është rritur aksesin në përfitimin e shërbimeve shëndetësore pa pagesë dhe afër vendbanimit për popullatat e pa favorizuara, përfshirë komunitetin Rom dhe Egjiptian, të

moshuarit, personat me aftësi të kufizuar dhe popullsitë në zonat rurale ose të largëta, si dhe personave me probleme të shëndetit mendor.

Programet e shërbimeve spitalore dhe para-spitalore kanë si qëllim përmirësimin dhe fuqizimin e shërbimit në spitalet publike, duke filluar nga investimet në infrastrukturë, pajisjet e teknologjisë bio-mjekësore, modernizimit të shërbimeve spitalore dhe hapjes së shërbimeve të reja në spitalet rajonale me qëllim aksesin dhe ofrimin e shërbimit për qytetarët afër vendbanimit. Ky program mbështet ofrimin e shërbimit shëndetësor për qytetarët duke filluar nga diagnostikimi, trajtimi dhe rehabilitimi, si dhe garantimin e terapive mjekësore për pacientët. Gjithashtu, ky program financon urgjencën kombëtare mjekësore, si dhe investime në zgjerimin dhe fuqizimin e flotës së pajisjeve motorike të urgjencës para-spitalore. 218 autoambulanca janë në shërbim të urgjencës para-mjekësore për t'iu përgjigjur në kohë, me cilësi dhe efikasitet çdo thirrje që vjen në Qendrën e Koordinimit të Urgjencës Mjekësore. Gjatë vitit 2022, flotës së autoambulancave ju shtruan dhe 28 autoambulanca të reja dhe në vitin 2023 fillon hartimi i projektit për ndërtimin e qendrës së urgjencës para-mjekësore me qëllim përgjigjen në kohë dhe me efikasitet të të gjithë emergjencave natyrore apo shëndetësore.

Ligji i ri Nr. 55, datë 7.7.2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” mundëson dhe garanton fillimin e një ndryshimi të shumëpritur për shërbimin spitalor publik dhe jo publik, duke i dhënë së pari mundësinë spitaleve publike të kenë mekanizmat e duhur ligjor dhe rregullator për tu vetë-administruar për nga pikëpamja menaxheriale dhe financiare, rritjen e konkurrueshmërisë ndërmjet spitaleve publike ndërmjet njëri – tjetrit por dhe me spitalet jopublike, rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor për qytetarët, mirë-menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e instrumenteve dhe mekanizmave për punësimin e mjekëve specialist në sektorin publik, si dhe rritjen e gamës së shërbimeve në spitalet publike duke i dhënë fund epokës së centralizimit të shërbimeve shëndetësore publike në nivel terciar vetëm në spitalet universitare.

Programet e digjitalizimit në shëndetësi janë pjesë integrale e sistemit shëndetësor publik ku është investuar në sistemet e informacionit në kujdes parësor, shëndet publik, sistemit spitalor dhe ato të menaxhimit të sistemit shëndetësor publik, duke zgjeruar sistemet e shëndetësisë elektronike.

Për të zbatuar qasjen “One Health” si dhe gatishmërinë shëndetësore për të gjitha rreziqet është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Nr. 2143, datë 23.05.2022, i cili përmirëson edhe shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin.

Sa i përket gjakut, indeksi i dhurimit është 12.2 dhurime për 1000 banorë (të dhënat e vitit 2021) dhe 19% e tyre janë dhurime vullnetare. Gjaku i dhuruar në nivel kombëtar testohet për agjentë infektivë në një qendër të vetme në Tiranë, ndërkohë që akoma nuk është centralizuar testimi imuno-hematologjik dhe përpunimi i gjakut në qendrat rajonale. Legjislacioni është harmonizuar në pjesën më të madhe të tij me Direktivën 2002/98/EC dhe direktivat zbatuese të saj edhe pse akoma ka nevojë për ndërhyrje specifike për një harmonizim të plotë me legjislacionin evropian. Është në fazë implementimi sistemi informatik kombëtar i menaxhimit të bankave të gjakut, i cili

synon të ngushtojë distancën e komunikimit midis dhuruesit, bankës së gjakut dhe marrësit përmes ofrimit të një sistemi të përbashkët për tre aktorët duke përmbushur kërkesat për gjak. Sistemi do të bëjë të mundur automatizim e procesit të ruajtjes, procesimit, marrjes dhe analizimit të informacionit që lidhet me menaxhimin administrativ dhe inventarizimin e gjakut dhe produkteve të tij në të gjitha bankat e gjakut dhe spitalet publike/private në vendin tonë.

Shkëmbimi i informacionit midis bankave të gjakut për të përmbushur kërkesat për gjak është një nga prioritetet e vënies në funksionim të tij. Sistemi do të garantojë rritje të saktësisë së informacionit mbi gjakun dhe nënproduktet, dhuruesin, testet laboratorike si edhe menaxhimin e mirë të shpërndarjes së qeseve të gjakut duke konsideruar datat e skadencës. Gjithashtu, do të bëjë të mundur ruajtjen e historikut të testeve laboratorike për personat që dhurojnë gjak.

Në Strategjinë kombëtare të shëndetësisë 2021-2030 përfshihen edhe sëmundjet e rralla. Në fushën e kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, ekziston baza ligjore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse e hartuar në përputhje me acquis. Ekziston një sistem kombëtar alarmi dhe mbikëqyrjeje për sëmundjet ngjitëse. Shkalla kombëtare e mbulimit të imunizimit është 97%.

Për kontrollin e duhanit është duke u zbatuar ligji për mbrojtjen e shëndetit publik kundër produkteve të duhanit, i cili është hartuar në harmonizim me acquis. Komitetit Ndër-sektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit ka miratuar vendimet si më poshtë:

- Vendim Nr. 7, datë 19.2.2020 “Për miratimin e fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë” përafuar me Direktivën e Deleguar të Komisionit 2014/109/BE të datës 10.10.2014 që ndryshon Aneksin II të Direktivës 2014/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke krijuar bibliotekën e paralajmërimeve me fotografi që do të përdoren në produktet e duhanit;
- Vendim nr. 8, datë 29.1.2021 “Për disa ndryshime në vendimin e Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit nr. 7, datë 19.2.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë”.

Për parandalimin e abuzimit me drogën dhe reduktimin e dëmeve, janë zhvilluar disa aktivitete parandaluese, kryesisht të iniciuara nga Departamenti i Promovimit të Shëndetit dhe Instituti i Shëndetit Publik. Në këtë kontekst, është garantuar këshillim psikologjik për reduktimin e varësisë nga drogat, ofrohen shërbime detokskifikimi pranë shërbimit të toksikologjisë, si mbulimin me metadon pa pagesë për të gjithë përdoruesit e drogave. Zyra e Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën, e ngritur me VKM Nr. 299, datë 14.4.2011, funksionon në përbërje të Institutit të Shëndetit Publik. Kjo zyrë mbledh informacione në fushën e drogës, të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 8750 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope”, si dhe të dhëna të tjera, sipas tabelave standarde të Qendrës Evropiane mbi Drogat dhe të Varësisë (EMCDDA) dhe është partneri zyrtar në vendin tonë për Drogat për EMCDDA. ZSKD-ja bashkëpunon me një rrjet specialistësh, përfaqësues të të gjitha institucioneve të përmendura në nenin 1 të VKM Nr. 299, datë 14.4.2011, për mbledhjen e informacionit dhe të dhënave të

nevojshme. Shqipëria po merr pjesë në Akademinë Reitor për Shkrimin e Raportëve Shkencorë mbi Drogat. Ky trajnim rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor filloi në tetor 2021 dhe përfundoi në qershor 2022. Më shumë se 6 ekspertë nga institucionet qendrore shqiptare (MHSP, ISHP, INSTAT, Policia e Shtetit Shqiptar, etj.) kanë marrë pjesë në trajnimin e Akademisë Reitor mbi shkrimin e RKD dhe kanë kontribuar me informacion, përpunim të të dhënave dhe shkrimi teksti për dokumentin e Raportit Kombëtar të Drogave.

Është ngritur grupi i punës për hartimin e Planit të Veprimit për parandalimin, trajtimin dhe reduktimin e dëmit nga drogat që do të pasqyrojë vizionin e dokumente ndërkombëtare, si të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të Qendrës Evropiane të Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat dhe ACQUIS përkatëse të BE-së. Gjithashtu, është hartuar projekt-ligji për disa ndryshime në Ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotik dhe lëndët psikotrope” që synon përditësimin e tabelës bazuar në rekomandimin e nënkomitetit Drejtësia, Liria dhe Siguria mbi përditësimin e tabelave të barnave narkotikë dhe substancave psikotrope.

Në kuadër të shëndetit mendor është në proces hartimi i Planit të Veprimit i ri mbi zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri, bazuar në objektivat relevante strategjike të dokumentit të ri të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021 – 2030. Objektivat do të reflektojnë vizionin e dokumenteve ndërkombëtare në shëndet mendor si Planit të veprimit për Shëndetin Mendor të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe dokumentet relevante të EU Soft Acquis në këtë fushë.

Në kuadër të përafrimit me acquis për barnat për përdorim njerëzor është hartuar Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 105/2014 ‘Për Barnat në Shërbimin Farmaceutik’, të ndryshuar” me qëllim harmonizimin më të plotë të kuadrit ligjor në këtë fushë me Direktivën e 2001/83/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 nëntor 2001 “Mbi Kodin e Komunitetit lidhur me produktet mjekësore për përdorim njerëzor”. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 105/2014 ‘Për Barnat në Shërbimin Farmaceutik’, të ndryshuar” aktualisht është në parlament për miratim.

Në lidhje me pajisjet mjekësore, është miratuar Ligji 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” në zbatim të rregullores evropiane për pajisjet mjekësore. Rishikimi i ligjit është bërë në vijim të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe ka si qëllim rritjen e sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve mjekësore pas vendosjes së tyre në treg dhe rritjen e aksesit për pacientet. Ligji parashikon pajisjen me licencë të tregtuesve me shumicë të pajisjeve mjekësore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përgatitur aktin nënligjor që përcakton kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimit për të garantuar cilësinë dhe ruajtjen e standardeve më të mira mbi pajisjet mjekësore që prodhohen në vend. Janë hartuar edhe tre akte rregullatore që lidhen me përcaktimin e rregullave për kryerjen e hetimeve klinike të pajisjeve mjekësore”, me tregtimin e pajisjeve mjekësore përmes internetit si dhe përcaktimin e rregullave të publicitetit të pajisjeve mjekësore që tregtohen në Republikën e Shqipërisë. Me qëllim forcimin e mëtejshëm të masave për garantimin e sigurisë në tregtimin dhe përdorimin e pajisjeve mjekësore, më qëllim përafrimit



e mëtejshëm të legjislacionit Evropian për pajisjet mjekësore, do të kryhet një proces vlerësues me qëllim rishikimin e kuadrit ekzistues rregullator dhe hartimin e akteve të tjera rregullatore.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit evropian mbi të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe në zbatim të politikave dhe strategjive të qeverisë shqiptare, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor operon përmes zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare bilaterale (kryesisht me vende anëtare të Bashkimit Evropian) të ratifikuara si më poshtë vijojnë:

- Ligji nr. 9066, datë 15.5.2003, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;
- Ligji nr. 35/2014, datë 3.4.2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;
- Ligji nr. 42/2015, datë 16.4.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligji nr. 123/2015, datë 12.11.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligji nr. 151/2015, datë 21.12.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligji Nr. 23/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Mbrojtjen Shoqërore dhe të Protokollit përfundimtar të saj”;
- Ligji Nr. 34/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për Mbrojtjen Shoqërore”;
- Ligji Nr. 42/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për Mbrojtjen Shoqërore”.

Në bazë të Marrëveshjeve të lartpërmendura Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është institucioni përgjegjës për ndjekjen e procedurave administrative lidhur me lëshimin e formularëve të sigurimeve shëndetësore. Në Marrëveshje parashikohen rastet kur një person i siguruar, që ka fituar të drejtën e përfitimit në natyrë sipas legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese fiton të drejtën e përfitimeve në natyrë në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Në këtë rast përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente (FSDKSH) nga agjencia e vendit të qëndrimit, e cila është përgjegjëse për rimbursimin e përfitimeve në natyrë sipas legjislacionit në fuqi.

Në kuadër të mirë-ushqyerjes në vitin 2021 u miratua Urdhri i Përbashkët ndërmjet MSHMS dhe MAS “Për miratimin e rregullores “Për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë”. Rregullorja për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë ka për qëllim të përcaktojë rregullat e ndalimit të reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore të arsimit bazë, në kuadër të luftës kundër kequshqyerjes. Rregullorja

zbatohet në të gjithë territorin dhe është e detyrueshme për të gjitha institucionet arsimore të arsimit bazë, publike e private. Kjo Rregullore synon të plotësojë dhe rregullimet e legjislacionit për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, si edhe legjislacionin për mediat audiovizuale, në lidhje me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare që shoqërojnë ose përfshihen në programet për të mitur, të ushqimeve e pijeve që përmbajnë substance të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të fëmijëve, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, acidi yndyror, kripe, sode e sheqeri, që janë tej normave të lejuara për një dietë ushqimore të shëndetshme për fëmijët.

Gjithashtu, u miratua edhe një Urdhër i përbashkët midis MSHMS, MAS dhe MBZhR nr. 336, datë 14.7.2021 “Për miratimin e rregullores “Për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore para-universitare”.

Një seri takimesh/trajnimesh që synojnë ndërgjegjësimin dhe zbatimin e duhur të Kuadrit rregullator dhe standardeve të ushqyerjes së fëmijëve – për institucionet e arsimit para-universitar në Shqipëri të të gjithë aktorëve të përfshirë, janë duke u zbatuar edhe gjatë periudhës 2021 – 2022 nga MSHMS dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Gjithashtu, vijon zbatimi i projektit “Shkollat për Shëndet”, që ka si synim kryesor të zvogëlojë ekspozimin ndaj faktorëve kryesorë të rrezikut për SJT-të në popullatën shqiptare me fokus të veçantë, nxënësit e arsimit 9-vjeçar, si dhe projekti “Përmirësimi i statusit ushqimor të fëmijët në shkolla, në Shqipëri”. Një projekt që zhvillohet nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), financuar nga UNICEF Albania. Ky projekt po zbatohet në 4 qarqe të vendit që prej 2020 dhe synon të kontribuojë në përmirësimin e praktikave ushqimore dhe parandalimin e çrregullimeve fizike dhe psikologjike tek fëmijët.

## 28.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Kuadri institucional që merret me mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit në Shqipëri përbëhet nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK);
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT);
- Banka e Shqipërisë (BA);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Spitalet Universitare për diagnostikimin, trajtimin, trajnimin e specialistëve;
- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

## 28.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Për sa i takon çështjeve të mbrojtjes së konsumatorëve janë identifikuar mangësitë në vijim:

- Mbështetur në dokumentin “Analiza e mangësive institucionale dhe administrative” (IAGA), janë evidentuar mangësitë në kapacitetet institucionale, kryesisht për arsye të numrit të limituar të stafit të strukturës së ngarkuar me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve. Së fundmi është miratuar një strukturë e re për MFE dhe krijohet një drejtori për tregun e brendshëm, në të cilën, çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve do të mbuloohen nga një sektor i veçantë. Rekrutimi i stafit parashikohet të kryhet gjatë viteve 2023-2024. Aktualisht, deri në plotësimin e strukturës së re, numri i punonjësve mbetet 3 të cilët vijnë të mbulojnë çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve të kapitullit 28 dhe të lëvizjes së lire të mallrave të kapitullit 1.
- Mungesa e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, në zbatim të legjisllacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, për ti dhënë zgjidhje ankesave individuale të konsumatorëve, gjithnjë e në rritje.
- Zhvillimet e vazhdueshme teknologjike, në tregun online, shërbimeve dixhitale apo dhe mjeteve dixhitale në përdorim nga konsumatorët, kërkojnë rregullime të legjisllacionit të mbrojtjes së konsumatorëve. Këto ndryshime, mbështetur edhe në analizën e legjisllacionit shqiptar të krahasuar me acquis (LGA), si dhe në takimet shpjeguese për kapitullin 28; , do të sigurojnë përafrimin e mëtejshëm me disa direktiva të reja evropiane, përmirësimin e transparencës së informimit ndaj konsumatorëve, zbatim më të mirë të të drejtave të tyre, si dhe përmirësimin e funksionimit të tregut.

Për sa i takon çështjeve të shëndetit publik janë identifikuar mangësitë në vijim:

- Pamjaftueshmëria në gjak (10,2 dhurime/1000 banorë)
- Shumica e dhuruesve janë dhurues familjarë (80%)
- Akoma mbetet një numër i vogël dhuruesish me pagesë jashtë Tirane (1% e dhurimeve në nivel kombëtar)
- Në Raportin Vjetor 2021 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për shëndetin mendor, rekomandohet vazhdimi i përmirësimit të aksesit në shëndetësi dhe shërbime për popullatat e pa favorizuara, duke përfshirë njerëzit me çrregullime të shëndetit mendor, të cilat shpesh i nënshtrohen formave të shumta të diskriminimit.

### **Prioritete në këtë kapitull për periudhën 2023 – 2025 janë:**

- Forcimi i kuadrit të politikave për shëndetin publik me miratimin e Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2021 – 2030 siguron zbatimin dhe qëndrueshmërinë e saj, përfshirë mbrojtjen financiare, dhe të harmonizojë më tej legjisllacionin e saj me acquis të BE-së për shëndetin mbi substancat me origjinë njerëzore dhe ilaçet për njerëzit dhe përdorimi veterinar;
- Përdorimi i mësimave të nxjerra nga pandemia COVID-19 për të forcuar gatishmërinë emergjente shëndetësore me të gjitha rreziqet, përfshirë kërcënimet përtej sëmundjeve ngjitëse dhe përgjigjeve si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal;
- Përmirësimi i aksesit në shëndetësi dhe shërbime për popullatat e pa favorizuara, përfshirë pakicat romë dhe egjiptiane, njerëzit e moshuar, personat me probleme të shëndetit mendor,

personat me aftësi të kufizuara; dhe popullsitë në zonat rurale ose të largëta, veçanërisht për gratë dhe vajzat që i përkasin këtyre grupeve të cilat shpesh i nënshtrohen formave të shumta të diskriminimit.

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit publik me *acquis* në përputhje me Analizën e Mangësive Ligjore (LGA) për Kapitullin 28;
- Fuqizimi i sistemit të mbikëqyrjes për rezistencën antibiotike dhe të një programi kontrolli dhe monitorimi mbi konsumin dhe politikat e antibiotikëve, përmes përmirësimit të legjislacionit, forcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve të informimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik;
- Rritja e numrit të dhuruesve vullnetarë përmes riorganizimit tërësor të promovimit të dhurimit vullnetar të gjakut në vend, forcimit të kapaciteteve promovuese brenda QKTGJ dhe digjitalizimit të të dhënave të dhuruesve/dhurimeve të gjakut në nivel kombëtar.
- Përmirësimi i cilësisë së gjakut përmes rritjes së kapaciteteve testuese/përpunuese/ruajtëse, harmonizimit të plotë të standardeve dhe legjislacionit me Direktivat Evropiane dhe dizenjimit/forcimit të kapaciteteve të autoriteteve kompetente për inspektim dhe hemovigjilancë. Implementimi i një sistemi të integruar të hemovigjilancës përmes ngritjes së një rrjeti raportimi dhe vlerësimi të reaksioneve dhe eventeve të padëshiruara.

Çështje të tjera horizontale:

- Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit, përmes funksionimit të Tryezës për Kapitullin 28, tashmë të ngritur, në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.
- Rritja e kapaciteteve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, lidhur me përfundimin e fazës *screening* dhe me tej me procesin e bisedimeve të anëtarësimit për Kapitullin 28.

## GRUPIMI III: KONKURRUESHMËRIA DHE RITJA GJITHËPËRFSHIRËSE

### KAPITULLI 10: SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA

#### 10.1 Përmbajtja e kapitullit

*Acquis* në këtë kapitull përfshin rregulla specifike për komunikimet elektronike, shërbimet e shoqërisë së informacionit, në veçanti tregtinë elektronike, shërbimet e aksesit të kushtëzuar dhe shërbimet audiovizive. Në fushën e komunikimeve elektronike *acquis* e Bashkimit Evropian, synon të eliminojë pengesat për funksionimin efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e telekomunikacionit, të promovojë konkurrencën dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në këtë sektor, duke përfshirë disponueshmërinë e shërbimeve universale moderne. Për sa i përket politikës audio-vizuale, *acquis* kërkon përafrimin ligjor me Direktivën e Televizionit pa Kufij, e cila krijon kushtet për lëvizjen e lirë të transmetimeve televizive brenda BE-së. Gjithashtu, *acquis* synon krijimin e një kuadri rregullator transparent, të parashikueshëm dhe efektiv për transmetimet publike dhe private në përputhje me standardet evropiane dhe kërkon kapacitet për të marrë pjesë në programet komunitare Media Plus dhe Media Training.

## 10.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 10, shoqëria e informacionit dhe media përbëhet nga tre fusha bazë si më poshtë:

- Komunikimet elektronike dhe teknologjitë e informacionit;
- Shërbimet e shoqërisë së informacionit;
- Politika audiovizuale

## 10.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Nenet 102-104 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, parashikojnë detyrimin për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së dhe harmonizimin me politikat e BE-së. Neni 102 i MSA parashikon bashkëpunimin në fushën audio-vizuale. Kjo përfshin një detyrim që Shqipëria të harmonizojë politikat e saj në rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimit ndërkufitar me standardet dhe legjislacionin e BE-së. Gjithashtu kërkon që vëmendje e veçantë t'i kushtohet respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në transmetimin e programeve me mjete të ndryshme, përfshirë tokësore, satelitore, kabllore etj. Ndryshimet e shpejta në teknologjinë e mediave, realitetin aktual të televizionit digjital në Shqipëri dhe përditësimin e legjislacionit me standardet dhe praktikën më të mira evropiane në këtë fushë, kanë shërbyer si një nxitje e fuqishme për të ndërmarrë hapat e duhur në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe një vizioni afatgjatë të qasjeve rregullatore. Neni 103 i MSA mbulon bashkëpunimin në fushën e shoqërisë së informacionit. Neni 104 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mbulon bashkëpunimin që fokusohet në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Pjesa kryesore e *acquis* në fushën e komunikimeve elektronike përbëhet nga Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike, Direktiva 2018/1972/BE e miratuar në dhjetor 2018, e cila ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Kodi përfshin masa për nxitjen e investimeve në rrjetet e kapaciteteve shumë të larta, rregulla të reja për spektrin e frekuencave dhe rrjetet celulare 5G, ndryshime në regjimin e shërbimit universal, rregulla për mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin dhe komunikimet e emergjencave. Përveç Rregullores së re të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme, që hyri në fuqi në maj 2018, rregullat e e-privatësisë në komunikimet elektronike janë duke ndryshuar<sup>64</sup>. Pjesë e rëndësishme legjislative është gjithashtu Direktiva për sigurinë e sistemeve të rrjetit dhe informacionit. Komisioni Evropian ka miratuar një numër *acquis* të reja që lidhen me zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike broadband, 5G dhe politikat spektrale.

Në fushën e politikës audiovizuale, pjesa kryesore legjislative është Direktiva 2010/13/BE për shërbimet audiovizive, që mbulon transmetimet televizive tradicionale dhe shërbimet mediatike audio-vizuale në kërkesë dhe vendos një sërë rregullash minimale për të dy llojet e shërbimeve. Më datë 14 nëntor 2018, Këshilli i BE-së ka miratuar ndryshimet në Direktivën 2010/13/BE me Direktivën 2018/1808/BE mbi koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore

<sup>64</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52017PC0010>

ose veprime administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive), në funksion të ndryshimit të realiteteve të tregut. Këto ndryshime përfshijnë disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të minorenëve; rregulla të reja për platformat e shpërndarjes së videove, promovimin e punëve evropiane etj.

Bashkimi Evropian ka miratuar një numër aktesh ligjore të reja që lidhen me zhvillimet digjitale dhe transformimin digjital si dy direktivat e fundit Akti i Tregut Digjital, Akti i Shërbimeve Digjitale, rregulla për inteligjencën artificiale, etj.

Në lidhje me fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias, janë në proces miratimi akte ligjore të reja, të cilat bazohen në zhvillimet e fundit të ekonomisë digjitale.

#### 10.4 Situata aktuale në Shqipëri

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim në Bashkimin Evropian në fushën e transformimit digjital dhe medias. Legjislacioni shqiptar në fuqi për komunikimet elektronike, shoqërinë e informacionit, dhe median audiovizive, i zhvilluar nga viti 2008 e në vijim, është bazuar në *acquis* të BE-së për këtë kapitull. Në përmbushje të angazhimeve të MSA-së, që rrjedhin nga nenet 102, 103 dhe 104 të saj, është punuar për planifikimin dhe implementimin e politikave në fushën e telekomunikacioneve dhe shoqërisë së informacionit.

Në fushën e komunikimeve elektronike, Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është ligji bazë për rregullimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike, dhe përcaktimin e rregullimeve specifike për shërbimet dhe rrjetet e telekomunikacionit në përputhje me *acquis* të BE-së. Ky ligj në momentin e miratimit transpozoi paketën e direktivave të BE-së për komunikimet elektronike të vitit 2002 (e cila është tashmë e shfuqizuar), të amenduara në vitin 2009, si më poshtë:

- Direktivën 2002/19/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për aksesin dhe interkoneksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të faciliteteve që lidhen me to (Direktiva e Aksesit);
- Direktivën 2002/20/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (Direktiva e Autorizimit); (tashmë e shfuqizuar);
- Direktivën 2002/21/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kuadër); (tashmë e shfuqizuar);
- Direktivën 2002/22/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesit lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal);(tashmë e shfuqizuar);

- Direktivën 2002/58/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 korrik 2002, për trajtimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva për privatësinë dhe komunikimet elektronike);
- Direktivën e Komisionit 2002/77/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 16 shtator 2002, për konkurrencën në tregje për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;
- Direktivën 2009/136/KE dhe 2009/140/KE që kanë amenduar respektivisht direktivat e vitit 2002 (Direktivën 2002/19/KE, Direktivën 2002/20/KE, Direktivën 2002/21/KE, Direktivën 2002/22/KE dhe Direktivën 2002/58/KE).

Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, është një tjetër ligj i rëndësishëm për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, i cili ka transpozuar Direktivën 2014/61/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15.5.2014 mbi masat për reduktimin e kostos së vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

Legjislacioni kombëtar në fushën e komunikimeve elektronike, përfshin dhe një numër aktesh nënligjore, vendime të Këshillit të Ministrave dhe rregullore të miratuara nga AKEP, për rregullime specifike të lidhura me sektorin e komunikimeve elektronike/telekomunikacionet dhe që janë në harmoni e të mbështetura në *acquis* dhe praktikën e BE-së për këtë fushë sikurse:

- VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit” që ka transpozuar Vendimin Nr. 243/2012/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 mars 2012 që përcakton programin shumëvjeçar të politikës së spektrit radio;
- VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” që bazohet në Planin Evropian të Alokimeve (ECA 2020);
- Udhëzimi i Ministrit nr. 7 datë 22.10.2019, “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të menaxhimit të trafikut të komunikimeve si dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve”, që ka transpozuar pjesërisht Rregulloren (BE) 2015/2120 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 25 nëntor 2015, që përcakton masat në lidhje me një akses të lirë të internetit dhe që ndryshon Direktivën 2002/22/KE të shërbimit universal dhe të të drejtave të përdoruesve në fushën e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik, si dhe Rregulloren (BE) nr. 531/2012 në lidhje me shërbimin roaming në rrjetet publike të komunikimeve mobile brenda Bashkimit Evropian (tashmë e shfuqizuar);
- Plani i Përdorimit të Frekuencave, miratuar nga AKEP në harmoni me praktikën evropiane dhe përdorimet në CEPT;
- Rregullore e AKEP nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e Autorizimit të Përgjithshëm” në përputhje me Direktivën 2002/20/KE dhe Direktivën 2002/21/KE, të cilat janë tashmë të shfuqizuara;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, plotësisht në përputhje me Direktivën 2009/114/KE; Direktivën 2005/82/KE dhe Vendimin 676/2002/KE;



- Rregullorja e AKEP-it Nr. 30, datë 5.12.2013, “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”;
- Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP-it nr. 932, datë 11.08.2009 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Numeracionit”, i ndryshuar;
- Rregullorja e AKEP-it Nr. 10, datë 11. 08. 2009 “Për përcaktimin e numrave dhe serive numerike”, e ndryshuar;
- Rregullore nr. 33 datë 15.05.2014 “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza”;
- Rregullore nr. 43 datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” e ndryshuar;
- Rregullore nr. 35, datë 10.09.2015 “Rregullat për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”;
- Rregullore nr. 37, datë 19.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
- Rregullorja nr. 16, datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”;
- Rregullorja nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, ndryshuar me Vendim të Bordit Drejtues nr. 2342, datë 31.07.2013, në përputhje me Rekomandimin 2007/879/KE dhe udhëzimet e Komisionit mbi analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së rëndësishme të tregut në kuadrin rregullator të Komunitetit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, (2002/C 165/03);
- Rregullore nr. 32, datë 26.12.2013, “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT)”, plotësisht në përputhje me Rekomandimin 2005/698/KE dhe Rekomandimin 2009/396/KE;
- Rregullore nr. 19, datë 14.06.2010, “Për aksesin dhe interkoneksionin;
- Rregullore “Për zbatimin e FUP dhe qëndrueshmërinë e RLAH me Ballkanin Perëndimor”, miratuar me Vendimin e KD të AKEP nr. 9 datë 9.6.2021;
- Rregullore nr. 49 datë 11.3.2021 “për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike etj.

Një listë e plotë e rregulloreve të miratuara nga AKEP, në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, jepet në linkun më poshtë: <https://akep.al/vendime-akte/komunikimet-elektronike/>;

Në fushën e komunikimeve elektronike, me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 434, datë 3.6.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020 – 2025”, është miratuar Plani i ri Kombëtar Broadband.

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe plani i veprimt” është miratuar dokumenti i politikës spektrale i cili ka bërë transpozimin e Vendimit të BE-së 243/2012/BE për miratimin e një programi shumëvjeçar për spektrin radio.

Gjatë vitit 2018 u amendua ligji për komunikimet elektronike për t'i hapur rrugë rregullimit të tarifave të roaming-ut nga AKEP mbi bazën e marrëveshjeve bilaterale, multilaterale. Më datë 1 korrik 2021, u realizua zbatimi i plotë “roaming si në shtëpi” (RLAH) për vendet e Ballkanit Perëndimor. Tashmë në vendet e rajonit funksionon “roaming si në shtëpi”, bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian për RLAH.

Me vendimin e politikës spektrale të miratuar me VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe plani i veprimit”, është përcaktuar afati për lirim e Digjital Divident 2, më 30 qershor 2022, sipas afatit maksimal në BE.

Në fushën e shoqërisë së informacionit, kuadri ekzistues ligjor përfshin:

- Ligjin nr. 10128 datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike” i ndryshuar, i cili ka transpozuar Direktivën 2000/31/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 8 qershor 2000 për disa aspekte juridike të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, sidomos të tregtisë elektronike, në Tregun e Brendshëm (Direktiva për Tregtinë Elektronike);
- Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik” ndryshuar me Akt Normativ nr. 8, datë 30.9.2009 “Për nënshkrimin elektronik”, i cili ka transpozuar Direktivën 1999/93/KE, e cila është tashmë e shfuqizuar nga Rregullorja (BE) Nr. 910/2014;
- Ligjin Nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike” që ka transpozuar Rregulloren e (BE) nr. 910/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 23 korrik 2014 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm;
- Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike ka transpozuar pjesërisht Direktivën nr. 2016/1148/BE të datës 6 korrik 2016, mbi masat për një nivel të përbashkët të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në BE;
- Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i cili transponon direktivën 2001/29/KE për të drejtën e autorit në shoqërinë e informacionit, Direktivën 93/83/KEE për të drejtat e autorit në transmetimet radio-televizive, etj.

Në fushën e shoqërisë së informacionit janë të miratuara disa akte ligjore e nënligjore të lidhura me e-qeverisjen, shërbimet publike elektronike, etj. Një pjesë e tyre si: Ligji për dokumentin elektronik, Ligji për databazat shtetërore, Ligji për konsultimin publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave për politikën për të dhënat e hapura, etj., nuk transpozojnë ndonjë *acquis* të veçantë të BE-së, por janë të mbështetura në praktika të vendeve evropiane për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.

Kuadri i interoperabilitetit i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është në përputhje me kuadrin evropian të interoperabilitetit. Është miratuar VKM nr. 1147, datë 9.12.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Portali unik qeveritar e-albania” dhe për miratimin e rregullave “Për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit”, e cila përcakton kërkesat e nevojshme funksionale, teknike dhe ligjore të pikës së vetme të kontaktit për shërbime elektronike në Republikën e Shqipërisë (e-albania) si porta e vetme digjitale për t'u lehtësuar

ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve aksesin në informacion, procedura elektronike dhe asistencë efektive në përfitimin e shërbimeve.

VKM Nr. 553, datë 15.07.2020, “Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit” është e mbështetur në praktikën e BE-së.

Në fushën e shoqërisë së informacionit, ka progres në digjitalizimin dhe zhvillimin e shërbimeve elektronike. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit është fuqizuar. Zbatimi i agjendës digjitale të Shqipërisë dhe planit kombëtar për zhvillimin e broadband vazhdon. Shërbimet elektronike të ofruara institucioneve publike dhe qytetarëve janë rritur.

Mbi bazën e praktikës së BE-së, është hartuar draft Strategjia për 5G për Shqipërinë dhe është në proces rishikimi.

Në fushën e medias audiovizive kuadri ligjor ekzistues përbëhet së pari nga Ligji nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar i cili ka transpozuar Direktivën 2010/13/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 10 mars 2010, për bashkërendimin e dispozitave të caktuara të përcaktuara me ligj, akt normativ apo vendim administrativ në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve të medias audiovizive (Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive).

Një numër rregulloresh janë miratuar nga AMA në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Është finalizuar procesi i switchover-it dhe kalimit të plotë në transmetime numerike, në dhjetor 2020. Aktualisht, transmetimet televizive digjitale janë të aksesueshme në të gjithë territorin dhe sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër të madh të programeve televizive pa pagesë. Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë punuar për transpozimin e Direktivës 2018/1808/EU “mbi koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose veprime administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive), në funksion të ndryshimit të realiteteve të tregut”. Këto ndryshime përfshijnë disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të minoreneve; rritje të transparencës për pronësinë e ofruesve të shërbimeve mediatike etj. Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në projektligjin e medias audiovizive nr. 97/2013 ka kaluar në proceset e konsultimit.

Gjatë vitit 2022, u miratua nga Kuvendi ligji nr. 33/2022 “Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili bën transpozimin e pjesshëm të Direktivës (BE) 2019/1024 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 20 qershorit 2019 mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Nga data 1 maj 2022, 95% e shërbimeve publike kanë kaluar online, ndërsa sportelet janë mbyllur.

Gjatë vitit 2022, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me AKEP ka punuar për transpozimin e direktivës së re Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike, direktiva 2018/1972/EU, e miratuar në dhjetor 2018, e cila ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Projektligji për komunikimet elektronike që bazohet gjerësisht në Direktivën 2018/1972/EU është në proces të konsultimit publik.

Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026 dhe Plani i Veprimit të saj janë miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 370, më 1 qershor 2022.

Kuadri institucional në kapitullin 10 përfshin:

- institucionet përgjegjëse për politikën dhe rregullimin e sektorit të komunikimeve elektronike/telekomunikacionit: Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë (MIE) dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- institucionet për fushën e shoqërisë së informacionit: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP për zhvillimin e rrjeteve broadband, si dhe institucione të tjera kontribuuese në aspekte të ndryshme si për tregtinë elektronike, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për aksesin e kushtëzuar, AMA-n, Ministrinë e Kulturës për të drejtën e autorit në shoqërinë e informacionit etj.;
- Autoritetin e Medias Audiovizive (AMA), si organi rregullator në fushën e medias audiovizive në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKEP në çështjet e lidhura me planin kombëtar të frekuencave për rrjetet e komunikimeve elektronike për transmetimet audiovizive, etj.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian, i ngarkuar me Kapitullin 10 (Shoqëria e Informacionit dhe Media), bashkëkryesohet nga Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë (MIE), si institucioni përgjegjës për politikën në sektorin e telekomunikacionit/komunikimeve elektronike, me të cilat lidhet një pjesë e madhe e *acquis* të këtij kapitulli, dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Në këtë kapitull janë kontribues të rëndësishëm në seksionet respektive organet rregullatore Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për rregullimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA), për rregullimin e medias audiovizive. Në seksionin e shoqërisë së informacionit, kontributi kryesor vjen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për zhvillimin e shërbimeve elektronike publike, dhe nga AKCESK në zbatim të legjislationit përkatës për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe sigurinë kibernetike. Në lidhje me fushën e politikës audiovizuale dhe zbatimin e ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, roli kryesor është tek Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA).

## 10.5 Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse

Institucionet koordinuese për kapitullin 10 janë Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE) dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI).

Institucione të tjera kontribuese janë:

- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA);
- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK);
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Instituti i Statistikave;
- Radio Televizioni Shqiptar;
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Kulturës;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit/AKKSHI;
- Kuvendi i Shqipërisë.

## 10.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Kapitulli 10 “Shoqëria e informacionit dhe media” përmban një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore si direktiva, vendime, rregullore si dhe soft law si komunikata, rekomandime etj.

Rregullimet kryesore për komunikimet elektronike të miratuara me kuadrin ligjor ekzistues janë të mbështetura në paketën e direktivave të vitit 2002 dhe 2009 për komunikimet elektronike (Direktiva 2002/19/KE) për aksesin dhe interkoneksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të faciliteteve që lidhen me to, Direktiva 2002/20/KE për autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, Direktiva 2002/21/KE për kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, Direktiva 2002/22/KE për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesit lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, të ndryshuara në vitin 2009, të cilat janë zëvendësuar nga Direktiva 2018/1972/BE, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike (EECC).

Lista e *acquis* për komunikimet elektronike përfshin një numër të madh vendimesh të BE-së (mbi 70), që lidhen me përdorimin e spektrit të frekuencave në breza dhe nënbreza të caktuar. Aktualisht rregullimet për spektrin e frekuencave përfshijnë dispozitat e ligjit për komunikimet elektronike për frekuencat, Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, si dhe dokumentin e politikës spektrale, të cilat janë në harmoni me praktikën dhe *acquis* të BE-së, por nuk ka akte të veçanta për transpozimin e vendimeve specifike për frekuencat. Është e nevojshme që të analizohen të gjitha vendimet e BE-së për spektrin e frekuencave, sipas listës së LGA-së dhe të shikohet mënyra më e mirë e transpozimit të tyre në kuadrin ligjor kombëtar.

Lista e *acquis*, për kapitullin 10, përmban edhe një numër të madh aktesh të reja të adoptuara nga BE, ose në proces dhe që lidhen me ndryshimet teknologjike. Gjithashtu një pjesë e *acquis* janë në një proces dinamik përditësimi periodik, sikurse *acquis* për komunikimet elektronike, vendimet për spektrit e frekuencave, direktiva për median audiovizive etj. Për një pjesë të *acquis* të re në këtë kapitull që lidhen me zhvillimet digjitale, si platformat digjitale, inteligjenca artificiale, etj. për shkak të ndërthurjes që ato kanë me disa sektorë, institucione, është e nevojshme një analizë e detajuar.

Prioritetet normative afatshkurtra dhe afatmesme përfshijnë adresimin e rekomandimeve të BE-së për përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së të Kapitullit 10, në përputhje me zhvillimet e *acquis* të BE-së dhe Agjendën Digjitale.

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian në raportin për Shqipërinë 2022, prioritetet e Kapitullit 10 synojnë si më poshtë vijon:

- të përfundojë shtrirjen e numrit të urgjencës 112 në 12 rajone të tjera;
- të miratojë legjislacionin përkatës në përputhje me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike;
- të përmirësojë mbledhjen e të dhënave statistikore mbi performancën dhe konkurrencën digjitale.

## KAPITULLI 16: TATIMET

### 16.1 Përmbajtja e kapitullit

Rregullat e BE-së për tatimet mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe Akcizën si dhe aspekte të tatimit të korporatave. Gjithashtu, këto rregulla disiplinojnë bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për parandalimin e evazionit fiskal.

### 16.2 Struktura e kapitullit

1. Tatimi i tërthortë: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe detyrimet e akcizës
2. Tatimi i drejtpërdrejtë
3. Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë

### 16.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Neni 98 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon se Shqipëria dhe BE-ja do të vendosin bashkëpunimin në fushën e tatimeve. Ky bashkëpunim përfshin masat që synojnë forcimin e

reformave të mëtejshme në sistemin fiskal dhe në ristrukturimin e administratës tatimore me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal. Për më tepër, ky bashkëpunim duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme tatimore. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe BE-ja e njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë mospagimin e tatimeve ose evazionin tatimor. Gjithashtu, ky nen kërkon konsultime ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të BE-së, me qëllim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve midis tyre, dhe për të siguruar një nivel të drejtë dhe të ndershëm për sa i përket tatimit të biznesit.

*Acquis* në fushën e tatimeve mbulon gjerësisht fushën e tatimeve indirekte, që përfshin Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe detyrimet e akcizës. Ai përcakton fushën e zbatimit, përkufizimet dhe parimet e TVSH-së. Detyrimet e akcizës mbi produktet e duhanit, pijet alkoolike dhe produktet energjike janë gjithashtu objekt i legjislacionit të Bashkimit Evropian. Për sa i përket tatimeve direkte, *acquis* mbulon aspekte të tatimit mbi të ardhurat personale dhe tatimet e korporatave.

*Acquis* në fushën e tatimeve direkte ka të bëjë me aspekte të caktuara të tatimeve mbi të ardhurat, dhe shmangies së taksimit të dyfishtë. Fokusi është në eliminimin e parregullsive për aktivitetet ekonomike ndërkufitare ndërmjet ndërmarrjeve brenda Bashkimit Evropian. Kodi i Sjelljes për Taksimin e Biznesit përfaqëson një angazhim politik nga Shtetet Anëtare për të trajtuar konkurrencën e dëmshme tatimore. Shtetet Anëtare janë të detyruara të mos vendosin masa të reja të dëmshme tatimore, apo të rikthejnë masa të tilla.

Legjislacioni i BE-së në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë midis autoriteteve tatimore të Shteteve Anëtare siguron mjetet për të shkëmbyer informacione me qëllim parandalimin e evazionit fiskal, dhe shmangien e taksave dhe ndihmën e tyre në zbatimin e legjislacionit tatimor. Informacione të caktuara lidhur me tatimet dhe doganat shkëmbehen automatikisht, informacione të tjera shkëmbehen në mënyrë spontane ose pas një kërkesë.

*Acquis* në fushën e kapaciteteve operationale dhe kompjuterizimit mbulon fusha të ndryshme të taksimit. *Acquis* për Sistemin e Shkëmbimit të Informacionit mbi Tatimin e Vlerës së Shtuar (VIES) parashikon shkëmbimin e drejtpërdrejtë elektronik të të dhënave ndërmjet administratave kombëtare që mbulojnë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Kjo lejon që administratat kombëtare të monitorojnë dhe kontrollojnë tregtinë brenda BE-së dhe të zbulojnë parregullsi të mundshme. Lidhur me akcizat, *acquis* kërkon që sistemet e IT-së t'u lejojnë Shteteve Anëtare të shkëmbejnë informacion mbi prodhuesit dhe tregtarët e produkteve të akcizës. Sisteme të tilla janë Regjistri Evropian i operatorëve (Sistemi për Shkëmbimin e të Dhënave të Akcizave - SEED) dhe sistemi për monitorimin e Shërbimeve Qendrore / Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Akcizat (CS/MISE). Lëvizjet e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit mbikëqyren brenda BE-së nëpërmjet Sistemit Elektronik të Lëvizjes dhe Kontrollit të Akcizës (EMCS). Në fushën e tatimit direkt, Shtetet Anëtare duhet të vendosin një sistem të shkëmbimit automatik të informacionit për pesë kategori të të ardhurave dhe kapitalit: të ardhurat nga punësimi, tarifet e drejtorëve, pensionet,

produktet e sigurimit të jetës dhe të ardhurat nga investimet kapitale dhe pasuritë e paluajtshme (dividentë, fitime kapitale, të ardhura të tjera të gjeneruara në lidhje me aktivet e mbajtura në një llogari financiare, çdo shumë në lidhje me faktin nëse një institucion financiar është obliguesi apo debitori, duke përfshirë pagesat e riblerjes, balancat e llogarisë) përmes formave të kompjuterizuara standarde.

#### 16.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e taksimit. **Përparim** është arritur, duke përfshirë në veçanti përafrimin e ndjeshëm me Direktivën e bashkimit, ndarjes së shoqërive, shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare dhe respektimin e planeve të pagesave të dakordësuara për rimbursimet e TVSH-së dhe zvogëlimin e stokut të detyrimeve të prapambetura në rimbursimet e TVSH-së

Për **tatimet indirekte**, norma standarde e TVSH-së është 20% dhe normat e reduktuara janë 6% dhe 10%. Në vitin 2021, është kufizuar përjashtimi nga TVSH-ja në importimin e makinerive dhe pajisjeve për realizimin e kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (afërsisht 4.2 milionë euro). Lehtësimi i kriterëve të riskut në prill 2020 dhe procedurat e thjeshtuara rezultuan në pagesa më të shpejta të rimbursimit të TVSH-së. Që nga prilli 2020, publikohet rregullisht stoku tremujor i rimbursimit të TVSH-së. Në dhjetor 2021, stoku i rimbursimeve të papaguara u eliminua plotësisht. Nga janari 2022, Administrata Tatimore rimbursion çdo muaj kërkesat korrente të tatimpaguesve.

Që nga janari 2021, në përgjigje të ndikimit të COVID-19, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është qarkullimi vjetor prej 10 milionë lekë (85 470 euro), ndërkohë që personat e tatueshëm me qarkullim vjetor më të madh se 5 milionë lekë (47 735 euro) mund të zgjedhin nëse duan të zbatojnë regjimin normal të TVSH-së.

Me Ligjin nr. 111/2021, datë 25.11.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë miratuar një sërë ndryshimesh në funksion të zgjerimit të bazës dhe reduktimit të përjashtimeve: është miratuar trajtimi nga furnizime të përjashtuara, në furnizime të tatueshme me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 10% për furnizimin e inputeve bujqësore; u rrit kufiri i vlerës së kontratave të investimeve nga 50 milionë lekë në 500 milionë lekë, në funksion të realizimit të të cilave importohen makineri dhe pajisje të përjashtuara nga TVSH-ja; u reduktua nga 6 % në 0% norma e kompensimit të prodhuesit bujqësorë.

Me Ligjin nr. 82/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me efekt nga 1 janari 2023, është miratuar trajtimi si furnizim i përngjashëm me eksportet për furnizimin e mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës



së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për pagimin e tatimeve indirekte në Shqipëri. Gjithashtu, mallrat e furnizuara në kuadër të realizimit të këtyre projekteve janë të përjashtuara nga TVSH-ja në import.

Është parashikuar skemë të veçantë për Bursën Shqiptare për tregtimin e Energjisë, duke përjashtuar nga TVSH-ja në import apo furnizimi brenda vendit i energjisë elektrike të destinuar për t'u shitur nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë, si dhe kalimin e përgjegjësisë për pagesën e TVSH-së, personit të tatueshëm për të cilin kryhet furnizimi me energji elektrike nëpërmjet mekanizmit të revers charge (auto ngarkesës).

Taksimi i akcizës është pjesërisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së. Nuk janë në përputhje me *acquis* vetëm disa artikuj si: energjia elektrike, kafe, fishekzjarrë, goma automjeteve dhe biokarburante. Ligji i akcizës takson të gjitha produktet energjetike të listuara në Direktivën 2003/96/KE përveç energjisë elektrike.

Që nga korriku 2022, niveli i akcizës për gazin e lëngshëm është i unifikuar, pavarësisht nga qëllimi i përdorimit të tij. Në nëntor 2021 është miratuar një kalendar i ri për të gjitha kategoritë e “Duhan dhe nënprodukteve të tij”, i cili parashikon një rritje prej 15% gjatë katër viteve, përafërsisht 65 euro për 1000 cigare, deri në vitin 2026, duke u përafëruar gradualisht me minimumin e BE-së. Për duhanin e përpunuar me gjethe duhani të kultivuar në Shqipëri, përkohësisht aplikohet një akcizë e diferencuar dhe më të ulët krahasuar me importin. Qëllimi i kësaj mase të përkohshme është nxitja e zbatimit vullnetar dhe pagimi i akcizës nga prodhuesit vendas dhe reduktimi i informalitetit, ndërkohë që ky diferencim akcize nuk ka ndikuar në volumin e importeve të këtij produkti, volume të cilat nuk janë ulur si rezultat i këtij diferencimi, përkundrazi.

Me Ligjin nr. 114/2021, datë 25.11.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë shtuar kategoritë shisha, nargjile dhe nikotinë (produkte duhani për përdorim oral), qymyri, linjiti, koks dhe gjysëm koks, gaz qymyri, gaz uji dhe gaz prodhimi, si dhe katran i distiluar nga qymyri, ndërkohë që është hequr kategoria goma të përdorura. Me ndryshimet e bëra është vendosur edhe unifikimi i akcizës për “Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike”, me nivel akcize 6 lekë/litër, i cili ka hyrë në fuqi në 1 korrik 2022. Gjithashtu, është vendosur indeksimi i nivelit të akcizës çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit të shpallur nga INSTAT, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij. Me anë të këtij ligji, prej datës 1 janar 2024, është hequr rimbursimi i akcizës së lëndëve djegëse për industrinë, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto.

Me Ligjin Nr. 98/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili është në fuqi që nga 1 janar 2019 është vendosur për herë të parë si produkt akcize duhani me ngrohje. Për duhan me ngrohje, produkte duhani të riformuar dhe me substanca të tjera, që konsumohen nga një proces ngrohje nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohje duhani, niveli i taksimit është 7250 lekë/kg.

Me Ligjin nr. 81/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar i cili është në fuqi që nga 1 janar 2023 është vendosur unifikimi i akcizës për birrën (prodhues vendas e të huaj), pavarësisht sasisë së prodhimit, nga 360 leke/HL, në 710 leke/HL/shkalle alkoolometrike, me qëllim eliminimin e diferencimit të akcizës.

Ndryshimi i akcizës së këtij artikulli konsiston në unifikimin e tarifës së akcizës për birrën e bërë nga malto nga prodhues vendas e të huaj, ligjërisht dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogël dhe më të mëdha se 200 000 HL në vit. Gjithashtu pijet e forta alkoolike (Spirituous Beverages), janë pjesë integrale e heqjes së diferencimit në tarifën e akcizës.

### *Rimbursimi TVSH*

Administrata tatimore ka përmirësuar ndjeshëm procedurat dhe afatet e rimbursimit të TVSH-së, rezultat ky edhe i automatizimit të procedurave.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, janë rimbursuar në total 22,469 milion lekë, rreth 6.8% më pak se në 2021 (nga 24,101 milion lekë në rimbursuar në 2021) dhe rreth 21.4% më shumë se planifikimi për vitin 2022 (18,500 milion lekë).

Të gjitha kërkesat e miratuara për periudhën janar – dhjetor 2022 janë rimbursuar në kohë, duke bërë që mos të ketë stok të kërkesave në fund të vitit 2022.

Shqipëria i është bashkuar Kornizës Gjithëpërfshirëse të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) mbi Erozionin e Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimit (BEPS) në gusht të vitit 2019. Në këtë kuadër Konventa Shumëpalëshe (MLI), për zbatimin e masave që lidhen me Marrëveshjet për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë për parandalimin e Erozionit të Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimit (BEPS), u miratua në parlament me Ligjin Nr. 93 datë 16.07.2020 dhe u dorëzua instrumenti i ratifikimit pranë OECD-së. Kjo Konventë ka hyrë në fuqi në datën 1.01.2021.

Nga janari 2022, ligji për tatimin mbi të ardhurat, parashikon ndryshime në normat tatimore për të ardhurat nga punësimi. Kështu, të ardhurat mujore nga punësimi nga 0-40 000 lekë nuk taten (niveli me pare ka qenë nga 0-30 000 lekë).

Të ardhurat mujore nga punësimi nga 40 001 deri në 50 000 taten me 0 % për të ardhurat nga 0-30 000; dhe 50 % \* 13 % të shumës mbi 30 000 lekë (norma për këtë kategori ka qenë 13 % më parë).

Të ardhurat mujore nga punësimi nga 50 001 e lart taten me 13% të shumës mbi 30 000 për të ardhurat nga 30 001 lekë deri në 200 000 lekë; dhe 23% të shumës për të ardhurat mbi 200 000 (norma 13% që ka qenë për të ardhurat nga 30 000 deri në 150 000 lekë dhe 23% për të ardhurat mbi 150 000 lekë).

Në lidhje me **bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën reciproke**, në janar 2020, u miratua Ligji për shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare, duke synuar përafrimin me Standardet e Raportimit të Konformitetit dhe përafrimin e pjesshëm me Direktivën përkatëse të BE-së të vitit 2014. Aktualisht ka filluar dhe është në vazhdimësi të kryhet çdo vit shkëmbimi automatik i informacionit për llogarite financiare.

Gjatë vitit 2022, u nënshkrua marrëveshja me Finlandën, dhe është miratuar në parim marrëveshja me Sllovakinë.

Është miratuar Ligji Nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” me objekt zbatimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në llogaritë financiare për qëllime tatimore, sipas standardeve të përbashkëta të raportimit. Përpara shkëmbimit të parë të informacionit, u hartua dhe miratua akti nënligjor (Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 613, datë 29.7.2020 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”) dhe u ngrit infrastruktura e nevojshme, përfshirë sistemin e IT-së së DPT-së për zbatimin e këtij angazhimi.

Administrata Tatimore Shqiptare ka nisur nga shtatori i vitit 2021 shkëmbime AEOI në mënyrë reciproke dhe po vijon këtë proces sipas standardeve ndërkombëtare. Në vitin 2022 Shqipëria i dërgoi informacion 77 shteteve (nga të cilat 24 shtete anëtare të BE), dhe mori informacion nga 65 shtete (nga të cilat 21 shtete anëtare të BE).

Për sa i përket **kapacitetit operacional dhe kompjuterizimit**, 1040 punonjës të DPT-së përfituan trajnime online në vitin 2022, sipas programit vjetor të trajnimit, i cili është i bazuar në nevoja.

Gjatë vitit 2022 janë punësuar gjithsej 105 punonjës/nëpunës, nga të cilët 47 nëpunës janë emëruar në pozicione pune me status nëpunësi civil, sipas procedurave të DAP, 2 nëpunës civilë janë emëruar në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe 58 punonjës të emëruar në pozicione që trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Gjatë këtij viti, Për vitin 2022 ka patur 6 (gjashtë) masa disiplinore të dhënë për shkelje të rregullave të etikës.

## **Procesi i fiskalizimit**

Zbatimi i Ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar i quajtur ndryshe “Projekti i Fiskalizimit” ka vijuar normalisht. Nëpërmjet procesit të fiskalizimit synohet ulje e informalitetit, duke përmirësuar dy aspekte kryesore: raportimi i më shumë transaksioneve me para në dorë dhe ulja e transaksioneve të fshehura pa para në dorë. Me anë të një kontroll më të mirë të sistemit fiskal pritet një reduktim i informalitetit në ekonomi. Të dhënat nga fiskalizimi po përdoren për të evidentuar tatimpagues që kalojnë pragun për regjistrim në përgjegjësi të reja tatimore si dhe nga DRT-të (Drejtoritë Rajonale Tatimore) përkatëse po analizohen tatimpaguesit që kanë mospërputhje ndërmjet të dhënave nga fiskalizimi lidhur me qarkullimin me të dhënat nga deklaratat tatimore.

Të dhënat në dispozicion janë deri më datë 31.12.2022 si vijon:

- 99,695 tatimpagues aktivë të fiskalizuar plotësisht që lëshojnë fatura të fiskalizuara. 785 milionë fatura të fiskalizuara që prej datës 1 Janar 2022.
- 102,810 tatimpagues të pajisur me certifikatën e fiskalizimit.
- 100% e Biznesit të Madh (BM) dhe Biznesit të vogël me TVSH (BV me TVSH) aktiv dhe që ushtron aktivitet është fiskalizuar
- 93% e Biznesit të Vogël (BV) aktiv dhe që ushtron aktivitet është fiskalizuar.
- Mbeten në proces verifikimi edhe 6,114 tatimpagues. Janë penalizuar 322 tatimpagues për mosinstalim të sistemit të fiskalizimit. Nga këto 131 BM, 53 BV me TVSH dhe 138 BV.

#### 16.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale (Institucioni lider);
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjet tatimore, duke administruar taksat dhe tarifatat kombëtare, të përcaktuara me ligjet përkatëse. Qëllimi kryesor i DPT-së është të ndihmojë tatimpaguesit që të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e aplikueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto taksa të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke u ofruar tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) është institucioni kryesor doganor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjin për Akcizat në R.SH, duke administruar detyrimet e akcizës në prodhimin e brendshëm dhe në import.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë dhe Bashkitë janë institucionet përgjegjëse për implementimin e reformës së taksës së pasurisë së paluajtshme.

#### 16.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Për **tatimet indirekte**, taksimi i akcizës është pjesërisht i harmonizuar me *acquis* e BE-së. Akciza e diferencuar për duhanin e përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri vazhdon.

Për **tatimet direkte**, ligji i ri për tatimin mbi të ardhurat është planifikuar të prezantohet në vitin 2023 dhe të futet në fuqi në vitin 2024. Ky ligj do të trajtojë çështje që lidhen me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin duke synuar zgjerimin e bazës së tatimit dhe reduktimin gradual të incentivave tatimore dhe përjashtimeve, duke e harmonizuar me ndryshimet ekonomike të ndodhura gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, synohet harmonizimi i mëtejshëm i direktivave në fushën e tatimeve direkte. Ky ligj njëkohësisht përaftron pjesërisht Direktivën ATAD (EU) 2016/1164. Negocimi i Marrëveshjeve të Tatimit të dyfishtë, veçanërisht me shtetet e BE-së, është një tjetër prioritet në këtë fushë.

Për **bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën reciproke**, Shqipëria ende nuk ka nënshkruar marrëveshje për taksimin e dyfishtë me Danimarkën, Qipron, Lituaninë, Portugalinë.

Shqipëria ka miratuar në parim me VKM nr. 560, datë 29.12.2021, “Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Finlandës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë për Tatimet mbi të Ardhurat dhe Parandalimi dhe Shmangia e Evazionit Tatimor”. Pas miratimit marrëveshja u nënshkrua dhe është në procedurë të miratimit në parlament.

Këshilli i Ministrave miratoi në parim VKM nr. 294, datë 11.05.2022, “Për miratimin në parim të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për Eliminimin e Tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit fiskal”. Pas miratimit do të vijojnë procedurat për nënshkrimin e saj dhe më pas për ratifikimin e marrëveshjes.

Për sa i përket **kapacitetit operacional dhe kompjuterizimit**. Administrata Tatimore ka ende nevojë për kapacitete teknike për të lehtësuar shkëmbimin efikas të informacionit. Sistemi elektronik i administratës tatimore ka funksionuar nga janari 2015, por nevojiten të ndërlihen dhe ndërveprojnë me sistemet e BE-së.

Lidhur me politikat tatimore, prioritet mbetet përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si edhe përmirësimi i administrimit të tatimeve në rritjen e bazës së tatueshme. Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet:

- Harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit tatimor me *acquis* e BE-së;
- Krijimit të klimës së favorshme të biznesit për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja;
- Formulimit të politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë;
- Përmirësimit të menaxhimit të administratës tatimore për realizimin e të ardhurave, duke u bazuar në profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, si dhe standarde, të cilat krijojnë besueshmëri tek qytetarët, partnerët ndërkombëtarë dhe komuniteti i biznesit vendas dhe të huaj.

Në vitin 2022 ka filluar zbatimi i elementëve të parashikuar në Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) 2022 – 2026, e hartuar me asistencën teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku prezantohen reformat në fushën e politikave tatimore dhe administrimit tatimor dhe doganor që parashikohen të ndërmerren gjatë kësaj periudhë pesë vjeçare, me synim përmirësimin e politikave fiskale, rritjen e të ardhurave tatimore dhe efektivitetit të administratës tatimore dhe doganore në mbledhjen e tyre. Në vitin 2022 dhe 2023 janë miratuar ndryshimet në ligjin e akcizave dhe në vitet 2024 e në vijim ndryshimet në tatimet mbi të ardhurat dhe në 2025 e më tej ndryshimet në tatimin mbi vlerën e shtuar.

## KAPITULLI 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

### 17.1 Përmbajtja e kapitullit

*Acquis*-i në fushën e politikës ekonomike dhe monetare rregullohet nga Titulli VIII (nenet 119 deri 144) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), dhe nga legjislacioni përkatës zbatues. Dispozitat e Traktatit që lidhen me miratimin e euros nuk zbatohen për Shtetet Anëtare me një përjashtim të përkohshëm siç përcaktohet në Nenin 139 të TFEU.

Legjislacioni përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në Shtetet Anëtare, duke ndaluar financimin e drejtpërdrejtë të sektorit publik nga bankat qendrore dhe duke ndaluar qasjen e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet Anëtare i konsiderojnë politikat e tyre ekonomike si një çështje me interes të përbashkët dhe i nënshtrohen një mbikëqyrje më të gjerë fiskale, ekonomike dhe financiare. Ata janë të detyruar gjithashtu t'i përmbahen rregullave të detajuara në lidhje me karakteristikat e kuadrit të tyre kombëtar në fushën e buxhetit. Shtetet e reja Anëtare duhet të përmbushin gjithashtu kriteret e përcaktuara në Traktat në mënyrë që të jenë në gjendje të adoptojnë euron në kohën e duhur pas anëtarësimit. Deri atëherë, ata do të jenë një Shtet Anëtar me përjashtim nga përdorimi i euros dhe do të trajtojnë politikat e tyre të kursit të këmbimit si një çështje me interes të përbashkët.

### 17.2 Struktura e kapitullit

- Politika ekonomike
- Politika monetare

### 17.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Neni 87 i MSA-së përcakton bashkëpunimin në fushat e politikave ekonomike dhe tregtare, duke theksuar se Komuniteti dhe Shqipëria do të lehtësojnë procesin e reformës ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar të kuptuarit e bazave të ekonomive të tyre përkatëse dhe

formulimit e zbatimit të politikës ekonomike në ekonominë e tregut. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, Komuniteti mund të ofrojë asistencë të dizenuar për të mbështetur përpjekjet e Shqipërisë për krijimin e një ekonomie tregu funksionale dhe përafrimin gradual të politikave të saj me politikat e orientuara drejt stabilitetit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

*Acquis*-i përbëhet kryesisht nga dispozitat dhe protokollet e Traktatit, si dhe rregulloret dhe vendimet që nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, siç tregohet në nenin 131 të TFBE, secili Shtet Anëtar do të sigurojë që legjislacioni i tij kombëtar, duke përfshirë edhe statutet e bankës qendrore, të jetë në përputhje me TFBE dhe Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane (Statuti i ESCB/ECB). Rregulloret sipas këtij kapitulli u kërkojnë shteteve anëtare të identifikojnë rreziqet e mundshme, parandalojnë ose korrigjojnë çdo deficit fiskal të tepërt si dhe pabarazitë makroekonomike të dëmshme. Direktiva 2011/85 përcakton kërkesat për kuadrot buxhetore të Shteteve Anëtare.

#### 17.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Sipas Raport Progresit 2022 është bërë përparim i kufizuar lidhur me rekomandimet e vitit të kaluar, ku përmendet përmirësimi i mekanizmit të koordinimit dhe të konsultimit të politikave ekonomike. Në rekomandimet e lëna ndër të tjera përmendet ende nevoja për përafrimin e plotë të ligjit për Bankën e Shqipërisë me *acquis*-nw e BE-së, ndërkohë që politika monetare ka qenë e përshtatshme dhe efektive. Në lidhje me përputhshmërinë e Ligjit aktual “Për Bankën e Shqipërisë”, jemi të gjykimit se ligji aktual garanton funksionimin e Bankës së Shqipërisë, në mënyrë të pavarur, transparente dhe të përgjegjshme në harmoni me shpirtin Evropian të bankingut qendror. Kjo është provuar si nga funksionimi i deritanishëm i Bankës së Shqipërisë, ashtu dhe nga vetë jetëgjatësia e ligjit në fuqi, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni të pavarur pa krijuar asnjë pengesë në përmbushjen e misionit si një banke qendrore moderne. Rishikimi integral i ligjit, për përafrim të plotë, vlerësojmë se kërkon kohë dhe duhet të mbështetet mbi analiza më të thelluara mbi sfidat me të cilat përballen sot bankat qendrore në Evropë dhe më gjerë, me qëllim ndërtimin e një kornize ligjore që i përgjigjet në mënyrë efikase këtyre sfidave.

Përparime të mëtejshme ka patur edhe në lidhje me shtimin e të dhënave të kërkuara për llogaritjen e treguesve të procedurës së zbalancimeve makroekonomike (MIP), në përafrimin e llogarive qeveritare dhe kombëtare me ESA 2010 dhe njoftimet e Procedurave të Deficitit të Tepëruar, të cilat Shqipëria i paraqet rregullisht duke shfrytëzuar çdo mundësi në këtë drejtim. Megjithatë, edhe në këtë rast, nevojiten të bëhen përmirësime të rëndësishme për të plotësuar përputhjen e plotë me ESA 2010.

#### *Politika ekonomike*

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria paraqet një herë në vit në Komisionin Evropian Programin e Reformave Ekonomike (ERP).

ERP për periudhën 2022-2024 paraqet prioritetet kryesore, politikat dhe reformat e qeverisë shqiptare dhe Bankës së Shqipërisë në aspektet ekonomike. Ky program bazohet në Ligjin nr. 88, "Për Buxhetin e 2020" dhe në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2023-2025, të miratuar në janar 2022<sup>65</sup>.

Në vitet e fundit, deri përpara goditjes nga pandemia, financat publike kishin hyrë në një trajektore të sigurtë dhe optimale të konsolidimit fiskal, e materializuar në parametrat më kyç të qëndrueshmërisë. Së pari, kjo u materializua në uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 5% të PBB në 2013 në poshtë nivelit prej 2% deri në vitin 2019.

Ndërsa në vitin 2020, si kundër-përgjigje kryesore për amortizimin prej pandemisë, u ndërmor një politikë fiskale mjaft ekspansioniste. Rrjedhimisht, deficitin e përgjithshëm buxhetor arriti në vlerën rreth 6.7% të PBB-së dhe borxhi publik u rrit në rreth 74.5% të PBB-së, pra me rreth 9 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2019.

Për të kryer një politikë të tillë fiskale ekspansioniste në kundër-përgjigje të goditjes, qeverisë iu bë e nevojshme që të aktivizonte gjatë vitit 2020 "klauzolat e devijimit" nga rregullat fiskale, si klauzola të parashikuara që më parë në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), duke mos cenuar kështu kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve dhe agjentëve ekonomikë.

Gjithashtu, me synimin për të ruajtur sa më shumë të ishte e mundur të pacënuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, element kyç ky i financave publike si një fundament makroekonomik, sidomos për vende të vogla dhe me nevoja ri-financimi buxhetor relativisht të larta siç është Shqipëria, u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore në Korrik të 2020 (në kulmin e pandemisë) duke përfshirë një rregull tjetër të ri fiskal në LOB, i cili sanksiononte ligjërisht që balanca primare e buxhetit të rikthehej në së paku në një nivel të balancuar (pra, jo më e vogël se sa zero) duke filluar nga viti 2024 e në vijim.<sup>66</sup>

Ky rregull u mirëprit mjaft pozitivisht nga të gjitha institucionet ndërkombëtare (përfshirë patjetër edhe agjencitë e *rating*-ut) dhe rrjedhimisht nga aktorët ekonomik në tërësi, si një iniciativë mjaft e duhur dhe efektive për të ruajtur kredibilitetin dhe qëndrueshmërinë e financave publike, jo vetëm në periudhën afatmesme dhe afatgjatë post-pandemisë, por madje vlerësohet se ishte mjaft ndihmuese për të siguruar një financim (huamarrje) relativisht mjaft normale edhe në afatin e shkurtër përgjatë goditjes, pra përgjatë vitit 2020 dhe në vijim, pavarësisht magnitudës mjaft më të lartë të huamarrjes se sa është tipikisht.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse.

<sup>65</sup>Miratuar nga Këshilli i Ministrave, më datë 13.01.2022, Nr. 19

<sup>66</sup>Rregulli origjinal sanksiononte "që prej 2023", por më pas kjo u ndryshua sërish në Korrik të 2021 dhe u bë "që prej 2024"



Politika fiskale do të targetojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore rënëse graduale por e përvitshme, ndërsa balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv që prej vitit të ardhshëm 2023 dhe do të vijojë e tillë në vijim, në përputhje edhe me rregullat fiskalë në LOB. Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, do të synohet që të ruhet një raport i shëndetshëm i shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) do targetohen të jenë rreth 5 përqind e PBB në çdo vit buxhetor.

Defiçiti buxhetor për vitin 2023 planifikohet të jetë në nivelin 2.6 përqind të PBB nga rreth 3.3 përqind i pritshëm për vitin 2022. Balanca primare për vitin 2023 pritet të jetë pozitive në rreth 0.3 përqind, në një përmirësim të qenësishëm nga niveli negativ prej rreth -1.3 përqind që pritet për vitin 2022.

Balanca korente fiskale (diferenca midis investime publike dhe deficitit fiskal) do të jetë pozitive në vitin e ardhshëm 2023, në nivelin prej 2.7 përqind të PBB nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 2.2 përqind këtë vit, në përputhje kjo me rregullin përkatës fiskal (“rregullin e artë” të buxhetit). Gjithashtu edhe borxhi publik bruto do të vijojë trajektoren rënëse të nisur që në vitin 2021 pas pandemisë në përputhje me rregullin përkatës fiskal. Në vitin 2022 pritet që borxhi publik të bjerë në rreth 68.8 përqind të PBB nga rreth 73.2 përqind që ishte në vitin 2021 dhe pritet të vijojë të ulet më tej në rreth 67.5% në vitin 2023. Balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv (suficit primar) që prej vitit 2023 e në vijim. Ndërkohë që, duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim ky target do të jetë edhe ligjërish i detyrueshëm, ku në LOB përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim, balanca primare të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të ulet në rreth 64.4 përqind në vitin 2026 dhe më tej në rreth 55 përqind në vitin 2031.

### *Politika monetare*

Siç përmendet në raport progresin e fundit të Komisionit Evropian, Banka e Shqipërisë është financiarisht e pavarur dhe ka instrumente, kompetenca dhe kapacitete administrative të mjaftueshme për të funksionuar efektivisht dhe për të zbatuar një politikë monetare eficiente. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është plotësisht operacional.

Për arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve, Banka e Shqipërisë ndjek një politikë monetare e cila hartohet dhe zbatohet sipas parimeve të regjimit të inflacionit të shënjestruar. Në përputhje me këtë regjim, Banka e Shqipërisë ndjek një regjim të kursit të lirë të këmbimit. Tiparet kryesore të regjimit të politikës monetare janë publikuar në Dokumentin e Politikës Monetare. Banka e Shqipërisë e ka përkufizuar objektivin e inflacionit si ndryshim vjetor të çmimeve të konsumit në nivelin 3.0% gjatë një horizonti kohor afatmesëm. Vendimet e politikës monetare bazohen në devijimet e inflacionit të parashikuar nga objektivi dhe vlerësimi i pritjeve për inflacionin. Zbatimi i politikës monetare kryhet nëpërmjet një set-i instrumentesh të tregut të hapur: i) operacione të tregut të hapur; ii) lehtësirat njëditore; iii) rezerva minimale e detyruar. Kuadri i politikës monetare dhe ai i kursit të këmbimit janë të përshtatshëm për arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve

dhe nuk pritet të ndryshojnë në afatin e mesëm. Instrumentet e politikës monetare janë subjekt kalibrimi me qëllim rritjen e eficiencës së transmetimit të politikës monetare në tregje.

Në përputhje me mandatin për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, Banka e Shqipërisë ka nisur normalizimin e politikës monetare. Pas një periudhe të gjatë me një politikë monetare akomoduese dhe me norma të ulëta interesi, rritja e fortë e presioneve inflacioniste pas fillimit të luftës në Ukrainë, ka kërkuar normalizimin gradual të politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka rritur normën bazë të interesit nga minimumi historik prej 0.50%, në 2.75% (deri në nëntor 2022). Presionet inflacioniste janë intensifikuar ndjeshëm në prani të rritjes së çmimeve ndërkombëtare, dhe një kërkesë të qëndrueshme nga ekonomia e brendshme. Banka e Shqipërisë pret që këto presione të zbuten gradualisht në vitin 2023 si pasojë e normalizimit të çmimeve jashtë dhe ngadalësimit të kërkesës prej kushteve më të shtrënguara monetare. Inflacioni pritet të arrijë objektivin në vitin 2024, i kushtëzuar nga vijimi i normalizimit të politikës monetare.

Politika monetare do të vijojë të orientohet nga arritja e objektivit të stabilitetit të çmimeve. Normalizimi gradual i qëndrimit të politikës monetare, nga pozicioni tejet stimulues i saj në një pozicion më neutral, është një masë e domosdoshme për respektimin e objektivit. Megjithatë, shpejtësia e normalizimit të politikës monetare do të varet nga të dhënat e reja dhe do të udhëhiqet nga përditësimi i parashikimeve për inflacionin dhe për ekonominë.

*Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ), Procedura e Deficitit të Tejkualuar (PDT), Procedura e Zhbalancimeve Makroekonomike dhe Llogaritë Financiare sipas sektorëve institucionalë.*

*Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ) dhe Procedura e Deficitit të Tejkualuar (PDT) në Shqipëri*

Shqipëria, si vend kandidat për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian, ka detyrimin e përpilimit dhe dërgimit në EUROSTAT të tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (PDT) si dhe të treguesve lidhur me Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ). Në kuadër të projektit “Përmirësimi i Kapaciteteve për Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ), në vendet e Evropës Juglindore”, i financuar nga SECO<sup>67</sup> është punuar në drejtim të rritjes së cilësisë si dhe të plotshmërisë së këtyre statistikave në drejtim të përmbushjes së detyrimeve si vend kandidat për anëtarësim në BE. Ky projekt u finalizua në shkurt 2022 dhe të gjitha përmirësimet metodologjike dhe rezultatet e arritura u prezantuan gjatë workshopit mbyllës. Nëpërmjet këtij projekti u ndërtua “Sistemi i Integruar i Përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë” i cili është përdorur dhe do të përdoret për përpilimin e tabelave të Statistikave Financiare të Qeverisë dhe Procedurës së Deficitit të Tejkualuar. Ky sistem u përdor për herë të parë në raportimin e tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar, tetor 2021. INSTAT nën asistencën e projektit IPA 2019 “Projekti Statistikor – SP 1.1 – Statistikat Financiare të Qeverisë dhe Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (2019 – 2023)”, ka vazhduar punën për mirëmbajtjen, zhvillimin e sistemit si edhe integrimin e përmirësimeve metodologjike për të prodhuar tabelat mbi Statistikat Financiare të Qeverisë dhe tabelat Procedurës

---

<sup>67</sup> Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO).

së Deficitit të Tejkualuar në linjë me ESA2010. Grupi i Punës midis tre institucioneve: INSTAT, BSH dhe MFE, i ngritur me qëllim zhvillimin dhe përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë dhe Procedurës së Deficitit të Tejkualuar, ka organizuar dhe organizon takime të vazhdueshme si dhe ka përgatitur raportet sipas specifikave dhe çështjeve të diskutuara. Gjithashtu Grupi i Punës ka organizuar takime të vazhdueshme me ekspertë të EUROSTAT dhe FMN-në duke përdorur platformën WebEx.

Në përputhje me “Memorandumin e Mirëkuptimit për Statistikat Makroekonomike dhe Financiare”, nënshkruar në vitin 2016, ndërmjet Institutit të Statistikave (INSTAT), Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Bankës së Shqipërisë (BSH), është përcaktuar përgjegjësia për prodhimin e Statistikave Financiare të Qeverisë dhe Procedurës së Deficitit të Tejkualuar që kanë të tre institucionet. Lidhur me detyrat e secilit institucion, ato përcaktohen përmes “Grupit të Punës për Statistikat Financiare të Qeverisë dhe Procedurës së Deficitit të Tejkualuar”. Ndarja e detyrave për prodhimin e statistikave financiare të qeverisë nënkupton që INSTAT, BSH dhe MFE përcaktojnë përgjegjësitë kryesore në këtë fushë dhe bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar konsistencë në të dhëna ku:

- **INSTAT** është përgjegjës për përpilimin e llogarive jo-financiare të sektorit të qeverisjes së përgjithshme (S.13) dhe koordinator për ndërveprimin mbi përpilimin e statistikave të tjera të qeverisë të prodhuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë.
- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** është ofruesi kryesor i informacionit për njësitë buxhetore të sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme si dhe sipas nën-sektorëve (Qeveria Qendrore, Lokale dhe Fondet e Sigurimeve). MFE është gjithashtu përgjegjëse për transmetimin e Statistikave Financiare të Qeverisë sipas formatit të kërkuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, duke ndjekur manualin e GFSM 2014.
- **Banka e Shqipërisë** është përgjegjëse për hartimin e setit të plotë të llogarive financiare për të gjithë sektorët institucionalë, përfshirë edhe sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme.

Bazuar në përgjegjësitë institucionale të përcaktuara më sipër, gjatë muajit Tetor 2022 janë vlerësuar tabelat për Statistikat Financiare të Qeverisë duke përdorur sistemin AIGCS.

**INSTAT** aktualisht përpilon dhe transmeton tabelat për Statistikat Financiare të Qeverisë për llogaritë jo-financiare në EUROSTAT në përputhje me Programin e Transmisionit ESA2010 përkatësisht:

- Tabela 0200 - Treguesit kryesore të Qeverisjes së Përgjithshme;
- Tabela 0900 - Detajimi i taksave dhe kontributeve shoqërore sipas llojit dhe sipas nën-sektorëve të Qeverisjes së Përgjithshme;
- Lista Kombëtare e Taksave;
- Tabela 1100 - Shpenzimet e qeverisë sipas funksionit;
- Tabela 2500 - Llogaritë tremujore jo-financiare të sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme.

**Banka e Shqipërisë** prej disa vitesh po punon për hartimin dhe transmetimin e tabelave për Statistikat Financiare të Qeverisë për llogaritë financiare në EUROSTAT në përputhje me Programin e Transmisionit ESA2010:

- Tabela 2700 - Llogaritë financiare tremujore për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme;
- Tabela 2800 - Borxhi tremujor i qeverisë (borxhi i Maastrichtit) për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme.

Si vend kandidat, Shqipëria ka raportuar duke filluar që nga viti 2014 tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar si edhe tabelat për Statistikat Financiare të Qeverisë sikurse kërkohen nga Programi i Transmetimit (ESA 2010 TP). Këto të dhëna janë dërguar në duke përdorur burimet e të dhënave të disponueshme dhe mbajnë statusin “jo për publikim”.

Të dhënat e raportuara nga tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar janë tabela të harmonizuara për të ofruar një kuadër të krahasueshëm me agregatët buxhetorë kombëtarë dhe ndërmjet deficitit/suficitit të qeverisë (i njohur në Llogaritë Kombëtare si: huadhënia neto/huamarrja neto) dhe ndryshimeve në borxhin e qeverisë.

INSTAT transmeton në mënyrë të rregullt, në muajt Prill dhe Tetor të çdo viti, tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar sikurse kërkohen nga Eurostat. Këto të dhëna janë dërguar në duke përdorur burimet e të dhënave të disponueshme dhe mbajnë statusin “jo për publikim”.

MFE aktualisht përpilon dhe transmeton tabelat vjetarin e tabelave për Statistikat Financiare të Qeverisë (GFSY eng.) tek Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), pjesërisht në përputhje me manualin GFSM2014 dhe aktualisht këto tabela mbulojnë vetëm njësitë buxhetore për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme dhe sipas nënsektorëve. Këto tabela gjenerohen drejtpërdrejt nga sistemi AGFIS dhe publikohen në faqen e internetit të MFE-së dhe FMN-së.

Duke përdorur “Sistemin e Integruar për Përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë (AIGCS eng.), i zhvilluar në kuadër të projektit SECO, janë vlerësuar tabelat sipas formatit që kërkohen nga FMN, duke integruar të dhënat për njësitë buxhetore dhe ekstra-buxhetore, dhe ndjekur metodologjisë e GFSM2014. Këto tabela aktualisht janë përpiluar duke përdorur burimet e të dhënave të disponueshme dhe mbajnë statusin "jo për publikim".

MFE ka iniciuar një projekt me Bankën Botërore dhe ka avancuar në drejtim të implementimit të Standardit Ndërkombëtar për Kontabilitetin Publik, i cili do të mundësojë vlerësimin dhe raportimin e saktë të deficitit dhe nivelit të borxhit të qeverisë së përgjithshme.

#### *Procedura për identifikimin e Zhbancimeve Makroekonomike (MIP)*

Shqipëria ka bërë progres lidhur me Procedurën për identifikimin e Zhbancimeve Makroekonomike (MIP).

#### *Llogaritë Financiare sipas Sektorëve Institucionale*

Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për përpilimin dhe transmetimin në Eurostat të llogarive financiare sipas sektorëve institucionalë bazuar në metodologjinë ESA2010.

Banka e Shqipërisë duke filluar nga 2018 ka përpiluar dhe publikuar llogaritë financiare sipas sektorëve institucionalë për serinë e të dhënave 2013 e në vazhdim. BSH ka raportuar në Eurostat nëpërmjet platformës SDMX për publikim këto tabela për vitet 2013-2021

0710 - Balance sheets for financial assets and liabilities (stocks), consolidated

0720 - Balance sheets for financial assets and liabilities (stocks), non-consolidated;

Në Eurostat janë raportuar gjithashtu të dhëna pilot për vitet 2020-2021 për tabelat:

0610 - Financial accounts by sector (transactions), consolidated;

0620 - Financial accounts by sector (transactions), non-consolidated

#### 17.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

#### 17.6 Mangësitë e identifikuarra dhe Prioritetet

Në kuadër të rekomandimit të Komisionit Evropian në Raport Progresin për Shqipërinë, të publikuar së fundmi (tetor 2021) mbi përmirësimin e koordinimit të politikave ekonomike qeveritare dhe mekanizmat e konsultimit me palët jo-qeveritare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në funksion të hartimit të dokumenteve si ERP dhe Buxheti Vjetor, kryhen konsultime me palët e interesit. Për ERP kryhen konsultime dhe dëgjesa si me institucionet e tjera të Qeverisë (ministrinë e linjës) dhe institucionet e varësisë, po ashtu dhe me palët e interesit për çështje të ndryshme në varësi të politikave strukturore që janë prezantuar dhe propozuar. Pothuajse e njëjta procedurë ndiqet dhe për etapat e hartimit të Buxhetit Vjetor.

Të gjitha sa më sipër janë thelbësore për të rritur ndërgjegjësimin për qëndrueshmërinë e financave publike dhe për të përforcuar besueshmërinë e politikës fiskale, veçanërisht nëpërmjet një angazhimi të qëndrueshëm politik ndaj rregullave fiskale. Ky është një proces në vazhdim i cili ka ende vend për përmirësime. Çdo vit shënon një hap më tej drejt rritjes së besueshmërisë duke qenë në përputhje totale me ligjin dhe duke ndjekur rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Në ndërlidhjen mes Qeverisë dhe palëve private, vijonë në ndihmë dhe struktura të pavarura që kanë për objektiva të lehtësojnë dialogun midis përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, organizatave ndërkombëtare, donatorëve dhe qeverisë. Kjo krijon një klimë të favorshme, jo-diskriminuese dhe

transparente të biznesit dhe investimeve, lehtëson zhvillimin e besimit të ndërsjellë midis komunitetit të biznesit dhe qeverisë në Shqipëri dhe kontribuon në një institucionalizim në rritje të dialogut efektiv të politikave. Mund të përmendet Këshilli i Investimeve dhe krahas tij, struktura të tjera që ndihmojnë për të njëjtin qëllim, janë: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore, Këshilli Kombëtar i Punës, Këshilli Konsultativ i Punësimit, Këshilli Ekonomik Kombëtar, etj.

Në synimet afatmesme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me qëllim harmonizimin me *acquis*-in, konkretisht sipas përcaktimeve të kapitullit të 17 si dhe në linjë me rregullat dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera anëtare të BE, do të jetë krijimi i Këshillit Fiskal si organ i pavarur. Për më tepër, sa i përket zhvillimit të kapaciteteve njerëzore brenda MFE-së, ky është një proces i vazhdueshëm me fokus në përmirësimin e proceseve të punës dhe planifikimin e trajnimeve. Gjithashtu, një numër i shtuar i vendeve të punës lidhur me procesin e përgatitjes së dokumentit të Kuadrit Makro -Fiskal në Drejtorinë e Makroekonomisë pritet të materializohet deri në fund të vitit. Plotësimi i këtyre vendeve të reja të punës pritet që të ndodhë gradualisht pasi procesi i rekrutimit ndjek një procedurë dhe ka afate ligjore të përcaktuara, duke bërë që i gjithë procesi të zgjasë deri në një ose dy vite.

Synohet përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit teorik dhe operacional të politikës monetare. Banka e Shqipërisë operon nën kuadrin e një politike monetare të ancoruar në regjimin e inflacionit të shënjestruar ku objektivi për inflacionin do të vijojë të jetë në nivelin 3.0% në afatin e mesëm. Vendimarrja e politikës monetare mbështetet në një kuadër të konsoliduar analizash dhe parashikimesh. Për shkak të dinamikave në peisazhin ekonomik e financiar dhe risitë në fushën ekonomike, Banka e Shqipërisë synon vazhdimisht përditësimin e modeleve të parashikimit dhe të analizës së politikës monetare, aplikimin e teknikave bashkëkohore në fushën e modelimit, si dhe përditësimin e njohurive të personelit me të rejtat më të fundit.

Prioritet është mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare në funksion të përmirësimit të mekanizmit të transmetimit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. Transmetimi i politikës monetare kërkon tregje të zhvilluara financiare. Politika monetare ka gjetur transmetim të mirë në tregjet ekzistuese, megjithatë zhvillimi i tyre mbetet prioritet për autoritetet mbikëqyrëse. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë mbështet Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në projektin pilot për emetimin e titujve referencë nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut.

Prioriteti i Grupit të Punës për përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë dhe Procedurës së Deficitit të Tejkalar mbetet raportimi i të dhënave të harmonizuara ndërmjet tre-institucioneve me qëllim përafrimin e plotë të tyre me standardet ESA 2010.

Lidhur me procedurën MIP, përtej punës së konsiderueshme që është zhvilluar deri tani, progres i mëtejshëm nevojitet në llogaritjen e treguesve që ende mungojnë dhe në përmirësimin e metodologjisë si në llogaritjen e indeksit të çmimeve të banesave si dhe treguesit ndihmës Shpenzimet e brendshme bruto për Kërkim dhe Zhvillim (R&D).

## KAPITULLI 19: POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

### 19.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull fokusohet në funksionimin e dialogut social, veçanërisht strukturat e përgjithshme ligjore mbi sindikatat dhe organizimet e punëdhënësve, e drejta për të organizuar/bashkuar sindikatat, kontratat kolektive dhe veprimi industrial, e drejta e grevës, mekanizmat trepalësh të konsultimit, duke përfshirë këshillin ekonomik dhe social, dialogun/kontratat, marrëveshjet dypalëshe dhe përfshirjen e partnerëve social në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit.<sup>68</sup>

Gjithashtu, kapitulli fokusohet tek politikat e punësimit, mbrojtja sociale, Fondi Social Evropian, si edhe trajtohen çështje të antidiskriminimit dhe pabarazive, përfshirja sociale dhe personat me aftësi të kufizuar.

### 19.2 Struktura e kapitullit

Lista e nënkapitujve, si më poshtë:

- Ligji i Punës;
- Shëndeti dhe Siguria në Punë;
- Dialogu Social;
- Politikat e Punësimit;
- Fondi Social Evropian;
- Përfshirja Sociale dhe Personat me Aftësi të Kufizuar;
- Mbrojtja Sociale;
- Antidiskriminimi dhe Shanset e Barabarta.

### 19.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Detyrimi i përgjithshëm për të përafuar ligjin Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga Neni 70 i MSA-së. E ndarë nga kjo dispozitë, Shqipëria nuk ka vetëm detyrimin për të sjellë teknikisht legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë edhe zbatimin e tij. Sipas Nenet 77 të MSA-së, Shqipëria duhet të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të BE-së në fushat e kushteve të punës, sidomos në shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mundësi të barabarta.

---

<sup>68</sup> Kapitulli 23 “Drejtësia dhe të Drejtat Themelore” mbulojnë lirinë e tubimit dhe organizimit nga një perspektive e gjerë e të drejtave themelore.

Detyrimet në fushën sociale dhe politikave të punësimit rrjedhin nga Neni 99 mbi “Zhvillimin dhe përmirësimin e Sistemit të Sigurisë Sociale”, Neni 48 “mbi Koordinimin e sistemeve të Mbrojtjes Sociale për Komunitetin e Qytetarëve Punëtorë në territorin Shqiptar dhe të shtetasve Shqiptarë të punësuarve në vendet e Bashkimit Evropian”.

Nenet 46, 47, 48, 77, 99 të MSA-së përcaktojnë bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, duke synuar në modernizimin dhe ristrukturimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimit profesional, zbatimit të programeve të punësimit aktiv dhe pasiv dhe mbështetjen e përafritit gradual të legjislacionit Shqiptar dhe praktikave në fushën e tregut të punës dhe trajnimit profesional me rregullat dhe standardet e Unionit.

Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standarde minimale për ligjin e punës, barazinë gjinore, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mos diskriminimin. Në bazë të Nenetit 153 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFBE), Unioni mbështet dhe plotëson aktivitetet e Vendeve Anëtare në fushën e politikave sociale. Fondi Social Evropian është mjeti kryesor financiar përmes të cilit BE mbështet zbatimin e strategjisë së saj të punësimit dhe kontribuon në përpjekjet e përfshirjes sociale (rregullat e zbatimit janë të përfshira në Kapitullin 22, i cili merret me të gjitha instrumentet strukturorë).

Në fushën e aftësive të kufizuara, BE-ja është pjesë e Kuvendit për të Drejtat e Personave me Aftësi Ndryshe të Kombeve të Bashkuara dhe ka përshtatur një strategji që synon integrimin, përhapjen e çështjeve të aftësive të kufizuara me politikat e përshtatshme të Unionit dhe rritjen e përfshirjes dhe pjesëmarrjes e njerëzve me aftësi ndryshe, njëllonj si të tjerët.

Marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura me punësimin, punën dhe çështjet sociale, siç është Kuvendi i ONP dhe Kuvendi i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, duhet të merren në konsideratë.

#### 19.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje në fushën e politikave sociale dhe punësimit. Disa përparime janë bërë në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës.

Shqipëria ka vijuar ristrukturimin e sistemit të qeverisjes së punësimit, siç parashikohet në ligjin e ri për arsimin dhe formimin profesional (AFP). Reforma e shërbimeve sociale po përparon, duke synuar rritjen financiare dhe administrative, për të forcuar nivelin lokal.

Në zbatimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm, të KE, Shqipëria ka njëfarë progresi, veçanërisht duke forcuar cilësinë dhe efektivitetin e institucioneve të tregut të punës dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit për grupet më vulnerabel.



Sa i përket **legjislaconit të punës**, Kodi i Punës i ndryshuar është duke u zbatuar. Me qëllim përmirësimit e monitorimit të zbatimit të legjislaconit të punës dhe mbledhjes së të dhënave të inspektimit nga ISHPSHSH Aktualisht Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është në proces ndryshimi dhe zhvillimi, përmes ristrukturimit, çka do të thotë që ky institucion përballet me formulimin e një vizioni të qartë, për të riorientuar shërbimet drejt një qëllimi të ri, duke vlerësuar punën e kryer deri tani dhe zhvillimin e objektivave tashmë ekzistuese, për implementimin me efikasitet të të gjitha aktiviteteve të inspektimit në punë, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe zhvillimit të politikave të reja, strategjive dhe metodave parandaluese.

“Platforma e ndërgjegjësimit” është një projekt i cili ka zëvendësuar “matricën e dënimeve”, në procesin e punës së përditshme të Inspektoratit të Punës, me mbështetje nga Organizata Botërore e Punës (ILO) për zhvillimin e mëtejshëm të tij nëpërmjet projektit “Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale 2- ESAP II”, e cila ka dhe në fokus shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet Inspektorateve të Punës së Ballkanit Perëndimor.

Gjithashtu kjo platformë shërben edhe për standardizimin e punës së inspektorëve të punës në çdo vendimmarrje duke qenë se:

- Rrit inteligjencën profesionale të inspektorëve të punës, siguron transparencë në vendimmarrjen tyre dhe minimizon abuzimin me detyrën.
- Synon trajtim të barabartë, për mos respektimin e të njëjtës dispozitë ligjore, në kushte të barabarta

Nëpërmjet përpunimit të të dhënave të inspektimit të marra nga “Platforma Ndërgjegjëse” orientojmë inspektimin bazuar mbi velin e riskut të subjekteve.

Me qëllim monitorimin e punës së fëmijëve, është hartuar një udhëzues praktik për inspektorët e punës në identifikimin dhe kontrollimin e formave të punës së fëmijëve dhe reagimin e duhur. Ky udhëzues i veçantë do të forcojë rolin e inspektorëve të punës në identifikimin dhe referimin e punës së paligjshme të fëmijëve.

- Me VKM Nr. 479, datë 17.6.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 15.2.2017 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë”,<sup>69</sup> është shtuar detyrimi i inspektorëve të punës për të zbatuar këto udhëzues praktik si shtojca II e cila i bashkëlidhet kësaj VKM-je.

Lidhur me **shëndetin dhe sigurinë në punë**, dokumenti i politikës së sigurisë dhe shëndetit në punë 2016 – 2020 meqënëse ka përfunduar, është propozuar zhvillimi i strategjisë së re për shëndetin dhe sigurinë në punë. Aktualisht, është në proces draftimi i strategjisë për “Aftësim dhe Punësim” 2023 – 2030 dhe si strategji nën sektoriale parashikohet një strategji e re për shëndetin dhe sigurinë në punë.

---

<sup>69</sup> Botuar në Gazetën Zyrtare, Datë 22.06.2020.

Gjate vitit 2019, hyri ne fuqi VKM Nr. 596 datë 4.09.2019 “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në VKM Nr. 639 datë 7.09.2016 “Për rregullat, procedurat dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit, si dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”. (c fare thote kjo vkm)

Aksidentet në punë hetohen nga ISHPSHSH-ja dhe ndahen sipas llojit të aktivitetit. Në këtë kontekst, për vitin 2021 rezultoi se numri më i lartë i inspektimeve për rast aksidenti në punë është evidentuar në rajonin Tiranë në sektorin Tiranë dhe Durrës, Rajonin Vlorë sektori Fier, sektori Elbasan dhe Rajonin Dibër.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i rasteve të hetimit të aksidenteve në punë, rezultoi në sektorin e ndërmarrjeve prodhuese të cilat zënë 21.3% të totalit të inspektimeve për aksident në punë duke vijuar me sektorin e ndërtimit i cili zë 18%, të totalit të inspektimeve për aksident në punë.

Situata e çështjeve të sigurisë dhe të shëndetit në punë ka marrë vëmendje të shtuar nga vetë subjektet. Si rezultat i pasojave të mos deklaramentit të aksidenteve, parashikuar në ligjin përkatës, vërehet ndërgjegjësim i rritur për deklarament të aksidenteve në punë nga punëdhënësi. Janë krijuar lehtësira për marrjen e informacionit të shtuar dhe të kryerjes së këtij raportimi, nëpërmjet faqes zyrtare, duke mundësuar deklarament të aksidenteve në çdo ditë dhe orë të javës, përfshirë ditët e pushimit javor apo ditët e festave zyrtare.

Përveç aksidenteve të njoftuara nga vetë punëdhënësit ashtu siç ligji e parashikon, gjatë vitit 2021 ka pasur të regjistruara edhe aksidente nga burime të tjera e konkretisht nga organet e Prokurorisë, media, ankesa të vetë punëmarrësve të aksidentuar të ardhura drejtpërdrejtë pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës apo nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes.

Me qëllim përmirësimit të ndërgjegjësit publik dhe promovimit të politikave të SSHP-së, në kuadër të Fushatës Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2020 – 2022 e udhëhequr nga Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (EU-OSHA), nën sloganin “Vende Pune të shëndetshme, Lehtëso Ngarkesën” e cila përqendrohet në parandalimin dhe çrregullimin e sëmundjeve muskulo-skeletore të lidhura me punën (MSD), Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si pjesë e EU-OSHA-s, ka shpërndarë fletë-palosje, postera, udhëzues e fletushka të përgatitura nga kjo Agjenci, si dhe ka organizuar vizita në subjekte të ndryshme.

ISHPSHSH organizoi një konferencë me pjesëmarrës të organizatave të punëdhënësve, punëmarrësve, sindikata shoqëri civile si aktivitet përmblyës të kësaj fushate.

Nuk janë regjistruar raste të fëmijëve të aksidentuar në punë, grave shtatzëna/ gra me fëmijë në gjë apo persona me aftësi të kufizuar, grupe këto që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjislacioni i punës.

Nga viti në vit konstatohet rritje e numrit të subjekteve që ndërmarrin masat për krijimin e kushteve të sigurta të punës, e konkretisht për periudhën janar-dhjetor 2021, vërehet rritje e:

- Numrit të subjekteve që mbulohen me shërbim mjekësor, (konstatohet në 45% të subjekteve të inspektuara);
- Numrit të subjekteve që përdorin pajisje mbrojtëse individuale, (81 % të subjekteve të inspektuara);
- Numri i subjekteve që përdorin pajisje mbrojtëse kolektive, (73 % të subjekteve të inspektuara);
- Numrit të punemarresve që përdorin pajisjeve mbrojtëse kolektive dhe individuale, (70% të punemarresve të konstatuar);
- Shërbimit të ndihmës së parë, ( 72 % të subjekteve të inspektuara);
- Shërbimit të mbrojtjes ndaj zjarrit, ( 79 % të subjekteve të inspektuara);
- Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe përfaqësuesve në Këshillat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, (në 48 % e subjekteve të inspektuara);
- Ekziston Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikut, (në 61 % të subjekteve të inspektuara).

Prioritetet e ISHPSHSH-së në drejtim të krijimit të kushteve të sigurta të punës kanë orientuar edhe planifikimin e inspektimeve në subjektet që paraqesin rrezikshmëri për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve, si dhe zhvillimin e takimeve ndërgjegjësuese me biznesin si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Vërehet një rritje e konsiderueshme e Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, dhe ekzistencës së dokumentit të vlerësimit të riskut, kjo si pasojë e kërkesës së vazhdueshme nga Inspektorati i Punës në këtë drejtim. ISHPSHSH inkurajon jo vetëm ngritjen e këtyre Këshillave por dhe efektivitetin e tyre. Gjithashtu, kërkon që dokumenti i vlerësimit të riskut të jetë konform legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me **dialogun social** në nivel qendror, me miratimin e VKM nr. 356, datë 26.05.2022 “Për caktimin e Organizatave të Punëdhënësve dhe të Organizatave Sindikale në Këshillin Kombëtar të Punës”, dhe urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për emërimin e anëtarëve dhe kandidatëve në KKP, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve”; u rikompozua Këshilli Kombëtar i Punës (KKP).

Ministri i Financave dhe Ekonomisë miratoi Urdhrin nr.186, datë 4.7.2022 “Për emërimin e anëtarëve dhe kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve”.

Mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Punës, pas rikompozimit të tij u zhvillua më datë 13.07.2022, KKP ka konsultuar një sërë ceshtjet që kanë të bëjnë me:

1. Njohja me VKM nr. 356, datë 26.05.2022 “Për caktimin e Organizatave të Punëdhënësve dhe të Organizatave Sindikale në Këshillin Kombëtar të Punës”, dhe urdhërin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për emërimin e anëtarëve dhe kandidatëve në KKP, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve”;

2. Zgjedhja e dy Nënkyetarëve të KKP, një nga pala punëmarrëse dhe një nga pala punëdhënëse;
3. Informacion mbi aktivitetin e Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për vitin 2022 dhe objektivat për vitin 2023;
4. Informacion mbi veprimtarinë dhe rolin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për vitin 2022 dhe objektivat për vitin 2023;
5. Informim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për masat e marra për mbështetjen e sektorit të turizmit në sezonin turistik;

Më parë, Këshilli Kombëtar i Punës ka zhvilluar online një mbledhje në 16 shkurt 2021, ku janë konsultuar çështje të rëndësishme si më poshtë:

1. Informacion lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.
2. Informacion për procedurën e ndjekur për ratifikimin e Konventës 190 “Për eliminimin e dhunës dhe ngacimit në botën e punës” të ILO-s.
3. Informacion lidhur me studimin për sfidat në biznesin e vogël dhe të mesëm për të përballuar situatën e Pandemisë si dhe implementimi i projektit “Fuqizimi i grave kundër Covid-19 në sektorin Fason”.
4. Informacion për veprimtarinë e Grupit të Punës për përmirësimin e procedurave të ndërmjetësim/pajtimin për zgjidhjen e konflikteve kolektive të punës si dhe rritja e aftësive të Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimin për arritjen e konsensusit ndërmjet Punëdhënësit dhe Punëmarrësit.

Gjatë periudhës raportuese ndërmjetësit dhe zyrat e pajtimit kanë trajtuan 8 mosmarrëveshje kolektive ndërmjet Organizatave të Punëmarrësve dhe Organizatave të Punëdhënësve, lidhur me:

- Uljen e bisedimeve;
- Për lidhjen e kontratës kolektive;
- Rinovimin e kontratës kolektive;
- Për përmirësimin e kushteve të punës

Gjate vitit 2022 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë janë depozituar 5 kontrata kolektive të punës në nivel kombëtar, në sektorin e turizmit, industrinë përpunuese dhe prodhuese si dhe në sektorin e rendit publik.

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimin dhe Zyrave Shtetërore të Pajtimin dhe në bashkëpunim me ILO, Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit të ILO-s (ITCILO)) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zhvilluan ciklin e dytë për trajnimin e ndërmjetësim/pajtimin e mosmarrëveshjeve të punës për ndërmjetësit e Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimin dhe anëtarë të Zyrave Shtetërore të Pajtimin, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës.

**Sa i përket politikave të punësimit**, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (NESS 2019-2022) dhe plani i saj i veprimit kanë si synim të përgjithshëm të promovojnë vende pune cilësore dhe mundësi aftësish për të gjithë gratë dhe burrat shqiptarë gjatë ciklit të tyre jetësor. Qëllimi kryesor i strategjisë ndiqet përmes një sërë veprimesh plotësuese dhe të ndërlidhura që mbështesin njëkohësisht ofertën e punës dhe inkurajojnë kërkesën për punë, si dhe adresojnë çështjet e përfshirjes sociale. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (NESS) 2019-2022, dhe plani i veprimit përkatës është në vitin e fundit të zbatimit.

Po hartohet Strategjia e re Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030 dhe objektivi kryesor është identifikimi dhe hartimi i politikave të përshtatshme nxitëse në vend për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore me qëllim krijimin e punësimit cilësor dhe trajnimit të vazhdueshëm për të gjithë. Plan i veprimit do të fokusohet në mundësimin e punësimit të denjë përmes zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës dhe zhvillimit të aftësive dhe përputhjen më të mirë të kërkesës me ofertën në tregun e punës për punësim më të lartë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), si institucioni udhëheqës në procesin e zbatimit të Strategjisë, koordinon punën e saj me strategjitë dhe politikat e tjera sektoriale për të arritur ndikim të rëndësishëm në tregun e punës. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (NAVETQ) dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISSHSHP) janë institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësimit. Përveç kësaj, MFE-ja koordinon ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MASR), Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe institucione të tjera përkatëse.

Të tre agjencitë kryesore zbatuese, të përmendura më sipër, kanë pësuar përmirësime të rëndësishme strukturore. Ky proces ka nisur tashmë në vitin 2019 me hartimin dhe themelimin e AKPA, institucion të cilit iu besua të luante një rol vendimtar në qeverisjen e tregut të punës dhe sistemit të AFP-së. Procesi i ristrukturimit dhe punësimit në të tre agjencitë pritet të përfundojë brenda vitit 2022. AKPA ka plotësuar 70 % të vendeve vakante. Gjatë vitit 2021, u realizuar edhe ristrukturimi i strukturave rajonale të punësimit të AKPA. Ristrukturimi u bazua në parimin e optimizimit të burimeve njerëzore për shërbime me cilësi më të lartë. Objektivat kryesore të procesit të ristrukturimit synojnë ndarjen e qartë të roleve dhe përgjegjësi, profilizimin e punonjësve, optimizimin e punës dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme si për punëdhënësit ashtu edhe për punëkërkuuesit.

Metodologjia e re e bashkëpunimit me biznesin, që ka mundësuar një shërbim të unifikuar të Zyrave të Punës ndaj bizneseve që kërkojnë staf të ri, është zbatuar në 22 zyra pune rajonale dhe lokale dhe ka rezultuar në përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset. Në total 132 individë staf nga Zyrat e Punës janë trajnuar përmes një procesi praktik. Gjithashtu, sistemi i monitorimit dhe matjes së kënaqësisë së klientit tashmë është i vendosur dhe mund të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit me bizneset, dhe përmirësimin e performancës së shërbimeve të Zyrave të Punës (ZP) në përgjithësi.

Tashmë është finalizuar sistemi i informacionit të AKPA dhe zhvillimi i planeve individuale të punësimit. Sistemi i ri i TIK-ut është projektuar gjatë vitit 2021, me shumicën e moduleve të zhvilluara dhe testuara, në versionin ueb dhe celular. Sistemi i TIK-ut u shpërnda plotësisht për të gjithë ZP. Modulet e finalizuara i janë prezantuar stafit të zyrave të punës ndërsa zhvillohen dhe janë ofruar trajnime përkatëse. Nëpërmjet sistemit TIK, AKSHI ka mundur të monitorojë të dhënat kryesore administrative. Futja e të dhënave monitorohet vazhdimisht. Mbi 60,000 Plane Individuale të Punësimit u zhvilluan gjatë vitit 2021 dhe u futën në bazën e të dhënave. Sistemi i ri ka mundur gjithashtu krijimin e një harte dixhitale të të gjitha vendeve vakante. Sistemi i TIK ka lejuar gjithashtu regjistrimin, kërkimin e punës dhe publikimin e vendeve të lira të punës nga punëdhënësit. Shërbimet e ndërmjetësimit tani mund të ofrohen online. Sistemi i TIK lidhet automatikisht me platformën e qeverisë e-Albania. Synimi është që sistemi i TIK-ut të zhvillohet më tej për të qenë në përputhje me EURES.

Pas miratimit të Ligjit të ri të Nxitjes së Punësimit në vitin 2019 (ligji nr. 15/2019), Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndërmoi një rishikim të thellë dhe reformë të mëvonshme në portofolin dhe provizionimin e programeve të nxitjes së punësimit (PPP) gjatë viteve 2019 dhe 2020. Në thelb të reformës ishte përpjekja për të adresuar nevojat e bazës së klientëve të AKPA dhe për të përmirësuar procedurat e zbatimit. Reforma synonte të zhvillonte dhe të ofronte një portofol shërbimi që bazohet në një qasje të ekuilibruar të orientuar nga kërkesa dhe oferta, duke njohur dhe nxitur potencialin e grupeve të ndryshme të punëkërkuesve përmes planeve të veprimit të përshtatura dhe masave ndërmjetësuese. Ndërsa kuadri ligjor dhe operacional u miratua në vitin 2020, një zbatim i plotë mund të fillonte vetëm në vitin 2021.

Programet e miratuara 2021 përfshijnë:

- Trajnimi në vendin e punës,
- Subvencionimi i pagës,
- Programi i praktikës profesionale,
- Programi i vetëpunësimit,
- Punësimi në komunitet,
- Programi i tregut të punës për të mbështetur riintegrimin në tregun e punës të punëtorëve që vetëdeklarohen se janë punësuar informalisht dhe janë pushuar nga puna si rezultat i pandemisë COVID-19. Programi i tregut të punës për të mbështetur riintegrimin në tregun e punës të punëtorëve formalë të pushuar nga puna si rezultat i pandemisë COVID-19 deri më 23 qershor 2020.

Zbatimi gjatë viteve 2021 - 2022 synonte arritjen e një përgjigjeje më të mirë ndaj nevojave të punëkërkuesve të papunë, veçanërisht i fokusuar në përgjigjen ndaj nevojave të punëkërkuesve të papunë më të rrezikuar, bazuar në veprimet e harmonizuara ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Shërbimit Social Shtetëror dhe autoriteteve lokale.

Kjo paketë e programeve të nxitjes së punësimit (bazuar në Ligjin 15/2019), është prezantuar gjatë vitit 2020. Në këto programe gjatë vitit 2020 kanë marrë pjesë 580 subjekte dhe 2822 punëkërkues të papunë. Gjatë vitit 2021, në programet e nxitjes së punësimit morën pjesë 900 punëkërkues dhe

592 subjekte, duke e bërë numrin total të përfituesve për periudhën 2020 – 2021, 3727 punëkërkuar dhe 1172 subjekte. Rezulton se 54% e punëkërkuarve gjatë kësaj periudhe kanë marrë pjesë në programet e VKM nr. 608 (për punësimin e personave të papunë si pasojë e situatës Covid 19). Për 8 muajt e parë të vitit 2022, në programet e nxitjes së punësimit morën pjesë 3416 persona dhe 1046 subjekte. Nga punëkërkuarët e punësuar, 56% janë gra dhe 41.5% janë të rinj. Punët janë në shitje, shitje, shërbime, industri prodhuese etj.

Mbështetur nga projekti SREPVET IPA, MFE hartoi Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore (PZGR), duke hartuar të gjithë kuadrin ligjor të nevojshëm, duke përgatitur procedurat dhe modalitetet e zbatimit dhe për zbatimin e një faze pilot që fillon në vitin 2023. PZGR është finalizuar dhe gati për t'u dërguar për miratim. Deri në fund të vitit 2021, u krye një Analizë Bazë e Tregut të Punës së të Rinjve dhe gjithashtu, një studim, Hartëzimi dhe Profilizimi i NEET në Shqipëri. Është analizuar kuadri ligjor dhe janë përgatitur draft propozimet për ndryshime në kuadrin ligjor, duke përfshirë propozimin për Modelin e Qeverisjes. U krijua një grup me shumë palë dhe një grup ekspertësh me të gjithë aktorët kryesorë që lidhen me zbatimin e Skemës Garanci Rinore në Shqipëri. Është zhvilluar një Observator i Informacionit të Tregut të Punës, i cili aspiron të bëhet mekanizmi kryesor për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit dhe inteligjencës në tregun e punës. MFE kërkon ta zgjerojë këtë instrument në të gjitha ministritë e tjera me qëllim që ta bëjë atë pjesë integrale të vendimmarrjes në të gjitha nivelet.

Në kuadër të **Fondit Social Evropian** nuk ka pasur zhvillime.

Në nënfushën mbi **Përfshirjen Sociale dhe Personat me Aftësi të Kufizuar**,

Lidhur me **Përfshirjen Sociale**, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është në procesin e hartimit të Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale, për të patur politika të përfshirjes sociale të mirë-koordinuara, me një qasje të integruar në monitorim dhe zbatim.

Krijimi i mekanizmave institucionalë për monitorimin dhe reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social do të shoqërohet me politika publike të targetuara, dhe akses në të drejta dhe shërbime që mundësojnë pjesëmarrjen në shoqëri, përfshirje sociale efektive dhe diversitet social.

**Lidhur me Personat me Aftësi të Kufizuar:**

Politikat dhe strategjitë e Qeverisë së Shqipërisë për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara janë në përputhje me objektivat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjinë Evropiane për Aftësinë e Kufizuar 2021 – 2030. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po monitoron dhe zbaton në bashkëpunim me të gjithë aktorët përgjegjës, Planin Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2021 – 2025, i cili është miratuar nga Qeveria me VKM Nr. 276, datë 12.05.2021.

Në harkun kohor 2021 – 2025 në Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar, ka një angazhim ndërinstitucional për masat për aksesueshmërinë në ndërtim, infrastrukturë, transport,

komunikim dhe aksesueshmërinë e informacionit në të gjitha sferat, arsim, punësim, shërbime, turizëm. Vlerësohet, se ende nuk ka një alokim fondesh të targetuar për masat mbi aksesueshmërinë, veçanërisht aksesin në informacion. Njësitë vendore ende nuk planifikojnë, apo buxhetojnë aksesueshmërinë në planet e zhvillimit social-ekonomik.

Aksesi i përmirësuar në shërbimet publike që mbështesin përfshirjen dhe mirëqenien është parakusht për integrimin në shoqëri të PA. Masat e aksesueshmërisë në infrastrukturë konsistojnë në përmirësimin e infrastrukturës në nivel qendror dhe vendor. Gjatë viteve të fundit, MSHMS ka përmirësuar infrastrukturën dhe rritur aksesueshmërinë në 400 qendra shëndetësore, poliklinika dhe spitale. Gjithashtu, në shkollat e prekura nga tërmet ka patur përmirësime të infrastrukturës dhe aksesueshmërinë për PAK. Për personat që nuk dëgjojnë është plotësuar baza ligjore për interpretin e gjuhës së shenjave dhe është përmirësuar niveli në arsimin e mesëm, me aftësim profesional.

Në zbatim të Ligjit 93/2014, është miratuar VKM nr. 436, datë 22.6.2022 i cili përcakton rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara dhe VKM Nr. 470 datë 6.07.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara”.

Aksesi në ndihmën juridike falas ofrohet bazuar në përcaktime të Ligjit Nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike” ku personat me aftësi të kufizuara janë një ndër kategoritë përfituese të kësaj ndihme. Po vijon procesi për zbatimin e ligjit për përkthyesit zyrtarë, ku përfshihet edhe shërbimi i interpretit të gjuhës së shenjave në shërbimet e përkthimeve zyrtare.

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga fushat e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Është rritur numri i mësuesve ndihmës dhe janë prioritet qendrat burimore në arsimin special. Profili i mësuesit të arsimit të veçantë është përcaktuar si një profesion i rregulluar dhe janë trajnuar mësues të licencuar në këtë profil si mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Profili i mësuesve ndihmës është tashmë një profesion i licencuar dhe i rregulluar dhe janë shtuar 250 mësues ndihmës. Raporti student mësues ndihmës është 3/1. Së fundmi, 150 klasa zhvillimore e në institucionet arsimore, u shërbejnë 1 100 nxënësve përfitues fëmijë me aftësi të kufizuara.

Legjislacioni për punësimin përmban krijimin e një Fondi Social të Punësimit, i cili do të përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitimin në punë dhe shërbimet mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara dhe po ndërmerren hapa për të mundur këtë fond. E drejta e kompensimit të aftësisë së kufizuara dhe e drejta për punësim nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën duke nxitur punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Planet Sociale ofrojnë një mundësi që aktorët vendorë të bashkëpunojnë për shërbime të qëndrueshme me shoqërinë civile dhe vetë kategoritë përfituese. Njëkohësisht janë financuar shërbime nga fondi Social si qendra të reja funksionale të shërbimeve komunitare për personat me aftësi të kufizuara. Fondi Social ka krijuar shërbime inovative si shërbimi i asistencës shtëpiake



krahas shërbimeve sociale të integruara që operojnë sipas standardeve të miratuara. Për herë të parë 5 shërbime të specializuara të lëvizshme funksionojnë në 5 bashki me më shumë se 600 përfitues dhe familjet e tyre. Modele të shërbimit të jetesës së pavarur promovohen dhe ofrohen nëpërmjet Fondit Social.

Shërbimet sociale të integruara për PAK ofrohen në nivel kombëtar në 35 institucione rezidenciale (7 shërbime publike dhe 28 jopublike dhe 28 shërbime komunitare të kujdesit ditor (11 shërbime publike dhe 17 jopublike) funksionojnë në territor nga të cilat përfitojnë 16 105 fëmijë me aftësi të kufizuara .

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar synon të përmirësojë cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara duke integruar përfitimet në para me shërbime, shërbime të kujdesit social, shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe formimit profesional, në bashkëpunim me të gjithë aktorët dhe strukturat në qendrën, rajonin dhe nivel lokal.

Qeveria ka ndërmarrë reformën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar që është në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, standardet ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksioneve (ICF).

Skema e vlerësimit bio-psiko-social po shtrihet në mënyrë progresive në të gjithë vendin dhe deri tani po zbatohet në 9 nga 12 qarqet e vendit. Qeveria ka marrë masa për të zbutur efektet e krizave që kanë impakt në të gjitha kategoritë e PAK. Është miratuar në mars të këtij viti, Paketa e parë e Rezistencës Sociale nga e cila personat me aftësi të kufizuar përfituan mbështetje financiare në vlerën 9 000 lekë për tre muaj. Nga kjo masë përfituan 70 mijë persona me aftësi të kufizuara.

Me Paketën e Dytë të Rezistencës Sociale të miratuar, pagesat e aftësisë së kufizuar u rritën me 7.5%. Gjithashtu u rrit me 1 000 lekë masa e kompensimit të energjisë elektrike për kategorinë e paraplegjikëve, tetraplegjikëve dhe të verbërve. Me VKM nr. 616/2022, këto pagesa janë rritur në vlerën 3 000 lekë në muaj për kategoritë që përfitojnë asistent personal dhe 2 400 lekë në muaj për kategoritë e tjera.

Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, në dispozitat e tij ka parashikuar krijimin e një Fondi Social të Punësimit, i cili do të përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitimin në punë dhe shërbimet mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara.

Sipas parashikimeve të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” legjislacioni i strehimit “Social” për kategoritë në nevojë adreson edhe personat me aftësi të kufizuara.. Për këtë qëllim ka programe sociale të strehimit si skema e aplikimit për bonus ose grante të menjëhershme

MSHMS trajton me kujdes shëndetësor të gjitha kategoritë e PAK dhe kjo reflektohet në Strategjinë për Shëndetësinë dhe Planin Kombëtar për Shërbimet e Shëndetit Mendor.

**Lidhur me Politikat Sociale për Fëmijët**

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026, e miratuar në nëntor 2021, ka natyrë ndërsektoriale që përfshin qëllime, objektiva dhe masa, të cilat kanë si synim:

- a) Të ndikojnë në jetën e fëmijëve, përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në të gjitha nivelet;
- b) Të promovojnë një kulturë të të drejtave të fëmijëve dhe të hedhë bazat për pjesëmarrje kuptimplote të fëmijëve në Shqipëri;
- c) Të mundësojnë mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës;
- ç) Të sigurojnë të dhëna cilësore në funksion të përmirësimit të politikave dhe programeve të hartuara për ta;
- d) Të realizojnë edukimin në funksion të mbrojtjes së fëmijëve online, duke garantuar kështu mirëqenien dhe një të ardhme më të mirë për fëmijët

Qëllimet strategjike të përcaktuara në këtë dokument kanë të bëjnë me Qeverisjen e mirë në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve; Eleminimin e të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve; Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë, si edhe Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. Ajo që duam të arrijmë është të krijojmë një mjedis të favorshëm për rritjen e sigurtë dhe të shëndetshme të fëmijëve, zhvillimin e potencialit maksimal fizik dhe psikosocial të tyre, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat që prekin jetën e fëmijëve, si dhe garantimin e vlerësimit të progresit të të drejtave të fëmijëve në fushat kryesore të politikave publike që lidhen me fëmijët.

Qëllimet e identifikuara mundësojnë vazhdimësinë e Agjendës së mëparshme Kombëtare dhe për afrimin me Strategjinë Evropiane për Fëmijët, duke përfshirë prioritetet e Këshillit të Evropës.

Nga skema e ndihmës ekonomike, janë 78 167 fëmijë anëtarë të familjeve që përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike (NE), ndërsa janë dhe 770 fëmijë me status jetimi që trajtohen me NE. Subvencionet shtesë të NE-së për familjet me fëmijë të vegjël për vaksinimin dhe arsimimin e tyre të detyrueshëm aplikohen çdo muaj.

Këtë vit është dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike për familjet me tre ose më shumë fëmijë (rreth 15 000 familje), është dyfishuar pagesa e ndihmës ekonomike për gratë kryefamiljare (5700 gra) me deri dy fëmijë dhe janë trefishuar pagesat për jetimët.

Nisma e re e ndërmarrë së fundmi do të mbështesë të gjitha gratë që nuk janë në punë, me tre apo më shumë fëmijë, në moshën deri 18 vjeç, kur një prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç, kur familja ka të ardhura nën 100 000 në muaj, duke i njohur si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrë lindje.

“Çeku i Bebes” është një politikë e re sociale, që synon të ndikojë në lindshmëri, si edhe një politikë universale për të gjithë familjet, jo vetëm për familjet në nevojë, por dhe për çdo fëmijë shqiptar të lindur, brenda dhe jashtë vendit. Për vitin 2022 deri në fund të shtatorit, janë 32 088 të sapolindur që kanë përfituar bonusin e bebes.

Miratimi i Ligjit Nr. 129/2021 “Për statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës” është një tjetër arritje. Ky ligj ka për qëllim që të marrë në mbrojtje dhe në përkujdesjen e shtetit fëmijët, ku njëri ose të dy prindërit e të cilit apo, në mungesë të tyre, personi i ngarkuar ligjërisht me kujdestarinë e tij kanë humbur jetën në kushtet e përcaktuara nga ligji “Për statusin “Dëshmor i Atdheut”. Kemi 15 fëmijë deri tani që kanë fituar statusin Fëmijë në Përkujdesje të Republikës.

Në nivel vendor janë ngritur dhe funksionojnë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, të cilët kanë përgjegjësi identifikimin, vlerësimin, marrjen në mbrojtje dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në rrezik dhunë, abuzimi, shfrytëzimi apo neglizhimi. Në të gjithë vendin deri në vitin 2021, kemi një rritje të qëndrueshme të të këtij numri në 241 punonjës për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë vendosur si njësi për mbrojtjen e fëmijëve në 61 bashki dhe punonjës të mbrojtjes së fëmijëve në njësitë administrative. Çdo vit, punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve kanë marrë në mbrojtje dhe kanë ofruar shërbime për rreth 2 200 fëmijë në nevojë për mbrojtje. Grupet Teknike Ndërsektoriale janë ngritur në të gjithë Bashkitë, për të mbështetur me një qasje shumë-dimensionale mbështetjen e fëmijëve të identifikuar në rrezik.

Sipas raportimeve, për vitin 2021 NJMF-të kanë menaxhuar 2 389 raste. Deri në shtator 2022 NJMF-të kanë menaxhuar 1 380 raste. Rastet e menaxhuara janë kryesisht raste të fëmijëve në rrezik apo viktima të dhunës, abuzimit, neglizhencës apo shfrytëzimit.

Nga Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët për periudhën janar – tetor 2022, janë zhvilluar një numër prej 23 060 telefonatash. Nga këto janë referuar 460 raste dhe është ofruar këshillim për 1 404 fëmijë.

Reforma e deinstitutionalizimit po shoqërohet me transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime të kujdesit alternative komunitar, ku prioritet kanë programet e fuqizimit ekonomik dhe social të familjes së fëmijëve në institucione. Në këtë drejtim, ka dy zhvillime të rëndësishme:

- Pilotimi në dy bashki (Korçë dhe Vlorë) i dy shërbimeve të reja komunitare “Fuqizimi fëmijës & familjes” ku janë 20 familje përfituese nga programi i Fuqizimit të Familjes, si dhe 5 fëmijë të mbështetur me kujdestari në familje, duke parandaluar vendosjen në përkujdes rezidencial.
- Hartimi i 3 Modeleve të reja, që do të mundësojnë deinstitutionalizimin dhe realizimin e të drejtës së fëmijës për të jetuar në mjedis familjar. Këto modele janë a) Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen b) Kujdestari alternative profesionale dhe c) Procedura të Ribashkimit të Fëmijës me Familjen biologjike.

Reforma për sistemin e vlerësimit biopsikosocial për aftësinë e kufizuar, ka për qëllim të ndihmojë individin për t’u integruar në jetën shoqërore, duke përdorur kritere të reja vlerësimi, të cilat janë të ndara për fëmijët dhe për të rriturit. Nuk ka diferencim pagesash për të rriturit dhe fëmijët. Kjo reformë bën të mundur ndërthurjen e pagesave për aftësinë e kufizuar, me shërbimet shëndetësore, sociale, të arsimit dhe të aftësisimit profesional, me qëllim përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, por edhe për të rritur efikasitetin e vlerësimit, duke krijuar mekanizma administrative që reduktojnë

ndjeshëm shkallën e abuzimit, shmangien e konfliktit të interesit dhe rritjen e besueshmërisë. Aktualisht skema e aftësisë së kufizuar si pjesë e programit të mbrojtjes sociale, mbështet me pagesa cash **14 660 fëmijë** fëmijë në shkallë vendi. Me këtë reformë u mundësua vlerësimi i aftësisë së kufizuar edhe për fëmijët e grupmoshës 0-2 vjeç.

Aktualisht kemi 45 qendra publike të cilat ofrojnë shërbime për personat PAK. Nga këto kemi 8 qendra rezidenciale dhe 37 qendra ditore. Nga këto përfitojnë aktualisht 993 fëmijë. Po kështu janë edhe 23 qendra jopublike, nga të cilat përfitojnë 42 fëmijë.

Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët, ashtu siç edhe parashikohet në kuadrin ligjor në fuqi për shëndetin mendor, ofrohen si ambulatorisht po ashtu dhe me shtretër, sipas nevojës.

Në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP), ndiqet zhvillimi i fëmijës nga ekipet e konsultorit të nënës dhe fëmijës, sipas protokolleve të dedikuara, të cilat aktualisht janë duke u përditësuar, veçanërisht për pjesën e shëndetit mendor. Përditësimi i këtyre protokolleve do të pasohet nga trajnime të stafëve të konsultorëve në nivel kombëtar, me qëllim rritjen e kapaciteteve identifikuese dhe referuese për këtë grupmoshë. MSHMS po përfshin stafe psiko-sociale si pjesë e strukturave së qendrave shëndetësore për të ofruar për herë të parë një shërbim të ri, atë socio – shëndetësor, ku përfitues do të jenë edhe fëmijët me probleme të shëndetit mendor. Shërbim i specializuar në shëndet mendor për fëmijët ofrohet edhe nga ekipet multidisiplinare të Qendrave Komunitare të Shëndetit Mendor (të përbërë nga mjek psikiatër për fëmijët dhe adoleshentët, infermier, psikolog dhe punonjës social).

Ndërkohë, shërbim i specializuar ofrohet edhe në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, në formën e shërbimeve ambulatorie dhe/ose me shtretër (përfshirë akomodimin e prindit kujdestarit ligjor) nëpërmjet ekipeve multidisiplinare të përbërë nga mjek psikiatër për fëmijët dhe adoleshentët, pediatër zhvillimi, neuropediatër, psikolog, punonjës social, therapist okuapcional, treapistë edukimi special, fizioterapist, logopedist, terapistë grupi dhe terapistë zhvillimi

Në zbatim të një nga objektivat më të rëndësishëm të qeverisë është miratuar Programi Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët. Ky program ka për qëllim. 1. Përcaktimin e protokolleve për ndjekjen dhe depistimin e shëndetit të syve. 2. Parandalimin e verbimit në lindjet premature, evidentimi i anomalive të lindura të syve dhe sëmundjeve të tjera kongenitale. 3. Ruajtjen dhe përmirësimin e pamjes në fëmijët 4-14 vjeç. 4. Nxjerrjen në pah të nevojave aktuale për zbatimin e suksesshëm të këtij projekti. Deri tani kanë përfituar 120 000 fëmijë nga ky program.

Gjithashtu edhe miratimi i programit për përkujdesin dentar në shkolla është një tjetër arritje e cila bën të mundur ofrimin e shërbimeve për shëndetin oral për fëmijët. Programi i Kujdesit i Shëndetit oral për fëmijët po pilotohet në 10 shkolla në Tiranë

Kemi rimbursimin e fishave të diabetit për fëmijët për moshat pediatrike.

Gjatë viteve 2020 – 2022, në kuadër të Fondit Social (FS) gjithmonë me fokus fëmijët, janë financuar zbatimimi i projekteve për ngritjen e shërbimeve të reja për fëmijët më aftësi të kufizuara, si në komunitet, si shërbim i specializuar në banesë apo shërbim emergjence për fëmijë në situatë rishikimi. Këto shërbime janë ngritur në bashkitë Kavajë, Rrogozhinë, Maliq, Librazhd, Lezhë, Lushnje, Durrës, Korçë, Vlorë, Elbasan.

Deri më sot vetëm nga FS kanë përfituar 26 bashki, për 27 shërbime të reja të ngritura, nga të cilat 14 shërbime janë për fëmijët. Gjithashtu në kuadër të FS janë financuar dhe 13 shërbime të specializuara në nivel qarku, ku nga këto 8 shërbime janë të dedikuara për fëmijë: një linjë kombëtare këshillimi për fëmijët, dy shërbime për fëmijët autik, tre shërbime për VT/VMT, një shërbim i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.

Aktualisht kemi 81 qendra të ofrimit të shërbimeve për fëmijët, të cilat ofrojnë shërbime për 6125 fëmijë. Nga këto 9 qendra rezidenciale publike 21 qendra rezidenciale jopublike. Kemi 51 shërbime komunitare (22 shërbime publike dhe 31 shërbime jopublike) të cilat ofrojnë shërbime psiko-sociale, shëndetësore, mbështetëse, programe edukimi dhe shërbime alternative.

Ngritja e dy qendrave (Fier, Shkodër) me një ndalesë të reagimit emergjent për fëmijët viktimat/të mbijetuar nga abuzimi seksual dhe forma të tjera të rënda të dhunës, (përveçse qendrës Liliun) do të bëjë të mundur ofrimin e shërbimeve të duhura ndaj tyre, ku fëmijët do të gjejnë mbështetjen e duhur, si edhe trajtimin specifik për problematikat që ata do të kenë. Tashmë qendrat janë funksionale dhe janë miratuar standardet e ofrimit të shërbimeve në këto qendra. Aktualisht nga të dhënat e marra nga qendra Liliun, për periudhën janar – tetor 2022, janë trajtuar 24 raste, ku 2 janë persona të rritur, ndërsa 20 raste janë fëmijë.

Gjatë vitit 2022, janë zhvilluar dy takime të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen në 25 janar dhe 21 nëntor 2022. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, mbledhet në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe funksionon sipas Rregullores të miratuar me VKM. Nr. 54, datë 31.01.2018.

**Në kuadër të Mbrojtjes Sociale**, zbatimimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020 – 2023 (SKMS), miratuar me VKM 866/2019, ka sjellë shndërrimin e skemës së ndihmës ekonomike (NE) në një skemë aktive që mundëson ri-integrimin shoqëror; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuara; ndërhyrjen dhe sigurimin e ri-integrimit të fëmijëve në familje dhe në komunitet dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare.

Lidhur me përmbushjen e prioritetit të parë për zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, është mundësuar mbulim më i mirë i familjeve dhe individëve të varfër duke përmirësuar shenjestrin e tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara me qëllim riintegrimin social të tyre në jetën shoqërore.

Masa e përfitimit të ndihmës ekonomike është rritur me 20% për të gjithë familjet përfituese, është dyfishuar për familjet me tre e më shumë fëmijë dhe për familje me gra kryefamiljare me deri në dy fëmijë, është dyfishuar për të gjithë individët përfitues të moshës mbi 65 vjeç të vetmuar, që nuk përfitojnë pension pleqërie apo pension social. Është trefishuar për individët jetim dhe viktima të dhunës dhe trafikimit.

Nga të dhënat e SILC 2020, për shpërndarjen e përfitimit rezulton që rreth 80% e popullsisë në kuintilin e parë dhe të dytë mbulohen nga skema e ndihmës ekonomike.

Në kuadër të masave të marra për riintegrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune është ngritur mekanizmi i referimit për punësim e riintegrim social të anëtarëve në moshë aktive pune, nga zbatimi i të cilit janë punësuar dhe regjistruar në kurse të formimit profesional rreth 3,000 individë.

Për përmbushjen e prioritetit të dytë të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023, për personat me aftësi të kufizuar, si edhe në zbatim të Dokumentit Politik Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale 2019-2024 dhe Planit të Veprimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka reformuar sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Në zbatim të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në RSH” dhe Vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” të ndryshuar me VKM nr. 77, datë 02.02.2022, skema e vlerësimit bio-psiko-social po shtrihet në mënyrë progresive në të gjithë vendin, dhe ***deri ne Dhjetor 2022 do te jete e zbatueshme ne 12 qarqe te vendit***. Kriteret e vlerësimit bio-psiko-social të miratuara me Udhëzimin Nr. 21, datë 07.10.2016, janë të veçanta si për fëmijët dhe për të rriturit, duke sjellë një ndryshim cilësor për një vlerësim adekuat që ndikon te shërbimet e ofruara. ***Ne te gjithë vendin janë ngritur 36 komisione*** multidisiplinare me figura profesionale, mjekë dhe punonjës sociale, të cilat janë të aksesueshme dhe plotësojnë standardet e ofrimit të një shërbimi cilësor. Në kuadër të kësaj reforme janë zhvilluar fushata komunikimi si edhe janë ngritur kapacitetet e stafeve përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe të akredituara.

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar synon përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke integruar përfitimet në para me shërbime, të tilla si shërbimet e përkujdesjes sociale, shëndetësore, të arsimit, punësimit dhe formimit profesional, në bashkëpunim me të gjithë aktorët dhe strukturat e përfshira në nivel qendror, rajonal dhe vendor.

Pagesat e aftësisë së kufizuar, në kuadër të reformës janë rishikuar duke parashikuar më shumë nivele përfitimi, si për personin me aftësi të kufizuar (4 nivele përfitimi - aftësi e kufizuar e lehtë, e moderuar, e rëndë dhe e thellë) edhe për ndihmësin personal (2 nivele përfitimi), duke pasur në konsideratë shkallën e rëndesës së sëmundshmërisë në përputhje me funksionet jetësore të prekura, duke mbështetur me më shumë para ata që kanë një nivel më të rënduar të aftësisë së kufizuar. Mbështetja në para për shërbimin e ndihmës personal përcaktohet për ata persona që kanë nevojë

për ndihmë të herëpashërëshme dhe ata që kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme. Ofrimi i shërbimit të ndihmës personal është standardizuar me miratimin e VKM nr. 874, date 24.12.2019 “Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal”.

Fokus i veçantë në objektivin e tretë lidhet **me zhvillimin e shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror dhe komunitar** në kuadër të reformës së decentralizimit dhe deinstitutionalizimit.

Rregullimi dhe bërja funksionale e mekanizmit të financimit të Fondit Social ka sjellë zgjerimin e hartës së shërbimeve komunitare të ngritura sipas nevojave të vlerësuara të kategorive vulnerabël nga njësitë e vetqeverisjes vendore, bazuar në planet sociale vendore, tashmë të hartuara dhe të miratuara në 61 Bashkitë e vendit. Në këtë kontekst, janë ngritur 40 shërbime (27 në nivel bashkie dhe 13 shërbime të specializuara në nivel qarku) të mbështetura me një fond prej 539 mln ALL dhe ku përfitojnë 10,477 individë në nevojë.

Regjistri elektronik kombëtar i shërbimeve shoqërore, ku aktual janë 1875 përdorues, të trajnuar on-the-job-training, kanë arritur të menaxhojnë rreth 1152 raste për të gjitha grupet vulnerabël.

Me reformën institucionale në 21 bashki, janë ngritur njësitë e vlerësimit dhe referimit të rastit, ndërkohë që bashkitë e tjera janë duke plotësuar strukturat përkatëse për të mundësuar ofrimin e shërbimeve sociale. Procesi i Deinstitutionalizimit ka filluar me pilotimin e një shërbimi të ri “Fuqizimi i Familjes dhe Fëmijës” në dy Bashki Korçë dhe Vlorë, i cili po shoqërohet paralelisht me procesin e transformimit të shtëpive të foshnjës 0-5 vjeç, në shërbim komunitar të kujdesit alternative.

Në nënfushën mbi **Antidiskriminimi dhe Shanset e Barabarta**.

## **Sa i përket Barazisë Gjinore**

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030 ka patur arritje të rëndësishme në përparimin drejt barazisë gjinore si dhe në përpjekjet për adresimin në mënyrën e duhur të dhunës në familje e dhunës ndaj grave e vajzave në tërësi.

Zbatimi i legjislacionit për barazinë gjinore dhe kuotave ka rezultuar në një numër të lartë të përfaqësimit të grave e vajzave në politikë e vendimmarrje.

- 50 gra deputete nga 140 gjithsej ose 37.5%, shënuan në këtë legjislaturë një rritje me 3.2% krahasuar me 2017 – 2021.  
Kryetarja e Kuvendit dhe një nga dy nënkryetarë janë gra, ndërsa 50% e komisioneve të përhershme parlamentare drejtohen nga deputete gra.
- Në përbërjen e Qeverisë posti i zëvendëskryeministrit dhe 12 nga 16 ministritë drejtohen nga gra.
- Pushteti vendor: 8 nga 61 bashki drejtohen nga kryetare bashkie femra, duke shënuar një rritje prej 13% nga zgjedhjet e fundit vendore. Në Këshillat Bashkiakë gratë përbëjnë rreth 44%.

U ndërmorrën një sërë masash e veprimesh si një paketë e plotë me fokus rimëkëmbjen pas situatës së Covid-19, ku grate dhe vajzat ishin në qendër të vëmendjes. Dyfishimi e më pas trefishimi i mbështetjes ekonomike për rastet e dhunës në familje me urdhëra mbrojtës, vendosjes në prioritet të grave kryefamiljare, u kombinuan me funksionimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtje nga dhuna në familje e dhuna me bazë gjinore, ku vetëm për vitin 2021 u financuan nga Fondi Social mbi 10 shërbime të reja në të gjithë vendin. Aktualisht 34 shërbime operojnë si shërbime mbështetëse të specializuara për personat që përjetojnë situata vulnerabiliteti të dhunës me bazë gjinore ose të dhunës në familje, të organizuara në strehëza të përkohëshme (16 qendra në nivel qarku dhe bashkie) dhe shërbime rezidenciale në nivel kombëtar (2 qendra kombëtare). Në këto shërbime ofrohet: strehim, shërbim shëndetësor, ligjor, psikosocial, mbrojtjen, ofrim sigurie dhe shërbime anti-trafikimit, edukim, kujdes për fëmijët.

Operojnë gjithashtu 3 linja këshillimi dhe Qendrës Liliun, e para qendër e specializuar për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, e cila funksionon që prej dhjetorit 2018 iu shtuan gjatë vitit 2022 dy qendra të reja për trajtimin e dhunës seksuale dhe formave më të rënda të dhunës ndaj fëmijëve përkatësisht në Fier dhe Shkodër.

Që nga Janari 2022 në mbështetje të familjeve, grave e vajzave dhe kategorive në nevojë janë ndërmarrë një sërë masash:

- ✓ Është rritur Ndihma Ekonomike (NE) 20% për të gjitha familjet në nevojë, ku gratë janë përfituese.
- ✓ Dyfishuar pagesa për 15,000 familje me 3 e më shumë fëmijë
- ✓ Dyfishuar për 5700 familje me kryefamiljare gra të cilat kanë mbi 2 fëmijë
- ✓ Dyfishuar për 5200 anëtarë familje mbi 65 vjeç dhe pa pensione sociale
- ✓ Trefishuar për 771 jetimë, viktimat të dhunës në familje dhe viktimat të trafikimit viktimat e abuzimit seksual

Që nga viti 2019, bonusi i bebeve u shpërnda në më shumë se 35000 nëna.

Përdorimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor si praktikë përshpejtuese për tejkalimin e pabarazisë, diskriminimit, disavantazhimit e dhunës po synohet të shtrihet edhe në nivel vendor. Në PBA 2022-2024, pabarazitë gjinore në shëndetësi, arsim, bujqësi, shërbime sociale etj. trajtohen përmes 45 programeve buxhetore në 14 ministri, nga 75 programe gjithsej, e cila përbën rreth 9% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve buxhetore.

Ndërmarrja e masave për vaksinimin falas të vajzave ndaj virusit të Papiomës Humane është një politikë e re e ndërmarrë me qëllim mbrojtjen e shëndetit të vajzave dhe fuqizimin e tyre. Garantimi i paketave për trajtimin për kancerin e gjirit (të gjitha diagnozat) të ofruara në spitalet publike dhe vazhdimi i fushatave vjetore ndërgjegjësuese për kancerin e gjirit.

**Sa i përket mbrojtjes nga diskriminimi për personat LGBTI, miratimi i Planit të Veprimit LGBTI+, 2021-2027**



Shqipëria ka bërë progres drejt përmirësimit të kuadrit ligjor kombëtar për të drejtat e njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin, si dhe harmonizimin e këtij kuadri me atë ndërkombëtar, përfshirë të drejtat LGBTI+. Plani Kombëtar i Veprimit LGBTI+ 2021-2027, trajton çështjet e të drejtave, mbrojtjes dhe trajtimit të personave LGBTI+. Nëpërmjet bashkëpunimit me OJF-të-të e fushës ka vazhduar ndërgjegjësimi i profesionistëve dhe publikut sidomos për ndalimin e gjuhës së urrejtjes, e cila kulmon me fushatën IDAHOT në maj të çdo viti. Mbrojtja dhe mbështetja e personave që pësojnë situatë vulnerabiliteti si ato të dhunës ofrohet nëpërmjet shërbimeve si Qendra Streha, e mbështetur nga Fondi Social. Kjo Strehëz siguron strehim të sigurt, mbështetje psiko sociale, ligjore, referim në shërbime të tjera të specializuara etj. Në dy vitet e fundit rreth 173 përfitues që i përkasin të rinjve LGBTI kanë marrë shërbime në këtë qendër.

Policia e Shtetit, ka marrë masa për të garantuar liritë dhe të drejtat themelore të personave të privuar nga liria në ambientet e Drejtorive Vendore të Policisë, Komisariateve të Policisë, Personave të ndaluar/arrestuar që u përkasin komuniteteve të cënueshme si Rom, Egjiptian, LGBTI, etj u garantohen dhe respektohen të drejtat ligjore në mënyrë të barabartë, të njëjlojtë dhe pa diskriminim.

Policia e Shtetit ka përmirësuar sistemin kompjuterik të përpunimit të të dhënave statistikore, ku për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal, gjenerohet të dhëna të ndara edhe për veprat penale me motiv për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë, ka rishikuar i modulet e trajnimit për oficerët e policisë mbi rastet e komunitetit LGBTI bazuar në Manualin e Këshillit të Evropës “Hetimi i krimeve të urrejtjes që përfshijnë personat LGBTI”. Mbi 500 studentë në Akademinë e Sigurisë u trajnuan për përdorimin e këtij manuali.

## **Mosdiskriminimi**

Në lidhje me stigmën dhe diskriminimin, kuadri ligjor për mbrojtjen kundër diskriminimit në Shqipëri parashikon ndër të tjera përkufizime për forma të reja të diskriminimit (si diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, segregacioni, ngacmimi seksual, diskriminimi i strukturuar, nxitja dhe ndihma ndaj diskriminimit dhe qëllimi i deklaruar i diskriminimit), duke iu referuar praktikës ndërkombëtare si dhe rrethanave aktuale sociale. Format ekzistuese të diskriminimit, si rasti i “viktimizimit”, janë riformuluar gjithashtu (neni 3). Ligji Nr. 93/2014 përfshin gjithashtu dispozitat për diskriminim duke pasur parasysh edhe përshtatjen e arsyeshme.

Sa i përket barazisë dhe mosdiskriminimit të Romëve dhe Egjiptianëve

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021 – 2025” (miratuar me Vendimin nr. 701, datë 18.11.2021) prioritetet janë hartuar në përputhje me Kornizën strategjike të BE 2020 – 2030 për Romët për Barazi, Përfshirje

dhe Pjesëmarrje. Plani bazohet në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave.

Objektivat e Planit Kombëtar përgjatë periudhës 2021 – 2025 janë:

1. Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe egjiptianët.
2. Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve jo formale.
3. Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis Romëve dhe Egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë.
4. Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore.
5. Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët.
6. Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianeve në programet e mbrojtjes sociale.
7. Antixhopsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike si dhe përmes ndryshimeve sistemike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj R&E.
8. Bashkëpunimi dhe sinergji mes institucioneve dhe me shoqërinë civile.

Në Deklaratën e Partnerëve të Rajonit në Poznan, Shqipëria u angazhua për të zhvilluar standarde rajonale në lidhje me integrimin e romëve për politikat e synuara, si dhe rritjen e buxhetit publik (qendror dhe lokal) për integrimin e këtij komuniteti; krijimin e kanaleve mekanizmave zyrtarë për përfshirjen e përbashkët të qeverive lokale dhe komunitetit rom në formulimin e politikave, vendimmarrjes si dhe zbatimit dhe monitorimit të përpjekjeve të ndërmarra për arritjen e objektivave të kësaj Deklarate.

Shqipëria organizoi Seminarin e Pestë të Dialogut Politik Shqipëri-BE në prill 2022, me qëllim promovimin e përfshirjes së romëve dhe egjiptianëve. Rekomandimet e përbashkëta të seminarit të Dialogut të Përbashkët Shqipëri- BE të miratuara dhe zbatimi i tyre janë një prioritet. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale koordinon zbatimin e Rekomandimeve të përbashkëta në bashkëpunim me të gjithë aktorët përgjegjës dhe shoqërinë civile si partnerë.

Pavarësisht situatës post-Covid-19 dhe krizës në Ukrainë, mbështetje dhe pagesa sociale iu ofruan popullatës së marginalizuar në zonat urbane dhe rurale, nëpërmjet një rrjeti mbështetjeje nga institucionet qendrore dhe njësitë e Zhvillimi i Shërbimeve të Kujdesit Social parashikohet në Planet Sociale në të 61 bashkitë, të miratuara nga Këshillat Bashkiakë. Bazuar në nevojat e identifikuar, buxheti i shtetit për Fondin e Shërbimeve Sociale, që prej vitit 2019 ka vijuar të ofrojë shërbime të integruara dhe tipologji të reja në përgjigje të nevojave apo të pakicave rome dhe egjiptiane në qendrat komunitare.

Në 10 bashki janë zhvilluar Plane Veprimi në nivel vendor të synuara për Integrimin e pakicave R&E të mbështetura nga Romacted, të zbatuara nga Këshilli i Evropës. Bonusi për fëmijë i dhënë

për çdo të porsalindur të regjistruar ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve rome dhe egjiptiane.

Pabarazitë adresohen në politika të synuara për mos-diskriminimin për promovimin e barazisë, gjithëpërfshirjes në çdo sektor të Planit. Plani Kombëtar përmban një qëllim mbi antixhopsizmin, luftën kundër diskriminimit dhe qëndrimeve diskriminuese duke njohur dhe trajtuar antixhopsizmin në politikat publike.

**Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 34 vendime**, 1 rekomandim dhe 3 vendime me gjobë për moszbatim vendimi, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 11 vendime diskriminimi;
- 5 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime mosdiskriminimi;
- 11 vendime mospranimi;
- 3 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesave;
- 2 vendime pushimi për pamundësi të vazhdimit të shqyrtimit të çështjes.

**Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, janë si vijojnë:**

- Mungesa e aksesueshmërisë në objekte që ofrojnë të mira dhe shërbime, si p.sh.: Zyrat e Postës Shqiptare apo Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.
- Mungesa e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit;
- Aksesueshmëria në linjat e transportit publik, në qendrat e votimit në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2021 dhe në stadiumin “Air Albania”;
- Zgjidhja e marrëdhënieve të punësimit;
- Përfitimi i medikamenteve mjekësore.

### **Çështje të antidiskriminimit**

Gjatë 6 mujorit të I-rë të vitit 2022, Komisioneri është shprehur me **27 vendime**, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë **8** vendime diskriminimi; **6** vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore, **8** vendime mosdiskriminimi dhe **5** vendime mospranimi;

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, janë si vijojnë:

- Mungesa e aksesueshmërisë në objekte që ofrojnë të mira dhe shërbime, si p.sh.: Zyrat e Postës Shqiptare dhe TKOB;
- Aksesueshmëria në linjat e transportit publik, në qendrat e votimit dhe në stadiumin “Air Albania”;
- Përfitimi i pagesës për personat e verbër për periudhën shtesë të studimeve në arsimin e lartë;
- Refuzimi për të regjistruar në shkollat e arsimit profesional nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Përfitimi i medikamenteve mjekësore në QSUT.

Komisioneri gjatë vitit 2021 ka ndermjetësuar për përfitim të ndihmës ekonomike - Një grup përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë paraqitur pranë Zyrës Rajonale për të parashtruar ankesën e tyre, pas përjashtimit nga skema e ndihmës ekonomike. Në komunikim të vazhdueshëm me Administratorët e Rajoneve dhe Zyrën e Punës është bërë i mundur kthimi në skemë i disa anëtarëve që në mënyrë jokorrekte u ishte ndërprerë ndihma ekonomike.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 15 vendime dhe 1 rekomandim, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të racës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë: 4 vendime diskriminimi; 4 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore, 2 vendime mospranimi, 5 vendime mosdiskriminimi. Gjithashtu, është marrë edhe 1 sanksion me gjobë për shkak të moszbatimit të vendimit me diskriminim.

Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat janë drejtuar kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, konsistojnë në regjistrimin në arsimin parashkollor të fëmijëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian, përdorimin në media të shprehjeve diskriminuese nga persona që bëjnë pjesë në jetën publike të vendit, për të etiketuar persona të komunitetit egjiptian, vonesat në procesin e legalizimit të banesave të anëtarëve të komuniteteve rom dhe egjiptiane dhe mosfrimi e shërbimeve, nga ana e njësisve të vetëqeverisjes vendore (si p.sh.: ndihma ekonomike).

Gjatë 6 mujorit të I-rë të vitit 2022, Komisioneri është shprehur me 12 vendime, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të racës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë 5 vendime diskriminimi; 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi ankuesi është tërhequr nga ankimi, 3 vendime mospranimi, 3 vendime mosdiskriminimi;

Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat janë drejtuar kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, janë si vijojnë:

- Përdorimi në media i shprehjeve diskriminuese në median vizive, nga persona që bëjnë pjesë në jetën publike të vendit;
- Mosofrimi e shërbimeve, nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore (si p.sh.: strehimi, sigurimi i ujit të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave të zeza).

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është anëtar, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Komisioneri gjatë vitit 2021, ka trajtuar në total 10 çështje ku janë trajtuar problematikat që lidhen me fëmijët, nga të cilat 7 ankesa, 2 çështje të nisura kryesisht dhe një çështje e ardhur si informacion. Gjatë vitit 2021, Komisioneri ka përfunduar shqyrtimin e 9 çështjeve ku janë trajtuar problematikat e fëmijëve. Nga këto 9 çështje, Komisioneri është shprehur si vijon:

- 2 vendime për diskriminim në formën më të rëndë, në të cilat janë gjetur përgjegjëse dy subjekte në mënyrë solidare, QSUNT dhe MSHMS, lidhur me mospunimin e medikamenteve mjekësore të fëmijëve që vuajnë nga sëmundja e leucemisë dhe marrin trajtim pranë QSUNT-së.
- Në 3 raste, problematikat e adresuara janë zgjidhur gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës para Komisionerit dhe çështjet janë mbyllur pa një vendim përfundimtar pasi është arritur qëllimin për të cilin ishin paraqitur ankesat. Nga këto 3 raste për të cilat Komisioneri ka arritur qëllimin e ankesës, në 1 rast problematika lidhej me faktin e mospranimit në shkollë të një nxënëse për shkak të mbulesës/shamisë që mbante. Pas ndërmjetësimit të KMD-së, fëmijës I’u krijuan kushtet duke i dhënë akses në ndjekjen e mësimi si të gjithë nxënësit e tjerë. Në 2 rastet e tjera është ngritur pretendimi nga ana e prindit, lidhur me përfitimin e regjistrimit të fëmijës të pakicës rom, në kopësht pa pagesë. Pas ndërmedjetësimit të KMD-së, fëmijët u regjistruan në kopësht pa pagesë.
- 3 rekomandime ku subjekt kanë qenë fëmijët, nga të cilat, 2 (dy) rekomandime lidhen me regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në shkollë, kopshte dhe çerdhe. Për njërin çështje të nisur kryesisht, problematika lidhet me regjistrimin pa pagesë në kopshte dhe çerdhe të fëmijëve të komuniteteve rom dhe egjiptiane, ndërsa për çështjen tjetër të paraqitur nga një OJF, Komisioneri doli me një rekomandim për shmangien e segregimit në shkollat e qytetit të Elbasanit. Në një çështje të nisur kryesisht, Komisioneri i ka rekomanduar Bashkisë Elbasan marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin në mënyrë efektive të ngrohjes në Shkollën 9-vjeçare “Europa”, Bradashesh, Elbasan.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2022, në kuadër të çështjeve ku janë trajtuar problematikat që lidhen me fëmijët, Komisioneri ka pasur dy vendimmarrje. Të dy vendimet e marra nga Komisioneri gjatë kësaj periudhe kanë pasur të bëjnë me ndjekjen e arsimit nga ana e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

## **Policia e Shtetit**

Ka marrë masa për të garantuar liritë dhe të drejtat themelore të personave të privuar nga liria në ambientet e Drejtorive Vendore të Policisë, Komisariateve të Policisë, konform përcaktimeve në konventat ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe në veçanti të personave të arrestuar/ndaluar; Kushtetutës së vendit, Kodit të Procedurës penale dhe akteve të tjera nënligjore.

Përfaqësues të saj, janë pjesë e grupit ndërinstitucional të grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Planit Kombëtar 2021-2027 të Komunitetit LGBTI.

Personave të ndaluar/arrestuar që u përkasin komuniteteve të cënueshme si Rom, Egjiptian, LGBTI, etj u garantohen dhe respektohen të drejtat ligjore në mënyrë të barabartë, të njëjlojtë dhe pa diskriminim.

Të arrestuarve/ndaluarve në ambientet e Policisë së Shtetit (*përfshi dhe ata të komuniteteve Rom, Egjiptian, LGBTI*), sipas nenit 115 të Ligjit 108/2014 për Policinë e Shtetit, i ndryshuar u njihet dhe u garantohet ushtrimi i të drejtës për të bërë/paraqitur kërkesë / ankesave lidhur me trajtimin që ju bëhet në ambientet e policisë, kushtet e qëndrimit, veprimet e sjelljet e personelit policor, shkelet e cënimit e të drejtave që mund tu bëhen nga personeli policor etj.

Zhvillimet ligjore për periudhën aktuale **në fushën e sigurimeve shoqërore** janë paraqitur si më poshtë vijon:

**Gjatë vitit 2021** janë miratuar VKM të mëposhtme:

- VKM nr. 196, datë 31.3.2021, “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”;
- VKM nr. 432, datë 15.07.2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”;

Si dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Udhëzim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. 6, datë 6.4.2021 “Për zbatimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 31.3.2021, “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së Vlerësuar”

**Gjatë vitit 2022** janë miratuar VKM të mëposhtme:

- VKM nr. 188, datë 30.3.2022, “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”;
- VKM nr., 159, datë 12.3.2022, “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë”;
- VKM nr. 605, datë 14.09.2022 “Për indeksimin e pensioneve”;
- VKM nr. 654, datë 10.10.2022 “Për një ndryshim në VKM nr. 605, datë 14.9.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për indeksimin e pensioneve”.

*Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*

Në kuadër të koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, në pajtim me nenin 48 të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, është ndërmarrë angazhimi për të koordinuar skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për të siguruar lirinë e lëvizjes së shtetasve shqiptarë dhe gjithashtu të drejtën e punëtorëve për të mbrojtur dhe garantuar elementët e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Procesi i koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore (shëndetësore) me vendet e tjera është një nga angazhimet për t'u bërë pjesë e familjes evropiane.

Marrëveshjet dypalëshe mbi **sigurimet shëndetësore** ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve përkatëse janë ratifikuar dhe kanë hyrë në fuqi me:

- Ligjin nr. 9066, datë 15.5.2003, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;
- Ligjin nr. 35/2014, datë 3.4.2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;
- Ligjin nr. 42/2015, datë 16.4.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligjin nr. 123/2015, datë 12.11.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligjin nr. 151/2015, datë 21.12.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për mbrojtjen shoqërore”;
- Ligjin Nr. 23/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Mbrojtjen Shoqërore dhe të Protokollit përfundimtar të saj”;
- Ligjin Nr. 34/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për Mbrojtjen Shoqërore”.

Pritet të hyjë në fuqi marrëveshja dypalëshe me:

- Rumaninë, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 42 datë 14.04.2016.

Ndërkohë, në datat 21-22 shtator 2022, në Tiranë ka përfunduar raundi i parë i negociatave me Republikën e Kroacisë.

#### 19.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni përgjegjës për kapitullin 19 është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

Institucione të tjera kontribuuese për Kapitullin 19 janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHS), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Agjencia Kombëtare për Edukimin, trajnimin Profesional dhe Kualifikimet Ministria e Brendshme (AKETK), Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF), Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Ministria e Brendshme (MB); Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Instituti i

Statistikave (INSTAT), Zyra e Avokatit të Popullit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Në ndihmë të koordinimit të punës së institucioneve përgjegjëse për kapitullin 19 në aspektin financiar dhe për të dhënat statistikore, ka angazhim të veçantë nga ministria përgjegjëse për fushën e financave (MFE) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT).

Në ndihmë të koordinimit të punës midis institucioneve ndërkombëtare dhe institucioneve përgjegjëse për kapitullin 19 është ngritur Sekretariati i Integritimit Evropian nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEFA).

#### 19.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar të zhvillojë një politikë punësimi dhe sociale që është në përputhje me kërkesat dhe praktikat më të mira të BE-së, duke investuar në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social, si një nga shtyllat kryesore të vizionit të saj strategjik parësor për t'u bërë anëtare e Bashkimi Evropian.

Objektivat kryesore të Shqipërisë për sa i përket politikave të punësimit dhe sociale përfshijnë:

- Intensifikimin e përpjekjeve për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes sociale, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, forcimin e aftësive dhe burimeve të pushtetit vendor për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e tyre;
- Zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit me fokus grupet më vulnerabël;
- Miratimin e një Planit Kombëtar të Garancisë Rinore që të adresojë kryesisht NEET.

Prioritetet në fushën e **mbrojtjes sociale** janë:

- Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale për 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit;
- Vijimësia e zbatimit të “strategjisë së daljes” që mundëson ri-integrimin shoqëror të përfituesve të NE.
- Programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç.
- Konsolidimi i skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të saj.
- Zgjerimi i hartës dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve komunitare shoqërore;
- Vijimësia e procesit të Deinstitutionalizimit që synon zëvendësimin e qendrave rezidenciale me shërbimet të kujdesit social alternative komunitare;
- Vendosja e lidhjeve dhe integrimi më i mirë ndërmjet politikave aktive të punësimit dhe politikave të mbrojtjes sociale.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (NSPS 2015 – 2023), procesi i zhvillimit institucional u bazua në një rishikim të plotë të funksioneve ekzistuese të programeve



të bazuara në cash (NE dhe aftësisë së kufizuar), si dhe funksioneve të menaxhimit të shërbimeve të kujdesit social. Pushtetet vendore kanë një rol parësor në ngritjen dhe menaxhimin e shërbimeve të kujdesit social që ofrojnë për personat vulnerabël.

Reforma e kujdesit social inicioi me miratimin e Ligjit 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror, i cili i- përcaktoi shportën e shërbimeve, me fokus shërbimet komunitare (VKM 518/2018); ii- përcaktimin e roleve të pushtetit qendror dhe atij vendor, që synon ngritjen e njësive të vlerësimit dhe referimit të rasteve; iii- ngritjen dhe funksionimin e një sistemi elektronik të integruar të shërbimeve shoqërore (VKM 136/2018); krijimin e një mekanizmi mbështetës financiar (Fondi Social krijuar me VKM 111/2018 dhe metodologjia e llogaritjes/shpërndarjes së fondeve VKM 150/2019) për të mundësuar mbulimin më të mirë të nevojave të individit/familjes me ofrimin e shërbimeve më pranë tyre.

Zbatimi i refomës ka shënuar progres duke: 1) zgjeruar hartën e shërbimeve: aktualisht ofrohen 339 shërbime sociale, krahasuar me 228 shërbime të ofruara në vitin 2019; 2) rritur numrin e përfituesve; 42.553 përfitues për vitin 2021 krahasuar me 10.000 përfitues në vitin 2019, që do të thotë se përqindja e popullsisë që merr paketën bazë të shërbimeve të kujdesit social është rritur nga 0.2% në 2019 në 0.5% në 2021; 3) të 61 Bashkitë kanë hartuar/miratuat Planet Sociale vendore; 4) në kuadër të Fondit Social janë krijuar 40 shërbime (27 në nivel bashkie dhe 13 shërbime të specializuara në nivel qarku) të mbështetur nga një fond prej 539 milionë lekësh dhe në të cilat përfitojnë 10,477 individë në nevojë.

Edhe pse zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Deinstitutionalizimit 2020-2022 (miratuar me VKM 706/2020) ka shënuar progress, mbetet një çështje e ndjeshme transformimi i qëndrave të kujdesit rezidencial, pasi kujdesi alternativ për fëmijët nuk ekziston në të gjitha bashkitë, çka ngadalëson ribashkimin e fëmijëve me familjet e tyre biologjike, aty ku është e mundur, ose vendosjen në e tyre në kujdestari. Nevojitet rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe ndryshimi i qëndrimit dhe mendësisë së përgjithshme ndaj institucionalizimit, duke promovuar edhe Shërbimin e Kujdestarisë Profesionale.

Sfidat e politikës të zhvillimit të shërbimeve shoqërore lidhen me krijimin e një sistemi funksional të integruar të kujdesit shoqëror të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale.

Konkretisht:

- Përpjekjet financiare dhe administrative duhet të rriten për të forcuar kapacitetet e nivelit lokal për ofrimin e shërbimeve
- Transformimi i shërbimeve rezidenciale në shërbime të kujdesit alternativ shoqëror të integruara komunitar ative, duke respektuar standardet e ofrimit të tyre.
- Plotësimi dhe fuqizimi i të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore me strukturat e shërbimeve sociale/Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.
- Integrimi i shërbimeve në nivel vendor, duke trajtuar rastin nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Shërbimeve të Kujdesit Social.

#### Masat Prioritare të Politikës:

- ✓ Zgjerimi i hartës së shërbimeve sociale nëpërmjet ngritjes së shërbimeve sa më pranë komunitetit nëpërmjet mekanizmit financiar të Fondit Kombëtar Social
- ✓ Transformimin gradual i shërbimeve të përkujdesit rezidencial për fëmijë në shërbime alternative me bazë komunitare për fuqizimin e individit dhe familjes, në kuadër të reformës së decentralizimit dhe deinstitutionalizimit.
- ✓ Sigurimi i referimit dhe manaxhimit të rasteve nëpërmjet Sistemit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore nga të gjitha bashkitë e vendit.
- ✓ Përmirësimi i aftësive operacionale për shpërndarjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin e shërbimeve të kujdesit social.

#### Sa i përket fushës së barazisë gjinore, në fokus është:

- Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave nga të gjitha grupet, nëpërmjet mbështetjes për krijimin e kushteve të favorshme për pjesëmarrjen e tyre në tregjet ekzistuese; ngritja e kapaciteteve për t'u dhënë atyre akses më të mirë në punësim; pjesëmarrje në vendimmarrjen ekonomike; mbështetje për gratë dhe vajzat sipërmarrëse që zbatojnë ide inovative me fokus në dixhitalizimin dhe ekonominë mjedisore.
- Mbështetje nga sigurimet shoqërore për nënat e papuna me 3 e më shumë fëmijë
- Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave, të rinjve dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre në vendimmarrjen politike dhe publike në nivel vendor, duke respektuar kuotat për barazinë gjinore dhe promovimin e modeleve pozitive.
- Mbrojtje më e mirë e grave, burrave, grave të reja, të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmi, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, nëpërmjet: Krijimit i programeve të dedikuara për rehabilitimin e shkelësve, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit, përvojat ndërkombëtare dhe praktikave të mira ekzistuese në vend; ngritja dhe përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat/të mbijetuarit e DHBGJ-së të përshtatura sipas nevojave të tyre.
- Fushata ndërgjegjësuere kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje, stereotipeve gjinore gjatë gjithë vitit.

#### Në lidhje me komunitetin e LGBTI, prioritetet janë:

- Shërbime të specializuara mbështetëse të aksesueshme dhe të disponueshme për personat LGBTI+ në të gjithë vendin.
- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve: kujdesi shëndetësor dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit social profesionistë, të vetëdijshëm dhe të gatshëm për të ofruar shërbime miqësore dhe sipas standardeve për personat LGBTI+.
- Zhvillimi i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit të publikut IDAHOT në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, përmes partneritetit të mbyllur me institucionet në nivel qendror dhe vendor, OJF dhe partnerë ndërkombëtarë.

- Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë, përfshirjes dhe mosdiskriminimit ndaj personave LGBTI+.
- Forcimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTI+ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës, nëpërmjet rishikimit dhe harmonizimit të legjislacionit kombëtar me standardet evropiane/ndërkombëtare.

Në lidhje me **Fëmijët**, prioritetet janë:

- ✓ Zbatimi i “Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026” i miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave datë 03.11.2021;
- ✓ Funksionimi i një sistemi mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët nëpërmjet përmirësimit të kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve. Forcimi i kapaciteteve të mekanizmave dhe shërbimeve për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve.
- ✓ Përmirësimi i mekanizmave dhe shërbimeve specifike dhe të integruara për të trajtuar format më të rënda të dhunës, duke përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin në internet.
- ✓ Hartimi i raportit të monitorimit në zbatim të qëllimeve strategjike të përcaktuara në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, për vitet 2021-2022
- ✓ Fuqizimi i skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomikisht.

Për çështjet e **Sigurimeve Shoqërore** prioritetet kryesore mbeten:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elemente të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme;
- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës dhe zhvillimi i kapaciteteve të ISSH-së, implementimi gradual i projekteve të nisura për ngritjen e një sistemi kompleks e të automatizuar informacioni për plotësimin e funksioneve të sigurimeve shoqërore edhe për të tretët;
- Mbështetje e shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit, përmes koordinimit të skemave të mbrojtjes sociale me vendet e BE-së edhe më tej duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.

Sa i përket **përfshirjes sociale dhe personave me aftësi të kufizuara**, prioritetet janë:

- Analiza dhe harmonizimi i të dhënave për përfshirjen sociale për grupet në nevojë
- Përmirësimi i legjislacionit për personat me Aftësi të Kufizuar
- Ligji për Përfshirjen dhe aksesueshmërinë të monitorohet për zbatim.
- Raporti afatmesëm i Planit Kombëtar për person me Aftësi të Kufizuar

Në kuadër të planit të veprimit të rishikuar të **Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive** 2019 - 2022 janë parashikuar, si prioritare:

- Nxitja e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës;
- Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;

- Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial;
- Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve.
- Zvogëlimi i mospërputhjes së aftësive dhe rritja e nivelit të saj për të gjithë popullsinë në moshë pune dhe për të gjitha profesionet dhe funksionimi më i mirë i tregut të punës për të gjithë

Në lidhje me kërkesat e **shëndetit dhe sigurisë në punë**, objektivi kryesor mbetet zbatimi i politikave dhe ligjeve më të mira dhe më të dobishme për SSHP, të cilat mund të zbatohen në mënyrë efektive duke zhvilluar një sistem më eficient inspektimi dhe menaxhimi të SSHP.

Në fushën e legjislacionit të punës prioritetet do të jetë përmirësimi i zbatimit të tij në sektorin publik dhe atë privat.

Në lidhje me zhvillimin e **dialogut social** ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve objekti kryesor mbetet promovimi i avantazheve të zgjidhjes paragjyqësore të konflikteve në punë; aftësimi i punëmarrësve dhe punëdhënësve për negociim dhe parandalim të mosmarrëveshjeve në punë; përmirësim i efektivitetit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe pajtimit të mosmarrëveshjeve kolektive në punë.

Gjithashtu, rendisim prioritetet, si më poshtë:

- Ngritja e një sistemi monitorimi në mënyrë që Këshilli Kombëtar i Punës të vlerësojë shkallën në të cilën rekomandimet e saj janë marrë në konsideratë/zbatuar nga Këshilli i Ministrave.
- Përmirësimi i procedurave të ndërmjetësimit/pajtimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kolektive të punës, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të shpejtë.
- Ngritja e kapaciteteve të ndërmjetësve të Zyrave të Punësimit nëpërmjet trajnimeve për bazën e të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve, për marrëveshjet kolektive dhe Sindikatat.
- Nxitja dhe zhvillimi i dialogut social në Këshillin Kombëtar të Punës për konsultimin e çështjeve në interes të Organizatave të Punëdhënësve dhe Punëmarrësve.
- Zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve kolektive të punës nëpërmjet procedurave të ndërmjetësimit dhe pajtimit.

## KAPITULLI 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

### 20.1 Përmbajtja e kapitullit

Politika industriale e BE-së kërkon të promovojë strategji industriale që rrisin konkurrencën duke përsheptuar përshtatjen ndaj ndryshimeve strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit në të gjithë BE-në, si dhe investimet vendase dhe të huaja. Ajo

synon gjithashtu të përmirësojë mjedisin e përgjithshëm të biznesit në të cilin operojnë Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

Ajo përfshin privatizimin dhe ristrukturimin (shih gjithashtu Kapitullin 8-Politika e konkurrencës). Politika industriale e BE-së përbëhet kryesisht nga parimet e politikave dhe komunikimet e politikave industriale, forumet e konsultimit të BE-së dhe programet e Komunitetit, si dhe komunikimet, rekomandimet dhe shkëmbimet e praktikave më të mira në lidhje me NVM-të që synojnë të përmirësojnë formulimin dhe koordinimin e politikave të ndërmarrjeve në tregun e brendshëm mbi bazën e një përkufizimi të përbashkët të NMV-ve. Zbatimi i politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale kërkon kapacitete të përshtatshme administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.

## 20.2 Struktura e kapitullit

- Politika industriale – Operacionet sektoriale
- Privatizimi dhe ristrukturimi
- Mjedisi i biznesit
- Politika e NVM-ve

## 20.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi mes BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikat e ndërmarrjeve dhe atyre industriale rregullohet në disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Së pari, **neni 86** përcakton se bashkëpunimi do të synojë të kontribuojë në potencialin për zhvillim dhe rritje të Shqipërisë. Masat do të hartohen për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në Shqipëri. Këto masa do të marrin parasysh bashkëpunimin rajonal.

**Neni 91** përcakton se palët (si BE dhe Shqipëria) do të synojnë të sjellin një klimë të favorshme për investimet private të cilat janë vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë.

**Neni 92** përqendrohet në bashkëpunimin industrial që mbulon modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë shqiptare, forcimin e sektorit privat, bashkëpunimin ndërmjet operatorëve ekonomikë etj. Bashkëpunimi industrial do të marrë parasysh edhe aspektet rajonale të politikave industriale. *Acquis* e BE-së do të përafrohet gjithashtu.

**Neni 93** i dedikohet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe synon të fokusojë bashkëpunimin BE-Shqipëri në zhvillimin dhe forcimin e NVM-ve duke marrë parasysh Aktin e Biznesit të Vogël, etj.

**Neni 94** trajton turizmin si një sektor të veçantë të industrisë. Neni 94 parashikon forcimin e rrjedhës së informacionit mbi turizmin dhe transferimin e njohurive. *Acquis* në lidhje me turizmin duhet të përafrohet gjithashtu.

Së fundi, **Neni 70** i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përcakton detyrimin e përgjithshëm të Shqipërisë për të përafuar legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së.

Në lidhje me kërkesat e BE-së, politikat në këtë Kapitull hyjnë nën grupin e III<sup>70</sup> të kompetencave të BE-së, d.m.th nën fushat ku BE mund të mbështesë, koordinojë ose plotësojë aktivitetet e vendeve anëtare dhe ku BE nuk ka të drejtë të kalojë akte ligjërish të detyrues. Shtetet anëtare kanë ende kompetenca ekskluzive në këto politika, ndërsa BE mund të mbështesë përmirësimin e tyre. Dokumenti më i rëndësishëm për politikën industriale të BE-së është “Evropa 2020: Strategjia për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse”<sup>71</sup>, e cila paraqet dokumentin kuadër të zhvillimit industrial të BE-së.

Instrumentet e politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale janë zhvilluar në programin e BE-së për Tregun e Përbashkët (SMP). Programi ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet dhe politikë-bërësit dhe fokusohet në veprimet që promovojnë fokusohet në financa, hyrjen në tregje, sipërmarrjen, shërbimet e mbështetjes së biznesit siç është Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve, zhvillimi i politikave më të mira në mbështetje të NVM-ve, mbrojtja e konsumatorit etj. Një instrument i rëndësishëm politik është Direktiva 2011/7/BE për luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Programet e politikave hapësinore të BE-së janë gjithashtu pjesë e këtij kapitulli, pasi ato kontribuojnë në përmirësimin e konkurrueshmërisë së BE.

Për sa i përket kërkimit dhe inovacionit, referenca kryesore është kapitulli XIX i Traktatit (TFEU) me dispozitat e kërkimit, duke përfshirë dispozitat specifike të asociimit, kërkesat e Zonës Evropiane të Kërkimit, reformat kombëtare dhe Semestrit Evropian, “Open Science” dhe “Open Access”, Politikat “Open Access”, Programi i ardhshëm “Horizon Europe”, Integriteti i Kërkimit, etj.

#### 20.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur.

Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021 – 2027, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 4466, datë 30.07.2021, përbën kuadrin strategjik për zhvillimin dhe

---

<sup>70</sup> Grupi i parë i politikave përfshin kompetencat ekskluzive të BE-së (ku aktet detyruese ligjore miratohen në nivelin e BE-së), ndërsa kompetencat e përbashkëta (si BE-ja, ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjërish të detyrueshme; vendet anëtare mund ta ushtrojnë këtë të drejtë vetëm kur BE nuk mund të veprojë ose ka zgjedhur të mos veprojë) bie nën grupin e dytë. Më shumë informacion mbi: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=URISERV:ai0020&from=EN>

<sup>71</sup> Evropa 2020: Një strategji për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, / \* COM / 2010/2020

mbështetjen e ndërmarrjeve dhe investimeve në Republikën e Shqipërisë. Tre objektivat kryesore të saj janë (i) Tërheqja dhe Ndërkombëtarizimi i Investimeve; (ii) Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni (iii) Zhvillimi i kapitalit njerëzor.

Strategjia BIDS 2021 – 2027 është në përputhje me strategjitë dhe programet gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015 – 2020, Programin e Reformës Ekonomike (ERP), si dhe në nivel ndërkombëtar me Planin e Veprimit për Tregun e Përbashkët 2021 – 2024 (CRM) për Ballkanin Perëndimor dhe Strategjinë e re të BE-së për NVM-të.

Gjatë vitit 2022, ligji nr. 43/2022, datë 21.04.2022 “Për zhvillimin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë dhe u botua në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 20.05.2022. Qëllimi i këtij ligji është rritja e politikave mbështetëse shtetërore, si dhe krijimi i një kuadri të ri institucional dhe rregullator për mbështetjen e ndërmarrjeve.

Për zbatimin e ligjit nr. 43/2022, datë 21.04.2022, janë miratuar aktet e mëposhtme ligjore:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 29.7.2022 “Për krijimin, organizimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të Bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënien e granteve”. Qëllimi i këtij akti është të përcaktojë rregullat për krijimin, organizimin e Bordit të Vlerësimit, si dhe përshkrimin e detajuar të procedurës konkurruese për grantet për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, në përputhje me përcaktimet e nenit 11 të këtij ligji (Ligji Nr. 43/2022);
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2022”. Ky Vendim i Këshillit të Ministrave synon të mbështesë sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në fushën e digjitalizimit;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 29.7.2022 “Për kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”.

*Përsa i përket instrumenteve të politikës industriale*, Shqipëria filloi negociatat me Komisionin e BE-së për përgatitjet e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian, nga njëra anë dhe Shqipërisë, nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit, Programi i Tregut të Vetëm. Më pas, Shqipëria ka zbatuar rekomandimet e OECD në “Small Business Act”.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ofron instrumente financimi për të stimuluar sipërmarrjen në inovacion, konkurrencë, start-up dhe zeje, për të mbështetur prodhimin e tarifave nën regjimin e përpunimit aktiv dhe konkurrencës. Në të ardhmen do të miratohen instrumente të reja të cilat do t'u përshtaten nevojave të reja të NVM-ve.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) me mbështetjen e BERZH krijoi dhe është në menaxhim të vazhdueshëm të platformës “Access to Finance” për t'i shërbyer MSME-ve, të

cilat duan të zgjerohen dhe investojnë në aktivitetin e tyre, duke përfituar nga mundësitë financiare që ofron tregu ndërkombëtar, me grante, kredi apo iniciativa të tjera financimi.

Pas Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 540, datë 29.07.2022 “Për shumën e grantit, kriteret dhe kushtet e veçanta të përfitimit të grantit për sipërmarrjet mikro, të vogla, të mesme” më 31 Gusht 2022, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka shpallur thirrjen për “Fondin për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme”.

Ky fond ka në fokus digjitalizimin e bizneseve shqiptare, si një nga mënyrat kryesore për të ruajtur konkurrueshmërinë në treg, për të qenë sa më koherent, si dhe për të arritur sa më shumë klientë potencialë nëpërmjet platformave digjitale. Thirrja qëndroi e hapur për aplikime deri në 21 Tetor 2022. Njësia menaxhuese e grantit pranë AIDA-s, ka përfunduar rishikimin e 480 aplikimeve të mbërritura dhe përmbushjen e kriterëve të përgjithshme. Pas verifikimit, aplikimet i janë dërguar Bordit të Vlerësimit për vlerësim.

Instrumenti i SME-ve në kuadër të programit Horizont Evropian 2020 synoi të mbështeste ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) me ide inovative për të sjellë në treg produkte, shërbime dhe modele të reja biznesi. Shqipëria mori pjesë në programin Horizon 2020 si vend i asociuar. Pjesëmarrja e saj në Horizon 2020 u përmirësua ndjeshëm dhe treguesit janë në rritje. Në kuadër të këtij Programi, AKKSHI (NASRI), organizuar 160 ditë informimi dhe trajnimi. Disa nga këto aktivitete u organizuan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Kërkimit dhe Inovacionit të Komisionit Evropian, Agjencinë Ekzekutive të Kërkimeve, Agjencinë për Promovimin e Kërkimeve Evropiane (APRE), etj. Performanca e Shqipërisë në Programin Horizon 2020 nga viti 2014, ka përmbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor 2017 – 2022, rritje të aplikimeve dhe projekteve të fituara me më shumë se 10% në vit.

“Ditët Informative” që janë zhvilluar, kanë ndikimin e tyre në përmirësim. Workshope, seminare si dhe informacione të Buletineve që Agjencia (NASRI) u dërgon periodikisht aplikantëve sipas bazës së të dhënave të tyre. Kjo bazë të dhënash përfshin afërsisht 3,900 studiues të përpiluar nga agjencia me të dhëna sasiore dhe cilësore. Në këtë kontekst, NASRI do të vazhdojë të koordinojë dhe promovojë Horizon Europe, i cili është programi i radhës kuadër i kërkimit dhe inovacionit.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Kërkimin, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022, e cila pasqyron dhe përfshin gjashtë Prioritetet ERA, AKSHI ka vazhduar të koordinojë dhe promovojë programet Horizon Europe, MSCA, COST, EURAXESS, Kartën dhe Kodin, HRS4R dhe CEEPUS.

Aktualisht po hartohet strategjia e re Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023 – 2030 e cila pasqyron, ndër të tjera, standardet e akteve ndërkombëtare si më poshtë:

- a) Agjenda e Ballkanit Perëndimor për Inovacion, Kërkim, Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
- b) Qasja Globale Evropiane ndaj Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit: Strategjia Evropiane për bashkëpunim ndërkombëtar në një botë në ndryshim;



- c) Strategjia Evropiane për Kërkim dhe Inovacion 2020 – 2024 dhe Plani Strategjik i BE-së për Kërkim dhe Inovacion 2020 – 2024;
- d) Parimet e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA);
- e) qarkullimi, aksesimi dhe transferimi optimal i njohurive shkencore, duke përfshirë “qarkullimin e njohurive” dhe “qasjen e hapur”;
- f) bashkëpunimi ndërkombëtar;
- g) Agjenda e Politikave të Zonës Evropiane të Kërkimit: Përmbledhje e Veprimeve për periudhën 2022 – 2024;
- h) Programi i ri Kuadër Evropian për Kërkim dhe Inovacion “Horizon Europe”.

Ministria e Arsimit dhe Sportit në koordinim me Akademinë e Shkencave është duke punuar për draftin e parë të projektligjit për shkencën. Qëllimi i këtij projektligji do të jetë krijimi i kushteve për funksionimin e një sistemi modern të kërkimit shkencor dhe inovacionit, si dhe mundësia e financimit të kësaj veprimtarie nga burime të ligjshme.

Projektligji po hartohet në përputhje me parimet kryesore të ERA-s, parimet e shkencës së hapur, efikasitetit, transparencës, mundësive të barabarta, konkurrencës, etikës dhe përgjegjësisë për arritjen e qëllimeve, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen të pronësisë intelektuale dhe të drejtës së autorit.

QKB funksionon si një qendër me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit, si dhe të regjistrimit të pronarëve përfitues. QKB ka mundësuar krijimin e modelit të konsolidimit të shërbimeve të biznesit në një dritare të vetme shërbimi, për të reduktuar maksimalisht vizitat fizike në shumë institucione dhe për të lejuar unifikimin e mëtejshëm të shërbimeve nëpërmjet sistemit online. Gjithashtu, krijimi i one-stop shop për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve dhe për regjistrimin e pronarëve përfitues ofron thjeshtësi për biznesin, jo vetëm për regjistrimin dhe licencimin dhe regjistrimin e pronarëve përfitues, por edhe duke ofruar nëpërmjet kësaj qendre një proces të unifikuar konsultimi për regjistrimin dhe licencimin e biznesit dhe për regjistrimin e pronarëve përfitues, si dhe mbi kërkesat dhe kriteret e regjistrimit të pronarëve përfitues. Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, Qeveria e Shqipërisë ka krijuar një grup pune për reformën rregullatore në fushën e licencimit. Në kuadër të kësaj reforme, grupi i punës ka propozuar heqjen e 22 licencave dhe përmirësimit e mëtejshëm të procesit të licencimit, duke ri-klasifikuar licencat e mbetura ose duke ulur periudhën e vendimmarrjes për 49 licencat e tjera. Aktualisht janë hequr 11 licenca. Më konkretisht:

1. Licenca "Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)", me kodin II.2.A.2
2. Licenca “Prodhimi dhe tregtimi i farërave dhe fidanëve”, me kodin II.4 –
3. Licenca “Veprimtari ekspertize lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.A
4. Licencë “Ekspertiza dhe/ose shërbime profesionale në lidhje me pyjet apo kullotat”, me kodin III.7.A.
5. Licenca “Ekspertizë dhe/ose shërbime profesionale në lidhje me burimet minerare”, me kodin IV.4.A.
6. Licencë “Ekspertizë dhe/ose shërbime profesionale në lidhje me burimet hidrokarbure”, me kodin IV.4.B.

7. Licenca “Tregtia e pjesëve të këmbimit të mjeteve motorike dhe/ose rimorkiove të autorizuara nga prodhuesi”, me kodin VII.3.B.3.
8. Licenca “Agjencitë që merren me praktikat e qarkullimit të mjeteve motorike dhe/ose rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4.
9. Licenca “Shërbimi Përbarimor Privat”, me kodin XI.2.
10. Licenca “Auditor Energjetik”
11. Licenca “Shërbime energjetike”

Në kuadër të reformës së ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare për digjitalizimin e shërbimeve publike, duke nisur nga viti 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për ofrimin e shërbimeve të saj në fushën e regjistrimit dhe licencimit të bizneseve, si dhe regjistrimin e pronarëve përfituesve online nëpërmjet portalit të qeverisë e-Albania.

Aktualisht, duke filluar nga data 1 maj 2022, të gjitha shërbimet e QKB-së ofrohen online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, me procedura të thjeshta, brenda afateve të shkurtra dhe pa kosto për biznesin.

Digjitalizimi i shërbimeve qeveritare ka zvogëluar barrën administrative për NVM-të. Platforma e-Albania, i menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), lejon që bizneset të kryejnë më shumë se 700 shërbime përkatëse online. Veçanërisht, taksat mund të paraqiten dhe paguhën në internet, duke sjellë uljen e barrës rregullatore për NVM-të.

Përveç dhënies së mundësisë së pagesës së taksave online, subjektet kanë mundësinë e gjenerimit të vërtetimeve të ndryshme në kohë reale dhe me vulë elektronike, që u jep vlerë të plotë ligjore. Ndër vërtetimet që gjenerohen nëpërmjet portalit e-Albania mund të përmenden:

- Vërtetim për pagim detyrimesh
- Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti
- Vërtetim për përgjegjësitë tatimore
- Vërtetim për posedim mjeti
- Vërtetim për regjistrim të investitorit
- Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)
- Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit

Vetëm për periudhën janar – tetor 2022 numri total i aplikimeve për shërbimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka qenë 1,318,693 aplikime.

Në kuadër të reformës së ndërmarrë nga Qeveria shqiptare për digjitalizimin e shërbimeve qeveritare, një pjesë e shërbimeve funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit ofrohen vetëm online nëpërmjet platformës qeveritar e-Albania dhe nga vitit 2020, të gjitha shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit ofrohen vetëm online nëpërmjet platformës qeveritar e-Albania, dhe për aplikimet online tarifa e aplikimit është 0 ALL.

Ndër shërbimet kryesore që ofrohen online nëpërmjet platformës e-Albania, dokumentet e të cilave gjenerohen në kohë reale mund të përmendim:

- Certifikatë Regjistrimi
- Lëshim i titullit të licencës/lejes
- Ekstrakt për të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues
- Ekstrakt i thjeshtë/historik (Biznes)
- Ekstrakt i thjeshtë/historik (Qytetar)

Ndërsa dy prej shërbimeve që u vijnë në ndihmë subjekteve për depozitimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit, në përputhje me legjislacionin për përmbushjen e detyrimeve, janë “Depozitimi i pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit” që ofrohet për të gjitha subjektet me administrator shqiptare dhe “Depozitimi i pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit (për subjektet me administrator të huaj)”.

Vetëm për periudhën janar – tetor 2022 numri total i aplikimeve për shërbimet e Qendrës Kombëtare të Biznesit ka qenë 734 100 aplikime.

Gjithashtu gjatë këtij viti, në platformën e-Albania ofrohen online dhe dy shërbimet “Pasaporta e Startup-it / Start-up Passport” dhe “Pasaporta e lehtësuesit / Facilitator’s passport”, të cilat u vijnë në ndihmë startup-eve të vetëdeklarohen në regjistrin elektronik të startup-eve dhe në regjistrin elektronik të lehtësuesve me qëllim krijimin e mundësisë për mbështetje me grant.

Numri total i aplikimeve deri më tani për të dyja shërbimet e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është 1 584 aplikime.

Falimenti në Republikën e Shqipërisë rregullohet me Ligjin nr. 110/2016 “Për falimentimin” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij. Kuadri i përgjithshëm i inspektimeve rregullohet me Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe me akte të tjera të nxjerra në zbatim të tij. Veprimtaria e autoriteteve sektoriale të inspektimit rregullohet me akte të veçanta ligjore. Nga janari 2019, të gjitha projektligjet që plotësojnë kriteret përkatëse i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit rregullator.

*Në lidhje me mësimin e aftësive sipërmarrëse, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka ndërmarrë reformën e kurrikulës dhe që nga viti 2014 ka zhvilluar programe lëndore sociale, duke përfshirë kompetencat kyçe që studentët duhet të fitojnë në kuadër të “Të mësuarit gjatë gjithë jetës”, ku përfshihen edhe aftësitë sipërmarrëse. Gjithashtu, janë miratuar udhëzime për ndjekjen ose përfundimin e arsimit bazë dhe të mesëm të lartë me kohë të pjesshme për ata që nuk kanë mundur ta përfundojnë atë.*

Në kuadër të mbështetjes së start-upeve dhe sipërmarrësve të rinj AKSHI ka krijuar strukturën TECHSPACE e cila është e vetmja strukturë shtetërore që ju vjen në ndihmë të rinjve me hapësirë

co-working dhe trajnime në lidhje me sipërmarrjen. Përgjatë vitit 2021 – 2022 TechSpace ka implementuar projektin “ROADMAP TO SILICON VALLEY”.

*Në fushën e prokurimit publik*, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 4.11.2020 u miratua Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik 2020 – 2023 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj. Strategjia synoi të përmirësojë më tej sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, të rrisë më tej efikasitetin dhe transparencën, konkurrencën e lirë dhe të ndershme dhe trajtimin e barabartë dhe shmangien e korrupsionit dhe diskriminimit. Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ka përafuar në një masë të konsiderueshme legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti me Direktivat 2014/24, 2014/25, si dhe me Direktivat 89/665 dhe 92/13 të ndryshuara nga Direktiva 2007/66.

Vitet e fundit, institucionet publike shqiptare janë fokusuar *në luftën kundër informalitetit*. Autoritetet tatimore kanë kryer dhe përmirësuar analizat e vlerësimit të rrezikut në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Përpjekjet maksimale po bëhen për të ndryshuar sjelljen e papajtueshme të tatimpaguesve. Në veçanti, gjatë sezoneve turistike janë hartuar dhe zbatuar plane sektoriale për uljen e informalitetit dhe uljen e evazionit fiskal në sektorin e turizmit. Planet e tjera sektoriale hartohen në bazë të rezultateve të vlerësimit të rrezikut, si në sektorin e ndërtimit etj.

Gjatë periudhës 2021 – 2022, administrata tatimore është përfshirë në një proces shumë të rëndësishëm lidhur me fiskalizimin, i cili do të ndihmojë drejtpërdrejt në marrjen e të dhënave të sakta në kohë reale për të gjitha transaksionet e biznesit me administratën tatimore, por edhe të gjithë informacionit që qarkullon në “biznes ndaj biznesit” dhe marrëdhënieve “biznes me qeverinë”.

Edhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale ka rritur aktivitetin edhe në luftën kundër informalitetit në punë dhe zbatimin e përgjithshëm të legjislacionit të punës dhe sigurisë dhe shëndetit në punë.

Turizmi është një degë shumë e rëndësishme e ekonomisë shqiptare. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 413, datë 19.06.2019, përcakton kuadrin strategjik për zhvillimin e sektorit. Zbatimi i kësaj strategjie monitorohet rregullisht nga Grupi Tematik për Zhvillimin e Turizmit dhe Kulturës, i kryesuar nga Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit, sipas urdhrit të përbashkët të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Kulturës nr. 395. 19.12.2019.

Për shfrytëzimin e plotë të potencialit turistik shqiptar dhe për rritjen e punësimit dhe të ardhurave, qeveria shqiptare ka miratuar një sërë masash stimuluese, si Ligji nr. 43/2020 “Për veprimtaritë e turizmit detar” dhe aktet në zbatim të tij, që përcaktojnë rregullat dhe kriteret për zhvillimin e aktiviteteve të turizmit detar, llojet e mjeteve të argëtimit, mjetet dhe pajisjet e tjera, infrastruktura e nevojshme, standardet e sigurisë dhe përgjegjësitë institucionale për këto aktivitete.

Ndryshimet në Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” mundësoi përjashtimin nga TVSH-ja 20% për importin e mjeteve lundruese turistike të cilat janë prodhuar jo më shumë se 20 vjet nga momenti i importimit, me qëllim krijimin dhe zgjerimin e flotës shqiptare të anijeve turistike miqësore me mjedisin dhe stimulimi i zhvillimit të infrastrukturës detare.

Sezoni turistik menaxhohet rregullisht nga një task force e drejtuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe me përfaqësues nga institucionet dhe agjencitë përgjegjëse për promovimin dhe marketingun e turizmit, menaxhimin e vijës bregdetare, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës (rrugë, energji elektrike, ujë), mbrojtjen e shëndetit., siguria ushqimore, siguria fizike dhe rendi publik, mbrojtja e konsumatorit, emergjencat civile, taksat dhe zhvillimi kulturor, etj.

Në kuadër të pandemisë COVID-19, për menaxhimin e sezonit turistik, në vitet 2020 dhe 2021, u ngrit Komiteti Ad Hoc për Menaxhimin e Sezonit Turistik, i kryesuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, i cili koordinoi masat në nivel kombëtar për të adresuar emergjencën e krijuar nga pandemia dhe për të siguruar efikasitetin e nevojshëm të të gjitha aktiviteteve.

*Kuadri ligjor për zhvillimin teknologjik dhe ekonomik* përbëhet nga ligji nr. 9789/2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij. Kuadri ligjor për fushat e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik është i plotë. Ndryshimet e fundit të bëra në bazën nënligjore kanë krijuar mundësinë që njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore të jenë zhvillues të zonave. Pushteti vendor, në bazë të projekteve zhvillimore nëpërmjet përthithjes së investimeve dhe rritjes së punësimit, në territorin nën administrimin e tij, mund të aplikojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të kërkojë shpalljen e një zone brenda territorit të saj, ku pushteti vendor do të marrë rolin e zhvilluesit.

Procesi i privatizimit mbetet prioritet në zhvillimin ekonomik. Sipas objektivave që lidhen me privatizimin e aseteve shtetërore, ministri përgjegjës për ekonominë shqyrton çdo vit planin për privatizimin e aseteve publike.

Në kuadër të përmirësimit të kuadrit rregullator (për nëntreguesin e tregut të daljes), u miratua VKM Nr. 65, datë 3.02.2021 “Për rregullimin e marrëveshjeve jashtëgjyqësore të riorganizimit të përshpejtuar”. Qëllimi i rregullores është të përcaktojë procedurat për lidhjen e marrëveshjeve të përshpejtuar të riorganizimit jashtë gjykatës ndërmjet debitorit, që janë objekt i ligjit të falimentimit, dhe dy ose më shumë kreditorëve, nëse debitori është i paaftë.

Shqipëria po vazhdon të zbatojë masa për zgjerimin e bazës së tatimpaguesve me qëllim rritjen e transparencës dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm biznesi.

*Masat e zhvillimit të kapaciteteve*

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Kapitullin 20 gjatë vitit 2022 u mbështet nga projekti GIZ SANECA në përgatitjet për takimin dypalësh të shqyrtimit që do të mbahet në maj 2023. Në këtë kontekst, GNPIE për Kapitullin 20 përditësoi analizat e boshllëqeve ligjore, institucionale dhe administrative për kapitullin në vitin 2022 si pjesë e përgatitjeve për takimet dypalëshe.

Më shumë se 40 anëtarë të GNPIE-s u trajnuan në shtator – tetor 2022 në një seri prej pesë trajnimesh fizikisht/ ose online mbi politikat industriale dhe sipërmarrëse të BE-së, konkurrencën, standardizimin, politikat e SME-ve, pagesat e vonuara në transaksionet e biznesit, inovacionin dhe aftësitë, duke përfshirë mbi politikat kryesore sektoriale të BE-së që lidhen me sektorët kryesorë industrialë në Shqipëri. Trajnimet u zhvilluan nga një ekip ekspertësh ndërkombëtarë të nivelit të lartë dhe u lehtësuan nga Kolegji i Evropës.

Projekti GIZ-SANECA mbështeti Tryezën e rrumbullakët të Platformës së Partneritetit për Integrimin në BE (PPIE) për Kapitullin 20 me aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve, duke përfshirë një seminar mbi metodologjinë, zbatimin dhe monitorimin e PKIE (shkurt 2022) dhe një seri sesionesh informacioni/diskutimi mbi sipërmarrjen dhe politikën industriale, sfidat kryesore të zbatimit në Shqipëri, praktikat më të mira në rajon, dhe strategjitë për zhvillimin dhe inovacionin e politikave të sipërmarrjeve dhe industriale, sipërmarrjen dhe mbështetjen financiare/aksesin në financa (në korrik 2022).

Tryeza e Rrumbullakët e Kapitullit 20 PPIE është ngritur në vitin 2021 dhe disponon rregullat për funksionimin e duhur si një platformë konsultimi midis aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në procesin e anëtarësimit.

Në dhjetor 2019, u miratua ligji “Për krijimin e Korporatës Investimeve Shqiptare” i cili konsistonte në ngritjen e AIC si një korporate me qëllim kryesor përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të investimeve dhe vënien në përdorim me efikasitet të pronave shtetërore duke mobilizuar kapital shtetëror dhe privat.

AIC u bë operacional në korrik të vitit 2021. Si rrjedhim, AIC, gjatë periudhës korrik 2021 – 2022, u fokusua në:

- Ngritjen e kapaciteteve të brendshme – deri më tani është punuar për identifikimin dhe rekrutimin e kapaciteteve që nevojiten për mbarëvajtjen e operacioneve të AIC. AIC ka një ekip prej 13 ekspertësh, përfshirë edhe Drejtorët e Divizioneve (Ligjor, Financë, Zhvillim Biznesi).
- Hartimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve të brendshme – Departamenti Ligjor ka hartuar aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme të AIC, të cilat janë dërguar për konsultim dhe miratim në Këshillin Mbikëqyrës. Dokumentet e hartuara deri më tani dhe që presin të miratohen së shpejti, janë si më poshtë:
  - VKM për transferimin e aseteve në AIC.
  - VKM kuadër për përdorimin e aseteve shtetërore.
  - Rregullore e Brendshme, dhe Kodin e Qeverisjes së Mirë dhe Etikës.

- Përgatitjen e projekteve - paralelisht me organizimin e brendshëm të AIC-së, janë ndërmerre hapa për të identifikuar projektet që mund të zhvilloje AIC të cilat ndahen në katër kategori të gjera: industri, logjistikë, energji, bujqësi dhe turizëm. Deri më tani janë identifikuar 5 projekte investimi për të cilat janë kryer analizat paraprake teknike dhe financiare, të cilat janë prezantuar dhe kanë marrë miratimin paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës për të vijuar me fazat pasardhëse si kryerja e vlerësimit të fizibiliteteve.

Si rrjedhim, gjatë vitit 2023, pritet të fillojnë fizibilitetet për 2-3 projekte (në fushën e energjisë, industrisë dhe turizmit), të shpallen thirrjet për shprehjen e interesit nga investitorët privatë dhe të transferohen asetet e para tek AIC. Po ashtu, gjatë 2023, do vijojë puna për identifikimin e projekt-ideve të reja dhe të zhvillimit të këtyre ideve në projekte konkrete. Së fundi, vlen të theksohet se gjatë vjeshtës 2021 dhe pranverës 2022, AIC konceptoi funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore, dhe hartoi ligjin e posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e tyre, i cili u miratua në Parlament në Korrik 2022. AIC është duke kryer një aplikim në WBIF për marrjen e një granti për vlerësimin e fizibilitetit të teknoparkut të parë që do të ndërtohet në vend.

Në muajin korrik 2022 u miratua Ligji 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”. Në funksion të ligjit të mësipërm janë hartuar edhe tre projektaktet e mëposhtme, të cilat janë në procedurë bashkërendimi me Ministrinë e Drejtësisë.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit e parqeve teknologjike dhe shkencore”;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kriterëve për përfitimin e lehtësirave fiskale nga zhvilluesit dhe përdoruesit që operojnë në Parqet Teknologjike dhe Shkencore”;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesit dhe mënyra e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në parqet teknologjike dhe shkencore”

Pas miratimit të tyre në Këshillin e Ministrave do t’i hapet rrugë krijimit të parqeve teknologjike dhe shkencore.

Në lidhje me krijimin e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Elbasan, Këshilli i Ministrave miratoi VKM Nr. 238, datë 20.03.2020 “Për miratimin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe zhvilluesit “Italdruri Elbasan shpk” për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e teknologjisë dhe ekonomisë - zonës së zhvillimit në Elbasan. MFE ka miratuar fillimin e aktivitetit si shfrytëzues i Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, në Elbasan nga kompania: “Today Sofas” e cila do të investojë në një hark kohor prej 5 vitesh një vlerë prej 1 000 000 euro dhe përdoruesin “Foam Today” i cili do të investojë një vlerë prej 250 000 euro në makineri dhe pajisje dhe do të punësojë 150 punonjës.

Ky është një model suksesi në bashkëpunimin shtet-privat pasi në Sh.A.-në Ital Druri shteti zotëron 18.7% të kuotave.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi shtyrjen e afatit për aplikime për investime strategjike deri më 31 dhjetor 2023, në kuadër të Ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me Vendimin e Komisionit të Investimeve Strategjike Nr. 1/8, datë 15.07.2021, u miratua statusi “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Zona Teknologjike e Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Tiranë”, me Bashkinë e Tiranës. si subjekt propozues me sipërfaqe 35 ha. Projekti propozohet të zbatohet nga Bashkia e Tiranës, si institucion i zhvillimit të zonës, në bashkëpunim me institucione të tjera publike.

Së fundmi është propozuar në mbledhjen e radhës së Këshillit të Ministrave, shpalljen e TEDA Tiranë me zhvillues Bashkinë Tiranë, me qëllim realizimin e investimit strategjik.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 717 dt. 11.11.2022 “Për shpalljen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Zhvilluesit të zonës me vendndodhje në Tiranë”, është shpallur TEDA Tiranë me zhvillues bashkinë Tiranë.

Aktiviteti i TEDA Tiranë do të jetë:

- a. Industria e Automobilave;
- b. Industria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT);
- c. Industria e pajisjeve elektronike;
- d. Industria farmaceutike;
- e. Industria agro-përpunuese;
- f. Industritë prodhuese;
- g. Industri të tjera në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e vendimeve të KIS-it, inicioi procedurën për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 22.7.2015 “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, me qëllim përafrimin e bazës ligjore për fushat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik me atë të investimeve strategjike. Këto ndryshime u miratuan me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa në vendimin nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”.

Privatizimi i paketave strategjike aksionare (shoqëritë që operojnë në sektorë me rëndësi të veçantë për ekonominë) zbatohet në përputhje me Ligjin nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2021 janë privatizuar dhe lidhur kontratat e shitjes për 7 asete në total, duke realizuar 24,696,978 të ardhura në Lekë dhe 57,852,504 të ardhura në Bono Privatizimi, në total 82,549,482 të ardhura.



Gjatë periudhës janar – tetor 2022 është privatizuar dhe lidhur kontrata shitjes për 1 aset në total, duke realizuar 6,278,056 të ardhura në Lekë dhe 51,750,000 të ardhura në Bono Privatizimi, në total 58,028,056 të ardhura.

## 20.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për Kapitullin 20, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94 të “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e GNIP për Integrimin Evropian” dhe janë si më poshtë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) (institucioni koordinues);
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Kulturës;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA);
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);
- Agjencia e Prokurimit Publik (APP);
- Autoriteti i Konkurrencës (AK);
- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);
- Sekretariati i Iniciativës së Transparencës për Industrinë Nxjerrëse (EITI);
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Banka e Shqipërisë (BSH);
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimet Sociale;
- Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

## 20.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

### *Mangësitë e identifikuar*

- Niveli i ulët ose mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet organeve kompetente qeveritare dhe organizatave joqeveritare

### *Prioritetet*

*Sipas raportit të progresit të BE-së 2022, nevojitet:*

- Adresimi i sfidave kryesore për mjedisin e biznesit, duke ulur barrën rregullatore, duke rritur pjesëmarrjen në programet e financimit të disponueshëm për bizneset, duke forcuar përpjekjet për të luftuar informalitetin dhe korrupsionin, duke rritur shërbimet për mbështetjen e biznesit dhe duke zbatuar Ligjin për bizneset fillestare;
- Miratimi i ligjit të unifikuar të investimeve dhe adresimi i sfidave ndaj konkurrencës dhe rritjes siç theksohet në rekomandimet e përbashkëta të Programeve të Reformës Ekonomike 2022-2024.

## KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

### 25.1 Përmbajtja e kapitullit

*Acquis* në fushën e shkencës dhe kërkimit nuk kërkon transpozimin e rregullave të BE-së në rendin juridik kombëtar. Kapaciteti zbatues lidhet me ekzistencën e kushteve të nevojshme për pjesëmarrje efektive në programet kuadër të BE-së. Për të siguruar anëtarësimin e plotë dhe të suksesshëm me Programet Kuadër, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë kapacitetet e nevojshme zbatuese në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik, duke përfshirë personelin e duhur.

### 25.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli shkencë dhe kërkimi shkencor nuk është i ndarë në nënkapituj. Në zbatim të metodologjisë së përcaktuar, kapitulli 25 përmban:

- Financimin e programit buxhetor për kërkimin shkencor në kuadrin *e Arsimit të lartë*
- Performancën e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)
- Strategjinë e Specializimit Inteligent, ecuria gjatë 2021
- Politikën e Shkencës së Hapur (Open Science)

### 25.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativa politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit shkencor, rrjedh nga Neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (Titulli VIII - Politikat e Bashkëpunimit / Bashkëpunimi për Kërkimin dhe Zhvillimin Teknologjik).

## 25.4 Situata aktuale dhe arritjet kryesore

Sipas “Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë të vitit 2022”, kapitulli 25 është pjesë e konkurrencës dhe rritjes së qëndrueshme të grupit 3. Në lidhje me këtë kapitull rekomandimet kryesore të BE-së janë si më poshtë:

- Rritja e investimeve në fushën e kërkimit shkencor në përputhje me angazhimet kombëtare dhe prioritetet e ERA-s.
- Të përfundojë hartimi i “Strategjisë së Specializimit Inteligjent”.
- Të prodhojë të dhëna dhe statistika të besueshme në fushën e kërkimit dhe teknologjinë duke përfshirë treguesin e investimeve të brendshme bruto për kërkimin dhe zhvillimin.

Brenda këtij kuadri sfidat që mbeten aktuale përfshijnë: shtimin e investimeve në kërkim shkencor dhe inovacion në Shqipëri, hartimi i Strategjisë së Specializimit Inteligjent si dhe gjenerimi e statistikave të besueshme që kanë të bëjnë me shkencën dhe kërkimin, veçanërisht treguesin që lidhet me investimet e brendshme bruto për kërkimin shkencor dhe inovacionin.

Progres është shënuar gjatë viteve 2021 – 2022, veçanërisht në hartimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent e cila filloj në vitin 2018 nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Komisionin Evropian. Gjithashtu me mbështetjen e projektit të “BE për Inovacion” në 2021 – 2022 ka përfunduar analiza cilësore e saj, ndërsa EDP është në zhvillim e sipër dhe pritet të përfundojë brenda prillit 2023.

Për politikën e kërkimit dhe inovacionit, me Urdhrin nr. 425, datë 02.11.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit u krijua një grup pune ndërinstitucional në vitin 2021, për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2017 – 2022.

Përveç kësaj, strategjia e re për kërkimin shkencor duhet të zhvillohet dhe miratohet. Pra, në shkurt 2022, me urdhër nr. 53, datë 9.02.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupit koordinues për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit” krijohet një grup i ri pune ndërinstitucional. Gjithashtu në zbatim të urdhrin nr. 336, datë 15.06.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për krijimin e grupeve teknike të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor 2023 – 2030”, janë ngritur grupet teknike të punës. Procesi mbështetet nga dy ekspertë të ofruar nga EU4Innovation. Sipas Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (NPEI), dokumenti i strategjisë parashikohet të përfundojë deri në tremujorin e katërt të vitit 2023.

Paralelisht me urdhër të Kryeministrit nr. 57, datë 25.03.2022 “Për ngritjen e grupit të punës ndërinstitucionale për hartimin e projektligjit për shkencën në Republikën e Shqipërisë”, MAS dhe Akademia e Shkencave po punojnë për hartimin e ligjit të ri për shkencën. Ligji i ri është pjesë e NPEI, që pritet të miratohet nga parlamenti në tremujorin e katërt të 2023.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit u krijua një grup pune me Urdhrin nr. 653, datë 3.11.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për krijimin e regjistrit kombëtar të revistave dhe periodikëve shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë revistat dhe periodikët shkencorë për t’u regjistruar në regjistrin kombëtar të Republikës së Shqipërisë”. Bazuar në rezultatet e këtij grupi pune, u miratua urdhri nr. 36, datë 24.1.2023, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa i përket programeve kuadër të BE-së, Shqipëria ishte pjesë e Horizon 2020 si vend i asociuar. Pjesëmarrja e saj në Horizon është përmirësuar ndjeshëm dhe tregon një zhvillim të mirë për vitin 2021.

Gjatë vitit 2021 përfunduan negociatat për Marrëveshjen e re Horizon Europe, dhe marrëveshja u nënshkrua dhe ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë në maj 2022.

Shqipëria është aktualisht një anëtare e përhershme e Horizon Europe. Në këtë drejtim kontributet për vitin 2021 (131,4284,43 Euro) dhe për vitin 2022 (1373395,96 Euro) janë paguar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si bileta hyrëse për vitet përkatëse.

Për sa i përket performancës, pjesëmarrja e institucioneve shqiptare në program për vitin 2021 ka qenë më e mira që kur Shqipëria ka marrë pjesë në Programet Kuadër të BE-së për Kërkimin dhe Inovacionin. 16 financime me një vlerë totale prej 1.9 milionë euro, 16% normë suksesi dhe për herë të parë dy institucione të arsimit të lartë shqiptare janë koordinatorë projektesh (drejtues projekti). Megjithatë pjesëmarrja e sektorit privat në program vazhdon të mbetet e ulët. Një trend pozitiv është masa e re kombëtare e mbështetjes që lehtëson bashkëpunimin akademik-biznes.

Edhe pse Shqipëria u bë anëtare e EUREKA-s që nga qershori 2021, ne nuk kemi ende asnjë projekt të aplikuar në këtë program. Kjo për shkak të skepticizmit.

Për sa i përket angazhimit në Bashkëpunimin Evropian në Shkencë dhe Teknologji (COST), Shqipëria ka arritur rritje mbresëlënëse gjatë dy viteve të fundit. Në vitin 2021 në program ishin 163 anëtarë, ndërsa në vitin 2022 tashmë janë 146 anëtarë, nga të cilët një koordinator kryesor. Komisioni ka përzgjedhur bashkinë e Elbasanit për të marrë pjesë në Misionin e BE-së për 100 qytete neutrale ndaj klimës dhe inteligjente deri në vitin 2030, i ashtuquajtur Misioni i Qyteteve.

*Financimi i programit buxhetor “Për arsimin e lartë”*

Fondet e planifikuara **për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor** për vitin 2023 zënë:

- 26.7% e fondeve totale të MAS;
- 0.6% ndaj PBB-së;
- 1.84% ndaj shpenzimeve publike.

Fondet buxhetore për financimin e programeve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, për vitin 2023 (pa përfshirë fondet jashtë buxhetore) është planifikuar në vlerën **prej 12 miliardë e 611 milionë lekë**, nga të cilat:

- **20.1 milion lekë** janë shpenzime personeli për Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacioni;

Gjithashtu, buxheti i vitit 2023 për programin “Kërkim Shkencor” ka një rritje prej 38.2% ose 284,74 milionë lekë më shumë krahasuar me vitin 2022. Për projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor, janë planifikuar gjithsej 550 milionë lekë ose 200 milionë lekë më shumë se viti 2022. Janë planifikuar dhe 84 milionë lekë më shumë për projektet kërkimore-shkencore të IAL-ve dhe programet kombëtare të zhvillimit dhe projektet dypalëshe.

### **Nga prioritet e Qeverisë në Arsimin e Lartë mund të veçojmë:**

Investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe sigurimin e integritet akademik dhe shkencor të institucioneve të arsimit të lartë, me qëllim që të përmirësohet cilësia e produktit universitar, ndërsa diploma e secilit student do të mbartë vlerën që duhet të ketë. (Plani i Qeverisë 2021 – 2025, Objektivat për arsimin).

**Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë – fillojmë punën për hapjen e filialeve të institucioneve të arsimit të lartë më të mira ndërkombëtare në Shqipëri**, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MAS do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha institucionet e arsimit të lartë shqiptare (Plani i Qeverisë 2021 – 2025, Objektivat për arsimin).

**Granti i punës kërkimore-shkencore** dhe veprimtarive krijuese për periudhën 2023 – 2025 është planifikuar 1 miliardë e 31 milionë lekë në vitin 2023 dhe 1 miliard e 182 milionë lekë në vitin 2025. Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, përfshin fondet për kërkimin shkencor. Ky grant është i hapur, për konkurrimin/aplikim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.

**Shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie të miratuara në formën e “Granti i punës kërkimore-shkencore”**, realizohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesore për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese të IAL- ve.

**Për vitin 2023**, nga grandit i punës kërkimore shkencore është planifikuar të mbështeten aktivitetet sa më poshtë;

- **Financimi i Programeve Kombëtare/Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik të mbështetura financiarisht.** Nxitja e punës kërkimore në IAL-të publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500 kërkuesve, ku prioritet kanë femrat.
- **Projekte bashkëpunimi të institucioneve të arsimit të lartë me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, Programet Kombëtare dhe**

**Ndërkombëtare.** Zgjerimi i bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë me biznesin privat.

- **Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër të Programeve të BE-së për Kërkim dhe Inovacion,** pjesëmarrje që premtan arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë.
- **Fonde grand për pjesëmarrje me të drejtë dhe të plotë të Republikës së Shqipërisë në Horizon Europe,** programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, propozuar nga Komisioni Evropian, që synon të nxisë modernizimin e sistemeve arsimore 160 milionë lekë në vit.
- **Fonde me financim të huaj rreth 300 milionë lekë,** janë parashikuar, për financimin apo bashkë-financimin e 50-70 projekteve me donatore në vit.

Në total për financimin e programit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor për periudhën afatmesme 2023 – 2025, fondet grant planifikuar me burim financimi buxhetin e shtetit së bashku me fondet nga të ardhurat detyësore si dhe grante të tjera të huaja, parashikohet që në vitin 2023 të arrijnë në 15.7 miliard lekë, në vitin 2023 në 16.4 miliardë lekë, si dhe në vitin 2024 16,8 miliardë lekë.

#### *Të dhënat statistikore*

Përsa i përket përmirësimit të të dhënave statistikore të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit, janë të përfshira me detaje në kapitullin 18 “Statistikat”.

AKKSHI dhe INSTAT në qershor të 2020, nënshkruan një memorandum bashkëpunimin, i cili parashikon përfshirjen në programin statistikor zyrtar, të një serie indikatorësh për fushën e kërkim & zhvillimit. Në zbatim të kësaj marrëveshje është hartuar një anketë e cila ka për qëllim të mbledhë informacion mbi disa indikatorë të dakordësuar ndërmjet INSTAT dhe AKKSHI-së. Burimet e marrjes së informacionit si dhe periodiciteti i mbledhjes së të dhënave, bazohet kryesisht në manualin “Frascati” dhe atë të Oslos.

Për herë të parë në vitin 2022, Shqipëria përfshihet në Tabelën Evropiane të Inovacionit, e cila është tashmë një rezultat i prekshëm i përpjekjeve të bëra gjatë viteve të fundit.

#### *Performanca e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)*

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Horizon 2020 është përmirësuar dhe ka arritur rezultate të kënaqshme, me pjesëmarrje në 53 veprime të Horizon 2020, duke përfituar 5.82 milionë euro të kontributit të drejtpërdrejtë të BE-së. Shkalla e suksesit të propozimeve me pjesëmarrje shqiptare është 8,7%, (nga 7.8% që nga viti i kaluar) krahasuar me 12.1% normë suksesit të vendeve në Horizon 2020.

Përmes marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunim Shkencor dhe Teknologjik, AKKSHI ka krijuar hapësira për lehtësimin e lëvizjes së kërkuesve të huaj. AKKSHI aktualisht po monitoron zbatimin e Marrëveshjeve me Republikat e Italisë, Austrisë, Kosovës dhe Turqisë.

## Arritjet kryesore

Ndër arritjet kryesore gjatë periudhës së raportimit janë si më poshtë:

- Ecuria me përgatitjen e Strategjisë së Specializimit Inteligent.
- Rritja e buxhetit për kërkimin shkencor;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor si rezultat i masave në kuadër të “Paktit për Universitetin”.
- Ndërtimi i anketës dhe marrja e informacionit mbi disa indikatorë dhe prodhimin e statistikave të fushës së kërkimit shkencor dhe inovacionit;

### 25.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Ministritë dhe institucionet kryesore përgjegjëse për kërkimin shkencor në Shqipëri janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Këshilli për Arsimin e Lartë për Kërkim Shkencor;
- Agjencia Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion;
- Institucionet e Arsimit të Lartë;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Rrjeti Akademik i Shqipërisë;
- Instituti i Statistikave - INSTAT;
- Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi;
- Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

### 25.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Mangësitë që identifikohen nga Raporti i Komisionin Evropian për vitin 2022 lidhen me:

- Mungesën e një metodologjie të qartë për të krijuar financime për kërkimin dhe shkencën.
- Investimet e pakta në kërkimin shkencor dhe masat shoqëruese për të forcuar kapacitetin e kërkimit dhe inovacionit në nivel kombëtar, duke pasur parasysh gjithashtu rëndësinë e inovacionit me Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

- Strategjinë e Specializimit Inteligjent ende nuk është miratuar.

## Prioritetet

Bazuar në rekomandimet e raportit progresit 2022 përparësitë kryesore të Shqipërisë në këtë fushë janë:

- Hartimi i strategjisë “Për kërkimin shkencor 2023-2030”, brenda vitit 2023.
- Reformimi dhe përmirësimi i sistemit ligjor dhe institucional të kërkimit shkencor.
- “Ligji i ri për shkencën” do të miratohet brenda vitit 2023.
- Shqipëria do të vazhdojë përpjekjet e saj për të rritur ndërgjegjësimin për pjesëmarrjen në programin e ri Horizon Europe dhe për të rritur rezultatet e pjesëmarrjes.
- Ngritja e kapaciteteve të NCP-ve, me qëllim rritjen e nivelit të pjesëmarrjes dhe suksesit në Programet Kuadër të BE-së, veçanërisht atë të Horizon Europe.
- Hartimi i metodologjisë kombëtare për investimin e fondeve për kërkimin dhe shkencën.
- Rritja e financimit në nivel kombëtar për shkencën dhe zhvillimin, që parashikohet edhe në buxhetin afatmesëm të MAS-it.
- Promovimi i bashkëpunimit të trefishtë qeveri-akademi-biznes (Triple Helix), si dhe përballja dhe zgjidhja e sfidave socio-ekonomike të vendit nëpërmjet një kërkimi shkencor cilësor.
- Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës dhe kërkimit, si në nivel rajonal ashtu edhe ndërkombëtar.
- Përfshirja dhe zbatimi i parimeve të Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA)
- Miratimi i Strategjisë së Specializimit Inteligjent brenda vitit 2023.
- Rritja e pjesëmarrjes në projektet kërkimore ndërkombëtare të IAL-ve nëpërmjet programit të ndërkombëtarizimit të iniciuar nga MAS.
- Përmirësimi i kuadrit rregullator për vlerësimin e cilësisë së kërkimit shkencor, nëpërmjet VKM nr. 165, datë 21.3.2018. MAS ka ngritur një grup pune për të ofruar informacion për institucionet e arsimit të lartë, i cili do të shërbejë si bazë kombëtare e të dhënave për këtë sistem.

## KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

### 26.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 26 përfshin fushat e arsimit, formimit profesional, rinisë dhe kulturës.. Kuadri i bashkëpunimit për politikën e arsimit dhe formimit synon të konvergojë politikën kombëtare dhe arrijtjen e objektivave të përbashkëta nëpërmjet metodës së hapur të koordinimit, e cila çoi në programin “Edukimi dhe Formimi 2010”, që integron të gjitha veprimet në fushën e arsimit dhe formimit në nivel evropian. Shtetet anëtare duhet të kenë kuadrin ligjor, administrativ dhe financiar dhe kapacitetin e nevojshëm zbatues për të siguruar menaxhim të shëndoshë financiar të programeve evropiane të arsimit, formimit dhe rinisë.



## 26.2 Struktura e kapitullit

- Arsimi;
- Kultura.

## 26.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar në arsim me *acquis* të BE-s buron nga neni 70 i MSA-së për përafrimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafrimin e legjislacionit në arsim dhe formim. Në fushën e kulturës neni 101 i MSA thekson se “palët zotohen të ndërmarrin bashkëpunim kulturor” dhe zotohen të bashkëpunojnë për promovimin e diversitetit kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO-s “Për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore”. BE gjithashtu fokusohet dhe inkurajon pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare të BE-së në fushën e arsimit dhe kulturës.

## 26.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025 i referohet në mënyrë të përgjithësuar, zbatimit të strategjisë kombëtare të arsimit, si një ndër prioritetet e kapitullit 26, me fokus në “sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor”. Bazuar në Progres Raportit të vitit 2022, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e arsimit dhe kulturës.

**Është bërë progres** në miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021 – 2026 dhe planit të veprimit; në shërbimin arsimor cilësor dhe krijimin e një mjedisi shkollor të hapur gjithëpërfshirës, miqësor dhe të sigurtë me nxënësit, prindërit dhe komunitetin; në digjitalizimin e arsimit; në krijimi e mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimin e sistemit të karrierës; në trazicionin e gjelbër dhe zhvillimin e qëndrueshëm; në marrjen e masave të veçanta në përshtatjen e shpejtë të edukimit në distancë gjatë periudhës së pandemisë Covid-19; në njohjen automatike të diplomave të Institucioneve të Arsimit të Lartë duke zbatuar njohjen e kualifikimeve akademike në Ballkanin Perëndimor; në rishikimin/përditësimin dhe hartimin e standardeve të cilësisë në Arsimin e lartë, pjesë e Kodit të Cilësisë, në përpjekje për t’i afuar ato dhe përputhur me standardet evropiane ESG; në zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe hartimin e Ligjit të Arsimit dhe Trajnimit Profesional; në forcimin e Agjencisë së re Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë; në ristrukturimin e vazhdueshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve; në optimizimin e sistemit të AFP-së për të zhvilluar shërbimet dhe kompetencat në përputhje me nevojat e tregut të punës; në miratimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 dhe Plani i veprimit sipas VKM nr. 692 datë 26.10.2022; në zbatimin e strategjisë për kulturën 2019 – 2025.

## **Arsimi Parauniversitar**

Në përputhje me Rezolutën e Këshillit Evropian për kornizën strategjike 2021 – 2030 është hartuar dhe miratuar Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021- 2026 për një **shërbim arsimor cilësor dhe krijimi i një mjedisi shkollor të hapur gjithëpërfshirës, miqësor dhe të sigurtë me nxënësit, prindërit dhe komunitetin**

**Arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuara (AK)**, si një prioritet realizohet përmes integritit të tyre në shkollat e zakonshme dhe në shkolla speciale.

Në vitin shkollor 2021 – 2022, në sistemin arsimor parauniversitar, raporti i nxënësve me AK që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës ndaj arsimit special është përmirësuar nga 75% që ishte në vitin 2014 në rreth 90%. 250 mësues ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara janë shtuar këtë vit shkollor në sistemin arsimor parauniversitar, duke e çuar raportin mësues ndihmës – nxënës me AK në 1 me 2-3 . **Në fokus është zhvillimi profesional i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara.** Një nga masat në SKA 2021 – 2026 është kthimi i shkollave speciale në qendra burimore. Për nxënësit që nuk dëgjojnë është miratuar shtrirja e arsimit special deri në nivelin e arsimit të mesëm të lartë të orientuar në fushën e të nxënësve teknologji dhe TIK.

## **Arsimimi i fëmijëve për pakicat kombëtare**

Bazuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **pakicave kombëtare**, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen **në gjuhën amtare**, të mësojnë **historinë dhe kulturën e tyre**, sipas planeve dhe programeve mësimore.

Në institucionet arsimore, ku mësojnë nxënës të pakicave zhvillohen veprimtarie me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave. Nxënësit e pakicave pajisen me tekste shkollore në gjuhën amtare, të cilat u jepen falas. Nxënësve romë dhe egjiptianë u ofrohen programe të veçanta pas mësimit për kryerjen e detyrave mësimore ose marrjen e mësimëve plotësuese nga **punonjës të caktuar në rolin e mediatorit për këto grupe** në funksion të ndërgjegjësimit dhe të përmirësimit të aksesit të tyre në arsim.

**Pajisja e nxënësve ne tekste shkollore falas**- sot nxënësit e arsimit bazë (klasa 1-9) dhe 16 kategorive të arsimit të mesëm të lartë përfitojnë tekstet shkollore në përdorim falas me një buxhet rreth 9 milion euro.

**Sigurimi i transportit falas për nxënësit dhe** mësuesit ku kanë përfituar 44 300 nxënës të arsimit parauniversitar dhe 12 000 mësues. Numri i nxënësve që mësojnë në klasa kolektive është ulur ndjeshëm, nga afro 34 mijë nxënës të arsimit bazë që kishim në klasa kolektive në vitin 2017, në rreth 20 mijë nxënës këtë vit.

## **Krijimi i një mjedisi shkollor të hapur gjithëpërfshirës, miqësor dhe të sigurtë**

**Nisma “Oficerët e Sigurisë”** ka si qëllim rritjen e sigurisë në shkollë. Në këtë vit do të ketë edhe 70 oficerë sigurie më shumë, duke e çuar numrin e tyre në 220.

### **Shërbimi psiko-social**

Për vitin shkollor 2022 – 2023 do të ketë edhe 235 punonjës të shërbimit psiko-social më shumë. Shërbimi psiko-social ka siguruar shërbime të drejtpërdrejta për të gjithë fëmijët në nevojë.

**Vlerësimi psiko-social i punonjësve arsimor i futur këtë vit shkollor (2022 – 2023)** ka për qëllim vlerësimin e mësuesve të rinj që punësohen në sistemin arsimor parauniversitar, nëse ato reflektojnë problematika të sjelljes në mjediset shkollore, si dhe parandalimin apo trajtimin e rasteve të sjelljes së papranueshme dhe të abuzimit nga ana e punonjësve arsimorë në mjediset shkollore.

**Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë”** është shtrirë edhe në 150 shkolla të tjera gjatë këtij viti shkollor (2022 – 2023) do të ndikojë ndjeshëm në lehtësimin e familjeve dhe në krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit, kryesisht për nxënësit që vijnë nga shtresat sociale në nevojë dhe grupe vulnerabël.

**Emërimi i mësuesve kryet nëpërmjet Portalit “Mësues për Shqipërinë”**, proces ky që ka rritur transparencën dhe meritokracinë.

**“Shkolla, qendër komunitare” (SHQK)** - në vitin 2021 – 2022 numri i shkollave u rrit në 461 shkolla SHQK, me rreth 195 shkolla të reja. Janë rreth 2 268 klube që drejtohen nga rreth 2 268 mësues ku marrin pjesë dhe përfitojnë rreth 52 017 nxënës.

**Integrimi i nxënësve në klasa sportive** - me fillimin e këtij viti është rritur në 400 numri i klasave sportive dhe kemi miratuar programet mësimore për hapjen e klasave sportive edhe në disiplina të tjera si gjimnastikë, tenis dhe atletikë. Qeveria Shqiptare ka financuar me një buxhet 500 milionë lekë projektin “Ekipet sportive” me qëllim masivizimin e sportit për nxënësit dhe të rinjtë, si dhe identifikimin dhe mbështetjen e talenteve.

Qeveria ka vënë në dispozicion 280 milionë lekë për **programin “Art, zeje, sport” në shkolla**, i cili përmban katër fusha të artit, sportit, bujqësisë, TIK që mund të zgjidhen nga nxënësit sipas dëshirës dhe mundësive që ka shkolla.

**Gjuha e huaj angleze** është futur si lëndë e detyrueshme që në klasën e parë. Janë hartuar programet mësimore në gjuhën angleze për klasën e parë dhe të dytë U ngrit rrjeti i koordinatorëve dhe u trajnuan mësuesit për kurrikulat e reja dhe metodologjinë e mësimdhënies.

**Teksti i përbashkët i Abetares Shqipëri Kosovë dhe për diasporën**

Me urdhrin nr. 516 datë 09.09.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, abetarja e përbashkët është bërë pjesë e katalogut të teksteve shkollore këtë vit shkollor dhe ka filluar përdorimi i këtij teksti nga të gjithë nxënësit e klasave të para në Kosovë dhe Shqipëri. Pritet që ky tekst, i cili do të pasohet edhe nga tekste të tjera shkollore të përbashkëta, të përdoret nga të gjithë fëmijët shqiptarë që banojnë në trojet e tyre në Republikën e Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut.

### **Pjesëmarrja e nxënësve shqiptarë në testimet ndërkombëtare PISA, TIMSS, PIRLS**

Shqipëria ka marrë pjesë gjashtë herë në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) - 2000, 2009, 2012, 2015, 2018 dhe 2022. Gjatë kësaj periudhe, nxënësit shqiptarë kanë treguar përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha fushat, gjë që ka ndikuar në zvogëlimin e hendekut me nxënësit nga vendet e OECD-së.

Shqipëria ka marrë pjesë për herë të parë në vlerësimin TIMSS 2019. Vendi ynë është përfshirë në këtë vlerësim për të matur arritjet e nxënësve të klasave të katërta nëpërmjet testimit që është zhvilluar në letër. Shqipëria do të marrë pjesë në ciklin e dytë në TIMSS 2023, Main Study, nëpërmjet testimit që do të zhvillohet me kompjuter.

Shqipëria ka marrë pjesë për herë të parë në vlerësimin PIRLS 2021, i cili mat arritjet e nxënësve të klasave të katërta në lexim.

### **Digjitalizimi i arsimit (Zhvillimi i kompetencës digjitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të nxënë)**

Në përputhje me Rekomandimin e Këshillit Evropian për blended learning si dhe bazuar në strategjinë kombëtare të arsimit 2021 – 2026 për digjitalizimin e arsimit *është parashikuar krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj*, investim për shtimin e pajisjeve digjitale. TIK-u ka filluar në klasën e parë me aftësitë e kodimit

MAS ka ngrit **Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)**, i cili mbledh dhe përpunon të gjitha të dhënat për arsimin parauniversitar.

Në vitin shkollor 2022 – 2023 mundësuar një shërbim të ri për **regjistrimin online** të të gjithë nxënësve në klasën e parë dhe në klasën e dhjetë duke lehtësuar dhe përsheptuar procedurat e regjistrimit të tyre dhe duke realizuar shërbimin në një kohë më të shkurtër dhe me efektivitet.

### **European School Education Platform/eTwinning**

Angazhimi i MAS në zbatimin e programit ESEP (European School Education Platform/eTwinning) ka vazhduar, duke zgjeruar numrin e mësuesve të përfshirë në këtë komunitet, gjë që ndikon në zhvillimin profesional të mësuesve në drejtim të integritit të TIK-ut në arsim.

Si pjesë e eTwinning dhe programit Erasmus+ aktualisht janë të angazhuar rreth 6 500 mësues e drejtues. 42 shkolla të certifikuar me etiketën e cilësisë si “eTwinning school”, si dhe mbi 3 200 etiketa cilësie në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për mësuesit e angazhuar në projekte.

### **Siguria e fëmijëve në internet**

Në përmbushje të qëllimit të politikës 3, të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025, MAS ka realizuar si më poshtë vijon:

Lidhur me objektivin specifik: **“Forcimi i kuadrit ligjor për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet, në institucionet arsimore parauniversitare”**, janë në zbatim udhëzime të miratuara nga MAS.

Mbështetur në dokumentin “Korniza evropiane për kompetencën digjitale të mësuesve, DigComEdu1”, e kornizës së kompetencës së TIK-ut për mësuesit (ICT CFT, version 3), të UNESCO. Janë hartuar modulet dhe materialet për trajnimin e mësuesve: “Qytetaria digjitale dhe siguria në internet në mjediset digjitale” si dhe dokumenti “Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit”, në të cilin synohet kuptimi i parimeve themelore të sigurisë kibernetike, edukimit mediatic dhe informativ.

Lidhur me objektivin specifik: **“Parandalimi i abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të hapësirave të sigurta për lundrimin në internet”**, janë realizuar: veprimtari me nxënësit, takime mujore të rrjeteve profesionale të TIK-ut, diskutime mujore dhe raporte vjetore nga mësuesit e TIK, si dhe janë vendosur filtra në shkolla për të parandaluar aksesin e fëmijëve në faqe të papërshtatshme dhe të paligjshme, si dhe informimi në vijueshmëri i mësuesve të TIK për raportimin e incidenteve.

Rubrika “Raporto përmbajtje të paligjshme”, në faqen zyrtare të MAS, institucioneve arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe IAP-ve është ndërlidhur me portalin online [www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al) të AKCESK, për mbylljen e aksesit të faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme

### **Mësuesit**

**(Krijimi i mundësive për formimin cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i sistemit të karrierës që i inkurajon të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive për mësimdhënie).**

Gjatë vitit 2022 ASCAP ka kryer 12 680 trajnime për tema që lidhen me përdorimin e TIK në procesin mësimor, metodologji të mësimdhënies, vlerësimet ndërkombëtare PISA, PIRLS dhe TIMSS, gjithëpërfshirja, etj. Bazuar në të dhënat e portalit të trajnimeve janë kryer rreth 10 000 trajnime nga agjenci të akredituara nga të cilat rreth 1 600 ofrohen falas për mësuesit. Rreth 60% e trajnimeve për të gjithë mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar ofrohen falas.

Shqipëria përfshihet për herë të parë në **studimin ndërkombëtar të TALIS 2024**. Gjatë periudhës shkurt – mars 2022, ASCAP ka zhvilluar procesin e pilotimit të instrumenteve të anketimit, ku tre instrumente të ndryshme u diskutuan në tryeza me mësues dhe drejtues shkollash.

### **Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në arsimin parashkollor.**

Në arsimin parashkollor janë hartuar dhe janë miratuar një sërë dokumentesh dhe materialesh për të përmirësuar cilësinë e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme si kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor, programet mësimore për grup-moshat: 3-4 vjeç, 4-5 vjeç dhe 5-6 vjeç, standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor, kornizën e vlerësimit në arsimin parashkollor të moshës 3-6-vjeçare, standardet e zhvillimit dhe të të nxënit për fëmijët 0-3 vjeç, standardet profesionale të drejtuesve të institucioneve arsimore parashkollore. Janë trajnuar 300 mësues të arsimit parashkollor për aspekte të gjithëpërfshirjes dhe për përdorimin e TIK në platformat digjitale.

**Të nxënit për tranzicionin e gjelbër dhe zhvillimin e qëndrueshëm** -Është hartuar dhe miratuar nga Ministri dokumentin politik të standardeve të të nxënit “Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm” nga klasa përgatitore deri në klasën e 12-të (nr. 10094/1 Prot., datë 1.11.2018 MAS); Në funksion të zhvillimit të kompetencës për mjedisin, në programet mësimore të lëndëve në të gjitha klasat, Mjedisi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm janë përcaktuar si tema ndërkurrikulare; Gjatë periudhës 2021 – 2022 janë trajnuar nga ASCAP 120 mësues për edukimin mjedisor; Shkollat zhvillojnë veprimtari dhe projekte mjedisore përmes të cilave synojnë të rrisin shkallën e ndërgjegjësimit të nxënësve dhe komunitetit për mbrojtjen e mjedisit dhe nxënësit të formohen si veprimtarë aktivë për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm;

Në kushtet kur Covid-19 vijon ende të jetë aktiv, institucionet arsimore do të ndjekin dhe respektojnë masat e kontrollit të infeksionit, higjienës personale dhe mjedisore me objektivin e mirëqenies dhe mbrojtjes së nxënësve dhe personelit që punon në institucionet arsimore, sipas udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Mbi kujdesin dhe masat ndaj Covid-19 në institucionet arsimore për vitin 2022-2023”, me nr. 309/4 prot., datë 26.8.2022.

### **Arsimi i Lartë**

Shqipëria është pjesë e EHEA dhe Procesit të Bolonjës nga 2003 dhe prej 1 Janarit 2021 deri më 30 Qershor 2024, do të udhëheq **sekretariatit e Bologna Follow-UP Group (BFUG)**.

### **Njohja e kualifikimeve akademike**

Shqipëria është angazhuar të integrojë dhe zbatojë njohjen e kualifikimeve akademike në Ballkanin Perëndimor në përputhje me *acquis* Evropian. Në këtë kuadër, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, me mbështetje e Sekretariatet të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), kanë

miratuar në nëntor 2022 “Marrëveshjen e Ballkanit Perëndimor për njohjen e kualifikimeve në arsimin e lartë”.

### **Dimensioni social**

Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 1.06.2022 “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, si dhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 27, datë 2.08.2022, “Për përcaktimin e rregullave, afateve të aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat e masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar”.

### **Cilësia në Arsimin e Lartë**

Për anëtarësimi e plotë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në Rrjetin Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë (EQAR) janë rishikuar vendimi nr. 109, datë 15.02.2017/i ndryshuar i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.09.2018, “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”. Janë përmirësuar disa nga elementët / standardet e Kodit të Cilësisë duke mundësuar përafrimin e tyre me Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (SUE) që njihen edhe si ESG 2015 (European Standards and Guidelines – 2015).

Janë nënshkruar në mars dhe nëntor të vitit 2022 dy memorandume bashkëpunimi me Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Agjencinë Kombëtare Italiane për Vlerësimin e Universiteteve dhe Instituteve Kërkimore (ANVUR), ku një nga synimet është plotësimi i kriterëve dhe rekomandimeve të ENQA dhe EQAR.

### **Ndërkombëtarizimi**

Në këtë kuadër, MAS nxit dhe mbështet hapjen e filialeve të IAL-ve ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe hapjen e programeve të studimit të përbashkëta dhe të dyfishta. IAL-të publike në vend kanë nënshkruar 41 marrëveshje bashkëpunimi me IAL-të e huaja, në të tre ciklet e studimit, nga të cilat 30 janë aktive. Masa e financimit nga MAS për projektet e miratuara për programet e përbashkëta të studimit të IAL-ve publike për vitin 2022 është 358.953 mije leke **Kodifikimi i Programeve të Studimit**

Për një arsim të lartë cilësor dhe të orientuar nga tregu i punës MAS ka ndërmarrë iniciativën për realizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë

në Republikën e Shqipërisë” si dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 31, datë 15.11.2022, “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke ju ardhur në ndihmë institucioneve të arsimit të lartë në orientimin e veprimtarisë së tyre akademike, si dhe duke mbështetur e lehtësuar menaxhimin dhe planifikimin e ofertës së kurrikulave dhe programeve.

### **Klasifikimi Kombëtar i Institucioneve të Arsimit të Lartë**

Për herë të parë MAS ka ndërmarrë nismën për të realizuar renditjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë në vend. Për këtë qëllim është ngritur Grupi i Punës (Urdhër nr. 672, datë 7.11.2022) , i cili ka për qëllim të përcaktoj kriteret kryesore dhe rregullat, mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i IAL-ve, për të bërë renditjen e tyre në RSH.

### **Rajonalizimi**

Në kuadër të qëllimit për të orientuar të rinjtë drejt tregut të punës dhe për të krijuar mundësinë e orientimit të kuotave sipas degëve përkatëse MAS ka ngritur grupin e punës (urdhër nr. 366, datë 1.07.2022) për të realizuar analizën e përshtatshmërisë së programeve të studimit të ofruara nga IAL-të publike sipas nevojave të zhvillimit rajonal.

### **Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK)**

Task Forca e ngritur me urdhrin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me nr. 22, datë 28.1.2020, i ndryshuar ka ekzaminuar dhe veçuar ndryshimet e nevojshme të kornizës ligjore për arsimin në mënyrë që të përmbushë kriteret e referencimit të Kornizës sonë të Kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF) dhe asaj të QF-EHEA.

Task Forca në zbatim të detyrave të saj ka përgatitur Raportin dhe ka përfunduar me sukses referencimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) është referencuar me sukses me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (EQF). Task-Forca e ka përfunduar mandatin në fillim të vitit 2022 dhe grupet e tjera të punës, në bashkëpunim me institucionet përkatëse që lidhen me KSHK-në do të vazhdojnë punën për të reflektuar nevojat e tjera të lidhura me këtë fushë.

### ***Buxheti***

- Fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2023 – 2025;
- Totali i fondeve/ tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”, kanë pësuar ndryshime pozitive në rritje krahasuar me tavanet e miratuara me VKM nr. 535, date 29.7.2022 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025” për buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.



- **Fondet e parashikuara për vitin 2023** janë në shumën 47 miliard e 174 milion lekë, krahasuar me fondet e rishikuara të vitit 2022, kanë një rritje prej 3.8% ose në shumën 1 miliard e 715 milionë lekë. Fondet e parashikuara për vitin 2023, ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore, parashikohet të arrijnë në 6.9%, ndaj produktit të brendshëm bruto parashikohet të arrijnë në 2.2%.
- **Fondet e parashikuara për vitin 2024**, janë në shumën 48 miliard e 116 milion lekë, krahasuar me fondet e parashikuara të vitit 2022 kanë një rritje prej 2% ose në shumën 942.6 milionë lekë. Fondet e parashikuara për vitin 2024, ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore, parashikohet të arrijnë në 6.9%, ndaj produktit të brendshëm bruto parashikohet të arrijnë në 2.1%.
- **Fondet e parashikuara për vitin 2025**, janë në shumën 48 miliard e 796 milion lekë, krahasuar me fondet e parashikuara të vitit 2024 kanë një rritje prej 1.4% ose në shumën 680 milionë lekë. Fondet e parashikuara për vitin 2025, ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore, parashikohet të arrijnë në 6.7%, ndaj produktit të brendshëm bruto parashikohet të arrijnë në 2.0%.
- **Fondet publike për “Sektorin e Arsimit”**, parashikuar për periudhën afatmesme 2023-2025, përfshirë të ardhurat dytësore, fondet e ministrive të linjës për arsimin parashikuar nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financës dhe Ekonomisë “Fonde për arsimin”, fondet e parashikuara të njësive të vetëqeverisjes vendore “Për shërbimet dhe funksionet në arsimin parauniversitar”, si dhe fondet nga projekte të veçantë të donatorëve për arsimin (\*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private); parashikohet sa vijon
  - **në vitin 2023**, fondet publike për “Sektorin e Arsimit”, parashikohet të arrijnë në 67.7 miliard lekë, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin parashikohet të arrijnë **në 9.83% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.15%**;
  - **në vitin 2024**, fondet publike për “Sektorin e Arsimit”, parashikohet të arrijnë në 71.2 miliard lekë, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin parashikohet të arrijnë **në 10.21% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.15%**;
  - **në vitin 2025**, fondet publike për “Sektorin e Arsimit”, parashikohet të arrijnë në 75.5 miliard lekë, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin parashikohet të arrijnë **në 10.29 % dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.1%**;

### *Arsimi dhe formimi profesional*

Në fushën e politikave të AFP, janë zhvilluar politika të konsiderueshme të zhvillimit të aftësive dhe plotësime në kuadrin ligjor për ligjin e AFP dhe KSHK. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, si dokumenti kryesor i politikës që udhëzon zbatimin e veprimeve që lidhen me punësimin dhe zhvillimin e aftësive në vend është në proces hartimi. Gjithashtu është hartuar në zbatim të deklaratës së Osnabrück & monitorimi i rekomandimeve të AFP (2021-2025), Plani Kombëtar i Zbatimit në Shqipëri. Në të dy këto dokumente synimet janë të garantojë institucione efikase, angazhim efektiv të sektorit privat në AFP dhe punësim dhe reagim të shpejtë të AFP-së, dhe veçanërisht rëndësi i kushtohet masave dhe aktiviteteve që ndërmerren për **Transformimin digjital dhe tranzicionin e gjelbër**;

Numri i nxënësve që ndoqën arsimin profesional (publik dhe privat) në vitin shkollor 2021-2022, ishte 18.179 nxënës ose 17.7 e totalit të nxënësve në arsimin e mesëm. Numri i vajzave që ndjekin shkollat profesionale është 2174 nxënëse.

Gjithashtu në vitin arsimor 2021-2022 i ndoqën shkollat profesionale 512 nxënës nga komuniteti Romë dhe Egjiptiane. Po ashtu numri i nxënësve me aftësi të kufizuar ishte 233 nxënës.

Trendi i regjistrimeve vijon të jetë konstant në vitet e fundit. Sqarojmë se duke ju referuar të dhënave statistikore sipas INSTAT, numri i nxënësve që përfundojnë klasat e 9-ta nga viti në vit vjen në ulje, kjo sipas problemeve demografike, lëvizjes së lirë të njerëzve, etj.

Në vitin 2022, AKAFPK koordinoi zhvillimin e kualifikimit fillestar me temë “Bazat e didaktikës” për 34 mësimdhënësve të rinj profesionale, i cili përfundoi me certifikimin e tyre. Aktualisht, AKAFPK po koordinon kualifikimin e vazhdueshëm profesional të 64 mësuesve/instruktorëve profesional.

Një hap shtesë drejt sigurimit të cilësisë është procesi i vetëvlerësimit, i cili tashmë është një proces që kryhet çdo vit në të gjithë ofruesit e AFP-së. Gjithashtu, qasja e procesit të akreditimit të ofruesve të AFP-së, pasi është konsultuar me aktorët përkatës në Shqipëri, është miratuar me urdhrin nr. 128, datë 6.7.2021 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Aktualisht 6 ofrues të AFP-së janë në proces akreditimi.

Në përputhje me nevojat e tregut të punës për punonjës të kualifikuar, në vitin 2021 janë hartuar dhe miratuar 20 standarde profesionale, 21 standarde kualifikimi dhe korniza përkatëse për nivelet 2-5 të KSSH. Në prill të vitit 2021 u miratua Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale me 122 kualifikime për nivelet 2-5 të KSSH.

Procesi i ngritjes së komitetit të parë sektorial është një nga zhvillimet e reja në AFP në Shqipëri.

Në mbështetje të pikës 1, të VKM Nr. 426, datë 26.06.2019, “Për mënyrën e organizimit, funksionimit, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, si dhe urdhrin të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, nr. 64 datë 30.03.2021 është përcaktuar sektori i TIK-ut për ngritjen e Komitetit të parë sektorial. Komiteti Sektorial i TIK-ut është funksional dhe do të krijohet komiteti i dytë sektorial në fushën e hotelierisë dhe turizmit.

Për sa i përket vlefshmërisë së mësimin joformal dhe informal bazuar në mësimet e nxjerra nga projektet pilot është miratuar VKM Nr. 756, datë 13.12. 2021 “Për sistemin e njohjes së mësimin të mëparshëm informal dhe joformal.

Nëpërmjet qendrave publike të formimit profesional janë ofruar kurse formimi sipas kërkesave të tregut të punës. Për periudhën të viti 2021 janë regjistruar 14,211 persona, prej të cilëve femra 5,210, ndërsa janë certifikuarit rreth persona, 9,141.

## **Rinia**

### *Programi Kombëtar i Praktikave të Punës*

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës (PKPP) në administratën publike, synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe njohjen e administratës publike. Në thirrjen e 7-të të PKPP, kohëzgjatja e praktikave shtrihet nga data 12 shtator 2022 deri më 12 dhjetor 2022.

### *Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022 – 2029 (SKR)*

Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022 – 2029 është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave me datë 26.10.2022, sipas vendimit nr. 692 botuar në Fletoren Zyrtare me nr. 144, datë 01.11.2022.

SKR 2022 – 2029 përfshin 3 qëllime, 9 objektiva specifike, dhe një sërë masash dhe aktiviteteve të cilat është konsultuar me të gjitha palët e interesit si dhe rakorduar me rreth 20 institucione shtetërore. SKR parashikon hartimin e politikave për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve në Shqipëri dhe adresimin e problemeve me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si përfshirja në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve rekreacionale, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizmi etj.

### *Këshillat Vendor i Rinisë (KVR)*

Ligji 75/2019 “Për rininë” parashikon ndërtimin e një sistemi funksional rinor, si dhe struktura me kompetenca të posaçme që sigurojnë përfshirjen e të rinjve në proceset politkberëse në nivel qendror dhe vendor. Ky ligj detyron çdo Bashki që të parashikojë ngritjen e Këshillit Vendor të Rinisë pranë strukturave të veta. Gjithashtu, neni 10, pika ç e ligjit “Për rininë” përcakton Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, Tiranë, [www.kryeministria.al](http://www.kryeministria.al) se KVR “bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë”. Deri në fund të vitit 2022, 51 nga 61 bashkitë e vendit kanë ngritur KVR-në e tyre.

## **Kultura**

Gjatë vitit 2022-2023, një rëndësi e veçantë mbeten investimet publike, ku veçojmë ngritjen e Qendrës së re Kombëtare për Fëmijë, Rikonstruksionin e Galerisë Kombëtare të Arteve, si dhe Rikonstruksionin e Godinës së Teatrit të Kukullave. Në fushën e artit dhe kulturës vazhdohet me Projektin “Parku i Artit”, Kalendarin Kulturor Shqipëri-Kosovë, Garat kombëtare, Tetori i Librit, Krijimtaria letrare për fëmijë, Fondi për përkthim nga shqipja në gjuhë të huaj dhe anasjelltas.

Industria Krijuese, do të ketë në fokus formimin profesional në restaurimin dhe konservimin e veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore. Në muzikë dhe dramaturgji veçojmë krijimin e **Fondit të krijimtarisë muzikore**, i cili do të mbulojë të gjitha zhanret e muzikës instrumentale, si dhe të **Fondit të Teatrit për të rinj**, nismë që do të realizohet në bashkëpunim me Teatrin Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

Në fushën e bashkëpunimi ndërkombëtar, Shqipëria mori pjesë, ndërmjet tjerave, në **Edicionin e 59-të të Bienales të Artit në Venecia, Itali, 23 prill – 27 nëntor 2022**, me titull **“The Milk of Dreams”**, si dhe Ministria e Kulturës lancoi nismën e re **“Javët Kulturore Ndërkombëtare”**, në bashkëpunim me Ambasadat e Huaja të akredituara në vendin tonë.

Prioritet kanë pasur dhe do të kenë edhe në të ardhmen **“Projektet me Thirrje”**, ku gjatë vitit 2022 Ministria e Kulturës ka mbështetur në total 231 projekt propozime në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Në fushën e trashëgimisë kulturore gjatë 2022 u organizuan ***Ditët Evropiane të Trashëgimisë*** me 24-30 shtator 2022; u dorëzuan në UNESCO-s dosjet për kandidimin e dukurive **“Xhubleta”** dhe **“Kërcimi i Tropojës”**, ku **“Xhubleta”** u miratua në fund të nëntorit 2022 në Listën e UNESCO-s të Trashëgimisë Botërore Jomateriale. Gjithashtu është përgatitur dosja për kandidimin e ***Arkivit të Muzeut Kombëtare të Fotografisë “Marubi”*** në Programin **“Memory of the World”** të UNESCO-s.

Lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e kulturës, Ministria e Kulturës gjatë periudhës Janar-Tetor 2022 ka nënshkruar 14 marrëveshje kulturore dhe aktualisht janë në proces 8 marrëveshje të tjera..

Referuar programeve të Bashkimit Evropian, Marrëveshja për pjesëmarrjen e plotë të vendit tonë në Programin **“Evropa Krijuese 2021-2027”** është ratifikuar tashmë me Ligjin nr. 22/2022, ndërkohë draft-marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së për pjesëmarrjen e vendit tonë në Programin **“Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat (CERV) 2021 – 2027”**, është aktualisht në proces konsultimi dhe negociimi.

## 26.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS);
- Ministria e Kulturës (MK);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF);
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP);
- Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA);
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL);

- Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFPK);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Brendshme (MB).

## 26.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Sipas raportit për Shqipërinë të vitit 2021 si dhe ai i vitit 2022 Shqipëria konsiderohet si e përgatitur mesatarisht në fushën e arsimit dhe kulturës. Dy prej rekomandimeve ai i përfundimit të strategjisë së re për arsimin në të gjitha nivelet, dhe strategjisë për rininë janë miratuar tashmë dhe janë në fazën e zbatimit.

**Disa nga prioritetet e MAS mbështetur në Programin e Qeverisë 2021-2025, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, si dhe në SKA 2021-2026 janë:** përmirësimin e zhvillimit profesional dhe trajnimit të mësuesve dhe trajnerëve digjitalizimi në arsim dhe fuqizimi i kompetencave digjitale; trajnim për mësuesit e IT dhe për të gjithë mësuesit e sistemit të arsimit parauniversitar; të mësuarit e gjuhës angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë; edukimi për zejet dhe artet në arsimin parauniversitar; shtimi i klasave të profilizuara sportive; përmirësimi i shërbimit për nxënësit me aftësi ndryshe, kthimi i shkollave speciale në qendra burimore; tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit e arsimit bazë , përfshirë edhe kategoritë e veçanta; reduktimi i numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive; ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë për hapjen e filialeve të institucioneve të arsimit të lartë të huaja si dhe për programet e studimit të përbashkëta dhe të dyfishta me to, mobiliteti i studentëve dhe stafeve akademike si edhe mbështetjen për hapjen e programe ne gjuhën angleze; investime infrastrukturore si në kampuse dhe investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe sigurim të integritet akademik dhe shkencor të institucioneve të arsimit të lartë me qëllim përmirësimin e cilësisë së produktit universitar; anëtarësimi i ASCAL në ENQA dhe regjistrimi i saj në EQAR; optimizimin e sistemit të AFP-së për të zhvilluar shërbimet dhe kompetencat në përputhje me nevojat e tregut të punës.

## *Rinia*

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022 – 2029 bazohet në dokumentet të cilat kanë në vëmendje edhe rininë, si: Programi i Qeverisë 2021-2025; Marrëveshja e Stabilizim Asocimit; Strategjia për Rininë në BE; Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. SKR 2022 – 2029 synon realizimin e tre qëllimeve politike:

**Qëllimi i Politikës 1:** Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.

**Qëllimi i politikës 2:** Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

**Qëllimi i politikës 3:** Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

### ***Kultura***

Prioriteti kryesor në fushën e artit dhe kulturës mbetet intensifikimi i përpjekjeve për realizimin e objektivave të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019 – 2025”, miratuar me VKM Nr. 903, datë 24.12.2019, si dhe zbatimin e Planit të saj të Veprimit. Në këtë Dokument strategjik janë marrë në konsideratë eksperiencat më të mira në këtë fushë, në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, si dhe me planifikimin buxhetor afatmesëm.

Ndërkohë vazhdon puna për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

## KAPITULLI 29: BASHKIMI DOGANOR

### 29.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së në fushën e Bashkimit Doganor është direkt i detyrueshëm për Shtetet Anëtare, duke siguruar funksionimin e bashkimit doganor si dhe mbrojtjen efektive dhe kontrollin e kufijve të jashtëm. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë ekzistencën e kapaciteteve të nevojshme zbatuese, duke përfshirë lidhjet me sistemet relevante të kompjuterizuara të BE-së. Shërbimet doganore gjithashtu duhet të sigurojnë kapacitete adekuate për zbatimin e rregullave të veçanta të përcaktuara në fushat përkatëse të *acquis* siç janë tregtia e jashtme, dispozitat për shëndetin dhe sigurinë.

### 29.2 Struktura e kapitullit

N/A

### 29.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit, nenet 13, 14, 15, 34, 43, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 41 dhe Protokolli 4 përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në veçanti neni 97 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin për të përafuar legjislacionin doganor shqiptar me atë të BE-së, bashkëpunimin mes Palëve duke pasur parasysh *acquis* në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencë të ndërsjellë administrative në çështje doganore.

*Acquis* në fushën e Bashkimit Doganor përfshijnë Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, Nomenklaturën e Kombinar, tarifën e përbashkët doganore dhe klasifikimin tarifor, lehtësimin e detyrimeve doganore, pezullimet doganore dhe kuotat e caktuara tarifore, si dhe dispozita të tjera të tilla si ato mbi kontrollin doganor të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore dhe transitin.

Implementimi i *acquis* të Bashkimit Doganor kërkon ekzistencën efektive të autoriteteve doganore, në secilin Shtet Anëtar për të siguruar zbatimin korrekt, uniform të rregullave doganore dhe kur është e përshtatshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme për mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore.

#### 29.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është e përgatitur mesatarisht në fushën e bashkimit doganor. Përparim i kufizuar, është shënuar veçanërisht duke zbatuar rregullat kalimtare të origjinës në zonën pan-Euro-Mesdhetare, duke forcuar kapacitetet dhe duke përmirësuar bashkëpunimin midis organeve të përfshira në luftën kundër kontrabandës dhe importit të mallrave të falsifikuara, midis Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar që janë konfirmuar nga CEFTA, si dhe duke bërë digjitalizimin e shërbimeve.

Shqipëria ka avancuar me zbatimin e programit të saj të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA) duke autorizuar 8 operatorët e parë ekonomikë në vitin 2021. Gjithashtu në 1 Nëntor 2022 është autorizuar kompania e 9-të me statusin OEA.

Legjislacioni doganor lidhur me Operatorët Ekonomikë të Autorizuar është i njëjtë me atë të BE-së. Dispozitat për OEA dhe procedurat e thjeshtuara kanë hyrë në fuqi nga 1 janari 2015. Ato parashikohen në Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i cili është në përputhje me Rregulloren nr. 952/2013 “Kodi Doganor i Bashkimit Evropian”) dhe VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014”.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka miratuar Udhëzimin nr. 6, datë 19.10.2020 (nr. prot.,19532, datë 19.10.2020) “Mbi zbatimin praktik të procedurave të aplikimit, miratimit, funksionimit dhe mbikëqyrjes së thjeshtimeve doganore dhe Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar”. Sipas AUTHORISED ECONOMIC OPERATORS GUIDELINES, TAXUD/B2/047/2011- Rev.6, approved by the CCC GEN (AEO subsection) on 11 March 2016 [https://taxation-customs.ec.europa.eu/system/files/2017-03/aeo\\_guidelines\\_en.pdf](https://taxation-customs.ec.europa.eu/system/files/2017-03/aeo_guidelines_en.pdf).

Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kanë organizuar fushata të ndërgjegjësimit të publikut me përfaqësues të biznesit dhe sindikatave mbi promovimin e përfitimeve/avantazheve dhe kriterëve për t'u plotësuar për pajisjen me autorizim të AEO. Si rezultat i kësaj fushate ka 15 aplikime për autorizim nga kompanitë të cilat janë nën procesin e shqyrtimit dhe plotësimit të dokumenteve të kërkuara. Janë autorizuar 9 operatorë ekonomikë gjatë vitit 2021 – 2022.

Në kuadër të njohjes reciproke të OEA me vendet e CEFTA-s, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës pranë Sekretariatit të CEFTA-s. Dogana Shqiptare në bashkëpunim me GIZ për zbatimin e projektit pilot rajonal të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar ka dorëzuar gjatë 2022, dokumentacionin ligjor në gjuhën angleze për finalizimin e kësaj procedure.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe GIZ kanë organizuar në muajin prill 2022 projektin pilot të validimit i cili ka për qëllim të mbështesë administratën Doganore të Shqipërisë në përgatitjen e misionit të Validimit të CEFTA. Të pranishëm në këtë aktivitet do të jenë edhe homologë të Doganës Kosovare. Për më tepër, ky mision gjithashtu shërbeu si një forum për konsultime dhe diskutime për të gjitha çështjet e hapura që lidhen me fushat e përmirësimit të mundshëm, si dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm që duhen të ndërmerren nga Administrata Doganore Shqiptare.

Sekretariati CEFTA mori në konsideratë kërkesën e parashtruar nga Administrata Doganore Shqiptare (ADSH) duke bërë të mundur dërgimin e ekipit të Validimit në Shqipëri. Pas kontrollit të detajuar të dokumentacionit që vërtetonte procedurën e autorizimit, Grupi i Validimit të CEFTA (Pjesëmarrës Kosove, Serbi, Mal i Zi, Bosnje, Moldavi, Maqedonia e Veriut) me vëzhgues nga DG TAXUD dolën në konkluzionin se:

- Dogana ka implementuar dhe vënë në funksion Autorizimin dhe Monitorimin e AEO-ve.
- Programi Shqiptar i OEA plotëson pritshmëritë dhe kriteret e Protokollit shtesë 5 të CEFTA dhe është në përputhje me standardet e Programit OEA të EU dhe OBD.
- Ekipi Validues i CEFTA-s do të japë Opinion Pozitiv pranë Komitetit të Lehtësimit të Tregtisë të CEFTA dhe do të rekomandojë Njohjen e Përbashkët të Programit OEA të Shqipërisë në Komitetit e Përbashkët të CEFTA (Joint Committee).

Shqipëria ka nënshkruar gjithashtu 2 marrëveshje për Njohjen e ndërsjellë të OEA me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Në kuadër të Iniciativës për Ballkanin e Hapur të tre vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet palëve për të lehtësuar më tej tregtinë, eksportin, importin dhe transitin ndërmjet këtyre vendeve. Bazuar në këtë memorandum:

Më 21 dhjetor 2021 u nënshkruan dy marrëveshje dypalëshe për OAE:



- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, për njohjen reciproke të autorizimeve të Operatorit Ekonomik të Autorizuar - Sigurinë dhe Mbrojtjen (-OEA), miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 2.03.2022.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për njohjen reciproke të Autorizimeve të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar - Siguri dhe Mbrojtje (AEOS), miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 2.03.2022. (ka hyrë në fuqi më 16 shtator 2022)

Gjithashtu më 1 shtator 2022 u nënshkrua Protokollin ndërmjet Ministrisë së Financave - Administratës Doganore të Republikës së Serbisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për njohjen reciproke të autorizimeve të operatorëve ekonomikë të autorizuar - sigurisë dhe mbrojtjes (AEOS) ndërmjet Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Më 14.11.2022 u nënshkrua Protokollin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë dhe Administratës Doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për krijimin e pikave të përbashkëta kufitare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pikën ndërkombëtare kufitare Kjafasan (Republika e Maqedonisë së Veriut) - Qafë-Thanë (Republika e Shqipërisë).

Marrëveshjet synojnë të eliminojnë pengesat për tregtinë e tyre të ndërsjellë dhe të krijojnë në mënyrë progresive një marrëdhënie më të ngushtë dhe të përmirësojnë sigurinë në lëvizjen e mallrave që hyjnë ose dalin nga territoret e shtetit të tyre, pa ndërprerë flukset tregtare, bazuar në procesin e harmonizimit të BE-së në nxitjen e njohjes së ndërsjellë të Programeve OAE.

Sa i përket certifikimit elektronik të dokumentacionit dhe nënshkrimit elektronik të deklaratës nga ana e Operatorëve Ekonomikë/Agjentëve Doganorë, si dhe nga ana e punonjësve doganorë zbatohet vula elektronike.

Nomenklatura e Kombinuar Mallrave (NKM) miratohet çdo vit duke përafuar Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave të BE. Me VKM Nr. 883, datë 27.12.2022 është miratuar Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave 2023, e cila përafuron pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (EU) 2022/1998, datë 20 shtator 2022, amendim i Rregullores së Këshillit Evropian (EEC) nr. 2658/87, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 282/1, datë 31.10.2022.

Shqipëria zbaton Konventën Rajonale mbi rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Mesdhetare (Ligji 1/2012 datë 26.01.2012).

Nga 1 shtator 2021 Shqipëria ka filluar zbatimin e rregullave transitore të origjinës preferenciale të Konventës PEM me BE (Ligji nr. 98/2021 datë 07.07.2021), nga 1 janar 2022 me vendet EFTA

(Ligjet Nr. 99/2021 datë 7.07.2021 si dhe 122/2021) dhe nga 1 shkurt 2023 me vendet CEFTA (Ligji nr. 101/2021 datë 7.07.2021).

Ligji nr. 101/2021 datë 7.07.2021 ka ndryshuar Shtojcën 4 të Marrëveshjes CEFTA 2006 për të mundësuar zbatimin e rregullave transitore të origjinës preferenciale të Konventës PEM si rregulla alternative.

Është miratuar edhe Ligji nr. 99/2021 datë 7.07.2021 i cili ka ndryshuar Protokollin B të MTL me vendet EFTA si dhe ndryshuar marrëveshjet bilaterale për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë e Republikës së Islandës, duke mundësuar zbatimin e rregullave transitore të origjinës preferenciale të Konventës PEM si rregulla alternative.

Nga 3 maj 2021 ka filluar të zbatohet Ligji nr. 82/2020 datë 2.07.2020, i cili ka zëvendësuar Protokollin II të MTL me Turqinë (Koncepti i “produkteve origjinës” dhe “metodat e bashkëpunimit administrativ”) me Konventën Rajonale mbi rregullat pan-Euro-Mesdhetare të origjinës preferenciale.

Më 3 maj 2021 Shqipëria ka nisur zbatimin e Marrëveshjes së Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (Ligji nr. 31 datë 8.03. 2021).

Së shpejti fillon puna për ndryshimet në Kodin Doganor, në Dispozitat Zbatuese të tij dhe disa manuale udhëzues, që synojnë përafrimin me *acquis* dhe manualët përkatëse të BE-së.

Me Ligjin nr. 62/2019 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Për Lehtësimin e Tregtisë dhe të Transportit në Ballkanin Perëndimor” me qasje programatike me shumë faza”, është parashikuar implementimi i sistemit NCTS si dhe përafrimi i mëtejshëm i *acquis* të BE në lidhje me dispozitat për NCTS. Ky projekt përfshin gjithashtu edhe komponentët e Sportelit të Vetëm (*Single Window*), dhe Pikën e Përbashkët të Kalimit të Kufirit (me Maqedoninë e Veriut) në Qafë Thanë. Data e pritshme për përfundimin e projektit është data 15 dhjetor 2025. Tashmë ka nisur zyrtarisht zbatimi i projektit të NCTS, i cili parashikon hartimin e kërkesave/specifikimeve teknike për zhvillimin dhe zbatimin e NCTS. Kjo detyrë përfshin përgatitjen e ligjeve dhe rregulloreve të reja që lidhen me NCTS si dhe përgatitjen e kërkesave teknike dhe funksionale dhe specifikimet e grafikut të punës dhe çdo kërkesë tjetër të nevojshme për fazën 5 të NCTS. Zbatimi i NCTS synon standardizimin e proceseve për NCTS.

Në kuadër të ndryshimeve që do të bëhen Kodit Doganor, dhe Dispozitave Zbatuese të tij që synojnë përafrimin e ndryshimeve të *acquis* përkatëse të BE-së, do të vlerësohen edhe ndryshimet për transitin e përbashkët.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është një nga përfituesit e Investimit të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), fazës së parë me fokus “Lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor (WBTFP)”. Komponentët e Doganës përfshijnë edhe Projektet për zhvillimin e Sportelit të Vetëm Kombëtar (National Single Window). Marrëveshja e huasë është nënshkruar në datën 19/06/2019 nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeveria e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Që prej Shkurtit 2020 Njësia PIU për Zbatimin e Projektit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave po ndjek procedurat e implementimit dhe kontraktimeve në kuadër të këtij Projekti. Në kuadër të këtij Projekti të Bankës Botërore është kontraktuar në nëntor 2020 kompania KGH Customs Services për të dizenuar NSW në tre shtete: Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni e Veriut. Qëllimi i projektit që po zbatohet nga KGH Customs Services është hartimi i “Blueprinti/Udhërrëfyese për Sportelin e Vetëm Kombëtar (NSW) për Shqipërinë”.

Blueprinti /Udhërrëfyese për Sportelin e Vetëm Kombëtar (NSW) për Shqipërinë është dorëzuar dhe përmbledh analizat dhe vendimet kryesore të marra për disa aspekte të rëndësishme të Sportelit të Vetëm Kombëtar, duke përfshirë strukturën drejtuese për të mbikëqyrur NS-në, modelin operacional dhe strukturën e tarifave për të mbështetur operacionet, një program të menaxhimit të ndryshimit dhe një plan zbatimi të NSW.

Ky sistem do të shërbejë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) dhe të gjitha Institucionet e tjera shtetërore që do të konsiderohen përfitues gjithashtu, që ofrojnë dhe lëshojnë certifikata, licenca apo autorizime për Subjektet që kryejnë IM, EX dhe T1 në Shqipëri që - kanë të domosdoshëm këto dokumente. Është një Sistem që do të lehtësojë shumë: që nga faza e Aplikimit deri në atë të Miratimit të këtyre dokumenteve në shërbim të Biznesit por dhe të procedurës doganore gjithashtu, duke shkurtuar kohën dhe pengesat e deritanishme të këtyre procedurave.

Përmes Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” është miratuar Baza Kombëtare e të Dhënave të Vlerësimit, si një instrument i njohur dhe i rekomanduar nga Organizata Botërore e Doganave. Kjo bazë të dhënash përdoret gjatë procesit të vlerësimit doganor të mallrave kur nuk pranohet vlera e deklaruar (vlera e transaksionit) në respektim të metodologjisë së vlerësimit doganor. Gjatë periudhës 1 janar – 31 tetor 2022 zhdoganimi me metodën e transaksionit ka qenë rreth 92.5% e totalit, krahasuar me 94% që ishte në periudhën e mëparshme. Metodatat alternative të Metodologjisë së Vlerësimit Doganor kanë qenë rreth 7.5% krahasuar me 6% për periudhën e mëparshme. Përdorimi i të dhënave të disponueshme i nënshtrohet kryesisht mallrave me vlerë të ulët tregu dhe atyre me origjinë jashtë vendeve të BE-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të misionit të saj mbrojtës dhe të sigurisë ushtron kontrolle me bazë rrisht (profilat e rrishtit janë efektive në sistemin ASYCUDA World prej vitit 2012) mbi importin, eksportin dhe transitin e lëndëve narkotike dhe prekursorëve psikotropikë të narkotikëve. Sistemi i kontrollit doganor për prekursorët e drogës, produktet kimike të rrezikshme

dhe "substancat e kontrolluara" është harmonizuar me Konventën e OKB-së të vitit 1988 kundër trafikut të paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotrope.

Në janar 2021, autoriteti doganor nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me policinë për të aderuar në platformën Europol SIENA. Është kryer lidhja fizike me lidhje drejtpërdrejt me fibër optike DPD - DPPSH. Janë kryer konfigurimet teknike nga të dyja palët për mundësinë e aksesimit të sistemit SIENA vetëm tek përdoruesit e përcaktuar nga DPD.

Në vijim të komunikimeve me Zyrën Kombëtare të EUROPOL-it, ADSH i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në datë 27 tetor 2022 për hapjen e aksesit në sistemin elektronik SIENA për punonjësit e trajnuar.

Gjithashtu, në mars 2021, është bërë funksionale baza e të dhënave nCEN (rrjeti kombëtar i zbatimit të doganave) e Organizatës Botërore të Doganave (OBD). Aktualisht nCEN po përdoret në versionin 3.3.1 dhe përditësimet bëhen herë pas here. nCEN ka mundësuar një rritje të ndjeshme të numrit të hedhjeve të sekuestrimeve në sistem, si dhe mbledhjen dhe mirëorganizimin e të dhënave të ndryshme, të gatshme për t'u përdorur sipas nevojave të administratës sonë doganore.

Në datën 9.09.2022 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Shkëmbimin Elektronik të të Dhënave ndërmjet Administratës Doganore të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Doganave, Akcizave dhe Monopoleve (ADM) të Republikës së Italisë.

Në luftën kundër krimit të organizuar, kontrabandës dhe trafikimit, vëmendje e veçantë dhe intensifikimi i kontroleve rutinë dhe/ose specifike të veprimtarisë doganore, veçanërisht në PKK, është ndërmarrë nga Drejtoria e Hetimit.

Vlera e deklaramit "cash" në kufi, që prej datës 25.07.2019, është 10,000 euro. Kjo është rregulluar me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar dhe është në linjë me Rregulloren (BE) 2018/1672 e Parlamentin Evropian dhe e Këshillit e 23 tetor 2018 për kontrollin e parave cash në hyrje ose dalje nga Unioni, që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1889/2005.

Për sa i takon formës së deklaramit, ajo kryhet në formatin elektronik, pranë Autoriteteve Doganore, në hyrje/dalje të Republikës së Shqipërisë. Formulari deklaramit është në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1672 e Parlamentin Evropian dhe e Këshillit Evropian e 23 tetor 2018 për kontrollin e parave cash në hyrje ose dalje nga Unioni, që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1889/2005. Ndryshimet e ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, (shtuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019), parashikojnë vendosjen e sanksioneve (gjopa) nga Administrata Doganore sipas rasteve dhe shumave të caktuara kur konstatohet mosdeklarim.

Me Urdhër nr. 16 datë 30.03.2022 të Drejtorit Administrativ të QNOD (Ministria e Mbrojtjes), është miratuar Rregullorja "Për Organizimin dhe Funkionimin e Brendshëm të Bazës së të

Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar”, ku edhe përfaqësuesi i Drejtorisë së Antikontrabandës dhe përfaqësuesve të DPD, ka kontribuar në hartimin dhe finalizimin e kësaj rregulloreje. Në sistem administrohen të gjitha lëvizjet dhe veprimtaritë e anijeve (mjeteve lundruese), që hyjnë/dalin në/nga Portet Detare Shqiptare dhe lëvizin/lundrojnë në ujërat tona, në përputhje me Konventën Ndërkombëtare IMO FAL dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Baza e të dhënave mundëson informacion të integruar në kohë reale, të të gjitha mjeteve të lundrimit, me natyrë tregtare ose jo.

Sistemet e Teknologjisë së Informacionit (TI)-së janë plotësisht të ndërlidhura me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, ndërsa kushtet për akses të drejtpërdrejtë janë krijuar për policinë dhe prokurorinë, si dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Organika e Administratës Doganore Shqiptare përcaktohet në VKM 355 datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Personelin e Administratës Doganore”, të ndryshuar dhe përbëhet në total nga 1,074 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) me 429 punonjës dhe nivel vendor (18 Degë Doganore) 647 punonjës. Organika e Administratës Doganore Shqiptare sipas VKM 355 datë 26.05.2022 është në proces implementimi.

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale (DASP) ka trajtuar raste, denoncime/ankesa, kërkesa për informacion mbi procedurat doganore, të mbërritura nëpërmjet Numrit Jeshil, adresës [antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al](mailto:antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al), si dhe raste kur është kërkuar asistencë nga Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion i atashuar në Administratën Doganore Shqiptare.

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u atashua Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion, e cila bazuar në VKM-në nr. 899 datë 18.11.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, si dhe VKM-ja nr. 618 datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit” mund të kërkojë asistencë nga Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale, si edhe nga strukturat e tjera doganore.

Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, dy specialistë të Drejtorisë së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale u caktuan pika kontakti të DPD me Koordinatorin e Bashkëqeverisjes në MFE. Që nga ngritja e kësaj strukturë, referuar ligjit për Bashkëqeverisjen, kësaj periudhë janë adresuar/koordinuar brenda afateve ligjore të përcaktuara 64 raste të mbërritura në Platformën e Bashkëqeverisjes adresuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Kjo strukturë kryen në Ministrinë e Financave edhe raportimin ditor mbi ecurinë e procesit të ankesave.

Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale, ka një punonjës të caktuar si Njësi Përgjegjëse për Sinjalizuesit, referuar Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm. Pas një inspektimi të kryer nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë e Konfliktit të Interesit

(ILDKPKI) rezultoi se Njësia Përgjegjëse ka përmbushur të gjithë detyrat që burojnë nga legjislacioni në fuqi për Njësitë Përgjegjëse në institucione, ndërsa u rekomandua të kryhet një sesion riinformimi në Degët Doganore lidhur me ligjin për sinjalizuesit. Njësia Përgjegjëse në DPD po realizon vendosjen e njoftimeve për këtë Njësi në të gjithë Degët Doganore, si edhe ka hartuar një material prezantues të sinjalizimit të korrupsionit që, gjithashtu, po prezantohet në Degët Doganore duke përmbushur dhe kryer një fushatë tjetër sensibilizimi për punonjësit.

Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (DMPI) ka koordinuar organizimin e operacioneve të përbashkëta ndërinstitucionale me strukturat brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave edhe me struktura ndërkombëtare.

DMPI mori pjesë aktive në operacion Balkan Gate që u finalizuar me 1 kapje të një sasive atlete sportive. DMPI mori pjesë aktive në operacion Balkan Gate 2, operacioni i organizuar nga Organizata Botërore e Doganave (OBD) përfshinte 10 administrata doganore nga rajoni, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Greqia, Italia, Mali i Zi, Kosova, Malta, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe përkatësisht Shqipëria. Operacioni u finalizua me 1 kapje të një sasive atlete sportive. Dogana Shqiptare u vlerësua për përkushtimin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me Njësinë e Koordinimit Operacional (OCU).

Përgjatë vitit 2022 në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale VKM Nr. 350/26.05.2022, janë zhvilluar trajnime teorike dhe praktike mbi përditësimin e njohurive legjislacionin për Pronësinë Industriale me metodën “Trajnim në vendin e punës”, dhe mbi përdorimin e sistemit Ines +. Numri i stafit doganor të trajnuar në total është 40 veta ka zhvilluar dhe ka marrë pjesë në trajnime në fushën e pronësisë intelektuale. 0 persona në nivelin lokal.

Më 1 janar 2023, ka hyrë në fuqi VKM nr. 800, datë 24.12.2021 “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2023”.

Sistemi doganor “paperless” për procedurat e import-eksportit zbatohet që prej datës 16.05.2019. Aplikimet për regjime doganore (magazinimi doganor, regjimi i përpunimit aktiv, regjimi i përpunimit pasiv dhe regjimi i lejimit të përkohshëm), kryhen përmes shërbimit e-Albania.

Për rritjen e aftësisë profesionale dhe në përputhje me nevojat e punonjësve, në vitin 2022 nga data 1 janar deri në 31 tetor janë zhvilluar 92 trajnime, ku janë trajnuar 867 punonjës të Administratës Doganore.

Lidhur me fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzetë, informacioni i detajuar jepet në kapitullin 1 “Lëvizja e Lirë e Mallrave”.

## 29.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria Kulturës;
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Instituti i Statistikave.

## 29.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Mangësitë e identifikuar janë:

- Projektvendimi për përcaktimin e rregullave për vendosjen e sanksioneve administrative nga organet doganore për mosdeklarimin/deklarimin e gabuar të parasë cash dhe sendeve me vlerë të çmuar në kufi nuk është miratuar akoma;
- Dispozitat e Kodit Doganor dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave për transitin e përbashkët janë në proces;
- Të intensifikojë përpjekjet për të vazhduar luftën kundër kontrabandës, korrupsionit dhe importit të produkteve të falsifikuara duke përfshirë forcimin e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis organeve të përfshira;
- Të aderojë në Protokollin FCTC (Kuatër Marrëveshja mbi Kontrollin e Duhanit) për të Eliminuar Tregtinë e Jashtëligjshme të Produkteve të Duhanit;
- Vendosja e “Tarifave të skanimit” për deklaraten doganore vazhdon të jetë në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit e cila ndalon detyrimet doganore ose tarifatat që kanë efekt të ngjashëm në tregtinë midis BE-së dhe Shqipërisë;
- Kontrabanda ndërkufitare e produkteve të duhanit dhe aktivitete të tjera të paligjshme në rajonet kufitare vazhdojnë të jenë një fushë e rëndësishme ku nevojitet përmirësimi i mëtejshme i mjeteve të bashkëpunimit dhe ato kundër mashtrimit.

Prioritetet janë:

- Përmirësimi i procedurave doganore në mënyrë që të rritet mbledhja e efikase e detyrimeve është një nga prioritetet kryesore në këtë fushë;
- Avancimi me regjistrimin e operatorëve ekonomik të autorizuar, ndjekjes së luftës kundër kontrabandës, dhe trafikeve të paligjshme importeve të produkteve të falsifikuara dhe korrupsionit;
- Ndjekja dhe zbatimi korrekt i Ligjit Nr. 62/2019, për zhvillimin dhe zbatimin e projektit të Sportelit të Vetëm (Single Window), Platformës NCTS (New Computerised Transit System), si dhe implementimi i Pikës së Përbashkët të Kalimit të Kufirit (me Maqedoninë e Veriut) në Qafë Thanë;
- Implementimi i korsive të gjelbra me vendet kufitare të BE-së;
- Përmirësimi dhe shtimi i numrit të aplikimeve online për Autorizime të cilat miratohen nga Administrata Doganore nëpërmjet portalit e-albania;

- Përmirësimi dhe zhvillim i sistemit informatik doganor për deklarimin para mbërritjes së mallrave;
- Miratimi dhe publikimi zyrtar i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave;
- Miratimi i dispozitave zbatuese të Ligjit Nr. 33, datë 17.6.2019 në lidhje me procedurat për vendosjen e sanksioneve (gjobë) nga autoriteti doganor në rastet e mosdeklarimit apo deklarimeve të rremë të parasë cash në kufi.
- Miratimi i ndryshimeve në Kodin Doganor, Dispozitat Zbatuese, dhe miratimi i akteve të nivelit të tretë në zbatim të tyre, duke përfshirë këtu dispozitat për transitin e përbashkët;
- Lufta kundër shkeljeve ndaj pronësisë intelektuale në doganë, sistemit të menaxhimit të riskut sipas modeleve të harmonizuara të menaxhimit të riskut të BE-së, si dhe bashkëpunimit aktiv me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



## GRUPIMI IV: AGJENDA E GJELBËR DHE KONEKTIVITETI I QËNDRUESHËM

### KAPITULLI 14: POLITIKA E TRANSPORTIT

#### 14.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së për sektorin e transportit synon përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm duke promovuar shërbime të sigurta, efikase dhe miqësore me mjedisin. Legjislacioni i fushës së transportit mbulon sektorët e transportit rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm, transportin e kombinuar, transportin ajror dhe detar. Ai ka të bëjë me standardet teknike dhe të sigurisë, standardet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në kontekstin e tregut të brendshëm të transportit.

#### 14.2 Struktura e kapitullit

- Transporti rrugor
- Transporti hekurudhor
- Transporti detar
- Transporti ajror
- Transporti i kombinuar

#### 14.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikën e transportit rregullohet nga disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Neni 106 “Transporti” parashikon që palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së, me qëllim ristrukturimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit shqiptar, përmirësimin e lëvizjes së lirë të udhëtarëve dhe mallrave, lehtësimin e aksesit në tregun dhe infrastrukturën e transportit, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe

lidhjen me rrjetet kryesore trans-evropiane dhe arrijten e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Neni 59 i MSA-së në lidhje me Protokollin 5 “Për transportin tokësor” përcakton detyrimet e palëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit midis Komunitetit dhe Shqipërisë. Neni 59 parashikon se palët do të sigurojnë trafikun rrugor transit të pakufizuar bazuar në zbatimin efektiv të parimit të mosdiskriminimit. Në transportin detar, palët do të aplikojnë në mënyrë efektive parimin e aksesit të pakufizuar në treg dhe trafik në baza komerciale pa hyrë në marrëveshje për ndarjen e mallrave me shtetet e treta, duke eliminuar të gjitha masat e njëanshme dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera që mund të pengojnë aksesin në transportin detar dhe garantimin e trajtimit kombëtar ndaj anijeve të palës tjetër. Në transportin ajror, palët do të bien dakord mbi kushtet e aksesit të ndërsjellët në tregun e transportit ajror.

Neni 70 dhe Neni 59(6) përcaktojnë se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së me qëllim përmirësimin e sistemit të transportit dhe shërbimeve të transportit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat në kapitullin 14 i përkasin grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian, d.m.th. grupit të kompetencave të ndara mes Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare. Sipas Nenit 4 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si Bashkimi Evropian ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjore në fushën e transportit. Shtetet anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk e ushtron këtë kompetencë ose ka vendosur të mos e ushtrojë këtë kompetencë.

Politika e transportit e BE-së ndihmon në mbajtjen në lëvizje të ekonomisë evropiane duke zhvilluar një rrjet modern të infrastrukturës që i bën udhëtimet më të shpejta dhe më të sigurta, duke promovuar zgjidhje të qëndrueshme dhe digjitale. Transporti është një element kyç i integritetit evropian dhe është thelbësor për plotësimin e lirisë së punëtorëve, shërbimeve dhe mallrave. Zbatimi i mënyrave të qëndrueshme dhe inovative të transportit luan një rol të rëndësishëm në plotësimin e objektivave të Bashkimit Evropian në fushën e energjisë dhe klimës. Objektivat e politikës së transportit të Bashkimit Evropian janë: të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm duke nxitur krijimin e një sistemi të integruar transporti të sigurt, konkurrues, me përdorim eficient të burimeve, që respekton mjedisin, lehtësisht të përdorshëm dhe efektiv, i cili ofron një nivel të lartë të lëvizjes së qëndrueshme në Bashkimin Evropian, duke mbrojtur mjedisin, duke promovuar standardet e punës dhe kualifikimeve për sektorin dhe duke mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve. Politika e transportit të qëndrueshëm e Bashkimit Evropian kërkon një sistem transporti të integruar, ndërveprues dhe të ndërlidhur për të përballuar nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë.

Politika e transportit e Bashkimit Evropian rregullohet nga Titulli VI, nenet 90 – 100 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Një pjesë e rëndësishme e *acquis* përbëhet nga legjislacioni i detyrueshëm dhe i zbatueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në formën e rregulloreve dhe vendimeve. Pjesa e mbetur e *acquis* në këtë kapitull, përbëhet nga direktiva, rregullore, vendime, etj., që kanë nevojë të transpozohen.

*Acquis* në këtë kapitull mbulon transportin rrugor, atë hekurudhor, transportin e brendshëm ujor, transportin e kombinuar, aviacionin, transportin detar dhe navigacionin satelitor.

Pjesë të *acquis* në këtë kapitull janë të mbuluara nga Marrëveshja për Zonën Evropiane të Përbashkëta të Aviacionit, konkretisht në Aneksin I.

#### 14.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Dokumenti strategjik bazë për sektorin e transportit është Strategjia Sektoriale e Transportit 2016 – 2020 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”.

Aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përditësuar strategjinë ekzistuese, duke hartuar një dokument të ri “Strategjia Sektoriale e Transportit 2021 – 2026, i cili ka në bazë të tij dokumentet strategjike të BE-së në fushën e transportit.

Dokumente të tjera strategjike në sektorin e transportit janë edhe “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, miratuar me Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 40, datë 21.01.2020, dokument i cili po zbatohet, duke qenë se konsiderohet si një instrument në funksion të politikave të transportit. Aktualisht Instituti i Transportit, në zbatim të urdhrin të sipërpërmendur ka filluar rishikimin vjetor të PKT3, me qëllim reflektimin e zhvillimeve dhe projekteve të reja në sektorin e transportit.

Në transportin rrugor, krahas projekteve për implementimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor, në zbatim të Urdhrit Nr. 185, datë 18.6.2020 “Për zbatimin e Strategjisë për aplikimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor”, ka vazhduar puna për përafrimin e legjislacionit të fushës me *acquis* të BE-së, për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe në zbatimin të ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.

Akti ligjor bazë në sektorin e transportit hekurudhor është Ligji Nr. 142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Ky akt ligjor është i përafruar pjesërisht me Direktivën 2012/34/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 nëntor 2012 për krijimin e një zone të vetme evropiane hekurudhore, Direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 mbi sigurinë hekurudhore, Direktivën (BE) 2016/797 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 mbi ndërveprimin e sistemit hekurudhor brenda Bashkimit Evropian, Direktivën 2007/59/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007 mbi certifikimin e makinistëve të lokomotivave dhe trenave operative në sistemin hekurudhor në Komunitetin Evropian”, Rregulloren (BE) 2016/976 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr. 881/2004, Rregulloren (KE) 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2007

për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë dhe rrugë dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KKE) nr. 1191/69 dhe nr. 1107/70, Rregulloren (KE) 1371/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007 mbi të drejtat dhe detyrimet e pasagjerëve hekurudhorë.

Bazuar në këtë akt ligjor si dhe në paketën ligjore që përmban Ligjin Nr. 88/2021 “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”, Ligjin Nr. 89/2021 “Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor”, Ligjin Nr. 90/2021 “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a.”, si dhe Ligjin Nr. 91/2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare është në proces riorganizimi i plotë i strukturës institucionale për sektorin e transportit hekurudhor, proces kompleks që pritet të përfundojë brenda vitit 2023.

Në transportin ajror, akti ligjor bazë është Ligji Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”. Ky akt ligjor është i përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 korrik 2018 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një Agjencie të Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian, dhe që ndryshon Rregulloret (KE) nr. 2111/2005, (KE) nr. 1008/2008, (BE) nr. 996/2010, (BE) nr. 376/2014 dhe direktivat 2014/30/BE dhe 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon Rregulloret (KE) nr. 552/2004 dhe (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3922/91, Rregulloren (KE) nr. 1008/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 shtator 2008 mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore në Komunitetin Evropian, Rregulloren (KE) nr. 1070/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 tetor 2009, që ndryshon Rregulloret (KE) nr. 549/2004, (KE) nr. 550/2004, (KE) nr. 551/2004 dhe (KE) nr. 552/2004, me qëllim përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit evropian, Rregulloren (BE) nr. 996/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 tetor 2010 mbi hetimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil, e cila shfuqizon direktivën 94/56/KE, Rregulloren (KE) Nr. 300/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2008 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil, e cila shfuqizon rregulloren (KE) nr. 2320/2002”, e ndryshuar. Faza I e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian (ECAA), po zbatohet, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Protokollin I të kësaj Marrëveshjeje. Me vendimin nr. 1/2019, datë 31 korrik 2019, të Komitetit të Përbashkët të kësaj marrëveshjeje, është miratuar zëvendësimi i Aneksit I të saj, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 211/4, datë 12.08.2019.

Në fushën e transportit detar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vazhduar punën me përafrimin e legjislacionit të fushës.

Gjatë vitit 2022, përparim është arritur në zbatimin e planit të rishikuar kombëtar të transportit (PKT3) dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe planit të saj të veprimit për periudhën 2021 – 2025. Puna ka avancuar për zgjerimin e Korridoreve të gjelbra me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ne vitin 2022 u miratua Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 8, datë 12.4.2022 "Mbi informacionin teknik të nevojshëm për elementët e kontrollit teknik, metodat e rekomanduara të kontrollit dhe rregullat që lidhen me formatin e të dhënave dhe procedurat për marrjen e informacionit teknik që lidhet me mjetet rrugore dhe rimorkiot e tyre. Ky udhëzim përafrohet plotësisht Rregulloren e Komisionit Evropian 2019/621 të datës 17 prill 2019. Gjithashtu u miratua Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 17, datë 20.7.2022 "Për lejen e qarkullimit të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre". Ky udhëzim përafrohet plotësisht direktivën 1999/37/EU e Këshillit Evropian të datës 29 prill 1999 mbi dokumentet e regjistrimit të mjeteve rrugore.

Gjatë vitit 2022 vazhdoi zbatimi i Strategjisë së sigurisë rrugore. Janë hartuar termat e referencës së konsulencës së BE-së në kuadër të marrëveshjes për IPA III për hartimin e strategjisë së sigurisë rrugore.

Në zbatim të Ligjit Nr. 118, datë 13.12.2012, "Për transportin e mallrave të rrezikshme", (i cili është përafrohet pjesërisht me Direktivën 2008/68/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 24 shtatorit 2008 mbi transportin e mallrave të rrezikshme që shfuqizon direktivën 94/55/KE, 96/49/KE, 96/35/KE dhe 2000/18/KE dhe plotësisht me direktivën e Këshillit nr. 95/50/KE "Mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë"), janë miratuar:

- Udhëzimi nr. 4, datë 03.02.2022, "Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për drejtuesit e mjeteve që kryejnë transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifatat përkatëse".
- Udhëzimi nr. 5, datë 03.02.2022, "Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për këshilltarët e sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifatat përkatëse".

Në fushën e transportit detar, në zbatim të masave për përmirësimin e performancës së anijeve me flamurin shqiptar në kuadër të memorandumit të Mirëkuptimit për Kontrollin Shtetëror Portual (Paris MoU) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe me Sekretariatit Permanent të TCT-së ka hartuar një udhërrëfyes i cili është i përbërë nga 33 masa.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të përafërimit të legjislacionit me acquis në fushën e transportit detar gjatë 2022 ka përafrohet disa rregullore. Konkretisht gjatë vitit 2022 janë miratuar këto akte nënligjore:

- Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 134, datë 27.06.2022 "Për miratimin e rregullores "Për nivelin minimal të trajnimit të detarëve", i cili përafrohet pjesërisht Direktivën 2008/106/KE;
- Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 111, datë 02.06.2022 "Për miratimin e rregullores "Mbi kërkesat specifike për anijet Ro-Ro për pasagjerë", i cili përafrohet pjesërisht Direktivën 2003/25/KE.

Legjislacioni shqiptar në transportin ajror është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Shqipëria është duke përmbushur kushtet në lidhje me përfundimin e fazës së parë të Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit ECAA, duke përfshirë në legjislacionin kombëtar, kuadrin ligjor të BE-së, i përcaktuar në Shtojcën I të ECAA, e përditësuar me vendimin e Komisionit Evropian nr. 1/2019 e datës 31 korrik 2019. Në zbatim të Ligjit Nr. 96/2020, datë 23.07.2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2022 janë miratuar aktet nënligjore, si më poshtë:

- VKM nr. 95, datë 9.2.2022 “Për miratimin e Programit Shtetëror të Sigurisë në operim në aviacionin civil”, në përputhje me standardet ndërkombëtare të aviacionit (Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, Aneksi 19 dhe Dokumenteve të ICAO-s).
- Urdhër i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193, datë 6.10.2022 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”, përafrohet plotësisht Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2017/373 e datës 1 mars 2017, mbi përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre, e ndryshuar me Rregulloret e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2020/469 e datës 14 shkurt 2020, nr. 2021/1338, datë 11.8.2021 dhe nr. 2022/938 e datës 26 korrik 2022.
- Urdhër i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 170, datë 13.9.2022 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”, përafrohet plotësisht Rregulloren e Komisionit Evropian nr. 139/2014 e datës 12 shkurt 2014 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet në pajtim me Rregulloren (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e ndryshuar me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2018/401, Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2020/469 dhe Rregulloret e Deleguara të Komisionit (BE) nr. 2020/1234, nr. 2020/2148 dhe nr. 2022/208,
- Urdhër i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 143, datë 18.7.2022 “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, përafrohet pjesërisht Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2019/947, e datës 24 maj 2019, për rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë, i ndryshuar me Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) 2020/639, të datës 12 maj 2020.
- Urdhër i Përbashkët i MIE-s dhe MFE-së nr. 114, datë 6.6.2022 “Për miratimin e rregullores për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e sistemeve të avionëve pa pilot”, përafrohet pjesërisht Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) nr. 2019/945, të datës 12 mars 2019, mbi sistemet e avionëve pa pilot dhe mbi operatorët e vendeve të treta të sistemeve të avionëve pa pilot, e ndryshuar me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1058, të 27 prillit 2020.
- Urdhër i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 115, datë 6.6.2022 “Për miratimin e rregullores për kërkesat, përmbajtjen e regjistrimit dhe procedurat e regjistrimit, çregjistrimit ose ndryshimit të të dhënave në regjistrin e avionëve civilë të Republikës së Shqipërisë”,

në zbatim të Aneksit 7, të Konventës së Çikagos (Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar);

- Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”, i cili është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 376/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014, mbi raportimin, analizën dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil, të ndryshuar nga Rregullorja (BE) 2018/1139; dhe me Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2015/1018 e datës 29 qershor 2015, që përcakton një listë që klasifikon ngjarjet në aviacionin civil që duhet të raportohen detyrimisht sipas Rregullores (BE) nr. 376/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

#### 14.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për Kapitullin 14, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 94 “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” janë si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Instituti i Transportit;
- Hekurudha Shqiptare Sh.a.;
- Drejtorja e Inspektimit Hekurudhor;
- Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Drejtorja e Përgjithshme Detare;
- Regjistri Detar Shqiptar Sh.A.;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

#### 14.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritet

Me përfundimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020, i cili është dokumenti strategjik bazë për sektorin e transportit, është i nevojshëm miratimi i Strategjisë së re Sektoriale të Transportit 2021 – 2025 për zbatimin e politikave dhe prioritetëve në përputhje me dokumentet rajonale dhe Evropiane për zhvillimin e sektorit të transportit.

Me gjithë zbatimin e mirë të Strategjisë së Sigurisë Rrugore, është i nevojshëm hartimi i Strategjisë së re të Sigurisë Rrugore. Kjo Strategji duhet të përfshijë masa të reja në lidhje me reduktimin e njollave të zeza në infrastrukturën rrugore, por njëkohësisht të forcojë edukimin dhe masat për zbatimin e legjislacionit përkatës në bashkëpunim mes të gjitha ministrive dhe institucioneve përkatëse. Kjo Strategji do të duhet të jetë në përputhje me Planin e Veprimit për Sigurinë Rrugore

të Komunitetit të Transportit. Po ashtu, legjislacioni për sistemet e menaxhimit të trafikut dhe sigurinë rrugore do të duhet të përmirësohet më tej.

Në transportin hekurudhor, është miratuar tashmë kuadri ligjor për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sh.a. dhe ngritjen e institucioneve të reja për rregullimin e transportit hekurudhor. Kapacitetet institucionale të këtyre institucioneve duhet të forcohen duke pasur parasysh zbatimin e legjislacionit të miratuar si dhe hartimin dhe miratimin e legjislacionit plotësuar në përputhje me acquis. Në sektorin hekurudhor do të vazhdojnë edhe përpjekjet për rritjen e volumit të mallrave të transportuara, për zgjerimin e transportit ndërkufitar hekurudhor, etj.

Në transportin detar, do të vijohet me zbatimin e planit të posaçëm të masave për përmirësimin e situatës për anijet me flamur shqiptar. Pas forcimit të kapaciteteve institucionale të njësisë për kontrollin e flamurit do të vijohet me trajnimin e mëtejshëm të stafit dhe shtimin e inspektimeve. Kjo do të krijojë mundësi që gradualisht të përmirësohet situata në anijet me flamur shqiptar dhe të iniciohen procedurat për nënshkrimin e Memorandumit të Parisit për Kontrollin Shtetëror Portual.

Një mangësi që do të plotësohet gjatë vitit 2023 dhe në vijim është ngritja e sistemit të monitorimit dhe informacionit të anijeve (VTMIS).

Në transportin ajror, do të vazhdohet me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit. Janë përmbushur tashmë kushtet e përcaktuara në Shtojcën I të Marrëveshjes për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Gjatë vitit 2023 dhe më tej do të vazhdohet me plotësimin e kushteve të mëtejshme të kësaj Marrëveshjeje.

Mangësi ka edhe në lidhje me zbatimin e sistemeve inteligjente në transport. Kjo do të përfshijë hartimin e dokumenteve strategjike (përveç transportit rrugor) dhe pastaj zbatimin e tyre përmes planeve të dedikuara të veprimit.

Në vitin 2023 do të miratohet projekt-udhëzimi “Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”, i cili synon përafrimin, pjesërisht, me Rregulloren (KE) nr. 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 23 tetor 2007, lidhur me shërbimet publike të transportit hekurudhor dhe rrugor të udhëtarëve, ndryshuar nga Rregullorja (BE) 2016/2338 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 dhjetor 2016.

Prioritetet e ministrive dhe institucioneve shqiptare të përfshira në kapitullin 14 gjatë vitit 2023 janë:

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Transportit për periudhën 2021 – 2025 dhe planit të saj të veprimit;
- Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë së re të Sigurisë Rrugore në përputhje me Planin e Veprimit për Sigurinë Rrugore të Komunitetit të Transportit;



- Zbatimi i legjislacionit për reformën e sektorit hekurudhor në përputhje me Planin e Veprimit Hekurudhor të Komunitetit të Transportit dhe garantimi i funksionimit të plotë të rrjetit të transportit hekurudhor;
- Përshpejtimi i marrjes së masave konkrete për përmirësimin e performancës së anijeve detare me flamur shqiptar.

## KAPITULLI 15: ENERGJIA

### 15.1 Përmbajtja e kapitullit

Objektivat e politikës energjetike të BE-së përfshijnë rritjen e konkurrencës, sigurinë e furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit. *Acquis* për energjinë përbëhet nga rregullat dhe politikat veçanërisht në lidhje me konkurrencën dhe ndihmën shtetërore (përfshirë sektorin e qymyrit), tregun e brendshëm të energjisë (hapjen e tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit, promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë), efikasitetin e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

### 15.2 Struktura e kapitullit

- Siguria e furnizimit
- Tregu i energjisë
- Eficenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë
- Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet

### 15.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Kërkesat e MSA-së në sektorin e energjisë përcaktohen në nenin 107 të saj, i cili parashikon se bashkëpunimi energjetik do të fokusohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e energjisë, duke përfshirë aspektet e sigurisë bërthamore sipas rastit. Bashkëpunimi në sektorin e energjisë do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe do të bazohet në Traktatin e nënshkruar rajonal të Komunitetit të Energjisë me synimin për integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë evropiane. Prandaj, prioritetet për përafrimin ligjor dhe rregullator të Shqipërisë me *acquis* të BE-së për energjinë rrjedhin qartë nga legjislacioni i Komunitetit të Energjisë, d.m.th., nga ato akte ligjore të BE-së, të cilat janë përshtatur dhe inkorporuar për Komunitetin e Energjisë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Përveç kësaj, neni 17(2) i MSA-së përcakton se tregtia e produkteve të mbuluara nga Traktati për themelimin e Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike do të kryhet në përputhje me dispozitat e atij Traktati. Neni 70 i MSA-së përcakton më tej se Shqipëria duhet të përafrojë gradualisht

legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së, duke synuar, ndër të tjera, të përmirësojë sektorin e saj të energjisë.

Lidhur me kërkesat e *acquis* të BE-së, politikat e Kapitullit 15 bëjnë pjesë në Grupin II të kompetencave të BE-së, d.m.th., në kompetencat e përbashkëta (neni 4 i TFEU): BE-ja dhe vendet e BE-së kanë kompetencën të nxjerrin ligje dhe të miratojnë akte ligjërish të detyrueshme. Vendet e BE-së ushtrojnë kompetencën e tyre aty ku BE-ja nuk ushtron ose ka vendosur të mos ushtrojë kompetencën e saj.

#### 15.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Dokumenti kryesor i politikave në sektorin energjetik të Shqipërisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 – 2030, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.07.2018. Strategjia është në përputhje me përpjekjet kombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit dhe për të përmbushur angazhimet e saj sipas MSA-së, Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare. Strategjia fokusohet në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe liberalizimin e tregut të energjisë me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Energjisë dhe referuar rekomandimit të BE-së, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 872, datë 29.12.2021 është miratuar Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP) 2020 – 2030. Ky Plan plotëson Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018 – 2030 dhe përditëson Planin Kombëtar të Veprimet për Eficencën e Energjisë (NEEAP) dhe në të njëjtën kohë vendos objektiva dhe masa të reja afatshkurtra dhe afatmesme për eficientë e energjisë, përdorimin e energjive të rinovueshme dhe dekarbonizimin.

Gjatë periudhës janar – prill 2022, Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën është rishikuar bazuar në rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke synuar uljen e konsumit final të energjisë me 9.4% krahasuar me 8.4% në versionin e mëparshëm, rritjen e peshës së energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë në 59.4% krahasuar me 54.4%, ndërsa emetimet e GS-ve mbeten në 18.7%. Objektivat e reja të propozuara nga Komisioni Evropian janë aprovuar nga Sekretariati dhe pritet të miratohet projektvendimi nga Këshilli i Ministrave.

- Siguria e furnizimit

Legjislacioni shqiptar për sigurinë e furnizimit me energji elektrike është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së.

Qeveria shqiptare vijon reformat në sektorin e energjisë, ndërkohë që konsolidon përpjekjet ekzistuese për të siguruar kushte të favorshme për zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe për të respektuar angazhimet e saj rajonale dhe ndërkombëtare. Ndërsa tregu ka dëshmuar përparime

të konsiderueshme vitet e fundit, Qeveria shqiptare tani është më e vendosur se kurrë për të rritur investimet që do të formësojnë të ardhmen e energjisë, duke krijuar një udhërrëfyes të qartë strategjik për burimet e rinovueshme.

- Tregu i energjisë

Legjislacioni shqiptar që rregullon marrëdhëniet në tregjet e energjisë elektrike dhe gazit është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së për energjinë.

Legjislacioni shqiptar në tregun e energjisë elektrike është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në momentin e miratimit ishte plotësisht i përputhur me Direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/KE dhe Rregulloren (KE) Nr. 714/2009, të cilat janë tashmë të shfuqizuara. Në bazë të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”. Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike ishte hapi i fundit drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri në një treg të energjisë plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 dhe modelit të tregut të energjisë elektrike, Enti Rregullator i Energjisë Shqiptare (në vijim “ERE”) miratoi Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (Vendimi nr. 214, datë 28.12.2016), të cilat rregullojnë tregun e ditës në avancë dhe brenda ditës të energjisë elektrike, si dhe Rregullat e Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike (Vendimi nr. 106, datë 2.07.2020), të cilat kërkojnë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit OST Sh.A të sigurojë shërbime balancimi nëpërmjet një procesi konkurrues të bazuar në treg.

Bursa e Energjisë (ALPEX) është krijuar dhe pritet të jetë plotësisht funksionale në vitin 2022. Me Vendim të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 247, datë 29.09.2022, shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., është licencuar në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar. Me datë 23 nëntor 2022 ALPEX ka hapur zyrtarisht trajnimin nëpërmjet platformës së tregtimit, me qëllim garantimin e një fillimi të sigurtë për Bursën Shqiptare të Energjisë. Ky trajnim do t’i mundësojë ALPEX-it në rolin e operatorit të tregut si dhe pjesëtarëve të tjerë potencial të tregut të marrin pjesë në një ambient tregtimi për të përfituar njohuritë e duhura që lidhen me mënyrën e ofertimit të energjisë elektrike në tregun e organizuar si dhe rezultatet e këtij procesi në një mjedis real

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 dhe ndryshimet e tij të mëvonshme, kërkesat për paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë elektrike në zbatim të Rregullores (BE) nr. 543/2013 janë transpozuar në legjislacionin kombëtar shqiptar dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit OST Sh.A. ka filluar me publikimin e të dhënave në Platformën e Transparencës ENTSO-E.

Të tre Kodet e Rrjetit të Energjisë Elektrike për lidhjet në rrjet të zbatueshëm në Komunitetin e Energjisë – Rregullorja (BE) 2016/631, Rregullorja (BE) 2016/1388 dhe Rregullorja (BE) 2016/1447 – u transpozuan nga ERE në 2018.

Në datën 1 janar 2020, ka përfunduar ndarja ligjore dhe funksionale e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE S.A.) në përputhje me nenin 72 të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ata vazhdojnë aktivitetin e tyre në përputhje me licencat përkatëse të lëshuara nga ERE.

Enti Rregullator i Energjisë Shqiptare, me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020 “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, miratoi Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, dhe në vijim me Vendimin Nr. 239, datë 22.09.2022 ka filluar procedurën për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., në përfundim të së cilës pritet emërimin Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga OSSH sh.a.

Nga 1 janari 2022, 7,358 konsumatorë të lidhur në 20/10/6 kV, pasi plotësuan kushtet teknike të instalimit të sistemit të matjes, kanë hyrë në tregun e liberalizuar dhe kanë të drejtë të gjejnë lirisht furnizuesin e tyre. Nëse nuk gjejnë një furnizues, në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, do të vazhdojnë të furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për një periudhë dy vjeçare.

Ligji nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, është përafuar me Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/KE. Në bazë të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 590, datë 9.10.2018 “Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror”. Miratimi i Modelit të Tregut të Gazit është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të gazit në Shqipëri duke garantuar një treg plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ligji Nr. 81/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”, ka përafuar pjesërisht Rregulloren 2017/1938 e Parlamentit Evropian, e cila konsiston në masat që duhet të merren për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz dhe ka në thelbin e saj miratimin e planit të veprimit parandalues dhe të një plani emergjence për masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e furnizimit me gaz.

Aktualisht është hartuar Plani i Veprimit Parandalues dhe Plani i Emergjencës të cilët priten të miratohen në vitin 2023. Gjithashtu është hartuar edhe projektvendimi “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë në furnizimin me gaz natyror dhe mënyrën e trajtimit të tyre”, i cili garanton mbrojtjen e klientëve në nevojë, sipas përkufizimit të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, janë klientët familjarë, të cilët për shkak të gjendjes sociale, do të duhet të gëzojnë disa të drejta të veçanta, lidhur me furnizimin me gaz, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

- Eficenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë

Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për eficiencyn e energjisë”, i ndryshuar, është kryesisht në përputhje me Direktivën 2012/27/BE, veçanërisht si rezultat i ndryshimeve të saj të miratuara në vitin 2021. Ky ligj synon krijimin dhe zbatimin e politikave kombëtare të Shqipërisë dhe rregullore për të promovuar dhe përmirësuar përdorimin efikas të energjisë, dhe përcakton objektivat përkatëse të detyrueshme për sektorin publik, privat dhe konsumatorët e mëdhenj. Në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 124/2015, është ngritur Agjencia për Eficiencyn të Energjisë, si një institucion përgjegjës për zbatimin e politikave dhe promovimin e masave për eficiencyn e energjisë.

Në zbatimin të Ligjit Nr. 124/2015 “Për eficiencyn e energjisë”, të ndryshuar, u miratuan disa akte ligjore në lidhje me miratimin e formatit të planeve të veprimit të eficiencys së energjisë për konsumatorët e mëdhenj të energjisë dhe modeli i raportimit vjetor të progresit të tyre, formati i planeve vendore të veprimit për eficiencyn e energjisë dhe modeli i raportimit të progresit të tyre dhe Udhëzuesi “Për modelin e kontratës për kontraktimin e performancës së energjisë” (ESCO). Këto akte ligjore janë hartuar në përputhje me objektivat e parashikuara në PKEK (Dimensioni i Eficiencys së Energjisë), implementimi i të cilave do të ndihmojë në uljen e konsumit të energjisë dhe arritjen e objektivave kombëtare për eficiencyn e energjisë në plan afatgjatë.

Në kuadër të gjendjes së emergjencës për furnizimin me energji elektrike, Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ Nr. 14, datë 5.10.2022 “Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizim me energji elektrike”. Nëpërmjet këtij Akti Normativ synohet forcimi i zbatimit të masave dhe rregullave të detyrueshme për uljen e konsumit të energjisë elektrike me 15% të konsumit mujor gjatë kohëzgjatjes së situatës emergjente në furnizimin me energji elektrike. Në zbatim të aktit normativ të sipërcituar, është miratuar Urdhri Nr. 207, datë 25.10.2022 “Për caktimin e administratorit energjetik për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” sipas të cilit çdo institucion publik duhet të përcaktojë një administrator energjie, i cili do të menaxhojë arritjen e targetit të përcaktuar për kursimin e energjisë.

Ne vijim, është miratuar Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 22, datë 27.10.2022 “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe metodologjisë për klientët familjarë që përfitojnë nga masat e financimit për kursimin e energjisë nga panelet diellore” për klientët familjarë, të cilët përfitojnë nga financimi i masave për kursimin e energjisë nga panelet diellore. Ky udhëzues përcakton rregullat dhe procedurat për tregtimin dhe marrjen e subvencioneve deri në 70% të kostos për instalimin e paneleve diellore që do të furnizojnë klientët familjare me ujë të ngrohtë sanitar, duke kontribuar në uljen e konsumit afatgjatë të energjisë elektrike dhe do të minimizojnë efektet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në energji elektrike.

Së fundmi është miratuar Vendimi Nr. 633, datë 28.9.2022 “Për ngarkimin e fondit shqiptar të zhvillimit, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për zbatimin e projektit për vendosjen e paneleve fotovoltaike në tarracën e kryeministrit dhe të ministrive të

linjës”, nëpërmjet implementimit të të cilit synohet ulja e konsumit të energjisë nga institucionet e administratës publike.

Ligji Nr. 116/2016, datë 10.11.2016 “Për performancën energjetike të ndërtesave” është kryesisht në përputhje me Direktivën 2010/31/BE. Ky ligj rregullon përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave, duke marrë parasysh kushtet klimatike lokale, nivelet e komfortit të brendshëm të një ndërtese dhe gjithashtu efektivitetin e kostos për ndërtimin e ndërtesave të reja dhe rindërtimin e atyre ekzistuese. Në zbatim të ligjit nr. 116/2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar një sërë rregulloresh zbatuese, të cilat specifikojnë më tej masat dhe procedurat për përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave dhe gjithashtu kurojnë boshllëkun e mëparshëm të akteve nënligjore të munguara për zbatimin praktik të ligjit.

Këshilli i Ministrave në dhjetor 2021 ka miratuar Planin Kombëtar të integruar të Energjisë dhe Klimës bazuar në Rekomandimin 2018/1/MC-EnC dhe në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1999, ku parashikohen objektivat dhe masat e efikasitetit të energjisë.

Ligji nr. 7/2017, datë 2.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i ndryshuar, synon nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme në Shqipëri dhe është kryesisht në përputhje me Direktivën 2009/28/KE tashmë të shfuqizuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rishikuar bazën ligjore në fuqi për të realizuar përafrimin e plotë me *acquis* të BE-së dhe ka marrë iniciativën për të propozuar miratimin e një ligji të ri në fushën e energjisë nga burimet e rinovueshme me qëllim shfuqizimin e ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Procesi i hartimit të projektligjit të ri ka nisur me synimin për të transpozuar Direktivën 2018/2001 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 11 dhjetor 2018 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme. Projektligji ka përfunduar procesin e konsultimit publik dhe po vijohet me miratimin e draftit.

Projektligji përcakton kuadrin ligjor për nxitjen e përdorimit të energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme. Ai gjithashtu përcakton objektivat kombëtare detyruese dhe detyrimet raportuese për kontributin e energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë në konsumin bruto përfundimtar të energjisë, rregullat për informacionin, statistikën, certifikimin, për mekanizmat e bashkëpunimit, për mbështetjen, rregullat lidhur me aksesin dhe funksionimin e rrjeteve për burimet e rinovueshme të energjisë dhe lidhjen e tyre me rrjetin elektrik, rregullat për dhënien, transferimin dhe anulimin e Garancive të Origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme, si dhe rregullat për integrimi i vetë-konsumatorëve nga komunitetet e energjisë së rinovueshme dhe energjisë në sektorin e energjisë elektrike.

Në zbatim të Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme (PKVRE) për 2019 – 2020, i ndryshuar, i cili është përditësuar për periudhën 2021 – 2030 si pjesë integrale e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2021 – 2030 dhe parashikon që deri në vitin 2030, Shqipëria të ketë një sasi prej 54.4% të sasisë së energjisë të prodhuar nga burimet e rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë. Shqipëria informon rregullisht Sekretariatit e

Komunitetit të Energjisë për zbatimin e PKEK-së dhe paraqet raportet e saj të progresit të energjisë së rinovueshme.

Gjithashtu, me synimin për të nxitur përdorimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, dhe konkretisht për të nxitur prodhimin e energjisë elektrike nga energjia diellore dhe e erës, Këshilli i Ministrave miratoi skemën për zhvillimin konkurrues të prodhimit të energjisë së rinovueshme dhe masat mbështetëse përkatëse. Në vijim të kësaj skeme, janë përfunduar me sukses dy ankande konkurruese për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese fotovoltaike me një kapacitet total të instaluar 240 MW dhe pas shpalljes së ankandit të ri për ndërtimin e impianteve me erë me një fuqi të instaluar prej 70 – 150 MW, janë përzgjedhur pjesërisht fituesit e ankandit. Procesi është në vazhdim dhe fituesi do të zgjidhet në vitin 2023.

Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, ka përafuar pjesërisht Direktivën 94/22/EC, të datës 30 maj 1994 për kushtet për dhënien dhe përdorimin e autorizimeve për zbulim, kërkim dhe prodhimin e hidrokarbureve. Në këtë ligj përcaktohen bazat mbi të cilat kryhet aktiviteti i kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri. Në të janë të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, duke përfshirë si kusht edhe garantimin e sigurisë kombëtare në rastin e lidhjes apo transferimit të kuotave të marrëveshjes hidrokarbure. Në të janë të përcaktuar edhe parimet bazë që duhet të ketë një marrëveshje hidrokarbure.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Master Plani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (Projekti TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe nëpërmjet gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Ionian Adriatik Pipeline (Projekti IAP), gazsjellësi Shqipëri – Kosovë (Projekti ALKOGAP).

Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, është ende në fuqi. Ligji është i përafuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2009/119/KE të datës 14 shtator 2009 që vendos një detyrim ndaj shteteve anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës. Ligji përcakton detyrimin për të mbajtur një rezervë sigurie për naftën dhe nënproduktet e naftës për 90 ditë të mesatares së shitjeve, duke filluar nga 2010.

Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport” i ndryshuar, është pjesërisht i përafuar me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE.

Kuadri i politikave në mbrojtjen e rrezatimit përfshin tre dokumente të politikave:

- Politika për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, e përgatitur si dokumenti Nr. 1319/3 e 25.03.2013 nga Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi;
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 435, datë 14.10.2015 “Për miratimin e dokumentit “Hapat strategjikë për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”. Dokumenti është i vlefshëm për periudhën 2017 – 2030 duke përcaktuar masat që duhen marrë për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Shqipëri;
- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 434, datë 14.10.2015 “Për miratimin e dokumentit “Arsimi dhe trajnimi për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues dhe hapat për zbatimin e tij”, që përcakton masat për trajnimin e personelit që merret me materiale radioaktive.

Akti kryesor ligjor në mbrojtjen e rrezatimit është Ligji Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, i ndryshuar, pjesërisht i përafuar me Direktivën e Këshillit 2013/59/Euratom të 5 dhjetorit 2013 që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen kundër rreziqeve që dalin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe shfuqizimin e Direktivave 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom. Kjo direktivë është e përafuar pjesërisht me:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Shqipëri”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me rrezatim jonizues”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 877, datë 30.10.2015 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen fizike të materialeve radioaktive”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 957, datë 25.11.2015 “Për miratimin e rregullores mbi nivelet e përqendrimit të radonit të brendshëm dhe përqendrimin radioaktiv në mallra, me qëllim mbrojtjen e publikut”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 638, datë 7.09.2016 “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 815, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Rregullores për transportin e sigurt të materialeve radioaktive”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 700 datë 21.11.2018 “ Për miratimin e rregullores “Për përgatitjen dhe reagimin në rast emergjence radiologjike për mbrojtjen e punonjësve dhe të publikut;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 801 datë 11.12.2019 “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut dhe punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues”.

Përveç kësaj, në fushën e mbrojtjes bërthamore dhe rrezatimit, Shqipëria ka ratifikuar konventat e mëposhtme ndërkombëtare:



- Konventa e përbashkët për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të përdorur dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, ratifikuar me Ligjin Nr. 10379, datë 24.02.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e bashkuar “Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive” i cili hyri në fuqi më 27.09.2011;
- Konventa për Sigurinë Bërthamore, ratifikuar me Ligjin Nr. 10380, datë 24.02.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Sigurinë Bërthamore”, që ka hyrë në fuqi më 27.09.2011;
- Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, ratifikuar me Ligjin Nr. 8853, datë 31.01.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore”, hyrë në fuqi më 4.04.2002. Amendamentet e Konventës për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore të ratifikuara me Ligjin Nr. 88/2013, datë 21.02.2013 “Për ratifikimin e ndryshimeve në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore”, hynë në fuqi më 6.03.2013;
- Konventa për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor, e ratifikuar me Ligjin Nr. 9026, datë 13.03.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor”, që hyri në fuqi më 30.10.2003;
- Konventa për ndihmën në rastin e një aksidenti bërthamor ose të emergjencave radiologjike, ratifikuar me Ligjin Nr. 9015, datë 20.02.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për ndihmë në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjik”, e cila hyri në fuqi më 31.05.2003;
- Konventa mbi protokollin shtesë, ratifikuar me Ligjin Nr. 10314, datë 16.09.2010 “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për zbatimin e garancive për të gjitha aktivitetet bërthamore në Shqipëri”, e cila hyri në fuqi më 3.11.2010.

#### 15.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Enti Rregullator i Energjisë (ERE);
- Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Agjencia për Eficiencë të Energjisë; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

#### 15.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Ligji nr. 7/2017, datë 02.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i ndryshuar është kryesisht në përputhje me Direktivën 2009/28/KE. Ndaj me

miratimin e një ligji të ri në fushën e energjisë nga burimet e rinovueshme brenda vitit 2022 synohet transpozimi i Direktivës 2018/2001 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 11 dhjetor 2018 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme. Projektligji ka përfunduar procesin e konsultimit publik dhe po vijohet me miratimin e draftit. Me miratimin e Ligjit të ri “Për nxitjen dhe promovimin e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme” synohet vijimi dhe ndjekja e procedura lidhur me aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në VKM nr. 275, datë 16.05.2018, deri në krijimin e Operatorit të Energjive të Rinovueshme këto funksione do të kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE).

Funksionet e Agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë kryen Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka parashikuar në Planin Analitik të Projektakteve, përgatitjen e projektligjit “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji” brenda vitit 2023, i cili synon të transpozojë Rregulloren (BE) 2017/1369 të Parlamentit Evropian. Projektligji do të përcaktojë detyrimet për tregtarët dhe furnitorët për të informuar përdoruesit fundorë për konsumin e energjisë të produkteve që ata vendosin në treg.

Gjithashtu është parashikuar përgatitja e projektligjit “Për përcaktimin e kërkesave të ekoprojektimit të produkteve me ndikim në energji” deri në 2025, i cili synon të transpozojë Direktivën 2009/125/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 21 tetor 2009 që do të krijojë një kornizë ligjore për vendosjen e kriterëve të projektimit ekologjik për produktet me ndikim në energji.

Në zbatim të Ligjit Nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për eficiency e energjisë”, i ndryshuar, është përgatitur projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave dhe metodologjisë së ngritjes së platformës së monitorimit dhe verifikimit të kursimeve të energjisë”, e cila është parashikuar të miratohet brenda vitit 2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 116/2016, datë 10.11.2016 “Për performancën energjetike të ndërtesave” është përgatitur edhe projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e ndërtesave që përjashtohen nga zbatimi i ligjit për performancën energjetike në ndërtesa”, i cili është parashikuar të miratohet brenda vitit 2023.

Në vijim të plotësimit të bazës ligjore në zbatim të Ligjit Nr. 124/2015, i ndryshuar, MIE ka ndërmarrë nismën e ngritjes së një grupi pune për hartimin e aktit nënligjor në mbështetje të Nenit 9, Pika 1, të Ligjit 124/2015 “Për eficiency e energjisë”, i ndryshuar, konkretisht VKM-së “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të prokurimit publik për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave me performancë të lartë të eficiency së energjisë”, nëpërmjet të cilit do të përcaktohen procedurat e prokurimit publik për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave me performancë të lartë të eficiency së energjisë në përputhje me efektivitetin e kostove, fizibilitetin ekonomik, përshatshmërinë teknike, si dhe konkurrencën e mjaftueshme.

Në përputhje me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë duhet bërë finalizimi i ndarjes funksionale të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike duke emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili do të monitorojë zbatimin e programit të pajtueshmërisë së OSSH, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në dhjetor 2020.

Prioritetet për vitin 2023 do të jenë:

- Bursa e Energjisë (ALPEX) dhe tregu i energjisë elektrike i ditës në vijim do të jenë plotësisht funksionalë dhe do të vazhdojë forcimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike;
- Do të përfundojë ndarja funksionale e operatorëve të energjisë dhe do të sigurohet akses i plotë në tregun e liberalizuar për të gjithë klientët e lidhur me 20kV në vitin 2022, si dhe do të zgjerohet në mënyrë progresive aksesimi për të gjithë konsumatorët;
- Do të zbatohet Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP) 2020 – 2030, i përditësuar, duke përfshirë planet e veprimit për energjinë e rinovueshme dhe eficientë të energjisë, do të sigurohet marrja e të gjitha masave institucionale dhe legjislative, si dhe masave për financimin, certifikimin dhe auditimin, përfshirë prodhimin e energjisë elektrike të rinovueshme jo nga hidrocentralet, duke pasur parasysh krizën energjetike;
- Do të shfrytëzohen përfitimet që vijnë nga garancitë e Komunitetit të Energjisë për origjinën dhe do të nënshkruhet marrëveshje e drejtpërdrejtë me ofruesin e shërbimit për përdorimin e regjistrit elektronik kombëtar për lëshimin, anulimin dhe tregtimin e garancive të origjinës, në përputhje me standardet e BE-së.

## KAPITULLI 21: RRJETET TRANS-EVROPIANE

### 21.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull përfshin politikën e Rrjeteve Trans-Evropiane në fushat e infrastrukturës së transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës energjetike, përfshirë udhëzimet e Komunitetit për zhvillimin e Rrjeteve Trans-Evropiane dhe masat mbështetëse për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët. Përcaktimi dhe zhvillimi i Rrjeteve Trans-Evropiane, si dhe promovimi i ndërlidhjes së duhur dhe ndërveprimit të rrjeteve kombëtare synojnë që tregu i brendshëm të përfitojë plotësisht dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e punësimit në vend dhe më gjerë.

### 21.2 Struktura e kapitullit

- Rrjetet Trans-Evropiane të Transportit;
- Rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë;
- Rrjetet Trans-Evropiane të Telekomunikacionit.

### 21.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me Rrjetet Trans-Evropiane rregullohet nga disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Lidhur me këtë, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në nenin 106 “Transporti” përcakton se palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së, duke synuar ristrukturimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit të Shqipërisë, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe lidhjen me rrjetet kryesore trans-evropiane dhe arritjen e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Në sektorin energjetik, neni 107 përcakton se bashkëpunimi në energji do të bazohet në Traktatin rajonal të Komunitetit të Energjisë të nënshkruar me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë të Evropës, i cili është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”.

Për sektorin e telekomunikacionit, bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë përcaktohet në nenin 104 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, “Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik”, duke parashikuar që bashkëpunimi do të përqendrohet së pari në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në këtë fushë.

Neni 70 përcakton se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së me qëllim përmirësimin e sistemit dhe shërbimeve të transportit dhe energjisë.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të BE-së, politikat në kapitullin 21 i përkasin grupit të dytë të kompetencave të BE-së, d.m.th. grupit të kompetencave të ndara mes BE-së dhe shteteve të tij anëtare.

Sipas Nenit 4 të Traktatit për Funkcionimin e BE-së, të dyja palët, si BE-ja ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjore në fushën e rrjeteve trans-evropiane. Shtetet anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në rast se BE-ja nuk e ushtron këtë kompetencë ose ka vendosur të mos e ushtrojë këtë kompetencë.

Politikat e BE-së në lidhje me rrjetet trans-evropiane të transportit (TEN-T) dhe energjisë (TEN-E) bazohen në tre shtylla kryesore: baza ligjore për TENs, Nenet 170 – 172 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Rregullorja (BE) Nr. 1315/2013 për udhëzimet e Bashkimit për Zhvillimin e Rrjetit Trans-Evropian të Transportit dhe Rregullorja (BE) 1153/2021 që ka shfuqizuar Rregulloren 1316/2013 për ngritjen e Instrumentit *Connecting Europe*, duke amenduar Rregulloren (BE) 913/2010 dhe shfuqizuar Rregulloret (KE) 680/2007 dhe (KE) 67/2010. Ky kuadër ligjor përcakton objektivat e politikës së Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë rrjetet e transportit dhe energjisë dhe synojnë përshtatjen dhe zhvillimin e rrjeteve dhe sigurimin e ndërlihdshmërisë dhe ndërveprimit të tyre. Politikat e TEN-T dhe TEN-E i janë nënshtruar një

rishikimi thelbësor. Instrumenti i ri i financimit për rrjetet trans-evropiane, *Connecting Europe* (CEF) dhe udhëzimet e rishikuara TEN-T dhe TEN-E hynë në fuqi në 1 janar 2014. Qëllimi i ngritjes dhe zhvillimit të rrjeteve trans-evropiane dhe nxitja e ndërlihdhjes dhe ndërveprimit të duhur të rrjeteve kombëtare bëhet për të shfrytëzuar plotësisht avantazhin e tregut të brendshëm dhe për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Evropian.

#### 21.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet

Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitjeje për anëtarësim në fushën e rrjeteve ndër-evropiane. Shqipëria ka bërë disa përparime, si në rrjetet e transportit ashtu edhe në atë energjetik duke përfshirë funksionimin e plotë të gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) i përfunduar tashme që në vitin 2020, si dhe lidhjes energjetike me Kosovën.

Në fushën e rrjeteve Trans-Evropiane të Telekomunikacionit, Shqipëria është pjesë e lidhjes me fibër optike të rrjetit Trans BalkanLine dhe Adria 1 dhe Adria 2.

Lidhur me rrjetet Trans-Evropiane të Transportit, Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020” ka përfunduar dhe aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përditësuar dokumentin ekzistues, duke hartuar një dokument të ri “Strategjia Sektoriale e Transportit 2021 – 2026”. Në këtë draft janë përfshirë të gjitha prioritetet e rajonale dhe të BE-së, të shprehura në Agjendën e Gjelbër (Green Agenda), në Planin Ekonomik të Investimeve (Economic Investment Plan), Strategjinë për një transport të zgjuar dhe qëndrueshëm për Ballkanin Perëndimor (Smart and Sustainable Strategy for the Western Balkan), si dhe të gjitha Planet e Veprimit Rajonale të TCT-së, të parashikuara në kuadër të bashkëpunimit rajonal. Edhe Strategjia e re parashikon zhvillimin e rrjeteve bazë dhe gjithëpërfshirëse të transportit në përputhje me kërkesat dhe standardet e BE-së nën qasjen trans-evropiane.

Me Ligjin nr. 8/2018, datë 26.02.2018 “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë ky Traktat, që është një nga dokumentet më të rëndësishëm për të gjithë sektorët e transportit, dhe që do të jetë udhërrëfyese për vitet në vijim. Zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit do të përmirësojë sektorin e transportit, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe do të përmirësojë në lidhjen e rrjetit shqiptar të transportit me rrjetin e transportit të BE-së. Traktati parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislacioneve kombëtare me *acquis* e BE-së për të gjitha fushat e transportit. Zbatimi i Traktatit do të rrisë edhe më tej integrimin e rrjetit shqiptar dhe rajonal të transportit në rrjetet evropiane të transportit. Sipas Traktatit, Neni 8(1) “Infrastruktura”, hartat e zgjatjes indikative të rrjeteve gjithëpërfshirëse dhe bazë TEN-T në Ballkanin Perëndimor janë pjesë përbërëse e Traktatit të detyrueshme për të gjithë palët në Traktat. Neni 3 i Traktatit përcakton se palët kontraktuese janë të detyruar të harmonizojnë legjislacionin e tyre me *acquis* e BE-së në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe vendimet e Komitetit Drejtues Rajonal.

Në fushën e rrjeteve Trans-Evropiane të Transportit Rregullorja (BE) Nr. 1315/2013, e amenduar është përafëruar pjesërisht me Urdhrin e Ministrit nr. 196, datë 9.7.2020 “Për zbatimin e rregullores “Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit trans-evropian të transportit”.

Gjithashtu nga Komisioni Evropian ka nisur procesi i rishikimit të rrjetit TEN-T, ku pala shqiptare ka paraqitur propozimet e saj për përfshirjen në rrjetin TEN-T të disa projekteve të rëndësishme të infrastrukturës shqiptare.

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 – 2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 31.07.2018. Kjo Strategji përcakton se vizioni i Shqipërisë është zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimal.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Master Plani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nga gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe të gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri – Kosovë.

Shoqëria Trans-Adriatic Pipeline AG ka përfunduar ndërtimin e gazsjellësit TAP në territorin e Shqipërisë dhe së fundmi ka filluar procesin e transmetimit të gazit natyror.

Në fushën e telekomunikacionit, ndërtimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar i cili është i bazuar në paketën e direktivave të BE-së për komunikimet elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Për zhvillimin e infrastrukturës digjitale, broadband, Këshilli i Ministrave ka miratuar me VKM nr. 434 datë 3.6.2020, Planin e ri Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020 – 2025, i cili ka përcaktuar si vizion: “*Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit*”. Në këtë dokument janë përcaktuar dhe objektivat strategjike të zhvillimit të broadband si zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës broadband, reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve broadband gjithëpërfshirëse dhe rritja e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit.

Gjatë vitit 2022, ka vazhduar të zbatohet edhe Plani i rishikuar kombëtar i transportit (PKT3), si një instrument për zbatimin e prioriteteve dhe politikave të sektorit të transportit dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit përgjegjës për transportin nr. 40, datë 21.01.2020 “Për miratimin e rishikimit

të dytë pesëvjeçar të Planit Kombëtar të Transportit”, nga Instituti i Transportit ka filluar rishikimi vjetor i tij, mbi bazën e zhvillimeve dhe projekteve të reja në sektorin e transportit dhe infrastrukturës, në kuadër të bashkëpunimit rajonal me TCT-në dhe Agjendës së Ndërlidhjes.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Shqipëria nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka marrë pjesë aktive në Komitetin Drejtues rajonal të Traktatit të Komunitetit të Transportit dhe në Komitetet Teknike rajonale të ngritura nga TCT-ja.

Në rrjetin kryesor rrugor, janë bërë disa përparime në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese. Ka përparime në përgatitjen e projekteve të infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe portuale, veçanërisht përgjatë korridorit të VIII dhe korridorit Adriatiko-Jonian. Bypass-et e Fierit, Vlorës dhe Tepelenës janë tashmë të përfunduara dhe të hapura për qarkullim. Punimet për ndërtimin e rrugës Qukës – Qafë Plloçë po ecin intensivisht. Studimi për korridorin rrugor Adriatiko Jonian ka përfunduar. Korridori Adriatiko-Jonian është pjesërisht i ndërtuar, por për përfundimin e tij sipas standardeve evropiane TEN-T nevojitet financim i mëtejshëm.

Ndërtimi i segmenteve rrugore Elbasan – Librazhd – Qafë Thanë me gjatësi 54 km do të bëhet në disa faza. Projekte të rëndësishme janë edhe ndërtimi i Bypass-ve të Elbasanit dhe të Tiranës, për të cilin është siguruar bashkëfinancim nga WBIF me EBRD.

Gjithashtu, po punohet edhe për ndërtimin e Tunelit të Llogarasë, që do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e turizmit në zonat bregdetare të Jugut të Shqipërisë.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është pothuajse i përfshirë në rrjetin rajonal të transportit. Gjatësia e përgjithshme e linjës kryesore është rreth 420 km, ka 200 kilometra linjë dhe degë hekurudhore dytësore. Sa i përket projekteve të ndërlidhjes, kontrata për rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe ndërtimin e një linje të re për në aeroportin ndërkombëtar është nënshkruar më 3 shkurt 2021 dhe punimet e ndërtimit po vijnë sipas kontratës. Projekti i detajuar për lidhjen hekurudhore Vorë – Hani i Hotit u përfundua në qershor 2021 dhe aktualisht është siguruar fondi i investimit nga WBIF, BERZH dhe BEI për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm, dhe lidhjes së vetme ndërkombëtare hekurudhore të Shqipërisë.

Prioritet i është dhënë edhe lidhjes hekurudhore përgjatë Korridorit të VIII, për të cilën ka përfunduar projekti i detajuar i segmentit hekurudhor Durrës – Rrogozhinë dhe po vijohet me pjesën tjetër (Rrogozhinë – Pogradec) për hartimin e projektit të detajuar. Pas nënshkrimit në shtator 2021 nga tre ministrat përgjegjës për transportin (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria) të Memorandumit të Mirëkuptimit për zhvillimin e Korridorit të VIII, i cili reflekton angazhimin politik të tre palëve për zhvillimin dhe realizimin e një Korridori të qëndrueshëm, sipas standardeve evropiane TEN-T, në kuadër të procesit të lancuar nga Komisioni Evropian për rishikimin e rrjetit TEN-T është kërkuar riklasifikimi i këtij korridori nga rrjeti gjithëpërfshirës në rrjetin kryesor.

Gjithashtu në kuadër të promovimit të intermodalitetit në Ballkanin Perëndimor, një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe lidhjes hekurudhore Durrës – Prishtinë. Kështu në vijim të Memorandumit të Bashkëpunimit, nënshkruar më 10 tetor 2020 ndërmjet dy kryeministrave për bashkëpunimin e ardhshëm në fushën e transportit hekurudhor, më qershor 2022 është firmosur marrëveshja ndërqeveritare për hartimin e Studimit të Fizibilitetit dhe projekt-idesë për këtë linjë hekurudhore me angazhimin financiar të përbashkët të të dy qeverive.

Në fushën e transportit detar, Porti i Durrësit, i cili është i vetmi port i rrjetit kryesor në Shqipëri, do të zhvendosë aktivitetet e tij të ngarkesave në zonën e Porto Romanos disa kilometra në veri të Durrësit. Në nëntor 2020, qeveria përfundoi një marrëveshje dhjetëvjeçare për bashkëpunimin ekonomik me Qeverinë e Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), duke përfshirë rizhvillimin e Portit të Durrësit dhe transformimin e tij në një marinë të madhe. Në qershor 2021, Autoriteti Portual i Durrësit nisi tenderin për një kontratë shërbimi për transferimin e aktivitetëve të ngarkesave nga Porti i Durrësit në Porto Romano.

Për sa i përket infrastrukturës aeroportuale, pas vënies në operim të Aeroportit të Kukësit në veri të Shqipërisë, në zbatim të kontratës koncesionare, të nënshkruar nga qeveria shqiptare në prill 2021, kanë filluar punimet për ndërtimin e një aeroporti të tretë ndërkombëtar në Vlorë, në jug të Shqipërisë. Parashikohet që ky aeroport të fillojë operimin në vitin 2025.

Në lidhje me sektorin e gazit natyror, në mars 2022 Trans Adriatic Pipeline (TAP) transmetimi arriti në 10 BCM.

Projekti i gazsjellësit IAP “Dizajnimi Paraprak i Gazsjellësit Jonian – Adriatik, seksionet Mali i Zi & Shqipëri ka përfunduar me sukses fazën e fundit të projektit në dhjetor 2021. Përfitimet e projektit IAP janë sigurimi i furnizimit me gaz të larmishëm në rajon, sigurimi i aksesit në kapacitetet magazinuese kroate dhe shqiptare; sigurimi i kapaciteteve dhe të ardhurave të konsiderueshme transitore për Shqipërinë, Bosnjë- Hercegovinën, Malin e Zi dhe Kroacinë, si dhe Kosovën; krijimi i parakushteve për mbylljen e unazës së gazit të Adriatikut dhe lidhjen me sistemet e gazit italian, slloven dhe hungarez duke mbështetur konceptin rajonal të Unazës së Gazit të Evropës Jugore dhe Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë; reduktimi i emetimeve të CO2 në rajon dhe lehtësimi i zhvillimit ekonomik; analiza dhe rekomandime për kapacitetin e mundshëm të depozitimit të gazit në Shqipëri.

Projekti i gazsjellësit Fieri – Vlorë, “Projektimi i Detajuar dhe Dokumentet e Tenderit”, financuar nga WBIF ka përmbyllur fazën e tij të fundit sipas ToR.

Ndërtimi i depozitave nëntokësore të gazit natyror në Dumre (UGS Dumrea). Përgatitja e Studimit të Fizibilitetit dhe VNMS-së për këtë projekt është mbyllur në dhjetor 2021. Rezultatet dhe përfitimet e këtij projekti janë futja e një burimi energjie më të pranueshëm për mjedisin në rajon; lehtësimi i gazifikimit të Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit; sigurimi i furnizimit me gaz të diversifikuar për rajonin; sigurimi i kapaciteteve të konsiderueshme transiti dhe të



ardhurave për Shqipërinë duke reduktuar emetimet e CO2 në rajon dhe duke lehtësuar zhvillimin ekonomik.

Ndërkohë, po shqyrtohet mundësia e përditësimit të Masterplanit të Gazit për të bërë zhvillime të reja që po ndodhin në sektorin e gazit.

Projekti ALKOGAP synon të krijojë një rrugë të re furnizimi për gazin natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni Kaspik i transportuar nga Gazsjellësi Trans Adriatik, në veri-lindje të zonës së Ballkanit Perëndimor drejt Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë. Projekti ALKOGAP do të planifikohet si një tubacion me dy drejtime, drejtimi i mundshëm i furnizimit gjithashtu mund të jetë në veri-jug, nga Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë (ECGR), ose burime të tjera.

Në lidhje me sektorin e Energjisë Elektrike, sipas ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Sistemi i Transmetimit është sistemi që përdoret për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë, i lidhur paralelisht me sistemet e vendeve të tjera, i cili përfshin, por nuk kufizohet te linjat, strukturat mbajtëse, transformatorët dhe pajisjet komutuese për shpërndarjen e Energjisë Elektrike tek klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, duke përjashtuar furnizimin me energji. Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat e tensionit 400 kV, 220 kV, 150 kV, 110 kV dhe nënstacionet e lidhjes ndërmjet tyre që shërbejnë për transmetimin dhe interkonjeksionin.

Gjatësia e linjave të sistemit të transmetimit sipas nivelit të tensionit janë:

- Linja e transmetimit 400 kV 445.7 km;
- Linja e transmetimit 220 kV 1,250 km;
- Linja e transmetimit 150 kV 34.4 km;
- Linja e transmetimit 110 kV 1,701 km.

Linjat e sipërpërmendura janë pjesë e Sistemit të Transmisionit dhe linjave të interkonjeksionit me vendet fqinje si:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi);
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi);
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë);
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierzë (Shqipëri) – Prizren (Kosovë);
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplik (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi);
- Linja e interkonjeksionit 150 kV Bistrice (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).

Gjatë vitit 2021 janë kryer investime me fondet e OST-së dhe investime të huaja që synojnë kryesisht rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet rehabilitimit të nënstacioneve, kryesisht të atyre 110 kV me pajisje të amortizuara në kohë dhe kryesisht në funksionimin manual, si dhe rikonstruksionin e linjave 110 kV dhe 220 kV për rritjen e transmetimit, kapacitetin për të qenë në gjendje të përballojë jo vetëm ngarkesën aktuale të pikut, por edhe të jetë gati për të trajtuar burimet e parashikuara të energjisë së rinovueshme.

Për realizimin e investimeve evidentohet fakti se Qeveria Shqiptare me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 8.10.2021 “Për shpalljen e situatës së jashtëzakonshme të furnizimit me energji elektrike”, mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 90 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, mbi të gjitha vendosi: Shoqëritë KESH, OST dhe Grupi OSHEE do të pezullojnë planet e investimit, me përjashtim të investimeve të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit. Këto shoqëri do të bashkërendojnë veprimtarinë, konform udhëzimeve të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike, deri më 15 prill 2022”.

- Linja e interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës

Linja e interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës ka përfunduar më 28.06.2016. Më 20.04.2020, u përmbyll me sukses marrëveshja e re për kyçje ndërmjet operatorit të sistemit të transmisionit të Kosovës (OST) KOSTT dhe ENTSO-E nga Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale (RGCE). Pas votimit, e më pas nënshkrimit, KOSTT dhe Republika e Kosovës duke fituar pavarësinë energjetike nga Serbia dhe Operuar e Pavarur si Zonë Rregullative, në kuadër të Bllokut Rregullator Kosovë – Shqipëri. Më 14.12.2020, ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Kyçjes ndërmjet KOSTT-it dhe operatorëve të sistemit të transmisionit (OST) nga Evropa Kontinentale duke shënuar ditën e parë të funksionimit të KOSTT-it si zonë kontrolli brenda bllokut të përbashkët të kontrollit me OST-në Shqiptare. Përveç kësaj, linja e re 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë tani është në funksionim duke kontribuar në shkëmbimet e mëtejshme ndërkufitare.

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Maqedoni e Veriut

Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri (Elbasan) – Maqedonia e Veriut (Manastir), është një nga projektet më të rëndësishme të sektorit elektroenergjetik shqiptar dhe në përputhje të plotë me politikat e qeverisë shqiptare për mbështetjen e sektorit elektroenergjetik, e cila synon rritjen e kapacitetet e transmetimit të energjisë, për të përmirësuar sigurinë e furnizimit dhe funksionimin e përgjithshëm të sistemit energjetik të Shqipërisë, si dhe për të ndikuar pozitivisht në tregun rajonal dhe bashkimin e tij.

Nga pikëpamja strategjike, projekti forcon lidhjet e interkonjeksionit me rajonin, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzite të pakufizuara të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën jugore të Shqipërisë, ku pritet prodhim i energjisë elektrike nga burimet e reja energjetike që do të zhvillohen.

Projekti është i ndarë në dy Lote: Loti 1 (Linjat) dhe Loti 2 (Nënstacionet). Kontrata për Lotin 1 “Linjat” është nënshkruar marrëveshja dhe ka hyrë në fuqi më 10 mars 2021. Data e përfundimit të projektit për këtë lot është parashikuar 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Kontrata për Lotin 2 “Nënstacionet” është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi më 27 korrik 2021. Data e përfundimit të projektit për këtë lot është parashikuar 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri (Fieri) – Greqi (Arachtos)

Bazuar në parashikimet dhe potencialet e mëdha zhvillimore të burimeve të rinovueshme, në planet afatgjata të OST parashikohet ndërtimi i linjës së re të interkonjeksionit 400 kV Shqipëri (Fieri) – Greqi (Arachtos), ajrore dhe me një qark të vetëm, me një gjatësi rreth 125 km.

Ky projekt synon të forcojë lidhjen ndërmjet sistemeve të transmetimit elektrik të Shqipërisë dhe Greqisë dhe të rrisë kapacitetin neto të transmetimit të rrjetit shqiptar duke lejuar rritjen e shkëmbimit të energjisë midis dy vendeve dhe reduktimin e sfidave teknike në kuadër të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, por edhe si korridor energjie drejt Europës Qendrore dhe Italisë për shkak të vendndodhjes së Shqipërisë. Projekti është në fazën e diskutimeve me palën greke.

Në lidhje me sektorin e telekomunikacionit, gjatë vitit 2022, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me AKEP-in ka punuar për transpozimin e Direktivës 2018/1972/BE (Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike), e miratuar në dhjetor 2018, e cila ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Projektligji për komunikimet elektronike që bazohet gjerësisht në Direktivën 2018/1972/BE është në proces të konsultimit publik dhe është planifikuar të finalizohet brenda vitit 2022.

Për zhvillimin e rrjeteve të telekomunikacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar projektin për Zhvillimin e Broadbandit Rajonal i cili është pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (*National Single Project Pipeline*) të miratuara nga Komiteti Kombëtar i Investimeve. Me mbështetjen e WBIF ka përfunduar studimi i fizibilitetit për zhvillimin e broadbandit rajonal në korrik 2020. Aktualisht kanë nisur dy projektet e WBIF për zhvillimin e broadband në zonat rurale dhe të bardha në veri dhe jug të vendit. Shqipëria është pjesë e projektit rajonal të WBIF për Digital Balkan Highway, të iniciuar nga Banka Botërore në vitin 2017 dhe që synon rritjen e kapaciteteve ndërkufitare për broadband duke shfrytëzuar kapacitetet e lira të fibrës optike të operatorëve të transmetimit të energjisë.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, dhe zhvillimin e rrjeteve të së ardhmes, është nënshkruar në 2 Nëntor 2020, në Tiranë gjatë Samitit të tretë Digjital të Ballkanit Perëndimor Memorandumi i Bashkëpunimit “Për udhërrëfyesin (Roadmap) për 5G, për transformimin Digjital në Ballkanin Perëndimor”.

Ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të Republikës së Kosovës është nënshkruar në Tiranë në 2.10.2020, Memorandumi i Bashkëpunimit për krijimin e korridorit digjital 5G dhe lehtësimin e lëvizjes në të ardhmen.

Në lidhje me ndërlidhjen digjitale dhe bazuar në angazhimet rajonale në fushën digjitale, me datë 1 korrik 2021 filloi zbatimi i roamingut si në shtëpi (RLAH) në vendet e Ballkanit Perëndimor duke lehtësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe përmirësuar klimën e biznesit.

Për reduktimin e tarifave të roamingut midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së është dakordësuar “Udhërrëfyesi për reduktimin e tarifave të roamingut midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor” i cili bazohet në angazhimin e qeverive të Ballkanit Perëndimor në kryerjen e reformave politike për zhvillimin e ndërlidhjes digjitale. Në këtë kuadër në datë 6 dhjetor 2022, në Samitin e BE-së të zhvilluar në Tiranë, operatorët celularë të vendeve të BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor nënshkruan marrëveshjen për reduktimin e tarifave të roamingut duke filluar nga viti 2023.

Samiti Rrugor, i mbajtur në Tiranë më 7 qershor 2022 konsiderohet një sukses për sa i përket bashkëpunimit rajonal. Ky Samit pati si rezultat dy dokumente të rëndësishme të nënshkruara, Deklaratën për rrugët e së ardhmes – të sigurta, të zgjuara dhe të qëndrueshme, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Autoriteteve Rrugore/Ndërmarrjeve Publike. Të dy dokumente e sipërpërmendura synojnë angazhimin e të gjithë partnerëve për të zhvilluar rrjetin TEN-T në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si dhe për të ndarë përvojat më të mira midis të gjithë aktorëve në rajon.

#### 21.5 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për Kapitullin 21, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94 “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” janë si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Instituti i Transportit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Portet detare, Sh.A;
- Autoriteti Portual i Durrësit;
- Hekurudha Shqiptare Sh.a;
- Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Agjencia për Eficencës së Energjisë;
- KESH, Sh.A;
- OST sh.a.;
- OSHEE sh.a.;

- Albpetrol sh.a.;
- ALBGAS sh.a.;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë;
- INSTAT.

## 21.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Në fushën e rrjeteve Trans-evropiane të Transportit, autoritetet shqiptare duhet të vazhdojnë të forcojnë bashkëpunimin e tyre të ngushtë në kuadrin e bashkëpunimit me TCT dhe të përparojnë me zbatimin e të gjithë planeve të veprimit të hartuara dhe të monitoruara nga TCT.

Me gjithë përparimet e vërejtura në zbatimin e projekteve të infrastrukturës së transportit, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përafuar e direktivën e ITS, për të zhvilluar një strategji kombëtare për zbatimin e ITS edhe për mënyrat e tjera të transportit, si dhe duhet të përgatitemi edhe për zbatimin e saj. Nga ana jonë duhet të sigurohet që projektet në rrjetin e transportit të jenë në përputhje me standardet TEN-T dhe me planet e veprimit të TCT, duke kontribuar në zbatimin e Axhendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Investimet duhet të zbatohen në përputhje me analizat e kostos/përfitimit të kryera në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së. Duhet të vazhdohet të merren masa të mëtejshme për sigurinë rrugore, veçanërisht për eliminimin e “pikave të zeza”, të identifikuara në rrugë me shkallë të lartë aksidentesh. Rrjeti kryesor rrugor tashmë mbulohet nga programe 5-vjeçare të mirëmbajtjes, ndërkohë që miratimi i planeve shumëvjeçare të mirëmbajtjes për rrjetin bazë hekurudhor mbetet një sfidë duke marrë parasysh gjendjen e infrastrukturës hekurudhore.

VKM Nr. 685 datë 14.11.2018 “Për miratimin e praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë” përafuron pjesërisht rregulloren (KE) nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 prill 2013 mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane, që shfuqizon vendimin nr. 1364/2006/EC, si dhe amendon rregulloret (KE) nr. 713/2009, (EC) nr. 714/2009 dhe (EC) nr. 715/2009, të inkuorporuara dhe të përshtatura me vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, 2015/09/MC-EnC, të datës 16 tetor 2015, për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, “Mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane”.

Publikimi i një manuali mbi procedurat për procesin e dhënies së lejeve, të zbatueshëm për Projektet me interes të Komunitetit të Energjisë do të lehtësojë realizimin e projekteve strategjike të infrastrukturës në vazhdim, si dhe përgatitjet e vazhdueshme për projektet e gazifikimit dhe infrastrukturës së gazit, veçanërisht projekti ALKOGAP dhe Gazsjellësi Jon Adriatik.

Prioritetet e vitit 2023 janë:

- Vazhdimi i zhvillimit të rrjeteve kryesore të transportit dhe energjisë në përputhje me: (i) strategjitë kombëtare për transportin dhe energjinë; (ii) prioritetimin e investimeve në

infrastrukturë në kuadër të Listës Prioritare të Projekteve; (iii) Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor duke kontribuar në Agjendën e gjelbër;

- Vazhdimi i harmonizimit të kuadrit ligjor me *acquis* e BE-së dhe rregulloret për TEN-T (rrjetet trans-evropiane të transportit) dhe TEN-E (rrjetet trans-evropiane të energjisë), duke përfshirë transpozimin e plotë të udhëzimeve për infrastrukturën trans-evropiane të energjisë;
- Zbatimi i planeve të veprimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit për transportin rrugor, sigurinë rrugore, transportin hekurudhor dhe lehtësimin e transportit dhe forcimi i kuadrit institucional dhe kapaciteteve administrative për zhvillimin dhe monitorimin e rrjeteve trans-evropiane;

## KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

### 27.1 Përmbajtja e kapitullit

Politikat e BE-së për mjedisin synojnë që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mbrojnë mjedisin për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen në veprimet parandaluese, parimin “ndotësi paguan”, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim, ndarjen e përgjegjësisë dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të Bashkimit Evropian. Legjislacioni mjedisor i BE-së përfshin mbi 200 akte ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale, kimikatet, zhurmat, mbrojtjen civile dhe ndryshimet klimatike. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme. Për aplikimin dhe zbatimin e *acquis* është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal.

### 27.2 Struktura e kapitullit

- Legjislacioni horizontal;
- Cilësia e ajrit;
- Menaxhimi i mbetjeve;
- Cilësia e Ujit;
- Mbrojtja e natyrës;
- Ndotja industriale;
- Kimikatet;
- Zhurmat;
- Mbrojtja Civile;
- Ndryshimet Klimatike

### 27.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim -Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me atë të BE-së.

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-së buron nga neni 108 i MSA-së, në të cilin citohet si më poshtë:

- Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit të mjedisit, me qëllim të promovimit të qëndrueshmërisë së mjedisit;
- Bashkëpunimi është përqendruar kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e mjedisit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funkionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Politikat e Bashkimit Evropian për mjedisin dhe ndryshimet klimatike synojnë të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, kalimin drejt një ekonomie me përdorim eficient të resurseve, emetime të ulëta dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat ekzistuese dhe të ata të ardhshëm. Parimet kryesore të *acquis* të përfshira në këtë kapitull janë: veprimi parandalues, parimi se ndotësi paguan, lufta kundër dëmtimit të mjedisit në burim, përgjegjësia e përbashkët dhe integrimi konsideratave mjedisore, klimatike dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore në politikat e tjera të Bashkimit Evropian. *Acquis* e Bashkimit Evropian në këtë kapitull përmban mbi 200 akte ligjore që rregullojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjeve industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, zhurmat, mbrojtjen civile dhe ndryshimet klimatike.

Respektimi i *acquis* së përfshirë në këtë kapitull kërkon investime të konsiderueshme dhe bashkëpunim të strukturuar ndërmjet të gjithë grupeve të interesit, duke përfshirë autoritetet vendore, industrinë dhe shoqërinë civile. Për më tepër, për aplikimin dhe zbatimin e *acquis* është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal.

### 27.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen mjedisit si një nga objektivat kryesorë të Shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit siguron bazat për akte

ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, pyjet .

Në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me *acquis* – legjislacionin evropian, është shënuar progres në fusha të tilla si: menaxhimi i mbetjeve dhe ujit, krimi mjedisor dhe mbrojtja civile. Përpjekje të mëtejshme janë ende të nevojshme për forcimin dhe zbatimin e legjislacionit, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve, cilësisë së ujit dhe ajrit, si dhe ndryshimet klimatike.

### **Legjislacioni horizontal**

Mesatarisht Legjislacioni Horizontal, është në nivel të avancuar të transpozimit, me 83.8%<sup>\*72</sup>, dhe disa pjesë të tjera të legjislacionit nën këtë kapitull, në nivele të ndryshme transpozimi.

Ka progres lidhur me zbatimin e plotë të Direktivës INSPIRE. Nevojitet progres i mëtejshëm për të arritur implementimin e plotë me direktivën për përgjegjësinë mjedisore, megjithëse Shqipëria ka transpozuar Direktivën për krijimin e një infrastrukture për informacionin hapësinor (INSPIRE).

Pjesëmarrja dhe konsultimi me publikun në vendimmarrje, duhet të përmirësohet, veçanërisht në nivelin lokal.

### **Cilësia e ajrit**

Transpozimi i nënkapitullit të cilësisë së ajrit është në nivel të avancuar 95%.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit (PKMCA), i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 412/2019, është duke u zbatuar në vend prej qershorit 2019 dhe identifikon masat që duhen implementuar nga institucionet përgjegjëse për të reduktuar shkarkimet në ajër që vijnë nga sektorët përkatës si: transporti, zhvillimi urban, sektori bujqësor, veprimtaritë industriale, etj. Bashkitë duhet të hartojnë planet e tyre lokale për menaxhimin e cilësisë së ajrit. Financimi dhe investimet e duhura në këtë fushë, janë të nevojshme për të garantuar zbatimin e legjislacionit, mbikëqyrjen e vazhdueshme, sigurimin e të dhënave dhe raportimin shkarkimeve kombëtare të ndotësve të ajrit nga të gjithë sektorët kontribuues.

Aktualisht, pajisjet e monitorimit të ajrit kanë hasur sfida për shkak të nevojës për kalibrim dhe mirëmbajtje. Mbetet për t'u rishikuar buxheti i dedikuar për kalibrimin e tyre.

---

<sup>72</sup> Dokumenti i analizës ligjore screening (SPA), përgatitur nga programi SANE27, rishikuar në vitin 2022.



Përmbushja e detyrimeve nga Konventa e UNECE, mbi Ndotjen e Ajrit në Distancë të Largët Ndërkufitare CLRTAP, kërkon rritjen e kapaciteteve teknike dhe zbatimin e projekteve mbështetëse afatgjata. Njësitë e Vetëqeverisjes lokale, kanë kapacitete teknike dhe burime të limituara financiare, dhe si rrjedhojë nuk kanë përgatitur planet lokale të cilësisë së ajrit sikurse kërkohen nga legjislacioni kombëtar në këtë fushë. Në zbatim të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, është miratuar VKM nr. 830, datë 24.12.2021 “Për masat lidhur me sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO<sub>2</sub> gjatë marketingut të automjeteve të reja”, që transponon pjesërisht Direktivën 1999/94/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 13 dhjetorit 1999 në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit për konsumin e karburantit dhe shkarkimet e CO<sub>2</sub> në lidhje me tregtimin e automjeteve të reja të pasagjerëve, të ndryshuar. VKM 830/2021 synon vënien në dispozicion të konsumatorëve të informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO<sub>2</sub> në automjetet e reja të pasagjerëve që ofrohen për shitje ose për dhënie më qira në Shqipëri, me qëllim:

- a) që t’i mundësoj konsumatorëve të bëjnë një zgjedhje të bazuar në informacion, si dhe
- b) promovimin e blerjes ose dhënies me qira të automjeteve, që përdorin më pak lëndë djegëse dhe në këtë mënyrë shkarkojnë më pak CO<sub>2</sub> në mjedis.

Efektet e VKM 830/2021, do të fillojnë në datë 1.1.2023.

Duke qenë se në Shqipëri emetimet që vijnë nga sektori i transportit janë ndër sektorët kryesorë përgjegjës që kontribuojnë në ndotjen e ajrit dhe emetimet e gazeve serrë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në fillim të vitit 2022, ndërmori një nismë të re për promovimin e zgjidhjeve të transportit alternativ miqësor me mjedisin. Bazuar në Udhëzimin e Ministres së Turizmit dhe Mjedisit, nr.1, datë 24.3.2022, “Për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimin e ndotjes në mjedis dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, caktimin e ditës pa makina” nga data 24 mars 2022, e diela e parë e çdo muaji në Shqipëri është caktuar si “Dita pa Makina” dhe qarkullimi i të gjitha kategorive të automjeteve private është i kufizuar përkohësisht në zonat e banuara.

## **Menaxhimi i Mbetjeve**

Kuadri ligjor është transpozuar me 53.5%. Strategjia e re kombëtare 2020 – 2035 për menaxhimin e integruar të mbetjeve është miratuar më 27 maj 2020. Ajo synon përfshirjen e parimeve të ekonomisë qarkulluese në sistemin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Gjithashtu është miratuar, Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, me Vendimin Nr. 1 datë 13.01 2020 nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në bazë të këtyre dokumenteve, Shqipëria është ndarë në 10 zona mbetjesh. Për secilën zonë do të ndërtohet nga një impiant rajonal për trajtimin e integruar të mbetjeve. Deri tani janë ndërtuar dhe funksionojnë impiantet rajonale (landfilli Bushat, Bajkaj, Maliq, Sharrë, Impianti i trajtimit të mbetjeve të Elbasanit dhe Fierit). Është në proces ndërtimi edhe i landfilleve të Sherishtës, Vlorës dhe Impianti i trajtimit të mbetjeve Tiranë. Parashikohet që brenda vitit 2030 të ndërtohen landfille për të gjitha zonat e tjera të mbetjeve, Berat, Kukës dhe Dibër.

Në zbatim të VKM Nr. 428 datë 8.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, për hartën digjitale të deponive të mbetjeve urbane", po hartohet harta GIS, e krijuar me informacione që pasqyrojnë situatën aktuale të mbetjeve urbane, deponitë, si dhe zhvillime të tjera në terren.

Është miratuar VKM Nr.402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", e cila transponon direktivën e katalogut evropian të mbetjeve.

Pas një analize të detajuar të mangësive, sfidave ose progresit në fushën e menaxhimit të mbetjeve, në fund të shtatorit 2020, u përgatit një plan veprimi në fushën e menaxhimit të mbetjeve me mbështetjen e projektit SANE 27. Plani është përgatitur për të gjitha Direktivat dhe Rregulloret e BE-së për nënkapitullin e mbetjeve. Përmbajtja e tij ofron një përshkrim të hollësishëm të situatës aktuale, transpozimin dhe zbatimin e detyrave që do të kryhen në periudhën afatshkurtër (2021 – 2023) dhe afatmesme (2024 – 2027) si dhe një vlerësim të burimeve financiare dhe njerëzore për të kryer këto detyra. Ky plan përcakton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira si dhe afatet për zbatimin e direktivave të përgatitura. Bazuar në identifikimin e vend-depozitimeve në të gjithë vendin, ka filluar rehabilitimi dhe mbyllja e tyre.

Janë rehabilituar nga një vendepozitim ekzistues në bashkitë e Beratit, Dimalit dhe Kuçovës, me mbështetjen e projektit zviceran SECO. Mbyllja e vend-depozitimit në Porto Romano dhe kthimi i tij në një ekopark është financuar nga buxheti i shtetit. Disa vendepozitime ekzistuese janë rehabilituar me buxhet të shtetit në bashkitë: Krujë, Kukës, Burrel, Përmet, Libohovë. Një seri trajnimesh janë kryer për të zbatuar plotësisht VKM 319/2018 në lidhje me llogaritjen e kostove dhe tarifave të kërkuara për menaxhimin e mbetjeve në një Njësi të Qeverisjes Vendore. Fillimisht trajnimet u zhvilluan me praninë e përfaqësuesve të komunave dhe më pas për shkak të fillimit të situatës pandemike, trajnimet u zhvilluan në internet përmes platformave të ndryshme: skype, webex, zoom.

Me asistencë të programit të financuar nga qeveria suedeze, "Mbështetje për Përgatitjen e Shqipërisë për Negociatat për anëtarësim në BE", SANE27, nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA), ka filluar përgatitja e një drafti për të vendosur sistemin e Përgjegjësisë të Zgjeruara të Prodhuesit.

Duke mbajtur në konsideratë përgatitjet e Shqipërisë për negociatat me BE, është thelbësore jo vetëm transpozimi i direktivave/rregulloreve të BE, por edhe zhvillimi i praktikave më të mira për zbatimin e sistemit të Përgjegjësisë të Zgjeruara të Prodhuesit.

Në këtë kuadër është miratuar ligji 28/2022 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i ndryshuar". Ky ligj është plotësuar me disa akte nënligjore. Janë kryer fushata ndërgjegjësimi për reduktimin deri në heqjen nga përdorimi të qeseve të holla plastike me qëllim përdorimin e çantave prej tekstili. Janë marrë masa për zvogëlimin e qeseve plastike, si dhe plastikës përmes vendosjes së kritereve të miratuara me Vendimin Nr. 367, datë 30.5.2022 "Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në

territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”, i ndryshuar si dhe Vendimin Nr. 563, datë 29.7.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, të ndryshuar.

Objektivat specifike të Dokumentit të Politikave Strategjike synojnë të japin zgjidhje praktike për:

1. Adresimin e problematikave në sistemin e deritanishëm të menaxhimit,
2. Zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe,
3. Përgatitjet e nevojshme për të përmbushur detyrimet nga ndryshimet në Direktivat e BE-së, përfshirë edhe objektivat e synuar në kuadër të Ekonomisë Qarkulluese.

Arritja e këtyre objektivave, përmirëson cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve, duke dhënë gjithashtu kontribut në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, si dhe hapjen e rrugës drejt integritimit evropian.

Në zbatim të VKM Nr. 538, datë 22.9.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 687, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, janë kryer trajnime me përfaqësues të pushtetit vendor.

## **Cilësia e ujit**

Sa i përket legjislacionit në fushën e Ujësjetës Kanalizimeve:

Me Urdhrin nr. 165, datë 08.09.2022, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës, për “Hartimin e Strategjisë Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, të Projektligjit dhe Rregullores së Standardeve të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri”. Grupi aktualisht ka rishikuar draft dokumentin e Strategjisë sektoriale dhe parashikohet që të miratohet brenda tre mujorit të parë të vitit 2023. Projektligji dhe Rregullorja e Standardeve të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve parashikohet të përfundojnë brenda vitit 2023.

Me Vendimin Nr. 302, datë 11.5.2022 “Për Politikën Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, ka nisur procesi i riformatimit për ofruesit e shërbimit të Ujësjetës Kanalizimeve.

Reforma konsiston në:

1. Shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizime ekologjiksht, tekniksht dhe financiarisht të qëndrueshme përmes mbulimit të plotë të kostos;
2. Shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizime me efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë Evropiane;
3. Shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizime të ofruara për konsumatorët me çmim të përballueshëm;
4. Transparencë në politikën e ujit dhe pjesëmarrje të publikut.

Procesi i riorganizimit po kryhet në bashkëpunim dhe mirëkuptim të plotë me pushtetin vendor, gjë e cila u reflektua në nënshkrimin e marrëveshjeve specifike, që çoi në formimin e 15 shoqërive të rajonalizuara të Ujësjellës Kanalizimeve.

Niveli i përafrimit të legjislacionit të BE-së më atë kombëtar për fushën e menaxhimit të ujërave për disa direktiva të rëndësishme, mbetet i pjesshëm, me transpozim 53%. Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1015, datë 16.12.2020, e ka rritur nivelin e përafrimit, pasi përmes tij janë përafuar pjesërisht 4 Direktiva, specifikuat Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2009/90/EC, Direktiva 2006/118/EC dhe Direktiva 2007/60/EC.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2021 është përgatitur një paketë ligjore nëpërmjet mbështetjes së projektit EUSIWM, financuar nga BE dhe ADA, e cila synon transpozimin e plotë të 9 Direktivave. Në këtë kuadër, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për finalizimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 24 datë 9.02.2021, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”. Ky grup ka filluar punën në prill të viti 2021 dhe vijoi edhe gjatë vitit 2022, deri në finalizimin e të gjithë paketës ligjore. Në vijim të përfundimit të punës së Grupit të Punës është bërë edhe konsultimi i projektligjit të ri “Për Burimet ujore” dhe Projektligjit “Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë” me publikun nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik të konsultimit publik, në faqen zyrtare të AMBU-së si dhe përmes organizimit të takimeve në nivel teknik në nivel baseni lumor, përkatësisht në të (7) Këshillat e Baseneve Ujore (KBU), në përbërje të të cilave janë përfaqësues të pushtetit lokal dhe grupeve të interesit. Në këto takime u ftuan edhe përfaqësues të OJF, objekti i veprimtarive të të cilave është i lidhur me sektorin e menaxhimit të integruar të ujit, si dhe përfaqësues nga bota akademike.

Aktualisht projektligji “Për Burimet Ujore” është në fazën e dërgimit për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave. Ndërsa Projektligji “Për strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë” pritet të përcillet për vijimin e procedurave për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave.

PMBU (Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor) Seman u miratua me VKM-në Nr. 453, datë 10.06.2020 “Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Seman”. Gjithashtu, PMBU Drin – Bunë, u miratua me VKM Nr. 849, datë 4.11.2020 “Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin – Bunë”. Mbi këto plane është bazuar puna në vijimësi për menaxhimin e baseneve ujore.

Gjithashtu me asistencë të projektit EUSIWM, ka filluar hartimi i Planeve të Menaxhimit për Basenet Ujore Ishëm, Erzen dhe Mat. Në këtë kuadër, përmes Urdhrit të Kryeministrit Nr. 32, datë 1.03.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për hartimin e planeve të menaxhimit të Baseneve Ujore, Ishëm, Erzen dhe Mat”, janë ngritur grupe ndërinstitucionale pune, me synim finalizimin e planeve të Menaxhimit në basenet e cituara më lart. Gjatë vitit 2022 është finalizuar faza e dytë e konsultimit Publik për draftin Përfundimtar të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor për basenin e lumit Ishëm dhe draftin Përfundimtar të Planit

të Menaxhimit të Basenit Ujor për basenin e lumit Erzen. Periudha e konsultimit zgjati 6 muaj për secilin dokument.

Pas përfundimit të procesit të konsultimit, janë mbledhur të gjitha komentet dhe sugjerimet që janë me rëndësi ekonomike, mjedisore dhe sociale dhe do të përfshihen në dokumentin final, i cili pritet të fillojë procedurën për miratim nga KKU, e më pas në Këshill të Ministrave.

Referuar ligjit 91/2013 të Legjislacionit Shqiptar (dhe Direktivës së BE-së 2001/42/KE), paralelisht me PMBU-të (Ishëm dhe Erzen) janë hartuar dhe publikuar raportet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për secilin Plan.

Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar drafti i Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor për Basenin e Lumit Mat dhe është publikuar në faqen zyrtare të AMBU-së në nëntor të këtij viti, duke kaluar me fazën e dytë të Konsultimit Publik. Periudha e konsultimit do të zgjasë 6 muaj dhe do të përfundojë në prill të 2023.

Ndërkohë, me mbështetjen e projektit EUSIWM, ka përfunduar hartimi i dy raporteve siç janë “Analiza e Hendekut” dhe “Raport Rekomandimi” për basenin ujor Vjosë, dokumente paraprake që do të ndihmojnë në hartimin e PMBU-së Vjosë.

Në qershor 2021, Këshilli Kombëtar i Ujit miratoi me Vendimin Nr. 1 datë 15.06.2021, Raportet e Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për Basenet Ujore Drin – Bunë, Mat, Ishëm Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe shpalljen e zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa që të ndodhin përmbytje. Në vijim, me urdhrin e Kryeministrit Nr. 75, datë 10.09.2021, është ngritur Grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e projektplanit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin – Bunë 4, 5 dhe 6. Në vijim gjatë vitit 2022 është hartuar Projektplanin e Menaxhimit të Rrezikut, i cili aktualisht është në proces miratimi nga Këshilli Kombëtar i Ujit, dhe në vijim do të publikohet për një periudhë 6 mujore për konsultim. Plani përfundimtar i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, për territorin në fjalë, pas miratimit paraprak në Këshillin Kombëtar të Ujit do të miratohet në Këshillin e Ministrave.

## **Mbrojtja e natyrës**

Përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, kryesisht referuar Direktivave për Habitatet dhe Shpendëve, është në nivel të avancuar. Ky nënkaptull është transpozuar me një mesatar me 32%. Në zbatim të protokollit të Nagojës për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre, u miratua Ligji Nr. 41/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9875, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar, i cili përafrohet pjesërisht Rregulloren (BE) Nr. 511/2014, datë 16.4.2014 "Mbi masat e pajtueshmërisë për përdoruesit nga Protokollin e Nagojës mbi aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që realizohen nga përdorimi i tyre në Union”. Është në proces plotësimi i këtij ligji me akte nënligjore, për të realizuar zbatueshmërinë e tij në praktikë.

Gjatë vitit 2022 do të fillojë rishikimi dhe përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, për periudhën deri në 2030, në linjë me kuadrin global Post 2020 për biodiversitetin, të Konventës së biodiversitetit dhe Strategjisë Evropiane për Biodiversitetin Post 2020.

Janë miratuar 4 VKM, konkretisht:

- VKM nr. 59, datë 26.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) e zonave të mbrojtura mjedisore”, me të cilën janë miratuar 11 zonat e mëposhtme, mes tyre dhe i vetmi Park Kombëtar Detar (PKD):
  - PK “Alpet e Shqipërisë”,
  - PK “Bredhi i Hotovës - Dangëlli”,
  - PK “Butrint”,
  - PK “Divjakë - Karavasta”,
  - PK “Mali i Dajtit”,
  - PK “Lurë - Mali i Dejës”,
  - PK “Llogora”,
  - PK “Mali i Tomorrit”,
  - PKD “Karaburun - Sazan”,
  - PK “Shebenik”,
  - PK “Prespa”.
  
- VKM nr. 60, datë 26.01.2022 “Për shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar / Park Natyror (Kategoria IV), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”, me të cilën janë miratuar 23 zonat e mëposhtme:
  - PN “Bredhi i Sotirës”,
  - PN “Korab - Koritnik”
  - PN “Ulëz”,
  - PN “Mali me Gropa - Bizë - Martanesh”,
  - PN “Qafështamë”,
  - PN “Syri i Kaltër”,
  - PN “Zagori”,
  - RNM “Balloll”,
  - RNM “Bogovë”,
  - RNM Bredhi i Kardhiqit - Rrëzomë”,
  - RNM “Bredhi i Zhulatit”,
  - RNM “Cangonj”,
  - RNM “Dardhë - Xhyrë”,
  - RNM “Gërmenj”
  - RNM “Karaburun”,
  - RNM “Kune - Vain - Patok - Fushë Kuqe - Ishëm”,

- RNM “Liqeni i Shkodrës”,
- RNM “Polis”,
- RNM “Stavraj - Sopot”,
- PN “Lugina e Shalës”,
- PN “Lugina e lumit Vjosë”,
- PN “Munellë”,
- RNM “Lugina e Gjergjovicës”.

Për shkak të rëndësisë dhe vlerave që mbart, si në aspektin natyror por dhe atë turistik, por njëkohësisht të interesit të gjerë për ruajtjen e këtij lumi në nivel ndërkombëtar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka nisur punën për koordinimin e procesit për vlerësimin e basenit ujëmbledhës dhe ekosistemit lumor të lumit Vjosa me qëllim shpalljen “Park Kombëtar Lugina e Vjosës”, me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre vlerave natyrore por dhe zhvillimin e potencialit turistik të Parkut të Vjosës. Procesi i shpalljes si Park Kombëtar pritet të përfundojë në muajt e parë të vitit 2023.

- VKM nr. 557, datë 29.07.2022 “Për shpalljen e ekosistemit natyror detar - bregdetar të Gjirit të Porto-Palermos “Park Natyror”, Kategoria IV”.
- VKM nr. 694, datë 26.10.2022 “Për ndryshimin e statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor “Pishë Poro–Nartë” nga “Rezervat Natyror i Menaxhuar” në “Peizazh i Mbrojtur” dhe heqjen e statusit “Zonë e Mbrojtur” të sipërfaqes së pakësuar”.

Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal për zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor të përditësuar dhe për procesin e ngritjes së rrjetit Natura 2000 në vend, është prioritet i fushës së mbrojtjes së natyrës, si detyrimi kryesor në kuadrin e procesit të integritimit evropian të vendit.

Struktura e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura, është miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 188 datë 15.11.2022 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 26, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave rajonale të zonave të mbrojtura”, duke e rritur numrin e punonjësve të ngarkuar për të bërë monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në tetor 2021 ka përfunduar regjistrimi i fondit pyjor dhe kullosor kombëtar në sistemin kadastral të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Krijimit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve. Ky inventar do të mundësojë akses më të mirë të informacionit nga ana e qytetarëve dhe do të mundësojë transaksionet ligjore me pronat pyjore për bashkitë;

Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka si mision qeverisjen e mirë të pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore shumëfunktionale, si burime natyrore me rëndësi kombëtare, që të realizohet:

- Sigurimi i performancës në sektorin e pyjeve;
- Vlerësimi i gjetjes së pyjeve;

- Të organizoje punën për inventarizimin dhe hulumtim në fushën e pyjeve;
- Organizimi i punës dhe hartimi i dokumenteve për menaxhimin e pyjeve;
- Organizimi i punës për monitorimin e pyjeve

## **Ndotja industriale**

Lidhur me ndotjen industriale, përafrimi me legjislacionin e BE-së mbetet sfidë. Transpozimi i përgjithshëm është 44%.

Transpozimi i Direktivës së Emetimeve Industriale mendohet të jetë rreth 70%, nëpërmjet miratimit të disa akteve ligjore.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të përafrojë pjesërisht në disa nene Direktivën 2010/75 / BE deri në fund të vitit 2024 duke miratuar Projektligjin ekzistues “Për Lejet Mjedisore” të përgatitur me çdo ndryshim të mundshëm.

## **Kimikatet**

Referuar fushës së *kimikateve*, megjithëse transpozimi është 25%, janë ndërmarrë disa hapa pozitivë në kuadër të harmonizimit me Rregulloren e BE-së për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH) dhe me instrumente të tjerë. Në shkurt të vitit 2020 Shqipëria ratifikoi Konventën Minamata për merkurin. Në prill 2021 u miratua VKM Nr. 222/2021, "Mbi miratimin e listës së substancave kandidatë", e cila ka sjellë në legjislacionin shqiptar 211 substanca dhe grup substancash të vlerësuara në aspektin e sigurisë kimike, në zbatim të legjislacionit të Bashkimit Evropian për kimikatet (*REACH dhe CLP*).

Me miratimin e VKM nr. 691, datë 26.10.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 360, datë 29.4.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”, legjislacioni kombëtar është përafuar pjesërisht me Rregulloren në fuqi (EU) 2019/1021 të Këshillit dhe të Parlamentit Evropian të datës 20 qershor 2019 mbi ndotësit organik të qëndrueshëm.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 23, datë 3.02.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, në korrik 2020, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është ngritur Zyra e Kimikateve, si një detyrim ligjor dhe organ kryesor për zbatimin e legjislacionit të kimikateve dhe menaxhimin e tyre në Shqipëri.

Për ti ardhur në ndihmë ngritjes së një helpdesku kombëtar mbi kimikatet, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit është krijuar dhe funksionon adresa e e-mail [info.kimikatet@akm.gov.al](mailto:info.kimikatet@akm.gov.al).

Për të siguruar bashkëpunimin dhe koordinimin midis institucioneve përgjegjëse në zbatim të ligjit 27/2016, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit prej datës 17 mars 2021, ka ngritur grupin



ndërinstitucional të punës mbi kimikatet, të përbërë nga 21 institucione të ndryshme që angazhohen sipas legjisllacioneve të tyre sektoriale.

Sidoqoftë, legjisllacioni i miratuar dhe strukturat e ngritura administrative duhet të forcojnë kapacitetet e tyre teknike në këtë fushë.

Gjithashtu janë ndërmarrë disa hapa pozitive lidhur me transpozimin në legjisllacionin kombëtar të Rregullores REACH Nr. 1907/2006, i cili ka avancuar më tej me miratimin e:

1. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 319, datë 15.05.2019 “Për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”;
2. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”;

Në vijim të miratimit nga Parlamenti Shqiptar të Ligjit Nr. 7/2020 “Për ratifikimin e Konventës së Minamatës “Për merkurin”, prej datës 26 Maj 2020, Shqipëria listohet përkrah shteteve që kanë ratifikuar Konventën e Minamatës për Merkurin, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet negative të merkurit. Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 442, datë 26.06.2019 “Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe të kriterëve specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje”, i cili ka transpozuar pjesërisht Rregulloren (EU) 2017/852 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2017 mbi merkurin, që shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1102/2008, CELEX: 32017R0852. VKM 442/2019, ka hyrë në fuqi prej datës 1 Janar 2020, dhe synon zbatimin e Konventës së Minamatës për Merkurin.

Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 161, datë 19.02.2020, “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”, i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën e Këshillit 87/217/EEC datë 19 mars 1987, Për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti e amenduar.

Në vend vazhdon të zbatohet **Projekti me titull “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve”** i cili mbështetet financiarisht nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) dhe zbatohet nga Agjencia Suedeze e Kimikateve (KemI). Në zbatim të Planit të Punës te projektit, gjate periudhës 2021-2022, janë zhvilluar disa aktivitete me fokus: (i) ndërgjegjësimin në të gjitha nivelet mbi rolin dhe detyrat që ka Zyra e Kimikateve, në zbatim te ligjit 27/2016; (ii) diskutime mbi ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Kombëtar të Kimikateve; (iii) ngritjen në AKM të një Helpdesku kombëtar për Kimikatet; (iv) organizimi trajnimeve “Train of the Trainers”, për forcimin e kapaciteteve te strukturave inspektuese ne vend, qe lidhen direkt ose indirekt me kimikatet, si dhe etiketimin e produkteve kimike.

Në vijim të punës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji 27/2016, për vitin 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit po angazhohet në përgatitjen e dokumentit të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Sigurt të Kimikateve. Ky Plan, po përgatitet me mbështetjen teknike të projektit “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për përmirësimin e menaxhimit të kimikateve”.

### **Mbrojtja nga zhurmat**

Lidhur me nënfushën e mbrojtjes nga zhurmat, transpozimi i legjislacionit është 86%.

Prioritet mbetet krijimi i hartës së zhurmave, i cili kërkon angazhim serioz dhe aktiv të të gjitha bashkive të vendit.

Autoritetet përkatëse janë duke identifikuar zonat në vend, për të hartuar një hartë digjitale të zhurmave.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë iniciativën e rishikimit të Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.

Qëllimi i këtij projektligji është ndarja e qartë e kompetencave midis institucioneve qendrore dhe vendore për monitorimin e nivelit të zhurmës në zona publike apo ajo e gjeneruar nga veprimtari ekonomike apo sociale, si dhe dhënien e miratimeve për zhvillimin e aktiviteteve që lëshojnë zhurmë në mjedis, duke siguruar që zhurma e lejuar të jetë brenda vlerave kufi, me objektiv madhor për ta bërë Shqipërinë një vend që plotëson standardet Evropiane për administrimin e zhurmës dhe duke ngritur sistemin bazë për të raportuar në lidhje me hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për zhurmën. Ky ligj transponon pjesërisht Direktivën 2002/49/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002 në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore - Deklarata e Komisionit në Komitetin e Pajtimit mbi Direktivën në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore, Fletorja Zyrtare L 189, 18/07/2002 F. 0012 – 0026, 02002L0049 — EN — 29.07.2021 — 006.001.

### **Mbrojtja Civile**

Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, është miratuar nga Kryeministri me Urdhrin Nr. 27, datë 3.02.2020, gjithashtu ligji Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, i cili shndërron Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, krijon kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në të ardhmen në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit.

Aktualisht po punohet për hartimin dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit.

Agjencia është në procese të ndryshme bashkëpunuese me partnerët dhe strukturat homologe, si dhe në procedura zbatuese të projekteve të ndryshme të financuara nga organizata ndërkombëtare. Këto nisma po ndihmojnë në funksionimin e agjencisë, ngritjen e kapaciteteve, infrastrukturave

dhe sistemeve, si dhe për anëtarësimin në të ardhmen në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane (UCPM).

Me mbështetjen e UNDP pritet të fillojë puna sa më shpejt për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Në vitin 2019 nisi reforma për ristrukturimin e strukturave të reagimit ndaj Emergjencave Civile, e cila u konkretizua me miratimin e ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”. Ligji për mbrojtjen civile parashikon krijimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile si person juridik publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, dhe ka përgjegjësinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës Së Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 747, Datë 20.11.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare Të Mbrojtjes Civile”, dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, në datën **03.02.2020** nisi procesi për funksionalizimin e NCPA-së.

Gjithashtu janë hartuar dhe miratuar e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit si më poshtë:

- VKM nr. 747, datë 20.11.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”;
- VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e Organizatës së Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të Institucioneve dhe Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile”;
- VKM nr. 1020, datë 16.12.2020 “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë”;
- VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për marrjen e certifikatës për rrezikun e subjekteve, që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”;
- VKM nr. 158, datë 17.03.2021 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”;
- VKM nr. 412, datë 8.07.2021 “Për miratimin e Flamurit, Stemës dhe Uniformës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”;
- VKM nr. 414, datë 8.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për ndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”;
- VKM nr. 431, datë 15.07.2021 “Për përbërjen dhe detyrat e njësive organizative që kanë në kompetencë çështjet e mbrojtjes civile në ministritë e linjës”;
- VKM nr. 594, datë 13.10.2021 “Për miratimin e kriterëve të identifikimit të subjekteve private, strukturave përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullave për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre”;
- VKM nr. 667, datë 10.11.2021 “Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në veprimtaritë e mbrojtjes civile ose në operacionet e parandalimit dhe reagimit ndaj fatkeqësive”;

- VKM nr. 775, datë 15.12.2021 “Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrin dhe mënyrën e përdorimit të tyre në rast fatkeqësish”;

Nënshkrimi i Planit Operacional në fushën e Mbrojtjes Civile në Kuadër të Marrëveshjes Open Balkan, nënshkruar më 2 Shtator 2022, në Beograd mes Republikës së Serbisë, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në kuadër të Rregullores së (BE) 2021/836, e cila parashikon anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (UCPM), Shqipëria dhe ka miratuar nëpërmjet DCM nr. 714 datë 11.11.2022 “Për miratimin në parim në të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, njëra palë dhe Bashkimit Evropian pala tjetër për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit” si dhe “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë nga njëra palë dhe Bashkimit Evropian, pala tjetër për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit” dhe në përputhje të plotë me Ligjin 45/2019.

Gjithashtu, anëtarësimi në UCPM parashikon edhe instalimin e sistemit TESTA. Rrjeti sTESTA (Trans European Services for Telematics between Administrations) është një rrjet i sigurt. Aktualisht sTESTA lejon ndërlidhjen dhe ofron shërbime për një numër të gjerë të aplikacioneve të regjistruara dhe palëve të interesuara, përfshirë administratat e Shteteve Anëtare të BE-së, Institucionet Evropiane dhe Agjencitë Evropiane. Aktualisht Shqipëria nuk mund të nxjerrë një kosto për implementimin e sTESTA duke qenë se përfshin gjithë administratën shqiptare dhe do të kryhet në bashkëpunim me BE, hap pas hapi. Nëpërmjet implementimit të sTESTA (e cila është parakusht për CECIS), do të vijohet me implementimin CECIS (Sistemit të Përbashkët të Komunikimit dhe Informacionit të Emergjencave), i cili është një sistem komunikimi emergjent dhe mjet monitorimi, një aplikacion alarmi dhe njoftimi i bazuar në ueb që mundëson një shkëmbim informacioni në kohë reale. Sistemi CECIS do të përdoret nga Qendra Kombëtare e Mbrojtjes Civile në NCPA, njësoj si ERCC ( Qendra e Koordinimit të përgjigjes të BE).

**Hartimi i projekteve të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskun ndaj Fatkeqësive, Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror dhe Plani Kombëtar i Emergjencave Civile.**

- **Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskun ndaj Fatkeqësive**

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, është ngritur urdhri nr. 57, datë 29.06.2021 “Për krijimin e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin të Riskut nga Fatkeqësitë”. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka vijuar përgatitjen e materialeve dhe dokumenteve të ndryshme, për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë së Grupit të Punës Ndërinstitucionale dhe Grupit Teknik të Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimin të Riskut nga Fatkeqësitë.

- **Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror**

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile, është ngritur Urdhrit nr. 59 datë 29.06.2021 “Për Ngritjen dhe Funkcionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kryerjen e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror”. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka vijuar përgatitjen e materialeve dhe dokumenteve të ndryshme, për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë së Grupit të Punës Ndërinstitucionale dhe Grupit Teknik të Punës për hartimin e Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror.

- **Plani Kombëtar i Emergjencave Civile.**

Në lidhje me Planit Kombëtar për Emergjencat Civile si dhe duke marrë parasysh faktin se që nga viti 2004 ka një ndryshim rrënjësor në funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe strukturave dhe institucioneve përbërëse të tij, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 58, datë 29.06.2021 “Për krijimin e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e draft Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”, ka nisur puna për hartimin e Planit të ri Kombëtar për Emergjencat Civile me krijimin e Grupit të Punës Ndërinstitucionale dhe Grupit të Punës Teknike Ndërinstitucionale.

- **Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskun ndaj Fatkeqësive**

Anëtarët e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës, në cilësinë e ekspertëve teknikë, si dhe nën udhëheqjen e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë kanë finalizuar tashmë draft-dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë. Drafti -dokumenti pasi është dërguar për mendim dhe rekomandime tek institucionet pjesëmarrëse ka marrë konfirmimin e tyre te plote për zhvillimin e hapave të tjerë për miratim. Aktualisht drafti i dokumentit të mësipërme ka përfunduar dhe do të kalojnë së shpejti për miratim në Këshillin e Ministrave. Gjithsesi, implementimi i këtij akti fillon zbatimin vitin që vjen dhe për shkak të projekteve dhe investimeve të mëdha që parashikohen të kryhen në të ardhmen.

- **Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror**

Anëtarët e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës në cilësinë e ekspertëve teknikë, si dhe nën udhëheqjen e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë kanë finalizuar tashmë draft-dokumentin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror. Drafti -dokumenti pasi është dërguar për mendim dhe rekomandime tek institucionet pjesëmarrëse ka marrë konfirmimin e tyre të plotë për zhvillimin e hapave të tjerë për miratim. Aktualisht drafti i dokumentit të mësipërme ka përfunduar dhe do të kalojnë së shpejti për miratim në Këshillin e Ministrave.

- **Plani Kombëtar i Emergjencave Civile.**

Aktualisht ka nisur puna për hartimin e Planit të ri Kombëtar për Emergjencat Civile. Gjithashtu në funksion të hartimit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC), me mbështetjen e UNDP, janë zhvilluar takime me ekspertët kombëtar dhe ndërkombëtar të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës.

- **Paralajmërimi i hershëm**

Në bazë të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile” Paralajmërimi, monitorimi dhe njoftimi i hershëm kryhen nga institucione dhe struktura të caktuara, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohen me akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore. Në kuadër të mbrojtjes civile, këto institucione dhe struktura bashkëpunojnë me institucionet dhe strukturat e sistemit të mbrojtjes civile dhe për këtë qëllim kryejnë këto detyra:

- a) identifikojnë, mbledhin, përpunojnë, analizojnë dhe komunikojnë të dhëna në lidhje me rreziqet e menjëhershme dhe të pritshme;
- b) identifikon dhe monitoron dukuritë që përbëjnë rrezik, duke njoftuar institucionet dhe strukturat përkatëse;
- c) njoftojnë dhe raportojnë menjëherë Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për dukuritë dhe ngjarjet, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre, të identifikuara ose që mund të shfaqen në një periudhë të shkurtër kohe, të cilat përbëjnë ose mund të kthehen në rrezik për komunitetin.

Në zbatim të ligjit 45 “Për mbrojtjen Civile” është miratuar me VKM nr. 594, datë 13.10.2021 “Për miratimin e kriterëve të identifikimit të subjekteve private, strukturave përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullave për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre”, përcakton se në infrastrukturë përfshihen subjektet private. të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit në rastet kur:

- a) objektet e zotëruara që janë të pozicionuara brenda ose pranë qendrave të banuara, qendrave tregtare, zonave industriale, porteve, aeroporteve, autostradave dhe rrjetit rrugor kombëtar; garantojnë fushën e shikimit, kanë një pozicion që mundëson vëzhgim dhe dëgjim në distancë; garantojnë shikueshmëri, kanë një pozicionim që mundëson kontrastin vizual nga një pikë;
- b) janë operatorë radioteleviziv kombëtar ose lokal, ofrues të shërbimeve të komunikimit tokësor dhe satelitor, si dhe shoqëri telefonike.
- c) si dhe VKM nr. 775, datë 15.12.2021 “Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrin dhe mënyrën e përdorimit të tyre në rast fatkeqësish”.

### **Implementimi:**

- **Projektit Pronës** janë instaluar 24 stacione meteorologjike.

Është trajnuar stafi i Sektorit të Paralajmërimit të Hershëm, Mbështetjes Operacionale dhe Humanitare për përdorimin e programit Dewetra nëpërmjet të cilit bëhet i mundur motorimi dhe parashikimi rreziqeve natyrore.

- Projekti TO BE READY, blerja e mjete pajisje dhe softwear për Early Warning System – EWS.
- Plani Buxhetor Afatmesëm – PBA, parashikon blerjen e një softwear për Early Warning System EWS.

- GIZ dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit – FSHZH, projekt i financuar nga Fondi Global i Klimës – GCF
- Pacific Disaster Center – PDC, planifikim i bashkëpunimit për mundësinë e implementimit të një platforme për EWS.
- Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar – JICA, planifikim i implementimit i EWS për zjarret në pyje.
- Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian UCPM parashikon edhe instalimin e sistemit Trans European Services for Telematics between Administrations TESTA.

## **Ndryshimet Klimatike**

Referuar fushës së Ndryshimeve Klimatike, përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis mbetet ende i kufizuar. Transpozimi mbetet në nivel fillestar me 12% për të gjithë kapitullin. Në korrik 2019, u miratua Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike për periudhën 2019 – 2030, me objektiva afatgjata. Strategjia fokusohet tek energjia, transporti, bujqësia, përdorimin e tokës dhe pyjeve dhe përmban planin si pjesë të integruar të saj 2 plane veprime, konkretisht Planin për Mitigimin dhe Adaptimin nga Ndryshimeve Klimatike.

Në tetor 2021, Këshilli i Ministrave miratoi me VKM Nr. 581 datë 06.10.2021 Kontributin Kombëtar të Përcaktuar 2021 – 2030 nëpërmjet të cilit parashikohen masat për uljen e emetimeve të Gazeve me Efekt Serrë me 20.9%. Shqipëria gjithashtu ka treguar angazhim të vazhdueshëm edhe për të rritur rezervuarët e GES përmes politikave ambicioze të mbjelljes së pyjeve.

Në dhjetor 2020 Shqipëria miratoi Ligjin 155/2020 “për ndryshimet klimatike” i cili krijon bazën ligjore për fushën e ndryshimeve klimatike dhe përafron pjesërisht legjislacionin Evropian.

Sa i përket raportimit të saj në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Shqipëria ka dorëzuar në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike Raportin Bienal të Përditësuar në tetor 2021 dhe është duke përgatitur Komunikimin e Katërt Kombëtar i cili pritet të përfundojë deri në vitin 2022.

Si një Palë jo e Aneksit I të UNFCCC (që nga viti 1995), deri më tani Shqipëria ka përgatitur katër Komunikime Kombëtare dhe Raportin e Parë Dyvjeçar të Përditësuar përkatësisht në 2002, 2009, 2016, 2021 dhe Komunikimin e Katërt Kombëtar, i cili u dërgua në sekretariatit e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në nëntor të vitit 2022.

Qeveria shqiptare ka shprehur një vullnet dhe angazhim të qartë politik për të përmbushur kërkesat dhe detyrimet e ngulitura në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe protokollat dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa shumë të rëndësishëm drejt dokumenteve të politikave dhe planeve të veprimit për ndryshimet klimatike, duke përfshirë veçanërisht sektorët e energjisë dhe transportit, por edhe bujqësinë, pyjet, menaxhimin e mbetjeve.

Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 3.07.2019 “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planeve kombëtare për zbutjen e gazrave serë dhe për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike”, duke përfaqësuar një strategji të përgjithshme ndërsektoriale me objektiva politikë dhe veprime konkrete lidhur me;

- uljen e emetimeve të GES;
- fleksibilitetin ndaj ndryshimeve klimatike.

Me miratimin e këtij akti ligjor, Qeveria e Shqipërisë u bë vendi i parë në Ballkanin Perëndimor me një Strategji të miratuar lidhur me Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike.

Nga ana tjetër, miratimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018 – 2030 (korrik 2018) si dokumenti kryesor i politikës së energjisë që përfshin ndryshimet klimatike bazohet në dy shtylla kryesore: (i) zhvillimi i reformave për të nxitur liberalizimin e tregut dhe integrimin rajonal, dhe (ii) investime të mëdha në zhvillimin e qëndrueshëm të nxitur nga pjesëmarrja në iniciativën e Komunitetit të Energjisë dhe në veçanti në nivelin ndërkombëtar nga marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike.

Strategjia dhe Ligji 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” parashikojnë përgatitjen e Planit Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës, si një angazhim i Republikës së Shqipërisë në Takimin Ministror të Komunitetit të Energjisë në përputhje me agjendën e BE-së e vitit 2030.

Nëpërmjet VKM është miratuar Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës” nëpërmjet së cilit synohet që deri në vitin 2030:

- Reduktimi i shkarkimeve të GES-ve (Reduktimi në raport me ËEM) me 18,7%;
- Efiçenca e energjisë (Reduktimi i Konsumit Final të Energjisë në raport me ËEM) me - 8.4%;
- Rritjen e pjesës që zë energjia e rinovueshme në kërkesën finale për energji në nivelin 54.4%.

Shqipëria ka filluar punën e nevojshme përgatitore për politikat, aspektet analitike dhe teknike të planeve.

Parlamenti shqiptar miratoi Ligjin Nr. 116/2020 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Dohas të Protokollit të Kiotos të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike. Shqipëria renditet së bashku me vendet që kanë ratifikuar amendamentin e Doha që përcakton periudhën e dytë të angazhimit të Protokollit të Kiotos 2013 – 2020, ka marrë numrin e duhur të ratifikimeve për të hyrë në fuqi. Amendamenti synon zvogëlimin e emetimeve të gazeve serrë (GHG) me 18% krahasuar me nivelet e vitit 1990 për vendet pjesëmarrëse.



Shqipëria ka ratifikuar Amendamentin e Kigalit të Protokollit të Montrealit dhe synon të zvogëlojë përdorimin e hidrofluorokarbureve (HFCs), gazeve të fuqishme serre të përdorura kryesisht në ftohje, kondicionim të ajrit dhe pajisjet e pompave të nxehtësisë, të cilat janë mijëra herë më të dëmshme për klimën sesa CO<sub>2</sub>. Amendamenti i Kigalit-t, i cili hyri në fuqi në janar 2019, ndryshon Protokollin e Montrealit për Substancat që hollojnë Shtresën e Ozonit për të përfshirë substanca – përfshirë hidrofluorokarburet (HFC) - të cilat nuk dëmtojnë shtresën e ozonit, por dihet se kanë potencial të lartë të ngrohjes globale. Ratifikimi i Kigalit nga Republika e Shqipërisë tregon se vendi është i angazhuar në mënyrë proaktive për të adresuar problemet në të ardhmen duke parandaluar një rritje të përdorimit të HFC dhe duke promovuar përdorimin e alternativave miqësore me klimën.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Amendamenti i Kigalit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është ka hartuar projektligjin “Për gazet serrë të fluoruara” i cili parashikohet të miratohet në dhjetor 2022 nga parlamenti.

Ndryshe nga NDC-ja 2015 – 2030, e cila parashikonte masa lidhur me vetëm dy sektorë, atë të energjisë dhe industrisë, NDC-ja 2020 – 2030 e ka rritur numrin e sektorëve në 5. Konkreisht:

- Sektori i energjisë dhe transportit;
- Sektori i pyjeve dhe përdorimit të tokës;
- Sektori i bujqësisë;
- Sektori i industrisë, si dhe
- Sektori i mbetjeve.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit gjatë vitit 2022 ka përgatitur draft projektvendimin “ Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar”.

Në përputhje me statusin dhe mundësitë reale të RSH si shtet akoma jo-anëtar në BE dhe Palë jo-aneks 1 në këtë Konventë, Projektvendimi përafron pjesërisht:

- Rregulloren (BE) 2018/1999, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, “Mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimin për Klimën”, që amendon Rregulloret (KE) Nr. 663/2009 dhe (KE) Nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat 94/22/KE, 98/70/KE, 2009/31/KE, 2009/73/KE, 2010/31/BE, 2012/27/BE dhe 2013/30/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Direktivat e Këshillit 2009/119/KE dhe (BE) 2015 /652 dhe shfuqizon Rregulloren (BE) Nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Gjatë hartimit të PVKM është mbajtur në konsideratë teksti I Rregullores Zbatuese (BE) 2020/1208 e datës 7 gusht 2020 mbi strukturën, formatin, procesin e dorëzimit dhe shqyrtimit të informacionit të raportuar nga Shtetet Anëtare në zbatim të Rregullores (BE) 2018/1999 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe që shfuqizon Rregulloren (BE) Nr. 749/2014. Kjo Rregullore është miratuar nga Komuniteti i Energjisë pasi vendet e Ballkanit nuk mund të

përafrojnë plotësisht Rregulloren 2018/1999 të BE, “Mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimin për Klimën”.

Përmes këtij projektvendimi synohet të krijohet një mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e Gazeve me Efekt Serrë (GES) dhe të informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar në mënyrë të qëndrueshme dhe në vazhdimësi, bazuar në rrethanat, aftësitë dhe kapacitetet reale të vendit. Qëllimi i këtij projektvendimi është ngritja e Sistemit Kombëtar të Inventarit dhe Projeksioneve për Gazet me Efekt Serrë (GES).

Projektvendimi përcakton detyrimet e institucioneve përgjegjëse për grumbullimin, përpunimin, monitorimin, raportimin, verifikimin dhe arkivimin e të dhënave të kërkuara, siguron përfshirjen efektive dhe të qëndrueshme të të gjithë aktorëve për përgatitjen e informacioneve dhe koordinimin mes tyre. Si pasojë e zbatimit të këtij projektvendimi synohet dhe pritët që raportimet e RSh në Sekretariatit e Konventës, Marrëveshjes së Parisit dhe Komunitetit të Energjisë të përgatiten në kohë, të jenë transparente, të sakta, të krahasueshme dhe të plota.

#### 27.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”, institucioni lider për Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ministrinë e linjës dhe agjencitë e pavarura, pjesë e këtij kapitulli janë si më poshtë:

- Zyra Kryenegociatorit dhe KM; (ZK, KM)
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
- Agjencia Kombëtare Mjedisit (AKM);
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP)
- Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT);
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU);
- Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM);
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC);
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG);
- Ministria e Brendshme;
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT);
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);

- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh);
- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT);
- Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT;
- Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH);
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM);
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV)

## 27.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

### Legjislacioni horizontal

Në lidhje me **çështjet horizontale**, siç theksohet në Progres Raportin e vitit 2022, Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të arritur një harmonizim dhe zbatim të plotë në shumicën e fushave, veçanërisht sa i përket zbatimit të Direktivave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në sektorët e energjisë dhe minierave.

Për sa i përket mjedisit, në fushën e *legjislacionit horizontal*, disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me forcimin e mëtejshëm për zbatimin e legjislacionit mjedisor.

Nevojitet një pjesëmarrje më efektive e publikut për konsultime në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht në nivelin lokal. Progres i mëtejshëm është i nevojshëm për të arritur plotësisht përafrimin dhe zbatimin e direktivave për përgjegjësinë mjedisore, krimin mjedisor dhe inspektimin mjedisor.

Rol të rëndësishëm duhet të luajë edhe pjesëmarrja e publikut sidomos në procedurat përkatëse, veçanërisht në sektorët e hidrocentraleve, ndërtimeve dhe minierave.

Nevojitet sigurimi i një buxheti të përshtatshëm, forcimi i kapaciteteve të monitorimit dhe raportimit të agjencisë së mjedisit.

### Cilësia e ajrit

Prioritet në fushën e cilësisë së ajrit për vitin 2022 vazhdon të mbetet forcimi i bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse me qëllim zbatimin e planit kombëtar të cilësisë së ajrit si dhe:

- përmirësimi i rrjetit të monitorimit;
- sigurimi i burimeve për funksionimin e monitorimit të vazhdueshëm;
- rritja e kapaciteteve teknike në MTM dhe AKM lidhur me detyrimet që rrjedhin nga Konventa për Ndotjen e Ajrit në kontekst të largët Ndërkufitar (CLRTAP);
- zbatimin e VKM 162/2020;

- sigurimi i aksesit të publikut në internet në të dhënat e cilësisë së ajrit dhe;
- sigurimi i përgatitjes së planeve të cilësisë së ajrit për aglomeratet kryesore.

## **Menaxhimi i Mbetjeve**

Mbyllja e venddepozitimeve të shumta jashtë standarteve, mbetet një sfidë. Ndarja në burim e rrymave të mbetjeve dhe instrumenteve ekonomike për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara. Një tjetër prioritet është dhe reduktimi deri në zhdukje e plastikës njëpërdorimshme. Ka përfunduar procedura e miratimit për ndalimin e prodhimit dhe përdorimit të qeseve plastike me trashësi nën 70 mikron nëpërmjet rishikimit të ligjit Nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Në kuadër të përmbushjes së kërkesave për përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit, janë identifikuar mungesa nga kuadri ligjor kombëtar për të rregulluar sistemin e menaxhimit të mbetjeve lidhur me Përgjegjësitë e Zgjeruara të Prodhuesit.

Gjithashtu janë identifikuar mungesë fondesh për të ngritur sistemin e plotë të menaxhimit të mbetjeve (kosha, makina teknologjike, landfill-et sanitare) në të gjithë zonat e mbetjeve.

Nëpërmjet projektit IPA III-ekonomia qarkulluese dhe rritja e gjelbër, e cila do të fillojë gjatë vitit 2023, parashikohen të realizohen disa aktivitete si vijon:

- Përgatitja e disa akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e mbetjeve;
- Përgatitja e udhërrëfyesit për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër;
- Përgatitja e programeve të parandalimit të mbetjeve;
- Forcimi kapacitetesh në nivel vendor e qendror;
- Ngritja e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve në zonën e mbetjeve Gjirokastrë dhe Kukës.

## **Cilësia e ujit**

Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura plotësojnë vetëm rreth 15% të popullsisë, duke sjellë shqetësime kryesore si mungesën e licencimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të ndotura, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme dhe ndikimit mjedisor të kufizuar për shkak të rrjeteve dhe lidhjeve në zhvillim e sipër.

Ka një nevojë urgjente për të siguruar harmonizimin e plotë me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane, shtrirjen e rrjeteve të kanalizimeve, licencimin dhe aplikimin e tarifave për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndërtimin e atyre të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare dhe ato të vizituara nga turistët.

Rrjeti i monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ujit dhe sistemi i licensimit duhet të përmirësohen më tej dhe të harmonizohen me kërkesat e *acquis*. Rrjeti i monitorimit të ujit shtrihet në lumenj, liqene, zona bregdetare dhe laguna. Nën-sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka nevojë

për përmirësime. Megjithatë, nevojiten përpjekje më të mëdha për të forcuar kapacitetet, performancën dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve komunale. Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale, është qasja e re e qeverisë shqiptare për ristrukturimin e thellë të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Për të konsoliduar progresin, nevojitet miratimi i projektligjit për furnizimin me ujë dhe kanalizimet brenda vitit 2023, si dhe Strategjisë Kombëtare 2022 – 2030 brenda dhjetor 2022, si dhe rregullorja e re e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime.

## **Mbrojtja e natyrës**

Ne fushën e mbrojtjes së natyrës pritet ecuria në lidhje me:

Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acquis), përsa i takon Direktivave të Shpendëve dhe të Habitave, si dhe zbatimi i kuadrit ligjor të përafruar.

Përditësimi dhe rishikimi i dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit deri në 2030. Kryerja e inventarëve të habitave dhe specieve si një mundësi për formulimin më të saktë të politikave në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës, dhe specifikisht të zonave të mbrojtura, AKZM do të punojë për të garantuar:

- Forcimin e zbatimit të legjislacionit të zonave të mbrojtura dhe konkretisht, një nga prioritetet e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), për vitin 2022 – 2023, do të jetë rishikimi i Ligjit 81/2017 “ Për Zonat e mbrojtura”.
- Identifikimin, studimin dhe plotësimin e formave standarde të propozimit për çdo zonë potenciale Natura 2000, brenda rrjetit të zonave të mbrojtura;
- Menaxhimin e integruar të zonave të mbrojtura;
- Forcimi i kapaciteteve të njësive menaxhuese të zonave të mbrojtura, në nivel qendror dhe lokal.

Në kuadër të detyrimit për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë Evropian “*acquis*”, gjatë proceseve të hartimit të PKIE, është identifikuar së legjislacioni kombëtar për fushën e mbrojtjes së faunës se egër mbetet i paplotë. Kjo nënkupton që mungon referenca ligjore për të bërë përafrimin e Rregullores 1007/2009 mbi produktet e Fokës, dhe direktiva e 1999/22/Zoo e cila është përafruar 50%.

Në fushën e *pyjeve*, sfidë dhe prioritet i MTM-së mbeten:

- Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushë, si dhe hartimi i akteve nënligjore që dalin nga Ligji 57/2020, datë 30.4.2020, për Pyjet;
- Bashkërendimi dhe unifikimi i praktikave me të mira në fushën e pyjeve me njesitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe;
- Pyllëzimin e sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor.

## **Ndotja industriale dhe menaxhimi i rrezikut**

Përsa i përket fushës së ndotjes industriale një nga prioritetet kryesore është përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me Direktivën 2010/75/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), si dhe me Direktivën 2012/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 korrik 2012 “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme”, ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/82/EC.

## **Kimikatet**

Në fushën e *kimikateve*, prioritetet e MTM-së për vitin 2023 e në vijim, kanë të bëjnë me:

- Suportin për zbatimin e projektit “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve” financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), dhe planin vjetor të punës së projektit;
- Mbështetjen teknike të Zyrës së Kimikateve, me qëllim mirëfunksionimin e saj dhe sigurimin e zbatimit të legjislacionit të kimikateve;
- Bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim përmbushjen e detyrimeve nga legjislacioni në fuqi në fushën e kimikateve dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë.

## **Mbrojtja nga Zhurmat**

Përsa i përket *politikave për zhurmën në mjedis*, mbetet ende sfidë rishikimit i Ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar, si dhe forcimi i kapaciteteve administrative dhe inspektuese, si dhe përgatitja e hartave të zhurmës dhe planeve të veprimit nga ana e Njësive të vetëqeverisjes vendore.

## **Mbrojtja Civile**

Tërmetet dhe përmytjet mbeten një rrezik i madh për vendin. Shqipëria ka bërë pak progres në përafrimin me Direktivën e Përmytjeve dhe akoma duhet të rregullojë shërbimet e paralajmërimit të hershëm dhe hidrometrik-meteorologjik.

Forcimi i kapaciteteve administrative, infrastrukurore dhe sistemeve për paralajmërimin e hershëm, parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin nevojiten të përforcohen.

## **Ndryshimet klimatike**

Ratifikimi i Amandamentit të Kigalit, të Protokollit të Montrealit, i hap rrugën Shqipërisë për të vendosur bazën e saj për HFC-të, për të ngrirë sasinë e saj të konsumit dhe për të vendosur një plan për heqjen nga përdorimi të HFC-ve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit po harton projektligjin “Për Gazet e Fluorinuara” që do të përafrojë pjesërisht Rregulloren (BE) Nr. 517/2014 të

Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 Prillit 2014 mbi gazet me efekt serrë dhe shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 842/2006.

Përgatitja e Planeve Kombëtare për Klimën dhe Energjinë (NECP-ve) do t'i mundësojë vendit të planifikojë në një mënyrë të integruar, objektivat që ka në fushën e klimës me objektivat energjetikë, synimet, politikat dhe masat dhe përafrimin e politikave energjetike shqiptare me ato të BE-së. NECP, pas finalizimit do të zvogëlojnë barrën administrative, do të sigurojnë koherencë më të madhe dhe do të sigurojnë parashikueshmëri afatgjatë për investime.

Puna përgatitore për aspektet analitike dhe teknike të planeve tashmë ka filluar dhe NECP pritet të miratohet brenda vitit 2022. Një çështje tepër serioze dhe shqetësuese mbetet mungesa e strukturave specifike administrative. Prioritet për fushën e ndryshimeve klimatike mbetet përafrimi i legjislacionit dhe hartimi i akteve nënligjore të parashikuara në legjislacionin vendas.

## GRUPIMI V: BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI

### KAPITULLI 11: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

#### 11.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 11 i bujqësisë përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave dhe kontrolli efektiv nga një administratë publike efikase janë thelbësore për funksionimin e politikës së përbashkët bujqësore (PPB). Politika e PPB-së kërkon ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe cilësisë të tilla si agjencia e pagesave, sistemi i integruar dhe i kontrollit të pagesave (IACS), dhe kapaciteti për të zbatuar masat e zhvillimit rural. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte të fermave dhe për zbatimin e dispozitave për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Anëtarësimi në BE kërkon integrimin në Organizimin e Tregut të Përbashkët për një sërë produktesh bujqësore, përfshirë bimët e arave, sheqerin, produktet me origjinë shtazore dhe bimë të specializuara. Rregullat e CMO-së janë veçanërisht komplekse. CMO mbulon 21 produkte/grup produktesh bujqësore. Kjo rregullore ka një aspekt të brendshëm që mbulon ndërhyrjen në treg dhe rregullat e marketingut dhe organizatave të prodhuesve dhe një aspekt të jashtëm që mbulon tregtinë me vendet e treta.

Ky kapitulli gjithashtu përfshin legjislacionin për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesit gjeografike dhe specialitetet tradicionale për produktet bujqësore dhe ato ushqimore dhe kontrollin e kësaj mbrojtje; rregullat për bujqësinë organike dhe kontrollin e inspektimit; ndihmat shtetërore në bujqësi; dhe krijimi dhe funksionimi i një sistemi për rrjetin e të dhënave të kontabilitetit në fermë, i cili është një mjet shumë i rëndësishëm për formimin e PPB.

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i Politikave të Përbashkëta Bujqësore (CAP) kërkojnë krijimin, modifikimin dhe / ose përforcimin e strukturave të përshtatshme administrative. Në disa raste, *acquis* paraqet specifikime të hollësishme për strukturat e kërkuara administrative. Në shumë raste, *acquis* thjesht përdor terma të tilla si “autoriteti kompetent” për t’iu referuar strukturës administrative që është e nevojshme. Kjo do të thotë se i mbetet çdo Shteti Anëtar të vendosë se cili institucion është përgjegjës për zbatimin efektiv të *acquis*. Megjithatë, funksionet që Shtetet Anëtare të BE-së duhet të kryejnë përmes strukturave administrative që ato krijojnë janë të përcaktuara qartë në *acquis*.



## 11.2 Struktura e kapitullit

- Çështjet Horizontale
- Organizimi i tregut të përbashkët
- Zhvillimi rural
- Prodhimi organik
- Politikat e cilësisë

## 11.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agroindustrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Neni 96 përcakton se fokusi duhet të jetë në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e bujqësisë.

Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit bujqësor dhe sektorit agroindustrial shqiptar dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Komunitetit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e bujqësisë janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funkionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

*Acquis* e bujqësisë dhe zhvillimit rural përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave dhe kontrolli efektiv nga një administratë publike efikase janë thelbësore për funksionimin e politikës së përbashkët bujqësore. Kjo kërkon ngritjen e agjencisë së pagesave dhe sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të pagesave, të tilla si Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit, dhe kapaciteti për të zbatuar programet e zhvillimit rural. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte të fermave dhe për zbatimin e dispozitave për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i Politikave të Përbashkëta Bujqësore (PPB) kërkon krijimin, modifikimin dhe / ose përforcimin e strukturave të përshtatshme administrative. Në disa raste, *acquis* paraqet specifikime të hollësishme për strukturat e kërkuara administrative. Në shumë raste, *acquis* thjesht përdor terma të tilla si “autoriteti kompetent” për t’iu referuar strukturës administrative që është e nevojshme. Kjo do të thotë se i mbetet çdo Shteti Anëtar të vendosë se

cili institucion është përgjegjës për zbatimin efektiv të *acquis*. Megjithatë, funksionet që Shtetet Anëtare të BE-së duhet të kryejnë përmes strukturave administrative që ato krijojnë janë të përcaktuara qartë në *acquis*.

Duke ndjekur reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore pjesët kryesore të *acquis* të BE-së janë:

- Rregullorja (BE) Nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 në mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EAFRD) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1698/2005;
- Rregullorja (BE) Nr. 1306/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 dhjetor 2013 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore;
- Rregullorja (BE) Nr. 1307/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetor 2013 në vendosjen e rregullave për pagesat direkte për fermerët nën skemat e mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 637/2008 dhe Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 73/2009 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 352/78, (KE) Nr. 165/94, (KE) Nr. 2799/98, (KE) Nr. 814/2000, (KE) Nr. 1290/2005 dhe (KE) Nr. 485/2008;
- Rregullorja (BE) Nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 dhjetor 2013 në krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 922/72, (KEE) Nr. 234/79, (KE) Nr. 1037/2001 dhe (KE) Nr. 1234/2007;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 834/2007 mbi prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 889/2008 e 5 shtatorit 2008 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 834/2007 mbi prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin;
- Rregullorja (BE) Nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë dhe artikujt ushqimorë për produkteve bujqësore.

#### 11.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitjeje në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ka pasur disa përparime në miratimin dhe zbatimin e kuadrit të ri ligjor në fushën e politikave të cilësisë, duke siguruar kapacitet administrative për zbatimin e programit të instrumentit të asistencës së para-zgjerimit për zhvillimin rural (IPARD II).

Në kuadër të zbatimit të Programit IPARD II (2014 – 2020), janë realizuar 4 thirrje për aplikime. Nën katër thirrjet për aplikime janë dorëzuar në total 1 189 aplikime me kërkesë totale për grant në vlerën prej rreth 245 milion euro.

#### **Thirrja e parë për aplikime**

Në total për këtë thirrje janë dorëzuar 317 aplikime ku numri total i projekteve të kontraktuara është 126 (aktive) projekte me vlerë granti prej rreth 22.6 milion euro dhe janë 124 investime të përfunduara. Procesi i kontraktimit për këtë thirrje ka përfunduar.

### **Thirrja e dytë për aplikime**

Në total për këtë thirrje janë dorëzuar 371 aplikime dhe janë kontraktuar 179 (kontrata aktive) projekte me vlerë granti prej rreth 29.8 milion euro dhe janë 151 investime të përfunduara.

### **Thirrja e tretë për aplikime**

Për këtë thirrje janë dorëzuar në total 369 aplikime, ku numri total i projekteve të kontraktuara është 161 projekte me vlerë granti 28.9 milion euro. 54 investime janë të përfunduara.

### **Thirrja e katërt për aplikime**

Është hapur vetëm për masën 7 dhe ka pasur gjithsej 132 aplikime. Janë nënshkruar gjithsej 14 kontrata me vlerë granti të kontraktuar 2.6 milion euro. Është akoma në proces kontraktimi i aplikimeve.

Shuma e parave të disbursuara duke përfshirë pagesat paradhënie (10% - 50%) dhe investime të përfunduara plotësisht për të 4 thirrjet, deri në fund të tetorit 2022 është: 50.5 milion euro Grant, nga të cilat 37.8 milion euro Kontributi i BE-së, dhe 12.6 milion euro Kontributi Kombëtar.

Të gjithë thirrjet për aplikim nën këtë program, janë të hapura për të gjithë personat (persona fizik dhe juridikë), puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Për të katër thirrjet për aplikime vihet re se ka pasur një tejkalim të pritshmërisë për të përfutur nga fondet grant. Në sajë të mbështetjes së granteve nga Programi IPARD II, janë rritur së tepërmi kapacitetet e ambienteve të grumbullimit dhe dhomave frigoriferike; linjat e përpunimit të fruta perime; mekanika bujqësore; investimet në serra; njësitë agroturistike; rrjeta antibreshër; thertore; investime përpunim mishi; akuakulturë dhe agro-turizmit etj.

Pas marrjes së besimit për masën e Asistencës Teknike, në korrik 2020, ka filluar zbatimi i aktiviteteve të planifikuara sipas Planeve Vjetore të kësaj mase. Në zbatim të masës së Asistencës Teknike janë realizuar procedurat e mëposhtme:

- Vlerësimi ex-ante për Programin IPARD III;
- Trajnim i Agjencisë IPARD;
- Fushatë informuese për procesin e ankimimit mbi vendimet e Agjencisë IPARD për thirrjet e Programit IPARD II;
- Fushatë informuese mbi thirrjen e katërt për aplikime për Programin IPARD II;

- Organizimi i Takimit të 8-të Komitetit të Monitorimit; si dhe
- Organizimi i Takimit të 9-të Komitetit të Monitorimit.

Të dy strukturat operative (Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD), në të tre thirrjet për aplikime, përgatitën dokumentacionin e nevojshëm që u prezantua në fushatat informuese dhe u botuan në faqet e internetit të MBZHR dhe Agjencisë IPARD, siç janë: udhëzimet për aplikantët me të gjitha anekset, plani i veprimit që detajon datat e fushatës informative, objektivi i pjesëmarrjes, përfshirja e specialistëve të zgjerimit në fushatën informative dhe përgjegjësitë e tjera që duhet të kryhen gjatë zbatimit të thirrjeve për aplikim, etj.

Fushatat informuese u implementua nga Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia e Pagesave duke përdorur të gjitha mediat kombëtare dhe lokale. Spote informuese u transmetuan në stacione televizive duke siguruar informacione të përgjithshme në lidhje me masat IPARD II, për ndërgjegjësimin dhe përfituesit e mundshëm.

### **Programi IPARD III (2021 – 2027)**

Programi IPARD III (2021 – 2027) për Shqipërinë u miratua nga Komisioni Evropian me vendimin numër C(2022) 1539, datë 9 Mars 2022 “Për miratimin e programit IPA III të Zhvillimit Rural (IPARD III) të Republikës së Shqipërisë për vitet 2021 – 2027”.

Buxheti i alokuar për zbatimin e Programit IPARD III është rreth 146 milion Euro (112 milion Euro kontributi i BE-së dhe 34 milion Euro kontributi i Qeverisë Shqiptare).

Programi IPARD III do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për investimet fizike që duhet të kryhen në mënyrë që të përputhen me standardet e BE-së (mjedisi, mirëqenia e kafshëve), të përmirësojë performancën ekonomike dhe mjedisore të ekonomive bujqësore, të sigurojë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e bujqësisë dhe investimet e nevojshme për arritjen e synimeve mjedisore, forcimin e pozicionit të fermerëve në zinxhirin ushqimor dhe nxitjen e rigjenerimit të fuqisë punëtore në sektorin e bujqësisë. Investimet në asetet fizike janë të nevojshme për të përmirësuar produktivitetin e përgjithshëm, qëndrueshmërinë ekonomike dhe arritjen e standardeve kombëtare dhe të Bashkimit Evropian në ekonomitë bujqësore.

Buxheti alokuar për Programin IPARD III 146 milion euro – 57% më shumë se Programi IPARD II.

Në këtë program janë propozuar 9 masa nga 4 masa në Programin IPARD II. Konkretisht, masat në Programin IPARD III janë:

- |        |   |
|--------|---|
| Masa 1 | Investime në aktive fizike në ferma bujqësore   |
| Masa 3 | Investime në aktive fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit |
| Masa 4 | Masa agro-mjedisore-klimatike dhe bujqësia organike   |

Masa 5	Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – Qasja LEADER
Masa 6	Investime në infrastrukturën publike rurale
Masa 7	Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit
Masa 9	Asistenca Teknike
Masa 10	Shërbimet këshillimore
Masa 11	Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve

*Masat e mbështetura nën Mbështetjen Kombëtare për vitin 2022:*

Mbështetje për fara/fidanë dhe inpute të tjera:	813 aplikime	
Mbështetje ndërtim serra diellore	6 aplikime	
Mbjellje bime mjekësore aromatike	908 aplikime	
Ferme organike	246 aplikime	
Certifikimi global GAP	56 aplikime	
Mbështetje për tufën baze të matrikular	7,015 aplikime	
Mbështetje për mbarështim bletarie	2,933 aplikime	
Mbështetje për kultivimin e grurit	7,470 aplikime	
Mbështetje me 40 (dyzet) lekë për litër karburant për anije peshkimi		190 aplikime
Rinovim infras. anijes peshkimi	54 aplikime	
Mbështetje për automatizimin dhe digjitalizimin e proceseve të punës në fermë		5 aplikime
Mbështetje për ndërtimin e tregjeve	9 aplikime	
Mbështetje e një skeme trajnimit në bujqësi dhe ngritjen e qendrës së ekselencës të UBT transf. 1 aplikim.		
Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve	49,654 aplikime	
Në total për vitin 2022 kishim	69,358 aplikime.	

Buxheti i Mbështetjes Kombëtare në total është 4,904,600,006 lekë ose 40.8 milion Euro, i cili mbulon 45,000 aplikime nga 69,358 në total. Deri më tani realizimi i buxhetit për Skemat Kombëtare është 78% e buxhetit të përgjithshëm. Shuma e disbursuar në total: 32 milion Euro.

Në fushën e organizimit të tregut të përbashkët është miratuar legjislacioni zbatues për Ligjin e ri për vajin e ullirit. Janë miratuar dy akte ligjore në sektorin e vajit të ullirit i cili pjesërisht harmonizon legjislacionin kombëtar përkatës me *acquis*:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 235, datë 21.3.2017 “Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”. Në këtë vendim përcaktohen dhe përditësohen karakteristikat e cilësisë, natyrshmërisë dhe sigurisë për vajin e ullirit dhe vajin e bërsive të ullirit, duke siguruar një produkt cilësor tek konsumatori i fundit dhe sigurimin e një konkurrence të ndershme në treg. Për çdo karakteristikë dhe kriter janë përcaktuar limitet përkatëse, në përputhje me Rregulloren e Komisionit Evropian (EEC) Nr. 2568/91 e datës 11 korrik 1991 “Mbi karakteristikat e vajit të ullirit dhe vajit të mbetjes së ullirit dhe mbi metodat përkatëse të kryerjes së analizave”, si dhe Standardet e COI të vitit 2015 të zbatuara për tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit;

- Urdhër nr. 512 datë 12.10.2016 “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të përhershëm të degustimit të vajit të ullirit të virgjër”. Ky urdhër përcakton përbërjen e komisionit, numrin e anëtarëve, institucionet dhe grupet të cilëve duhet t’i përkasin, detyrat e kryetarit dhe anëtarëve, si dhe përmes shtojcës që i bashkëlidhet urdhrin, përcakton, metodat e vlerësimit organo-shqisor, fjalorin, infrastrukturën e dhomës së degustimit, elementët, mbikëqyrjen e degustuesve, fletët e vlerësimit.

Gjithashtu, është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datë 24 dhjetor 2020 projektligji, “Për vreshtarinë dhe verën”, dhe është miratuar në Kuvend me Ligjin 86/2022 “Për vreshtarinë dhe verën”.

Për bujqësinë organike, është arritur progres në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për prodhimin organik me *acquis* të BE –së, ku është miratuar ligji 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” dhe pothuajse është plotësuar me akte nënligjore.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka filluar procesin për përditësimin e legjislacionit ekzistues me legjislacionin e ri të BE-së, përkatësisht rregulloren kuadër 848/2018/KE “Për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve biologjike”, dhe rregullore të tjera implementuese dhe deleguese.

Grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Ministrit nr. 200, datë 4.5.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e legjislacionit për prodhimin organik”, ka hartuar draftin e parë të ligjit të ri për prodhimin biologjik, me mbështetjen e projektit BIOREGOAL, financuar nga CEI, dhe zbatuar nga CIHEAM Bari. Ligji i ri për prodhimin biologjik, është planifikuar të miratohet në tremujorin e IV të vitit 2024.

Komisioni për Prodhimin Biologjik (KPB) është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e trupave të kontrollit për certifikimin e produkteve organike. Mbikëqyrja e trupave të kontrollit, për llogari të KPB, kryhet nga Sektori për Prodhimin dhe Standardet e Tregtimit që është përgjegjës për hartimin e legjislacionit, regjistrimin e operatorëve organikë dhe mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit statistikor për prodhimin organik.

Gjatë viteve të fundit ka vazhduar dhe është rritur mbështetja financiare për bujqësinë organike nëpërmjet skemave direkte, ku përfshihen fermat biologjike dhe ato në kalim drejt bujqësisë biologjike.

Përsa i përket politikave të cilësisë, gjatë vitit 2019 është miratuar ligji nr. 8/2019 datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Ky ligj krijon skemat e cilësisë dhe përcakton institucionet përgjegjëse për njohjen dhe mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara për produktet bujqësore dhe ato ushqimore. Në zbatim të këtij ligji janë parashikuar akte nënligjore, të cilat janë miratuar, po ashtu ka filluar zbatimi i tyre.

### 11.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për kapitullin 11 është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që është edhe institucioni koordinues i grupit ndërinstitucional të punës.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 11 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator (MSHK)
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)
- Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve (AKDC)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë dhe Informacionit (AKSHI);
- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI);
- Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)

### 11.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Në lidhje me zbatimin e Programeve IPARD, strukturat operative (Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD) janë të ngritura dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat e parashtruara në rregulloret e BE-së. Me gjithë arritjet e deritanishme kërkohet forcim i vazhdueshëm i kapaciteteve të autoriteteve IPARD për të zbatimin e masave të reja në kuadër të Programeve IPARD.

Në fushën e bujqësisë organike, në zbatim të Ligjit Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, është plotësuar kuadri ligjor në lidhje me aktet nënligjore:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 336, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin, kalimin, rregullat përjashtuese të prodhimit dhe kontrollin e prodhimit biologjik bimor dhe të algave të detit”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 830, datë 18.12. 2019 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për grumbullimin, ambalazhimin, transportin, ruajtjen, etiketimin, njoftimin e aktivitetit dhe kontrollin e produkteve biologjike”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 859, datë 24.12.2019 “Për përbërjen, funksionimin, organizimin dhe detyrat e komisionit për prodhimin biologjik”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1030, datë 16.12.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin e ushqimeve biologjike të përpunuara për kafshë, ushqimeve biologjike të përpunuara, majave biologjike dhe rregullat përjashtuese”;
- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 288, datë 8.6.2020 “Për miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në përpunimin e ushqimeve biologjike”;
- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 349, datë 25.7.2022 “Për miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik”, përafruar pjesërisht me Regulloren zbatuese të Komisionit Europian (BE) 2021/1165 të 15 korrikut 2021 që autorizon produktet dhe substancat e caktuara për tu përdorur në prodhimin organik dhe krijimin e listës së tyre.

Për zbatimin e ligjit Nr. 8/2019, datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore” janë miratuar aktet nënligjore:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 677 datë 16.10.2019 “Për miratimin e logos kombëtare për produktet bujqësore dhe ushqimore me emërtimin “Specialitet Tradicional i Garantuar”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 860 datë 24.12.2019 “Për funksionimin, kohëzgjatjen, organizimin dhe detyrat e Komisionit për Skemat e Cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”;
- Udhëzim Nr. 7 datë 21.4.2020 “Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit për produktet bujqësore dhe ushqimore me tregues specialitet tradicional i garantuar”;
- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr. 299, datë 29.7.2020 “Për miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor”;
- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 424 datë 16.10.2020, “Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së certifikatës së cilësisë për përputhshmërinë e produktit bujqësor ose ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 425 datë 16.10.2020, “Për përcaktimin e formatit të aplikimit dhe kundërshtimit të produkteve bujqësore ose ushqimore si Specialitet Tradicional të Garantuar”;
- Vendim i këshillit të Ministrave nr. 231 datë 19.4.2021 “Për përbërjen, funksionimin, organizimin dhe detyrat e Komisionit për miratimin dhe auditimin e trupave certifikuese”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401 datë 6.7.2021 “Për përcaktimin e kriterëve të hollësishme për miratimin dhe kompetencat e trupave certifikuese”;

Në zbatim të ligjit 8/2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr. 305 datë 28.6.2022, është miratuar Komisioni i Skemave të Cilësisë. Nga ana e këtij komisioni janë miratuar 3 (tre), produkte me emërtimin “Specialitet Tradicional i Garantuar” (STG), si dhe është dhënë mendimi pozitiv për vlerësimin një produkti me Emërtim Origjine të Mbrojtur (EOM), të cilët janë regjistruar në regjistrat përkatës online të MBZHR dhe DPPI-së.



Gjithashtu, është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datë 24 dhjetor 2020 projektligji, “Për vreshtarinë dhe verën”, dhe është miratuar në Kuvend me Ligjin 86/2022 “Për vreshtarinë dhe verën”.

Projektligji është miratuar në dy komisionet parlamentare të Ekonomisë dhe Integritimit Evropian, si dhe janë zhvilluar disa seanca dëgjimore me grupet e interesit në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Po ecet paralelisht me draftimin e bazës nënligjore lidhur me 3 urdhra të Ministrit për:

- Kadastrën e vreshtarisë;
- Regjistrin e hyrje –daljeve; si dhe
- Deklarimet e detyrueshme të prodhuesve.

Është miratuar projektligji “Për bletarinë” me VKM-në Nr. 841, date 27.12.2022. Ky draft është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat, Universitetin Bujqësor të Tiranës, ekspertë të fushës.

Përmes projekteve donatore kemi kërkuar asistencë, për hartimin e një plani veprimi lidhur me CMO-në, si dhe masat direkte.

Me gjithë arritjet e deritanishme kërkohet plotësimi i bazës ligjore lidhur me skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, prodhimin organik ligjin për vreshtarinë dhe verën, si dhe masat direkte sipas CMO-së.

### *Kapacitetet e AZHBR*


Një strukturë e re organizative e AZHBR-së u miratua përmes Urdhrit të Kryeministrit Nr. 81 datë 10.05.2022.

Struktura e re e miratuar operative e AZHBR-së është rritur nga 203 në 239 punonjës në total.

Ngritja e kapaciteteve të reja institucionale të miratuara me Urdhrin e Kryeministrit, do të jenë pjesë e funksioneve të fuqizimit të ndryshimeve në kapacitetet e sektorëve IPARD do të jetë krijimi i tre drejtorive të reja si më poshtë:

- Drejtoria e Monitorimit të Riskut dhe Raportimit,
- Drejtoria e Bazave të të Dhënave dhe Kërkimit të Tregut,
- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit,
- Struktura e re e miratuar operative:

Më poshtë struktura e miratuar:



Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria synon këto prioritete:

- Zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), përfshirë përmirësimin e regjistrit të fermave dhe kafshëve;
- Miratimin e planit të zbatimit për regjistrat e Rrjetit të të Dhënave Kontabël të Fermës (FADN), me qëllim sigurimin e të dhënave konsistente, sistematike dhe të certifikuara;
- Zbatimi i Programit IPARD III 2021 – 2027;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e Programeve IPARD;
- Forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për të lehtësuar zbatimin e suksesshëm të programit IPARD;
- Plotësimin e kuadrit ligjor për produktet organike, në linjë me legjislacionin e ri të BE-së, i cili hyn në fuqi në 2022;
- Plotësimin e kuadrit ligjor për emërtimet e mbrojtura të origjinës, treguesit gjeografike dhe specialitetet tradicionale të garantuar;
- Miratimin e ligjit për vreshtat dhe verën si dhe të akteve nënligjore;
- Miratimin e ligjit “Për bletarinë”;
- Garantimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për zbatimin e legjislacionit.

*Çështje të tjera horizontale*

Është miratuar Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 – 2027, me VKM nr. 460 datë 29.6.2022, si dhe plani i masave në zbatim të saj. Ky dokument u hartua me asistencë të projektit GIZ, duke kaluar një proces të gjatë konsultimesh me grupet e interesit.

Është në koherencë me procesin e përafrimit me BE, i orientuar drejt objektivave të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (PPB) dhe Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE-së (PPP), si dhe objektivave të Zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës së OKB 2030.

## KAPITULLI 12: POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

### 12.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 12 mbulon rregullat e hollësishme në fushën e sigurisë ushqimore. Politika e përgjithshme e produkteve ushqimore përcakton rregullat e higjienës për prodhimin e produkteve bujqësore. Më tej, legjislacioni i Bashkimit Evropian përcakton rregullat e hollësishme në fushën e veterinarisë, të cilat janë thelbësore për të ruajtur shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë e produkteve ushqimore me origjinë shtazore në tregun e brendshëm. Në fushën e fitosanitetit, rregullat e Bashkimit Evropian mbulojnë çështje të tilla si cilësia e farërave, materialet e mbrojtjes së bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.

### 12.2 Struktura e kapitullit

- Siguria ushqimore
- Politika veterinare
- Politika fitosanitare
- Farat dhe Fidanët
- Ushqimi për kafshë
- OMGJ-të

### 12.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë ligjin e saj kombëtar me atë të BE-së.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Në nenin 96 përcaktohet se fokusi duhet të jetë në fushat me përparësi që lidhen me acquis e Bashkimit Evropian në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e

sektorit shqiptar bujqësor dhe agro-industrial, dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Acquis për politikat e sigurisë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare pasqyron qasjen e integruar të BE-së në sigurinë ushqimore me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda Bashkimit Evropian nëpërmjet masave koherente nga ferma në tavolinë dhe monitorimit adekuat, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm. Parakushtet kryesore për një vend kandidat në këtë fushë janë transpozimi i legjislacionit të BE-së, si dhe zbatimi i tij nga një administratë e strukturuar mirë dhe e trajnuar.

Acquis në këtë kapitull përmban një numër shumë të madh rregulloresh direktivash dhe vendimesh.

Për zbatimin e legjislacionit të sigurisë ushqimore, shteti anëtar duhet të ketë strukturat administrative të përshtatshme që të jetë në gjendje që të kryejë inspektimin dhe kontrollin e produkteve ushqimore duke përfshirë kapacitetet e duhura laboratorike. Rregullat bazë janë përcaktuar në Rregulloren e përgjithshme për ushqimet për njerëzit dhe kafshët Nr. 178/2002 për parimet dhe kërkesat e përgjithshme të prodhimit ushqimor, përpunimit, paketimit, etiketimit, parketimit dhe shpërndarjes. Në veçanti, ky akt përcakton përkufizimet, parimet dhe detyrimet që mbulojnë të gjitha fazat e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit për njerëz dhe kafshë. Plotësimi i kërkesave të gjurmueshmërisë për të gjithë ushqimin për njerëz dhe kafshë, ashtu edhe për operatorët e biznesit, janë të detyrueshme për zbatim. Legjislacioni për sigurinë ushqimore mbulon paketimin, etiketimin, marketingun, aditivët, tretësit e nxjerrjes, aromatizuesit, materialet e kontaktit ushqimor, shtesat ushqimore, ujërat minerale dhe rrezatimet jonizuese, ndotësit, ushqimet e reja, ushqimet e ngrira të shpejta, cilësinë e farërave dhe materialit shumues, produktet, organizmat e dëmshëm, të drejtat e varieteteve të bimëve, si dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Në fushat e politikave të veterinarisë, Rregullorja Nr.2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve përcakton rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve të cilat janë të transmetueshme të kafshët ose të njerëzit. Këto rregulla parashikojnë prioritizimin dhe kategorizimin e sëmundjeve dhe përcaktimin e përgjegjësive të stabilimenteve për shëndetin e kafshëve, zbulimin e hershëm, njoftimin dhe raportimin e sëmundjeve, mbikëqyrjen, programet e çrënjosjes dhe statusin pa sëmundje, ndërjegjësimin, gatishmërinë dhe kontrollin për sëmundjet, regjistrimin dhe miratimin e stabilimenteve dhe transportuesve, lëvizjet dhe gjurmueshmërinë e kafshëve, produkteve germinale dhe produkteve me origjinë shtazore, hyrjen e kafshëve, produkteve germinale dhe produkteve me origjinë shtazore në Bashkimin Evropian dhe eksportin e dërgesave të tilla nga Bashkimi Evropian, lëvizjet jo-tregtare të kafshëve shtëpiake si dhe masat emergjente që duhen marrë në rast të një situatë emergjente të një sëmundjeje. Këto rregulla synojnë të sigurojnë përmirësimin e shëndetit të kafshëve për të mbështetur prodhimin e qëndrueshëm bujqësor dhe të akuakulturës, funksionimin efektiv të tregut të brendshëm si dhe një reduktim të efekteve negative në shëndetin e kafshëve, shëndetin publik dhe mjedisin të

sëmundjeve të caktuara dhe masave të marra për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve. Legjislacioni i veterinarisë mbulon sistemet e kontrollit në tregun e brendshëm, produktet me origjinë shtazore, certifikimin, sistemin e kontrollit të importeve, pikat e inspektimit kufitar, identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve të të gjitha specieve dhe regjistrimin e lëvizjes së tyre, masat e kontrollit për sëmundjet në kafshë, sëmundjet e kafshëve si dhe tregtinë e kafshëve të gjalla dhe embrioneve.

Rregullorja Nr. 2016/2031 për masat mbrojtëse kundër parazitëve të bimëve vendos rregulla për të përcaktuar rreziqet fitosanitare të paraqitura nga çdo specie, lloj ose biotip i agjentëve patogjenë, kafshët ose parazitët e dëmshëm për bimët ose produktet bimore ('dëmtuesit') dhe masat për reduktimin e rreziqeve të tyre në një nivel të pranueshëm.

Duke ndjekur reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore pjesët kryesore të acquis të BE-së në fushën fitosanitare janë:

- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 2019/2072 e datës 28 nëntor 2019 për krijimin e kushteve uniforme për zbatimin e Rregullores (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve dhe shfuqizimin e Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 690/2008 dhe ndryshimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/2019;
- Direktiva Nr. 2009/127/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, përsa i përket makinerive për aplikimin e pesticideve;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 2017/269 e datës 16 shkurt 2017, në lidhje me statistikat e pesticideve, sa i përket listës së substancave aktive;
- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 540/2011 e datës 25 maj 2011 zbatimi i Rregullores (KE) Nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me listën e substancave aktive të miratuara;
- Direktiva Nr. 2009/128 /KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 21 tetorit 2009 duke krijuar një kornizë për veprimin e Komunitetit për të arritur përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve.

Rregullorja Nr. 2016/625 mbi kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve përcakton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteteve të tjera zyrtare nga autoritetet kompetente, financimin e kontrolleve zyrtare, asistencën administrative dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve në funksion të zbatimit korrekt të rregullave, miratimin e kushteve që duhet të plotësohen në lidhje me kafshët dhe mallrat që hyjnë në Bashkim nga një vend i tretë, krijimin e një sistemi informacioni të kompjuterizuar për të menaxhuar informacionin dhe të dhënat në lidhje me kontrollet zyrtare. Këto rregulla zbatohet për kontrollet zyrtare të kryera për verifikimin e respektimit të rregullave për zbatimin e legjislacionit në fushat e sigurisë, integritetit dhe shëndetit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes, lëshimi i qëllimshëm në mjedis i organizmave të modifikuar gjenetikisht për qëllime të prodhimit të ushqimit dhe ushqimit, sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë në çdo fazë të prodhimit,

përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit dhe përdorimit të ushqimit për kafshë, kërkesat për shëndetin e kafshëve, parandalimin dhe minimizimin e rreziqeve për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve që rrjedhin nga nënproduktet e kafshëve, kërkesat e mirëqenies për kafshët, masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve, kërkesat për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve, prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, përdorimi dhe etiketimi i emërtimeve të mbrojtura të origjinës, treguesve gjeografikë të mbrojtur dhe specialiteteve tradicionale.

#### 12.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka arritur **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. Shqipëria ka bërë **disa përparime**. Shqipëria krijoi Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Shqipëria ka bërë disa përparime mbi rekomandimet e vitit 2021, por ato mbeten të vlefshme duke qenë se kërkohet përparim i mëtejshëm.

Në lidhje me **sigurinë ushqimore në përgjithësi**, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrole të rregullta zyrtare në përputhje me planin vjetor të bazuar në risk.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen kontrole zyrtare në Pikat e Kontrollit Kufitar duke përfshirë produktet me origjinë shtazore, origjinë jo shtazore, kafshë të gjalla, produkte mjekësore veterinare, material mbjellës shumëzues bimor dhe produkte për mbrojtjen e bimëve. TRACES përdoret rregullisht.

**Sa i përket politikave veterinare**, ka patur përparim nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB ) për rekrutimin e veterinerëve. Rritja e numrit të veterinerëve ka rritur ndjeshëm identifikimin e hershëm të sëmundjes dhe të gjitha masat veterinare të marra në shkallë vendi. Gjithashtu, është bërë e mundur kryerja dhe monitorimi efikas për stafin veterinar, veçanërisht për ata të sapo rekrutuar. Qeveria ka miratuar në maj 2022 riorganizimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke krijuar drejtoritë që merren me sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe fitosanitetin bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 88 datë 20.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural) dhe Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 318, datë 4.7.2022 “Për miratimin. të strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

Kanë vazhduar programet për monitorimin e brucelozës, tuberkulozit në tufat e gjedhëve me më shumë se 10 krerë, Plasjes dhe sëmundjes së dermatozës nodulare të gjedhit. Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar fushatat e vaksinimit kundër tërbimit për periudhën 2020 – 2022, duke përfshirë edhe monitorimin post vaksinal. Në shkallë vendi ka vazhduar verifikimi dhe regjistrimi i numrit të kafshëve. Nga tetori 2021 janë kryer kontrole zyrtare, nga Autoriteti Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjen e Bimëve, në tregjet dhe thertoret e kafshëve të gjalla, duke përmirësuar kështu raportimin e sëmundjeve të kafshëve dhe lëvizjes së tyre.

Në lidhje me **vendosjen në treg të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe nënprodukteve të kafshëve**, Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve, përfshirë produktet mjekësore veterinarë, mbetjet e pesticideve, metalet e rënda dhe mikotoksinat në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore është kryer rregullisht, në përputhje me kërkesat dhe metodat analitike të vlefshme.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit merr rregullisht mostra nga stabilimentet që eksportojnë produkte peshku, të cilat analizohen për përmbajtjen kimike dhe mikrobiologjike, përfshirë histaminat.

Kapaciteti për të monitoruar nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimore është rritur. Instituti i Veterinarisë dhe Sigurisë Ushqimore teston një numër të konsiderueshëm të substancave kimike në përputhje me Udhëzuesit e Komisionit mbi procedurat e vlefshmërisë së metodave dhe kontrollin cilësor analitik për analizat e mbetjeve dhe pesticideve në ushqime dhe ushqime për kafshë.

Sa i përket **rregullave të sigurisë ushqimore**, Shqipëria ka vazhduar me ndryshimet në aktet rregullatore kombëtare në lidhje me aditivët ushqimorë të lejuar, që përafron Rregulloren e BE-së Nr. 1333/2008 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, duke krijuar një listë të aditivëve ushqimorë të lejuar për përdorim në produktet ushqimore; Kërkesat për dhënien e informacionit për konsumatorët, për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në ushqim, e cila përafron Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 828/2014 e datës 30 korrik 2014 mbi kërkesat për dhënien e informacionit për konsumatorët për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në ushqim. Për procedurën e marrjes së mostrave dhe metodën e analizës për kontrollin zyrtar të temperaturave të ushqimeve të ngrira shpejt të destinuara për konsum njerëzor, përafrim i Direktivës së Komisionit 92/2/KEE të datës 13 janar 1992 që përcakton procedurën e marrjes së mostrave dhe metodën komunitare të analizës për kontrollin zyrtar të temperaturave të ushqimeve të ngrira shpejt të destinuara për konsum njerëzor, si dhe caktimin e niveleve maksimale për praninë e kokcidiostatëve ose histomonostatëve në ushqime, si rezultat i bartjes së pashmangshme të këtyre substancave në ushqimin ushqimor jo të synuar, përafrim i pjesëshem me Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 124/2009 të datës 10 shkurt 2009 që përcakton nivelet maksimale për praninë e kokcidiostatëve ose histomonostatëve në ushqim që rezulton nga bartja e pashmangshme e këtyre substancave në ushqimin jo të synuar.

Për **politikën fitosanitare**, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vazhduar miratimin e substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve në përputhje me acquis të BE-së. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (NVPPA) ka kryer monitorimin dhe verifikimin e gjendjes fitosanitare për çdo dëmtues të bimëve në vend, duke mbikëqyrur përdorimin e produktet të mbrojtjes së bimëve të rrezikshme që paraqesin rrezik të lartë për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe lëshimin e certifikatave fitosanitare për eksport. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer edhe inspektime për mbrojtjen e bimëve dhe inputet bujqësore.

Janë përmirësuar kërkesat në lidhje me përdorimin e PMB-ve. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 226, datë 13.4.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. përdorimi i produkteve

për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit” dhe Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 275, datë 14.6.2022 “Për miratimin e modelit të regjistrit të përdorimit të PMB-ve në fermë, përmbajtjen dhe plotësimin e tij” janë miratuar. Trajnimi i trajnerëve është bërë me mbështetjen e Projektit të Sigurisë Ushqimore dhe është zhvilluar në rrethet Berat, Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Kukës. 189 trajnerë janë trajnuar nga Autoriteti Kombëtar për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve dhe Shërbimet Rajonale të Ekstensionit të Bujqësisë. Fermerët kanë filluar të mbajnë të dhëna në regjistrë për pesticidet e përdorura.

Është përgatitur drafti i Planit të Veprimit për përdorim të qëndrueshëm të produkteve të mbrojtjes së bimëve me mbështetjen e ekspertëve të FAO-s. Objektivi kryesor i Planit të Veprimit është të parashikojë veprime që ndihmojnë në minimizimin e rreziqeve për shëndetin e njeriut dhe mjedisin që rrjedhin nga përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve duke vendosur objektiva, veprime, masa dhe tregues. Më tej, Plani zhvillohet në kuadër të përafrimit të ligjit të Shqipërisë me legjisllacionin e BE-së.

Në vazhdim të Planit vjetor “Për miratimin e planit kombëtar të kontrolleve zyrtare të bazuara në rrezik dhe kampionimit për ushqimin, ushqimin e kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe inputet bujqësore, si dhe plani i kampionimit në PIK për vitin 2022”, në Planin Kombëtar të Monitorimit të mbetjeve të pesticideve në fruta-perime të miratuar për periudhën tetor 2022 – dhjetor 2023, numri i produkteve me origjinë bimore që do të monitorohen është 19 produkte dhe numri minimal i mostrave që do të analizohen në periudhën e përcaktuar është 1 290 mostra.

Përsa i përket politikave në fushën e veterinarisë, për vitin 2022 janë hartuar programet dhe aktet e mëposhtme:

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 269, datë 13.6.2022 “Për miratimin e programit të kontrollit të brucelozës tek ruminantët e vegjël”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 233, datë 20.5.2022 “Për miratimin e programit të kontrollit të Plasjes te ruminantët e vegjël”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 249, datë 31.5.2022 “Për miratimin e programit të kontrollit të brucelozës së gjedhit”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr. prot 6275/1, datë 9.9.2021 “Për miratimin e programit afatgjatë të brucelozës në gjedhë”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 411, datë 20.9.2022 “Për miratimin e planit të kontigjencës së gripit të shpendëve”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 412, datë 20.9.2022 “Për miratimin e planit të mbikëqyrjes së gripit të shpendëve”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 611, datë 2.12.2021 “Për miratimin e formateve të njoftimit të sëmundjeve infektive të kafshëve dhe listës së sëmundjeve të njoftueshme në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 651, datë 31.12.2021 “Për miratimin e protokollit të kontrollit veterinar të veterinerëve zyrtarë”;



- Urdhër Nr. 377 datë 9.9.2021 “Programi i kontrollit të tuberkulozit të gjedhit” parashikon testimin e fermave me drejtim prodhim qumështi me 10 krerë e lart;
- Urdhër Nr. 350 datë 31.8.2021 “Plani i Kontrollit të Sëmundjeve së Dermatozës Nodulare” parashikon vaksinimin e gjedhit të remontit;
- Urdhri i Ministrit Nr. 174, datë 15.4.2022 “Për përcaktimin e kriterëve për vaksinat e përdorura kundër sëmundjes së Pseudopestit në programet rutinë të vaksinimit” përafuar me direktivën e BE-së 93/152 EEC;
- Urdhri i Ministrit Nr. 277, datë 15.6.2022 “Për zbatimin e rregullave të caktuara për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve për kategoritë e sëmundjeve të listuara dhe përcaktimin e listës së llojeve dhe grupeve të specieve që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e këtyre sëmundjeve të listuara”, përafuar me Rregulloren e BE-së 2018/1882;
- Urdhri i Ministrit Nr. 356, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e parimeve dhe udhëzimeve të praktikave të mira për prodhimin e produkteve mjekësore veterinarë”, përafuar me direktivën BE 91/412/KEE.
- Urdhri i ministrit nr. 325, datë 8.7.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për produktet mjekësore veterinarë”, miratuar me urdhrin nr. 370, datë 29.7.2014.
- Urdhri i Ministrit Nr. 411, datë 20.9.2022 “Për miratimin e planit të kontingjencës të gripit të shpendëve”;
- Urdhri i Ministrit Nr. 412, datë 20.9.2022 “Për miratimin e planit të mbikëqyrjes së gripit të shpendëve”;

Sistemi i informacionit veterinar dhe blegtoral RUDA, është bërë i aksesueshëm edhe përmes Google Chrome për të mundësuar transferimin e të dhënave nga celularët dhe në kohë reale. Janë përgatitur temat referuese për përmirësimin e sistemit RUDA.

Procedura e prokurimit për “përmirësimin e sistemit Ruda” për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është finalizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është përmirësimi i sistemit të menaxhimit të kafshëve dhe fermave “RUDA”, duke rritur nivelin e interaktivitetit digjital dhe duke automatizuar disa procese për transmetimin e informacionit nga fermat te konsumatori.

Përmirësimi konsiston në:

1. Përmirësimin e sistemit “RUDA” duke optimizuar modulet aktuale dhe duke shtuar module të reja;
2. Ngritja e një infrastrukture hardware në kapacitetet e duhura për këtë sistem;
3. Furnizimi dhe konfigurimi i pajisjeve të përdoruesve (tablet) për të lehtësuar punën në terren;
4. Krijimi i një aplikacioni celular për punonjësit e autorizuar nga Autoritetet përkatëse, por edhe për tregtarët dhe thertoret;
5. Furnizimi me çipa RFID që do të vendosen nga veterinerët në kafshë në ferma;
6. Përmirësimi dhe përditësimi i modeleve analitike të raporteve me grafikë dhe tabela;

7. Trajnimi i përdoruesve për sistemin dhe infrastrukturën e përmirësuar;
8. Procesin e mirëmbajtjes.

Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit, me mbështetjen e Projektit IPA “Mbështetje për Standardet e Sigurisë Ushqimore, Veterinare dhe Fitosanitare” dokumenti mbi analizën e mangësive ligjore i është nënshtruar një rishikimi të plotë. Ky dokument ka përfunduar dhe vazhdon të përditësohet në përputhje me aktet e reja të Acquis, akteve të transpozuar në legjislacionin shqiptar, gjetjeve nga përgatitja e Tabelave të Përputhshmërisë si dhe nga Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative. Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative është përgatitur në fushën e sigurisë ushqimore dhe është në proces në fushën e veterinarisë dhe fitosanitetit.

Për fushën e sigurisë ushqimore me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, janë miratuar për vitin 2022 aktet e mëposhtme ligjore:

- Udhëzimi Nr. 22 datë 29.12.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me Bazë Risku dhe i Marrjes së Mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore si dhe Planin e Marrjes së Mostrave në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) për Vitin 2023”;
- Udhëzimi Nr. 439 datë 4.10.2022 “Për miratimin e Planit të Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve për periudhën tetor 2022-dhjetor 2023”.
- Udhëzimi nr. 18, datë 9.11.2022 “Për aditivët ushqimorë të lejuar”, që përafron pjesërisht Rregulloren e BE-së nr. 1333/2008 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, duke krijuar një listë të aditivëve ushqimorë të lejuar për përdorim në produktet ushqimore.
- Udhëzimi nr. 5, datë 1.04.2022 “Mbi kërkesat për dhënien e informacionit për konsumatorët, për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në ushqim”, përafruar pjesërisht me Rregulloren zbatuese të komisionit (BE) Nr. 828/2014 e datës 30 korrik 2014 “Mbi kërkesat për dhënien e informacionit për konsumatorët për mungesën ose praninë e reduktuar të glutenit në ushqim”.
- Udhëzim nr. 9, datë 26.5.2022 “Për procedurën e marrjes së mostrave dhe metodën e analizës për kontrollin zyrtar të temperaturave të ushqimeve të ngrira shpejt të destinuara për konsum njerëzor”. Ai përafron pjesërisht Direktivën e Komisionit 92/2/EEC të datës 13 janar 1992 që përcakton procedurën e marrjes së mostrave dhe metodën komunitare të analizës për kontrollin zyrtar të temperaturave të ushqimeve të ngrira shpejt të destinuara për konsum njerëzor;
- Udhëzimi nr. 12, datë 13.7.2022 “Për caktimin e niveleve maksimale për praninë e kokcidiostatëve ose histomonostatëve në ushqime, si rezultat i bartjes së pashmangshme të këtyre substancave në ushqimin ushqimor jo të synuar”. Ai përafrohet pjesërisht me Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 124/2009 të datës 10 shkurt 2009 që përcakton nivelet maksimale për praninë e kokcidiostatëve ose histomonostatëve në ushqim që rezulton nga bartja e pashmangshme e këtyre substancave në ushqimin jo të synuar;

Aktet nënligjore të mëposhtme janë përgatitur me qëllim përmirësimin e kornizës ligjore dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e veterinarisë:

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 367 datë 9.9.2021 “Për rregullat minimale që zbatohen për mbrojtjen e pulave për prodhimin e mishit” i përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2007/43 / KE e datës 28 qershor 2007 për përcaktimin e rregullave minimale për mbrojtjen e shpendëve të mbajtura për prodhimin e mishit;

Legjislacioni i mëposhtëm është përgatitur për kontrollin e sëmundjes së dermatozës nodulare dhe gripit të shpendëve.

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 163/1, datë 20.4.2021 “Për miratimin e planit të kontigjencës së sëmundjes së dermatozës nodulare”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 228, datë 1.6.2021 “Për disa masa mbrojtëse kundër gripit të shpendëve me patogjenitet të lartë në shpendët, që shfaqet në Republikën e Kosovës”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 234, datë 2.6.2021 “Për miratimin e planit të kontigjencës së gripit të shpendëve”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 241, datë 7.6.2021 “Për miratimin e rregullores “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e gripit të shpendëve në shpendët”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 242, datë 8.6.2021 “Për krijimin e qendrës kombëtare të krizave”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 261, datë 24.6.2021 “Për disa masa shtesë për parandalimin dhe kontrollin e gripit të shpendëve, në pikat e inspektimit kufitar, mbarështimin, lëvizjen dhe tregtimin e shpendëve”.

Për fushën fitosanitare me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, janë miratuar për vitin 2022 aktet e mëposhtme ligjore:

- Ligji nr. 15/2022 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”. Për shkak të problemeve të konstatuara gjatë zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore të tij lidhur me importin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera dhe në lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e shëndetit të bimëve, ndryshimi i ligjit nr. 105/2016 “Për bimët. mbrojtja” ishte shumë e nevojshme;
- Vendim KM nr. 226, datë 13.4.2022 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 317, datë 15.5.2019 “Për miratimin e rregullave, për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit”;
- Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 15.03.2022 “Për miratimin e rregullores specifike për paketimin dhe etiketimin e PMB”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 113, datë 15.3.2022 “Për miratimin e rregullores “Për masat mbrojtëse ndaj dëmtuesve të bimëve”. Ai përafron pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2072 të datës 28 nëntor 2019 që vendos kushte uniforme për zbatimin e Rregullores (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe

Këshillit, në lidhje me masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve dhe shfuqizimin Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 690/2008 dhe ndryshimi i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/2019;

- Urdhri i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 250, datë 01.06.2022 “Për përditësimin e Urdhrit të Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 72, datë 02.03.2017 “Për miratimin e substancave veprimi në përmbajtjen e PMB”. Ai përafrohet pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2022/456 të datës 21 mars 2022 që miraton substancën bazë kitosan në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me vendosjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve në treg, dhe ndryshimi i Aneksit të Rregullores Zbatuese (BE) Nr. 540/2011; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/496 e datës 28 mars 2022 për miratimin e substancës aktive me rrezik të ulët *Spodoptera exigua multicapsid* nuk le opoliedrovirus (SeMNPV), izolimin BV-0004 në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshilli në lidhje me vendosjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve në treg, dhe ndryshimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 540/2011; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/501 e datës 25 mars 2022 për miratimin e substancës aktive *Beauveria bassiana* strain 203 në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. , dhe ndryshimin e Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 540/2011; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/383 e datës 4 mars 2022 që rinovon miratimin e substancës aktive me rrezik të ulët *Metarhizium brunneum* shtamet Ma 43 (dikur *Metarhizium anisopliae* var. *anisopliae* strain BIPESCO 5/F50 Nr. 1) /2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me vendosjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve në treg dhe ndryshimin e Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 540/2011; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/698 e datës 3 maj 2022 për rinovimin e miratimit të substancës aktive bifenazate në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. , dhe ndryshimin e Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 540/2011; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/378 e datës 4 Mars 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me zgjatjen e periudhave të miratimit të substancave aktive abamectin, *Bacillus subtilis* (Cohn 1872) shtamet QST 713, *Bacillus* ssp. Shtamet Aizawai ABTS-1857 dhe GC-91, *Bacillus thuringiensis* subsp. *israeliensis* (serotipi H-14) shtami AM65-52, *Bacillus thuringiensis* subsp. shtamet Kurstaki ABTS 351, PB 54, SA 11, SA12 dhe EG 2348, shtamet e *Beauveria bassiana* ATCC 74040 dhe GHA, clodinafop, *Cydia pomonella* Granulovirus (CpGV), cyprodinil, dichlorpropyroxim, metrafen, diklorprop-P, metrafen, , pirimicarb, shtamet *Pseudomonas chlororaphis* MA342, pirimetanil, *Pythium oligandrum* M1, rimsulfuron, spinosad, *Trichoderma asperellum* (dikur *T. harzianum*) shtamet ICC012, T25 dhe TV1, *Trichoderma* (atroviride. viride) shtamet ICC080, *Trichoderma harzianum* shtamet T-22 dhe ITEM 908, triclopyr, trinexapac, triticonazole dhe ziram; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/489 e datës 25 mars 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me periudhat e miratimit të substancave aktive flubendiamide, acid L-askorbik, spinetoram dhe spirotetramat; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/708 e datës 5 maj 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me zgjatjen e periudhave të miratimit të substancave aktive 2,5-diklorobenzoik metilester, acid acetik, aktonifeni,

amonium alumini sulfat, fosfid alumini, silikat alumini, beflubutamid, benthiavalicarb, boscalid, karbit kalciumi, kaptan, cimoxanil, dimetomorf, dodemorf, ethefon, etilen, ekstrakt nga pema e çajit, mbetjet e distilimit të yndyrës, Cfluopetrobina, acidet yndyrore Cfluorooksflu0 formetanate, acid giberelik, giberelinë, proteina të hidrolizuara, sulfat hekuri, fosfid magnezi, metam, metamitron, metazaklor, metribuzin, milbemectin, phenmedipham, pirimiphos-metil, vajra bimore/vaj karafili, vajra bimore/vajra të farërave të rapit vaj, propamocarb, proquinazid, prothiokonazol, piretrins, rërë kuarci, vaj peshku, repelentë nga era me origjinë shtazore ose bimore/yndyrë dele, S-metolachlor, Lepidopteran Ph. eromone, sulkotrione, tebukonazol dhe ure; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/686 e datës 28 Prill 2022 që ndryshon Rregulloret Zbatuese (BE) 2015/1295 dhe (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me kushtet e miratimit të substancës aktive sulfoxaflor;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 275, datë 14.6.2022 “Për miratimin e modelit të regjistrimit të përdorimit të PMB-ve në fermë, përmbajtjen dhe plotësimin e tij”;
- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 402, datë 15.09.2022 “Për përditësimin e Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 72, datë 02.03.2017 “Për miratimin e substancave vepruese në përmbajtjen e PMB”. Ai përaftron pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2022/1251 të datës 19 korrik 2022 që rinovon miratimin e substancave aktive Feromonet Lepidopteran me Zinxhirë të Drejtë (acetate) si substanca aktive me rrezik të ulët dhe Feromonet Lepidoptera me zinxhir të drejtë (aldehidet) në përputhje dhe alkoolet) me Rregulloren (KE) Nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe ndryshimin e Aneksit të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 540/2011; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/808 e datës 23 maj 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me periudhën e miratimit të substancës aktive bispyribac; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/814 e datës 20 maj 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me zgjatjen e periudhës së miratimit të substancës aktive heptamaloxylolucan; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/1480 e datës 7 shtator 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me zgjatjen e periudhave të miratimit të substancave aktive 2-fenilfenol (duke përfshirë kripërat e tij siç është kripa e natriumit), 8 -hidroksikuinoline, amidosulfuron, bensulfuron, bifenoks, klormequat, klorotoluron, klofentezine, klomazone, daminozid, deltametrin, dicamba, difenokonazol, diflufenican, dimetaklor, esfenvalerate, etofenrafeniprofenaz, , MCPA, MCPB, nikosulfuron, vajra parafine, vaj parafine, penkonazol, pikloram, proheksadion, propaquizafop, prosulfocarb, kuizalofop-P-etil, kuizalofop-P-tefuril, 5-nitroguaiacolate natriumi, natriumi o-sotropheniol, p. squfur, tebufenpyrad, tetrakonazol, tri-alate, triflusulfuron dhe tritosulfuron; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/740 e datës 13 maj 2022 në lidhje me mosmiratimin e substancës aktive 1,3-dikloropropen, në përputhje me Rregulloren (KE) Nr 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me vendosjen të produkteve për mbrojtjen e bimëve në treg; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/751 e datës 16 maj 2022 në lidhje me mosmiratimin e substancës aktive kloropicrinë, në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me vendosjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve në treg; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/782 e datës

18 maj 2022 për tërheqjen e miratimit të substancës aktive isopyrazam në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me vendosjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve në treg , duke ndryshuar Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) Nr. 540/2011 dhe duke shfuqizuar Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 1037/2012; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/1468 e datës 5 shtator 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me kushtet e miratimit të substancës aktive penflufen dhe shfuqizimin e Rregullores Zbatuese (BE) 2018/185; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/800 e datës 20 maj 2022 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 540/2011 në lidhje me kushtet e miratimit të substancave aktive vajra parafine CAS Nr 64742-46-7, CAS Nr 72623-86-0 dhe Nr CAS 97862-82-3.

- Udhëzimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 16, datë 19.10.2022 “Rregullat për masat dhe trajtimet specifike të kontrollit të dëmtuesve për kontrollin e dëmtuesve, Xylella fastidiosa (Wells et al.)” Përafron pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/1201 e datës 14 gusht 2020.

Gjithashtu në bashkëpunim me Projektin e Sigurisë Ushqimore janë trajnuar veterinerët zyrtarë të kontrollit për inspektimin e mishit ante/post-mortem, në këtë mënyrë produktet e mishit janë të sigurta për konsumatorin si për gjendjen higjienike ashtu edhe për atë shëndetësore.

Projekti i Sigurisë Ushqimore pajisi të gjithë veterinerët zyrtarë të kontrollit me pajisjet e duhura si thertoret standarde të BE-së për të rritur standardin e sigurisë ushqimore. Çdo veteriner zyrtar është i pajisur me vulën e identifikimit në mënyrë që çdo produkt të mund të gjurmohet. Të gjitha certifikatat e lëvizjes përditësohen në sistemin RUDA ku çregjistrimi i kafshëve të therura bëhet në kohë reale.

Bashkëpunimi i ngushtë dhe i shpejtë i AKVMB me AKU-në, ka bërë të mundur kontrollin në kohë reale të sasisë dhe gjendjes shëndetësore të kafshëve të therura.

Në qarkun e Shkodrës u zhvillua një trajnim në datën 16 qershor 2022 me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale të veterinerëve të rinj të punësuar në misionin e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit të Murtajës Afrikane të Derrit (ASF) në Shqipëri.

Funksionet dhe përgjegjësitë e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve nuk kanë ndryshuar.

Gjithsej për AKVMB-në dhe 4 DRVMB-të nga 546 pozicione, janë rekrutuar 473 punonjës dhe mbeten 73 vende vakante.

<b>AKVMB</b>			
4 DRVMB	16	10	6
12 sektorë veterinarë	530	463	67
<b>TOTAL</b>	<b>546</b>	<b>473</b>	<b>73</b>

## 12.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për këtë kapitull është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

MBZHR është përgjegjëse për formulimin e politikave, legjislacionit dhe strategjive për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimit si një funksion kyç në mbrojtjen e shëndetit dhe interesave të konsumatorit, duke siguruar konkurrencë të ndershme në tregun kombëtar dhe futjen e ushqimit produkteve në tregun ndërkombëtar.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 12 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);
- Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve (AKDC);
- Enti i Farave dhe Fidanëve (EFF);
- Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT).

## 12.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritet

Nëpërmjet projektit IPA “Mbështetje për sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe standardet e fitosanitetit”, tabela e analizës së mangësive legjislative (LGA) i është nënshtruar një rishikimi të plotë dhe vazhdon të përditësohet në përputhje me rezultatet dhe gjetjet nga përgatitja e Tabelave të Përputhshmërisë (ToCs), dhe Analizës institucionale dhe Mangësive Ligjore (IAGA) dhe duke e krahasuar me *acquis* të BE.

Bazuar në analizën e mangësive ligjore, transpozimi i *acquis* së Bashkimit evropian me legjislacionin vendas në lidhje me kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve do të kryhet brenda vitit 2024.

Legjislacioni vendas në këtë kapitull është i përafëruar në mënyrë të pjesshme. Ndërkohë që në Shqipëri ekziston tashmë një kuadër i përshtatshëm institucional për zbatimin e *acquis* në këtë Kapitull, ende kërkohen disa rregullime dhe forcimi i kapaciteteve administrative të institucioneve ekzistuese.

Në lidhje me sigurinë ushqimore, edhe pse Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen kontrolle të

rregullta zyrtare në përputhje me planin vjetor të bazuar në risk, problematikë mbetet hartimi dhe miratimi i një metodologjie të përmirësuar të vlerësimit të riskut, për shkak të mungesës së sistemeve të nevojshme operacionale të teknologjisë së informacionit që nuk mund të kompensohen me burimet njerëzore ekzistuese të nevojshme për të analizuar të dhënat. Cilësia e statistikave të inspektimit duke mos e kufizuar atë vetëm në numrin e inspektimeve ose masave të marra për shkeljet, mbetet për tu përmirësuar.

Për sa i përket legjislacionit në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, si dhe në fushën e organizmave të modifikuara gjenetikisht, mbetet për tu hartuar kuadri ligjor i mëtijshëm si dhe përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Reforma e sektorit veterinar duhet të përfundojë duke plotësuar të gjitha vendet vakante dhe duke krijuar kapacitetet e nevojshme për mbikëqyrjen pasive dhe aktive duke përfshirë vlerësime të besueshme të prevalencës së sëmundjeve, analiza të plota të të dhënave dhe hartimin, planifikimin dhe zbatimin e sistemeve efektive për parandalimin e sëmundjeve dhe /ose çrrënjosjes së tyre. Shqipëria duhet të sigurojë krijimin e një strukture koherente me *acquis* të BE-së, me një zinxhir të qartë komandimi, linjë komunikimi dhe raportimi. Shqipëria duhet të marrë pronësinë e plotë të fushatave të vaksinimit kundër tërbimit dhe të kalojë në përdorimin e mjeteve të veta për fushata të tilla të ardhshme vaksinimi, në përputhje me detyrimet për të harmonizuar me *acquis* përkatëse të BE-së. Regjistri i kafshëve duhet të përfshijë më shumë informacion për kafshët e tjera, si derrat, kuajt, shpendët dhe kafshët e tjera referuar *acquis* të BE-së, për të siguruar sisteme solide të gjurmueshmërisë për ushqimet me origjinë shtazore.

Në fushën e fitosanitetit, kuadri ligjor mbi kontrollin e dëmtuesve në bimë dhe produkte bimore si dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve duhet të plotësohet në përputhje me aktet normative të BE-së. Zbatimi i plotë i tyre është shumë i rëndësishëm.

Prioritetet afatshkurtra në fushën e sigurisë ushqimore përfshijnë:

- Forcimin e sistemit të sigurisë ushqimore dhe të sistemeve të kontrollit;
- Përforcimin e kapaciteteve laboratorike në fushën e sigurisë ushqimore;
- Plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë në lidhje me ushqimet për përdorime të veçanta ushqyese, aditivët në ushqime, rregullat zbatuese për autorizimin e deklaratave shëndetësore, informimin e konsumatorëve për mungesën ose reduktimin e pranisë së glutenit në ushqim, vendosjen e niveleve maksimale të koksidiostateve ose histomonostateve në ushqim që rezultojnë nga bartja e pashmangshme e tyre në ushqimin për kafshë, përcaktimin e procedurës së marrjes së mostrave dhe metodat për analizimin e ushqimeve të ngrira shpejt të destinuara për konsum njerëzor, rregullat e hollësishme mbi kërkesat minimale për pikat e inspektimit kufitar, prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit për kafshë të medikuar; përdorimin e acidit laktik për të eliminuar kontaminimin e karkasave të gjedhit, dallimin midis materialeve të ushqimit për kafshë, aditivëve të ushqimit për kafshë, produkteve biocidale dhe PMV-ve;
- Përcaktimi i rregullave specifike mbi kontrollet zyrtare për *Trichinella* në mish;
- Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore;



- Zbatimi i rregullave të sigurisë ushqimore përmes kontrolleve zyrtare të përmirësuara, përfshirë kushtet e kontrollit dhe kontrollet;
- Miratimi i një metodologjie të re me bazë rrisht për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore; zbatimi i kontrolleve zyrtare sipas planeve vjetore të përditësuara të inspektimit të bazuara në një metodologji të përmirësuar me bazë rrisht për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore;
- Zëvendësimi i planit të monitorimit vjetor të mbetjeve të pesticideve me një plan kontrolli kombëtar, bazuar në faktorët shtesë të rrisht, ku përfshihet konsumimi nga grupet e ndjeshme (vulnerabël) si dhe nga fazat e përpunimit para konsumit;
- Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë ushqimore ushqimeve në përputhje me aktet normative të BE-së dhe zbatimi i plotë i tyre.

Prioritetet afatshkurtra në fushën e veterinarisë përfshijnë:

- Fillimin e hartimit të ligjit mbi shëndetin e kafshëve në përputhje me *acquis* e Bashkimit Evropian në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar të sigurisë ushqimore.
- Përfundimin e reformës në shërbimin veterinar, përfshirë personelin në të gjitha nivelet dhe miratimin e procedurave të brendshme operacionale.
- Marrjen në pronësinë e plotë të fushatave të vaksinimit kundër tërbimit, duke kaluar në të ardhmen në përdorimin e mjeteve të veta për fushata të tilla vaksinimi, në përputhje me detyrimet e harmonizimit me *acquis* përkatëse të BE-së si dhe vazhdimi i zbatimit me efikasitet i programit të vaksinimit kundër tërbimit (2020 – 2022);
- Përfshirja në regjistrin e kafshëve më shumë informacion mbi kafshët e tjera, të tilla si derrat, kuajt, shpendët dhe kafshët e tjera siç përmenden në Ligjin përkatës të BE-së për Shëndetin e Kafshëve.
- Krijimi i kapaciteteve të nevojshme për mbikëqyrjen pasive dhe aktive duke përfshirë vlerësime të besueshme të përhapjes së sëmundjeve, nëpërmjet një analize të plotë të të dhënave, planifikimit dhe zbatimit të sistemeve efektive për parandalimin dhe/ose çrrënjosjen e sëmundjeve.
- Plotësimi i kuadrit ligjor mbi kontrollin e sëmundjeve në kafshë, higjienën e mirëqenien e kafshëve, kontrollet veterinarë në përputhje me aktet normative të BE-së dhe zbatimi i plotë i tyre.

Prioritetet afatshkurtra në fushën e fitosanitetit përfshijnë:

- Hartimi i ligjit mbi shëndetin e bimëve në përputhje me *acquis* e Bashkimit Evropian në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar të sigurisë ushqimore.
- Përfundimi i kapaciteteve laboratorike në fushën fitosanitare;
- Regjistrimi i operatoreve profesionist;
- Trajnimin dhe miratimin e operatoreve për lëshimin e pasaportës bimore;
- Monitorimi, kontrolli dhe evidentimin të dëmtuesit karatinorë dhe jo karatinorë;
- Forcimi i strukturave implementuese i shërbimit fitosanitar;
- Përmirësimi i kontrollit të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe konsolidimi i kapaciteteve të monitorimit të pesticideve në produktet ushqimore;
- Plotësimi i kuadrit ligjor mbi kontrollin e dëmtuesve në bimë dhe produkte bimore si dhe

produkteve për mbrojtjen e bimëve në përputhje me aktet normative të BE-së dhe zbatimimi i plotë i tyre.

## KAPITULLI 13: PESHKIMI

### 13.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo kërkon futjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, e cila përfshin politikën e tregut, menaxhimin e burimeve dhe flotës, inspektimin dhe kontrollin, masat strukturore dhe kontrollin e ndihmës shtetërore. Në disa raste, marrëveshjet dhe konventat ekzistuese në fushën e peshkimit me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare është e nevojshme që të përshtaten.

### 13.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 13 nuk është i ndarë në nënkapituj.

### 13.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian

Sipas Nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin kombëtar me *acquis* e BE-së.

Detyrimi nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit rrjedh nga neni 96 i MSA-së. Neni përcakton rëndësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellët me interes të përbashkët me prioritetin që lidhet me *acquis* e BE-së për peshkimin, duke përfshirë respektimin e detyrimeve ndërkombëtare lidhur me rregullat e organizimit ndërkombëtar dhe rajonale të peshkimit për menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve të peshkimit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e peshkimit (me përjashtim të ruajtjes së burimeve biologjike detare) janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë transpozimin në legjislacionin kombëtar., dhe kërkojnë marrjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për të zbatuar rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit. Fusha e veprimit, objektivat dhe parimet

e PPP-së janë të përcaktuara në Rregulloren kuadër të Politikës së Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Këshillit (BE) Nr. 1380/2013).

PPP përcakton rregullat për ruajtjen e burimeve të gjalla ujore, kufizimin e ndikimit në mjedis të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujëra dhe resurse. Ai gjithashtu përfshin një politikë strukturore dhe rregulla specifike për menaxhimin e kapacitetit të flotës, kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe zbatimin e rregullave të saj. PPP bazohet në këshilla të shëndosha shkencore dhe ofron një kornizë për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave të peshkimit. Masat specifike të menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit në Detin Mesdhe përcaktohen në Rregulloren (EC) Nr. 1967/2006 (Rregullorja Mesdhetare). Rregulla të veçanta zbatohen gjithashtu për menaxhimin e disa specieve, si për shembull, për ngjallën evropiane (Rregullorja 1100/2007).

Në lidhje me menaxhimin e resurseve dhe flotës, *acquis* përmban rregulla specifike për rregullimin e kapacitetit të peshkimit me qëllim që të kërkojë një ekuilibër midis flotës dhe rezervave, ashtu edhe matjen e tonazhit. Shteteve Anëtare u kërkohet të mbledhin dhe përditësojnë të dhënat lidhur me kapacitetin e peshkimit në një regjistër të veçantë të flotës së peshkimit. Inspektimi dhe kontrolli janë kryesisht përgjegjësi e Shteteve Anëtare që kanë nevojë të sigurojnë kapacitetet administrative për zbatim efektiv, ndërsa korniza ligjore është përgatitur në nivel të BE. *Acquis* përcakton ndërmjet të tjerash rregulla të hollësishme për regjistrimin dhe raportimin e kapjeve dhe funksionimin e një sistemi monitorimi satelitor të anijeve.

Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Fondin Evropian të Peshkimit Detar (EMFF) dhe përcakton masat financiare për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, masat përkatëse në lidhje me Ligjin e Detit, zhvillimin e qëndrueshëm të fushës së peshkimit dhe akuakulturës, dhe peshkimin e brendshëm, si dhe Politikën e Integruar Detare. Për të përfituar nga Fondi Evropian i Peshkimit Detar, Shtetet Anëtare të BE duhet të miratojnë një dokument strategjik dhe një Program Operacional (OP). Shtetet Anëtare gjithashtu duhet të kenë kapacitetet e nevojshme administrative dhe të kontrollit me qëllim që të sigurojnë një zbatim të shëndoshë dhe efikas të Programit Operacional.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian për politikën e tregut përcaktohet nga Rregullorja Nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe i Këshillit si dhe është i bazuar në organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionin për konsumatorin, rregullat e konkurrencës dhe intelijenca e tregut.

Përveç rregulloreve të përgjithshme të ndihmës shtetërore, *acquis* përmban rregulla specifike të ndihmës shtetërore të zbatueshme për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.

Duke pasur parasysh kompetencën e saj ekskluzive në fushën e ruajtjes së burimeve biologjike detare, BE është pjesë e një numri të marrëveshjeve dhe organizatave ndërkombëtare. Në disa raste, marrëveshjet ekzistuese të peshkimit dhe konventat me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare duhet të përshtaten ose të shfuqizohen përpara anëtarësimit.

Shqipëria ka harmonizuar kuadrin e saj ligjor dhe dispozitat e rregulloreve kombëtare me dispozitat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit (CFP) me qëllim që në mënyrë adekuate të përgatisë sektorin dhe administratën për përmbushjen e plotë të detyrimeve të saj në kuadër të Politikës së Përbashkët të Peshkimit.

Pjesët kryesore të *acquis* të BE-së janë:

- Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës, duke ndryshuar rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizimi i Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 104/2000;
- Rregullorja Nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, duke ndryshuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1954/2003 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe duke shfuqizuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 2371/2002 dhe (KE) Nr. 639/2004 dhe Vendimit të Këshillit 2004/585/EC;
- Rregullorja (BE) Nr. 2017/1004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 maj 2017 për krijimin e një kornize të Unionit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetje për këshilla shkencore në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 199/2008;
- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1224/2009 e datës 20 nëntor 2009 për krijimin e një sistemi të kontrollit të Komunitetit për të siguruar respektimin e rregullave të politikës së përbashkët të peshkimit, duke ndryshuar rregulloret (KE) Nr. 847/96, (KE) Nr. 2371/2002, (Nr. 811/2004, (KE) Nr. 768/2005, (EC) Nr. 2115/2005, (KE) Nr. 2166/2005, (KE) Nr. 388/2006, (KE) Nr. 509/2007, (KE) Nr. 676/2007, (KE) Nr. 1098/2007, (KE) Nr. 1300/2008, (KE) Nr. 1342/2008 dhe rregullat shfuqizuese (KEE) Nr. 2847/93, (KE) Nr. 1627/94 dhe (KE) Nr. 1966/2006.
- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1100/2007 e datës 18 shtator 2007 për vendosjen e masave për rikuperimin e stokut të ngjalave evropiane.
- Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi Fondin Evropian të Detarisë dhe Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KE) Nr. 2328/2003, (EC) Nr. 861/2006, (KE) Nr. 1198/2006 dhe (KE) Nr. 791/2007 dhe Rregullorja (EU) Nr. 1255/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

#### 13.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në peshkim, ka bërë progres të mirë duke finalizuar procesin e riaktivizimit të sistemit të monitorimit të anijeve (VMS) duke forcuar kapacitetet të inspektimit dhe kontrollit për të parandaluar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar. Qeveria miratoi planin për zonat e përcaktuara për akuakulturën në shkurt 2021, megjithatë, licencimi i sipërmarrjeve të akuakulturës do të zhvillohet në këto zona të përcaktuara pas diskutimeve me ministrinë e linjës.

Për krijimin e një tregu funksional të shitjes me shumicë të peshkut dhe ngritjen e sistemit të informacionit për tregtimin e peshkut ka përfunduar ndërtimi i tregut të tregtimit të peshkut në Shëngjin. Ndërsa ndërtimi i tregut të Vlorës është në proces ndërtimi.

Janë identifikuar Zonat e Lejuara të Akuakulturës për hartimin e planeve shumëvjeçare strategjike kombëtare me qëllim zhvillimin e akuakulturës në Shqipëri.

Shqipëria ka përditësuar regjistrin e anijeve të peshkimit dhe ka bërë përparime për përmirësimin e statistikave të zbarkimit. Është vënë në zbatim sistemi i lëshimit të certifikatave të zënies për produktet e peshkimit.

Në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në aktivitetet e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun dhe ka përmbushur rekomandimet e dhëna. Përpos kësaj, Shqipëria ka përmbushur të gjitha kërkesat e rekomandimet e Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut. Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm raportimet në këto organizata ne përputhshmëri me kërkesat e tyre.

Shqipëria ka përgatitur dhe dorëzuar Statlant37A\_GFCM\_FAO\_2021 dhe Albania008A\_2021, duke rishikuar të gjitha të dhënat e kapur që nga 2013. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2018, Shqipëria dorëzoi të gjitha të dhënat sipas GFCM\_DCRF-2021 si dhe ICCAT - Task I + II (2021).

Në kuadër të peshkimit, Shqipëria nënshkroi Deklaratën MedFish4Ever të Maltës në lidhje me qëndrueshmërinë e burimeve të peshkimit në Mesdhe (një iniciativë e BE-së për të kthyer peshkimin në Mesdhe për qëndrueshmëri dhe në këtë mënyrë të ruajë rritjen ekonomike dhe vendet e punës) si dhe deklaratën e konferencës së Nivelit të lartë të peshkimit artizanal (HL-SSF) në shtator 2018 në Maltë.

Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e peshkimit, për vitin 2022 janë përgatitur aktet e mëposhtme:

- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 182, datë 19.4.2022 “Për përcaktimin e sasive minimale të lejueshme që mund të hidhen në det për disa forma të peshkimit të pelagjikëve të vegjël”. Ky urdhër është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 2018/161 e Deleguar të Komisionit, të datës 23 tetor 2017 që përcakton një përjashtim minimal nga detyrimi i zbarkimit për disa pelagjike të vegjël në Detin Mesdhe.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 283, datë 29.4.2022 “Për marrjen e masave menaxhuese për ruajtjen e burimeve peshkore”. Ky vendim i Këshillit të Ministrave është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2013, mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) nr. 1954/2003 dhe (KE) nr. 1224/2009 dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) nr. 2371/2002 dhe (KE) nr. 639/2004 dhe Vendimin e Këshillit nr. 2004/585/KE.

- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 230, datë 20.5.2022 “Për miratimin e rregullores ‘Për një plan shumëvjeçar rehabilitimi për peshkun shtizë’”. Ky urdhër është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 2019/1154 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 20 qershor 2019, mbi një plan shumëvjeçar rehabilitimi për peshkun shtizë në Mesdhe dhe që ndryshon Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 1967/2006 dhe Rregulloren (BE) 2017/2107 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit.
- Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 8, datë 20.5.2022 “Për përcaktimin e kostove të pranueshme që mbështeten nga ndërhyrjet strukturore”. Ky udhëzim është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 2015/531 e deleguar e Komisionit Evropian të datës 24 nëntor 2014, që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit duke identifikuar kostot e pranueshme për mbështetje nga Fondi Evropian i Detit dhe Peshkimit me qëllim përmirësimin e higjienës, shëndetit, sigurisë dhe kushteve të punës së peshkatarëve, mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve detare, zvogëlimin e ndryshimeve klimatike dhe rritjen e efikasitetit energjitik të anijeve të peshkimit.
- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 357, datë 29.7.2022 “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e kushteve shtesë për njohjen e organizatave prodhuese”. Ky urdhër është përafuar pjesërisht me Rregulloren Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 1419/2013 të datës 17 dhjetor 2013 në lidhje me njohjen e organizatave të prodhuesve dhe organizatave ndërsektoriale shtrirjen e rregullave të organizatave të prodhuesve dhe organizatave ndërsektoriale dhe publikimin e çmimeve kufi siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit për organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës dhe me Rregulloren (BE) Nr. 1379/2013 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit për organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr. 1184/2006, Nr. 1224/2006 dhe shfuqizon Rregulloren (BE) Nr. 104/2000.

### 13.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për kapitullin 13 është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që është edhe institucioni koordinues i grupit ndërinstitucional të punës.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 13 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator (MSHK);
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

### 13.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

## *Mangësitë e identifikuara*

Shqipëria duhet të kompletojë personelin e administratës së peshkimit dhe të krijojë kapacitetet e nevojshme administrative të sektorit të peshkimit për të zbatuar politikat kombëtare në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE-së (CFP) dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Pavarësisht krijimit të Drejtorisë së Peshkimit dhe Akuakulturës kapacitetet administrative mbeten akoma të ulëta.

## *Prioritetet*

Gjatë vitit 2023 Shqipëria synon këto prioritetet:

- Arritja e përputhjes së mëtejshme me kuadrin ligjor me rregullat e BE në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe ujërat e brendshme;
- Rritja e kapaciteteve të administratës së peshkimit, si dhe grumbullimi, përpunimi i të dhënave të zënieve për hartimin e planeve të menaxhimit të peshkimit si dhe raportimin në organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit (GFCM);
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Peshkimit;
- Zhvillimi i mekanizmave të duhura për grumbullimin e të dhënave në nivel kombëtar, e cila duhet të jetë plotësisht në përputhje me *acquis* të BE;
- Zbatimi dhe zhvillimi i politikave për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkut me shumicë dhe pakicë dhe promovuar përmirësimin e cilësisë së produkteve të peshkut;
- Zgjerimi i mëtejshëm i porteve të peshkimit ekzistuese, ndërtimin e shkallëve për riparimin e anijeve dhe ndërtimin e bankinave për anijet e peshkimit në Vlorë, Sarandë dhe Shëngjinit, në mënyrë që të rritet gatishmërinë e treguesve teknike për flotën e peshkimit detar;
- Mbështetje për dhënien e kredive të buta për operatorët e peshkimit me qëllim riparimin dhe modernizimin e anijeve të tyre të peshkimit, pa rritur sforcën e peshkimit;
- Rritja e nivelit të përpunimit industrial të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës, përmirësimin e marketingut të tyre përmes rritjes së cilësisë dhe sigurisë;
- Forcimi i kapaciteteve të inspektimit, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes.

## KAPITULLI 22: POLITIKAT RAJONALE DHE BASHKËKOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTOROR

### 22.1 Përmbajtja e kapitullit

*Acquis* e BE-së për politikën rajonale dhe të kohezionit nuk kërkon transpozim pasi Rregullorja është drejtpërdrejt e zbatueshme për Shtetet Anëtare. Në nivel kombëtar do të duhet të miratohen shumë akte administrative dhe/ose legjislative për të krijuar të gjithë sistemin për qeverisjen e Fondeve Strukturore dhe Investimeve Evropiane.

Kërkesat formale të Traktatit duhet të njihen: në veçanti, neni 175 i cili përcakton se Shtetet Anëtare do të drejtojnë politikat e tyre ekonomike dhe do t'i koordinojnë ato në mënyrë të tillë që, përveç kësaj, të arrijnë objektivat e përcaktuara në nenin 174, d.m.th. për të reduktuar pabarazitë ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme dhe prapambetjes së rajoneve më pak të favorizuara.

Duhet të krijohet një kornizë legjislative që lejon programimin shumëvjeçar në nivel kombëtar dhe, aty ku është e nevojshme, në nivel nënkombëtar/rajonar. Kuadri legjislativ kombëtar duhet të lejojë gjithashtu fleksibilitet buxhetor, duke mundësuar kapacitetin e bashkëfinancimit në nivel kombëtar dhe nën-kombëtar (rajonar/lokal) dhe duhet të sigurojë kontroll të shëndoshë dhe efikas financiar dhe auditim të ndërhyrjeve.

Shtetet anëtare duhet gjithashtu të respektojnë legjislacionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushat relevante për zbatimin e politikës së kohezionit, p.sh. ndihmës shtetërore, prokurimet publike, mbrojtja e mjedisit, transporti, mosdiskriminimi, barazia midis burrave dhe grave, gjatë përzgjedhjes dhe zbatimit të projekteve.

Shtetet anëtare duhet të kenë kornizën e duhur institucionale dhe kapacitetin e zbatimit për të siguruar që programimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi janë të përshtatshme dhe me kosto efektive nga perspektiva e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

## 22.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 22 nuk është i ndarë në nënkapituj.

## 22.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian

Republika e Shqipërisë në Kapitullin 22 do të fokusohet në:

- Zbatimin e nenit 110 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit që përcakton se palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë rajonale. Ndihma financiare e siguruar nga BE është e rregulluar me nenet 112 - 115 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA);
- Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 qershor 2021 që përcakton dispozita të përbashkëta për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit të Drejtë dhe Fondin Evropian Detar, Peshkimit dhe Akuakulturës dhe rregullat financiare për ata dhe për Fondin e Azilit, Migracionit dhe Integritimit, Fondit të Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentit për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politikën e Vizave.



## 22.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturorë. Për këtë qëllim, situata e hartimit të dokumenteve strategjike po evolon dhe shumë procese po zbatohen nga institucionet kyç që ndikojnë në progresin e zbatimit të kushteve për zhvillimin rajonal.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020 ka përfunduar fazën e zbatimit dhe aktualisht ka filluar procesi për hartimin e strategjisë së re kombëtare që do të shtrihet për periudhën deri në vitin 2030. Për përgatitjen e SKZHI është hartuar draft metodologjia për procesin e hartimit, duke u bazuar në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me planifikimin e integruar dhe sistemin informatikë IPSIS (Integrated Planning System Management Information System), miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020. Gjithashtu, është përgatitur draft Urdhri për miratimin e standardit metodologjik për SKZHIE 2022 – 2030 dhe për fillimin e procesit për SKZHIE 2022 – 2030, i cili përmban metodologjinë përkatëse për SKZHIE 2022 – 2030. Aktualisht ka përfunduar procesi për identifikimin e prioriteteve afatmesme 2022 – 2024, përmes përgatitjes së Dokumentit të Politikave Prioritare 2022 – 2024, i cili është miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në mars 2021. Ky dokument orientoi diskutimin për përgatitjen dhe miratimin e tavanëve të buxhetit për periudhën 2022 – 2024, me Urdhër të Ministres së Financave dhe Ekonomisë.

Në kuadër të përgatitjes së SKZHIE 2022 – 2030, është angazhuar mbështetje me asistencë teknike nga OKB, për hartimin e draftit të SKZHIE 2022 – 2030, si edhe për analizën e rritjes ekonomike dhe kostimin e SKZHIE 2022 – 2030. Kjo strategji do të sigurojë mbështetje veçanërisht për orientimin e Programimit Buxhetor Afatmesëm në ciklet brenda harkut kohor 2030, si edhe në harmonizim me dokumentet e lidhura me strategjinë e Bashkimit Evropian për zgjerimin /Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Gjithashtu, SKZHIE 2022 – 2030 do të përfshijë qëllimet e politikave për politikat afatgjata të lidhura me zhvillimin rajonal të vendit, në përputhje edhe me ligjin 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin: (neni 11/6).

Në lidhje me kuadrin e përgjithshëm të politikave dhe prioriteteve sektoriale, SKZHIE 2022 – 2030 siguron:

- **Lidhjen me prioritetet afatmesme të Qeverisë Shqiptare**, ku prioritetet e parashikuara në programin e Qeverisë, si edhe sektorët prioritarë të Qeverisë, janë pjesë integrale e vizionit drejt të cilit duhet të zhvillohet vendi dhe politikat strategjike që përcaktohen në SKZHIE, në funksion të vizionit.
- **Lidhjen e plote të PBA me SKZHIE përmes:**
  - hartimit të një kuadri makroekonomik për 2030, që përfshin prioritetet e politikave për 2030, financimin e huaj të parashikuar apo programuar, si edhe aspekte të tjera lidhur me financimin dhe të ardhurat.
  - qëllimit të politikave të mirëpërcaktuara për 2022 – 2030, të cilat përfshijnë edhe objektivat në kuadër të integritimit evropian. Për këtë qëllim, Udhëzimi për hartimin

e Buxhetit përcakton detajet teknike të përfshirjes së politikave dhe zërthimin e objektivave në PBA e ardhshme në funksion të realizimit të qëllimeve 2022 – 2030.

- SKZHIE III është një pjesë e rëndësishme e IPSIS, e cila përbëhet nga një sërë parimesh operacionale që sigurojnë që planifikimi dhe zbatimi i politikave të planifikimit të qeverisë të kryhet në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar. IPSIS ka evoluar dhe përfshin dy shtylla bazë për planifikimin strategjik dhe koordinimin e politikave në nivel kombëtar:

- procesit të planifikimit strategjik afatmesëm dhe afatgjatë, i shoqëruar me strategji sektoriale, të cilat drejtojnë politikëbërjen e nivelit të lartë në përcaktimin e prioriteteve dhe qëllimeve strategjike kombëtare, dhe
- procesit të buxhetimit afatmesëm, ose programi buxhetor afatmesëm (PBA), i cili kërkon që çdo ministri dhe agjenci qeveritare të përgatisë një plan tre-vjeçar brenda një tavani të caktuar shpenzimesh, për zbatimin e objektivave të politikës, si hapa të ndërmjetëm për të përmbushur SKZHIE 2022 – 2030.

- **Lidhjen e plotë me agjendën e integrimit të vendit/MSA, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA-së janë pjesë integrale e SKZHIE-së dhe planifikimit buxhetor afatmesëm.**

SKZHIE 2022 – 2030 i paraprin miratimit të fondeve vjetore të buxhetit të shtetit, duke përcaktuar objektivat e politikave, të cilat përfshihen në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha institucionet shtetërore.

SKZHIE 2022 – 2030 është gjithashtu një dokument i rëndësishëm referimi për partnerët e zhvillimit, për harmonizimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit dhe të proceseve integruese të vendeve në BE, me mbështetjen që partnerët ndërkombëtarë i japin Shqipërisë. SKZHIE III paraqet fazën aktuale të zhvillimit të vendit, në lidhje me aspiratat dhe progresin e vendit në rrugëtimin drejt integrimit evropian dhe njëkohësisht shërben për të monitoruar progresin e bërë dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030.

SKZHIE 2022 – 2030 shtrihet në të gjitha fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe synon të pasqyrojë prioritetet e zhvillimit në një periudhë relativisht më të gjatë kohore, duke marrë parasysh:

- Harmonizimi i zbatimit të SKZHIE 2022 – 2030 me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), pjesë e Agjendës 2030, për të cilën Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në 2030;
- Zhvillimi dhe zbatimi i një vizioni afatgjatë për zhvillimin e vendit;
- Shtyrja deri në vitin 2030 e disa prej strategjive të rëndësishme sektoriale të miratuara ose në proces përgatitjeje;
- Përfitimi i krijimit të një kuadri strategjik afatgjatë që ndihmon procesin e integrimit të Shqipërisë në BE brenda një kuadri strategjik të qartë dhe të qëndrueshëm;
- Mbështetja e procesit të buxhetimit afatmesëm duke ndërtuar projeksione afatgjata të shpenzimeve buxhetore për arritjen e qëllimeve strategjike dhe objektivave të

politikave për zhvillimin e vendit.

SKZHIE 2022 – 2030 siguron gjithashtu boshtin orientues për të gjitha programimet e fondeve të partnerëve për zhvillim, duke përfshirë financimin përmes IPA-s, si instrument financimi i BE për Shqipërinë, apo edhe strategjitë për zhvillimin e vendit që kanë donatorët shumëpalësh (si BB, UN etj.) apo dypalësh (si SIDA, SDC, Gjermania, Italia etj.). Duke qenë në sintoni me proceset planifikuese edhe me Bashkimin Evropian, që ne synojmë të anëtarësohemi, SKZHI përfshin një hark kohor 10 vjeçar, ku 7 vjet është edhe cikli planifikues i politikave të vetë BE-së, ndërkohë që deri në 2030 është edhe harku kohor i zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 642, datë 29.10.2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”, koordinimi i procesit të programimit dhe monitorimit të asistencës financiare të BE-së (fondet IPA) kryhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA). KKIPA dhe ZM KKIPA kanë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi sikurse janë përcaktuar në Marrëveshjen Financiare Kuadër të Partneritetit (IPA II dhe IPA III) ndërmjet Komisionit Evropian dhe Shqipërisë.

Zyrtari Kombëtar Autorizues (Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë) mban përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të asistencës IPA në Shqipëri duke siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve sipas IPA I dhe IPA II. ZKA-ja mbështetet nga strukturat drejtuese, të cilat përbëhen nga Fondi Kombëtar dhe Drejtoria për Mbështetjen e ZKA/NAO. Të dyja këto janë struktura të veçanta brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat përgjigjen tek NAO/ZKA për funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar të zbatimit indirekt të Programeve IPA-IPARD në Shqipëri.

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës e Akredituar nga BE u krijua me Ligjin Nr. 90/2016, datë 15.09.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Asistencës të akredituar nga BE në Republikën e Shqipërisë”. Agjencia ka si objekt të veprimtarisë auditimin për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian.

Procesi i programimit për programet e reja të Bashkëpunimit Territorial për periudhën 2021 – 2027 nën IPA III, ku Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme dhe më pas SASPAC përmbyllën me sukses duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në 8 programe, aktivitete të cilat u zhvilluan gjatë periudhës 2021 – 2022.

Së bashku me paketën për vitin programues IPA 2023, në korrik 2022 u realizua dhe përditësimi i dokumentit i Përgjigjes Strategjike, në të cilin evidentohen veprimet kryesore për secilën dritare/prioritet nën IPA III.

Në fund të korrikut 2021, Komisioni Evropian gjithashtu i dorëzoi KKIPA paketën e miratuar për

vitin programues IPA 2021, si vijon:

- BE për Drejtësinë – 8 milionë euro – Përfituese: Ministria e Drejtësisë;
- E drejta pronësore e BE-së – 10 milionë euro – Përfituesit: Kryeministria përfitues dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- BE për Natyrën / SPIN – 6 milionë euro – Përfituese: Ministria përfituese e Turizmit dhe Mjedisit;
- BE për ekonominë qarkore – 30.9 milionë euro – Përfituese: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Ministria përfituese e Turizmit dhe Mjedisit;
- BE për Inovacion (faza e dytë) – 10 milionë euro – Përfituese: Përfituesi Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Duke filluar nga marsi 2021, institucionet përfituese, nën koordinimin e KKIPA/ZM KKIPA kanë punuar për përgatitjen e 9 draft Dokumenteve të Veprimit nën Programin IPA 2022. Paketa është finalizuar dhe dërguar në KE brenda afatit të caktuar nga Komisioni Evropian, në fund të vitit 2021.

Në nëntor 2022, KKIPA është njoftuar nga shërbimet e Komisionit Evropian mbi paketën finale të miratuar, e cila përfshin Dokumentet e Veprimit, si vijon:

- Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM): Mbështetje për procesin e rivlerësimit të përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri – Faza III – 9.7 milionë euro, përfitues: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Dhoma e Apelit dhe Komisionerët Publikë (KP);
- BE-ja për Demokracinë – 5 milionë euro, përfitues: Kuvendi i Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- BE-ja për zbatimin e ligjit – 14.9 milionë euro, përfitues: Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Instrumenti lehtësues për Integrimin Evropian – 19 milionë euro, përfituesit: SASPAC, MFE, NAO, CFCU, KM, Njësitë IPA, MIE, MBZHR, QKB, ARRSH, Hekurudha Shqiptare, Agjencia e Eficencës së Energjisë;
- BE-ja për sektorin e ujit – 29 milionë euro, përfitues: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Manaxhimit të Ujërave dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- BE-ja për Rininë – 5 milionë euro, përfitues: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Më 16 tetor 2022, Komisioni Evropian iu komunikoi të gjitha qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor vënien në dispozicion të një fondi prej 500 milionë eurosh për mbështetje buxhetore për përballimin e efekteve të krizës së energjisë duke shtyrë në kohë paketën e dërguar tashmë si pjesë e programit vjetor IPA 2023 për programimin vjetor IPA 2024.

Dialogu i Nivelit të Lartë BE-Ballkani Perëndimor për menaxhimin e situatës së krizës energjetike (i bashkëkryesuar nga Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin dhe Ministrat e Energjisë së Ballkanit Perëndimor) filloi më 17 tetor 2022 për të diskutuar çështje afatshkurtra, afatmesme dhe

afatgjata, si p.sh. adresimin e krizës energjetike për dimrin dhe vitin e ardhshëm 2023 si dhe rritjen e Ballkanit Perëndimor dhe në veçanti sigurinë dhe efikasitetin energjetike të Shqipërisë.

Më 3 nëntor 2022, përmes Koordinatorit Kombëtar të IPA, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe u përcoll pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian koncept-ideja dhe draft-plani për përgjigjen ndaj krizës së energjisë, ku janë reflektuar masat që do të ndërmerren vendi ynë dhe treguesit që duhet të realizohen.

Më 25 nëntor 2022, u përcoll paketa e plotë e propozimeve nga Qeveria Shqiptare, përmes KKIPA.

Më 20 dhjetor 2022, me qëllim shprehjen e angazhimit nga Qeveria e Shqipërisë mbi zbatimin e planit të masave të propozuara dhe realizimin e objektivave të vendosura, u nënshkrua Urdhri nr. 276 datë 20.12.2022 “Për miratimin e planit të veprimit për përfitimin e mbështetjes buxhetore të Bashkimit Evropian në kuadër të krizës energjetike” nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Në këtë Urdhër shprehen sipas fushave të përgjegjësisë të sevilës Ministri angazhimet e ndërmarra për realizimin me sukses dhe mundësimin e përthithjes së fondeve të miratuara për Shqipërinë.

Programi vjetor kombëtar IPA 2023 i kushton vëmendje të veçantë ndërtimit të shtetit dhe rezistencës për të zbutur ndikimin e menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike si pasojë e koniukturës ndërkombëtare të imponuar nga agresioni ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës në shkurt 2022 dhe për të krijuar bazën për ndërtimin e rezistencës energjetike në Shqipëri. Marrëveshja vjen në formën e një mbështetje buxhetore dhe do të kontribuojë në rritjen e burimeve financiare të qeverisë duke lejuar për marrjen e masave për reduktimin e gjasave të varfërisë energjetike duke ndihmuar NVM-të dhe familjet në nevojë, duke siguruar ofrimin e tyre të vazhdueshëm dhe akses në shërbimet thelbësore, veçanërisht për segmentet më të cënueshme të popullsisë dhe për të mbështetur rimëkëmbjen afatgjatë socio-ekonomike, siguri energjetike dhe rezistencë energjetike, si dhe diversifikim të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) të Shqipërisë.

Programi vjetor kombëtar, që kontribuon në Paketën e Mbështetjes Energjetike të Ballkanit Perëndimor në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2023, do të mbështesë si më poshtë vijon:

Veprimin: Kontrata e Ndërtimit të Shtetit dhe Rezistencës për Shqipërinë

Dritarja 3: Axhenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme

Prioriteti Tematik 2: Transporti, ekonomia dhe shoqëria dixhitale, si dhe energjia (60%)

Dritarja 4 – Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse

Prioriteti Tematik 1: Arsimi, punësimi, politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, si dhe shëndeti (20%)

Prioriteti Tematik 2: Zhvillimi i sektorit privat, tregtisë, kërkimit shkencor dhe novacionit (20%)

Institucioni përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kostoja totale e llogaritur për këtë Program është 80 000 000 Euro.

Për herë të parë, Shqipëria, nën kuadrin programues IPA III ka aplikuar për të zhvilluar 3 programe shumëvjeçare (2024 – 2027):

- Programi Operacional “Garancia Rinore”, ku si autoritet menaxhues do të jetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, program nën Dritaren 4 “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse” – Prioriteti tematik nr. 1: “Arsimi, Punësimi, Mbrojtja Sociale dhe Politikat e Përfshirjes dhe Shëndetësia”;
- Programi Operacional “Eficiencia e Energjisë”, ku autoritet menaxhues do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, program i propozuar nën Dritaren 3: Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme, prioriteti tematik 2: Transporti, ekonomia dhe shoqëria dixhitale dhe energjia;
- Programi Operacional “Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale”, ku autoritet menaxhues do të jetë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), program i propozuar nën Dritaren 3: Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme, prioriteti tematik nr 2: “Zhvillimi i Sektorit Privat, Tregtia, Kërkimi dhe Inovacioni”.

Përpos 3 Programeve Operacionale, pjesë e paketës së IPA 2024 janë dhe 6 Dokumente Veprimi:

- Mbështetje për menaxhimin e pyjeve – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Mbështetje për Antikorrupsionin – Ministria e Drejtësisë;
- Mbështetje për politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- BE për Qeverijes Lokale – Ministria e Brendshme;
- Ngritja e komunikimit të rrjetit bazuar në teknologjinë TETRA – Ministria e Brendshme;
- Ngritja e Institucionit Mjekësor të Posaçëm/LSI për pacientët psikiatrikë mjekoligjorë, në nivel kombëtar – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë;
- Mbështetje Buxhetore “BE për punësimin” – Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Më 16 tetor 2022, Komisioni Evropian iu komunikoi të gjitha qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor vënien në dispozicion të një fondi prej 500 milionë eurosh për mbështetje buxhetore për përballimin e efekteve të krizës së energjisë duke shtyrë në kohë paketën e dërguar tashmë si pjesë e programit vjetor IPA 2023 për programimin vjetor IPA 2024.

Dialogu i Nivelit të Lartë BE-Ballkani Perëndimor për menaxhimin e situatës së krizës energjetike (i bashkëkryesuar nga Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin dhe Ministrat e Energjisë së Ballkanit Perëndimor) filloi më 17 tetor 2022 për të diskutuar çështje afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, si p.sh. adresimin e krizës energjetike për dimrin dhe vitin e ardhshëm 2023 si dhe rritjen e Ballkanit Perëndimor dhe në veçanti sigurinë dhe eficientën energjetike të Shqipërisë.

Më 3 nëntor 2022, përmes Koordinatorit Kombëtar të IPA, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe u përcoll pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian

koncept-ideja dhe draft-plani për përgjigjen ndaj krizës së energjisë, ku janë reflektuar masat që do të ndërmarrë vendi ynë dhe treguesit që duhet të realizohen.

Më 25 nëntor 2022, u përcoll paketa e plotë e propozimeve nga Qeveria Shqiptare, përmes KKIPA.

Më 20 dhjetor 2022, me qëllim shprehjen e angazhimit nga Qeveria e Shqipërisë mbi zbatimin e planit të masave të propozuara dhe realizimin e objektivave të vendosur, u nënshkrua Urdhri nr. 276 datë 20.12.2022 “Për miratimin e planit të veprimit për përfitimin e mbështetjes buxhetore të Bashkimit Europian në kuadër të krizës energjetike” nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Në këtë Urdhër shprehen sipas fushave të përgjegjësisë të sevilës Ministri angazhimet e ndërmarra për realizimin me sukses dhe mundësimin e përthithjes së fondeve të miratuara për Shqipërinë.

Programi vjetor kombëtar IPA 2023 i kushton vëmendje të veçantë ndërtimit të shtetit dhe rezistencës për të zbutur ndikimin e menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike si pasojë e koniukturës ndërkombëtare të imponuar nga agresioni ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës në shkurt 2022 dhe për të krijuar bazën për ndërtimin e rezistencës energjetike në Shqipëri. Marrëveshja vjen në formën e një mbështetje buxhetore dhe do të kontribuojë në rritjen e burimeve financiare të qeverisë duke lejuar për marrjen e masave për reduktimin e gjasave të varfërisë energjetike duke ndihmuar NVM-të dhe familjet në nevojë, duke siguruar ofrimin e tyre të vazhdueshëm dhe akses në shërbimet thelbësore, veçanërisht për segmentet më të cënueshme të popullsisë dhe për të mbështetur rimëkëmbjen afatgjatë socio-ekonomike, siguri energjetike dhe rezistencë energjetike, si dhe diversifikim të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) të Shqipërisë.

Programi vjetor kombëtar, që kontribuon në Paketën e Mbështetjes Energjetike të Ballkanit Perëndimor në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2023, do të mbështesë si më poshtë vijon:

Veprimi: Kontrata e Ndërtimit të Shtetit dhe Rezistencës për Shqipërinë

Dritarja 3: Axhenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme

Prioriteti Tematik 2: Transporti, ekonomia dhe shoqëria dixhitale, si dhe energjia (60%)

Dritarja 4 – Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse

Prioriteti Tematik 1: Arsimi, punësimi, politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, si dhe shëndeti (20%)

Prioriteti Tematik 2: Zhvillimi i sektorit privat, tregtisë, kërkimit shkencor dhe novacionit (20%)

Institucioni përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kostoja totale e llogaritur për këtë Program është 80 000 000 Euro.

Për herë të parë, Shqipëria, nën kuadrin programues IPA III ka aplikuar për të zhvilluar 3 programe shumëvjeçare (2024 – 2027):

- Programi Operacional “Garancia Rinore”, ku si autoritet menaxhues do të jetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, program nën Dritaren 4 “Konkurrueshmëria dhe Rritja

Gjithëpërfshirëse” – Prioriteti tematik nr. 1: “Arsimi, Punësimi, Mbrojtja Sociale dhe Politikat e Përfshirjes dhe Shëndetësia”;

- Programi Operacional “Eficiencia e Energjisë”, ku autoritet menaxhues do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , program i propozuar nën Dritaren 3: Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme, prioriteti tematik 2: Transporti, ekonomia dhe shoqëria dixhitale dhe energjia;
- Programi Operacional “Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale”, ku autoritet menaxhues do të jetë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), program i propozuar nën Dritaren 3: Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme, prioriteti tematik nr 2: “Zhvillimi i Sektorit Privat, Tregtia, Kërkimi dhe Inovacioni”.

Përpos 3 Programeve Operacionale, pjesë e paketës së IPA 2024 janë dhe 6 Dokumente Veprimi:

- Mbështetje për menaxhimin e pyjeve – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Mbështetje për Antikorrupsionin – Ministria e Drejtësisë;
- Mbështetje për politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- BE për Qeverijes Lokale – Ministria e Brendshme;
- Ngritja e komunikimit të rrjetit bazuar në teknologjinë TETRA – Ministria e Brendshme;
- Ngritja e Institucionit Mjekësor të Posaçëm/LSI për pacientët psikiatrikë mjekoligjorë, në nivel kombëtar – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë;
- Mbështetje Buxhetore “BE për punësimin” – Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Monitorimi i asistencës IPA kryhet nga Drejtoria e Administrimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian (ZM KKIPA) në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, për të gjitha programet në zbatim IPA dhe Veprimet nën menaxhimin direkt dhe indirekt, ecurinë e tyre në arritjen e objektivave dhe rezultateve, sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve IPA në Shqipëri, etj.

Gjatë procesit të monitorimit, strukturat përkatëse marrin parasysh Marrëveshjen Kuadër ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, legjislacionin kombëtar për zbatimin e fondeve të BE-së IPA I (2007 – 2013), IPA II (2014 – 2020) dhe IPA III (2021 – 2027), marrëveshje ndërinstitucionale dhe manuale procedurale. Komiteti i Monitorimit të IPA-s për vitin 2021 u organizua gjatë janarit 2022, i cili u parapri nga takimet e Komiteteve Monitoruese Sektoriale. Në vitin 2022, u zhvilluan 4 takime të Komiteteve Monitoruese Sektoriale.

Në kuadër të Bashkëpunimit Territorial dhe perspektivës së re IPA III 2021 – 2027, Shqipëria merr pjesë në tetë programe të bashkëpunimit territorial si më poshtë:

Tre programe IPA-IPA CBC:

- IPA CBC Maqedonia e Veriut – Shqipëri;
- IPA CBC Mali i Zi – Shqipëri;
- IPA CBC Shqipëri – Kosovë.



#### Dy programe bashkëpunimi ndërkufitar me Shtetet Anëtare:

- Interreg IPA CBC Greqi – Shqipëri;
- Interreg IPA CBC Itali – Shqipëri – Mali i Zi.

#### Tre programe transnacionale:

- Interreg ADRION (Adriatik – Jon);
- Interreg Euro MED
- Interreg URBACT

Gjatë gjithë këtij procesi është mbajtur parasysh se programet e reja duhet të financojnë projekte që do të kontribuojnë në zbatimin e reformave politike, ekonomike dhe institucionale në Shqipëri dhe njëkohësisht do të ndihmojnë Shqipërinë të ecë përpara në procesin e integritimit evropian brenda fqinjëve të saj. Në këtë drejtim, bashkëpunimi me shtetet anëtare të BE-së është veçanërisht i vlefshëm.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me SASPAC dhe me mbështetjen e Asistencës Teknike të projektit “Për forcimin e kapaciteteve për planifikimin, përgatitjen dhe implementimin e projekteve infrastrukturore në Shqipëri”, hartuan VKM-në Nr. 887, datë 27.12.2022 “Për menaxhimin e procedurave të investimeve publike”, e cila shfuqizoi VKM-në Nr. 185, datë 29.03.2018. Ndryshimet e sjella nëpërmjet kësaj VKM-je, synojnë të përmirësojnë procedurat e menaxhimit të investimeve publike, si edhe të ofrojnë mbështetje ligjore për Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP), e cila do të shërbejë si instrument për përzgjedhjen e projekteve bazuar në kritere që lidhen me dokumentet strategjike, prioritet e qeverisë dhe atyre sektoriale.

Përmirësimi cilësor i projektve, si edhe prioritizimi i tyre brenda listës korrespondon me rëndësinë në rritje të Fondit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF). Siç specifikohet në Strategjinë e BE-së për Zgjerimin në BP, datë 6 shkurt 2018, WBIF do të vazhdojë të jetë gjithnjë e më e rëndësishme në ofrimin e investimeve në rajon. Kështu WBIF po zhvillohet dhe po ndryshon (WBIF 3.0) në mënyrë që të përshtatet me perspektivën e re financiare të IPA III, 2021 – 2027.

#### **Përditësimi i kontributeve të Shqipërisë në Strategjinë e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR)**

Shqipëria ka intensifikuar gjithashtu pjesëmarrjen e saj në Strategjinë e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jon (EUSAIR), duke kontribuar në zbatimin, veçanërisht në kuadër të identifikimit të projektive me karakter rajonal.

Shqipëria mori Presidencën njëvjeçare të Iniciativës së Adriatikut dhe Jonit (AII) dhe Strategjisë së BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) më 1 qershor 2021. Gjatë periudhës njëvjeçare, Shqipëria ka stimuluar dhe veprime që synojnë thellimin e bashkëpunimit brenda komunitetit AII/EUSAIR për të gjetur zgjidhje të përbashkëta dhe për të trajtuar në mënyrë adekuate pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë, duke lehtësuar dhe mbështetur një

rimëkëmbje të qëndrueshme.

Në cilësinë e Kryesisë në Zyrën e AII/EUSAIR, Shqipëria ndërtoi praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra nga kryesimet e mëparshme. Ai do të vazhdojë të mbështesë procesin e përfshirjes në kuadrin e perspektivës së re financiare 2021 – 2027. Përafrimi i programeve të BE-së me prioritetet e EUSAIR është një qasje “win-win”. Siç thuhet në Deklaratën Izola, Bordi Drejtues do të monitorojë dhe vlerësojë nga afër rezultatet e procesit të përfshirjes. Në këtë drejtim, Shqipëria ka qenë në dialog të vazhdueshëm me Delegacionin e BE-së, si dhe midis vendeve tona dhe Autoriteteve Menaxhuese përkatëse për identifikimin e instrumenteve të mundshme dhe mundësive të financimit sipas IPA III për “flamurët (marrëveshjet) e EUSAIR”.

Për më tepër, Koordinatorët Kombëtarë si dhe përfaqësuesit e Shqipërisë në çdo Shtyllë (institucionet përgjegjëse për përfaqësimin e Shqipërisë në Shtyllat e Strategjisë) janë udhëzuar të përfshijnë prioritetet e EUSAIR në strategjitë e tyre sektoriale (ku është e mundur). Në nivel kombëtar, Shqipëria nuk ka asnjë mjet specifik monitorimi EUSAIR. Koordinatorët Kombëtarë monitorojnë zbatimin e Strategjisë nëpërmjet organizimit të takimeve periodike (dhe *ad hoc*) me përfaqësuesit e TSG të Shqipërisë.

Një nga sfidat kryesore që do të trajtohet menjëherë është të sigurohet që të mundësohet përfshirja e aktorëve nga niveli lokal dhe rajonal (si dhe shoqëria civile) në qeverisjen e Strategjisë EUSAIR (në një kapacitet këshillues). Gjithashtu, Shqipëria beson se pjesëmarrja në Strategji sjell përfitime për procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Procesi i zbatimit të Strategjisë EUSAIR ka nevojë për koordinim në baza të barabarta nga vendet anëtare dhe jo-anëtare.

#### *Përmbledhje e arritjeve kryesore*

Në kuadër të prioritzimit të politikave afatmesme, si fazë përgatitore për SKZHIE 2022 – 2030, është përgatitur dhe diskutuar Dokumenti i Politikës së Prioritetit 2023 – 2025, i cili siguron buxhetimin e prioriteteve dhe përcaktimin e taveve të PBA-së në periudhën afatmesme.

Nga viti 2022, Dokumenti i Politikës Prioritare 2023 – 2025 u përgatit nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), në varësi të Kryeministrit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim rregullimin e procesit të shpërndarjes së burimeve ndërmjet sektorëve.

Dokumentu i Politikës Prioritare 2023 – 2025 u diskutua nga Komiteti i Planifikimit Strategjik. Ky dokument përbën një fazë të ndërmjetme përpara përcaktimit të taveve buxhetore për planifikimin buxhetor afatmesëm, si dhe për përgatitjen e draft Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030. Procesi për përgatitjen e SKZHIE 2022 – 2030 bazohet në parimin e funksionimit të plotë të të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale që lidhen me Sistemin e Planifikimit të Integruar.

Analiza e Deklaratës së Politikës së Prioritetit bazohet në analizën e kryer në:

- Prioritetet e përcaktuara në dokumentet e kuadrit strategjik të vendit për sektorët/politika, të miratuara me VKM;
- Prioritetet e përcaktuara nga ministritë e linjës dhe nga Kryeministri, bazuar në Programin e miratuar të Qeverisë;
- Projektet strategjike prioritare të ministrive të linjës, pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP), miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik.

Procesi për përgatitjen e SKZHIE 2022 – 2030 bazohet në parimin e funksionimit të plotë të të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale që lidhen me Sistemin e Planifikimit të Integruar.

Platforma qeverisëse gjatë periudhës së zbatimit të SKZHIE II bazohej në një vizion për përshpejtimin e rritjes ekonomike, krijimin e vendeve të punës, rikthimin e besimit të qeveria, përparimin e mëtejshëm drejt anëtarësimit në BE dhe përmbushjen e nevojave urgjente të qytetarëve. Realizimi i këtij vizioni u mbështet nga miratimi i gjashtë prioriteteve kryesore për qeverinë, të cilat shoqërojnë në vazhdimësi reformat e kryera në këtë periudhë.

Përsa i përket mirëqenies inovative, një nga gjashtë prioritetet e qeverisë shqiptare për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social është transformimi i mënyrës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri nëpërmjet një qasjeje me në qendër qytetarin. Kjo është mishëruar në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2018 – 2022, e cila përbën kuadrin e përgjithshëm për modernizimin dhe transformimin e institucioneve dhe praktikave të administratës publike në vend, me vizionin e “ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative, në përputhje me kërkesat e integritetit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionistë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efikase”.

Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin është miratuar në korrik 2020 (Ligji nr. 102/2020). Ky ligj përcakton parimet bazë, objektivat, përgjegjësitë, rregullat e zhvillimit dhe kohezionit rajonal, si dhe kuadrin institucional e strategjik të këtij zhvillimi në Republikën e Shqipërisë. Sipas këtij ligji, zhvillimi rajonal realizohet në përputhje me parimin e partneritetit, subsidiaritetit, qëndrueshmërisë, planifikimit, programimit, transparencës, fokusimit dhe koordinimit. Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin synon:

- Të përcaktojë instrumentet e veçanta dhe kuadrin institucional e financiar për zhvillimin dhe kohezionin Rajonal në Republikën e Shqipërisë.
- Përcaktimi i kuadrit strategjik dhe institucional të hartimit afatgjatë rajonal.
- Politikat e zhvillimit në përputhje me politikat kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, social dhe kulturor rajonal.
- Të sigurojnë që autoritetet politikëbërëse të koordinojnë aktivitetet e tyre të planifikimit për të promovuar.
- Planifikimi rajonal i harmonizuar dhe i integruar.
- Sigurimi i harmonizimit të strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët të zhvillimit rajonal, duke e mbështetur atë me buxhetin përkatës.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, bazuar në përgjegjësinë e deleguar nga Zyra e Zëvendëskryeministrit po punon për plotësimin e akteve nënligjore që do të bëjnë të mundur zbatimin e ligjit për RDC.

Janë identifikuar 10 (dhjetë) akte nënligjore që rrjedhin nga ligji për krijimin e rajoneve të zhvillimit, ngritjen e bordeve të partneritetit dhe Komitetit Kombëtar për RDC, procedurat e planifikimit dhe programimit, strukturën dhe përmbajtjen, krijimin e autoritetit drejtues dhe organeve të ndërmjetme, mekanizmi financiar, databaza etj.

Në këtë kuadër, nga dhjetori 2020 deri në prill 2021, Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Zëvendëskryeministri i Shqipërisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) zhvilloi një cikël të 26 takime ndërgjegjësimi dhe konsultimi në 12 Rajonet e vendosura në 4 rajonet e zhvillimit të vendit.

Gjatë këtyre takimeve u konsultuan dhe u diskutuan 5 akte nënligjore që çuan në përgatitjen e draft VKM-ve nga ekipi i FSHZH-së me mbështetjen e asistencës teknike të projektit të qeverisë zvicerane dhe austriake për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri (RDPA).

Akti i parë nënligjor “Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit në Shqipëri dhe kufijve të tyre”, u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 459, 30.7.2021.

Akti i dytë nënligjor për krijimin e “Komitetit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal” është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 497, datë 27.07.2022.

Ndërkohë janë përgatitur edhe 3 projektvendime të tjera lidhur me:

1. Projektvendim i Këshillit të Ministrave për Politikën Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.
2. Projektvendim i Këshillit të Ministrave për Bordet e Monitorimit të Zhvillimit Rajonal.
3. Projektvendim i Këshillit të Ministrave për Strukturën dhe Procedurat e hartimit të Planit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal dhe Planet Rajonale për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal.

Këto drafte janë finalizuar dhe ka nisur një proces konsultimi zyrtar. Për shkak të vonësave në lidhje me COVID-19, raundi i dytë i procesit të konsultimit për këto akte nënligjore pritet të përmbillet në tremujorin e parë të vitit 2023. Parashikohet që procesi për miratimin e 3 akteve të mbetura nënligjore të mbyllet brenda muajit maj ose qershor 2023.

Nga dhjetori 2020 deri në prill 2021, u organizua një cikël prej 26 takimesh sensibilizuese në 12 Rajonet që ndodhen në 4 rajonet e zhvillimit të vendit. Ky proces u drejtua në thelb nga qasja “Informo – Komunikoj – Dëgjohet – Reflekto” për të adresuar nevojat lokale dhe rajonale për zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar përmes një sistemi që mundëson zbatimin e Politikës së Zhvillimit Rajonal dhe kohezionit. Gjatë këtij cikli prej 26 takimesh, 183 aktorë institucionalë dhe joinstitucionalë ishin pjesë e tryezës së diskutimeve, ku u diskutua për reformën e zhvillimit

rajonat, objektivat e politikave, nevojat dhe sfidat e komuniteteve lokale dhe rajonale drejt zhvillimit dhe kohezionit rajonal.

Pjesëmarrësit i fokusuan diskutimet e tyre në 2 drejtime kryesore:

- Nevojat dhe mekanizmat për investime, format dhe mënyrat se si Programi Operacional i Zhvillimit Rajonal do t'i adresojë këto nevoja. Ndërhyrjet në infrastrukturë (kryesisht infrastruktura rrugore, furnizimi me ujë dhe energji elektrike) u identifikuan si nevojat parësore për investime në të gjitha rajonet së bashku me nevojat për ngritjen e kapaciteteve për hartimin e projekteve/ndërhyrjeve, duke përfshirë zhvillimin dhe përgatitjen e studimeve të fizibilitetit.
- Diskutimet dhe propozimet konkrete për përmirësimin e akteve nënligjore, si përbërja e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal dhe Bordet e Monitorimit Rajonal, mënyra dhe forma e organizimit dhe funksionimit të tyre, nevoja për t'u përfaqësuar më mirë. Këto propozime shqyrtohen dhe pasqyrohen në draft dokumentet përkatëse.

Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin dhe aktet e tij nënligjore trajtojnë qartë përgjegjësitë e të gjitha institucioneve të përfshira në këtë proces.

Parimi për procesin e programimit që zbaton FSHZH (Fondi Shqiptar i Zhvillimit) është koordinimi dhe integrimi i programeve dhe ndërhyrjeve të ndryshme në një mënyrë që 1+1=3, që nënkupton maksimizimin e ndikimit në territor duke integruar ndërhyrje të ndryshme dhe burime financimi për arritjen e rezultatit maksimal. .

FSHZH po menaxhon disa programe të financuara nga buxheti i shtetit, kredi dhe grante. Fondet e buxhetit të shtetit për infrastrukturën rajonale dhe vendore përdoren për bashkëfinancimin e disa programeve zhvillimore në territor. Gjithashtu, disa programe të menaxhuara nga FSHZH si furnizimi me ujë financohen me kredi dhe bashkëfinancohen nga pushteti vendor në masën 10%.

Aktualisht nëpërmjet një programi të financuar nga Qeveria Zvicerane dhe Austriake, janë nisur nga FSHZH dy thirrje për propozime ku veprimet janë financuar 85% nga grantet dhe 15% nga bashkëfinancimi i bashkive lokale. Këto veprime konsiderohen si skema pilot që do të kapitalizohen dhe do të përsëriten gjatë përgatitjes dhe zbatimit të çdo Programi Operacional të Zhvillimit Rajonal të ardhshëm.

Komiteti i Planifikimit Strategjik dakordësoi në qershor 2022 Dokumentin e Politikave Prioritare 2023 – 2025, i cili përfshin projekte strategjike, pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP), që do të jetë pjesë e Buxhetit 2022 dhe Planit Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025 (PBA). Dokumenti i Politikave Prioritare 2023 – 2025 do të rishikohet çdo vit në përputhje me procedurën e hartimit të PBA-së.

Shtatë Komitete Sektoriale të Monitorimit, të krijuara për herë të parë në vitin 2019, tashmë janë plotësisht funksionale dhe organizojnë takime të rregullta dy herë në vit për secilin sektor. Për herë

të parë në vitin 2019 është bërë punë përgatitore për realizimin e Vlerësimit të Zbatimit të Projektit gjatë fazës së zbatimit të tyre (Vlerësimi i Ndërmjetëm). Ushtrimi i Vlerësimit nisi gjatë vitit 2020 dhe nxori raportin përfundimtar të vlerësimit “Qëndrueshmëria e projekteve të financuara nga BE në Shqipëri”, Vlerësimi i Programit, në shkurt 2021, i cili i është shpërndarë institucioneve përkatëse për ndjekjen e mëtejshme të tyre.

Në prill 2021, ka filluar vlerësimi i ndërmjetëm “Vlerësimi i veprimeve në kuadër të Menaxhimit Indirekt me Vendin Përfitues në kuadër të IPA II – Vlerësimi i Programit”. Drafti i raportit të ndërmjetëm është nxjerrë në shtator 2021, i cili u është shpërndarë institucioneve përkatëse për komente përpara se të dalë raporti përfundimtar.

Për herë të parë në buxhetin e vitit 2022 u vendos një fond i veçantë për të ndihmuar institucionet publike qendrore dhe lokale duke iu vendosur në dispozicion fonde për të mbuluar bashkëfinancimin, parafinancimin dhe rimbursimin e TVSH dhe detyrimeve të tjera. Deri në dhjetor 2022, ky fond u ezaurua në masën 100% (360 milionë lekë), duke zgjidhur kështu një problematikë të mbarur prej disa vitesh dhe duke i mundur përfituesve shqiptarë mundësinë e zbatimit dhe realizimit me sukses të projekteve me financim të huaj.

#### 22.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni drejtues për Kapitullin 22 është Ministria e Brendshme e mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Institucionet e mëposhtme janë të përfshira në Grupin Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 22:

- Ministria e Brendshme;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndhmës (SASPAC);
- Zyra e Zëvendëskryeministrit;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI);
- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Autoriteti Shqiptar i Auditimit;
- Autoriteti i Konkurrencës.

## 22.6 Mangësitë dhe prioritetet e identifikuara

### Mangësitë e identifikuara:

- Vendi nuk ka krijuar kuadrin institucional të kërkuar për zbatimin e politikës së kohezionit. Kjo përfshin përcaktimin dhe themelimin e të gjitha strukturave në nivel kombëtar dhe, sipas rastit, në nivel nën-kombëtar (Rajone/Bashki) të kërkuar nga Rregullorja (BE) 2021/1060 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 qershor 2021 që përcakton dispozita e përbashkët për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondi Social Evropian Plus, Fondi i Kohezionit, Fondi i Tranzicionit të Drejtë dhe Fondi Evropian i Detit, Peshkimit dhe Akuakulturës dhe rregullat financiare për ata dhe për Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetjen Financiare për Menaxhimin e Kufirit dhe Politika e Vizave.
- Kuadri institucional kërkon caktimin e autoritetit me përgjegjësi të përgjithshme për politikën e kohezionit, duke përfshirë, koordinimin e planifikimit, zbatimit, raportimit dhe vlerësimit të marrëveshjes së partneritetit dhe programeve operative. Nuk është marrë asnjë vendim për caktimin e organeve përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e instrumenteve strukturore – kërkohen autoritete menaxhuese, organe të ndërmjetme, trupa kontabël. Organet përgjegjëse për kontrollin financiar - autoriteti i auditimit, gjykata supreme e auditorëve duhet të pajisen me kornizën e nevojshme ligjore dhe institucionale.
- Nuk është ngritur sistemi i zbatimit me një përcaktim të qartë të detyrave dhe përgjegjësive të organeve të përfshira në zbatimin e politikës së kohezionit. Nuk është përgatitur përshkrim i detajuar i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit për zbatimin e programeve operative.
- Kapaciteti administrativ i autoriteteve të përfshira në programimin, zbatimin dhe kontrollin, monitorimin dhe raportimin e programeve operationale nuk është vlerësuar, analizuar dhe siguruar. Kapaciteti i duhur administrativ duhet të sigurohet në të gjitha strukturat përkatëse, duke marrë parasysh tre faktorët kryesorë që kanë ndikim në kapacitetin administrativ të administratës publike:
  - Arkitektura/strukturat (në veçanti caktimi i përgjegjësive dhe detyrave, delegimi, koordinimi, hartimi i politikave);
  - Burimet njerëzore (veçanërisht në lidhje me numrin dhe kualifikimet e personelit, përshkrimet e vendeve të punës, rekrutimin dhe trajnimin e stafit, vendosjen e masave për të mbajtur staf të kualifikuar dhe me përvojë, vlerësimin e bazuar në performancë dhe ndoshta shpërblimin);
  - Sistemet dhe mjetet (instrumentet, metodat, udhëzimet, manualet, sistemet e IT-së).
- Asnjë program për ngritjen e kapaciteteve nuk është hartuar për autoritetet dhe strukturat që do të përfshihen në zbatimin dhe menaxhimin e Politikës së Kohezionit të Fondeve Strukturore dhe Investimeve Evropiane.
- Kapaciteti administrativ i autoriteteve rajonale dhe lokale, partnerëve socialë dhe ekonomikë dhe përfaqësuesve të sektorit joqeveritar në cilësinë e tyre si partnerë në procesin e programimit dhe monitorimit, si dhe në procesin e zbatimit të politikës së kohezionit duhet të ndërtohen dhe forcohen.
- Për sa i përket programimit, vendi duhet të demonstrojë kuptim të mjaftueshëm të politikës

së kohezionit të BE-së 2021 – 2027 dhe aftësi për të përpunuar dokumente strategjike kombëtare në përputhje me politikën e kohezionit të BE-së. Programimi strategjik i politikës së kohezionit të BE-së 2021 – 2027 përfshin një marrëveshje partneriteti dhe programe operationale. Duhet të krijohet një afat kohor i mjaftueshëm i projekteve të maturuara, duke lejuar zbatimin e plotë financiar të programeve operationale. Mekanizmi i koordinimit dhe marrëdhëniet përkatëse të punës - rrjedha e informacionit dhe dokumenteve, mekanizmat e konsultimeve me ministritë e linjës, procedurat e vendimmarrjes do të përpunohen e hartohen mirë me shkrim.

- Vendi duhet të organizojë partneritete të gjera për përgatitjen e dokumenteve programuese. Partnerët që do të përfshihen në përgatitjen e dokumenteve të programimit strategjik do të zgjidhen sipas metodologjisë së përcaktuar paraprakisht duke siguruar transparencë dhe përfaqësim adekuat. Roli i partnerëve do të përcaktohet si pjesë e procesit të vendimmarrjes në takimet konsultative, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe mundësive të reagimit.
- Një sistem i integruar i kompjuterizuar i monitorimit dhe informacionit për të gjitha programet operative do të jetë plotësisht funksional me qëllim të monitorimit të zbatimit të politikës së kohezionit.
- Do të caktohet një zyrar i vetëm informativ. Do të përpunohet një strategji e përbashkët komunikimi në përputhje me rregullat për informacionin dhe komunikimin, siç përcaktohet në kuadrin rregullator në fuqi.

#### Prioritetet për Kapitullin 22:

- Përgatitja, miratimi nga Qeveria dhe zbatimi i udhërrëfyesit/roadmap për përgatitjen e zbatimit të politikës së kohezionit, duke marrë parasysh qasjen specifike organizative dhe ngritjen e përshtatshme të saj.
- Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Veprimit të detajuar me një plan kohor, duke përcaktuar objektiva dhe afate kohore të qarta për të adresuar mangësitë e identifikuara në përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga Politika e Kohezionit të BE-së.
- Emërimi i institucioneve dhe organeve për zbatimin e politikës së kohezionit që do të mundësojë hartimin dhe zbatimin e programeve për ngritjen e kapaciteteve.
- Përgatitja për zbatimin efektiv të *acquis* të BE-së sipas Kapitullit 22 dhe faktorizimi i kërkesave të fondeve të ardhshme strukturore/kohezionit në strukturën institucionale, sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kapacitetin administrativ, duke siguruar që të gjitha instrumentet dhe fondet e tij janë duke u bërë gradualisht në përputhje me kërkesat e BE-së për sa i përket programimit dhe parimeve të partneritetit.
- Krijimi i një sistemi menaxhimi dhe kontrolli për zbatimin e IPA III, siç kërkohet nga Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) dhe Marrëveshja e Partneritetit të Kornizës Financiare ndërmjet Komisionit Evropian dhe Shqipërisë (ratifikuar në maj 2022), përfshirë. Marrëveshjet ndërinstitucionale të lidhura ndërmjet organeve që përbëhen nga struktura dhe autoritete për menaxhimin indirekt të IPA III, procesi i besimit të detyrave të zbatimit të buxhetit të përfunduara, rregullat dhe procedurat kombëtare për zbatimin e IPA III janë në fuqi dhe programet shumëvjeçare dhe vjetore për



IPA III janë përgatitur dhe në zbatim.

- Të vazhdohet me strategjinë dhe planin kombëtar për zhvillimin dhe kohezionin rajonal (2021 – 2027) dhe të plotësohen planet e zhvillimit rajonal (2021 – 2024) të cilat duhet të nxisin potencialin zhvillimor nëpërmjet ndërhyrjeve të decentralizuara të bazuara në plane dhe strategji të integruara lokale dhe/ose rajonale.
- Përfundimi, miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2020 – 2030.
- Sqarimi i përgjegjësive ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore në përputhje me progresin e arritur në decentralizimin dhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të organeve qendrore, rajonale dhe vendore, veçanërisht në nivel qendror dhe në veçanti duke siguruar personel adekuat dhe duke rishikuar strukturën e pagave të qeverisjes vendore dhe prioritizimi i decentralizimit fiskal në agjendë.

## KAPITULLI 33: DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

### 33.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull mbulon rregullat që disiplinojnë fondet e buxhetit të BE-së ('burimet vetjake'). Këto burime konsistojnë kryesisht në: i) kontribute të bazuara në të ardhurat kombëtare bruto të secilit Shtet Anëtar; ii) detyrimet doganore; dhe iii) një burim bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar. Shtetet Anëtare duhet të kenë kapacitetet e duhura administrative për të koordinuar në mënyrë adekuate dhe për të garantuar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e burimeve vetjake.

### 33.2 Struktura e kapitullit

#### Burimet vetjake tradicionale

### 33.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Neni 70 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së, ku gjithashtu përfshihet dhe legjislacioni i BE-së për këtë kapitull.

Sa i përket *acquis*, ky kapitull përfshin rregulloret në lidhje me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së ('burimet vetjake'). Këto burime përbëhen nga të ashtuquajturat burimet tradicionale vetjake. *Acquis* në këtë fushë është direkt detyrues dhe nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar.

### 33.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka **njëfarë niveli përgatitje** në këtë fushë. **Njëfarë përparimi** është arritur në përafrimin me *acquis* të BE-së në fushat themelore të politikave që ndikojnë në funksionimin e sistemit të financimit të BE-së. Shqipëria publikon rregullisht treguesin e Produktit të Brendshëm Bruto dhe atë të të Ardhurave Kombëtare Bruto duke ndjekur metodologjinë e ESA 2010 dhe kryen përmirësime të vazhdueshme metodologjike për sa i përket përafrimit me standardet ESA 2010.

Shqipëria ka shënuar përparim në fushat bazë të politikave që ndikojnë indirekt në sistemin e **burimeve vetjake** (kapitujt: 16 Tatimet, 18 Statistikat, 29 Bashkimi Doganor dhe 32 Kontrolli financiar).

Në lidhje me **burimet e veta**, Shqipëria ka konsoliduar strukturat për mbledhjen e detyrimeve tatimore dhe doganore, përkatësisht Administratën Tatimore dhe atë Doganore. Prej vitit 1996, Shqipëria ka një sistem kombëtar të TVSH-së, të përafuar me Direktivën 6 të BE.

Shqipëria, e suportuar nga Departamenti i Çështjeve Fiskale të FMN, ka hartuar Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, e cila përmbledh reformat kryesore në fushën e politikave tatimore dhe administrimit tatimor dhe atij doganor, me synim rritjen e të hyrave të buxhetit me 3% të PBB-së brenda një periudhe afatmesme, dhe me objektivin për tejkalimin e nivelit 30% të të ardhurave të buxhetit në raport me PBB-në.

INSTAT transmeton rregullisht vlerësimet e treguesve të PBB-së dhe të treguesit të të Ardhurave Kombëtare Bruto (GNI) në EUROSTAT. Progres i vazhdueshëm është bërë në përafrimin me standardeve të përpilimit të llogarive kombëtare me standardet e kërkuara ESA 2010. Fokus i vazhdueshëm janë përmirësimet metodologjike duke përfshirë përmirësimet metodologjike të ekonomisë së pavrojtuar si dhe përmirësimet në kuadër të përmbushjes së kërkesave të transmetimit të treguesve sipas ESA 2010 Programi i Transmetimit.

Gjatë vitit 2022, INSTAT përveç tabelave të reja të dërguara, u fokusua gjithashtu edhe në përmirësimin e cilësisë dhe variablave, që janë pjesë e Programit të Transmetimit ESA 2010.

Shqipëria nën asistencën teknike të ofruar nga EUROSTAT nëpërmjet projekteve IPA MB ka punuar në drejtim të përmirësimeve metodologjike në vlerësimin e komponentëve të ekonomisë së pavrojtuar si dhe ka kryer vlerësime eksperimentale mbi aktivitetet e paligjshme dhe auditimin fiskal. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtorja e Përgjithshme e Doganave kanë vijuar punën për evidentimin e evazionit fiskal dhe mashtrimin. Stafi merr pjesë në trajnime të organizuara nga Akademia Fiskale, duke përfshirë procesin e fiskalizimit. Në janar 2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është krijuar një Njësi e posaçme Kundër Informalitetit.

Me Ligjin nr. 81/2022, datë 24.11.2022, “Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar u bënë ndryshime në disa zëra të akcizës, u hoq akciza për

akumulatorët e automjeteve elektrike, hiqet diferencimi dhe unifikohet niveli/shkalla e taksimit për birrën dhe për pijet e forta alkoolike (Spirituos Beverages), politika për të cilat pritet që, impakti të jetë pozitiv në rritjen e qëndrueshme të të ardhurave të buxhetit të shtetit, unifikimin gradual të nivelit kombëtar të akcizave me ato të vendeve të rajonit.

INSTAT, në koordinim me Bankën Qendrore të Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), ka përgatitur dhe publikuar në vitin 2019 “Politikat e Harmonizuara të Revizionimit” për Statistikat Makroekonomike.

INSTAT ka publikuar në faqen zyrtare, inventarin e Burimeve dhe Metodave të përdorura në Llogaritë Kombëtare, duke përdorur strukturën e një inventari burimesh të rekomanduar nga EUROSTAT. Ky inventar është përditësuar me të gjitha aktivitetet e realizuara deri tani mbështetur në raportet përfundimtare të çdo projekti statistikor të vlerësuar nga EUROSTAT, në kuadër të projekteve pilot IPA shumë-përfituese.

Shqipëria po punon për revizionimin madhor të treguesve të Llogarive Kombëtare në vitin 2024 i cili do të konsistojë në përmirësime metodologjike, vlerësim të treguesve të rinj dhe përmirësim të vlerësimit të treguesve ekzistues. Përditësimi i inventarit i cili përshkruan burimet dhe metodat e përdorura për vlerësimin e treguesit të të ardhurave kombëtare bruto (GNI Inventory) do të jetë pjesë e këtij procesi.

INSTAT transmeton në mënyrë të rregullt, në prill dhe në tetor të çdo viti, tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkalluar sikurse kërkohen nga Eurostat për vendet kandidatë për në BE. Këto të dhëna janë dërguar në Eurostat në formë eksperimentale dhe jo për publikim.

INSTAT ka vijuar punën për përmirësimin e të dhënave të procedurës së deficitit të tejkalluar (EDP tables) dhe të statistikave financave të qeverisë sipas kërkesave të ESA 2010 dhe manualit për deficitin dhe borxhin e qeverisë.

Në lidhje me **infrastrukturën administrative**, MFE ka përgjegjësinë e përgjithshme për çështjet financiare dhe buxhetore. INSTAT në zhvillimin dhe prodhimin e statistikave makroekonomike mbështetet nga buxheti i shtetit dhe asistenca e programit IPA shumëpërfituese në fushën e projekteve statistikore.

### 33.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (lider i kapitullit);
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
4. INSTAT.

### 33.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Përsa i përket **burimeve vetjake**, Shqipëria duhet të finalizojë Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS), që ishte parashikuar të miratohej në vitin 2020. Miratimi i strategjisë u shty në kohë për shkak të:

- (i) pasojave në ekonominë e vendit, si pasojë e tërmetit të fund vitit 2019;
- (ii) pasojave të Pandemisë globale të Covid 19 në ekonomi; dhe
- (iii) pasojave në ekonominë e vendit të luftës Rusi-Ukrainë.

Megjithatë, në fushën e politikave tatimore, nga janari i vitit 2022 ka filluar implementimi i masave të parashikuara në MTRS, fillimisht në fushën e akcizave, dhe do vazhdojë në vitin 2023 në tatimet direkte mbi të ardhurat e individëve dhe korporatave. Më tej, kjo strategji do zbatohet edhe për ndryshimet e projektuara në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Ndërkohë, në administrimin tatimor dhe doganor, masat e parashikuara në MTRS po zbatohen, ku më sinjifikative janë zhvillimet në fushën e fiskalizimit, implementimit të e-invoicing, reduktimit të barrierave burokratike dhe zgjerimit të ndjeshëm të shërbimeve elektronike. Rezultatet në reforma janë materializuar në rritjen e të ardhurave të buxhetit, të cilat në 2022 arrijnë në 28.2% të GDP-së, në vitin 2023 janë projektuar 29% e GDP-së, ndërkohë që në vitin 2019, si vit referues i fillimit të reformës, kanë qenë në nivelin 27.2% e GDP-së. Shqipëria po ecën me hapa të sigurtë drejt rritjes dhe përmirësimit të burimeve vetjake, të cilat do t mbështesin buxhetet respektive në vite.

Përpyekje të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar përputhshmërinë me ESA 2010 dhe për të filluar punën për krijimin e Inventarit të GNI-së në përputhje të plotë me rekomandimet e Eurostat-it.

Përpyekje të vazhdueshme nevojiten për të garantuar marrjen e masave efektive për formalizimin e ekonomisë informale, përmirësimin e shterimit të llogarive kombëtare dhe llogaritjet e PBB/GNI dhe për të luftuar evazionin fiskal dhe mashtrimin me detyrimet doganore.

Përpyekje të mëtejshme nevojiten në drejtim të rritjes së plotëshmërisë së tabelave të njoftimit të procedurës së deficitit të tejkalluar (EDP tables) dhe përmirësimeve në drejtim të statistikave financave të qeverisë.

Për **infrastrukturën administrative**, Shqipëria do të duhet të punojë për krijimin e institucioneve përkatëse të përfshira në sistemin e burimeve të veta, një organ koordinues të burimeve të veta dhe rregullave zbatuese. Këto nevojiten për të siguruar që, me anëtarësimin, do të jetë në gjendje të, llogarisë, parashikojë, mbledhë, paguajë, kontrollojë dhe të raportojë pranë BE-së mbi burimet e veta, në përputhje me *acquis*.

Në kuadër të procesit *Screening*, për kapitullin 33 ende nuk janë përgatitur ende Analiza e Mangësive Ligjore dhe Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative. GNPI e kapitullit 33 ka kërkuar asistencë teknike të dedikuar për kryerjen e kësaj analize.

Lidhur me prioritet Shqipëria:

- Duhet të vijojë me harmonizimin e të dhënave të Llogarive Kombëtare me ESA 2010 (Sistemi Evropian i Llogarive) dhe përmirësimin e transmetimit të të dhënave në Eurostat sipas programit të transmetimit ESA 2010.
- Duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me dispozitat e BE-së për TVSH-në dhe detyrimet doganore dhe të forcojë përpjekjet për të luftuar evazionin fiskal.
- Të forcojë kapacitetet administrative dhe mekanizmat e koordinimit ndërmjet aktorëve kryesorë në sistemin e burimeve vetjake.

Në fokus është dhe zhvillimi i mëtejshëm i burimeve të brendshme, burimeve të cilat bazohen në tatimin mbi vlerën e shtuar si dhe i atyre burimeve që lidhen me të ardhurat e brendshme bruto.

## GRUPIMI VI: MARRËDHËNIET ME JASHTË

### KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

#### 30.1 Përmbajtja e kapitullit

*Acquis* në këtë fushë përbëhet kryesisht nga legjislacioni direkt detyrues i BE-së i cili nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar. Ky legjislacion i BE-së rezulton nga angazhimet tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe të BE-së, si dhe nga një numër masash autonome preferenciale tregtare. Në fushën e ndihmës humanitare dhe politikës së zhvillimit, Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë legjislacionin e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë aftësinë për të marrë pjesë në politikat e zhvillimit dhe humanitare të BE-së. Vendet aplikuese u kërkohet të harmonizojnë në mënyrë progresive politikat ndaj vendeve të treta dhe pozicionet brenda organizatave ndërkombëtare në lidhje me politikat dhe pozicionet e miratuara nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij.

#### 30.2 Struktura e kapitullit

- Politika tregtare;
- Bashkëpunimi për zhvillim dhe ndihma humanitare.

#### 30.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70-të i MSA-së, dispozitë nga e cila Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së, por edhe të sigurohet që ajo të zbatohet.

Marrëveshja Stabilizim-Asociimit (MSA) përfshin një titull kryesor mbi tregtinë e lirë mes Shqipërisë dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë që palët të veprojnë në përputhje me rregullat e OBT-së ose të detyrimeve ndërkombëtare. Detyrimet e Shqipërisë sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare në mënyrë të përmbledhur janë nenet relevante të MSA-së për këtë kapitull, si: 7, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 33, 34, 40, 59, 60, 70, 71, 72, 73, 74 dhe 97.

Legjislacioni në fushën e politikës së përbashkët tregtare përbëhet kryesisht nga zbatimi i drejtpërdrejtë i legjislacionit të BE-së, i cili nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar.

*Acquis* në këtë fushë është produkt kryesisht i angazhimeve tregtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të Bashkimit Evropian si dhe i një sërë masash autonome tregtare. Në fushën e kredive të eksportit

dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, disa elementë të *acquis* kërkojnë përgatitje më të hershme për të pasur një administratë plotësisht të aftë që nga dita e anëtarësimit. Vendeve kandidate u kërkohet të harmonizojnë në mënyrë graduale politikat tregtare ndaj vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare, me politikat dhe qëndrimet e miratuara nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij, në mënyrë që të jenë në gjendje të zbatojnë politikën e përbashkët tregtare të BE-së në datë e anëtarësimit. Në fushën humanitare dhe të zhvillimit, Shtetet Anëtare duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me angazhimet ndërkombëtare të BE-së si dhe të sigurojnë kapacitetet për të marrë pjesë në zhvillimet dhe politikat humanitare të Bashkimit Evropian.

#### 30.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

##### **Situata aktuale në Shqipëri**

Në Raportin për Shqipërinë që Komisioni Evropian nxori në tetor 2022, evidentohet se Shqipëria **ka një nivel të mirë përgatitjeje**. Gjatë periudhës raportuese është **bërë progres**, veçanërisht në lidhje me vazhdimin e përafrimit të legjislacionit në fushën e mallrave me përdorim të dyfishtë me *acquis* përkatëse të BE-së.

Për shkak të progresit të arritur në zbatimin e masave në lidhje me zbatimin e Protokollit Shtesë 5 për lehtësimin e tregtisë të parashikuar në Planin e Veprimit 2021 – 2024, për krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, rekomandimet për vitin 2022 janë fokusuar në zbatimin e mëtejshëm të Protokollit Shtesë 6 të CEFTA-s në tregtinë e shërbimeve, dhe përfundimi dhe miratimi i Protokollit 7 të CEFTA-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Është bërë progres i mirë në adresimin e rekomandimeve të vitit 2021 në lidhje me zbatimin e veprimeve sipas Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR) 2021-2024 për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale, si dhe zbatimin e vazhdueshëm të Planit Kombëtar të Veprimit për Lehtësimin e Tregtisë.

Shqipëria vazhdoi të zbatojë angazhimet e CEFTA-s në lidhje me protokollet shtesë (AP) 5 dhe 6. Shqipëria vazhdoi fushatën e saj ndërgjegjësuere me përfaqësuesit e sektorit privat në lidhje me procedurat dhe përfitimet e aplikimit për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar (OAE) dhe ka regjistruar 16 aplikime nga bizneset vendase. Tetë operatorët e parë ekonomikë të autorizuar janë certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe janë vlerësuar pozitivisht nga komisioni i validimit të CEFTA-s. Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë në negociatat për CEFTA AP 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Në politikën e përbashkët tregtare, Shqipëria ka vazhduar të koordinojë pozicionin e saj për zhvillimet tregtare në sistemin shumëpalësh të tregtisë së OBT-së me Komisionin Evropian. Në këtë drejtim, Shqipëria ka mbështetur dhe sponsorizuar disa nisma dhe deklarata të OBT-së të mbështetura nga Komisioni Evropian, si:

- Iniciativa për Rregullimin e Brendshëm të Shërbimeve – Pas koordinimit me të gjitha institucionet përkatëse që mbulojnë sektorët e shërbimeve, më 22 nëntor 2021 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka qarkulluar në OBT Planin e rishikuar të Angazhimeve Specifike duke ndërmarrë angazhime shtesë në lidhje me Seksionin II dhe Seksionin III të Dokumentit Referencë mbi Rregulloren e Brendshme.
- Iniciativa për Tregti dhe Shëndetësi.
- Iniciativa për Tregtinë dhe Diskutimet e Strukturuar Mjedisore.
- Dialogu jozyrtar mbi ndotjen plastike dhe tregtinë e plastikës të qëndrueshme për mjedisin (IDP).
- Nisma për subvencionimin e lëndëve djegëse fosile.
- Deklaratë e përbashkët ministrore për lehtësimin e investimeve për zhvillim

Qeveria shqiptare ka dorëzuar rregullisht notifikimet përkatëse pranë sekretariatit të OBT-së, bazuar në kërkesat e notifikimeve të Marrëveshjeve të OBT-së.

Për shkak të situatës së pandemisë Covid 19, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Urdhrin Nr. 131 datë 08.03.2020, ka miratuar masën e përkohshme “Për ndalimin e eksportit të barnave dhe pajisjeve mjekësore”. Me përmirësimin e situatës pandemike në vend, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nxjerrë një urdhër të ri nr. 324 datë 06.07.2021, me të cilin ka shfuqizuar masën. Kështu Urdhri nr. 131 datë 08.03.2020, “Për ndalimin e eksportit të barnave dhe pajisjeve mjekësore”, nuk është më në fuqi që nga 6 korrik 2021.

Grupi ndërinstitutional i Koordinimit të Politikës Tregtare dhe Lehtësimit të Tregtisë, i krijuar tashmë, është rikompozuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 104 datë 7.08.2020, po punon dhe në aspekt të rëndësishëm të lehtësimit të tregtisë, për t’iu përgjigjur zhvillimit intensiv të CEFTA-s për zbatimin e Protokollit Shtesë 6 “Për Tregtinë e Shërbimeve”. Ky grup ndërinstitutional ka përfshirë përfaqësues të biznesit nga sektori i turizmit dhe përfaqësues të biznesit të përpunimit të qumështit.

Puna ka vazhduar për zbatimin e planit kombëtar të veprimit për koordinimin dhe lehtësimin e politikave tregtare 2021 – 2023. Sekretariati teknik ka bashkëpunuar ngushtë me anëtarët e Komitetit. Më 22 tetor 2021, u mbajt mbledhja e 12-të e Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë. Në takim u raportua për punën e bërë në zbatimin e Planit Rajonal të Veprimit 2021 – 2024 për krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, për korridoret e gjelbra, u prezantua raporti rajonal për masat jotarifore të përgatitur nga GIZ, si dhe puna rajonale për lehtësimin e tregtisë së shërbimeve. U prezantua puna që po bëhet në CEFTA për uljen e koston së tregtisë dhe përfaqësuesit e bizneseve u ftuan të evidentojnë kostot tregtare me të cilat përballen për t’i konstatuar dhe për të diskutuar me palët e CEFTA-s për uljen e tyre.

Përfaqësuesit e bizneseve kanë paraqitur shqetësimin e tyre për barrierat me të cilat ballafaqohen gjatë aktiviteteve të tyre ditore, veçanërisht për kohën e pritjes në kufi për eksportin e produkteve të tyre, koston e zhdoganimit të mallrave dhe njohjen e certifikatave sanitare dhe fitosanitare.



Shqipëria ka vazhduar fushatën e saj ndërgjegjësuere me përfaqësues të sektorit privat në lidhje me procedurat dhe përfitimet e aplikimit për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar (OEA) dhe ka regjistruar 12 aplikime nga bizneset vendase.

Gjithashtu, Qeveria krijoi një mekanizëm për zbatimin dhe monitorimin e REA dhe më vonë, të Tregut të Përbashkët Rajonal. Gjithashtu, është punuar në drejtim të lehtësimit të tregtisë elektronike rajonale dhe në drejtim të njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale, duke filluar nga inxhinierët e ndërtimit si dhe në krijimin e një grupi pune për liberalizimin e tregtisë në sektorin e turizmit. Së bashku me palët e tjera të CEFTA-s, Shqipëria ka punuar për zgjerimin e korsive/korridoreve të gjelbra me shtetet anëtare të BE-së, përkatësisht me Greqinë në pikën kufitare Kapshticë – Kakavijë; ka përgatitur dhe dërguar në Sekretariatit e CEFTA-s listën prioritare të produkteve farmaceutike, vaksinave dhe testit për COVID që do të kalojnë nëpër korridoret e gjelbra.

**Në fushën e kontrollit të eksportit për artikujt me përdorim të dyfishtë**, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për mallrat me përdorim të dyfishtë.

Korniza ligjore përbëhet nga Ligj Nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, që përafrohet pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 428/2009 datë 5 maj 2009, “Mbi vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të mallrave me përdorim të dyfishtë”.

Bashkimi Evropian ka miratuar Rregulloren e re (BE) 2021/821 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 20 Majit 2021 “Mbi vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të mallrave me përdorim të dyfishtë”, për këtë qëllim, Autoriteti i kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), ka nisur konsultimet me partnerët e BE-së për të identifikuar të rejat e kësaj rregulloreje si dhe për të parashikuar afatin e transpozimit të këtyre ndryshimeve. Gjatë vitit 2022 Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve dhe institucione të tjera të përfshira si Doganat, Ministria e Punëve të Jashtme, kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Programi EU P2P Për kontrollin e Eksporteve për mallrat me përdorim të dyfishtë, me fokusin ndryshimet dhe risitë e Rregullores 2021/821 (EU).

Legjislacioni që ka të bëjë me Rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 16.1.2019 “Për tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese” i ndryshuar është në proces hartimi dhe synohet të përafrohet plotësisht nga projektligji “Për tregtimin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese” dhe projektvendimi “Për miratimin e listës së mallrave të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues”. Projektligji gjatë vitit 2021 u konsultua me shërbimet e Komisionit Evropian dhe u reflektuan amendimet dhe sugjerimet e Komisionit në projekt draft. Gjatë vitit 2022 ky projektligj

u konsultua me të gjitha ministratë relevante, dhe tashmë është në fazën finale për tu miratuar në Këshillin e Ministrave. Ky process pritet të përmbyllet brenda vitit 2023.

#### **Aktualisht janë miratuar:**

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 668 datë 10.11.2021 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare” që përafrojnë plotësisht Aneksin 1 të Rregullores e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) 2021/821, datë 20 Maj 2021, “Për krijimin e një regjimi komunitar për kontrollin e eksporteve, transferimeve, ndërmjetësimeve dhe transiteve të artikujve me përdorim të dyfishtë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 31 datë 22.01.2020 “Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si përcaktimin e procedurave lidhur me lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror”.

Ky vendim ka miratuar:

- statusin, organizimin, përbërjen dhe funksionimin të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;
- afatet, mënyrën dhe të procedurën për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara;
- procedurat për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror.

**Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit ekonomik dhe teknik,** Republika e Shqipërisë ka nënshkruar më shumë se 120 marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik me vende të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe, janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi disa marrëveshje mbi bashkëpunimin ekonomik dhe/ose tregtar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Turqinë.

Deri më tani, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar 46 marrëveshje investimi dypalëshe , marrëveshje të cilat ndikojnë në investimet e huaja dhe mbrojtjen reciproke të tyre në vend, nga të cilat 23 janë nënshkruar me shtetet anëtare të BE-së. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve janë: Austria, Azerbajxhani, Unioni Ekonomik Belgjikë-Luksemburg, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kina, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Emiratet e Bashkuara Arabe, Egjipti, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Izraeli, Italia, Korea, Kuvajti, Kosova, Lituania, Maqedonia, Malajzia, Malta, Moldavia, Holanda, Polonia, Portugalia, Katari, Rumania, Federata Ruse, San Marino, Serbia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Tunizia, Turqia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sa i takon marrëveshjeve në proces, Shqipëria ka në proces negocimi projekt marrëveshjen midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite mbi nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve. Aktualisht palët janë në fazë negocimi të tekstit të kësaj marrëveshje.

***Në fushën e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare***, Shqipëria nuk ka ende një kuadër politik ose ligjor, si dhe asnjë institucion apo njësi specifike për menaxhimin e ndihmës për zhvillim apo ndihmave humanitare. Ai siguron ndihmë humanitare vetëm në baza ad-hoc si përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore të rënda ose situatave të jashtëzakonshme humanitare. Kjo ndihmë jepet drejtpërdrejtë në mbështetjen përkatëse të buxhetit të shtetit. Ligji i vitit 2001 për Organizatat Jo-Fitimprurëse njeh aktivitetet e mundshme të organizatave të tilla në fushën e ndihmave humanitare dhe i lejon ata të kryejnë veprimtari zhvillimi dhe ndihme humanitare në Shqipëri dhe diku tjetër.

### **Përmbledhje e arritjeve kryesore**

Puna ka përparuar për zgjerimin e Korsive të Gjelbra/Korridoreve me Shtetet Anëtare të BE-së. Shqipëria miratoi listën e saj kombëtare të kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë në përputhje me *acquis* të BE-së.

Katër operatorët e parë ekonomikë të autorizuar janë certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe kanë filluar përgatitjet për njohje reciproke nga palët e CEFTA-s. Shqipëria vazhdoi të punojë në përputhje me angazhimet e saj në kuadër të Planit Shumëvjeçar të Veprimit të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale (REA). Është bërë përpjekje për të reduktuar kohën e pritjes në pikat kufitare të kamionëve dhe për të harmonizuar orarin e punës së të gjitha autoriteteve inspektuese me palët fqinje CEFTA. Aktualisht, autoritetet shqiptare po shqyrtojnë një projekt pilot për zgjerimin e korridoreve të gjelbra midis portit të Durrësit dhe atij italian të Ankonës.

Në zbatim të Planit të Veprimit për Krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, Shqipëria ka miratuar projektvendimin Për miratimin në parim të Vendimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore “Për lehtësimin e Tregtisë Elektronike” – VKM 550 datë 29.9.2021.

Progresi i arritur veçanërisht në transparencën rregullatore, përmirësimin e konsultimeve publike në hartimin e politikave tregtare dhe zhvillimin dhe koordinimin e politikave tregtare. Mekanizmi i koordinimit ndër-institucional të ekonomisë është forcuar përmes miratimit të rregullave dhe procedurave të reja për Komitetin Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë (NTFC).

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 104/2020, është krijuar Sekretariati Teknik me përfaqësues të sektorit të Tregtisë në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe të administratës doganore. Deri më tani, janë mbajtur dy takime online të NCTF, përkatësisht në dhjetor 2020 dhe mars 2021 dhe një takim me prezencë më 22 tetor 2021. Plani Kombëtar i Lehtësimit të Tregtisë 2021–2023 u miratua më 30 qershor 2021, që përmban jo vetëm detyrimet për lehtësimin e tregtisë

sipas Marrëveshjes CEFTA por edhe masat për adresimin e çështjeve të ngritura nga përfaqësuesit e biznesit.

Faqja e internetit e NCCLTT është funksionale (<http://tregtia.gov.al/index.php/sq-al/>).

Shqipëria tashmë po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e MSA-së) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendeve të Evropës Lindore (CEFTA 2006), vendeve të EFTA-s dhe Turqisë. Shqipëria..

Për sa i përket zbatimit të Planit të Veprimit 2021 – 2024, për vitin 2022 është vazhduar puna për masat e mëposhtme:

- Programet e validimit të OAE: Rezultatet e misionit të validimit për programin OAE të Shqipërisë u miratuan nga Komiteti i Lehtësimit të Tregtisë i CEFTA-s në mbledhjen e tij më 29 qershor 2022. Misioni i vlefshmërisë u zhvillua në datat 7-10 qershor në Tiranë, dhe validuesit konstatuan se programi është në përputhje me acquis të BE-së. Përfaqësuesit e DG TAXUD gjithashtu morën pjesë në misionin e validimit si vëzhgues. Janë në shqyrtim 8 kompani që kanë përfituar statusin OEA dhe 10 aplikime të tjera.
- Për harmonizimin e orarit të punës së Agjencive Kufitare të përfshira në zhdoganimin e mallrave, do të vazhdojë puna në nivel ekspertësh të agjencive të përfshira.
- Zgjerimi i korsive të gjelbra me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shtetet anëtare të BE-së me kufij me vendet e Ballkanit Perëndimor: Më 9 shtator 2022 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Administratës Doganore të Shqipërisë dhe Agjencisë së Doganave dhe Monopoleve të Akcizave të Italisë (ADM).
- Zbatimi i vendimit për lehtësimin e tregtisë së frutave dhe perimeve: ka vazhduar puna për përgatitjen e udhëzimeve që detajojnë proceset e detyrueshme të njoftimit, certifikimit dhe monitorimit të tregtisë së fruta-perimeve. Puna për planifikimin dhe kryerjen e anketave për dëmtuesit me prioritet, fitosanitar, përgatitjen e planeve të emergjencës, planeve shumëvjeçare të kontrollit, procedurat e auditimit është duke u zhvilluar.
- Implementimi i programit SEED +: Puna është fokusuar në Përgatitjen e projektit pilot që kërkon përfshirjen e ekipit të projektit SEED por edhe të institucioneve Fitosanitare. Aktivitetet përgatitore po zhvilloheshin në dy pista paralele, duke mbledhur informacionin e nevojshëm nga Përfituesit (p.sh., administratorët, operatorët, inspektorët, etj.) dhe përgatitja teknike e mjedisit dhe vetë aplikacionit të CEFTA TRACES NT. Janë organizuar disa takime dhe seminare me ekipin e përfituesve të përfshirë, në mënyrë që të finalizohet marrëveshja dhe plani për zbatimin e pilotit.
- Përgatitja e aplikacionit në aspektin teknik kërkonte përfshirje të konsiderueshme të numrit të ekspertëve për detyra të ndryshme – nga konfigurimi deri te përkthimi i softuerit në të gjitha gjuhët e CEFTA-s. Palët më aktive gjatë pilotimit ishin Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Puna do të vazhdojë me të gjithë përfituesit për testimin e sistemit dhe për përgatitjen e Udhërrëfyesit për komunikimet pa letra (eCertificate).
- Ka filluar puna për përzgjedhjen e sektorëve të produkteve industriale për të cilët do të bëhet njohja reciproke, për të cilat u mbajt një takim teknik në Beograd më 21 shtator 2021. Përzgjedhja e sektorëve kyç sipas fitimit ekonomik dhe nivelit të vlerësuar të cilësisë së

infrastrukturës, të tilla si produktet elektrike, makineritë dhe pajisjet nën presion, tekstilet dhe këpucët ose produktet e ndërtimit, si sektorët më të preferuar për t'u marrë në konsideratë. Shqipëria në propozimet e saj ka shprehur interes për sektorët e produkteve elektrike, makinerive, tekstileve dhe këpucëve.

- Po vazhdon puna për përgatitjen e Projektvendimit të Komisionit të Përbashkët për kostot tregtare, me qëllim uljen e kostove të inspektimeve doganore, sanitare dhe fitosanitare etj., në tregtinë e mallrave ndërmjet vendeve. Është krijuar një grup pune ekspertësh për të diskutuar këtë vendim në nivel teknik.

## **Zbatimi i Protokollit Shtesë të CEFTA-s (AP) 6 për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve**

Rishikimi i Protokollit Shtesë 6: me mbështetjen e asistencës teknike të GIZ-it, ekspertët kanë përgatitur raportin për secilën palë individuale të CEFTA-s dhe një raport rajonal mbi gjetjet e rezultuara nga shqyrtimi i kuadrit ligjor vendas në sektorin e shërbimeve dhe angazhimet e palëve, sipas AP6. Sekretariati i CEFTA-s i mbështetur nga ekspertë ka organizuar workshop-e për të informuar biznesin mbi angazhimet e ndërmarra nga palët në AP6 dhe nevojën për rishikim të mëtejshëm.

Projektvendim i Komitetit të Përbashkët për lehtësimin e tregtisë së shërbimeve të ofruara nga agjencitë turistike dhe operatorët turistikë: Projektteksti është rishikuar për të përfshirë komentet dhe qëndrimin e palëve. Diskutimet janë ende duke vazhduar në nivel ekspertësh në grupin punues të krijuar për këtë çështje.

Vendimi i Komisionit të Përbashkët për Njohjen Reciproke të Kualifikimeve Profesionale, duke filluar me profesionin e inxhinierëve të ndërtimit: Projektteksti është harmonizuar me draft tekstin e Marrëveshjes për njohjen automatike të kualifikimeve profesionale të bërë nga grupi i punës nën kujdesin e RCC. Marrëveshja për njohjen automatike është finalizuar në tetor 2022 dhe është miratuar për nënshkrim nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Projektvendimi i Komitetit të Përbashkët Për shtimin e një angazhimi horizontal për heqjen e kërkesës për leje pune për aktivitete profesionale sipas Protokollit Shtesë 6: Sekretariati i CEFTA-s është ende në pritje të komenteve nga palët (Bosna dhe Hercegovina).

Vendimi i Komitetit të Përbashkët për lehtësimin e tregtisë elektronike: draft teksti është finalizuar dhe Palët e CEFTA po ndjekin procedurën e tyre të brendshme në mënyrë që ky vendim të miratohet nga Komiteti i Përbashkët.

Në vazhdim të punës për lehtësimin e tregtisë elektronike, Sekretariati i CEFTA-s ka përgatitur dy projektvendime: (i) është përgatitur dhe miratuar në nivel teknik një projektvendim i Komitetit të Përbashkët “Për parandalimin e bllokimeve gjeografike të pajustificuara”. Vendimi bazohet në Rregulloren e BE-së për Bllokimet Gjeografike. Është planifikuar të hyjë në fuqi më 1 janar 2025; (ii) një projektvendim për dorëzimin e pakove. Teksti i këtij vendimi është rënë dakord në nivel

teknik dhe në Nënkomitetin për tregtinë e shërbimeve. Vendimi bazohet plotësisht në Rregulloren e BE-së për dorëzimin e pakove ndërkufitare. Ai pritet të hyjë në fuqi më 1 janar 2025.

- Vendimi i Komitetit të Përbashkët për disiplinën e rregullores së brendshme: Teksti është në diskutim në nivel ekspertësh. Palët e CEFTA-s kanë dakord të miratojnë disiplinën mbi rregulloren e brendshme plotësisht të bazuar në iniciativën e sponsorizuar nga BE-ja nën kujdesin e OBT-së vetëm me rregullimet e nevojshme tekstuale. Marrëveshja synon dakordësimin mbi standardet minimale për licencimin, kualifikimet dhe standardet dhe shtrirjen e mbështetjes për iniciativën e BE-së për palët e CEFTA-s që nuk janë anëtare të OBT-së.
- *Negociatat e Protokollit Shtesë 7 “Për krijimin e Mekanizmit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve”*
- Shqipëria ka marrë pjesë aktive në raundin e negociatave për hartimin e Protokollit Shtesë 7, i cili ka vazhduar intensivisht gjatë vitit 2022. Çështjet që diskutohen kanë të bëjnë me fondin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe përbërjen e panelit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për të cilat ekziston një avancim në diskutimin dhe është rënë dakord për shumicën e paragrafëve të neneve që lidhen me këto çështje. Çështje të tjera që duhen diskutuar janë hyrja në fuqi dhe fillimi i zbatimit të AP7, afatet për procedura specifike etj.

**Në fushën e kontrollit të eksportit për artikujt me përdorim të dyfishtë**, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për mallrat me përdorim të dyfishtë.

- Shqipëria së fundi, ka miratuar dhe nënshkruar Marrëveshje dhe Memorandume dhe Protokolle, bashkëpunimi ekonomik e teknik, specifikisht: Minutat e Sesionit të 4-rt të Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Arabi Saudite, nënshkruar në Riad, më 23.03.2022.

Në datat 6 dhe 7 dhjetor 2022 është parashikuar për t’u zhvilluar në Tiranë Sesionin i 7-të i Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar për Bashkëpunimin Ekonomik Shqipëri-Poloni

Në vitin 2023 , janë parashikuar për t’u zhvilluar Sesionet me vende si: EBA, Kuvajti, Italia, Rumania, Bullgaria, Egjipti, Serbia, Kroacia, Çekia, Izraeli, Azerbajxhani apo Maqedonia e Veriut.

- Në kuadër të zbatimit të agjendës rajonale të reformës së investimeve (RIRA), në bashkëpunim me IFC/WB është hartuar me ekspertët e Bankës Botërore, edhe një model i BIT për Shqipërinë, që është ende në fazën e diskutimeve të brendshme, për të vijuar me miratimin final.

Në mënyrë që të sinkronizohet vizioni 2030 me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe të sigurohet sinergji të të dy proceseve, kërkohen përpjekje të

mëtejshme për të integruar OZHQ/SDG në SKZHI (III), si dhe strategjitë e sektorëve përkatës, politikat dhe planet kombëtare. Një proces planifikimi për hartimin e SKZHI III, i filluar tashmë, synon të përgatisë vizionin afatmesëm për kornizën e planifikimit strategjik të Shqipërisë duke përfshirë kornizën OZHQ/SDG-ve në proces. Planifikohet që Vizioni 2030 të projektohet dhe prezantohet së bashku me SKZHI III.

### 30.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministër Shteti dhe Kryenegociator
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (si përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; dhe çdo ministri apo institucion që ndikon në tregti;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Banka e Shqipërisë;
- Autoriteti i Konkurrencës;
- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave Tregtare;
- Instituti i Statistikave.

### 30.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

*Në fushën e politikës së përbashkët tregtare:*

#### **Mangësitë e identifikuara:**

Aktualisht, Shqipëria ka një njësi të vogël të dedikuar që merret me çështjet tregtare në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik. Janë bërë disa përpjekje për të forcuar kapacitetet administrative për politikën tregtare duke krijuar një njësi tregtare, e cila përbëhet nga një drejtues njësie dhe dy ekspertë, si pjesë e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik. Njësia merret me politikat tregtare, duke përfshirë BE-në, CEFTA-n dhe OBT-në, nën mbikëqyrjen e drejtorit të drejtorisë së zhvillimit ekonomik. Dy ekspertë të njësisë tregtare së bashku me një ekspert nga drejtoria e doganave formojnë Sekretariatit Teknik të Komitetit Kombëtar për Politikat dhe Lehtësimin e Tregtisë. Duke marrë parasysh ngarkesën e lartë që po përballon kjo njësi, rëndësia

e çështjeve që kanë të bëjnë me mbulimin e tregtisë së mallrave, shërbimeve, aspekteve të lidhura me tregtinë e pronësisë intelektuale, prokurimit publik, tregtisë dhe zhvillimit, tregtisë dhe mjedisit, si dhe marrëdhëniet e zgjeruara që kjo njësi ka me BE-në, CEFTA-n, OBT-në, UNCTAD-in, ITC-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare dhe marrëdhëniet tregtare dypalëshe me vendet e tjera është shumë e rëndësishme që njësi të bëhet një drejtori e përbërë me disa njësi.

### **Prioritetet ne këtë fushë janë:**

Në rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021, Shqipëria duhet të:

- vazhdimi i zbatimit të planit kombëtar të veprimit për koordinimin dhe lehtësimin e politikave tregtare dhe forcimin e kapaciteteve administrative;
- vazhdimi i harmonizimit të legjislacionit përkatës me *acquis* në fushën e kontrollit të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë;
- të përfundojë negociatat dhe më pas të miratojë CEFTA AP 7;
- vazhdimi i zbatimit të veprimeve në kuadër të planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021 – 2024 për zhvillimin e Zonës Ekonomike Rajonale, me qëllim arritjen e integritimit ekonomik të rajonit në lidhje me 4 liritë: Lëvizja e lirë e mallrave, lëvizja e lirë e shërbimeve, lëvizjen e lirë të njerëzve dhe lëvizjen e lirë të kapitalit;
- Intensifikimi i bashkëpunimit përmes iniciativës “Open Balkan”;
- vazhdimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Investime.

Në vijim, referuar prioritetëve:

- Shqipëria do të punojë jo vetëm për të rritur dhe forcuar kapacitetet e saj në lidhje me formulimin e politikave tregtare, por edhe për të zhvilluar më tej ato ekzistuese;
- Shqipëria bën një analizë për të zgjeruar njësinë në drejtori me përcaktim të saktë të përgjegjësive, detyrave dhe funksioneve.
- Shqipëria do të vazhdojë të koordinojë pozicionet e saj dhe t’i përafrojë plotësisht politikatat e saj me ato të BE-së, përfshirë edhe ato në kuadër të OBT-së;
- Shqipëria do të sigurojë nivelin ekzistues të koordinimit dhe do të forcojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet e përfshira në formulimin e politikave tregtare. Shqipëria ka vazhduar të bëjë notifikimet e kërkuara sipas neneve 1.4, 10.6.2 dhe 12.2.2 të Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Shkëmbimeve Tregtare.

*Në fushën e mallrave me përdorim të dyfishtë:*

### **Mangësitë e identifikuara:**

- Me miratimin e projektligjit “Mbi tregtimin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese”, do të nisë puna për miratimin e Projektvendimit “Për miratimin e listës së mallrave të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues”, brenda vitit 2022.



**Prioritetet në këtë fushë janë:**

- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit për kontrollin e eksporteve, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të artikujve me përdorim të dyfishtë dhe në Listën Ushtarake të Përbashkët të Bashkimit Evropian (Rregullorja e BE 2017/2268) u ndoq nga Vendimit i marrë nga Qeveria në muajin shkurt. Shqipëria ka miratuar tashmë listën kombëtare të kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë në përputhje me aktet normative të BE;
- Përditësimi i listës së mallrave me përdorim të dyfishtë është prioritet i realizuar për vitin 2021, por mbetet për tu ndjekur sipas ndryshimeve që do të miratoj BE-ja;
- Transpozimi i legjislacionit me aktet normative të BE-së përsa i përket tregtisë së mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose ndëshkim dhe trajtim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues.

*Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe me vende të treta:*

**Mangësitë e identifikuara:**

Forcimi i strukturave institucionale dhe administrative të kërkuara për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 1219/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 12 dhjetor 2012, për krijimin e aranzhimeve kalimtare për marrëveshjet dypalëshe të investimeve midis shteteve anëtare dhe vendeve të treta.

**Prioritetet në këtë fushë janë:**

- Prioritet është miratimi i një modeli shqiptar BIT: Statusi: Modeli BIT për Shqipërinë është hartuar me ekspertë të BB, por është ende në fazën e diskutimeve të brendshme dhe ende nuk është miratuar
- Rishikimi i BIT-ve ekzistues me vendet e treta, me të cilat BE-ja nuk ka mandat për të negociuar dhe do të mbeten në fuqi pas datës së pranimit;
- Negociatat për ndryshimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë vazhdojnë, duke u fokusuar në përfshirjen e specifikimeve që lidhen me tregtinë në shërbime dhe investime;
- Zbatimi i një plan veprimi shumëvjeçar për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor; pas rakordimit nga të gjitha vendet WB6 do të vijohet me ndjekjen e procedurave ligjore të mëtejshme për adaptimin zyrtar të standardeve rajonale të pranuar nga WB6, për negociimin e IIA-ve, bazuar tek RIRA.

*Në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe ndihmës humanitare:*

**Mangësitë e identifikuara:**

- Shqipëria nuk ka kuadër të politikave zhvillimore për bashkëpunim/ndihmë apo agjenci për bashkëpunimin zhvillimor.
- BE rekomandon të krijohet një kornizë ligjore që të mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe politikën e zhvillimit, si dhe ndihmën humanitare ndaj vendeve jo anëtare të BE-së, në përputhje me politikën dhe parimet e BE-së.

- Ligji i vitit 2001 për Organizatat Jofitimprurëse njeh aktivitetet e mundshme të këtyre organizatave në fushën e ndihmës humanitare dhe i lejon ato të kryejnë aktivitete zhvillimore dhe ndihme humanitare në Shqipëri dhe gjetkë.

### **Prioritetet në këtë fushë janë:**

- Prioritet është miratimi i një dokumenti politikash për të trajtuar çështjet e krijimit të strukturës strategjike, ligjore dhe institucionale në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së.

## KAPITULLI 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

### 31.1 Përmbajtja e kapitullit

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) e Bashkimit Evropian u krijua nga Traktati për Bashkimin Evropian (TEU), në 1993, me qëllim ruajtjen e paqes, forcimit të sigurisë ndërkombëtare, promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, konsolidimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Traktati i Lisbonës, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2009, i dha Unionit personalitet juridik dhe krijoi një sërë aktorësh të rinj CFSP, duke përfshirë Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, krijoi Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) dhe përmirësoi Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP), e cila është pjesë integrale e CFSP.

Baza ligjore për CFSP u përcaktua në TBE dhe u rishikua në Traktatin e Lisbonës. Nenet 21- 46, Titulli V, i TEU-së përcaktojnë “Dispozitat e Përgjithshme mbi Veprimin e Jashtëm të Bashkimit dhe Dispozitat Specifike mbi Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP)”. Nenet 205 – 222, Pjesa V e Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) mbulojnë veprimin e jashtëm të Bashkimit.

Vendet anëtare duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dialogun politik në përputhje me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së, të linjëzohen me Deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimtarinë e BE-së dhe të aplikojnë sanksionet dhe masat kufizuese të dakordësuara. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) dhe Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) bazohen në akte juridike, përfshirë marrëveshje ndërkombëtare detyruese dhe në dokumente politike. Acquis përbëhet nga deklaratat, veprime dhe marrëveshje politike.

### 31.2 Struktura e kapitullit

1. Dialogu Politik.
2. Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare.
3. Kontrolli i Armëve.
4. Zbatimi i Masave Kufizuese dhe Sanksioneve Ekonomike.
5. Lufta kundër Terrorizmit.
6. Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

### 31.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, që në hyrje të saj, thekson dëshirën e përbashkët për të zhvilluar më tej një dialog politik të rregullt për çështje dypalëshe dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjellë, përfshirë aspektet rajonale, duke pasur parasysh Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian.

Neni 8 “Dialogu Politik” përcakton se dialogu politik ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian zhvillohet më tej brenda kontekstit të MSA-së dhe do të zhvillohet në drejtim të konsolidimit të marrëdhënieve ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe do të kontribuojë në vendosjen e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit.

Pika 3 e nenit 8 në pjesën “Dialogu Politik” përcakton se Shqipëria dhe BE bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe të mjeteve për shpërndarjen e tyre, nëpërmjet respektimit të plotë dhe zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve të tyre ekzistuese, detyrime këto që rrjedhin nga traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare për çarmatimin dhe mospërhapjen, si dhe detyrime të tjera ndërkombëtare.

Neni 6 i Kuadrit Negociues të BE-së për Shqipërinë përcakton se “në periudhën deri në anëtarësim, Shqipërisë do t’i kërkohet të harmonizojë në mënyrë progresive politikatat e saj ndaj vendeve të treta dhe pozicionet e saj brenda organizatave ndërkombëtare me politikatat dhe qëndrimet e miratuara nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij. Përafrimi i CFSP-së do të monitorohet rregullisht gjatë gjithë procesit të negociatave dhe do të promovohet përmes dialogut të rregullt CFSP”.

### 31.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Për sa i përket politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së, Shqipëria ka një nivel të mirë përgatitjeje. Që prej 1 janarit 2022, Shqipëria mori dhe ka ushtruar mandatin e saj si anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për 2022/2023, duke demonstruar përkushtim ndaj bashkëpunimit shumëpalësh në favor të paqes dhe sigurisë. Shqipëria merr pjesë në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave. Shqipëria linjëzohet plotësisht me të gjitha deklaratat dhe vendimet kufizuese të BE-së. Shqipëria zbaton plotësisht këto masa kufizuese në territorin shqiptar nëpërmjet Komitetit të Masave Shtrenguese Ndërkombëtare. Shqipëria vijon të

zbatojë Strategjinë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024 dhe Planit e saj të Veprimit 2022 – 2024. Shqipëria ka bërë funksionale pikën fokale për armët e zjarrit në Policinë e Shtetit dhe vijon përmirësimet e sigurisë të objekteve të ruajtjes së armatimit dhe municionit.

### *Dialogu Politik*

Marrëdhënia e Shqipërisë me Bashkimin Evropian karakterizohet nga një angazhim gjithëpërfshirës politik dhe institucional i vendit tonë në kuadër të përmbushjes së reformave të nevojshme për anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), dialogu politik Shqipëri-BE lidhur me çështje të integritimit evropian, përfshirë për çështje të politikës së përbashkët të jashtme e të sigurisë, zhvillohet në formatin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit (KSA) dhe nëpërmjet Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit. Këshilli i Stabilizim Asociimit nuk është mbledhur për periudhën raportuese. Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit ka zhvilluar takimin e 15-të të tij, në Bruksel, në datat 1 – 2 dhjetor 2022.

Dialogu politik me BE zhvillohet edhe në fushën e politikës së jashtme të përbashkët e të sigurisë. Një takim i përbashkët i përfaqësuesve të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të BE-së me drejtorët politikë të Ministrive të Punëve të Jashtme të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, u mbajt në Podgoricë, me 13 tetor 2022. Në qendër të diskutimeve ishin lufta në Ukrainë dhe pasojat e saj, zhvillimet aktuale në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe marrëdhëniet BE-Ballkani Perëndimor dhe bashkëpunimi në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme e të Sigurisë dhe të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.

### *Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare*

#### ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA

Gjatë vitit 2022, si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara, Shqipëria i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me ruajtjen e paqes dhe forcimin e sigurisë në mbarë botën, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zbutjen e problemeve ekonomike dhe sociale, promovimin e mbrojtjes dhe forcimit të shëndetit dhe mjedisit. të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimit të multilateralizmit.

Në gusht 2022, Shqipëria dorëzoi përgjigjet mbi çështjet e kërkuara, në kuadër të Raportit të 3-të për Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (CCPR).

MEPJ ka dhënë kontributin e saj gjatë kësaj periudhe lidhur me përgatitjen e Planit të Veprimit për periudhën 2023 – 2025, në zbatim të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 mbi “Gratë, Paqen dhe Sigurinë”.

Duke marrë në konsideratë deklaratimet e bëra më parë për angazhime shtesë në operacionet e OKB-së, si dhe pozicionin aktual që Shqipëria ka si anëtare jo e përhershme në Këshillin e Sigurimit (KS) të Kombeve të Bashkuara, Ministri i Mbrojtjes ka miratuar në parim rritjen e kontributeve me trupa në operacionet e OKB-së. Opsionet e ndryshme të përzgjedhura për pjesëmarrje në operacione, në bashkëpunim me Përfaqësuesin e MM-së në OKB dhe Misionin e RSH-së në OKB, po hidhen në Sistemin e Gatishmërisë së Aftësisë Paqeruajtëse (PCRS) të OKB-së si zotime të Shqipërisë për angazhim me kapacitete FARSH në operacione të OKB-së.

## KËSHILLI I SIGURIMIT

Që prej 1 janarit 2022, Shqipëria mori dhe ka ushtruar mandatin e saj si anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për 2022/2023. Me aktivitetin e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Shqipëria ka demonstruar përkushtim ndaj bashkëpunimit shumëpalësh, në favor të paqes dhe sigurisë. Më 1 qershor 2022, Shqipëria mori Presidencën e KS të OKB. Agjenda e Këshillit për muajin qershor 2022 pasqyroi gjerësisht prioritetet e Shqipërisë për mandatin e saj në KS, në lidhje me respektimin e së drejtës ndërkombëtare, forcimin e llogaridhënies, avancimin e agjendës së grave, paqes dhe sigurisë, marrëdhëniet e OKB-së me organizatat rajonale dhe metodat e punës të Këshillit të Sigurimit. Situata në Ukrainë si pasojë e agresionit rus, që prej shkurtit 2022, me iniciativë të Shqipërisë është përfshirë si çështje e përhershme në agjendën e Këshillit të Sigurimit.

## KËSHILLI I EVROPËS

Gjatë vitit 2022, MEPJ është angazhuar maksimalisht, në bashkëpunim me institucionet e Kosovës, për të realizuar procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Shqipëria, në përputhje me nenin 8 të Statutit të Këshillit të Evropës, ka votuar në mbështetje të vendimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, i cili vendosi të pezullojë Federatën Ruse nga e drejta e përfaqësimit në Komitetin e Ministrave dhe në Asamblenë Parlamentare me efekt të menjëhershëm.

Shqipëria mbështeti projektvendimin e Komitetit të Ministrave për t'u konsultuar me Asamblenë Parlamentare për t'i kërkuar Federatës Ruse të tërhiqet nga Këshilli i Evropës. Komiteti i Ministrave, pas opinionit unanim PACE, vendosi më 17 mars 2022, të përjashtojë Rusinë nga Këshilli i Evropës, me efekt të menjëhershëm, duke filluar nga 16 marsi 2022.

Më 25 korrik 2022, Shqipëria i transmetoi Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës instrumentet e ratifikimit të dy traktateve ndërkombëtare, konkretisht:

- Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare, e njohur si Konventa e Tromsø, dhe
- Protokollin që ndryshon Konventën për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, i njohur si Konventa 108.

Në kuadër të KDNJ, Shqipëria ka qenë aktive në të gjitha sesionit e këtij viti, si me ndërhyrje në cilësi kombëtare, bashkim me një numër deklaratash në mbrojtje të drejtave të njeriut për një sërë çështjesh të ndjeshme ndërkombëtare, ka bashkësponsorizuar një numër rezolutash ku veçojmë rezolutën mbi situatën e të drejtave të njeriut në Ukrainë, atë për emërimin e një Raportuesi të Posaçëm për situatën e të drejtave të njeriut në Federatën Ruse, mbi situatën e të drejtave të njeriut në Rajonin Autonom Ujgur të Xinjiang, në Kinë, rezolutën “Kundër bullizmit kibernetik” etj. Shqipëria ka bashkë-sponsorizuar takimin në nivel ministror për të dënuar sulmin e Rusisë kundër Ukrainës dhe pasojat e tij në të drejtat e njeriut në atë vend.

### *Dialogu për të Drejtat e Njeriut*

Shqipëria ka ratifikuar shumicën e instrumenteve ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe qëndron e angazhuar për të kontribuar në mbrojtjen ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Shqipëria i është bashkuar të gjitha deklaratave BE-së në mbrojtje të drejtave të njeriut.

Shqipëria ka dorëzuar një raportim në kuadër të Raportit të 3-të për Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (CCPR);

Shqipëria ka reaguar në kuadër të rekomandimeve të raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave (CEDAW).

Më 23 mars 2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Pjesëshme të Zgjeruar (EPA) për Rrugët Kulturore”, miratuar me Rezolutën CM/Res (2013)66 për të mundësuar një bashkëpunim më të ngushtë midis shteteve, veçanërisht të interesuar për zhvillimin e Rrugëve Kulturore. Shqipëria u anëtarësua në EPA që nga 12 maji 2022.

### *Kontrolli i Armëve*

Shqipëria ka bërë një progres të dukshëm në fushën e harmonizimit të legjislacionit në fushën e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta. Shqipëria ka plotësuar kuadrin strategjik me miratimin e planit të ri të veprimit për kontrollin e Armëve të Vogla, Municioneve dhe Eksplozivëve (AME) 2022 – 2024. Shqipëria ka rritur shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin me Europol, Frontex dhe Interpol, si edhe me vendet e rajonit, për të luftuar trafikimin e armëve, por edhe kontrollin e tyre në territorin e brendshëm. Shqipëria ka përmirësuar koordinimin e aktiviteteve dhe mbledhjen e të dhënave në fushën e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta, përmes dy instrumenteve të rëndësishëm koordinues në nivelin politik dhe operacional, si Komisioni Kombëtar i AVL dhe Njësia Qendrore e Armëve të Zjarrit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2022, autoritetet shqiptare kanë vijuar zbatimin e “Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024” të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 06.02.2019 dhe zbatimin e Planit të Veprimit të miratuar në

dhjetor 2021, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 9.12.2021 “Për miratimin e planit të veprimit 2022 – 2024, të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024”.

Në zbatim të objektivit 1 të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024, që brenda vitit 2023 të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së, dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, datë 26 maj 2022, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre”, e cila përfaqëson Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/337, datë 5 mars 2018, “Për ndryshimin e Rregullores Zbatuese (BE) 2015/2403 që përcakton udhëzime të përbashkëta për standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të siguruar që armët e zjarrit të çaktivizuar të bëhen të pakthyeshme”.

Në zbatim të objektivit nr. 3 të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024, që brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme qarkullimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) drejt, brenda dhe jashtë vendit tonë, vijon të ulet mjaftueshëm numri i përlllogaritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në vendin tonë, nëpërmjet sekuestrimeve.

Autoritetet shqiptare kanë vijuar zbatimin e Udhërrëfyesit për një Zgjidhje të Qëndrueshme për Zotërimin e Paligjshëm, Keqpërdorimin dhe Trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL)/armëve të zjarrit dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor duke raportuar të dhënat për vitin 2021 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2022.

Shqipëria ka dorëzuar raportin e 8-të të monitorimit të Udhërrëfyesit Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta në Ballkanin Perëndimor, për periudhën janar – qershor 2022, në platformën e krijuar nga SEESAC për këtë qëllim.

Në funksion të monitorimit të Strategjisë Kombëtare dhe Udhërrëfyesit Rajonal, Komisioni Kombëtar mbi Armët e Vogla dhe të Lehta ka qenë plotësisht i angazhuar në koordinimin ndër-sektorial midis institucioneve përkatëse dhe agjencive të zbatimit të ligjit për të koordinuar dhe monitoruar të gjitha aktivitetet në vend në lidhje me Armët e Vogla dhe të Lehta. Komisioni Kombëtar i AVL-ve ka zhvilluar takimin e 7-të dhe të 8-të Lokal Koordinues për Zbatimin e Udhërrëfyesit për një Zgjidhje të Qëndrueshme për Zotërimin e Paligjshëm, Keqpërdorimin dhe Trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL)/armëve të zjarrit dhe Municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor. Komisioni ka marrë pjesë në Takimin e 7-të Rajonal Koordinues për Zbatimin e Udhërrëfyesit Rajonal dhe Takimin Rajonal të Komisioneve Kombëtare të Armëve të Vogla e të Lehta të koordinuara nga SEESAC, të cilat mbahen si pjesë e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian 2018/1788/CFSP në mbështetje të zbatimit të Udhërrëfyesit Rajonal.

Plani i Veprimit është dokumenti strategjik kombëtar më i rëndësishëm në terma të aktiviteteve konkrete dhe domethënëse për përmbushjen e objektivave strategjike në fushën e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta. Në këtë drejtim, gjatë 2022, është bërë progres në rritjen e kapacitetit profesional, njohurive dhe ndërgjegjësimit të anëtarëve të Komisionit në fushën e AVL, rritjen e kapaciteteve hetimore në kuadër të trafikimit të armëve me fokus të veçantë përmirësimin e sistemeve në përdorim të Njesisë Qendrore të Armëve të Zjarrit, rritjen e aksesit të NJQAZ në sistemet relevante për zhvillimin e kapaciteteve analitike dhe gjenerimin e raporteve për qëllime vendimmarrëse. Plani i Punës me SEESAC për rritjen e kapaciteteve të NJQAZ, në kuadër të projektit IPA rajonal të SEESAC, në fushën e kontrollit të AVL, ka qenë një tjetër angazhim shumë pozitiv për zhvillimin e kapaciteteve të kësaj Njësie, por edhe për identifikimin e nevojave konkrete të kësaj njësie dhe mbështetjen e tyre. Paralelisht me forcimin e kapaciteteve të zbulimit të trafikimit të armëve të zjarrit, gjatë kësaj periudhe, Ministria e Brendshme është angazhuar në procesin e reformimit institucional të Policisë Kriminale, duke u bazuar në rekomandimet dhe përvojat e ekspertëve për krijimin e një modeli efektiv në luftën kundër krimit.

Ministria e Brendshme synon rritjen e kapaciteteve analitike, operacionale dhe aksesin e Njesisë Qendrore të Armëve të Zjarrit duke e shndërruar atë në një strukturë të konsoliduar organizative (*sipas modelit të Konkluzioneve të Këshillit të BE për implementimin e Njësive Qendrore Kombëtare të Armëve të Zjarrit në Vendet anëtare të 13 korrikut 2021*), si pjesë e Departamentit të Policisë Kriminale. Kjo masë është parashikuar edhe në Planin e Veprimit 2022 – 2024.

Sa i përket modernizimit të sistemeve dhe rritjen e shkëmbimit efektiv të dhënave, strukturat e policisë shkencore kanë testuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë e sistemit të identifikimit balistik Evofinder, si një sistem i avancuar për identifikimin balistik. Në 31 maj 2022, Shqipëria iu bashkua 5 vendeve të Ballkanit Perëndimor që do të përdorin këtë sistem. Gjatë 6 mujorit të parë 2022, Instituti i Policisë Shkencore (Sektori i Balistikës) ka marrë në dorëzim Sistemin Evofinder (donacion i qeverisë franceze) dhe ka filluar punën për popullimin e tij me të dhëna. Ky sistem do të sjellë rritjen e kapaciteteve në fushën e identifikimit, gjurmimit dhe menaxhimit të armëve të lehta dhe me kalibër të vogël si dhe shkëmbimit të dhënave balistike.

Bazuar në ndryshimet e ligjit për armët, një fokus i veçantë i është dhënë edhe procesit të çaktivizimit, për plotësimin e kuadrit nënligjor, harmonizimit me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/337 e datës 5 mars 2018 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) 2015/2403 që përcakton udhëzime të përbashkëta mbi standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të siguruar që armët e zjarrit të çaktivizohet të bëhen në mënyrë të pakthyeshme të papërdorshme. Në vijim, do të punohet për ngritjen e një sistemi efektiv të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së procesit të çaktivizimit. Transferimi i këtij procesi nga Ministria e Mbrojtjes në Policinë e Shtetit ka shtruar edhe nevojën e transferimit të përvojës dhe ekspertizës së realizimit dhe kontrollit të këtij procesi në Policinë e Shtetit. Gjatë kësaj periudhe janë miratuar 3 Vendime të Këshillit të Ministrave për karakteristikat, llojet dhe parametrat teknikë të armëve të ftohta; për krijimin, aksesin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve dhe rregullorja e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, e cila ka përafëruar pjesërisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/337 e datës 5 mars 2018 që



ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) 2015/2403 e cila përcakton udhëzime të përbashkëta mbi standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të siguruar që armët e zjarrit të çaktivizoheshin në mënyrë të pakthyeshme të përdorshme.

Gjithashtu, në proces konsultimi ndër-institucional janë edhe aktet e hartuara nga Ministria e Brendshme si: projektvendimi “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve, procedurave të shqyrtimit e të vendimmarrjes, formatet e tyre dhe afateve për dhënien e autorizimit për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e artikujve piroteknikë”, projektvendimi “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve, procedurave të shqyrtimit e të vendimmarrjes, formatet e tyre dhe afateve për dhënien e autorizimit për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse” dhe rregullorja “Për kushtet dhe kriteret për përdorimin e magazinimin e artikujve piroteknikë për shitje me pakicë”.

Paralelisht nga Ministria e Mbrojtjes po punohet për hartimin e akteve për licencimin e importit, eksportit, transitit, etj. Ministria e Mbrojtjes / Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksperteve (AKSHE), në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, ka planifikuar projektligjin “Mbi përcaktimin e autorizimeve të eksportit, dhe masat për importin, transitin e armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve” në PKIE 2023 – 2025. Sipas fushës, kjo nismë raportohet në kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave” dhe është parashikuar për miratim në tremujorin e katërt të vitit 2024.

Një ndër hapat vijues në këtë drejtim do të jetë analiza e kuadrit ligjor ekzistues për përcaktimin e përgjegjësiave institucionale në kontrollin e prekursorëve të lëndëve eksplozive, analiza e kuadrit ligjor ekzistues për përafrimin me direktivat e BE 2019/68 dhe 69 për armët sinjalizuese dhe akustike dhe për specifikimet teknike të markimit, për të përcaktuar qartë edhe nivelin e harmonizimit me këtë Acquis të re të BE në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta gjatë vitit 2023.

Gjithashtu, është duke u zhvilluar pastrimi i pikave të nxehta të kontaminuara me armatura të pashpërthyera. Në këtë drejtim, është duke vazhduar puna për pastrimin e zonës së fundit “hot spot” të evidentuar dhe deklaruar, përkatësisht në rajonin e Jubë – Sukthit, Durrës.

Policia e Shtetit ka ndërmarrë veprimtarinë e verifikimit dhe regjistrimit në regjistrin kombëtar të gjitha armëve në pronësi të qytetarëve të cilat janë dhënë para hyrjes në fuqi të Ligjit 74/2014 “Për armët”. Ka vijuar regjistrimi i armëve të gjahut (armë të cilat sipas ligjit 74/2014, (152/2020) konsiderohen armë të kategorisë “C” në pronësi të qytetarëve). Qytetarët posedojnë 103 062 armë gjahu (nën kategorinë “C”), të cilat janë të regjistruara në sistem në çdo stacion policie (manualisht). Në periudhën 1 janar deri 30 qershor 2022, rezultojnë 1,148 armë të kategorisë “C” verifikuara dhe ri-regjistruara. Në total në përfundim të 6-mujorit të parë janë verifikuar dhe ri-regjistruar 73,986 armë ose 71,88% në raport me totalin e armëve në përdorim të personave fizik dhe juridik në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë 2022, ka vijuar zbatimi i projektit "Forcimi i kontrollit, administrimit dhe qëndrimeve sociale ndaj AVL (Armëve të Vogla dhe të Lehta)" dhe janë blerë pajisjet për avancimin e reregjistrimit të armëve dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të armëve SIMA.

Shqipëria ka bërë përmirësime të mëtejshme në sigurinë e ambienteve të magazinimit për armatimet dhe municionet. Aktualisht është duke u përmirësuar siguria fizike dhe infrastruktura e 10 (dhjetë) magazinave të AVL nga kompania e kontraktuar nga UNDP.

Gjatë periudhës raportuese ka përfunduar projekti “Rritja e masave të sigurisë së kontrollit të Armëve të Vogla e të Lehta (AVL) në Shqipëri”, përmes të cilit u realizua përmirësimi i infrastrukturës së mjediseve të magazinimit të AVLME dhe u rikonstruktuan magazinat e armatimit të AVLME në DVP Tiranë, DVP Korçë dhe mjediset e markimit të armatimit në Qendrën e Furnizimit, në Mullet. Gjithashtu, u mundësua blerja e 50 kasafortave për armët e gjata të zjarrit të sekuestruara.

Me kërkesën e Komisionit Kombëtar për AVL është miratuar nga Fondi i Besimit Shumëpalësh financimi i përmirësimit të 13 ambienteve të tjera të ruajtjes dhe magazinimit të armatimit në Policinë e Shtetit, i cili do të zbatohet nga UNDP/SEESAC gjatë vitit 2023, përveç atyre aktualisht në proces rikonstruktimi.

Në ligjin nr. 152/21 “Për armët”, të rishikuar, përcaktohet se “Armët e zjarrit, pjesët kryesore dhe municionet, si dhe ato të grumbulluara me ligj nga Policia e Shtetit të gjetura në ambiente, armët stok nga ristrukturimi i armatimit të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, SHISH, apo hotspote nga strukturat e FA-së, i kalojnë Ministrisë së Mbrojtjes me urdhër të përbashkët për kalim kapital. Ministria e Mbrojtjes, për këto armë, pjesët kryesore dhe municionet e tyre, kryen procedurat e demilitarizimit, asgjësimit të tyre dhe shitjes për skrap.

Ministria e Mbrojtjes, edhe gjatë vitit 2022, ka vijuar proceset e shkatërrimit të sasive të armëve të lehta dhe të vogla të tepërta dhe të dala jashtë funksioni, sasive të armatimit të marra nga Ministria e Brendshme dhe ato të gjetura në hotspote të ndryshme.

#### *Materialet me përdorim të dyfishtë*

Në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian, Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve filloi procedurat e brendshme për vlerësimin e angazhimit të mundshëm në marrëveshjen Wassenaar. Vlerësimi u krye në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe të gjitha institucionet e tjera që do të jenë pjesë e këtij procesi. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme janë dakordësuar për vazhdimin e procedurave për anëtarësim.

Gjatë vlerësimit të kryer nga Ministria e Mbrojtjes, Autoriteti i Kontrollit të Eksportit dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, bazuar në kriteret e aplikimit, u deklarua se Republika e Shqipërisë i respekton plotësisht të gjitha kriteret e marrëveshjes Wassenaar.

Procesi i dokumentimit për përmbushjen e kriterëve dhe përgatitjen e dosjes së kandidaturës vijon. Konkretisht, duhet të dorëzohet një listë shteruese e elementeve për secilin kriter me informacion në lidhje me kuadrin legjislativ, politikat, çështjet teknike dhe statistikat. Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti Shtetëror Shqiptar i Kontrollit të Eksporteve po punojnë në këtë proces dhe po mbledhin të gjithë informacionin nga të gjitha institucionet e përfshira.

#### *Mospërhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë (C-WMD)*

Si një anëtare e NATO dhe kandidate për BE, Shqipëria do të vazhdojë të inkurajojë, mbështesë dhe forcojë më tej politikat e saj të kontrollit të armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen e armëve, si elementë kryesorë të sigurisë Euro-Atlantike dhe globale, si dhe do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet për dialog brenda Këshillit NATO-Rusi, për zvogëlimin e rrezikut të Rusisë dhe rritjen e transparencës së saj.

Shqipëria nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 22.01.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimeve Masive (DMD) dhe Planit të saj të Veprimit” ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimeve Masive, duke përmbushur detyrimet e Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve shtetërore të saj, në zbatim të përgjegjësive që burojnë nga Rezoluta 1540 e KS të OKB-së për ndalimin e përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM-së) në nivel rajonal dhe global.

Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit Masive (DMD) dhe Plani i saj të Veprimit janë plotësisht të linjëzuara me Strategjinë e BE për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit Masive, e miratuar nga Këshilli, nr. 15656/3.

Sipas kapitullit VI “Zbatimi i Strategjisë”, rishikimi i saj parashikohet deri në fund të vitit 2025. Duke qenë se Plani i Veprimit të kësaj strategjie ka afat tre vjeçar dhe përfundon në vitin 2022, Koordinatorin Kombëtar në Ministrinë e Mbrojtjes ka filluar konsultimet me Sekretariatit Teknik, institucionet mbështetëse dhe Qendrën Rajonale për Bashkëpunim dhe Siguri, RACVIAC, në interes të hartimit të planit të ri të veprimit.

Nën drejtimin dhe organizmin e Qendrës Rajonale për Bashkëpunim dhe Siguri RACVIAC, në Kroaci, në datat 26-30 shtator 2022, u zhvillua një takim rajonal i pikave të kontaktit të Projektit mbi Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë (WMD) që shërbeu për orientimin e fazave të projektit dhe inicimin e Planeve të reja të WMD për vendet e rajonit, të cilat ndodhen aktualisht në procesin e hartimit të draft planeve.

Ministria e Mbrojtjes ka caktuar Koordinatorin Kombëtar si përgjegjës për ndjekjen e realizimit të masave të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë. Koordinatorin Kombëtar drejton Sekretariatit Teknik që ka në përbërje përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Autoritetet përgjegjëse për realizimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë kanë vijuar të ndjekin realizimin e masave të parashikuara në planin e veprimit, sipas objektivave të strategjisë.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për ngritjen e kapaciteteve për mospërhapjen dhe reagimin ndaj situatave me Armë të Dëmtimit në Masë (C-WMD), në Ministerialin e Mbrojtjes së NATO-s, të zhvilluar në datën 22 tetor 2021, Ministri i Mbrojtjes firmosi “Letrën e Qëllimit”, nëpërmjet së cilës vendet anëtare të NATO-s zotohen të bashkëpunojnë mbi zhvillimin e menaxhimit e zbulimit të agjentëve kimikë, biologjikë e radiologjikë, si dhe identifikimin e kapaciteteve, si edhe për sigurimin e pajisjeve mbrojtëse kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore. Në këtë kuadër, Shqipëria, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, është duke ndjekur procedurat e nevojshme për pjesëmarrjen në projektin e NATO-s mbi bashkëpunimin shumëkombësh në kuadër të ngritjes së kapaciteteve në fushën “Chemical, Biological, Radiological and Nuclear (CBRN)”.

Ligji Nr. 72, datë 17.10.2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë parashikon detyrimin ligjor për implementimin e Rezolutës së OKB-së lidhur me parandalimin, ndërprerjen dhe shkatërrimin e përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre.

#### *Zbatimi i Masave Kufizuese dhe Sanksioneve Ekonomike*

Zbatimi i masave kufizuese të BE-së, kryhet mbi bazën e Ligjit Nr. 72/2019 “Për Masat Shtrënguese Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 454, datë 10.06.2020 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr. 72/2019. Me datë 30.12.2020, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1128, me anë të së cilës Republika e Shqipërisë ka filluar të zbatojë masat kufizuese në vijim të vendimeve të Këshillit të BE-së.

Ky ligj nuk përfshin masa kufizuese në lidhje me financimin e terrorizmit, të cilat tashmë janë adresuar nga ligji për Masat kundër Financimit të Terrorizmit.

Për periudhën raportuese janë miratuar:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 24.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 13.1.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 2.2.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika

- e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
4. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 92, datë 9.2.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
  5. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 123, datë 2.3.2022 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
  6. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 157, datë 11.3.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
  7. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 168, datë 18.3.2022 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
  8. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 187, datë 30.3.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
  9. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 200, datë 6.4.2022 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.
  10. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 215, datë 13.4.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
  11. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 292, datë 11.5.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
  12. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 341, datë 26.5.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
  13. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 373, datë 1.6.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.

14. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 413, datë 15.6.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
15. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 448, datë 29.6.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
16. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 527, datë 29.7.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
17. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 631, datë 28.9.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
18. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 638, datë 5.10.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
19. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 670, datë 19.10.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
20. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 715, datë 11.11.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
21. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 718, datë 11.11.2022 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Rregulloreve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare”.
22. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 738, datë 23.11.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
23. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 830, datë 19.12.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
24. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 877, datë 27.12.2022 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.

25. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 10, datë 11.01.2023 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.
26. Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 14, datë 18.01.2023 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 30.12.2020 “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të Vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar.

Komiteti i Masave Shtrënguese Ndërkombëtare vijon aktivitetin e tij normal në zbatim të kompetencave të përcaktuara në ligjin 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 454, datë 10.6.2020. Gjatë vitit 2022, Komiteti është mbledhur 4 herë, përkatësisht në 10 mars, 31 maj, 19 shtator dhe 2 nëntor, për të diskutuar zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si kryesuese e Komitetit për Masat Shtrënguese Ndërkombëtare, vijon përpjekjet për rritjen e kapacitetit të anëtarëve të KMSHN, sa i takon zbatimin e sanksioneve të BE-së, duke angazhuar ekspertizë të Komisionit Evropian dhe të shteteve anëtare. Në prill, qershor e shtator 2022 janë zhvilluar, respektivisht: Misioni i ekspertëve në Shqipëri, i iniciuar nga Departamenti për Stabilitet Financiar dhe Tregjet e Kapitalit (DG FISMA), mbi zbatimin e masave kufizuese në nivel të BE-së; një takim virtual mes Grupit të Ekspertëve të Komisionit Evropian mbi Masat Kufizuese dhe përfaqësuesve të administratave nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të angazhuar me implementimin e sanksioneve të BE në territoret e vendeve të tyre; një seminar në Shqipëri për çështje të Kapitullit 31, si dhe për koordinimin, zbatimin dhe sfidat e hasura sa i takon zbatimin korrekt të masave shtrënguese të BE-së.

Ministria e Mbrojtjes ka përfunduar procesin e krijimit të bazës së të dhënave (listë), me pikat e kontaktit të çdo strukture të MM-së dhe FARSH-së që mund të preken nga masat shtrënguese. Lista e pikave të kontaktit mundëson ndërveprim më të shpejtë, monitorim dhe raportimin e drejtpërdrejtë të strukturave në Ministri.

Gjithashtu, në Ministrinë e Mbrojtjes, përpos legjislacionit në fuqi për masat shtrënguese (Ligjit nr. 72/2019 dhe VKM nr. 454, datë 10.6.2020), është hartuar dhe miratuar udhëzimi nr. 2/2022, i Ministrisë së Mbrojtjes “Për miratimin e udhëzimit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen në Ministrinë e Mbrojtjes për propozimin e vendosjes së masave dhe zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i vendos, zbaton, ndryshon ose i shfuqizon”.

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi në Ministrinë e Mbrojtjes, i rregullave dhe procedurave të propozimit për vendosje të masave shtrënguese dhe të zbatimit të masave shtrënguese ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i vendos, zbaton, ndryshon ose i shfuqizon, në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vendimet e miratuara nga organizatat

ndërkombëtare, në të cilat ajo është shtet anëtar, akteve të Bashkimit Evropian, si dhe me Ligjin nr. 72/2019. Për çdo informim që vjen pranë adresës së Ministrisë së Mbrojtjes ndiqen hapa të detajuara të brendshme, që përcaktojnë procedurat për:

- njoftimin dhe shpërndarjen e informacionit nga pika hyrëse deri në të gjitha strukturat e Ministrisë që mund të kenë veprime;
- zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare (bllokimin e përkohshëm me 30 ditë deri në dalje të VKM dhe më pas zbatimin sipas vendimit);
- detyrimet e strukturave MM dhe FARSH për zbatimin dhe masat që duhen të merren.

Sa i takon zbatimin e masave të përcaktuara në Rekomandimin 7 të FATF, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP), në cilësinë e kryesuesit të Delegacionit përfaqësues për Shqipërinë pranë Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Këshillit të Evropës (MONEYVAL), ka përcjellë pranë MEPJ kërkesën për ndryshim të ligjit nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim rritjen e vlerësimit për Rekomandimin 7 të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), specifikisht masat shtrënguese ndërkombëtare në lidhje me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

MEPJ dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për DPPP, do të bashkëpropozojnë projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 72/2019”. Gjithashtu, krahas rregullimeve ligjore të nevojshme për rritjen e vlerësimit për Rekomandimin 7 të FATF, vlerësohet i nevojshëm edhe rregullimi ligjor sa i përket ndarjes së qartë të përgjegjësive të institucioneve kompetente për zbatimin e këtij ligji (neni 11, pika 1 i ligjit).

### *Lufta Kundër Terrorizmit*

Shqipëria është anëtar i koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, duke e konsideruar bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit si një përparësi për agjencitë e zbatimit të ligjit. Ekzistojnë kuadri ligjor dhe strukturat e duhura për të parandaluar dhe luftuar çdo kërcënim të sigurisë nga aktet terroriste. Shqipëria është një vend që nuk ka përjetuar akte terroriste, por është përballur me fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë, qytetarë që shkojnë në zonat e konfliktit në Siri / Irak, madje edhe me familjet e tyre, gratë dhe fëmijët.

Shqipëria linjëzohet plotësisht me politikën e jashtme të BE-së në luftën kundër terrorizmit, duke pasur parasysh veçanërisht promovimin e dialogut ndërkulturor, qeverisjen e mirë dhe për të trajtuar shkaqet themelore të radikalizmit.

Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025 dhe Plani i saj i Veprimit (2021 – 2023), miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1173, datë 16.12.2020 është dokumenti kryesor në luftën kundër terrorizmit. Plani i Veprimit 2021 – 2023, parashikon masa konkrete që duhen të realizohen për përmbushjen e qëllimeve të politikave dhe objektivave specifike, sipas afateve të përcaktuara.



Sa i takon vazhdimin të angazhimit në Planin e Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit dhe marrëveshjen dypalëshe zbatuese, gjatë vitit 2022, Shqipëria në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian inicioi procesin e rishikimit të marrëveshjes mes Komisionit Evropian dhe autoriteteve shqiptare për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në dritën e zhvillimeve të fundit të kuadrit institucional dhe ligjor, por edhe të sfidave dhe kërcënimeve të reja në lidhje me radikalizmin online, radikalizmin në burgje apo aspekte si monitorimi dhe rehabilitimi-riintegrimi i Luftëtarëve të Huaj të Kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak ose familjarëve të tyre, rritjen e shkëmbimit të dhënave dhe informacioneve të inteligjencës mes strukturave të antiterrorit dhe vendeve partnere, por edhe mbrojtja e hapësirave publike dhe infrastrukturës kritike, u finalizua Plani i Veprimit i rishikuar, i cili u nënshkrua në Bruksel, më datë 9 dhjetor 2022, nga Ministri i Brendshëm dhe Komisionerja Y. Johansson.

Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe luftës kundër Terrorizmit është në fazat finale të miratimit të saj. Në përbërje të saj, kjo strategji do të ketë 2 (dy) plane veprimi, të ndara sipas fushave përkatëse të luftës kundër terrorizmit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Strategjia e re do të jetë në përputhje me shtyllat strategjike të Qeverisë së Shqipërisë, por edhe me angazhimet e Shqipërisë në sferën euroatlantike, duke përfshirë procesin e integritimit në BE. Fokusi i Strategjisë së re mbi parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm do të jetë i fokusuar në tre shtylla kryesore, të cilat ndahen në: 1. Parandalim; 2. Rehabilitim, Ri-integrim dhe Ri-socializim; 3. Komunikimi Strategjik.

Strategjia është pjesërisht e harmonizuar me drejtimet kryesore (shtyllat) të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe masat prioritare të përcaktuara në dokumentet strategjike të BE.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit 2022 – 2026 dhe Plani i Veprimit 2022 – 2024 ishin planifikuar për t'u miratuar në PKIE 2022 – 2024 në tremujorin e dytë 2022. Në varësi të zhvillimit të takimeve konsultuese me Delegacionin e BE dhe kohës së reflektimit të komenteve të tyre mundet që të mos miratohet brenda vitit 2022. Duke mbajtur në konsideratë këtë, është planifikuar përsëri në tremujorin e parë 2023, në Kapitullin 24 të PKIE 2023 – 2025.

QKEDH në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit synon të ndërhyjë në kurrikulën bazë arsimore për ta pasuruar atë në kuadrin e njohurive arsimore të përgjithshme të nxënësve shqiptarë duke iu referuar konceptit bazë. Po zhvillohet gjithashtu një proces për krijimin e platformave të edukimit digjital, ku veçanërisht të rinjtë mund të shkëmbejnë ide dhe të ndërtojnë narrativa alternative efektive për t'iu kundërvënë këtij fenomeni, një qasje e cila do të kontribuojë në zhvillimin e të menduarit kritik për çështje të tilla si demokracia, feja, të drejtat dhe liritë e individit etj.

Me 16 mars 2022 u lidh Marrëveshja e Bashkëpunimit me Rektoratin e Tiranës për angazhimin e profesorëve për përfshirjen e njohurive mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmit në

literaturën studentore. Janë kryer disa takime për mënyrën se si do zbatohen njohuritë e EDH në lëndë të veçanta si e drejta ndërkombëtare.

Fuqizimi ekonomik i grave të kthyer deri më tani duke i përfshirë dhe në kurse mbi aftësimin profesional është gjithashtu në fokus të punës së CVE.

Sa i takon angazhimit në terren, qendra CVE vazhdon angazhimin maksimal për koordinimin, monitorimin e punës me ministrinë e linjës, agjencitë ligjzbatuese, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të lehtësuar procesin e rehabilitimit, riintegritit dhe risocializimit për të 37 (tridhjetë e shtatë) qytetarët shqiptarë të kthyer nga kampet Al-Hol dhe Roj, në Siri, në të tre riatdhesimet, përfshirë dhe të fundit më 27 maj 2022.

Në datat 26 – 30 shtator 2022, u zhvillua në Tiranë, Misioni i Vlerësimit nga Komisioni Evropian, në lidhje me monitorimin e institucioneve dhe funksionimin efektiv të tyre mbi sfidat e paraqitura nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm zhvilloi takimin me ekspertët e KE, përfaqësues të zyrës së Kryeministrit, Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Ministria e Mbrojtjes. Gjithashtu në përmbushje të këtij misioni, Qendra CVE koordinoi dhe realizoi takimin me ekspertët të Misionit të Vlerësimit të KE dhe Këshillit Ndërfetar Shqiptar, me përfaqësues të komuniteteve fetare.

### *Politika Evropiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes*

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë kanë struktura të përshtatshme për të marrë pjesë në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si dhe në politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes.

Angazhimi i Shqipërisë në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (CSDP) është në përputhje me orientimet për angazhim aktiv ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe synon vijimin e kontributit për konsolidimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes si në rajon, ashtu edhe në arenën globale.

Shqipëria merr pjesë në misionet ushtarake të menaxhimit të krizave nën Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP). Aktualisht, Shqipëria merr pjesë në misionin ushtarak EUFOR ALTHEA në Bosnje Hercegovinë.

Në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian, Ministria e Mbrojtjes ka bërë një vlerësim paraprak të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes (EDA). Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme janë duke zhvilluar bisedime të përbashkëta me EDA mbi mundësitë dhe hapësirat për bashkëpunim në të ardhmen.

Më 26 tetor 2022, Ministria e Mbrojtjes zhvilloi takime lidhur me mundësinë e ofrimit të asistencës me anë të instrumentit të BE-së për Paqen (European Peace Facility). Gjatë këtyre takimeve, u diskutuan propozimet për mundësi bashkëpunimi në fusha të ndryshme të sigurisë dhe të mbrojtjes.

### *Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar me BE*

Në funksion të procedurave të sigurisë për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar me BE, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 836, datë 14.10.2015 “Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së”, i cili përcakton rregullat për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Në mars të vitit 2016, është nënshkruar marrëveshja midis Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi procedurat për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshjeje, u realizua vizita inspektuese nga EEAS (Drejtoria e Sigurisë dhe Infrastrukturës e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian), në Tiranë, më datë 21-24 nëntor 2022. Vizita përfshiu prezantime mbi legjislacionin në lidhje me sigurinë në Shqipëri, organizimin e sigurisë, si dhe për të gjitha fushat e tjera të sigurisë: sigurinë e personelit, sigurinë e menaxhimit të dokumenteve, sigurinë fizike, sigurimin e informacionit dhe sigurinë industriale; diskutime dypalëshe (një ekspert i BE-së + një ekspert shqiptar) për temat e përmendura më sipër; vizitën e zyrës së Regjistrit Qendror, Nën – regjistrin, si dhe të institucioneve ku trajtohen dokumente që përmbajnë informacion të klasifikuar.

Në lidhje me mbrojtjen dhe trajtimin e informacionit të klasifikuar nga Shqipëria, Delegacioni i BE-së, në kuadër të vizitës vlerësoi legjislacionin në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, organizatat e sigurisë (NSA dhe organe të tjera të përfshira), sigurinë e personelit, sigurinë e menaxhimit të dokumenteve, sigurinë fizike, sigurimin e informacionit, sigurinë industriale.

Në konkluzionet paraprake të datës 24 nëntor, delegacioni i BE-së vlerësoi kuadrin ligjor kombëtar në fushën e informacionit të klasifikuar, si dhe masat e marra nga institucionet në të cilat u krye vizita vlerësuese. Një vizitë vlerësuese do të zhvillohet edhe në Misionin e Republikës së Shqipërisë pranë BE-së, në Bruksel.

Në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të Kapitullit 31, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar hartoi ligjin e ri “Për informacionin e klasifikuar”, i cili synon të përafrojë pjesërisht Vendimin e Këshillit të BE 2013/488 i datës 23 shtator 2013 mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së, i ndryshuar. Projektligji është miratuar në Këshillin e Ministrave në datë 13.07.2022 dhe nisur nga procedurat e brendshme ligjore, akti është shqyrtuar nen për nen, në Komisionet e Kuvendit (Komisioni i Sigurisë, Integritimit Evropian dhe Ligjeve) dhe pritet të miratohet në Kuvend në seancën e radhës me 15.12.2022.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shifrës në Ministrinë e Mbrojtjes, hartoi “Rregulloren për përzgjedhjen dhe instalimin e pajisjeve që përpunojnë informacion të klasifikuar”, i cili përaftron pjesërisht disa akte të klasifikuara të BE-së, konkretisht “Politikën e garantimit së sigurimit të informacionit në TEMPEST”, “Udhëzime për sigurinë e informacionit për zgjedhjen dhe instalimin e pajisjeve TEMPEST”, si dhe “Udhëzime për sigurinë e informacionit mbi procedurat e zonimit TEMPEST”. Ky akt u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 232, datë 13.04.2022, brenda afatit të planifikuar në PKIE 2022 – 2024, në tremujorin e parë 2022.

### 31.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- SHISH;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Ministria e Drejtësisë;
- Agjencia Kombëtare Bërthamore;
- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

### 31.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Shtetet anëtare duhet të jenë të afta të zhvillojnë dialog politik në kuadrin e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes, të jenë në linjë me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimtarinë e BE-së dhe të zbatojnë sanksionet dhe masat shtrënguese të dakordësuara në nivel të Bashkimit Evropian.

Prioritetet në Kapitullin 31 janë:

Në kuadër të *politikës së përbashkët të jashtme e të sigurisë*, Shqipëria do të vijojë të ruajë linjëzimin e plotë me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së;

Në kuadër të *politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes*, Shqipëria do të vijojë kontributin për konsolidimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes, si në rajon, ashtu edhe në arenën globale. Në përputhje me prioritetet e Strategjisë Globale të Bashkimit Evropian, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Shqipëria do të përfaqësohet me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Grup Batalionet BE, në gjashtëmujorin e parë 2024-01, në gatishmëri të ulët dhe për gjashtëmujorin e dytë 2024-02, në gatishmëri të lartë. Ministria e Mbrojtjes do të

vlerësojë hapësirat për bashkëpunim me EDA, si dhe do të vijojë të angazhohet në kuadër të Instrumentit të BE-së për Paqen.

Në kuadër të *organizatave ndërkombëtare*, përgjatë periudhës 2023 – 2025, pritet të ketë raportime, në kuadër të Këshillit të Evropës, në këto komitete:

1. GRETA – Grupi i Ekspertëve kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore;
2. FCNM – Konventa Kuadër e pakicave kombëtare – Raport i Komitetit Këshillimor për Konventën kuadër të pakicave kombëtare në gjysmën e dytë të 2023;
3. CPT – Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës – Raport gjatë 2023 ose 2024, në varësi të periudhës që do të zhvillohet vizita e CPT në Shqipëri;
4. ESCR – Komiteti Evropian i të Drejtave Civile - Pritet një raport për Shqipërinë gjatë vitit 2023 ose 2024.

Në kuadër të *zbatimit të Strategjisë kombëtare për armët e vogla dhe të lehta, dhe hetimeve dhe ndjekjen penale të trafikut të armëve të zjarrit, dhe Planit të Veprimit 2022 – 2024*, Ministria e Brendshme synon shndërrimin e Njësisë Qendrore të Armëve të Zjarrit në një strukturë të konsoliduar organizative (sipas modelit të Konkluzioneve të Këshillit të BE për implementimin e Njësisë Qendrore Kombëtare të Armëve të Zjarrit në Vendet anëtare të 13 korrikut 2021) pjesë të Departamentit të Policisë Kriminale.

Në kuadër të plotësimit të kuadrit nënligjor, nga Ministria e Mbrojtjes po punohet për hartimin e akteve për licencimin e importit, eksportit, transitit, etj. Ministria e Mbrojtjes / AKSHE, në bashkëpunim me MB, ka planifikuar projektligjin “Mbi përcaktimin e autorizimeve të eksportit, dhe masat për importin, transitin e armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve” në PKIE 2023 – 2025. Sipas fushës, kjo nismë raportohet në kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave” dhe është parashikuar për miratim në tremujorin e katërt të vitit 2024.

Një ndër hapat vijues gjatë vitit 2023 do të jetë analiza e kuadrit ligjor ekzistues për përcaktimin e përgjegjësive institucionale në kontrollin e prekursorëve të lëndëve eksplozive, analiza e kuadrit ligjor ekzistues për përafrimin me direktivat e BE 2019/68 dhe 69 për armët sinjalizuese dhe akustike dhe për specifikimet teknike të markimit për të përcaktuar qartë edhe nivelin e harmonizimit me këtë *acquis* të re të BE në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta.

Në lidhje me procesin për t’iu bashkuar *Marrëveshjes Wassenaar*, bazuar në punën e bërë gjatë vitit 2022 për mbledhjen e dokumentacionit dhe informacionit nga institucionet kryesore kontribuuese për përgatitjen e dosjes së aplikimit, parashikohet që gjatë vitit 2023 që dosja të jetë e plotë për aplikim pranë sekretariatit, pasi të kalojë edhe një herë konsultimin ndërinstitucional me dokumente të përkthyer në gjuhën angleze.

Në lidhje me *mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë (C-WMD)*, rishikimi i Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimeve Masive parashikohet deri në fund të vitit 2025. Duke qenë se Plani i Veprimit të kësaj strategjie ka afat tre vjeçar dhe përfundon në vitin 2022, Koordinatorin Kombëtar në Ministrinë e Mbrojtjes ka filluar konsultimet me Sekretariatit

Teknik, institucionet mbështetëse dhe Qendrën Rajonale për Bashkëpunim dhe Siguri, RACVIAC, për hartimin e planit të ri të veprimit.

Në kuadër të *zbatimit të masave kufizuese dhe sanksioneve ekonomike*, lidhur me zbatimin e masave të përcaktuara në Rekomandimin 7 të FATF, inicimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2019” do të jetë bashkëpropozim i MEPJ me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në lidhje me masat *për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin*, kërkohet një qasje shumëdimensionale dhe përfshirja e të gjithë aktorëve qendrorë dhe vendorë në zbatimin e kuadrit ligjor strategjik në fuqi, me qëllim parandalimin dhe zhvillimin e alternativave të qëndrueshme.

Sa i takon riatdhesimit të shtetasve shqiptarë që ndodhen aktualisht në zonat e konfliktit, Siri dhe Irak, do të synohet rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale për të gjitha strukturat e kategorizuara në të ashtuquajturën “qasje e butë”, por jo vetëm. Të gjitha programet e riintegritimit për këtë kategori, përfshirë gratë/vajzat dhe fëmijët, do të kërkojnë angazhim të vazhdueshëm dhe afatgjatë të burimeve financiare dhe njerëzore në terren. Aktualisht, këto burime mbeten ende të kufizuara.

Sa i takon miratimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit 2022 – 2026 dhe Planit të Veprimit 2022 – 2024, mundet që miratimi të shtyhet për tremujorin e parë 2023 në PKIE 2023 – 2025. Planifikimi do të bëhet në Kapitullin 24.

Lidhur me masat për përmirësimin e bazës ligjore të sigurimit të *informacionit të klasifikuar* që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe informacionit, miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në VKM nr. 542, datë 25.07.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI)”, planifikohet në Kapitullin 31, në tremujorin e katërt të vitit 2023 të PKIE 2023 – 2025.

Nuk janë zbatuar detyrimet ligjore që informacioni i klasifikuar të trajtohet në pajisje dhe sisteme të akredituara nga DSIK, në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar i cili është përafër me *acquis* e BE. Marrja e këtyre masave do të prioritetizohet në vijim, edhe në bazë të rekomandimeve të raportit të vizitës së Misionit Vlerësues në Tiranë, që pritet në fillim të vitit 2023.